

KDU 811.18(06)(05)

821.18(06)(05)

008(=18)(05)

FAKULTETI I FILOLOGJISË – PRISHTINË

FACULTY OF PHILOLOGY – PRISTINA

FAKULTETI HISTORI-FILOLOGJI – TIRANË

FACULTY OF HISTORY-PHILOLOGY – TIRANA

**SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË
DHE KULTURËN SHQIPTARE**

**INTERNATIONAL SEMINAR FOR ALBANIAN LANGUAGE,
LITERATURE AND CULTURE**

REVISTË / JOURNAL

38

ISSN 2521-3687

VËLLIMI / VOLUME

1

PRISHTINË, 38/2019

Kryeredaktor/Editor in Chief:

Shkumbin Munishi

Redaksia/Editorial Board:

Shkumbin Munishi (Prishtinë), Bardh Rugova (Prishtinë), Osman Gashi (Prishtinë), Muhamet Hamiti (Prishtinë), Blerta Ismajli (Prishtinë), Haki Hysenaj (Prishtinë), Shpëtim Elezi (Prishtinë), Rahman Paçarizi (Prishtinë), Sali Bashota (Prishtinë), Albulena Blakaj-Gashi (Prishtinë), Lindita Tahiri (Prishtinë), Abdulla Rexhepi (Prishtinë), Muhamet Jahiri (Prishtinë), Evalda Paci (Tiranë), Erenestina Halili (Tiranë), Dhurata Shehri (Tiranë), Lili Sula (Tiranë), Viola Isufaj (Tiranë), Mimoza Kore (Tiranë), Idriz Metani (Tiranë), Linda Mëniku (Tiranë), Lindita Latifi (Tiranë), Flora Koleci (Tiranë), Kastriot Gjika (Tiranë), Julie Kolgjini (New York), Maria S. Morozova (Shën Peterburg).

PËRMBAJTJA

LIGJËRATA..... 7

Bardh RUGOVA

E ARDHMJJA NË BAST – FUTURI I SHQIPES 9

Aleksandra DUGUSHINA, Maria MOROZOVA, Aleksandër NOVIK
RINGJALLJA E ETNICITETIT NË KOHËN DIGJITALE:
DIASPORA E SHQIPTARËVE NË UKRAINË 47

Evalda PACI

NJË TRADITË GJURMIMESH ALBANOLOGJIKE MBI
HISTORINË E JETËS DHE TË BËMAVE TË GJERGJ
KASTRIOTT-SKËNDERBEUT 63

TRYEZA..... 99

Anton Nikë BERISHA

RRETH VEPRËS “KËNGËTORJA ARBËRESHE” TË FRANÇESK
ANTON SANTORIT 101

Don Lush GJERGJI

IMZOT PJETËR BOGDANI, NJERI I ZOTTIT DHE POPULLIT
(1625 – 1689 (PROFILI SHPIRTËROR DHE KULTUROR)..... 129

Evalda PACI

CUNEUS PROPHETARUM (1685), NJË VEPËR MADHORE NË
SHËRBIM TË DIJES DHE ATDHETARISË 143

GJUHËSI / LINGUISTICS..... 158

Anila KANANAJ, Shezai RROKAJ

PËR HARTIMIN E NJË FJALORI TË GJUHËS SHQIPE TË
ILUSTRUAR PËR FËMIJË..... 160

Delina BINAJ PËRSHKRIMI I STRUKTURAVE GJUHËSORE TË GJINIZUARA SI SFIDË PËR REFLEKTIMIN E NDËRTIMIT TË IDENTITETEVE GJINORE NË GJUHËN SHQIPE.....	178
Elsa SKËNDERI RAKIPLLARI TRI METAFORA KONCEPTUALE NË LIGJËRIMIN POLITIK NË SHQIPËRI.....	194
Hysnie HAXHILLARI (HYSKA) VËSHTRIM GJENERATIVIST I KLASËS SË PËREMRAVE NË GJUHËN SHQIPE.....	220
Julie KOLGJINI ZHVENDOSJA E TRAJEKTORES SË STIGMËS: DUKURIA <i>SHIBBOLETH</i> NË SHQIPEN BASHKËKOHORE	236
Marek MAJER PARAHISTORIA INDOEVROPIANE E FJALËS SHQIPE PËR 'MOTRËN'	252
Rozana RUSHITI STRUKTURA E SHQIPES AKTUALE NË STILIN E LETËRSISË ARTISTIKE (VEPRA ORIGJINALE E I. KADARESË DHE PËRKTHIMI NË ITALISHTË).....	267
TRYEZA E DOKTORANTËVE.....	283
Agnesa HASIMJA KOMPETENCA GRAMATIKORE E NXËNËSVE TË KLASAVE XII NË PRISHTINË.....	285
Anila SHORRI A JANË NJËSI TË VEÇANTA LEKSIKORE FOLJET VETVETORE NË GJUHËN SHQIPE?	307

Behar HOXHAI LËVIZJET SEMANTIKE GJATË PROCESIT TË SHNDËRRIMIT TË PARAFJALËS PËR NË PARASHITESË	311
Edona JAHIU NDIKIMI I GJINISË NË GJUHË TEK ADOLESHENTËT NË PRISHTINË.....	324
Entela MAZE (KORE) TIPARE TË PËRBASHKËTA ARKAIKE MES ÇAMËRISHTES DHE AUTORËVE TË VJETËR	342
Hana RADONIQI VLERA DALLUESE DHE KONTRASTIVE E THEKSIT NË GJUHËN SHQIPE.....	352
Labinot KRASNIQI FORMIMI I SHUMËSIT TË EMRAVE NË SHQIPE ME PRAPASHITESAT ME BURIM TURK -LLARË / -LERË	367
Majlinda BUSHAJ DISA VEÇORI TË NJËSIVE FRAZELOGJIKE NË KRAHINËN E POSTRIBËS.....	382
Mjellma ZHARA BILINGUALIZMI SHQIP-TURQISHT NË QYTETIN E PRIZRENTI.....	414
Senad NEZIRI VARIANTET AKTUALE TË SHQIPES NË PRIZREN E RRETHINË	426
Shemsi HAZIRI DALLIMET TERMINOLOGJIKE NË LIGJIN E TRAFIKUT RRUGOR (KOSOVË) DHE NË KODIN RRUGOR (SHQIPËRI)	436

Sheqere TABAKU KUNDRINOR I ZHDREJTË ME PARAFJALË APO RRETHANOR? TRAJTIMI GJENERATIVIST I TYRE	448
Zana PREKAZI GJYMTYRËT E VEÇUARA, FJALITË E NDËRMJETME DHE FJALITË E NDËRKALLURA TË SHQIPES – TRI KATEGORI, NJË FUNKSION.....	458
Zeqije XHAFÇE LESIKALIZIMI I NGJYRAVE NË GJUHËN SHQIPE: HUAZIMET DHE SINONIMET.....	468

LIGJËRATA

Bardh RUGOVA

E ARDHMJA NË BAST – FUTURI I SHQIPES

1. Çështje konsensusi

Çështja e së ardhmes në gjuhën shqipe, në gramatikat me orientim tradicional¹, është thujse konsensuale. E ardhmja është e përfshirë në mënyrën dëftore: e ardhmja (do të punoj), e ardhmja e përparme (do të kem punuar), e ardhmja e së shkuarës (do të punoja), e ardhmja e përparme e së shkuarës (do të kisha punuar) (Domi 1995: 316-318; Jashari, Çitaku 2009: 123; Dhrimo et al 1989: 209; Newmark et al 1982: 50 – 51; Demiraj 1980: 283).

Disa gramatika e thjeshtojnë në vetëm dy: të ardhmen dhe të ardhmen e përparme (future perfect). (Camaj 152 – 153; Beci 2001: 115; Friedman 2003: 49; Douchet 1995: 257; Mulaku, Kelmendi 1988: 150; Demiraj 1971: 156-157).

Gramatikat tradicionale (Domi 1995: 273) të ardhmen e përkufizojnë ose si një kohë foljore që shënon “një veprim që pritët të kryhet pas çastit të ligjërimit”, ose (Camaj 1984: 152) si një kohë foljore që indikon një veprim që shfaqet (arising v.j.) pas çastit të ligjërimit.

Sami Frashëri në “Shkronjëtoje e gjuhësë shqip” (1886) e përdor fjalën *e pritmja*, në vend të *e ardhmja*.

Këto klasifikime dhe përkufizime ndërtohen nga bindja që del qysh nga antikiteti se kohë themelore të foljes janë: e tashmja, e shkuara dhe e ardhmja (Domi 1995: 273) dhe se koha shpjegohet (si edhe në shumë gjuhë të tjera) përmes një boshti kohor dydimensional.

¹ Për ndonjë përjashtim, si Buchholz e Fiedler (1987), Breu (2009, 2010) do të diskutojmë më pas, ndonëse nuk ndryshojnë thelbësisht.




Fig. 1. Metafora tradicionale e kohësisë

Metafora më e zakonshme e rrjedhës së kohës në studimet tradicionale është boshti dydimensional me një drejtëz dhe një pikë të veçuar imagjinare brenda saj (O po e zëmë) që shënon çastin e ligjëritimit. Ajo pikë (O) e çastit të ligjëritimit e përfaqëson të tashmen, gjithçka para saj e përfaqëson të shkuarën dhe gjithçka pas saj e përfaqëson të ardhmen. Tutje në bosht ka pika si A ose C (në të shkuarën) apo B (në të ardhmen) si pika referimi, ndaj të cilave një veprim është edhe më i hershëm ose më i ardhshëm. Përmes analizës kritike të diskursit do të mund të vërenim se kjo metaforë mbështetet në mendësinë se e ardhmja është e shkruar, pra se një veprim kryhet në të ardhmen, siç kryhet në të tashmen dhe të shkuarën.

Kjo metaforë na e shfaq të ardhmen si një entitet, ku ne e dimë kryerjen e veprimit, aq sa e dimë në të tashmen apo në të shkuarën. Natyrisht, pa dashur të merremi me mendësi të tilla, do të mund të themi se e ardhmja, si veprim i këtitillë i përket vetëm të së shkuarës. Para pikës O mund të jetë një pikë tjetër C, pas të cilës (por gjithsesi para O-së) është kryer një veprim (A) dhe në atë rast kemi një veprim që përbën të ardhme në raport me pikën C (e që është e shkruar në raport me pikën O, çastin e ligjëritimit). Mirëpo, a ka një B diku, një veprim në të ardhmen? Për këtë do të argumentojmë së shpejti brenda këtij teksti.

Sidoqoftë, edhe përtej këndvështrimeve tradicionale, ndarja: e tashme, e shkruar, e ardhme është propozuar shpeshherë në studime të rëndësishme linguistike.

Siç kemi raportuar dhe më parë (Rugova 2009: 181-182), kjo është trajtuar edhe nga autorë që e kanë parë kohën përtej fjalisë. Egon Werlich (1983: 143), së këndejmi, mendon se koha është një njësi e këndvështrimit që ndikon në zgjedhjet e emetueses varësisht nga ajo se si emetuesja i kundron dukuritë në raport me çastin e orientimit përgjatë kontinuimit

kohor. Mbi këtë përkufizim, Werlich sheh tri mundësi të emetueses: trajtimin e dukurive në një hapësirë të pakohë (paskajorja e tipit *me punue*); si dhe në kohë absolute (para e pas pikës O, si dhe në pikën O në boshtin tonë metaforik – pra e tashme e shkuar dhe e ardhme), si dhe në kohë relative – pra në raport me çastin e shkuar të orientimit në kontinuumin e kohës në të shkuarën (para “para së tashmes” – pika C në boshtin tonë të imagjinuar metaforik), në të tashmen (gjatë para së tashmes) dhe të ardhmen (pas së para të tashmes). Kohë relative do të mund të ishin koha më se e kryer, e pakryera, e ardhmja e përparme e së shkuarës e kështu me radhë (shih Rugova 2009: 182).

Boshti metaforik dydimensional i kohës i paraqitur në figurën 1 u shkon për shtati edhe koncepteve të Harald Weinrichut, i cili kohët e foljes i ndan në bazë të tri boshteve informative: qëndrimi folës, perspektiva folëse dhe relievizimi i tekstit (shih Ismajli 1980: 96-97). Sipas perspektivës folëse bëhet dallimi në kohë të tashme, të shkuar dhe të ardhme. Sipas relievizimit të tekstit bëhet dallimi ndërmjet kohëve të planit të parë të rrëfimit (pika A në boshtin metaforik të kohësisë) dhe kohëve të prapavijës (pika C në boshtin metaforik të kohësisë). Kohë të tilla të prapavijës mund të jenë të tejshkuarat: më se e kryera (kisha punuar) dhe e kryera e tejshkuar (pata punuar) (Weinrich 2001 (1964), interpretuar sipas Ismajlit 1980).

Në gramatikat tradicionale të shqipes, ku është shënuar kushtorja si mënyrë më vete, format: do të kem larë dhe do të laja janë konsideruar, përkatësisht, si kohë e tashme dhe e kryer (Domi 1995: 295), ndërsa është thujse konsensuale që format e dëshirores (punofsh) dhe të urdhërores (puno) të konsiderohen si kohë të tashme.

Ah, po! Është shënuar edhe koha kam + paskajore gege si formë jostandarde, tok me formën kam + për të punuar (Camaj 1984: 152, Çeliku 2006: 285).

Bokshi (2012a), në studimin e tij të shkëlqyeshëm diakronik, do të argumentojë se paskajorja e tipit me + forma e pjesores e së kryerës (me dalë, me ardhë) është përfutur para krijimit të mbiemrit të nyjshëm dmth

brenda huazimeve latine, para shekullit VI të e.s., ndërsa perifraza kam + ky infinitiv është përftuar shpejt më pas (Bokshi 2012a: 31).

Sipas tij, nga format e futurit të përftuar nga perifraza i pari është futuri me do + lidhore, i dyti kam + paskajore, kurse kam + paskajorja e dytë “kam për të punuar” pas krijimit të nyjës së përparme, pas shekullit VI pra. Forma kam të punoj edhe më e re, shekujt 12 – 13, kur tashmë largohet infinitivi nga toskërishtja (Bokshi 2012a: 36).

Dhe po. Kundërvënia *do të punoj – kam me punu* (Mansaku 2012: 83 e quan tip roman i futurit) del si një shembull themelor i modalitetit në shqipen, me formën *do të punoj* si modalitet epistemik dhe *kam me punu* si tipik deontik.

Forma do + lidhore që është pjesë e shqipes së sotme standarde, është një nga veçoritë e Sprachbundit ballkanik (së pari vërejtur nga Kopitari (1829), e diskutuar mes tjerësh nga Sh. Demiraj 1994, B. Demiraj 2012, Mansaku 2012).

Ky është, përmbledhtazi, diskutimi për futurin në gjuhën shqipe.

Gjithçka është e qartë dhe pak a shumë konsensuale. Kjo do të nënkuptonte se ky diskutim do të duhej të kishte përfunduar këtu dhe ne të gjithë do të shkojmë të lumtur në shtëpi.

Përralla në shkallë, dukati në ballë.

Mirëpo, kjo ligjëratë mëton të ofrojë një tjetër pikë vështrimi të problemit. Është një pikë e tillë e vështrimit që e hedh të ardhmen në bast.

Ky këndvështrim tjetër i problemit lidhet me vetë nocionin e ardhme apo futur.

Për ta elaboruar problemin, po nisim menjëherë nga përkufizimi i kohës në gramatikën e shqipes: nëpërmjet kategorisë gramatikore të kohës shprehet lidhja midis kohës kur kryhet veprimi i emërtuar nga folja dhe një çasti të caktuar që merret si bazë për marrëdhëniet kohore. Si bazë për marrëdhëniet kohore në gjuhën e folur merret çasti i ligjëritimit, kurse në gjuhën e shkruar merret ose çasti kur shkruajmë ose një çast tjetër i përfytyruar (Domi 1995: 273).

Cili qenka veprimi që kryhekëshka në të ardhmen? Nuk ka një veprim që kryhet në të ardhmen, përveç një veprimi në të shkuarën që ka

ndodhur pas një veprimi tjetër po në të shkuarën. E pamë te relievizimi i tekstit te boshti dydimensional.

Pra, na duhet ta dekonstruktojmë, fillimisht, boshtin dydimensional.

Boshti dydimensional i kohës nuk është një drejtëz, por është një kometë, e cila e ka kokë të tashmen, bisht të gjatë të shkuarën dhe një tërësi mundësish, disa të parashikueshme e disa të gjashme, disa më të pritshme e disa më pak të pritshme, të dëshirueshme e të domosdoshme, të lejueshme e të kushtëzuara që janë përpara e që ne i quajmë futur. (Për këtë do të shohim konceptimin e mëpasshëm – irrealis mood).




Fig. 2. Metafora e kometës. Koka e kometës në lëvizje e përfaqëson të tashmen – çastin e ligjërit

Si në një refren brutal punku të grupit *Sex Pistols*² do të konstatojmë: no future - nuk ka të ardhme.

Çka paska?

Për të trajtuar problemin, së pari, duhet të japim një sfond filozofik, do të thosha. Ta diskutojmë të ardhmen si ide.

² Varg nga kënga “God Save the Queen” e grupit *Sex Pistols*.

2. Histori e kohës

Sabri Hamiti e ka një poezi të titulluar “Dashunia paskajore me shqipen”, të cilën e fillon me këto vargje:

*“Kam me të dashtë përjetë edhe mbas vdekjes
Sepse unë nuk due të vdes por kam me vdekë”*

Në këto dy vargje i kemi mbi 2000 vjet diskutimesh filozofike mbi kohën.

I pari meditim filozofik i regjistruar për kohën, në të vërtetë i përket jo një poeti, gjuhëtari, fizikani a filozofi, por një mjeku - më të famshmit ndër të gjithë mjekët, Hipokratit (shih Weinrich 2008: 6):

*Ho bíos brakbús,
hē dē tékhnē makrḗ,
ho dē kairòs oxús,
hē dē peíra sphalerḗ,
hē dē krísis khalepḗ³*

Dy vargjet e para të thënies së Hipokratit janë bërë të famshme përmes përkthimit në latinishten: *Vita brevis, Ars longa* (jeta e shkurtër, arti i gjatë). Tekhne, në greqishten e vjetër nuk ka të bëjë me artin në kuptimin e sotshëm (sepse edhe vetë përkufizimi i artit është i ndryshueshëm ndër kohë), por me mjeshtrinë, pra veprën, shëmbëlltyrën.

Hipokrati, së këndejmi, flet për jetën si të shkurtër dhe për trashëgiminë e njeriut përmes veprës së tij. Koha shihet si koncept fizik.

Në terma të Lakoffit dhe të Johnsonit (1980), koha si njësi abstrakte, kur trajtohet si entitet fizik, del metaforë.

Gjysmë shekulli pas Hipokratit, Aristoteli do të përkufizojë: “Koha është një numër në lëvizje përkಿತazi me më parë dhe më pas” (shih Weinrich 2008). Pra, për Aristotelin koha vlen vetëm në raport me hapësirën, pa hapësirën koha është një abstraksion, një infinit, një diçka e pjesëtuar me zero.

³ Jeta e shkurtër, arti i gjatë, shansi i qëndrueshëm, eksperimenti i rrezikshëm, gjykimi (vendimi) i vështirë (v.j.).

Mirëpo, ai sheh domosdonë dhe mundësinë në raportin “pas”. E domosdoshmja nënkupton të mundshmen, por është në kundërvënie me të padomosdoshmen dhe kundërshton të pamundshmen.




Fig. 3. Përkuftizimi i Aristotelit i pasqyruar në këtë skemë të njohur (Sibih Auwera, Aguilar 2016: 24)

Kanti (2000 (1781)) i kthehet konceptimit aristotelian dhe nxjerr termin modalitet (në Mesjetë përdorej termi *modus*) ashtu që e lidh me domosdonë dhe mundësinë e propozimeve (shih Auwera, Aguilar 2016: 11). Ai e çon modalitetin në katër kategoritë e gjykimit njerëzor tok me cilësinë, sasinë dhe relacionin.

Së këndejmi: “Sepse unë nuk due të vdes por kam me vdekë”, duket si një kundërvënie mes dy modaliteteve: due të vdes (modalitet epistemik, mundësi) dhe kam me vdekë (modalitet deontik, domosdo). Të dyja janë veprime përtej çastit të ligjërimit: e para si veprim që ka dëshirë të emetuesit që të kryhet dhe e dyta si veprim që është domosdo për emetuesin për t’u kryer ndonjëherë apo parashikim i sigurt. Nuk mund të

vendosen në boshtin kohor, sepse asnjëra nuk ka ndodhur dhe gjasat për realizimin e cilitdo nga këto veprime janë pak të rëndësishme. E mundshmja dhe e domosdoshmja janë nocione që i përkasin së ardhmes – njëfarë parashikimi figurativ i drejtimit që do të marrë kometa jonë dydimensionale e kohës.

Dy vargjet e Sabri Hamitit ofrojnë, në fakt, një histori të diskutimeve për kohën që nga antikiteti deri në fund të shekullit XVIII.

Mirëpo, Sabri Hamiti, po ashtu, thotë:

Me shkue, me shkue, krejt njisoj asht me shkue...

Me shkue do me thanë, me vdekë, pak nga pak...

E me mbetë çka do të thotë me mbetë përjetë...

Përtej modalitetit aristotelian e kantian të domosdosë a të mundësisë, kundrimi i kohësisë jo si bosht me drejtëz të pafund, por me një kometë në lëvizje, e vë futurin në një rang tjetër nga e shkuara dhe e tashmja.

Së këndejmi, një zhvillim posaçërisht i rëndësishëm në këtë kuadër do të shfaqet në shekullin XX në formën e përkufizimit të termit “irrealis mood” që në strukturalizëm vihej në kundërvënie me termin “realis”, ndonëse është përdorur edhe termi “potencialis” si i treti.

Përmes Sapirit (1930 (1992:186-187)) u shfaq si term i përgjithshëm që shënon çkado që s’është reale ose faktuale ose veridikale (e prekshme në kuptimin e vërtetueshmërisë), shpesh përfshin edhe potencialitetin (shih Auwera, Aguilar 2016: 12).

Pra, irrealis është krejt ajo hapësira ku mund të lëvizë koka e kometës, pos pjesës që është në kometë. Gjithçka që s’është në bosht është irrealis. Figurativisht, krejt çka është në kometë është realis, drejtimi i mundshëm i kometës është irrealis.

Palmeri më 2001 (shih Auwera, Aguilar 2016), por jo më 1986, mënyrat i ndan jo më si te latinishtja në pesë, po në dy grupe kryesore: realis dhe irrealis. Brenda tyre krijohen kategorizime të tjera. Nëse e shohim sipas Palmerit: te realisi dëftorja e shqipes ka të tashmen, të pakryerën, të kryerën, të kryerën e thjeshtë, më se të kryerën, të kryerën e tejshkuar dhe, ndonëse nuk janë në gramatikat e shqipes, format e tejtjeshkuara të tipit: kam pasë shkuar, kisha pasë shkuar (për këto të

fundit shih Rugova, Sejdiu-Rugova 2015: 175). Do të punoj, qoftë si dëshirë, qoftë si pritshmëri, thjesht, mbetet në shtresën e irrealës, përderisa nuk përbën veprim konkret, por veprim të projektuar për t'u realizuar.

Koha reale dhe koha si kategori gramatikore, natyrisht, nuk kanë një shenjë barazie mes vete. Deri këtu, u përpoqëm të argumentojmë se koha reale nuk është një drejtëz e pafund, meqë e ardhmja nuk është asnjëherë e shkruar ose e parashkruar. Kjo bën që koha si kategori gramatikore të manifestojë pritshmëri, mundësi, domosdo, kushte e shumëçka tjetër në atë hapësirën e projektuar para çastit të ligjërimit.

Në këtë kuadër, kur flasim për futurin mund të flasim për modalitete në njërin anë dhe, më shumë se kaq, në anën tjetër mund të flasim për mënyrën irrealis.

Prandaj, tani na mbetet ta përkthejmë në gjuhësi këtë koncept filozofik.

Kjo nënkupton diskutimin në dy rrafshe: a. për çka mendojmë, kur themi e ardhme dhe b. cilat struktura gramatikore i shfrytëzojmë për t'i shprehur ato që i kemi menduar si të ardhme.

Kur themi e ardhme a flasim për një veprim që projektohet (me çfarëdo modaliteti) në të ardhmen në raport me çastin e ligjërimit, apo një veprim në raport me një çast të caktuar brenda rrëfimit pavarësisht çastit të ligjërimit? Apo të dyja?

Do të përpiqemi të ofrojmë shembuj që tregojnë konceptimet e së ardhmes dhe strukturat gjuhësore të atyre konceptimeve:

- a. Parashikim i rëndomtë: Si duket, do të bjerë shi nesër! Nesër bie shi! (Përdoret e ardhmja dhe e tashmja);
- b. Parashikim faktik: (Tash, sot) nesër, lind dita. Nesër do të lindë dita. (Përdoret edhe e tashmja);
- c. Parashikim faktik si tërheqje e vëmendjes a e vërejtjes: Treni ka për t'u nisur (me u nisë) në dhjetë! Unë kam me ardhë nesër!
- d. Imanencë të "garantuar": Ika, shihemi nesër! (në kuptimin Do të shkoj tani) Erdha, pritme! (në kuptimin Do të vij së shpejti...).
- e. Aranzhim: Unë (do të) dal për ta pritur Selimin nesër në aeroport. (Përdoret edhe e tashmja e dëftores);

- f. Veprim i kërkuar: Dil jashtë! Mund të dalësh jashtë; Duhet të dalësh jashtë! A po del përjashta? Ke me dalë jashtë, (meqë të them unë)! (Më shumë forma gjuhësore të shfrytëzuara);
- g. Veprim i mundshëm: Mund të dal nesër! Do të mund të dilja nesër. Ndoshta dal nesër. Ka mundësi që dal nesër. Ndoshta do të dal nesër. Do të kisha dalë nesër. Kisha për të dalë nesër. (Shkallë të ndryshme mundësie e gjase, reflektuar me forma gjuhësore të ndryshme).
- h. Veprim i lejuar/urdhëruar: Le të shkojë (nesër).
- i. Veprim i planifikuar (orar): Treni nisët në dhjetë (pas dhjetë minutash). Sipas orarit, treni do të nisët në dhjetë.
- j. Veprim i dëshiruar: Uroj të mbushesh mend një ditë; U gëzofsh; Ishalla mbushesh mend!
- k. Një veprim në zhvillim e sipër në të ardhmen: Nesër do të jem duke punuar;
- l. Një veprim i pritshëm në të ardhmen e afërt: Treni sa nuk është nisur. Qe mu tash, do të nisët treni.
- m. Projektim i së ardhmes dhe diskutim i saj si veprim i përfunduar: Veç edhe një muaj, veç kur të shohim: ti erdhe; Veç edhe një muaj e ti do të jesh i ulur këtu.
- n. Veprim i kushtëzuar: Nëse do të vije, do të bëje mirë. (Ka një tërësi shembujsh, të ofruar më poshtë – shih).
- o. Bashkëkohësi e paskohësi në të ardhmen: Kur ti të vish, unë do të kem çfarë të të tregoj.
- p. Parakohësi në të ardhmen: Kur ti të vish, unë tashmë do të jem i vdekur.

Etj.

Problemin mund ta shtrojmë edhe në këndvështrime të tjera:

- E ardhmja si e sigurt: Nesër do të lindë dielli. Nesër ka me lindë dielli.
- E gjasshme: Nesër mund të ketë shi. Do të mund... (gjasë e zbutur)
- E domosdoshme: Nesër duhet t'i bësh detyrat. Por edhe do të të duhet... (domosdo jo si urdhër)

- E dëshirueshme: Nesër do të ta blej dhuratën. U gëzofsh (kurdo)!
- E lejueshme: Le të shkojë. (Le të shkojë tani, por veprimi mund të realizohet vetëm pas çastit të regjistruar si tani. Në gramatika kjo shihet si e tashme, sepse çasti i ligjërimit lidhet me lejen, por veprimi si veprim lejohet të kryhet në të ardhmen dhe nuk është duke u kryer tani. Përse do të duhej t'i jepnim leje dikujt për një veprim që është duke u kryer, pos kur themi: *Le të vazhdojë* që sërish lidhet me veprim në të ardhmen).
- E urdhëruar: Lexo! (Edhe kjo shënohet si e tashme e urdhërores, por sërish, urdhri jepet në çastin e ligjërimit, por veprimi ende s'ka ndodhur, se po të kishte ndodhur s'do të duhej të urdhëronim).
- E kushtëzuar: Nëse do të vije, do të zhgënjeheshe. (Ka plot forma të së ardhmes së kushtëzuar, për të cilat do të diskutohet më detajisht më poshtë).
- E befasueshme: Paska me ardhë! (Habitorja me paskajoren gege, si e ardhme). Mirëpo, ka edhe *Nesër hapeshka shkolla!*

Etj.

Siç po shihet, ajo që shihet si veprim i projektuar pas çastit të ligjërimit, përfshin kontekste të ndryshme gjuhësore dhe shprehet me struktura të ndryshme gjuhësore – madje edhe kohën e tashme dhe të kryerën e thjeshtë (p.sh. erdhja!).

Mund ta shohim, po ashtu, si një veprim të ardhshëm jo në raport me çastin e ligjërimit, por me një çast të caktuar brenda ligjërimit:

- Në atë kohë, Skenderbeu do të luftonte me osmanët.
- ... kështu Skenderbeu kishte hyrë pa luftë në Krujë. Një vit më pas, ai do ta organizojë Kuvendin e Lezhës.
- ... kështu Skenderbeu kishte hyrë pa luftë në Krujë. Vetëm tani do të mund të thërriste princat e tjerë shqiptarë në një Kuvend.

Etj.

Siç po shihet, ajo që shihet si veprim i projektuar pas çastit të ligjërimit, përfshin kontekste të ndryshme gjuhësore dhe shprehet me struktura të ndryshme gjuhësore.

Mirë, le të shohim çfarë thotë gjuhësia këtu.

Siç po e shohim, dalin dy gjëra për t'i diskutuar. Në njëren anë kemi disa kontekste të ndryshme të së ardhmes – e ardhmja nuk shihet si një entitet i vetëm. Në anën tjetër, kemi disa forma të ndryshme gjuhësore, me të cilat shprehen ato kontekste.

Për këtë arsye, do të përqipemi të bëjmë analizën e këndvështrimit folës (për kontekstet) dhe çështjen e gramatikalizimit (për format gjuhësore).

3. Këndi i vështrimit

Po nisim me këndvështrimin folës.

Akira Kurosawa në filmin e tij kult *Rashomon*, më 1950, rrëfen për një krim, të parë dhe të rrëfyer nga katër persona të ndryshëm që më pas e interpretojnë secili në mënyrë të veten atë që ka ndodhur, por ajo që rrëfëhet nuk është gjithnjë e njëjta.

Në këtë film, disa nga interpretimet e së vërtetës varen nga këndi nga i cili është parë ngjarja, e disa nga këndi i interesit të atij/asaj që e ka parë ngjarjen.

Të dyja këto përbëjnë këndvështrim.

Këndin, nga i cili shihet bota dhe nga i cili bëhen zgjedhjet gjuhësore brenda tekstit, e kemi quajtur këndvështrim teksti (Rugova, Sejdiu-Rugova 2015: 155). Këndvështrimin, siç e pamë figurativisht nga shembulli i filmit të Kurosawa, mund të trajtohet në dy boshte: atë të zgjedhjes gjuhësore (si stil) dhe si paraqitje e qëndrimeve, e prirjeve dhe e ideologjive (gjuhësia kritike).

Te Kurosawa, interesi i dëshmitarëve të ngjarjes, përfshin këtë boshtin e dytë.

Mbi këto dy boshte kryesore, këndvështrimi i tekstit mund të trajtohet si strukturë, funksion dhe përmbajtje.

Janë katër kategori që e përbëjnë këndvështrimin: koha, hapësira, individi (psikologjia) dhe shoqëria (ideologjia) (Fowler 1986; Simpson 1994: 10).

Siç kemi interpretuar edhe më parë (Rugova, Sejdiu-Rugova 2015: 155, 156), këndvështrimi hapësinor e shfaq “këndin e kamerës”. Varësisht nga pozita ku jemi, edhe e interpretojmë botën. Në film, po e zëmë, nëse kamera vihet më lart, personi duket më i vogël, nëse kamera vihet më poshtë, personi duket më i madh. Francis Baconi në Renesansën e vonë (shih Popper 1997:83), nisur nga këndvështrimi i tij personal i hapësirës, e kishte parë diellin e vogël që po vinte rreth Tokës së madhe dhe mbi parimin e këtij vëzhgimi e kishte nxjerrë parimin se Toka është statike, ndërsa Dielli rrotullohet rreth saj. Sikur Baconi të kishte qenë në pozitën neutrale që është mesi i trajektores mes Tokës dhe Diellit, do ta kishte parë përmasën e vërtetë të Diellit dhe Tokës. Ai ka dhënë mendim të gabuar, sepse nuk e ka llogaritur fare këndvështrimin e tij personal, faktin se ai është duke e parë Diellin nga Toka. Dawkins (2014), për të ilustruar çështjen e këndvështrimit, ofron dialogun e filozofit Ludwig von Wittgenstein me një mik të tijin lidhur me këndvështrimin. Wittgensteini e kishte pyetur mikun e tij se përse njerëzit kishin kujtuar (si Baconi) se Dielli sillet rreth Tokës. “Për shkak se ashtu duket?” – i ishte përgjigjur miku. “E si do të dukej ndryshe rrotullimi i Diellit rreth Tokës?” – kishte shtruar pyetjen retorike si konstatim filozofi. Thelbi i shembullit të Wittgensteinit është që të tregojë se, kur bëhet një vëzhgim, krahas objektit të vrojtuar, duhet të llogariten edhe vëzhguesja dhe, me këtë, edhe këndi i vështrimit të saj.

Njësi të këndvështrimit filmik vlejné në rrëfimet e shkruara: mizanskena, fokusi, plani i gjerë, plani i ngushtë, rakursi i bretkosës, rakursi i zogut e kështu me radhë.

Lexueseve, si edhe shikueseve në film, u ofrohen objektet, hapësirat e personazhet në mënyra të ndryshme (Simpson 1994:11) që mund të jenë plane të ngushta të *film noir* a plane të gjera si ato të Isa Qosjes (te *Kukumi* po e zëmë) me karakteristika lëvizëse në panoramë (Rugova, Sejdiu-Rugova 2015: 156).

Kjo është diskutuar në njëfarë mënyre që nga Platoni. Platoni bën fjalë për dy lloje të ndryshme të imitimit. I pari është imitimi i drejtpërdrejtë, pra sa më i përafërt me objektin që synohet të imitohet dhe tjetri është qëllimisht i ndryshuar për t’iu dukur audiencës më i saktë a më

i mirë se objekti origjinal. Ai ofron shembujt e statujave gjigande greke që shikoheshin nga poshtë (rakursi i bretkosës) dhe për këtë arsye këmbët do të duken më të mëdha dhe koka më e vogël. Prandaj, skulptorët e asaj kohe bënë devijimin e qëllimshëm, duke i bërë këmbët më të vogla e kokat më të mëdha, në mënyrë që kur të shihen nga poshtë të duken “më të vërteta”. Kjo është quajtur simulacrum⁴.

Këndvështrimi kohor shfaqet posa e dinamizojmë pamjen. Filmata, rrëfimet gojore, rrëfimet e shkruara kanë fleshbekë, prolepsa, ndërthurje të ngjarjeve, bashkëkohësi veprimesh etj.

Njësi që përbëjnë këndvështrimin e kohës janë ato që i ka përshkruar Weinrich e që e kemi paraqitur më lart: çasti i ligjërimit, relievizimi i tekstit (një çast brenda rrëfimit), qëndrimi folës (a jemi duke rrëfyer apo duke i përfolur fjalët e dikujt tjetër). Për këtë do të flitet më gjerësisht pak më poshtë.

Këndvështrimi i individit si këndvështrim psikologjik (shih Rugova, Sejdiu-Rugova 2015: 156) ka të bëjë me mënyrat se si teksti është bartur (njësia e mediumit të kategoritë e komunikimit të Jacobsonit) përmes vetëdijes së rrëfimitares (Simpson 1994:10). Kjo nisët nga ideja se emetuesja është një person me mendime të vetat dhe me shqisa e dije të kufizuara. Mbështetur në këto kufizime ajo e bënë edhe interpretimin e botës. Së këndejmi, mendimi i shprehur i një individi nuk është vetëm një mendim për objektin e diskutuar nga vetë individi, por përbën një masë informacionesh që të tjerët marrin edhe për atë. Së këndejmi, qëndrimet e Baconit se Dielli sillet rreth Tokës nuk përbëjnë vetëm këndvështrimin hapësinor, por edhe atë të individit të asaj kohe dhe të mendësisë së Renesansës.

Këndvështrimi në rrafshin e ideologjisë është edhe më i ndërlikuar. Në konceptimet strukturaliste sosyriane gjuha shihet si thelb dhe vështrohet pa kontekst, si manifestim apo pasqyrim i realitetit. Wittgensteini (1922) do ta pasqyronte me thënien e tij se kufijtë e gjuhës sime nënkuptojnë kufijtë e botës sime. Kemi gjuhë, për atë që kemi botë dhe, sipas kësaj, del se gjuha shërben për të pasqyruar realitetin përreth.

⁴ Baudrillard (1981) thotë se simulacra nuk është më kopje, por e vërtetë më vete. Nuk simulohen indiciet, por prodhohen vërtet.

Ky botëndijim (këndvështrim më vete apo jo?) ka zgjatur afërsisht një gjysmë shekulli dhe, pastaj, nën ndikimin e Foucaultsë (1977) krijohet qëndrimi konstruktivist për gjuhën. Gjuha është pjesë në kuadër të kontekstit pushtet/status në terma të Bourdiesë. Nuk është *langue* (gjuha) në plan të parë, por *parole* (të folurit). Kjo e bën gjuhën kontigjencë, medium të vazhdueshëm të konstruksionit. Sipas kësaj, gjuha nuk është, thjesht, për të pasqyruar realitetin, por për të krijuar realitetin dhe negociuar staturë.

Foucault e përdor termin diskurs, pak a shumë për të shënuar atë që e quajmë ideologji. Secili prej nesh e përdor gjuhën për të shprehur botëkuptimin e tij dhe, me këtë, edhe një këndvështrim të ideologjizuar për botën. Sa për ilustrim, një person që ka rastisur të jetë duke i dhënë makinës e duke u ngutur, do t'i bjerë borisë, kur t'i duket se një kalimtar është duke kaluar më ngadalë në kalimin e këmbësorëve. I njëjti person, kur të jetë këmbësor, duke kaluar në kalimin e këmbësorëve dhe të ketë një makinë që nuk ndalon, do të kundërshtojë. Pra, kemi ndërrimin e këndvështrimit dhe me këtë edhe reagimin dhe ndërrimin e qëndrimit.

Në gjuhësi, themelor në këtë kuadër është negociimi i statusit dhe ndryshimi i diskursit varësisht nga statusi dhe negociimi i statusit.

Një element posaçërisht i rëndësishëm sa i përket këndvështrimit folës është përfaqësimi folës. Mekanizmat për realizimin e këndvështrimit në gjuhë janë të shumtë. Siç kemi raportuar më parë (Rugova, Sejdiu-Rugova 2015), elemente me të cilat shprehet këndvështrimi mund të jenë: deiksi, veta, mbiemrat dhe ndajfoljet, mënyra, modaliteti, aspekti, diateza, fokusi dhe kohët e foljes.

I rëndësishëm në këtë kuadër për problemin tonë: të ardhmen (futurin) është qëndrimi folës në kuadër të ligjërimit lidhur me kohët e foljeve. Weinrich më 1964 (2001), siç kemi prezentuar më parë brenda këtij punimi, i kategorizon kohët sipas perspektivës folëse, relievizimit dhe qëndrimit folës. Derisa dy të parat janë sqaruar më lart, prandaj tani le të diskutojmë qëndrimin folës. Në bazë të qëndrimit folës, Weinrich i ndan kohët në kohë të përfoljes dhe të rrëfimit. Qëndrimi folës i sqaron marrëdhëniet ndërmjet emetueses (rrëfyeses) dhe mesazhit (rrëfimit) dhe kjo marrëdhënie mund të jetë e drejtpërdrejtë, më intime dhe mund të jetë

më e veçuar, pra e përfolur, e ndërmjetësuar. Në rastin e parë, emetuesja është e lidhur drejtpërdrejt me botën e rrëfyer, ndërsa në rastin e dytë ka një distancë më të madhe me botën e rrëfyer dhe përdor ligjëratë të zhdrejtë (shih Rugova, Sejdiu-Rugova 2015: 171).

Në dëftoren e shqipes kohë të rrëfimit janë e pakryera, e kryera e thjeshtë dhe e kryera e treshkuar; ndërsa kohë të përfoljes janë e kryera, më se e kryera.

Koha e kryer dhe e kryera e thjeshtë kanë dy kundërvënie mes vete: pos aspektit e kanë edhe qëndrimin folës, me ç'rast e kryera e thjeshtë është kohë e rrëfimit, ndërsa e kryera është kohë e komentit (e përfoljes). Po ashtu, të më se e kryera dhe e kryera e tejkshkuar që konsiderohen si sinonimike në gramatikat e shqipes (Domi 1995: 314-315), dallimi është se më se e kryera është kohë e komentit, ndërsa e kryera e tejkshkuar është kohë e rrëfimit. Së këndejmi, një fjali e tillë: **A të kujtohet kur të kisha puthur?* nuk është e mundur në gjuhën shqipe, sepse konteksti është intim dhe bëhet fjalë për relacion të pandërmjetësuar, kështu që është i domosdoshëm përdorimi i kohës së rrëfimit (e kryera e tejkshkuar – të pata puthur).

Prandaj, tipari themelor dallues ndërmjet këtyre dy grupeve të kohëve të shqipes nuk mund të kërkohet, thjesht, brenda fjalisë, por në ligjërim, si dallim i ngjarjes së rrëfyer kundrejt ngjarjes së komentuar (të përfolur, të raportuar).

Çështja e ndarjes së kohëve të rrëfimit dhe të përfoljes në shqipen, është vërejtur nga Ismajli (1980:97, 1985), i cili edhe e ka ofruar terminologjinë në shqipen, dhe është trajtuar tutje nga studiues të tjerë më pas (Kelmendi 1993, Tahiri 2009, Friedman 2004:231, Rugova 2009, Rugova, Sejdiu-Rugova 2015), duke qenë një ndër kategoritë më të studiura të shqipes në rrafshin e përtejfrazës.

Sidoqoftë, koha, aspekti, modaliteti dhe mënyra janë nocione që ndërlidhen mes vete, krijojnë prerje, dhe ndonjëherë duket më e zorshme të bëhet një ndarje e qartë mes tyre. Kjo është komplikuar edhe më në rastin e shqipes, për shkak të klasifikimeve, shpeshherë të pasakta, të mbështetura në modelet e gramatikës së latinishtes – siç kanë bërë që nga

Mesjeta e tëhu edhe përshkrimet e gjuhëve të tjera, deri aty nga tri-katër dekadat e fundit të shekullit të shkuar⁵.

Comrie (2006) thotë se një ngjarje në boshtin kohor mund të lidhet si pjesë e atij boshti ose si një njësi lëvizëse kundrejt vetë boshtit (dmth a është veprim që vazhdon apo që ka përfunduar). Në këtë kuadër, pjesëmarrja brenda boshtit kohor është kohë e lëvizja përbën aspektin. Fleischerman (1990: 5) kohën e foljes e përkufizon si gramatikalizim të vendosjes së një ngjarjeje në rrjedhën e kohës.

Këtu dalim përtej konceptit të këndvështrimit dhe kalojmë në boshtin e gramatikalizimit si nocion gjuhësor.

4. Gramatikalizimi

Gramatikalizimi, në thelb, është markimi gramatikor i një kategorie gjuhësore⁶. Po e zëmë, dëshirorja e shqipes e ka elementin e dëshirës që është e markuar gramatikisht: punofsha. Ky element -fsh- bën që dëshira në shqipen të jetë e markuar gramatikisht dhe, prandaj, të ekzistojë mënyra dëshirore. Derisa shprehja e dëshirës mund të realizohet edhe me mjete të tjera gjuhësore, kjo e gramatikalizuara e përbën mënyrën dëshirore.

Në rastin e shqipes është e domosdoshme të shihet se si është i markuar gramatikisht koncepti i së ardhmes. Në bazë të kësaj do të mund të përcaktojmë a bëhet fjalë vërtet për kohë, apo ndoshta është një tërësi modalesh, apo është mënyrë më vete (irrealisi).

Një prej problemeve kryesore të klasifikimit të qartë të mënyrës, të kohës dhe të modalitetit (por edhe të aspektit) në shqipen është pasojë e mostrajtitimit të gramatikalizimit në disa nga gramatikat që shërbejnë si mjete mësimi në nivele universitare.

⁵ Lidhur me këtë, ndikimin e latinishtes në dijen e Mesjetës e të Renesansës sdhe, tutje, ndikimin e Mesjetës dhe të Renesansës në mendësinë gjuhësore deri nga fundi i shekullit XX, shih Joop van der Horst (2016).

⁶ Termi është përdorur sefte nga Antoine Meillet (1912). Mirëpo, këtu nuk do ta diskutojmë si term të Meillet-së në gjuhësinë historike, por si të Pullumit (2006). Pra, kur një formë gjuhësore e shënon një koncept semantik, atëherë kemi gramatikalizim.

Ta zberthejmë problemin duke kërkuar, fillimisht, dallimin mes nocioneve mënyrë dhe modalitet⁷.

Tradita (Demiraj 1976, Domi 1995, Beci 2001:113) në gramatikat e shqipes pranon gjashtë mënyra të foljes, ndërsa nocioni i modalitetit nuk diskutohet teorikisht në plotni, por vetëm në kuadër të foljes, në veçanti te foljet e ashtuquajtura gjysmëndihmëse dhe ngjyrimet modale të nxjerra prej tyre. Ky klasifikim nuk është bërë në të gjitha rastet mbi shënjes të qartë gramatikore.

Gramatika e Gjuhës së Sotme Shqipe problemin e sheh kësisoj: *Nëpërmjet kategorisë gramatikore të mënyrës shprehet lidhja midis veprimit të emërtuar nga folja dhe realitetit objektiv. Pra, me anë të kategorisë gramatikore të mënyrës folësi shpreh qëndrimin e tij ndaj veprimit të emërtuar nga folja, duke e paraqitur atë si të vërtetë, të mundshëm, të detyrueshëm etj.... Kategoria gramatikore e mënyrës është mjete kryesor për të shprehur modalitetin. Sipas kuptimeve modale dhe formave gramatikore përkatëse, në gjuhën shqipe dallohen gjashtë mënyra të foljes: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore. (Domi 1995:272)*

Foljet me vlerë modale quben ato që shërbejnë për të shprehur modalitet. Foljet me vlerë modale në fjali e humbasin mëvetësinë e tyre si folje të zakonshme dhe, si rrjedhim, po të merren të shpëputura nga togfjalëshi ku bëjnë pjesë, nuk kanë mundësi të kryejnë funksionin e kallëzuesit. (Domi 1995:261)

Nëse e shohim këtë përkufizim për foljet me vlerë modale (që e humbin, pra, mëvetësinë e tyre si folje të zakonshme) del se çfarëdo që shkon me lidhoren merr njëfarë ngjyrimi modal. Mirëpo, po aty (Domi 1995: 261) sanksionohet se folje me vlerë modale në gjuhën shqipe janë: *mund, dubet* (a lipset), *do* dhe foljet *kam* dhe *jam* të ndjekura nga forma e pashtjelluar e tipit për të punuar. Aty, njëherësh, jepen raste kur përdoret forma e ngurosur *mund* dhe kur përdoret në formën e plotë, pa analizuar më tej dallimin e formës së ngurosur - e cila, çuditërisht quhet folje (gjysmëndihmëse), edhe pse nuk mund të zgjedhohet.

Në këtë shpjegim, po ashtu nuk sqarohet qartë dallimi ndërmjet *dua të punoj* dhe *do të punoj*, ku e kemi foljen *dua* që mund ta marrë paradigmen e saj të plotë dhe funksionon për bukuri si cilado folje tjetër që shkon me

⁷ Një interpretim i këtillë është ofruar edhe te Rugova 2018

lidhoren, por i jep ngjyrim modal foljes në lidhore (të punoj), ndërsa pjesëza *do* që është formë e ngurosur e foljes *dua* qartazi nuk është baraz me vetë foljen *dua*.

Po te kjo gramatikë, në fusnotë, jepet përkufizimi: *Me termin modalitet kuptohet të shprehurit e qëndrimin folës ndaj asaj që kumton, në lidhje të ngushtë me realitetin objektiv. Ky qëndrim i folësit mund të shprehet me mjete të ndryshme gjuhësore: me anë të mënyrave të foljes, me anë të foljeve me vlerë modale dhe me anë të pjesëzave modale.*

Pjesëzat modale "shërbejnë për të shprehur qëndrimin e folësit ndaj një a më shumë mendimeve, ndaj vërtetësisë së një ngjarjeje a dënuarie të një realiteti objektiv. Në këtë grup hyjnë pjesëzat pobuese, mohuese, pyetëse, dyshuese, zbutëse (Domi 1995:419).

Pra, pjesëza modale dhe folja modale bëhen njësh, sipas kësaj gramatike.

Ndërkaq, përkufizimi i modalitetit si një term ombrellë për një spektër nocionesh semantike si mundësi, aftësi, hipoteticitet, obligim e detyrim (Depraetere, Reed 2006:468, 469), sado që më i ngushtë dhe praktik se përkufizimi i dhënë në Gramatikën e shqipës me Domin si kryeredaktor, sërish nuk është i mjaftueshëm për të nxjerrë thelbin e së përbashkëtës të të gjitha thënieve modale.

Ndryshimi ndërmjet këtyre dy kategorive gjuhësore, me rëndësi të veçantë në analizën tekstore, më qartë shpjegohet te Huddleston/Pullum (2002:172) duke i krahasuar me konceptet *tense* dhe *time* në anglishten ose me konceptet *aspekt* dhe *aspektualitet*: mënyra duke qenë kategori gramatikore, ndërkaq modaliteti kategori kuptimore. Me fjalë të tjera, gramatikalizimi i modalitetit brenda sistemit flektiv foljor është vetë kategoria e mënyrës. Përkufizim të tillë ofron edhe Depraetere/Reed (2006: 469). Autorë si Auwera dhe Aguilar (2016) ndarjen e tyre e bëjnë, duke folur për mënyrën në rrafshin puro gjuhësor, pra gramatikor, ndërsa për modalitetin vetëm në atë semantik dhe, prandaj, duke e kundruar vetëm nga këndvështrimet filozofike.

Natyrisht, kjo vlen edhe për kohën. Një mjet gramatikor duhet të shërbejë edhe për të bërë markimin e kohës si perspektivë folëse, relievizim dhe qëndrim folës.

4.1. Modalitet

Kundruar në rrafshin historik, sidomos në antikitet, për termat modalitet dhe mënyrë është e vështirë të diskutohet në mënyrë të ndarë.

Qysh në shekullin V p.e.s (shih Auwera, Aguilar 2016:3), Protagora flet për pyetjet, dëshirat, përgjigjet dhe urdhrat që do të mund të interpretoheshin sot si mënyra më vete, ndërsa Dyonis Thrax-i e përdor termin *enklisis* për mënyrën, si një nga tetë atributet, siç i quan ai, të foljes. Quintiliani, ndërkaq, në shekullin I të e.s. e përdor termin “modus”, një term që lidhet me etimonin mënyrë/modalitet⁸, ndonëse nuk e përkufizon fare si kategori.

Aristoteli, ndërkaq, fliste për dijen a priori dhe a posteriori që i ka shërbyer si bazë kritikës së mendjes së shëndoshë të Immanuel Kantit në shekullin XVIII dhe ofron katër ekstreme modale: domosdo dhe mundësi (si elemente pozitive) dhe pamundësi dhe jodomosdo (si elemente negacioni), të cilat krijojnë ndërlidhje mes vete në raporte të ndryshme: kundërshti, nënkuptim, kundërrthënie etj. (shih figura 3, në sythin 2 te ky punim).

Mbi këtë bazë, Kanti (2000 [1781]) e trajton modalitetin si një ndër kategoritë e gjykimit nga njeriu (krahas cilësisë, sasisë dhe relatës), secila me nga tri kategori më vete – në rastin e modalitetit këto kategori janë: e mundshmja, realja dhe e domosdoshmja. Me Kantin, termi modalitet, si dhe termat modalitet epistemik e deontik shtojnë frekuencë përdorimi.

Një term tjetër që është i rëndësishëm për t’u trajtuar këtu është edhe termi “irrealis”, si term që vihet në kundërvënie me atë “realis”, por që ka rëndësi të veçantë për studimin e fjalive kushtore dhe të shprehjes së kushtit, duke e pasur parasysh se gramatikat tradicionale e përfshijnë kushtoren si një nga mënyrat e foljes në shqipen. Termi është farkëtuar nga Sapiri (1930 [1992]) për diçka që “nuk është faktike”, “nuk është e verifikueshme”, por si diçka që është potenciale. Siç e diskutuam te sythi 2, termi është shfrytëzuar nga Palmeri (2001). Ky këndvështrim nxjerr dy

⁸Bloomfieldi (1933) dhe Hocketi (1958) e përdorin termin “mode”, në vend të “mood” në anglishten.

mënyra themelore: realismin dhe irrealismin dhe të tjerat pastaj vetëm pjesë të njëres ose të tjetrës.

Mirëpo, le ta zbërthejmë problemin e modalitetit. Deri tash, dy ndarjet kryesore të modalitetit ishin: epistemik dhe deontik. Simpsoni (1993:47) thekson se deontiku përfshin qëndrimin e folës ndaj shkallës së obligimit që emetuesja ia mvësh shprehjes së veprimit të caktuar, ndërsa epistemiku lidhet me të pasurit ose jo të besimit folës ndaj një koncepti të shprehur nga emetuesja. Ky i fundit, gjithnjë sipas Simpsonit, në vetvete e ngërthen edhe sistemin e modalitetit perceptiv që në të vërtetë e paraqet aftësinë e emetueses për të besuar ose jo një koncept të shprehur, duke u mbështetur ose jo në një perceptim vizuel.

Termi: *epistemik* është nga greqishtja e vjetër *episteme* që do të thotë dije. Termi: *deontik* është nga greqishtja *deontos* që do të thotë “(ajo) që është e duhura”.

Modaliteti deontik është kur jepet leje, urdhër apo shfaqet një detyrim a domosdo që projektohet për t’u kryer dhe (shih Palmer 2001) tregon diçka që është e ndaluar, e lejuar, e rekomanduar dhe e obligueshme.

Ti duhet të shkosh; Ti mund të shkosh (si leje); Ti do të duhej të shkoje (si rekomandim), Patjetër, duhet të shkosh etj. janë shembuj të modalitetit deontik.

Modaliteti epistemik (shih Palmer 2001) tregon diçka që është e sigurt, e mundshme, e gjasshme, e pamundshme, e pagjasshme.

P.sh. *Ai do të jetë aty!* tregon një mendim të emetueses për atë që është duke u diskutuar dhe emetuesja, në këtë rast është duke e parë si të sigurt një veprim që projektohet të ndodhë në të ardhmen. Në këtë rast flitet për modalitet epistemik.

Unë (nuk) do të vij; Unë (nuk) do të vija (edhe unë ndoshta do të vij; unë mund të vij (si gjasë) etj. janë shembuj të modalitetit epistemik.

Disa autorë (Huddleston et al 2002: 178, Palmer 2001: 9) duke u nisur nga anglishtja, ia shtojnë këtij klasifikimi edhe modalitetin dinamik apo të ashtuquajturin modalitet periferik. Sipas tyre, ky modalitet nuk shpreh mendim a qëndrim të emetueses, por përshkruan një gjendje faktike. Përfshin aftësi dhe predispozitë, si gjendje faktike.

Unë *mund të lexoj* shkronjat greke, nëse ju duhet ky shërbim (si aftësi); i përket modalitetit dinamik.

Huddleston dhe Pullum (2002) dinamikun e lidhin me foljen *can* në anglishten (mund(em)).

Së këndejmi, mund të kemi:

- a. *Ajo mund të shkojë në shkollë tani, (nesër)...* (po shprehet si leje, prandaj është modalitet deontik)⁹;
- b. *Ajo mund ta rrahë atë.* (Po shprehet si mundësi dhe shpreh modalitet epistemik. Nëse emetuesja parashih se dikush mund ta rrahë dikë, ajo nuk paraqet aftësitë objektive, por bën një vlerësim personal. Kjo e bën modalitetin epistemik);
- c. *Ajo mund të flasë shqip.* (Nëse paraqitet fakti se folësja di të flasë shqip, pra prezentohet kapaciteti i saj, atëherë kemi modalitet dinamik)¹⁰.

Si mund të përkthehen në kategorinë kohë këto modalitete?

Shembulli c. shëmbëllen të jetë një e tashme e vazhdueshme. Për të do të diskutohet më poshtë më gjerësisht. Shembujt a. dhe b. përfshijnë çastin e ligjërimit si moment vlerësimi bashkë me projektimin në të ardhmen të ngjarjes. Përkufizueshmëria e tyre si e tashme e vazhdueshme duhet të vihet në raport kundërvënijeje me shembullin c. Nëse ne e paraqesim si kapacitet: mund të flasë shqip (modalitet dinamik), kjo nënkupton se ajo tashmë e ka zotëruar shqipen dhe se kjo është gjendje faktike edhe për të ardhmen. Nuk mund ta thuash si gjendje faktike thënien: *Ajo mund të flasë shqip nesër.* (Pos, nëse është apodozë në një strukturë që shënon kusht). Në momentin që ia kemi vendosur ndajfoljen e kohës *nesër* dhe e kemi projektuar në të ardhmen, automatikisht kemi shprehur qëndrim personal dhe e kemi shndërruar në modalitet qoftë deontik, qoftë epistemik (varësisht nga konteksti a konteksti).

⁹ Nëse shihet si mundësi, do të ishte modalitet epistemik, ndërsa, nëse shihet si aftësi, modalitet dinamik.

¹⁰ Shembulli i nxjerrë kështu nga konteksti është ambig. Mund të shihet edhe si leje (dmth ajo lejohet të flasë) dhe atëherë kemi modalitet deontik.

Përfshirja e modalitetit deontik apo epistemik nënkupton se koncepti modal është i çastit të ligjërit, por ngjarja e projektuar është e së ardhmes, sado imanente ajo.

Ajo mund të shkojë në shkollë tani, si leje, nënkupton se momenti tani, megjithatë, është, të paktën, një sekondë pas çastit të ligjërit.

Ajo mund të shkojë në shkollë tani, si gjendje faktike (shih fusnotën 9), në kuptimin se pas një diçkaje që ka ndodhur, ajo mund të shkojë në shkollë, tregon se kemi të bëjmë me kapacitet dhe heqje ngjyrimi epistemik a deontik, por momenti tani është imanencë e megjithatë veprimi nuk është duke ndodhur.

Ajo mund ta rrahë atë, ndërkaq, është në të vërtetë një parashikim, për një situatë sado hipotetike qoftë ajo. Sërish, ngjyrimi modal është i çastit të ligjërit, por ngjarja e projektuar i përket të ardhmes hipotetike (Nëse do të rraheshin, nëse do të krijohej nevoja etj.).

Prandaj, a. dhe b. hyjnë në domenin e irrealitetit.

Sa për ta zbërthyer edhe më teorinë, Nuyts (2006:1) modalitetin e trajton si kualifikim të gjendjes dhe e konsideron superkategori abstrakte, më abstrakte se koha e foljes dhe aspekti dhe (2006:3) e zgjeron modalitetin, duke përfshirë brenda tij edhe indikacionin e nuancave të reja kuptimore, siç janë të ashtuquajturat “kategori në margjina të modalitetit”: volicioni, qëllimi, evidencialiteti, modaliteti bulemik (qëndrimi folës emocional), si dhe duke i përcaktuar tiparet që i nënkategorizojnë më pas shprehjet modale (subjektiviteti vs. objektiviteti dhe neutraliteti).

- *Mendoj se ai nuk do të vijë në mësim. (subjektiv)*

- *Ai nuk vjen në mësim (mbështetet në përvojat e mëparshme). (Shih Rugova, Sejdiu-Rugova 2015: 178)*

Në gjuhën shqipe modaliteti shprehet me pjesëza modale, si: *dubët, mund, le dhe do*, me foljet leksikore në funksion gjysmëmodal: *lejohet, bën dhe guxoj* (dy të fundit kalke nga serbishtja në shqipen e Kosovës kryesisht), etj. si në shembujt: *Ai ban me ba sherr* ose *Ai nuk guxon me t'prekë, se e mbyl*), me mënyrat e foljes (dëshirorja, habitörja, dhe lidhorja me kuptim joreal/jofaktik (irrealis mood), me mjete leksikore, siç janë ndajfoljet modale: *ndoshta, patjetër, me siguri* etj.: *Patjetër që do të vij me ty!*; pastaj me mbiemrat modale (*e sigurt, e dyshimtë, e detyruar*, etj.): *Ai është i*

sigurt se kjo do të ndodhë, si dhe me emra modalë (gjasë, aftësi, siguri, urdhër, këshillë, lutje, kërkesë, etj.).

- Ka gjasë që ai nuk vjen fare. Ky njeri ka aftësi të flasë bukur. Ai e pati një kërkesë: të shkosh në shtëpi sa më parë!

Po ashtu, me foljet kam dhe jam + trajta e pashtjelluar e tipit për të punuar.

Në dialekte, kjo duhet të kundrohët në raport me paskajoren e tipit *me punu(e)*: kam me punu, (më) duhet me punu, duhna me punu, muj me punu, (më) vyn me punu, lypset me punu, marr me punu, guxoj me punu, bon me punu, lo me punu e kështu me radhë.

Si gjuhë në funksion, njësitë e modalitetit në shqipen janë të lidhura me irrealisin dhe gramatikalizohen brenda tij, duke shprehur nuanca të qëndrimit folës lidhur me të ardhmen, si e dëshirueshme, e mundshme, e domosdoshme, e lejueshme.

Siç kemi thënë edhe më parë (Rugova 2018), ky varg sintagmatik i trajtave mënyrore të së tashmes në shqipen i kundërshton gramatikat tradicionale të shqipes që i klasifikojnë 6 trajta mënyrore brenda sistemit foljor të shqipes. Disa autorë që janë marrë me studimin e mënyrës, nxjerrin 8 trajta mënyrore (Newmark 1982, Buchholz e Fiedler 1987), ndërsa Breu (2010) flet për dhjetë sosh. Blerta Ismajli (2012:437), duke argumentuar për habitoren dhe kushtoren e shqipes në kontekstin ballkanik, thekson se nga të gjitha format foljore që konsiderohen mënyra në shqipen, dëftorja, lidhorja, dëshirorja dhe urdhërorja janë të padiskutueshme, ndërkaq, sipas saj, është pikërisht klasifikimi i habitores dhe i kushtores si mënyra foljore që vihen shpeshërë në pikëpyetje dhe herë trajtohen si mënyra e herë si konstrukt me folje modale: habitorja si evidencialitet e kushtorja si kohë.

Në diskutimin e tij për modalitetin në gjuhën shqipe Walter Breu (2009:257) qëllimisht kap një koncept të “restriktuar” siç e quan vetë të modalitetit, mbështetur te Hansen (2001:54-81), duke e shtuar edhe nocionin e volicionit, krahas posibilitetit që mund të shprehë qëndrim objektiv (aletik¹¹ e dinamik) dhe aftësi, kapacitet (deontik) dhe subjektiv

¹¹ Aletik dmth që ka të bëjë me më shumë variante të së vërtetës.

(epistemik); necesiteti objektiv (aletik/dinamik), obligim (deontik) dhe supozim i fortë (necesitet subjektiv, epistemik). Volicioni lidhet me dëshirën dhe supozimet e shprehura nga të njëjtat mjete formale. Secila nga to është realizuar si kundërvënie mungesore, me kategorizimin +, - . Ai vëren se të tri modalitetet shprehen nga një tërësi modalesh që e drejtojnë foljen dhe mund të shprehin të tria nivelet e modalitetit: dinamik, epistemik e deontik.

Ai (Breu 2009:255) shton se kjo situatë është edhe më e komplikuar, për shkak se edhe foljet e plota të njëjësive modale, mund të shprehin modalitet, po ashtu: psh. mund dhe mundem, duhet dhe duhem¹². Breu ofron edhe një përkthim të shqipes në variantet e tjera, jo vetëm të standardit dhe vëren presupozivën apo evidencialin deduktiv, përmes foljes ndihmëse kam. Breu (2009:256) këtë e fut në sferën e modalitetit epistemik.

- Te arbëreshët e sheh supozitivin (Ka rënë shi).

Te Rugova (2018) kemi diskutuar për këtë të fundit: Nëse supozitivi qenka mënyrë, cilat qenkan kohët e supozitivit? Kemi shprehur qëndrimin se problemi i supozitivit (trajtuar edhe nga Altimari) duhet të shihet në qëndrimin dhe këndvështrimin folës dhe në kategorizimin e kohëve të foljeve në kohë të rrëfimit dhe të komentit - diçka që mendoj se e kemi trajtuar shumë deri tash dhe nuk ka nevojë të ndalemi këtu më gjatë (Ismajli 1980, 1985; Rugova 2009, Rugova, Sejdiu-Rugova 2015).

Buchholz dhe Fiedler, ndërkaq, shohin posibilitativin me format aktive të, siç e quajnë, së tashmes: mund të laj dhe të pësoros: mund të lahem, si dhe necesitativin: kam për të larë (Buchholz, Fiedler 1987: 85).

Nuk e diskutojnë si të ardhme. Nuk e shohin pjesëzën modale si element të çastit të ligjërimin, ndërsa veprimin si të projektuar diku në të ardhmen. Nuk e shohin si pjesë të irrealitetit.

Irrealiteti, siç e theksuam edhe më parë, lidhet me një gjendje e veprim që, në çastin e ligjërimin, nuk është i sigurt të ketë ndodhur a të ndodhë. Shkon në kundërshtim me realis. Gjuhët kanë mjete të ndryshme

¹² Të parat të gramatikalizuara e të dytat: mundem dhe duhem jo. Megjithatë, *duhet* nuk është e gramatikalizuar, sepse nuk është e ngurosur, ndonëse duket si e ngurosur. Krahaso: Më duhet, të duhet, i duhet/na duhet, ju duhet, u duhet.

gjuhësore për të shprehur irrealisin. Tash, derisa dëftorja (edhe habitorja), po e zëmë, është realis, lidhorja i përket irrealisit. Në të vërtetë, edhe kushtorja, edhe dëshirorja, edhe urdhërorja, edhe jusivi, supozitivi, potencialisi, dubitativi, presumptivi, hortativi, inferenciali i përkasin irrealisit.

Në rastin e shqipes, lidhorja merr rolin qendror. Lidhorja, në thelb, është një gramatikalizim i mundësisë së shprehjes së nocioneve modale për atë që emetueset duan ta kumtojnë dhe shërben si mjet për shprehjen e gjendjeve të ndryshme të jorealitetit (irrealisit) përfshirë: dëshirë, vullnet, gjykim, mundësi, obligim, mendim, gjasë për një veprim që nuk ka ndodhur ende.

Në shqipen është formë e shtjelluar, por funksionon pak a shumë si formë e pashtjelluar (dallon në faktin se duke qenë e shtjelluar mund të marrë pjesëz modale, ndërsa format e pashtjelluara duan gjithsesi folje) dhe duhet të veprojë gjithsesi me një njësi tjetër që i jep ngjyrim: duhet të punoj, po të punoj, le të punoj, shkoj të punoj, vendos të punoj, planifikoj të punoj. Nuk mund të thuash thjesht: Të punosh tokën, pos si urdhër, me ç'rast njësia 0 markon urdhrin.

Në fjalitë e tipit: Të punosh është mirë, lidhorja del kryefjalë (Domi 1996), por duhet pasur parasysh (shih konceptualisht Sejdiu-Rugova 2019) gjithnjë se edhe në këtë rast duhet të shohim se ka një element që mungon (të punosh diçka), një komplement, përndryshe do të barazohej me gjerund.

Kur lidhorja merr pjesëz, merr element gramatikalizimi dhe ngjyrimi modal i saj mund të shndërrohet në mënyrë apo kohë tjetër.

Në gramatikat e shqipes (Domi 1995: 273) pranohet modaliteti i mundësisë që shprehet nga lidhorja. Aty (Domi 1995: 293, 294) shënohet koha e tashme, e pakryer (të punoja), e kryer (të kem punuar) dhe më se e kryera (të kisha punuar) si kohë të lodhores. Po ashtu, shënohet edhe lidhore-habitorja: të punuakëshka (Domi 1995: 294).

Fakti që lidhorja përbën irrealis, bën që të lidhet me diçka përtej çastit të ligjërit. Edhe strukturat *planifikoj të punoj, mendoj të punoj*,

shënojnë veprim të projektuar në të ardhmen¹³. Mirëpo, jo kur lidhet me folje në të shkuarën: *fillova të punoj(a)*. Elementi i parë e shënon gjithnjë çastin e ligjërimit dhe ky çast i përket së shkuarës, ndërsa lidhëria e shënon veprimin ireal, të projektuar.

Njëjtë ndodh edhe në formën më të shpeshtë: do + të punoj. *Do* është çasti i ligjërimit, njëfarë e tashme që e përfshin ngjyrimin eventual modal, kurse *të punoj* është veprimi në irrealis.

Kjo mund të jetë, po ashtu, dyfish ireale: *Do të doja të punoja*, me ç'rast *do të doja* është strukturë e parë si futur.

Pra, fakti se lidhet patjetër me diçka, bën që elementi i parë ta përcaktojë çastin e ligjërimit: *Vazhdoja të punoja. Kam vazhduar të punoj. Do të vazhdoja të punoj(a)*.

Sidoqoftë, në shqipen kemi forma të gramatikalizuara të dëftores, të lidhores, të urdhërores, të dëshirores dhe të habitores. Nuk kemi formë të gramatikalizuar të kushtores.

5. Gramatikalizimi 2.0

Siç thamë deri këtu, mund të shohim pesë mënyra foljore të gramatikalizuara të shqipes. Përveç dëftores (punoj) dhe lidhores (të punoj), janë edhe

- Punofsha (forma -fsh- që e gramatikalizon dëshiroren);
- Punuake (-ke që e gramatikalizon habitoren);
- Puno (-0 që e gramatikalizon urdhëroren).

Pra, kur e kemi një formë të gramatikalizuar të modalitetit, kemi një mënyrë më vete.

Gramatika tradicionale e shqipes (Domi 1995: 272) thotë se dëshirorja e urdhërorja kanë modalitetin e volicionit, kështu që nënkuptohet irrealisi.

Në gramatikat e shqipes (Domi 1995: 295), dëshirorja kategorizohet me kohën e tashme: punofsh dhe të kryer paça punuar.

¹³ *Vazhdoj të punoj*, me foljen *vazhdoj*, për shkak të semantikës së vetë foljes, përbën një të tashme të vazhdueshme. Ngjashëm edhe me foljet: di, filloj, etj.

Siç thamë edhe më parë, *punofta* patjetër shpreh dëshirë për një veprim që s'mund të jetë i projektuar pos në të ardhmen. *Paça punuar* nuk është veprim i kryer, nuk i përket së shkuarës (nuk mund të dëshirosh një veprim që ka përfunduar).

Urdhërorja (Domi 1995: 296-7) është kategorizuar me kohën e tashme: *puno*. Njësoj, urdhri s'është veçse një veprim i projektuar si urdhër pas çastit të ligjërit. Nëse dikush është duke punuar, nuk do të kishte nevojë ta urdhëronim, apo jo?

Te habitorja që nuk konsiderohet formë e irrealitetit, gramatikat (Domi 1995: 292) japin kohën e tashme (punuaka), të pakryerën (punuakëshka), të kryerën (paska punuar) dhe më se të kryerën (paskëshka punuar). Përdoren edhe format e mbipërbëra të së kryerës (paska pasë ardhur) (shih Domi 1995: 293).

Megjithatë, mund të thuhet: *Nesër punuakëshkan edhe këta*. Kjo është njësoj si në strukturat e dëftores: *Nesër vij me ty!*

Ofrohet një veprim që konsiderohet i sigurt për t'u realizuar në të ardhmen.

Në formime të tilla si *paska të punojë*, ose në gegërishten *paska me punu(e)* realizohet future si modalitet epistemik (qoftë si siguri, a mundësi).

Gjuhës shqipe ia mvëshin kushtoren: *do të punoja, do të punoj*. Janë format e zakonshme të futurit do + lidhore. Gramatikat do të thonë - të shprehura përmes kushtit.

Për shembull: Nëse do të kishe ardhur (protaza), do të bëje mirë (apodoza).

Mirëpo, a ka ndonjë formë të gramatikalizuar të kushtit në shqipen? Jo. Vërtet *do të punoja* dhe *do të punoj* janë pjesë të apodozës në një fjali kushtore, por nuk e kanë të gramatikalizuar kushtin në strukturën e tyre gramatikore dhe, për më tepër, nuk janë format e vetme gjuhësore që mund të paraqiten në apodozë në gjuhën shqipe.

Sa për ilustrim, po ofrojmë disa shembuj rasti:

- a. Se po s'erdhe, do të vij;
- b. Do të të bëja Teutë, po të isha mbret;
- c. Po erdhi ai, unë nuk vij;
- d. Në ardhsha, më ma mirë ma bëfsh;

- e. Me bo me të ardhë, kryet ta thej;
 - f. Hajde, e sheh;
 - g. Në guxofsh të vish, hajde;
 - h. Nëse vjen, merre Hasanin me vete;
 - i. Nëse ti vjen, unë shkova;
 - j. Nëse po të dhemb, shko te mjeku;
- Etj.

Paskemi, pra, përdorime të urdhërores, të lidhores, të dëftores e të dëshirores. Përfshikëshkan kohë të ndryshme, po ashtu: edhe e tashme, madje edhe e kryer e thjeshtë aorist (te fjalía e parafundit). Në të gjitha rastet, kushti shprehet i pagramatikalizuar. Nuk ka një formë gramatikore që e shpreh kushtin në shqipen, siç ka formë të gramatikalizuar të dëftores, të lidhores, të dëshirores, të habitores a të urdhërores.

Po. Kondicionali i diskutuar sipas modeleve të shpjegimit të gjuhëve në Renesansë, thjesht, nuk ka gramatikalizim në shqipen.

Mirëpo, a ka gramatikalizim të formave të futurit në shqipen? Dhe a përbëjnë ato forma thjesht kohësi, apo janë mënyra më vete?

Po nisim me formën *dua + lidhore*: dua të punoj, do të punosh, do të punojë, duam të punojmë, doni të punoni dhe duan të punojnë. Këtu kemi të bëjmë me nocionin e modalitetit, të shprehur përmes foljes *dua*. Ngurosjja e foljes *dua* në pjesëzën *do*: unë do të punoj (krahaso me unë dua të punoj) tash shërben si gramatikalizim. Cilin nocion semantik e shënon? Thjesht, kohën? Irrealen, pra, mënyrën?

Krahasimi me gegërishten *du me punu* (ose do të punoj) dhe *kam me punu* nuk është identik: Unë kam me punu, ti ke me punu, ai ka me punu (etj.) dhe unë du me punu, ti do me punu, ai do me punu, na dojmë me punu (etj.). Pra, këtu kemi modalitet të pastër deontik në rastin e parë dhe epistemik në rastin e dytë, sepse paskajorja është e ngurosur dhe forma foljore para saj ndryshon doemos në paradigme.

Në format me paskajore nuk funksionon trajta e ngurosur. Nuk mund të thuhet *unë do me punu*.

Së këndejmi, *do + lidhore* është njësi e gramatikalizuar që shënon të ardhme. B. Demiraj (2012: 39, 53) e ka trajtuar këtë problem; Bokshi (2012) pakëz me fjalë më të tjera, po ashtu. Sipas Demirajt (2012: 39),

bëhet fjalë për “gramatikalizim largvajtës të një fraze foljore me dy gjymtyrë në marrëdhënie sintaksore (pas gjase) asindetike e me përdorim prospektiv/voluntativ ose/edhe necesitativ, një gramatikalizim ky që mori formë të përfunduar me përgjithësimin dhe ngurosjen e fjalëformës (2/3 nj. tash. dëft. akt.) {do} si pjesëz gramatikore, e cila i paraprin foljes kryesore në trajtën paradigmatiche përkatëse të mënyrës dëftore”.

Mirëpo, për të parë, nëse bëhet fjalë thjesht për futur, duhet ta kundrojmë në kundërvënie me format e tjera që (mund të) shënojnë të ardhme. Kjo pyetje e shtron pyetjen tjetër: A është *do* + *lidhore* njësia e vetme e gramatikalizuar që shpreh të ardhmen në shqipen?

Mendojmë se lidhur me mbizotërimin e formës *do* + *lidhore*, sikur edhe për raportin kohë e kryer – kohë e kryer e thjeshtë; pastaj për shpjegimin e rimarrjes së kundrinës; për kushtoren, ose për theksin si të rrokjes së parafundit brenda fjalës – është ndikimi i parashkrimit në librat shkollorë të shqipes. Në gramatikat e shqipes janë një sërë shpjegimesh, ndonjëherë jo krejtësisht të sakta, që janë mësuar brez pas brezi dhe pastaj kanë marrë tagrin e mainstreamit si në ndonjë dogmë.

Në gramatikat e shqipes (shih Domi 1995) kemi emërtime të ndryshme, pjesëza modale apo folje gjysmëndihmëse, për: mund të punoj, le të punoj, duhet të punoj.

i. *Mund të punoj* është po aq e ngurosur sikur edhe *do të punoj*. Mirëpo, siç e pamë te shembujt a, b dhe c te sythi 4.1., trajta *mund* duket se jo doemos shënon futur. Te shembulli: *Filanja mund të flasë shqip* si modalitet dinamik (në kuptimin se di të flasë shqip dhe mund të flasë nëse ka nevojë), në shikim të parë duket se nuk përbën kohë të ardhme, por të tashme të vazhdueshme. Megjithatë, e ka një nuancë kushti brenda që i jep ngjyrim futuri. Nëse themi: *Filanja di të flasë shqip*, atëherë është e tashme e vazhdueshme. Mirëpo, kur themi *mund të flasë shqip*, lihet një nuancë kushtoreje që ofrohet me një protazë të papërshtetshme: *Mund të flasë shqip* (apodozë), nëse do t'i kërkohet (protazë) (apo p.sh. nëse do të ketë nevojë). Së këndejmi, *mund të flasë* nuk është baraz me *di të flasë*, sepse *mund*, megjithatë, e projekton një të ardhme brenda strukturës së saj.

Sidoqoftë, *mund të punoj*, kur ofron modalitet deontik dhe modalitet epistemik, varësisht nga konteksti si përdoret, shënon një veprim që

ngjyrimin modal e ka të çastit të ligjërimin, ndërsa veprimin e projektuar e ka në të ardhmen, kështu që bëhet fjalë për një formë të irrealisit.

Megjithatë, derisa te *do të punoj*, pjesëza *do* gramatikalizon në mënyrë të qartë një njësi semantike, te *mund të punoj*, nuk ekziston një njësi e qartë semantike. *Mund* mund të jetë edhe leje, edhe urdhër, edhe mundësi, edhe kusht, edhe kapacitet. E përbashkëta e secilës është irrealisi.

Në format e gegërishtes me paskajore nuk mund të funksionojë forma e ngurosur *mund*. Nuk mund të thuhet *unë mund me punu*. Përdoren *unë muj me punu, ti mun(ësh) me punu, ai mun(ët) me punu, na mujmë me punu...*

ii. *Le të punoj* është pak më e ngatërruar.

Le është formë e ngurosur e *lë* apo e (më) *lër* (*lër(më)*), *lër(e)*; *lër(na)*, *lër(i)* + folja në mënyrën lidhore. *Lër* është urdhërore që lidhet edhe me ngjyrimet e formës *le të punoj*. Forma e ngurosur *le* është një urdhërore-lejore e gramatikalizuar. Nuk vlen për vetën e dytë. Nuk mund të thuhet: *le të punosh*. Së këndejmi, është e kundërt me format e urdhërores që vlejné për vetën e dytë njëjës dhe shumës: (ti) *puno*; (ju) *punoni*. Përdoret si urdhërore-lejore për vetën e tretë: *le të shkojë*. Në këtë rast, diferenca është në qëndrimin folës. Në rastin: *Puno*, kemi të bëjmë me kohë rrëfimi (pra të drejtpërdrejtë), ndërsa te *le të punojë*, urdhër me ligjërim të ndërmjetësuar. Mirëpo, mund të përdoret edhe në vetën e parë: *Le të mbërrijmë së pari aty, pastaj flasim*. Në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me urdhër. As leje. Shpreh volicion, modalitetin dinamik, për një veprim të dëshiruar në të ardhmen, në raport me një ngjarje tjetër po në të ardhmen, duke ofruar relievizim teksti, me veprimin e parë si çast të projektuar në të ardhmen para një çasti tjetër që është edhe më larg në të ardhmen. Në thelb, sikur edhe me *mund të flasë*, përbën një kusht: *Le të mbërrijmë së pari aty* (protazë), *pastaj flasim* (apodozë).

Sikur te *mund + lidhore*, kemi modalitetin të shprehur në çastin e ligjërimin, por veprimi projektohet në të ardhmen.

iii. *Duhet të punoj* është, po ashtu, një formë që shëmbëllen e gramatikalizuar. Në formën e zakonshme duhem të punoj, duhesh të punosh, duhet të punojë..., shpreh modalitetin e detyrës, të obligimit. Mirëpo, *duhet* duket si e gramatikalizuar. Mirëpo, sikur te *lër*, është, në të vërtetë: (më) duhet të punoj, (të) duhet të punosh, (i) duhet të punojë...

Në këtë rast, nuk kemi formë të ngurosur fare, por veta e tretë, joveprore, njëjës shfaqet në paradigme, duke e pasur të nënkuptuar edhe përemrin në trajtën e shkurtër në dhanore (mua, më, ty të, atij i).

Forma *dubet* + *lidhore* shpreh modalitet deontik në kuptimin e obligimit, të ndalesës, të lejes a të rekomandimit. Në të folme, merr ngjyrim edhe epistemik: E ndërrova cilindrin. Duhet të mbajë një kohë... Në këtë rast, tregon mundësi, e jo obligim, prandaj është modalitet epistemik.

Në të folmet geqe, mund të përdoret: (*më*) *dubet me shkë*, sikur edhe forma: *unë dubna (dubem) me shkë*.

Sidoqoftë, merr element gramatikalizimi të detyrimit. Përbën modalitet në çastin e ligjërit dhe veprim të projektuar në të ardhmen.

Te shembulli: *Filani dubet të jetë njeri i ndershëm*, trajta *dubet të jetë* shpreh mundësi dhe kuptohet jo si *është njeri i ndershëm*, por në kuptimin kur të vijë koha, ai do të dëshmohet i ndershëm. Në relievizim, tregon një paskohësi të projektuar, pas një veprimi tjetër të projektuar pas çastit të ligjërit.

Ngjyrimet e tjera modale: *marr të vij*, *di të vij*, *bën të vij*, *guxoj të vij* etj. nuk kanë formë të ngurosur a të gramatikalizuar¹⁴. Tregojnë një futur, por nuk janë gramatikalizuar.

Do, *mund* dhe *dubet* mund t'i marrin format e lidhore: të punoj, të kem punuar, të punoja dhe të kisha punuar. Edhe *le* i merr, por me pëndarje më të kufizuar.

Trajta *do të punoj* mund të përfshijë më pas edhe *mund* e *dubet* brenda vetes: do të mund të vij(a); do të duhet të vij(a). Kjo e bën më tipike për gramatikalizimin puro të së ardhmes. Megjithatë, kemi edhe përdorime të tilla si *mund të dubet të vijë*, *dubet të mund të vijë*, *le të dubet të vijë*, *le të mund të vijë*, etj. Mirëpo, as *le*, as *mund*, as *dubet* nuk mund ta kenë në strukturë të veten pjesëzën do: nuk ka **le* të do të vijë, as **mund* të do të vijë, as **dubet* të do të vijë.

¹⁴ Do të mund ta shtonim edhe trajtën e gramatikalizuar po + lidhore (*po të punoj*, *po të punoja*, *po të kisha punuar*, *po të kem punuar*) që do të mund të konsiderohej një nga format e kushtores, meqë shërben protazë e fjalisë kushtore.

Për përdorimet e formave të lidhore: të punoj, të punoja, të kem punuar dhe të kisha punuar dhe kuptimet përkatëse të tyre, nuk do të ndalemi këtu.

Do, mund, duhet dhe *po* mund t'i marrin që të katra format. *Le* merr vetëm + *të punuar* dhe + *të kem punuar*.

Diskutim përmbledhës

Gramatika tradicionale e shqipes dhe klasifikimet e saj nuk puqen me konceptimet bashkëkohore të ndarjeve të mënyrës dhe të modalitetit, prandaj edhe të kohëve të foljes.

Prandaj, kur flasim për futurin si koncept, duhet të shihet, para së gjithash, ndarja në dy mënyrat kryesore foljore: realis dhe irrealis.

Derisa dëftorja dhe habitorja janë mënyra realis, të tjerat (lidhorja, dëshirorja dhe urdhërorja) janë irrealis.

Megjithatë, koha e ardhme është e shprehur me forma të caktuara të gramatikalizuara në kuadër të lidhore dhe irrealisit. Më tipikja ndër to është forma *do* + lidhore që ka zbutur më fort ngjyrimin modal në çastin e ligjëritimit dhe shpreh projektimin e një veprimi a gjendjeje në të ardhmen. Mirëpo, forma, *po* ashtu, të gramatikalizuara që shënojnë futur në shqipen janë edhe: *mund, le, duhet* dhe *po*, të cilat kanë gramatikalizuar modalitete të ndryshme secila.

Në të folme të ndryshme, ku *mund* të ketë edhe ndikim të sllavishtes, përdoret edhe një lidhore-urdhërore: *Të punosh!*

Në shqipen kolokuiale është trajta e zakonshme e gegërishtes *kam* + *paskajore*, por e gjithë shqipes është *kam* + për të punuar, ndërsa te arbëreshët e Italisë përdoret edhe *ka* + lidhore (*ka* të punoj).

Derisa trajtat *le* të punoj, *do* të punoj, *mund* të punoj, *duhet* të punoj, *po* të punoj, të gjitha përfshijnë lidhoren dhe shprehin ngjyrimin të caktuara brenda irrealisit, edhe vetë lidhorja është mjet për të shprehur një veprim irreal. Mirëpo, derisa te *do, mund, le, duhet* e *po* kjo është e gramatikalizuar, futuri mund të shprehet edhe me një sërë foljesh të tjera që shkojnë bashkë me lidhoren: *marr, vendos, dua, dëshiroj, ngutem, kam dëshirë*, në të cilat folja është në paradigmen e saj të plotë, në kohën e

tashme dhe shpreh veprim në çastin e ligjëritit që merr ngjyrimin irreal, kur i shtohet lidhorja. Së këndejmi, në strukturat dua të punoj, ndryshe nga do të punoj apo mund të punoj, le të punoj a po të punoj, folja e parë nuk e humb mëvetësinë e saj funksionale, kështu që kemi dy folje që përbëjnë dy klauza të ndryshme.

Prandaj, shqipja brenda irrealitetit ka forma të gramatikalizuara (gramatikalizim analitik) për modalitete të tilla si posibilitiv, jusiv, hipotetike, obligativ, kjo e fundit jo krejt e sigurt. Dëshirorja e urdhërorja, tutje, kanë gramatikalizim sintetik.

Volitivi i gramatikalizuar do të punoj (krahaso me *du me punu*) brenda irrealitetit vlen në formën e ngurosur: do të mund të vijë, do të duhet të vijë, por edhe me folje të tjera brenda, p.sh. do të vazhdojë (guxojë, fillojë, marrë) të vijë. Shfrytëzohet jo më si volitiv puro, por edhe si ngjyrim sigurie të veprimit.

Kushtorja në rrafshin e strukturës nuk është e gramatikalizuar, sepse funksionet e kushtit në shqipen shprehen me mjete të ndryshme dhe format e futurit volitiv janë vetëm një nga strukturat e mundshme për shprehjen e kushtit, kundruall formave të tjera, me ç'rast përdoren edhe koha e tashme e dëftores, aoristi, urdhërorja, dëshirorja, paskajorja e kështu me radhë.

Tash, më lejoni të bëj një parashikim të shkurtër të së ardhmes. Të shkruarit e këtij teksti do të përfundojë brenda pesë sekondash... pesë... katër... tri... dy... një...

Ia qëllova?! Përfundoi vërtet?!

Bibliografia

1. Aristotle. "Physics". (shekulli IV p.e.s). Në: McKeon, R. (red.). 1941. *The Basic Works of Aristotle*. New York: Random House
2. Aristotle. *Physics*. *Physics*.
<http://classics.mit.edu/Aristotle/poetics.html> (350 p.e.s)

3. Auwera, Johan van der; Aguilar, Alfonso Zamorano. 2016. The History of Modality and Mood. Në: *The Oxford Handbook of Modality and Mood*. Oxford: Oxford University Press
4. Baudrillard, Jean. 1994 (1981). *Simulacra and Simulation*. Ann Arbor: The University of Michigan Press
5. Beci, Bahri. 2001. *Gramatika e gjubës shqipe për të gjithë*. Prishtinë: Enti i teksteve...
6. Bloomfield, Leonard. 1965 (1933). *Language*. London: Ruskin House
7. Bokshi, Besim. 2012a. Format e futurit të shqipes në raport me ato të gjuhëve ballkanike. Në: *Shqipja dhe gjubët e Ballkanit*. Prishtinë: ASHAK
8. Bokshi, Besim. 2012b. *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*. Prishtinë: ASHAK
9. Breu, Walter. 2009. Modals in Albanian. Në: Hansen, Björn et al. (red.) – *Modals in the Languages of Europe*. Berlin: Mouton de Gruyter (fq. 229 – 266)
10. Breu, Walter. 2010. Mood in Albanian. Në: Rothstein, Björn; Becker, Martin G. (ed.) – *Mood in the Languages of Europe*. Amsterdam: John Benjamins Publishing Company (fq. 447 – 472)
11. Buchholz, Oda; Fiedler, Wilfried. 1987. *Albanische Grammatik*. Leipzig: Verlag Enzyklopädie
12. Camaj, Martin. 1984. *Albanian Grammar*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz
13. Comrie B. 2006. *Tense*. Cambridge: Cambridge University Press
14. Çeliku, Mehmet. 2006. *Çështje të shqipes standarde*. Tiranë: ASHRSH
15. Dawkins, R. 2014. *Deluzioni Zot*. Prishtinë: Trembelat
16. Demiraj, Bardhyl. 2012. E ardhmja e tipit do + lidhore sui dukuri mbarëgjuhësore, dialektore dhe ballkanike në shqipe. Në: *Shqipja dhe gjubët e Ballkanit*. Prishtinë: ASHAK
17. Demiraj, Shaban. 1971. *Gramatika e gjubës shqipe – fonetika dhe morfologjia*. Prishtinë: Enti i teksteve...

18. Demiraj, Shaban. 1980. *Morfologjia historike e gjuhës shqipe – pjesa I dhe II*. Prishtinë: Enti i teksteve...
19. Demiraj, Shaban. 1994. *Gjuhësi ballkanike*. Shkup: LogosA
20. Depraetere, Ilse; Reed, Susan. Mood and Modality in English. In: Aarts, Bas; McMahon, April (red.) - *The Handbook of English Linguistics*. London: Blackwell
21. Domi, M. (kryeredaktor). 1995. *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë: ASHRSH
22. Domi, M. (kryeredaktor). 1996. *Gramatika e gjuhës shqipe II*. Tiranë: ASHRSH
23. Douchet, Jean-Louis. 1995. The Albanian Tense System. Në: Thieroff, R. (red.). *Tense System in European Languages II*. Tübingen: Max Niemeyer Verlag
24. Dhrimo, A.; Angoni, E.; Hysa, E.; Lafa, E.; Likaj, E.; Agalliu, F.; Demiraj, Sh. 1989. *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe (morfologjia)*. Prishtinë: Enti i teksteve...
25. Fleischman S. 1990. *Tense and Narrativity. From Medieval Performance to Modern Fiction*. Austin: University of Texas Press
26. Foucault, Michel. 1977. Truth and power. Në: Foucault, M. 1980. *Power/knowledge. Selected Interviews and other writings 1972-1977 by Michel Foucault* (redaktuar nga C. Gordon). Brighton: Harvester Press.
27. Fowler, Roger. 1986. *Linguistic Criticism*. Oxford: Oxford University Press
28. Frashëri, Sami. 1979 (1886). Shkronjëto e gjuhës shqip. Në: Frashëri, Sami, *Vepra 5*. Prishtinë: Rilindja
29. Friedman, Victor. 2003. *Studies on Albanian and Other Balkan Languages*. Pejë: Dukagjini
30. Hockett, Charles. 1958. *A Course in Modern Linguistics*. New York: The Macmillan Company
31. Horst van de, Joop. 2016. *Propast standardnoga jezika*. Zagreb: Srednja Evropa

32. Huddleston, Rodney; Pullum, Geoffrey et al. 2002. *The Cambridge Grammar of the English Language*. Cambridge: Cambridge University Press
33. Ismajli, Blerta. 2012. Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes? Kushtorja dhe habitorja. Në: *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*. Prishtinë: ASHAK
34. Ismajli, Rexhep. 1980. *Sbumësia e tekstit*. Prishtinë: Rilindja
35. Ismajli, Rexhep. 1985. Gjuha shqipe e “Kuvendit të Arbënit” (1706). Prishtinë: Rilindja.
36. Jashari, Ali; Çitaku, Flutura. 2009. *Gramatika e gjuhës shqipe 1, Morfologjia – për studentët e degëve të gjuhëve të huaja*. Prishtinë: 2009 (botimi i tretë i përmirësuar)
37. Kant, Immanuel. 2000 (1781). *Critique of Pure Reason*. Cambridge: Cambridge University Press
38. Kelmendi, Tafil. 1993. *Funksionet e kobës foljore të pakryer të dëftores në shqipen e sotme letrare*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës
39. Kopitar, Jernej B. 1945 (1829). Albanische, walaschische und bulgarische Sprache. Në: *Jerneja Kopitarja Spisov*. II. Del, 2. Knjiga. Ljubljana
40. Lakoff, George; Johnson, Mark. 1980. *Metaphors We Live By*. Chicago: The University of Chicago Press
41. Mansaku, Seit. 2012. Tipologji romane dhe ballkanike në strukturën gramatikore të shqipes. Në: *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*. Prishtinë: ASHAK
42. Meillet, Antoine. 1912. *L'évolution des formes grammaticales*. Paris: F. Alcan
43. Mulaku, Latif; Kelmendi, Ahmet. 1988. *Gramatika e gjuhës shqipe (Fonetika dhe morfologjia) – për klasën I të arsimit të mesëm të orientuar*. Prishtinë: Enti i teksteve...
44. Newmark, Leonard; Hubbard, Philip; Prifti, Peter. 1982. *Standard Albanian: A Reference Grammar for Students*. Stanford: Stanford University Press

45. Nuyts, J. 2006. Modality: Overview and linguistic issues. In: Frawley, W (red.) – *The Expression of Modality*. Berlin: Mouton (fq. 1 – 26)
46. Platoni. *Sophist*. 360 p.e.s. (Përkthimi anglisht)
Në:
<https://web.archive.org/web/20051230161511/http://philosophy.eserver.org/plato/sophist.txt>
47. Popper, Karl R. 1997. *The Myth of the Framework: In defense of Science and Rationality*. New York: Routledge
48. Pullum Geoffrey. 2006. *Ideology, Power and Linguistic Theory*.
<http://people.ucsc.edu/~pullum/MLA2004.pdf> (Së fundi kundruar më 10 gusht 2014)
49. Rugova, Bardh. 2009. *Gjuha e gazetave*. Prishtinë: Koha
50. Rugova, Bardh; Sejdiu-Rugova, Linditë. 2015. *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Trembelat
51. Rugova, Bardh. 2018. Mënyrë dhe modalitet në gjuhën shqipe – kontributi i Walter Breu-it. Në: *Konferenca shkencore: Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht*. Prishtinë: ASHAK
52. Sapir, Edward. 1992 (1930). *Southern Paiute and Ute Linguistics and Ethnography* (The Collected Works of Edward Sapir, X). Berlin: Mouton de Gruyter
53. Sejdiu-Rugova, Linditë. 2019. *Strukturë dhe funksion – studime në sintaksë të shqipes*. Prishtinë: Trembelat
54. Simpson, Paul. 1994. *Language, Ideology, and Point of View*. London, New York: Longman
55. Tahiri, Linditë. 2009. *Rrëfimi impersonal i Kadaresë*. Shkup: Vatra
56. Weinrich, Harald. 2001 (1964). *Tempus – Besprochene und erzählte*. München: Welt
57. Weinrich, Harald. 2008. *On Borrowed Time*. Chicago: The University of Chicago Press
58. Werlich, Eggon. 1983. *A Text Grammar of English*. Stuttgart: Quelle & Meyer
59. Wittgenstein, Ludwig. 1922. *Tractatus Logico-Philosophicus*. London: Kegan Paul, Trench, Trubner & CO. LTD në:
<https://www.gutenberg.org/files/5740/5740-pdf.pdf>

**Aleksandra DUGUSHINA, Maria MOROZOVA,
Aleksandër NOVIK**

**RINGJALLJA E ETNICITETIT NË KOHËN
DIGJITALE: DIASPORA E SHQIPTARËVE NË
UKRAINË¹**

Abstrakt

Diaspora e shqiptarëve në Ukrainë është një shembull i ruajtjes së gjuhës dhe kulturës gjatë pesë shekujve të kaluar jashtë traditës origjinale duke përjetuar fazat e ndryshme të zhvillimit të etnicitetit. Pas ndërrimit të vektorit të interesave gjeopolitike të Ukrainës në fund të vitit 2013 – fillim të vitit 2014 ne vërejmë një interes të madh ndër shqiptarët e Ukrainës për gjuhën dhe kulturën e tyre amtare. Shtrirja kolosale e vetëdijes etnike të popullsisë shqiptare mbahet në nivele të ndryshme. Nga njëra anë, kjo bëhet në nivelin lokal në saje të përpjekjeve të intelektualëve të fshatit, mësuesve të shkollës, entuziastëve dhe figurave publike. Nga ana tjetër, në vitet 2018 dhe 2019 Ministri i Shtetit për Diasporën dhe përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës të Shqipërisë vizituan fshatin Karakurt që ishte jo vetëm rizbulimi i rrugës për "atdheun e stërgjyshërve" për përfaqësuesit e diasporës, por edhe shprehja e mbështetjes simbolike për rilindjen e vetëdijes identitare. Kjo dha një impuls të ri për krijimin e lidhjeve midis shqiptarëve të Ukrainës dhe të Ballkanit. Pasoja të vlefshme kanë pasur edhe ekspeditat shkencore organizuar nga Universiteti Shtetëror i Sankt Peterburgut dhe Muzeu i Antropologjisë dhe Etnografisë “Pjetri i Madh” (Kunstkamera) i

¹ The reported study was funded by Russian Foundation for Basic Research according to the research project No 18-39-20004 “Ethnocultural projects and their leaders in the post-Soviet space”.

Akademisë së Shkencave të Rusisë. Një "dritare në Shqipëri" e vërtetë u hap dhe zhvillimi aktiv i komunikimit me shqiptarët jashtë Ukrainës filloi falë rrjeteve sociale dhe veçanërisht Facebook-ut. Në Facebook në disa grupe të krijuara me iniciativën e liderëve etnikë, përfaqësohen jo vetëm ngjarjet nga jeta e diasporës, por edhe informacioni për gjithë botën shqipfolëse që jep reagimin e nevojshëm për "mirëqenien" etnike të shqiptarëve në Ukrainë. Ky proces shoqërohet me njohjen më të afërt dhe më të drejtpërdrejtë me të folmen dhe kulturën e shqiptarëve të Ukrainës dhe në të njëjtën kohë me miratimin aktiv të simboleve të përbashkëta kombëtare shqiptare (flamuri kombëtar, figura e Skënderbeut etj.). Studimi do të paraqesë një vështrim aktual të ringjalljes dhe vetëdijes etnike të shqiptarëve në Ukrainë, bazuar në vëzhgimet e reja të autorëve në terren të viteve 2018-2019.

Fjalët çelës: *Shqiptarët e Ukrainës, diaspora, vetëdija, identiteti, etniciteti, koha digjitale, simbolet e identitetit, Ballkani*

Abstract

The diaspora of Albanians living in Ukraine is a vivid example of the preservation of the language and traditional culture for five centuries being in isolation from origin tradition and experiencing various stages of self-consciousness and ethnicity. After the crucial geopolitical events of the end of 2013 – the beginning of 2014 in Ukraine we state a new interest for Albanian language and culture among the Albanians of Ukraine. The colossal splash of ethnic self-consciousness is supported at various levels. On the one hand – because of the efforts of rural enthusiasts, school teachers, and local public figures. On the other hand – in 2018 and 2019 the Albanian village Karakurt in Odessa region was visited by the Minister of State for Diaspora and representatives of the National Agency of Diaspora from Albania, which resulted as a real path to the “homeland” for representatives of the diaspora, but at the same time – as an expression of symbolic support for diaspora’s new ethnic feelings. This gave a new impuls for the communication between the Albanians of Ukraine and the Albanians of the Balkans. Social media and especially Facebook became

a real “window to Albania” and to Albanian diasporas abroad. Different events covering diaspora’s life are represented in several web-communities created by Albanian ethnic leaders, but mostly there is information about the entire “Albanian world” aiming at having feedback from Albanians abroad to support the desired ethnic “well-being”. This process is accompanied by a closer acquaintance with the dialect and culture of the Albanians of Ukraine, but on the other hand – with the active adoption of common Albanian national symbols by diaspora’s community (the national flag, the figure of Skanderbeg, etc.). The report will present a look at the current process of the ethnic revival of Albanians in Ukraine based on the authors’ field research in 2018–2019.

Keywords: *Albanians of Ukraine, diaspora, identity, ethnicity, digital times, symbols of identity, the Balkans*

Në vitin 1811 në jug të ish- Perandorisë Ruse kolonët nga Ballkani kanë themeluar fshatin Karakurt. Shqiptarët, bullgarët dhe gagauzët janë shpërngulur aq larg nga trojet e tyre amtare për shkak të luftimeve turko-ruse. Në mes të shekullit XIX, më 1861–1862 pjesa e popullsisë së Karakurtit ka themeluar tri fshatra të tjera në rajonin e Detit Azov (në territorin e rajonit të Zaporozhjes në Ukrainë sipas ndarjes administrative moderne) [НОВИК И ДР. 2016].

Periodha e gjatë e pranimit të shqiptarëve në Perandorinë Ruse / Bashkimin Sovjetik / Ukrainën e sotme ka veçori të saj në çdo etapë historike. Pasojat e rëndësishme për historinë dhe vetëdijen, ruajtjen e identitetit dhe të traditave shumëshekullore kanë pasur ekspeditat shkencore të organizuara nga Nikollaj Sevastjanoviç Derzhavin, Agnia Vasiljevna Desnickaja, Julia Vlladimirovna Ivanova, Irina Ivanovna Voronina etj.

Ndërtimi i shtetit të ri dhe të pavarur të Ukrainës ishte shkak i ringjalljes së etnicitetit ndër shqiptarë në këtë vend. Mungesa e përparimit ekonomik, situata jo stabile politike dhe zhgënjimi në drejtimin e qeverisë kanë ndikuar dukshëm në rritjen e identitetit etnik [НОВИК 2018: 68–91].

Fillimi i vitit 2018 mund të konsiderohet absolutisht një pikë kthese e rëndësishme në jetën e shqiptarëve të Ukrainës: Më 14 Janar 2018, një delegacion i Ministrisë së Diasporës të Shqipërisë, i kryesuar nga vetë Ministri Pandeli Majko, vizitoi fshatin Karakurt në rajonin e Odases të Ukrainës. Kjo ngjarje, pa dyshim do të bëhet pjesë e historisë moderne të diasporës shqiptare në Ukrainë, pasi, për herë të parë gjatë gjithë ekzistencës së kësaj diaspore, Shqipëria në një nivel zyrtar shtetëror i ka kushtuar vëmendjen e duhur. Sigurisht që kjo vizitë nuk kaloi pa lënë gjurmë: vëmendja e Shqipërisë zyrtare për problemet e diasporës, zhvillimi i lidhjeve kulturore dhe ekonomike kontribuoi në atë që tashmë mund të quhet një "ringjallje etnike": një rritje e interesit të popullatës për kulturën, gjuhën, traditat dhe të entuziazmit të aktivistëve etnikë vendas për të kërkuar lidhjet me shtëpinë stërgjyshore, me Shqipërinë. Vizitës së ministrit Pandeli Majko i kushtuan vëmendjen e duhur si mediet lokale ukrainase, ashtu dhe ato shqiptare. Kurse banorët e Karakurtit ende vazhdojnë ta përjetojnë këtë ngjarje me entuziazëm të madh, duke i rrefyer

njëri-tjetrit dhe ne studiuesve përshtypjet e tyre për takimin. Ministri zhvilloi një takim me përfaqësuesit e administratës rurale, ai gjithashtu u përshëndet nga grupet e folklorit dhe vallëzimit të fshatit Karakurt, nxënës shkollash dhe fëmijë të veshur me kostume tradicionale. Me rastin e mbërritjes së Ministrit u mbajt një mësim i hapur në gjuhën shqipe, të cilin fëmijët e studiojnë në shkollë si lëndë fakultative me mësuesen Natalja Kirçeva, e cila është trajnuar në Shkollën Verore të gjuhës shqipe pranë Universitetit të Tiranës. Pavarësisht vitalitetit të së folmes shqipe në Karakurt, takimi me ministrin u përkthye në gjuhën Ruse: për shkak të dallimeve midis së folmes dhe gjuhës standarde, njerëzit e fshatit e kishin të vështirë të kuptonin fjalimin e ministrit. Sidoqoftë, fraza e fundit e thënë nga Ministri: “Gjaku nuk bëhet ujë” u bëri përshtypje të gjithëve, duke qenë se u kuptua nga të gjithë përfaqësuesit e diasporës. Më tej, kjo frazë vazhdoi të përsëritej vazhdimisht nga aktivistët etnikë shqiptarë të Ukrainës nëpër postimet në Facebook dhe intervistat nëpër medie lokale. Mund të themi se kjo frazë përfaqësonte afrimin dhe njohjen zyrtare mes Shqipërisë në Ballkan dhe "Shqipërisë së vogël" në Ukrainë.

Pas vizitës në Karakurt nga Ministria e Diasporës e Shqipërisë në vitin 2018, ndodhën edhe ngjarje të tjera të rëndësishme për vetëdijen etnike ndër shqiptarët e Ukrainës. Në shkurt–mars të vitit 2019, kreu i administratës së Karakurtit, Elena Zheçeva, konsulli i nderit i Shqipërisë në Ukrainë, Shahin Omarov dhe kreu i organizatës “Unioni i Shqiptarëve të Rajonit të Zaporozhjes”, Vladislav Ilchenko morën pjesë në Samitin e Diasporave në Tiranë, duke vizituar kështu për herë të parë Shqipërinë. Pas kësaj ngjarjeje, Ministri i Diasporës përsëri vizitoi Karakurtin me kolegët e tij në maj 2019. Në verën e vitit 2019 u organizua një ekskursion për fëmijët dhe anëtarët e ansambllit të këngës dhe valles popullore nga Karakurti në Shqipëri, me mbështetjen e Ministrisë së Diasporës. Po këtë verë, grupi i fëmijëve që studiojnë gjuhën shqipe në shkollën e Karakurtit, kanë pasur një udhëtim mbreslënës nëpër qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe Maqedonisë me mësuesit e shkollës së tyre, duke marrë mbështetje të plotë financiare nga mecenatët shqiptarë në mbarë botën. Përshtypjet e përditshme, si dhe fotot e postuara në Facebook nga drejtuesit e këtij udhëtimi shkaktuan një trazim të madh në mesin e

shqiptarëve të Shqipërisë dhe Maqedonisë: në çdo qytet që ata vizituan u pritën nga një grup përfaqësuesish të administratës, punëtorë të kulturës, gazetarë dhe njerëz të zakonshëm të interesuar për kulturën shqiptare në Ukrainë. Në qershor të vitit 2019, mësuesit e vallëzimit dhe vokalit nga Ansambli Kombëtar dhe Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit të Shqipërisë u dërguan në Karakurt nga Agjencia Kombëtare e Diasporës. Mjeshtrit shqiptarë u mësuan pjesëmarrësve të ansamblit të Karakurtit këngë dhe valle tradicionale shqiptare, të njohura për të gjithë shqiptarët dhe njerëzit afër kulturës shqiptare – të tilla si “Eja Luleborë”, “Mora mandolinën” etj. Këtë vjeshtë, shqiptarët e Karakurtit presin një mësues të gjuhës shqipe nga Tirana, i cili do t'u mësojë gjuhën shqipe nxënësve të shkollës, si dhe të gjithë atyre që dëshirojnë ta mësojnë atë.

Duhet përmendur, se për shqiptarët e Ukrainës, këto takime dhe biseda me përfaqësues të “botës shqiptare” nuk ishin të parat. Që nga vitet ‘40 fshatrat shqiptare të Ukrainës ishin vizituar nga shkencëtarët, gazetarët nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia:

- viti 1949 – është realizuar puna në terren e shkencëtarit shqiptar Selim Islami (bashk me etnografen ruse Julia Ivanova) në Priazovje;
- viti 1995 – gazetarët shqiptarë nga Maqedonia, Sefer Musliu, Afet Miftari dhe Daut Dauti, vizituan Priazovjen;
- viti 1995 – një delegacion nga fshati Karakurt mori pjesë në Festivalin Folklorik Kombëtar në qytetin e Beratit (me vizitë në Sarandë);
- Që nga fillimi i viteve 2000, vizitat e gazetarëve dhe studiuesve të pavarur nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia në fshatrat shqiptare të Ukrainës (të tillë si: Jakup Lecaj dhe të tjerë) janë bërë gjithnjë e më të shpeshta;
- Që nga viti 2010 Shqiptarët e Ukrainës kanë filluar ta vizitojnë Shqipërinë për të marrë pjesë në programet e Universitetit të Tiranës apo dhe për turizëm individual.

Megjithatë, ishte mbështetja dhe interesi i drejtpërdrejtë zyrtar i Tiranës ai që rezultoi të ishte mjaft i rëndësishëm për shqiptarët e

Ukrainës, duke sjellë kështu në jetë një mirëqënie të re etnike, afër ndjenjës së përkatësisë ndaj Shqipërisë dhe gjithë “botës shqiptare”. Një interes i tillë i jashtëm për popullatën shqiptare dhe kulturën shqiptare është bërë një nxitje e rëndësishme për të ruajtur identitetin etnik dhe vendor, për të rritur vetëdijen, për të mësuar gjuhën amtare (brezit të ri nga ai më i vjetër) dhe ngjallur dëshirën për të mësuar sa më shumë rreth jetës dhe traditave të të parëve të tyre.

Rritja e vetëdijes, e cila bazohet në ndjenjën e “urisë” etnike pas kohës mjaft të gjatë, ka ndikuar edhe në veprimtarinë e organizatave publike shqiptare që ekzistojnë në Karakurt dhe Zaporozhje, të cilat në përgjithësi nuk kanë pasur kontakte me njëra-tjetrën. Për shembull, vlen të përmendet këtu krijimi i organizatës publike “Shoqata e Shqiptarëve të Ukrainës”, e cila bashkon aktivistët etnikë nga fshatrat e rajonit të Zaporozhjes dhe Karakurtit.

Përkundrajt faktit se që nga mesi i viteve 1990 në Karakurt ekziston organizata publike “Rilindja” [Новик и др. 2016], e cila është e përqendruar në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e kulturës shqiptare, në prill të vitit 2018, shiptarët që jetojnë në qytetin e Izmailit, qendra rajonale, Ilja Rusinskij dhe Aleksandër Dermentli, krijuan një organizatë të re publike e quajtur “Oborri shqiptar. Komuniteti shqiptar i Izmailit”. Organizatorët i shohin detyrat kryesore të shoqatës në konsolidimin e përpjekjeve të intelektualëve vendas dhe entuziastëve të tjerë për të ruajtur kulturën dhe të folmen shqiptare, mbledhjen për muze të objekteve të kulturës shqiptare, studimin e gjuhës letrare shqipe, promovimin e kulturës shqiptare në rajon dhe krijimin e lidhjeve të forta kulturore me Shqipërinë, Kosovën dhe Diasporën shqiptare nga e gjithë bota.

Organizata «Oborri shqiptar» dhe ansamblet nga Karakurti kanë filluar të marrin pjesë në mënyrë mjaft aktive nëpër festivalet etnike të mbajtura në rajon: në qytetet Bollgrad, Izmail, Odessa, Kharkov. Kohët e fundit, në rajon, në territorin e Odesës, i cili mund të konsiderohet pa dyshim një mozaik i ndritshëm etnik – rajoni është i banuar nga shqiptarë, bullgarë, gagauzë, ukrainas, rusë, grekë, hebrenj, moldavë dhe grupe të tjera etnike – festivalet e qyteteve që synojnë prezantimin e kulturave etnike janë bërë shumë popullore.

Kështu në festivalin e organizuar në qytetin e Bollgradit, kushtuar Ditës së Shën Gjergjit, pjesëmarrësit e ansambleve të fshatit Karakurt krijuan le të themi një "qoshe shqiptare" në sheshin e festivalit, ku vizitorët u qerasën me verë dhe ushqime tradicionale të shqiptarëve të Karakurtit.

Me mbështetjen e Universitetit Shtetëror të Izmailit, mbi bazën e të cilit dhe filloi të funksionojë organizata "Oborri shqiptar", u organizuan forume dhe konferenca kushtuar gjuhës dhe kulturës shqiptare. Më 19 Prill të vitit 2018 u mbajt konferenca studentore "Shqipëria dhe shqiptarët: histori, etnografi dhe modernitet", në të cilën morën pjesë jo vetëm studentë nga universiteti, por edhe përfaqësues të fshatit Karakurt, ansamble vokale dhe koreografike të Shtëpisë së Kulturës së Karakurtit.

Më 2 Dhjetor të vitit 2018, në Universitetin Shtetëror të Izmailit, u organizua një tryezë e rrumbullakët me titull "Faqet e Historisë së Flamurit Shqiptar", e cila iu kushtua Ditës së Flamurit të Republikës së Shqipërisë, në të cilën morën pjesë stafi i universitetit, aktivistë të organizatës "Oborri shqiptar" dhe përfaqësues intelektualë ruralë. Identiteti modern i shqiptarëve të Ukrainës karakterizohet nga një dëshirë e vazhdueshme për t'u afruar me historinë e shtëpisë së tyre stërgjyshore dhe për të kërkuar mbështetjen e shqiptarëve të rajonit dhe Ballkanit: përmes komunikimit me video Skype, u realizua një komunikim i drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e diasporave shqiptare të Moldavisë, Zaporozhjes dhe jashtë vendit.

Më 5 maj të vitit 2019, organizata publike "Oborri shqiptar", Universiteti i Izmailit dhe Qendra e Zhvillimit e Besarabisë, organizuan forumin ndërkombëtar "Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë historike dhe kulturore të shqiptarëve të Ukrainës: aspektet problematike dhe mënyra për t'i zgjidhur ato", në të cilin ne patëm fatin të merrnim pjesë. Forumi iu kushtua festimit të Ditës së Shën Gjergjit, ose, siç quhet ndryshe në Karakurt, festës së "Kurbanit" – një festë tradicionale për të cilën çdo familje therr qengjin dhe pjek mishin shoqëruar me drithëra "bullgur" në furrë. Mysafir nderi i këtij forumi ishte Ministri i Diasporës, Pandeli Majko, i cili për herë të dytë vizitoi fshatin Karakurt me kolegët e tij.

Në forum morën pjesë përfaqësues të administratave rurale, të qyteteve dhe universiteteve, drejtues dhe aktivistë të organizatave kombëtare-kulturore shqiptare, mësuesit nga fshati Karakurt. Vlen të përmendet këtu pjesëmarrja e shqiptarëve të Ballkanit dhe përfaqësuesve të diasporës shqiptare nga e mbarë bota – mecenatë që mbështetnin veprimtaritë e aktivistëve të organizatave publike.

Fjalimet përgjithësisht kishin të bënin me jetën e diasporës shqiptare në Ukrainë, problemet e ruajtjes së gjuhës dhe kulturës etnike. Ata diskutuan perspektivat e bashkëpunimit midis shqiptarëve të Ukrainës dhe strukturave zyrtare të Republikës së Shqipërisë në drejtim të shkëmbimit kulturor, trajnimit në Shqipëri, marrëdhëniet të sipërmarrjes, krijimin e një fondi mbështetës të Diasporës, krijimin e objekteve muze, studimin e gjuhës letrare shqipe, krijimin e Qendrës Kulturore Shqiptare me bazë në Universitetin Shtetëror Humanitar të Izmailit.

Zhytja, le të themi, në ngjyrat etnike u realizua padyshim në pjesën e dytë të forumit: në shëtitoren përgjatë lumit Danub u organizua dhe festa tradicionale e Ditës së Shën Gjergjit. Në një territor të hapur, të ftuarëve iu ofrua qengj i pjekur, llokume, bukë e gatuar në shtëpi, djath dele dhe verë. E gjithë kjo u realizua ashtu siç e kërkon zakoni në Karakurt – në rrugë, në një tryezë të gjatë që shërben për njëzet deri në tridhjetë persona, e gjithë kjo atmosferë u shoqërua nga muzika popullore dhe vallet tradicionale.

Gjithashtu aty ishte improvizuar një ekspozitë me artefakte të ndryshme – mjete të lashta dhe sende shtëpiake nga muzeu i shtëpisë së kryetarit të organizatës “Oborri shqiptar”, zoti Ilja Rusinskij.

Citimi: “Pala pritëse tregoi plotësisht mikëpritjen e saj, ndërkohë që të ftuarit u zhytën plotësisht në ngjyrat e traditave të shqiptarëve të Ukrainës dhe kuptuan se fryma e shtëpisë stërgjiyshore ende jeton mes tyre”.

Dita tjetër ishte festimi i panairit të Shën Gjergjit në fshatin Karakurt. Pavarësisht që festa u realizua në çdo familje, administrata e fshatit ka përgatitur një festë të teatralizuar edhe për të gjithë banorët. Patjetër, festa ishte orientuar më shumë për mysafirët nga Shqipëria. Në

fillim i çuan në një nga shtëpitë nga fshati për të parë si gatuhet në të vërtetë kurbanit i shqiptarëve të Ukrainës. Pastaj mysfirët vizituan muzeun etnografik dhe panë shfaqjen me këngë dhe valle popullore në sheshin para shtëpisë së kulturës.

Sigurisht, do të ishte e pakujdesshme të përmendim se ndjenjat e reja etnike të shqiptarëve të Ukrainës ndodhën “papritur” në vitin 2018 [НОВИК И ДР. 2019: 89–94].

Një zhvillim i ri i interesit për gjuhën dhe kulturën e tyre mund të vihet re pas ndodhive në fund të vitit 2013 – dhe fillim të vitit 2014 në Ukrainë, pas të ashtuquajturave ngjarje në Majdan të Kievit, kur vektori gjeopolitik i interesave të qeverisë së re dhe një pjese të popullsisë së vendit pësoi një ndryshim kardinal. Duket se shqiptarët e Ukrainës të gjendur përballë kësaj situatë e konsideruan veten në një farë mënyre të mashtruar dhe të harruar padrejtësisht nga autoritetet vendase. Prandaj, ata filluan të rifitojnë forcën e duhur për të pozicionuar “shqiptarin” brenda tyre nëpërmjet nismave të reja etnike dhe praktikave të etiketimit të identitetit të tyre. Këto ndjenja u mbështetën edhe më shumë nga ardhja në vitin 2015 në qytetin e Kharkovit të Konsullatës së Nderit të Shqipërisë në Ukrainë, aktivitetet e së cilës përfaqësohen nga Konsulli i Nderit, i cili përfaqëson nivelin e departamenteve dhe ministrive zyrtare shqiptare. Kështu për shembull, u shfaqën mundësi konkrete arsimore për studentët shqiptarë nga Ukraina në Shqipëri, të cilët tani mund të shkojnë për të studiuar gjuhën shqipe për një kohë të shkurtër dhe/ose të studiojnë një disiplinë të caktuar në Tiranë për të gjithë kursin e studimit.

Sidoqoftë, është një fakt i mahnitshëm që ishte pikërisht Facebook-u ai që u bë “dritarja e vërtetë për Shqipërinë” dhe një platformë në zhvillimin aktiv të komunikimit midis shqiptarëve të Ukrainës dhe përfaqësuesve të diasporës shqiptare jashtë vendit. Studimet e manifestimeve bashkëkohore të etnisë shpesh nënvizojnë se janë bashkësitë e vogla etnike dhe diaspora ato që shfaqin aktivitetin më të madh në internet, me siguri duke kompensuar mungesën e pjesëmarrjes në jetën reale të bashkësisë etnike përmes internetit [Головнѣв И ДР. 2018: 100–108].

Nga grupet e shumta të krijuara me iniciativën e përfaqësuesve shqiptarë të Karakurtit dhe Priazovjes, mund të përmendim “KARAKURT – 200-vjetori i ekzistencave të Shqiptarëve në Ukrainë” (shqip dial. ‘Karakurt – 200 vjetori i ekzistencës së shqiptarëve në Ukrainë’), duke numëruar 1868 pjesëmarrës, “Bashkimi i shqiptarëve të Ukrainës” (“Unioni i Shqiptarëve të Ukrainës”), i cili ka 400 anëtarë, dhe “Unioni i Shqiptarëve të Ukrainës në rajonin e Zaporozhjes”, i cili ka 85 anëtarë, “Oborri shqiptar”, krijuar nga aktivistë etnikë në qytetin e Izmailit. Në këto bashkësi, përgjithësisht publikohen ngjarje nga jeta e shqiptarëve të diasporës ku përfshihen: festimet, nismat, konferencat dhe shumë ngjarje të tjera, duke u lejuar atyre të flasin gjithashtu për veten dhe të marrin atë që fare mirë mund ta quajmë reagimi etnik i shqiptarëve të Shqipërisë (*«Respekt!»; «bukuri shqiptare nuk mbaron, rroftë bashkimi i shqiptarëve të Ukrainës»; «respekt për njerëzit e gjakut tim në Ukrainën e largët»*). Komunitetet në Facebook në njëfarë mënyre janë vazhdimi i jetës reale të diasporës, një lloj deklarimi i ekzistencës së grupit të tyre të vogël etnik. Kështu, një aktivist i organizatës “Unioni i Shqiptarëve të Ukrainës”, Aleksandër Dermentli, shpeshherë në intervistat e tij për mediet lokale thekson se qëllimi i komunitetit është që “të tregojë se grupi etnik shqiptar është gjallë”.

Sidoqoftë, komunitetet shpeshherë bëhen kanale për të marrë informacione rreth gjithçkaje “shqiptare”. Drejtuesit dhe anëtarët e grupeve në Facebook kanë një shkallë të ndryshme të njohjes së gjuhës standarde shqipe, azhurnojnë çdo ditë përmbajtjen, shpeshherë duke kopjuar mesazhe nga segmenti shqip i internetit – në lidhje me ngjarjet në Shqipëri, traditat në zona të ndryshme kulturore të vendit, etj. Një strategji e tillë tërheq kryesisht vëmendjen e shqiptarëve të Gadishullit Ballkanik, arbëreshët e Italisë, migrantët nga vendet shqipfolëse në Evropë dhe ShBA.

Në të njëjtën kohë, për shkak të aftësive të ndryshme gjuhësore të përdoruesve, është e vështirë të vlerësohet sot se sa i suksesshëm është ky “komunikim”: nuk ekziston asnjë traditë e shkrimit në të folmen e shqiptarëve të Ukrainës (me përjashtim të librave me poezi shqip me germa cirilike të Pjotr Merzhevit në fshatin Georgievka të Priazovjes),

transmetimi i fjalëve në alfabetin cirilik nuk është shumë i kuptueshëm, prandaj shqiptarët e Ukrainës si pjesëmarrës në rrjetet sociale shpesh përdorin emoji, d.m.th. fjalë zëvendësuese, ose të kufizuara në formulime gjuhësore të pranuar në komunikimin në internet për shqiptarët (për shembull: *flm vlla* ‘faleminderit, vëlla’).

Sidoqoftë, në rrjetet sociale, në mesin e përdoruesve nga fshatrat shqipfolëse të Ukrainës, shkrimi në shqip duke përdorur alfabetin latin është duke u bërë një trend. E megjithatë, tashmë konsiderohet si diçka prestigjioze të flasin shqip në jetën e përditshme. Duke qenë se situata gjuhësore e fshatit Karakurt është e tillë që konsiderohet shumëgjuhëshe: kemi etni të ndryshme si – bullgarët, shqiptarët, gagauzët etj., ata që jetojnë në fshat përdorin bullgarishten, gjuhën gagauze, gjuhën shqipe; rusishten dhe ukrainishten përdorin në komunikimin në shkollë dhe në ngjarje zyrtare si gjuhë zyrtare e shtetit. Sot, njerëzit kanë përshtypjen se “fshati fliste shqip”. Sipas njërit prej informatorëve tanë, kreu i organizatës “Oborri shqiptar”, në një takim, gjatë festimeve rurale, njerëzit përpiqeshin të flisnin më shumë me njëri-tjetrin në dialekt.

Facebook-u ishte ai që tërhoqi vëmendjen e shqiptarëve të tjerë në gjithë botën për shqiptarët e Ukrainës si një enklavë e ruajtjes së gjuhës dhe kulturës shqiptare, si të thuash, si kultura e të parëve të tyre. Ata ofrojnë mbështetje financiare për fëmijët që studiojnë shqipen letrare në shkollë – ata dërgojnë libra shkollorë, laptopë, organizojnë udhëtime në Shqipëri, dërgojnë sende me simbole shqiptare – flamuj, veshje, etj. Dhe vijnë nganjëherë në fshat.

Puna aktive e drejtuesve etnikë si në jetën reale ashtu edhe në internet gradualisht po çon në faktin që shqiptarët e Ukrainës të zënë vendin e tyre të veçantë në kombin e madh shqiptar [Endresen 2014: 201–225], duke pushuar së qeni “aborigjenë” që ruajnë vetëm dialektin arkaik dhe traditat. Ky proces shoqërohet, nga njëra anë, nga një njohje më e ngushtë dhe më e drejtpërdrejtë me dialektin dhe kulturën dalluese të shqiptarëve të Ukrainës dhe, nga ana tjetër, me adoptimin aktiv të simboleve kombëtare shqiptare.

Vetem 5-7 vjet më parë, kur bëmë kërkime në fshatrat shqiptare të Ukrainës, simbolet e kujtesës historike të shqiptarëve në Shqipëri (dhe më

gjerësisht – në Ballkan) ishin praktikisht të panjohura për informatorët tanë. Sot, pothuajse në çdo shtëpi, është prestigjioze të kesh një flamur shqiptar dhe disa suvenire me imazhin e Shqipërisë, Skënderbeut ose një shqiptonjë dykrenare. Kjo simbolikë është gjithashtu e ekspozuar dhe e pozicionuar si shënjuese e identitetit vendor shqiptar në festat dhe ngjarjet etnike. Duke bërë fotografi, shqiptarët e Ukrainës shpalosin duart në formën e një shqiptonje, duke shënuar kështu përkatësinë e tyre në botën shqiptare.

Është interesante që kjo krijon edhe simbolikën e vet, duke shënuar shqiptarët e Ukrainës si pjesë e kombit shqiptar në sfondin e identitetit të shtetasve ukrainas.

Festimet dhe takimet e pjesëmarrësve në organizatat publike filluan të përkojnë me datat historike shqiptare. Kështu për shembull, një nga konferencat iu kushtua Ditës së Flamurit Shqiptar. Një takim tjetër i aktivistëve shqiptarë nga Izmaili iu kushtua Ditës së fitores së trupave të Skënderbeut mbi osmanët.

Përpjekjet për t'u bashkuar me kulturën shqiptare ndonjëherë çojnë në rikonstruksion dhe, ndoshta, në një rishikim të paqëllimshëm të disa elementeve kulturore. Për shembull, festa e Shën Gjergjit, e cila tradicionalisht lidhet me emrin e shenjtorit dhe shoqërohet me ritualin e therrjes së qengjit dhe përgatitjen e kurbanit, interpretohet nga përfaqësues të caktuar të bashkësisë etnike si e lidhur me emrin dhe datëlindjen e heroit kombëtar Gjergj Skënderbeut.

Në verën e vitit 2019, në qendër të fshatit Karakurt është ngritur një monument për Skënderbeun, i cili është bërë me urdhër të Ministrisë të Diasporës dhe është dërguar nga Tirana në Karakurt. Aktivistët e diasporës prisnin të ngrinin monumentin dhe patën diskutime të nxehta në rrjetet sociale se ku dhe si do të qëndronte. Sidoqoftë, pasi është ngritur monumenti, tabela mbi të cilën janë shkruar emri i heroit dhe datat e lindjes dhe vdekjes janë ndryshuar dy herë, pasi në versionin e parë emri i heroit është shkruar në gjuhën ukrainase me gabime.

Falë internetit dhe rrjeteve sociale, u zhvillua një rikonstruksion i kostumit tradicional të shqiptarëve të Ukrainës, në të cilin performuan pjesëmarrës të ansambleve vokale dhe koreografike. Sot, këto dy grupe

mund të quhen pa frikë, “fytyra” e diasporës shqiptare në Ukrainë, duke dhënë shfaqje në ngjarje të ndryshme në rajon dhe në gjithë Ukrainën. Për një kohë të gjatë, veshja e atyre korrespondonte me kompleksin tradicional të veshjeve të shqiptarëve në Karakurt dhe Priazovje. Megjithatë, për pjesëmarrësit e ansamblit të Karakurtit, ai dukej tepër i thjeshtë për të dalë në skenë. Në internet, anëtarët e ansamblit gjetën kostume nga rajonet e ndryshme të Shqipërisë dhe përfundimisht zgjodhën atë që e pëlqyen më shumë [НОВИКИДР. 2016a; НОВИК 2018: 68–91]. Kështu duket ai tani – kostumi i zonës së Tiranës në jug të Ukrainës!

Një situatë e ngjashme është zhvilluar me repertorin e ansamblit. Vallet dhe këngët e shqiptarëve të Ukrainës nuk kanë një format origjinal të folklorit shqiptar, ato përbëjnë fondin e përgjithshëm folklorik të tria grupeve etnike në Karakurt – bullgarët, shqiptarët dhe gagauzët. Ishte interneti që lejoi anëtarët e ansambleve shqiptare të njiheshin me këngët dhe vallet e shqiptarëve të Ballkanit dhe të formonin repertorin e tyre shqiptar që do të dallonte shqiptarët e Ukrainës nga fqinjët e tyre. Dhe, ato që u pëlqyen veçanërisht, tani performohen nga ansambli në Karakurt. Në bisedat me anëtarët e ansambleve, kemi dëgjuar vazhdimisht se tekstet në gjuhën shqipe jo gjithmonë janë kuptuar plotësisht nga artistët. Për më tepër, pjesëmarrësit nuk janë vetëm shqiptarë, por bullgarë dhe gagauzë. Shpeshherë, ata i mësojnë këngët përmendësh dhe i interpretojnë në mënyrën “e tyre” le të themi, me dialektin e tyre, “me fonetikën e tyre”.

Në një mënyrë apo tjetër, është kështu si sot shqiptarët e Ukrainës njihen me kulturën e shqiptarëve të Ballkanit, përmes një përshtatjeje prestigjioze për ta të simboleve dhe aspekteve kulturore, duke zënë vendin e tyre të veçantë në botën mbarëkombëtare shqiptare.

Literatura:

1. Головнёв и др. 2018 — Головнёв А.В., Белоруссова С.Ю., Киссер Т.С. Веб-этнография и кибер-этничность // Уральский исторический вестник. 2018. № 1. С. 100–108.
2. Новик и др. 2016 — Новик А.А., Бучатская Ю.В., Ермолин Д.С., Дугушина А.С., Морозова М.С. «Приазовский отряд». Язык и культура албанцев Украины / Новик А.А. (отв. ред.). СПб.: МАЭ РАН, 2016. Часть I. Т. 1. 912 с.
3. Новик 2018 — Новик А.А. Албанцы Украины: албанский «стандарт» vs. говор и идентичность в XXI в. // Балканский полилог: коммуникация в культурно-сложных сообществах. Памяти Вячеслава Всеволодовича Иванова / Отв. ред. И.А. Седакова, ред. М.М. Макарец, Т.В. Цивьян. — М.: Институт славяноведения РАН, 2018. (Материалы круглого стола ЦЛИ Balcanica. 6). С. 68–91.
4. Новик и др. 2016а — Новик А.А., Бучатская Ю.В., Ермолин Д.С., Дугушина А.С., Морозова М.С. «Приазовский отряд». Язык и культура албанцев Украины / Новик А.А. (отв. ред.). СПб.: МАЭ РАН, 2016. Часть I. Т. 2. 672 с.
5. Новик и др. 2019 — Новик А.А., Дугушина А.С., Ермолин Д.С. «Një komb, një gjuhë» (?): коммуникация между албанцами Балкан и диаспоры // Балканский тезаурус: коммуникация в сложно-культурных обществах на Балканах / Отв. ред. И.А. Седакова, ред. М.М. Макарец, Т.В. Цивьян. — М.: Институт славяноведения РАН, 2019. (Балканские чтения. 15). С. 89–94.
6. Endresen 2014 — Endresen C. Status Report Albania 100 Years: Symbolic Nation-Building Completed? // Strategies of Symbolic Nation-building in South Eastern Europe / Kolstø P. (ed.). Farnham: Ashgate, 2014. P. 201–225.

KDU 811.18(091)

Evalda PACI

**NJË TRADITË GJURMIMESH ALBANOLOGJIKE
MBI HISTORINË E JETËS DHE TË BËMAVE TË
GJERGJ KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT**

Abstrakt

Rëndësia e njohjes së traditës studimore mbi jetën dhe bëmat e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Tradita historiografike dhe gjinitë shkrimore që promovuan në shekuj figurën dhe personalitetin e Gjergj Kastriotit. Rrethet kulturore që mbështetën përpilimin dhe daljen në dritë të shtypit të veprës së Marin Barletit mbi Skënderbeun. Të dhënat biografike mbi Barletin dhe autorë të tjerë bashkëkohës së tij. Historia e letërsisë së shkruar shqipe dhe burimet në gjuhë të huaj në vështrimet e historianëve të letërsisë shqipe. Referencialiteti i Marin Barletit në veprat e shkruara në disa gjuhë të Evropës mbi Skënderbeun dhe bëmat e tij. Kontributi i studiuesve shqiptarë në interpretimin dokumentar dhe faktik të historisë së Skënderbeut. Fan Noli në vështrimin e historianëve, por dhe të studiuesve të historisë së letërsisë së shkruar shqipe. Vlerat që sjellin për brezat e studiuesve variantet e ribotuara dhe të rishikuara të veprës së Fan Nolit. Gjurmimet françeskane si përfaqësuese të një tradite solide gjurmimesh në drejtim të historisë së jetës së Gjergj Kastriotit. Pikëpamje të Atë Marin Sirdanit O.F.M., Atë Paulin Margjokajt O.F.M., Jak Marlekajt O.F.M., Vinçens Malajt O.F.M. në lidhje me momente të rëndësishme të historisë së Skënderbeut dhe studimet kryesore të kryera mbi të. Përkimet në motive me letërsinë arbëreshe dhe me burimet përkatëse që bëjnë fjalë për këtë histori. Periudhat më të rëndësishme kohore në të cilat u bë objekt referimi historia e jetës dhe e bëmave të Gjergj Kastriotit, Skënderbeut.

Abstract

The studies on the figure of Gjergj Kastrioti (Skënderbeu) till the beginning have belonged different disciplines, meanwhile the first concrete steps towards the compiling of a biography related to events in which he was directly involved, were done by authors seen in manuals of literature history as humanists. Those authors remained special in our written history of literature by the fact their works were written in languages of culture of time and especially for the european context. That's why our studies offer potential studies of different dimensions.

The highlighting of the values, but also of some constructive features of the work of Marin Barleti, the comparison with the essays of Dhimitër Frangu and any other author that for the sake of the century our national hero lived in, was invited and inspired to write about his figure and his impact in the developments in the Balcans and wider, it was done always in the tradition of studies on written Albanian history and literature, also in the historiographic studies concerning this period.

The historiographic studies are an inseparable part of a complex mosaic that include inquiries of different disciplines, amongst also the contributions of scientific researchers on what's bring the popular literature on this argument weren't missing. It's a difference in between the scholars and foreign authors that wrote almost immediately after the century in which Gjergj Kastrioti-Skënderbeu lived with those that right in the first decades of the last century were putting order and highlight the values helpful for the actuality the previous inquiries leaded mostly by historic dimensions of watching the life and the bravery of our hero.

In this article we emphasized not only the achievements in the collective and individual studies on written literature that reflects the eco of the period of our hero, but also studies even of proper historiographic nature, are part of view study that complete the vision on the personality of our national hero, alive still today because of the positivity that conveys and the influence of some historical circumstances that were repeated in a way or another in our country. Concerning the studies prepared and published in the first decades of the last centurythere are considerations

as for the work of Fan Noli, Marin Sirdani O.F.M., Francis Pall, Athanas Gegaj etc. Our commentary follows a reasoned chronological course and don't trespass the year of 500 anniversary of death of Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, year in which were published collective studies, based on archival researches and also reprints of works of Marin Barleti and other authors.

Një reflektim i domosdoshëm para se të ndërmerret një sprovë në të cilën do të pasqyrohen kontribute, por dhe vepra që për nga natyra dhe destinacioni dallojnë mirëfilli mes tyre, të shpie dhe në të tjera çështje që, para së gjithash, kanë të bëjnë me burimet që në këto raste mbeten parësore, por dhe kushtëzuese në proces të përpilimit të punës. Një përpjesëtim i arsyetuar do të bënte të mundur të kihet parasysh që çdo vepër, çdo shkrim, çdo formë krijimtarië dhe gjini që nuk ka të bëjë domosdoshmërisht me shkrimoren ka ndikuar që të krijohet një koncept i përfunduar mbi një figurë që për nga bëmat dhe fama e mirë vijon të përfaqësojë një periudhë të përcaktuar kohore që për Ballkanin dhe Evropën nuk qe aspak e qetë dhe pa ndërlikime. Zhvillimet e kësaj periudhe bënë të mundur që në sytë e krerëve dhe hierarkëve të shteteve të rëndësishme të saj një personalitet si ai i Gjergj Kastriotit të cilësohej me atributet që u visheshin heronjve, figurave më me peshë dhe që ndikuan në zhvillime historike të pakthyeshme. Kastrioti qëndron në qendër të korpuseve të tëra të një trashëgimie të pamatë kulturore, ka frymëzuar krijime të cilat dhe janë rimarrë e interpretuar nga autorët e letërsisë së shkruar shqipe dhe arbëreshe, duke u risjellë dhe duke marrë forma që i sigurojnë dhe sot e kësaj dite lexueshmëri dhe mundësi për ta konsideruar gjithë këtë pasuri pjesë të një tradite disashekullore letrare, gjuhësore, filologjike dhe historike.

Metodologjia e qasjes ndaj burimeve të caktuara do të dallojë mirëfilli studiuesit tanë, pjesa më e madhe e të cilëve u ishin kushtuar gjurmimeve në fushë të historiografisë dhe hulumtimit në arkiva e dokumente të hershme, ndër të cilat dhe të dhënat mbi periudhën e Skënderbeut nuk mungojnë e, për më tepër, vijnë të grishin drejt nënvizimit të një diversiteti të dukshëm si në pikëpamje të referimit të

fakteve të caktuara, ashtu dhe në atë të natyrës së teksteve që janë përpiluar apo sjellë nga autorë të ndryshëm. Është më se e qartë që një motiv i tillë e që sillet rreth figurës së një heroit që shënoi një periudhë më vete në historinë e kombit e të viseve ballkanike do të bënte të mundur të përfshiheshin gjini të ndryshme shkrimore, e në të cilat ajo e veprave që në pamje të parë mbarin përmasat e narrativës e të përshkrimeve pozitiviste qoftë dhe për kohën në të cilat panë dritën e shtypit, janë më në qendër të vëmendjes së studiuesit të asaj periudhe.

Burimet popullore të trajtuara në vëllime të veçanta nga mbledhës të kujdesshëm, por njëkohësisht njohës të periudhës së sipërcituar në pikëpamje faktesh dhe rrethanash janë sjellë në botime *ad hoc* dhe të klasifikuara sa i përket gjinisë së cilës i përkasin, si dhe motiveve përmbajtjesore mbi të cilat duket se janë ideuar. Këto burime, para së gjithash, duke qenë se dhe në studimet mbi historinë e letërsisë sonë njihen dhe trajtohen prej kohësh, mbeten një dëshmi e qartë e një lidhjeje të hershme pikërisht gjenetike me figurën e heroit tonë kombëtar, bëmat e të cilit filluan të këndohen herët dhe erdhën duke u përforcuar në pikëpamje të mesazhit të fortë patriotik që përcillnin.

Figura dhe personi i Gjergj Kastriotit (Skënderbeut), përveç simbolikës themelore që lidhet me të qenët heroit kombëtar i popullit shqiptar, ka qenë (mund të themi) dhe mbetet plotësisht fatlume në kuptimin që ka përfshirë dhe ka qenë shtysë jo vetëm për realizimin e veprave të mirëfillta që e kanë pasur këtë të fundit figurë qendrore dhe protagoniste, por dhe për promovimin e veprave unike, ekzistenca e të cilave në historinë e shkrimit shqip lidhet pikërisht me jetën dhe bëmat e tij kryesisht në periudhën e moshës kur ishte ushtarak dhe më tej me veprimtarinë e tij pas kthimit të përhershëm në trojet arbërore.¹

¹ Pipa A., *Umanisti Italo-Albanesi*, nw *Albanica*, n.3-4, 1992, f.32: Non solo senza ragione gli albanesi esaltano l'epoca del loro eroe nazionale, Scanderbeg. Quell'epoca vide non solo l'affiorare di una embrionale coscienza nazionale facente capo alla figura dell'eroe, una specie di re incoronato dell'ancora non riunito regno d'Albania, ma attestò anche la nascita di una cultura albanese, rappresentata da una serie di intellettuali albanesi. Si può parlare di un umanesimo albanese, fiorito nel Cinquecento e continuato nella prima metà del Seicento, e che costituisce il precedente storico della letteratura albanese dei secoli seguenti.

Ndërmendja e Gjergj Kastriotit, heroit që u njoh gjerësisht për aftësi të veçanta njerëzore, përfshirë inteligjencën dhe mençurinë jo të zakonshme, është mjaft e qartë si në dokumentime të posaçme arkivore të Venedikut, Raguzës, Milanos, Napolit, por dhe në vepra që kryesisht pas shekullit në të cilin ai jetoi u shkruan posaçërisht për të dhe nën shtysën e motivimit për të hedhur dritë mbi një kontekst specifik historik dhe politik në të cilin u përfshi dhe merr domethënie dhe çdo trajtesë mbi Kastriotin.

Emri i Kastriotit, prijësit legjendar të cilit iu këndua brez pas brezi për qëndresën që dëshmoi karshi një fuqie të stërmadhe të kohës së tij, gjen vend e hapësirë jo vetëm në gjini të caktuara që kanë të bëjnë me historiografinë dhe kritikën historike medievale, por në përpilime më të thukëta që kanë qenë arsyetuar të shërbejnë si tekste shkollore.

Vetitë e aftësitë e Kastriotit nuk janë lënë pa vëmendje nga historianët e kronikanët e kohës, por kanë vijuar të jenë objekt vëmendjeje dhe më tej, pas vdekjes së heroit. Një fakt i tillë kuptohet fare mirë nëse kihet parasysh që pikërisht në lidhje me të tilla figura e personazhe kujtesa popullore e ajo historike gjithashtu ndihen të tërhequra dhe të interesuara, qoftë dhe për të nënvizuar më ndjeshëm nëpërmjet theksimit të tipareve fizike përkatëse ndikimin e personazhit në fjalë në kujtime dhe legjenda. Janë dëshmi e një fakti të tillë dhe portrete të natyrës artistike që gjenden të ekspozuara në galeri arti dhe muzeume evropiane, një pjesë e të cilave pasqyrohen gjithashtu në frontespice apo faqe të tjera të përmbajtjes së veprave që u shkruan në gjuhë të huaj posaçërisht për Gjergj Kastriotin.

Episodet në të cilat pikërisht bie në sy kapaciteti jo i zakonshëm i këtij heroit janë rimarrë e përshkruar nga bashkëkohësit në radhë të parë e ndonjë syresh mbetet vërtet më mbresëlënëse. Përshkrimet në fjalë kanë nënvizuar më shumë besimin që heroit zotëronte veti të mbinatyrshme, duke qenë se jo vetëm mbijetonte në situata vërtet kritike në fushë të betejës, por dhe paraqitej jashtë mase rezistent ndaj vështirësive që krijoheshin në kushte të motit të vështirë apo të betejave të stërzgjatura.² Sa i përket trajtimit të momenteve të caktuara të jetës së tij, pikërisht ecuria

² Barleti M., *Historia e Skënderbeut, Libri XI, Botimi IV*, Infbotues, Tiranë, 2005, f.451.

apo procesi i kthimit të tij në viset arbërore me synimin për të rimarrë në dorë mbikëqyrjen e fortesave arbërore jo si vasal i sulltanit, por si kryezot i ligjshëm ishte trajtuar prej autorësh të ndryshëm, ndër të cilët dhe prej Fan Nolit që mbetet dhe në vështrimin tonë si ndër më të interesuarit ndaj rindërtimit të një ecurie mbi të gjitha historike në lidhje me jehonën e figurës së Skënderbeut në arealin shqiptar dhe më gjerë. Pikërisht botimet që pasojnë shekullin në të cilin jetoi heroit ynë kombëtar, për më tepër, të përpiluara në gjuhë të ndryshme evropiane, konfirmojnë fuqishëm jehonën e bëmave dhe vetë rolin e vyer që mendohet dhe thuhet dhe sot e kësaj dite se ka pasur ky i fundit. Në shumë prej tyre është e mundur të vilen elemente të cilat dhe mund të bëhen objekt qasjeje mes njëri-tjetrit, fakt që ka mundësuar dhe realizimin e jo pak evidentimeve nga ana e historianëve që përqendrohen si në traditën e botimeve të përveçme që sillen rreth heroit tonë, ashtu dhe në përmbajtjen dhe vërtetësinë e trajtesave në disa prej tyre. Realizimi i këtyre veprave, dhe pse në jo pak raste me mospërputhje qoftë brenda vetë përmbajtjes, qoftë dhe ndaj vetë varianteve të ndryshme në gjuhë të ndryshme, duhet parë në dritën e një konteksti specifik historik që shënohet pikërisht nga rreziku i fuqizimit të një perandorie që kërcënonte soliditetin shtetëror evropian me një përparim të mëtejshëm territorial e ushtarak. Të ripara dhe në vështrimin e një perspektive diakronike, një pjesë e mirë e këtyre botimeve u frymëzuan apo u ndikuan gjerësisht nga përpilimet e Marin Barletit, që dhe në këtë trajtesë tonën do të konsiderohet si një ndër kontribuesit kryesorë në përvijimin e një historie të jetës dhe të bëmave të Gjergj Kastriotit. Këto botime e ribotime janë introduktuar dhe me parathënie që kanë mbartur qëndrimet e botuesve ndaj veprës në fjalë e më tej dhe ndaj rolit që shihej se kishte pasur gjithë veprimtaria e heroit tonë kombëtar, që konsiderohet mbrojtës i evropianitetit dhe i krishterimit në Evropë. Cilësimet ndaj heroit tonë konvergojnë drejt faktit që konsiderohet luftëtar i paepur e barrierë e fortë ndaj rrezikut otoman, i quajtur prej studiuesve si një kërcënim që buronte prej natyrës së tij feudale dhe ushtarake.³

³ Shih Prifti S., *Hyrje, Idetë e Barletit në "Historinë e Skënderbeut"*, në Barleti M., *Historia e Skënderbeut*, Botime Vatra, Shkup, 2004, f.32: Që në moshë të vogël Skënderbeu digjej dhe bluante në mendje plane për gjëra të mëdha. Së pari ai u dallua në mësimet e pastaj

Shekulli në të cilin jetoi Gjergj Kastrioti është i mbartur me ngjarje të një rëndësie të madhe për historinë e Ballkanit vetë dhe të viseve evropiane, kryesisht të atyre përtej Adriatikut, me të cilat prej shekujsh na lidh një histori e gjatë dhe e pashlyer shkëmbimesh. Do të jenë rrethana të caktuara që do të ndikojnë gradualisht në vendimet e heroit tonë, ashtu si dhe në fatet e vendeve të cilat u gjendën drejtpërdrejt të rrezikuara nga një fuqi ushtarake e politike që do të përmendet gjatë në historinë e Ballkanit dhe të Evropës.

Fuqizimi i një perandorie si ajo otomane ka qenë dukur pothuaj i pandalshëm e një fakt i tillë sigurisht përbënte një rrezik të pamohueshëm për vendet evropiane të Perëndimit e të Lindjes. Ballkani u bë jo rrallë një fortesë që priste e përballonte valë të ndryshme të këtij avancimi, ndërkohë që zhvillimi i marrëdhënieve mes prijësve të këtyre vendeve dhe atyre otomane ndikonte konkretisht në statusin e popullsisë vendase dhe në gjendjen reale të saj, në kuptimin që, siç figuron dhe në dokumentacionin e kohës, vendet që u shndërruan në vasalë të osmanëve e paguan një fakt të tillë me dëme njerëzore dhe materiale. Në këtë kontekst duhet parë dhe e gjithë historia e një marrëdhënieje të trazuar mes një princi arbër siç ishte Gjon Kastrioti (i ati i Gjergjit) dhe sulltanëve të kohës, duke qenë se këtyre të fundit Kastrioti kishte qenë i detyruar t'u bënte lëshime që sigurisht nuk ishin shprehje e vullnetit të tij personal. Kastrioti, i ati i Gjergjit, rezulton se ka pasur një familje me shumë bij e bija, dhe disa prej tyre ka qenë i shtrënguar t'ia lejonte sulltanit në këmbim të vijmësisë së ruajtjes së statusit të tij si mbikëqyrës i një tërësie të caktuar

në të tjera. Barleti na thotë: “Kështu, brenda një kohe të shkurtër, mendja e tij, e gatshme për çdo gjë, mësoi gjuhën dhe letërsinë turke, arabe, greke, italice dhe sllave. E ndërsa bashkë me moshën po i shtoheshin pak e nga pak edhe fuqitë, djaloshin e pushtoi vetëm një dëshirë: të mos i shpëtonte asgjë pa provuar në trimëritë luftarake dhe të jepte për çdo gjë prova gati të pabesueshme të gatishmërisë trupore, herë me shpatë, herë me hark e shigjetë, herë si kalorës e herë si këmbësor, të bënte gjithmonë me guxim, diçka më të madhe se moshë e tij.”(I, 57,7). Dhe me trimëritë që bëri, fitoi famë botërore që në fushatat e para të tij. (I, 58,8). Skënderbeu kishte fuqi shpirtërore të pamposhtur, po aq sa edhe trupore dhe vepronte shpejt e s'përkulej para asnjë vështirësie, s'donte t'ia dinte as nga të ftohtit, as nga të nxehtit. Që nga dita e parë që erdhi në Epir e gjersa çliroi mbretërinë, mezi i bënte dy orë gjumë çdo natë, mrekulli kjo veçanërisht e një trupi hyjnor dhe e një trimërie të pashterur” (I, 79,25).

territoriale. Ndjekja e këtij procesi dhe e këtij raporti aspak të qetë mund të bëhet vetëm në baza të një dokumentacioni përkatës kancelaresk që në kohë të vet mbahej në disa gjuhë (jo vetëm në latinisht), por njëkohësisht bën të mundur dhe të ndiqet një periudhë e rëndësishme e vetë biografisë së heroit tonë, i cili, siç thuhet në mjaft burime që shkruajnë për të, pati mundësi të shkollohej e të aftësohej kryesisht në artin militar falë qëndrimit të tij prej disa vjetësh në oborrin e Sulltanit.

Me kthimin pranë fortesave arbërore për Gjergj Kastriotin do të fillojë një periudhë e re në jetën dhe në vetë rrugëtimin e tij personal që nuk ka të bëjë vetëm me karrierën individuale. Sigurisht që ky princ arbër kishte ambicie jo të pakta dhe një fakt i tillë mbështetet nga historianë dhe kronikanë të kohës, por ndërkohë marrëdhëniet e tij me princa të tjerë të së njëjtës përkatësi kombëtare do të bëhen një preokupim i vazhdueshëm, duke qenë se Gjergj Kastrioti do ta kuptonte fare mirë që i vetëm ose dhe pa mbështetje dhe pa koalicione do ta kishte të vështirë të kishte një mbijetesë të qetë në viset arbërore. Në këtë pikëpamje, e ashtuquajtura *Besëlidhje e Lezhës (1444)* është rimarrë si një nga ngjarjet më të shënuara në gjithë historinë e Skënderbeut dhe do të gjendet e reflektuar dhe në një nga krerët e veprës së Barletit kushtuar jetës dhe bëmave të tij.⁴ Përpyekjet e Kastriotit për të fituar me radhë territore dhe fortesa do të bëhen objekt vëmendjeje dhe nga Barleti në krerët e parë të veprës së tij mbi jetën dhe bëmat e heroit tonë. Në këta krerë do të ndeshemi dhe me trajtat më të përdorura toponimike të viseve të ndërmendura, ndërkohë dhe me koordinata që në pikëpamje gjeografike dhe janë rimarrë në pikëpamje diskutimi shkencor nga pasardhësit e Barletit.

Gjinia shkrimore e veprave në të cilat flitet për heroin tonë është pothuaj e përcaktuar në pikëpamje karakteri dhe tipologjie, duke qenë se dhe Marin Barleti, meshtari shkodran që i kushtoi një vepër që do të jetojë si për famë e emër të mirë, si për vlera të shumta, përpiloi një tërësi trajtesash e përshkrimesh që u ngjet në disa pikëpamje dhe komentareve të luftës që shkruheshin tradicionalisht në Evropë mbi luftëra e konflikte që zgjatnin në kohë e që më tej do të shënonin dhe epoka të rëndësishme

⁴ Shih në veçanti kreun me titull *Libri i dytë i historisë së Skënderbeut*, në Barleti M., *Historia e Skënderbeut, shqipëroi S.Prijti, Botimi IV*, Infobotues, Tiranë, 2005, f.45 v.

në historinë e një vendi të caktuar. Te Marin Barleti mund të gjurmohet në mënyrë shtrënguese një nomenklaturë specifike mbi kampet e luftës dhe njësitë ushtarake që mobilizoheshin në atë kohë, mbi armët që përdorshin, mbi një sërë elementesh që ndihmojnë të brendësohet më mirë një kontekst jo i afërt në kohë, po i lidhur drejtpërdrejt me historinë e Katërqindës në viset arbërore. Duket qartë që Barleti ndërkohë që plotëson një formim të domosdoshëm në pikëpamje kulturore dhe arsimimi, kishte njëkohësisht dhe shqetësimin që të reflektonte në vepra unike momente domethënëse nga historia e vendit amë, histori që detyrimisht përfshinte dhe Serenissima-n, Republikën e Venedikut, interesat e së cilës shpreheshin konkretisht dhe në ruajtjen e mbikëqyrjes ndaj principatave më të rëndësishme të dheut të Arbërit, përfshirë dhe Shkodrën. *Rrethimi i Shkodrës* dhe *Historia e jetës dhe e bëmave të Gjergj Kastriotit (1508-1510)* janë sa të afërta në pikëpamje të një filli tematik që lidhet fare mirë me zhvillime historike që përfshijnë dy vendet e bashkuara nga rrethana të ngjashme dhe të afuara gjeografikisht nga deti Adriatik, por ndërkohë, secila prej tyre, për arsye të argumentit qendror mbi të cilin është arsyetuar të përpilohet, duhet trajtuar e konsideruar në bazë të veçantive që diktohen ose nga ngjarja që mbizotëron në vepër, ose nga ideja e përshkrimit të një konteksti që mundësoi ardhjen në qendër të vëmendjes të një heroi, siç qe Gjergj Kastrioti. Veprat e Barletit do të përkthehen pa vonesë në disa gjuhë të Evropës, duke u dhënë jetë mjaft varianteve të cilat në ndonjë rast përbëjnë dhe raste studimi në pikëpamje të modifikimit apo ruajtjes së përmbajtjes origjinale të vetë autorit. Përcaktimi i vitit të saktë të variantit të parë të botimit të veprës mbi jetën dhe bëmat e Kastriotit, si dhe ndjekja e ecurisë së mëtejme biografike të vetë Barletit kanë qenë elemente që kanë shënuar vështirësi konkrete për studiuesit e periudhës në fjalë e në këtë pikëpamje shihet se janë ndjekur dhe linja gjurmimi që kanë gjetur pikënisjen nga disa elemente që gjendeshin në frontespicin e veprës dhe të dhëna të tjera specifike ikonografike që lidheshin me botuesit e asaj kohe, njëkohësisht dhe anëtarë qerthujsh kulturorë me rëndësi të spikatur në arealin ku mendohet se operonte dhe vetë Barleti.

Në të vërtetë, nëse duhet konsideruar një material burimor që për shumë kohë u ka shërbyer dhe për hir të së vërtetës do vijojë t'u shërbejë studimeve mbi figurën dhe epokën e Gjergj Kastriotit, i tillë për nga vlerat dhe të dhënat që sjell është pikërisht Barleti si personalitet që jetoi nga afër ngjarje të rëndësishme që më vonë do të rrëfohen dhe duke u nisur nga pjesë të caktuara nga vepra e tij. Gjejmë me vend në këtë rasë t'i rikthehemi një cilësimi domethënës që Arshi Pipa përfshiu në një shkrim të tijin kushtuar humanistëve italo-shqiptarë e në të cilin receptohet qartë konsiderata e vlerësimi i këtij studiuesi ndaj kontributit të këtij autori humanist të letërsisë së Pesëqindës. Shprehimisht nga Pipa do të thuhet: *L'umanista albanese che diffuse la gloria di Scanderbeg nel mondo cristiano (circa duecento traduzioni, rifacimenti e opere letterarie in quasi tutte le lingue europee, elencate da Petrovich nel suo saggio bibliografico del 1881), è Marinus Barletius. Di lui abbiamo tre opere: De obsidione Scodrensi (Venezia, 1504); historia de vita et gestis Scanderbegi, Epirotarum principis (Roma, c.1508); e Compendium vitarum summorum pontificum..imperatorumque Romanorum (Roma, 1555). Barletius, prete cattolico, era scutarino di nascita, ciò che egli fa chiaro più di una volta nelle sue opere: "Marini Barletii Sacerdotis Scodrensis" (dedica di De obsidione), .."ut de Scodra mea taceam" (Historia, 1.2, p.35). Il nome ha fatto pensare ad alcuni che forse era oriundo di Barletta. Ma il nome suona albanese, Barletius essendo la forma latinizzata di Bardheci (Bardhetsi, Barlletsi). Non sappiamo né quando nacque, né quando morì. Nel libro VI dell'Historia dice che prese parte ai combattimenti durante l'assedio di Scutari del 1478-79. Dopo la conquista turca della città, emigrò a Venezia, dove sembra esser vissuto.*⁵

Shkrimtaria e Barletit është parë në jo pak këndvështrime edhe nga studiues të filologjisë së tekstit dhe për këdo që njeh sadopak traditën e përpilimit të teksteve të tilla në kohën në të cilën mori formimin personal ky i fundit, është fare e qartë që ndikimet nga modele ekzistuese janë pothuaj të zakonshme. Vërtetësia e asaj çka shpesh thotë Barleti është marrë në shqyrtim nga historianë dhe medievalistë, madje janë përpiluar dhe monografi të mirëfillta në të cilat figurë qendrore është pikërisht ky i fundit, por gjithsesi pozitiviteti në konsiderimin e kontributit të tij në

⁵ Pipa A., *Umanisti italo-albanesi*, në *Albanica*, n.3-4, 1992, f.32-44.

fushë të historiografisë skënderbeiane mbizotëron ndaj çdo kritike të mundshme që sigurisht duhet të ketë parasysh dhe faktin që vepra e tij u shkrua shekuj më parë dhe për më tepër do të mbartte dhe ndikime të kuptueshme për rrethin në të cilin u formua autori dhe tek i cili ai gjeti jo pak mbështetje dhe për të shpënë deri në fund projektin për të nxjerrë në dritë të shtypit veprën mbi jetën dhe bëmat e Skënderbeut. Një fakt i tillë është rimarrë vitet e fundit më se një herë dhe nga studiuesja Lucia Nadin, duke u bërë dhe objekt i një analize të hollësishme elementesh biografike dhe historike që lidhen dhe me historinë e shtypshkrimit të librave të ngjashëm në pikëpamje modeli në kohën kur jetoi Marin Barleti.⁶ Në këtë pikë, është me vend të ritheksohet se pikërisht historiku i përpilimit dhe i daljes në dritë të shtypit të veprave që vijojnë të jenë themelore si për studimet tona specifike historiografike, ashtu dhe për vetë historinë e letërsisë së shkruar shqip, lidhet natyrshëm me një kontekst zhvillimesh kulturore në të cilat pikërisht historia e librave të tillë përbën një element kyç e me mjaft rëndësi. Rëndësia e një çështjeje të tillë merr tjetër domethënie, nëse kemi parasysh që dhe në pikëpamje metodologjike, vetë gjurmimi më i përqendruar i rrethanave që mbështetën dhe realizimin për shtyp të të parit libër që njohim deri më sot në traditën e historisë së shkrimit shqip, do të gjejë jo pak shpjegime në kërkimet konkrete që studiuesja Nadin ndërmori pikërisht mbi tipografinë e mundshme që mund të ketë qenë dhe realizuesja e një ekzemplari të rrallë si libri i Gjon Buzukut.

Analizimi i shkrimtarisë së Barletit dhe i aspekteve themelore të prirjes së tij për të lënë me shkrim ngjarje me rëndësi siç ishte rrethimi i Shkodrës, por dhe biografi me vlerë siç ishte ajo e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut nuk mënjanojnë rëndësinë e trajtimit dhe të hulumtimit të figurës së heroit tonë kombëtar. Botimet dhe ribotimet e shumta të veprave të tij, për më tepër, përkthimi i tyre në disa gjuhë të huaja dhe vlerat që sjell translrimi i kontributit të tij nga një gjuhë në tjetrën, veç rikonfirmon rëndësinë e rolit të tij në një sërë pikëpamjesh, ndër të cilat

⁶ Nadin L., *Ikona e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut (Nga historia te miti: shekujt XV-XVIII)*, përkthet nga origjinali dhe përgatiti për botim: Prof.As.Dr.Evalda Paci, Botimet Albanlogjike, Tiranë, 2018.

primare për ne pasardhësit mbetet dhe nënvizimi i një vendi nderi që i duhet dhënë në një kontekst specifik, siç është ai i historisë së letërsisë së shkruar shqipe. Rimarrja e kontributit të tij shumëdimensional mbetet dhe dëshmi e leximit dhe e rileximit të kësaj vepre, ndërkohë që pikërisht nga botimet e mëvona që e kanë marrë parasysh këtë të fundit si një nga burimet më të afërta në përshkrimin e biografisë së Kastriotit do të kemi mundësi dhe të vjelim attribute celebrative në lidhje me heroin tonë kombëtar, Skënderbeun.⁷

Barleti konsiderohet me të drejtë një autor humanist dhe një emërtim i tillë mund të qëndrojë më së miri dhe në ditët e sotme, duke pasur parasysh se me gjithë rëndësinë e veprës që ai la pas, pa asnjë dyshim vuri në zbatim të punës së tij parime dhe metoda që ia mundësonte dhe përfshirja nga afër në një kontekst kulturor që ishte sa i zgjedhur, aq dhe karakteristik për kohën në të cilën ky i fundit jetoi e kreu ofiqet e tij meshtarake. Kritika ndaj zgjedhjeve dhe përdorimeve të caktuara në veprën e tij dokumentohet dhe në studime të dekadave të para të shekullit të kaluar dhe një fakt i tillë do të ndërmendet dhe ndërkohë që merren në analizë autorë dhe tekste që lidhen me këtë problematikë.

Vepra e Barletit u studiua gjerësisht dhe thellësisht nga historianë të mirëfilltë, nga medievalistë që ndër të tjera dhe bazoheshin në përshkrimet e këtij të fundit mbi ngjarje dhe episode të cilat dhe janë përjetësuar në monumente kishare, në elemente objektesh kulturi, siç dhe rezultojnë së fundmi nga hulumtimet që na kanë ofruar studime të kryera mbi rolin e Venedikut në përjetësimin e jehonës së figurës së heroit tonë në viset

⁷ I referohemi në veçanti një botimi në gjuhën frënge të përpiluar nga Jacques de Lavardin (Histoire de George Castriote, surnommé Scanderbeg, roy d'Albanie, contenant ses mémorables victoires à l'encontre des Turcs, pour la foy de Jésus-Christ, recueillie et poursuivie jusques à la mort de Mahomet II, par Jacques de Lavardin ; Dernière édition, augmentée d'une chronologie turque où sont... représentées les choses les plus remarquables advenues depuis Mahomet II jusques à Otthoman II...., 1621, në të cilin është e mundur të gjurmohen jo pak vlerësime atributive që e bëjnë Kastriotin një mbrojtës të krishterimit në Evropë dhe përforcojnë konceptin e një heroit që arriti të dalë fitimtar në shumë luftëra dhe beteja. Përveç përshkrimeve komplekse mbi personalitetin e Gjergj Kastriotit, krahasuar me heronjtë më të mëdhenj të të gjitha kohërave, nënvizojmë dhe referimin e qartë të autorit ndaj Marin Barletit, të cilin e ka pasur si referencë kryesore në proces të përpilimit të veprës së tij.

veneciane e në rrethina të afërta. Pavarësisht si mund të vështrohet pas disa shekujsh nga koha e botimit të variantit të parë të veprës së tij qëndrimi i Barletit si autor dhe shkrimtar, ai vijon të mbetet një prej burimeve më të rëndësishme referenciale për historianët dhe studiuesit e epokës së Skënderbeut. Interes të veçantë ka ngjallur motivimi që ky i fundit ka patur për të realizuar dy vepra që i referohen një periudhe të caktuar të historisë së Arbërit, ndërkohë që te gjithsecila do të jetë e mundur që dhe në pikëpamje të realizimit artistik të mund të gjurmohen të dhëna dhe tipare që dëshmojnë qartë një angazhim jo të paktë të vetë autorit për të rijetësuar jo vetëm ngjarjet që kanë shënuar ndjeshëm jetën e tij, por dhe një figuracion kompleks që pavarësisht shkallës së autenticitetit, mbetet dëshmi e një përpjekjeje që veprës në tërësi t'i jepen përmasat e artistikes dhe narrative.

Francisc Pall (1911-1992) njihet për gjurmimet skrupuloze në drejtim të historisë së Skënderbeut, të parë dhe në dritën e marrëdhënieve konkrete mes tij dhe viseve të tjera kryesisht të Gadishullit Italik që në një mënyrë a në një tjetër ishin të përfshira në një proces të gjatë shndërrimesh që ndikoheshin a diktoheshin dhe nga vetë zhvillimet që po ndodhnin në Ballkan e gjithashtu dhe në vendin tonë. Dhe, sot e kësaj, dite punimi monografik i tij mbi Barletin si një historian humanist (1938) e që pa dritën e botimit në vitet '30 të shekullit të kaluar hedh dritë mbi shumë çështje, ndër të cilat në këndvështrimin tonë mbetet me rëndësi primare pikërisht historia e jetës dhe e bëmave të Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Analizimi në mjaft hollësi i shkrimtarisë së Barletit nga ana e Francisc Pall-it përbën mbi të gjitha një çështje me mjaft interes për studimet tona, duke qenë se pikërisht në rastin e Barletit vëzhgimet filologjike e tekstore janë më të përshtatshmet për të kuptuar më mirë brendinë, por dhe shkallën e objektivitetit në përmbajtjen e veprës së tij. Një linjë po me aq interes do të përbëjë pas mendimit tonë gjurmimi i pasazheve në të cilat vihet re një ndikim i qartë i tij nga autorët e klasicitetit latin, të njohur si përpilues veprash që në pikëpamje tematike dhe përmbajtjesore ngjajnë me atë të Barletit.⁸ Nëse do të ishim të interesuar të gjurmonim në pikëpamje ecurie

⁸ Shih në veçanti kreun me titull *Le fonti del Barlezio*, në Pall F., *Marino Barlezio, uno storico umanista*, Bucuresti, 1938, f.33-62.

traditën e botimeve që në të vërtetë dhe ndikuan të përjetësonin kujtesën e kontributit kryesisht historiografik të Marin Barletit në lidhje me figurën e Gjergj Kastriotit, pikërisht në analizat e studiuesit Pall, të reflektuara dhe në studimin e sipërcituar monografik, do të gjejmë të dhëna me vlerë që u vlejné, para së gjithash, hulumtimeve tekstore e filologjike mbi variantet e veprave të Marin Barletit. Nëpërmjet këndvështrimeve origjinale të këtij studiuesi mbi kompleksitetin e kontributit të Marin Barletit në disa fusha të dijes, mbi të gjitha shkrimtarisë së performuar sipas modeleve të kohës dhe përshkrimeve të ngjarjeve themelore që e grishën këtë të fundit të vihet të shkruajë mbi këto argumente, autori ynë vendoset në një plan trajtimi të denjë për çdo shkrimtar serioz të çdo kohe e periudhe. Studime të natyrës së mirëfilltë historiografike e që në vijim të çdo trajtесе apo argumenti të mbështetur nga vetë Francisc Pall në lidhje me periudhën e Skënderbeut dhe përfshirjen e këtij të fundit në marrëdhënie shkëmbimesh me dukatet dhe sinjoritë e zonës italice janë përforcuar nga një dokumentacion i përzgjedhur i natyrës arkivore, i përmbledhur pikërisht nën titullin *I rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV (documenti con introduzione e note storico-critiche)*, botuar në Napoli në vitin 1966 e që në të vërtetë dëshmon që ky studiues ndërkohë që dhe i kishte dhënë një formë përfundimtare studimit të sipërcituar mbi Barletin, shqyrtonte burime dhe tekste arkivistike që i ndihmonin të kishte më të qartë dhe të bënte po aq të qartë kontekstin e marrëdhënieve në të cilat Gjergj Kastrioti ishte i kushtëzuar të përfshihej.⁹

⁹ Shih në veçanti dhe sqarimet hyrëse të këtij vëllimi, në Pall F., *I rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV (documenti con introduzione e note storico-critiche)*, Società Napoletana di storia patria, Napoli, 1966, në të cilat vetë autori do të shprehet: Durante un breve, ormai molto lontano, soggiorno a Milano, troncato dai gravi eventi dell'estate 1939, abbiamo potuto raccogliere nell'Archivio di Stato di quella città un certo numero di documenti inediti riguardanti le relazioni italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV. Pur avendo annunciato già nel 1942 la loro imminente pubblicazione, varie vicende hanno sfortunatamente procrastinato l'adempimento del nostro disegno. Questi nuovi documenti lumeggiano non solo certi particolari, ma alle volte anche aspetti maggiori delle suddette relazioni negli anni 1455-1467, cioè al tempo del principe Giorgio Castriota Scanderbeg, il celebre campione del popolo albanese nella sua eroica lotta per la libertà contro l'aggressione feudale-militare ottomana, nonché il fedele alleato del romeno Giovanni da Hunyadi, di questo illustre combattente contro lo stesso pericolo nel settore

Historiografia skënderbeiane ka njohur një hap të ndjeshëm pozitiv me trajtesat që Fan Noli i përpiloi në dekadat e para të shekullit të kaluar. Botimet e ribotimet e veprës së tij mbi historinë e Skënderbeut, variantet gjegjëse në gjuhë të huaj, gjithashtu përbëjnë një vlerë të pamohueshme që plotësoi meritueshëm një kontekst studimor në lidhje me të cilin pikërisht studiuesit shqiptarë duhet të kishin një rol parësor. Historia e Skënderbeut ka simbolizuar për Fan Nolin një objektiv që nuk duhej lënë lehtë, ndërkohë që ky i fundit në raste ribotimesh dhe rimarrjesh të argumenteve të punimit të tij mbi këtë figurë të rëndësishme historike ka reflektuar mbi momente të caktuara të trajtuara, mbi argumente të bëra objekt diskutimi nga studiues të tjerë, mbi hierarkinë e burimeve që shërbejnë dhe sot e kësaj dite si pjesë e një tradite historiografike mbi Gjergj Kastriotin. Fan Noli mbetet një prej autorëve më të cituar për mprehtësi dhe vëmendje të spikatur prej historiani në burimet studimore evropiane, fakt ky që rikonfirmon përfshirjen e kontributit të tij në radhën e gjurmimeve më serioze të përpiluara mbi heroin tonë kombëtar. Në veçanti kategorizimi që ky i fundit u ka bërë burimeve nga të cilat mund të vilet e hulmtohet historia e jetës e heroit tonë në disa këndvështrime, përbën një linjë studimore që lë hapësirë dhe për të gjykuar një hierarki në pikëpamje vlerash të secilit prej tyre. Në pikëpamje rendi, në nenin kushtuar burimeve shqiptare Barleti vjen i dyti duke i prirë Dhimitër Frangut dhe Gjin Muzhaqit, ky i fundit i ndërmendur dhe nga studiues të tjerë për arsye të përpilimit të një gjenealogjie të Derës së Myzeqesë, në të cilën ka përfshirë dhe elemente të historisë së Skënderbeut.¹⁰

danubiano, alle frontiere dell'Ungheria e dei paesi romeni, e nella parte settentrionale della penisola Balcanica.

¹⁰ Shih në veçanti Noli F., *Historia e Skënderbeut*, Tiranë, 1950, *Kapitla VII, Burimet dhe historianët*, f.128-129: Marin Barleti: Ishte prift nga Shkodra dhe disa vjete më i ri se Pal Engjëlli. Ishte djalë kur vdiq Skënderbeu, njihte personalisht shokëlëftonjësit e tij, kishte përpara syve dokumenta të kohës dhe veçanërisht ato të Venetisë, kishte vizituar fushat e betejave që përshkruan, u ndohte në rrethimin e Shkodrës dhe pastaj u vendos në Veneti ku shkroi veprën e tij me famë mi kryetrimin e math të shekullit të vet. Historia e tij, e shkruar latinisht edhe e botuar midis vjetëve 1506-1510, është baza e historive të panumërta që janë shkruar mi Skënderbenë gjer pothua në fundin e shekullit të nëntëmbëdhjetë.Me latinishten elegante dhe me stilin e kujdesur fitoi këndonjës anëmbanë botës dhe e bëri të pavdekur kujtimin e Skënderbeut në Evropë. Libra e tij pati disa edicje të ndryshme latinisht, edhe u përkëthye në të gjitha gjuhët evropiane. Si

Përkatësia gjenealogjike dhe prejardhja e Gjergj Kastriotit, betejat më të rëndësishme në të cilat ai mori pjesë dhe që qenë vendimtare për famën e tij përtej kufijve të viseve arbërore, bëmat që bënë të mundur që ai të konsiderohej mbrojtës i krishterimit dhe i integritetit të viseve evropiane përtej Adriatikut, të gjitha këto elemente pikërisht në penën dhe konceptimin e Fan Nolit marrin një konotacion të veçantë e për më tepër përbëjnë një nga lekturat më të besueshme në lidhje me historinë e Skënderbeut. Duke pasur fare të qartë rëndësinë që në këto raste paraqet për afrimi me kompetencën dhe tagrin e historianit, Fan Noli nuk lë pas dore dhe përpunimin e një stili të shkruari, që, pa asnjë dyshim, përbën një favor të madh për ta bërë më lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme veprën e tij, që gjithsesi theksojmë se u shërben në radhë të parë studiuesve të periudhës në fjalë, historianëve të saj. Të dhënat që gjurmohen në të në lidhje me një sërë elementesh vijnë ta paraqesin këtë vepër si ndër më të mirat në kontekstin e studimeve mbi periudhën dhe vetë figurën e Skënderbeut. Çdo variant i realizuar në vite nga ana e Fan Nolit përbën në të vërtetë një hap më vete në kuadër të një rrugëtimi që erdhi duke marrë përmasa të një qartësie e sigurie deri në botimet më të fundit që njeh nga ky autor tradita përkatëse e studimeve historike.¹¹

historian Barleti qëndron aqë shkallë nënë Antivarinon sa e kapërcen si shkrimtar. Rrallë jep mot, muaj dhe ditë, si Antivarinoja dhe me disa përjashtime të pakta, datat e tij janë të lajthitura. Viktorjet i madhon, edhe mjerimet nuk i përment. Shtrinë në fushën e betejës me mijëra Turq të vranë, dhe si pa gjë të keq shton se Shqiptarët e vranë ishin disa duzina të paka, sikur rrëfen romancë dhe jo histori. Shkurt, është fare hapur një panegjirist, sa historianët kritikë konkluduan që vepra e tij nukë ka asnjë vlerë. Marinesku e gjykon aqë ashpër, sa të gjithë të tjerët, po e këndoi Barletin, dhe pranon që këtu atje të thënat e tij vërtetohen prej dokumentave të kohës. Makusheff-i vete një çap më tutje, dhe thotë që Barleti duhet besuar kurdoherë që nuk vjen në kundërshtim me burimet e tjera.

¹¹Historia e Skënderbeut e shkruar nga Fan Noli përbën dhe sot e kësaj dite një prej burimeve kryesore të natyrës shkencore dhe kritike që kanë për objekt të mirëfilltë trajtimi dhe vëmendjeje një prej periudhave më të rëndësishme historike të kombit tonë. Disponimi i disa varianteve të botimit të kësaj vepre, sigurisht me modifikime të ndjeshme që diktohen nga vetë zgjedhjet e autorit përbën një vlerë të shtuar për disiplinat themelore të albanologjisë, në të cilat dhe historia e letërsisë së shkruar shqipe shënohet ndjeshëm në pikëpamje të një kontributi sa të denjë, aq dhe serioz.

Një ndër meritat më të mëdha që Fan Nolit i duhet njohur dhe në këto raste është fakti që burimet që dispononte i bënte objekt të një vështrimit të mirëfilltë kritik dhe pasqyronte ndërkohë dhe reflektime serioze në lidhje me shkrimtarinë dhe pozicionimin e secilit në raport me historinë e Skënderbeut. Njohja nga ana e tij e artificeve që mund të vihen në përdorim dhe kur shkruhen vepra të atyre përmasave dhe me një objekt që rreh qartë nga historiografia i bën më tërheqëse dhe interesante pasazhet konkrete nga vepra e tij.

Rimarrja e një biografie që ngërthen të dhëna mjaft me rëndësi për zhvillimet në dheun e Arbërit gjatë kohës në të cilën jetoi heroji ynë, por dhe më parë gjithashtu, përbënte një sprovë aspak të lehtë për një studiues si Noli, i cili risheh në optikën e historianit data, ngjarje, qëndrime të ndryshme në lidhje me këtë biografi dhe veçanërisht sa u takon elementeve jetësore që jo rrallë dhe janë vënë në dyshim nga burimet historiografike. Noli dallon fare qartë qëndrimet jo të njëjta të mbajtura nga historianë të ndryshëm, ndërkohë që Barleti vetë mbetet një prej burimeve më të konsideruara prej tij, qoftë në këndvështrimin e objektivitetit të diskutueshëm nga ana e tij, qoftë dhe në raste kur autori vetë beson në vërtetësinë e referimeve që sjell ky i fundit.

Konsiderohen jo pak burime nga ana e Nolit, qoftë në pikëpamje kronologjike, qoftë dhe në një hierarki këndvështrimesh të përzgjedhura prej tij e në të cilat ndërmendja e emrit të Barletit është e paevitueshme për shumë arsye. Pavarësisht motivimit të Barletit për të ndërmarrë përpilimin e dy veprave themelore që shënuan dhe vendin e tij plotësisht të merituar si në historinë e letërsisë sonë të shkruar, ashtu dhe në historiografinë skënderbeiane, referimi ndaj tij nga ana e mjaft historianëve apo biografëve nuk shmanget dot, kjo dhe për faktin që për shumë prej tyre Barleti konsiderohej një bashkëkohës i heroit tonë kombëtar dhe përjetues i ngjarjeve që u bënë vendimtare dhe për të ardhmen e qytet-kështjellave arbërore pas rënies së Shkodrës. Noli ka një qëndrim të qartë ndaj veprës së Barletit dhe kontributit të tij në lidhje me historinë e jetës dhe bëmave të Skënderbeut, ndërkohë që dallon fare mirë kur të tjerë biografë apo historiografë i referohen duke e kopjuar të plotë (jo rrallë dhe duke përsëritur të njëjtat inkoherenca që ndeshen te Barleti)

apo mbështeten duke marrë *a priori* të mirëqena pohimet e këtij të fundit. Subjektivizmi i mundshëm i Barletit është marrë në konsideratë dhe nga të tjerë studiues që kanë marrë përsipër të vështrjnë në mënyrë kritike dhe shkencore veprën e tij dhe ky fakt mbështetet dhe nga kontribute që gjatë dekadave të para të shekullit të kaluar u konkretizuan në punime të plota monografike.

Një kontribut jo rrallë i ndërmendur dhe i analizuar nga shumë studiues të periudhës së Skënderbeut mbetet ai i A. Gegajt, botuar nën titullin *L'Albanie et l'invasion turque au xv siècle*, Louvain, 1937.¹² I afërt në kohë me ndihmesat që përpiloi e realizoi për botim dhe autori i sipërpërmendur Francisc Pall, kjo vepër përmban analiza të hollësishme të elementeve të jetës së heroit tonë dhe të përfshirjes së tij në ngjarje dhe rrethana të rëndësishme historike. Ndërkohë dhe në këtë optikë konsideratash duhet vënë në dukje fakti që të tillë studiues që i afron si koha kur kanë përpiluar dhe parashtruar pikëpamje koncize në përbërje të gjurmimeve të tyre, ashtu dhe një prirje që ka ekzistuar në atë kohë në lidhje me të tilla hulumtime dhe me figura të rëndësishme të Gjergj Kastriotit,

¹² Sa i takon një vështrimi të natyrës kritike mbi këtë botim të Gegajt, shih në veçanti Monti G.M., në *Rassegne(Storia)*, në *Rivista d'Albania*, I, Milano, 1940, f.194-195: Il volume del Gegaj, edito nel 1937 a Lovanio, è l'ultima monografia erudita, con ricca bibliografia, con ampie annotazioni e alcuni documenti inediti sull'eroe albanese, e ad essa occorre far capo per la narrazione sistematica delle sue vicende, ben inquadrate in quelle dell'intera Albania di quel tempo e della grande lotta contro i Turchi. In 9 capitoli, oltre una conclusione, l'autore indaga prima sulle condizioni albanesi nella prima metà del Quattrocento e sulle varie famiglie signorili, quali i Topia, i Balscia e gli Aroniti, e poi illustra man mano la biografia del Castriota, dall'infanzia alla morte, terminando con il rilevare le tristi conseguenze della sua fine e della vittoria turca, non solo per l'Albania ma anche per i possedimenti di Venezia e per l'intero mondo occidentale. Si tratta di un'opera di ampio respiro, che ha molti meriti e che sostituisce tutte le precedenti, anche perché cerca, e riesce, a "correggere parecchi errori singoli e numerosi giudizi falsi o inesatti". È pur vero, però, che egli ci dà un'altra serie di altri errori, sia nei giudizi, come sui rapporti di Scanderbeg con il Magnanimo, sia nei dati di fatto, i quali furono rilevati in una minuta analisi dal Pall. Ma soprattutto è pur vero che il Gegaj continua a servirsi largamente dello "Anonimo di Antivari" quale fonte di prim'ordine per la biografia del Castriota, mentre invece, si tratta di un falso dovuto al prete settecentesco bresciano Giammaria Biemmi, come dimostrarono il Babinger nel 1931 e l'Ohly nel 1933, e come ribadisce di recente il Pall: è ovvio che l'uso di tale fonte apocrifia altera la veridicità della ricostruzione del Gegaj non solo in dati cronologici, ma perfino nella menzione di molti avvenimenti, che mai si ebbero! Occorre, quindi, selezionare dal volume tutte le notizie attinte al Biemmi, come occorre correggerlo di tutti i singoli errori segnalati dal Pall.

nuk kanë munguar të konsiderojnë në mënyrë kritike arritjet e njëri-tjetrit dhe një dukuri e tillë reflektohet në recensione dhe kritika shkencore që botoheshin në përmbyllje dhe rubrika të caktuara të revistave shkencore të po asaj kohe. Një vepër si kjo e A. Gegajt vijon të mbetet një burim i rëndësishëm referimi për këdo që jo vetëm interesohet për ndjekjen në pikëpamje ecurie të rrugëtimit biografik të heroit tonë kombëtar, por dhe për të pasur një ide më të qartë mbi një traditë gjurmimesh shkencore specifike që pikërisht në periudhën kur panë dritën e shtypit ky kontribut i Athanas Gegajt dhe i ndonjë bashkëkohësi të tij që u ndërmend më sipër, u shënuan nga arritje pozitive e konkrete në disa drejtime. Pikërisht sa i përket veprës së A. Gegajt, në këndvështrimin tonë mbetet për t'u veçuar evidentimi i burimeve në të cilat flitet për Gjergj Kastriotin dhe ndaj të cilave ai mban një qëndrim të natyrës kritike, të shprehur dhe në faktin që dallon në elemente të përmbajtjes së tyre dhe në modalitetet e referimit në to të ngjarjeve, rrethanave dhe momenteve jetësore me rëndësi që lidhen me heroin tonë.¹³

¹³ Shih në veçanti Pjesën hyrëse (*Introduction*) në Gegaj A., *L'Albanie et l'invasion turque au XV-e siècle*, Paris, 1937, f.V-XIV. Edhe në këndvështrimin tonë paraqitet pak më i ndryshëm qëndrimi i reflektuar në shënimet hyrëse të Gegajt mbi burime që kanë të bëjnë me historinë e Skënderbeut dhe pikërisht në lidhje me ato burime që konsiderohen alternative ndaj Barletit. Ky fakt reflektohet konkretisht në konsideratat mbi veprën e Biemmit dhe faktin që sipas tij ky i fundit duhet t'i ishte referuar Anonimit të Tivarit në proces të përpilimit të saj. Qëndrimi ndaj veprës së Barletit nënvizon për më tepër pikëpamje kritike të tij në lidhje me motivimet që ky i fundit duket se ka pasur për të përpiluar veprën e tij. Shih *po aty*, *Introduction*, f.IX: Barletius est un historien de la Renaissance qui écrit pour exalter le sentiment national de ses compatriotes. Pour lui, Scanderbeg est un héros national qu'il faut comparer aux héros de l'Antiquité, Alexandre le Grand ou Pyrrhus ; sa vie a été un véritable drame et par conséquent la principale tâche de l'historien consistera à en faire revivre les épisodes. Il intercale dans son récit un grand nombre de harangues, de longues descriptions de batailles et de victoires, qui fatiguent le lecteur moderne ; il exagère les victoires de son héros et cache soigneusement tout ce qui pourrait ternir sa gloire ; ainsi, quoique partisan de Venise, il rappelle de temps en temps la crainte ou la faveur que la République a témoignées vis-à-vis de Scanderbeg. D'autre part, cependant, les affirmations de Barletius ne sont pas toutes inventées ; il semble même qu'il a eu à sa disposition de nombreux documents qui lui ont fourni, pour plusieurs passages de son oeuvre, des renseignements précis et très exacts ; mais la façon de concevoir sa tâche l'a amené à les utiliser d'une manière fort peu critique. Barletius nous a donc conservé des informations détaillées sur les événements qu'il expose ; mais ses affirmations resteront toujours douteuses et ne pourront être acceptées qu'avec une grande réserve.

Çka mund ta përafrojë me Fan Nolin në pikëpamje metodologjike, mbetet fakti që Gegaj u ka dedikuar shekujve që i prijnë periudhës së Skënderbeut krerë të rëndësishëm të punimit të tij, ndërkohë që dhe në gjithë ecurinë e shtjellimit të përmbajtjes mund të vlerësohet nga ana e lexuesit dhe studiuesit një stil fare i qartë analizimi dhe paraqitjeje të saj, i karakterizuar thellësisht nga konciziteti në shprehjen e mendimeve dhe po në atë shkallë dhe në ndërtimin e frazës.¹⁴ Gegaj ka të qartë çdo argument që ka zgjedhur të bëjë pjesë të kësaj vepre, po ndërkohë nuk bie në sy për tejzgjatje në trajtimin e elementeve të një historie që pa dyshim do të kishte nevojë dhe për një parashtrim rrethanash historike që do të përgatisnin lexuesin si për faktin që një perandori e njëkohësisht fuqi militare e kohës do të kishte interesin të shtrinte sundimin dhe në viset tona, ashtu dhe për ndërgjegjësimin që ky vend pati figura prijësish të denjë që bënë të mundur që dhe para daljes në skenë të Gjergj Kastriotit të shënoheshin beteja që do të përjetësonin emrin e tyre në historinë e vendit tonë dhe në atë të Ballkanit. Do të gjenden në faqet e këtij punimi që mbart mirëfilli formatin dhe përmasat e një disertacioni shkencor dhe të dhëna me rëndësi për personalitete që kanë spikatur në pikëpamje kontributesh, por dhe për mbiemra familjesh dhe shtrirje territoriale që përmenden në analet e kohës dhe që janë të lidhura drejtpërdrejt me konfiguracionin gjeopolitik të viseve arbërore. Njohja dhe shtjellimi i këtyre rrethanave dhe i rolit që patën në mënyrë të ndërsjellë si në zhvillimet e mëvona, si në drejtim të koalicioneve të mundshme mes prijësve të këtyre viseve është me rëndësi të madhe, nëse kemi parasysh që mbetet po aq themelore të njihet çdo shekull i historisë sonë mesjetare, por dhe për të pasur të qartë se ç'faktorë do të shpinin më tej dhe në vendimet që do të ndikonin si në jetën e Kastriotit të ri, ashtu dhe në vijimësinë e ekzistencës së principatave të Arbërit. Gjurmimet historiografike mbi këtë periudhë të historisë së kombit tonë e kanë të domosdoshëm pikërisht trajtimin e ngjarjeve më me rëndësi që i prinë daljes në skenë dhe përfshirjes së pakthyeshme në skenat politike të Evropës së një personaliteti si Gjergj Kastrioti, ndërkohë që dhe vetë

¹⁴ Gegaj A., *L'Albanie et l'invasion turque au XV-e siècle*, Paris, 1937, *Chapitre III, Le soulèvement de l'Albanie contre la conquête turque et la famille Araniti (1385-1444)*, f.48-58.

saktësimi i shtrirjes territoriale të zotërimeve të prijësve arbër dhe pasardhësve të tyre mbetet po aq i rëndësishëm sepse përbën një element të pandarë të një mozaiku që plotësohet mbi të gjitha nga studime që marrin parasysh burime të shumta arkivore dhe qëndrimet e historianëve, kronikanëve dhe shkruesve të kohës mbi këtë periudhë dhe zhvillimet kryesore të saj.

Mbi Gjergj Kastriotin disponohen burime që nuk i përkasin vetëm dokumentacionit arkivor në pikëpamje origjine dhe përkatësie tekstore. Dokumentacioni arkivor pa dyshim mbetet një referencë themelore pa të cilën nuk do të ishte e mundur të ndërtoheshin arsyetime, të ndiqeshin linja që lidhen kryesisht me biografinë dhe me rrugëtimin personal të këtij heroit unik në çdo pikëpamje, të deduktoheshin përfundime qoftë dhe mbi ngjarje të caktuara apo dhe tipare fizike të heroit tonë, të risjella prej autorësh që e kanë përshkruar këtë të fundit në shënimet e tyre. Është fare e qartë që veçanërisht në traditën shqiptare të studimeve mbi këtë figurë dhe kontekstin që mbështet formimin dhe ecurinë e mëtejme të tij ka mbizotëruar vështrimi pozitivist që bën të mundur të krijohet një vizion mjaft i ngrohtë mbi një hero, luftëtar të sprovuar, ushtarak të talentuar dhe të prirur ndaj sakrificave në momente kryesore të jetës së tij dhe të vendit të tij.

Sa i takon saktësimin të momenteve themelore të jetës së heroit tonë, edhe vetë të dhënat mbi Gjon Kastriotin dhe marrëdhëniet e tij me fuqitë e kohës, ndihmojnë sadopak në këtë drejtim.¹⁵Në trajtime të caktuara rezulton që Gjon Kastrioti, i ati i Gjergjit dhe i bijve të tjerë që

¹⁵ Geci T., *Gjon Kastrioti dhe Dubrovniku*, në *Fjala*, n. 8, 1968, f. 18: Gjon Kastrioti, bir i Palit apo Gjergjit, Zot i Matit, Kastriës e Vumenishtës si dhe më vonë i Krujës, pa dyshim është fytyrë e dalluar e familjes kastriotjane, pikërisht për arsye se duke u përballuar zaptimeve turke në Shqipërinë e Mesme, ndërmoi një politikë e cila në një anë kishte për qëllim shpëtimin e vendit, kurse nga ana tjetër përpjekjet e saj nuk mbetën pa u shënuar me akte diplomatike e ekonomike, të cilat në histori shërbejnë si burim i rëndësishëm. Emri i tij është përdorur mjaft në historiografi, duke patur në gojë heroin legjendar-të birin e tij, Gjergj Kastriotin-Skënderbeun. Mirëpo, Gjon Kastrioti është përmendur edhe në dokumente arkivore të Venedikut që nga dekada e parë e shekullit XV. Kësaj radhe fjalën e kemi për marrëdhëniet ekonomike dhe politike të Gjon Kastriotit me Dubrovnikun për të cilat na dëshmon dokumenti nr. 793 i Arkivit historik të Dubrovnikut. Historia e këtij dokumenti është plotësisht e ngjashme me dokumentin nr. 163, për të cilin është bërë fjalë në numrin 7 të “Fjalës”.

ndërmenden dhe në përpilime të kohës, është përpjekur të stipulojë marrëveshje sidomos me Venedikun, duke pasur arsye dhe sigurimin e një lloj distancimi apo çlirimi nga të qenët vasal i sulltanit, fakt që si duket nuk e arrin me sukses.¹⁶ Vetë marrëdhënia e tij me Venedikun, siç do të vërehet dhe në rastin e Gjergjit, të birit, nuk do të jetë lineare dhe Gjon Kastrioti do të shihet më se një herë i pozicionuar në mënyra të ndryshme.¹⁷

Dhe kur flitet për prijës dhe zotërues të tjerë të viseve arbërore në këtë periudhë, si dhe për qëndrueshmërinë e statusit të tyre në këto zotërime, jo rrallë prej studiuesve është marrë në konsideratë mbështetja e mundshme e Venedikut, Raguzës, apo e ndonjë fuqie tjetër ballkanike apo evropiane. Një gjykim i tillë dëshmon dhe rinëvizon dhe një herë faktin që këto fuqi politike dhe ekonomike kanë qenë vazhdimisht influencuese në zhvillime të caktuara në viset tona, e kjo pikërisht në rastin e Kastriotit të ri mund të vërtetohet nëpërmjet mjaft burimesh dhe dokumentesh arkivore.

Në këtë kuptim, jo më me pak interes paraqiten dëshmi të natyrës dokumentare që dëshmojnë se në pikëpamje marrëdhëniesh tregtare dhe ekonomike, i ati i Gjergj Kastriotit ka kryer marrëveshje dhe me Dubrovnikun. Të tilla dokumente dëshmojnë, ndër të tjera, se Gjon Kastrioti dispononte një kancelari të veten dhe një fakt i tillë është dëshmuar dhe përmes studimesh që nuk kanë munguar të përpilohen dhe më parë në formate punimesh të plota apo artikujsh shkencorë.¹⁸ Njohja

¹⁶ Noli F., *Historia e Skënderbeut, Kryezotit të Arbërisë(1405-1468)*, Tiranë, 1962, f.19: Më 1411, sikundër e përmentmë më sipër, Gjon Kastrioti përpigjet të bënë një marrëveshje me Venetinë kundër Balshës III, dhe blaton 2.300 kalorës, a më tepër në qoftë nevoja për një pension prej 1.000 dukatesh në mot. Dy vjet më vonë, më 1413, Senati i Venetisë e bëri qytetar honorar të Republikës. Gjithatë mot e bëri qytetar honorar edhe Republika e Raguzës. Po këto alianca nuk i hynë në punë, se më 1416 përmendet prapë si vasali i Turqisë. Si duket, në këtë mes, u thye për së dyti, humbi Krujën, të cilën e zaptuan Turqit më 1415, dhe u shtrëngua prapë të njihte Sulltanin si kryezot edhe t'i paguante haraç.

¹⁷ Noli F., *Historia e Skënderbeut, Kryezotit të Arbërisë(1405-1468)*, Tiranë, 1962, f.20: Më 1422 Gjon Kastrioti kthehet kundër Venetikut, edhe lidhet me Kralin e Sërbisë Stefan Lazareviç, të cilit i ka dërguar një prej të bijve, ndofta prapë Stanishin, me një ushtri Shqiptare kundër Shkodrës Veneciane. Venetia përpigjet ta çkëputë nga kjo aliancë, duke i dhënë si ryshfet një pension prej dyqind dukatash në mot, edhe disa dhurata të tjera. Gjon Kastrioti preferoi të bëhet mik i të dy palëve, se më 1423 e shohim që hyn si ndërmjetës dhe arbitron paqen midis Venetisë dhe Sërbisë.

¹⁸ Shih në veçanti Geci T., *Gjon Kastrioti dhe Dubrovniku*, në *Fjala*, n. 8, 1968, f. 18.

dhe në këtë pikëpamje e një konteksti që nuk duhet të ketë qenë i ndërtuar vetëm mbi luftëra dhe përleshje, për më tepër dhe i ndërthurur me informacione që hedhin dritë mbi ndërtimin e marrëdhënieve komerciale të asaj kohe, përbën dhe zgjerim në pikëpamje vlerash dhe elementesh historike të një panorame që veçanërisht në dritën e dokumentacionit arkivor të ruajtur në vite paraqitet dhe interesante dhe me hollësi që transkribimet dhe botimet e përpiluara *ad hoc* ndihmojnë të studiohet e të përfshihet më mirë në studimet historike.

Botimet françeskane shqiptare janë pasuruar vazhdimisht me shkrime në të cilat trajtoheshin gjerësisht elemente të historisë së Skënderbeut e një fakt i tillë bie në sy në mënyrë të veçantë në historikun e tyre të gjysmës së parë të shekullit të kaluar. Në të vërtetë, vetë historiku i urdhrit françeskan në viset shqiptare ka lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimet konkrete në periudhën e Skënderbeut dhe një fakt i tillë është rimarrë dhe trajtuar dhe në studime e trajtesa specifike.¹⁹ Studimet shqiptare skënderbeiane u shënuan më tej dhe nga kontributi i çmuar i Atë Marin Sirdanit O.F.M., i cili pikërisht në vitet '20 të shekullit të kaluar botoi një vepër me mjaft interes e që, ndër të tjera, përfshinte dhe prurje nga letërsia popullore në të cilat shihet qartë jehona e figurës së Gjergj Kastriotit në popull. Një vepër si *Skanderbegu mbas gojëdhënash* përbën një nga kontributet më konkrete të Atë Marin Sirdanit O.F.M. ndaj kësaj tematike të gjerë dhe që e ka përfshirë thellësisht këtë të fundit në pikëpamje gjurmimesh dhe shkrimesh të natyrës shkencore dhe njëkohësisht divulgative. Leximi i pjesëve dhe i një arsenali këngësh tradicionale që ai ka përmbledhur në këtë vepër ndihmon në krijimin e një imazhi të veçantë mbi figurën e Gjergj Kastriotit dhe gjithë periudhën në të cilën jetoi ai vetë. Personazhe që kanë qenë të rëndësishme për të dhe njëkohësisht pjesë e lidhjeve më të afërta të tij janë bërë gjithashtu objekt i trajtimit në rrëfimet që e përbëjnë veprën, duke marrë kjo e fundit dhe përmasa të një tërësie që karakterizohet nga fryma narrative.²⁰

¹⁹ Shih në veçanti di Miceli F.M., *I Francescani in Albania ai tempi di Skanderbeg*, në *i Francescani e la politica, Atti del Convegno internazionale di studio a cura di A. Musco*, Palermo, 2002, f.343 v.

²⁰ Sirdani M. O.F.M., *Skanderbegu mbas gojëdhënash, Parathane*, Shkodër, 1926, f. 11: Në sa u orvatshe në shestim të këtyne gojëdhënave më ra në dorë një kolekcjon këngësh

Qasja e Atë Marin Sirdanit O.F.M. ndaj elementeve themelore të biografisë së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit, interesimi konkret ndaj personalitetit të një luftëtari që për nga bëmat dhe rreziqet me të cilat zgjedh të përballet meritonte të ngrihej në një pedestal të lartë nderimi e celebrimi, zbulon qartë faktin që dhe në këto sprova që në të vërtetë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të kontributeve shkencore të tij, ai mbetet një historian që vlerëson objektivisht dhe njeh gjithashtu burimet më të rëndësishme që orientojnë ndaj përvijimit të një historie të Skënderbeut nga pozita e hulumtuesit shkencor. Burimet që lidhen drejtpërdrejt dhe me kontekstin në të cilin jetoi dhe militoi Gjergj Kastrioti gëzojnë dhe njëfarë hierarkie vlerësimi dhe konsiderimi në shkrimet e Atë Marin Sirdanit O.F.M., ndërkohë që ky i fundit nuk ka munguar të vlerësojë dhe të dhënat jo të pakta që kanë ofruar për historianin dhe rindërtuesin e një historie të tillë dhe disiplina të tjera sa konkrete dhe po aq të lidhura me humanitetin, ndër të cilët dhe arkeologjia e botës së krishterë. Prireja e Atë Marin Sirdanit O.F.M. për të shpënë deri në fund arsyetime dhe interpretime të paraardhësve mbi momente të caktuara të jetës së Gjergj Kastriotit, zbulohet gradualisht nëpërmjet prurjeve të bollshme që dëshmojnë nga artikuj dhe trajtesa shkencore që më së pari panë dritën e botimit në revista kulturore dhe ishin themeluar kryesisht nga Provinca Françeskane shqiptare. Ato mbeten një argument tërheqës leximi dhe për ecurinë që autori vetë ka zgjedhur të ndjekë në çdo parashtrim të vetin në faqet e këtyre revistave. Pavarësisht si mund të vështrohen këto të fundit në optikën e gjurmimeve të sotme mbi figurën dhe kontributet e heroit tonë kombëtar për çështjen kombëtare, metodologjia e gjurmimit të mjaft burimeve nga ana e tij mbetet një ndihmesë mjaft e çmuar për shumë arsye, ndër të cilat do të renditnim dhe pranëvënien e mjaft burimeve që kanë qenë për shumë kohë faktorë ndikues dhe për të tjerë studiues të periudhës dhe shekullit në të cilin jetoi

tradicionare t'Italo-shqyptarëve, e do numëra të përkohëshme shqyptare të Londonit "Albania", e m'u mbush mendja atëherë se ishte më një landë e mjëftueshme për me perpilue një histori tradicionare të vogel me to. Ia hîna pra me lidhë njënen gojëdhânë me tjetëren, me u vû vrimet e nevojëshme, e me i krahasue me historîi, tuj marrë para sysh asertat e historjakëve më kritikë e të paëndëshëm, për me pasë ashtû lexuesi një njoftim të vertetë t'atyne kohëve.

Skënderbeu. Analizat e Sirdanit janë përherë të një gjatësie të konsiderueshme sa të ndihmojnë dhe të kuptohet rëndësia e datave apo e ngjarjeve të përveçme në receptimin e biografisë së Kastriotit dhe në to shihet fare qartë që ai vetë ka zgjedhur të ndalet dhe në shtjellimin e arsytimit që ndonjë bashkëkohës i Gjergj Kastriotit ka dashur të lërë dhe nën ndikimin e rrethanave që në kohë të caktuar nuk kanë qenë në favor të tij.

Edhe në shkrimet në të cilat personaliteti i Gjergj Kastriotit zë një vend qendror dhe është objekt motivimi për Sirdanin si autor, mund të shquhen pjesë të rëndësishme që duke shërbyer si elemente parahistorike që mbështetin gjithë skenarin e shfaqjes së heroit tonë në një kontekst të ndërlikuar nga shumë pikëpamje, vlejné gjithashtu dhe për të pasur ide të qarta mbi gjithë shtjellimet historike që nuk i munguan Ballkanit dhe viseve tona në veçanti, të përfshira në vazhdimësi në zhvillime sa politike, aq dhe të lidhura me çështje territoriale dhe autonomie. Një ide më e qartë mund të krijohet po të kihet parasysh dhe një gamë më e gjerë shkrimesh që mbajnë autorësinë e Atë Sirdanit O.F.M. e që në vetvete dëshmojnë interesin e vazhdueshëm që ai vetë kishte për historinë e kishës dhe të besimit të krishterë në trojet shqiptare dhe në shekujt që u prijnë në pikëpamje kronologjike ngjarjeve dhe zhvillimeve që lidhen me Gjergj Kastriotin. Mbetet ky i fundit një element përherë i pranishëm në objektivat e tij studimore, ndërkohë që nuk mungon të shërbejë si parashtrësë dhe në shkrime specifike në pikëpamje tematike si *Në sbka fajiset Skanderbegut*²¹; *Nji rival i Skanderbegut*²² etj.

Mund të konstatohet pa dyshim që dhe kur përshkruan personazhe që në pikëpamje virtytësh mund të rivalizojnë me Gjergj Kastriotin, Atë Marin Sirdani O.F.M. nuk bën tjetër veç përforcon një kuadër në të cilin epërsinë vijon ta mbajë heroi ynë me vetitë e tij që konvergojnë natyrshëm në një person të vetëm. Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut është

²¹ Sirdani M., O.F.M., *Në sbka fajiset Skanderbegu*, në *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f.42, botuar së pari në *Hyllin e Dritës*, n.2, 1935; n.3, 1935; n.11, 1935; n.1, 1936; n.2, 1936; n.3, 1936.

²² Sirdani M.O.F.M., *Nji rival i Skanderbegut*, botuar në *Hyllin e Dritës*, n.7-8, 1932, f.385-395; pasqyruar në *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f.43-65.

e lidhur pandashëm me personazhe që herë përkrahës të tij, herë ndjekës të interesave të ngushta personale, janë gjurmë dhe ndikuan dhe në rrjedhën që do të merrte marrëdhënia mes fisnikëve dhe të parëve të krahinave të vendit. Janë po aq për t'u shënuar figura që përfaqësojnë personazhe komplekse, në sa mund të jenë me origjinë shqiptare, por të mburjtur e të rritur në vende të huaja e duke u vënë në shërbim të turqve, janë në të vërtetë armiqtë më të egër për Skënderbeun dhe për ushtrinë e tij. Në këtë këndvështrim, figura e Lekë Dukagjinit, krenar dhe kryelartë për çka mendonte se i përkiste, mbetet po aq e trajtuar në shënimet dhe shkrimet e Atë Marin Sirdanit O.F.M., dhe kompleksiteti i tij karakterial do të krijojë jo pak vështirësi për ecurinë e ngjarjeve në të cilat Gjergj Kastrioti ishte i thirrur drejtpërdrejt të luante rolin e tij prej prijësi.²³

Ribotimi i kontributeve kryesore të atë Marin Sirdanit O.F.M. vitet e fundit përbën një gjest domethënës dhe krejt me vend sa i takon çështjes së rikthimit të vëmendjes ndaj monumenteve shkrimore që i bëjnë nder historiografisë shqiptare dhe lartësimit të figurave themelore të saj. Ribotimi anastatik i veprës me të cilin Marin Sirdani u bë i njohur në dekadat e para të shekullit të kaluar, *Skanderbegu mbas gojëdhânasb* (Shkodër, 2008); botimi tematik me titull *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare* (Botime Françeskane, Shkodër, 2017); si dhe përfshirja e kontributeve më specifike të tij në lidhje me historinë e Skënderbeut në përmbledhjen më të fundit me titull *Gjergj Kastrioti-Atleta Christi* (Botime Françeskane, Shkodër, 2018), janë një tjetër dëshmi e një vlerësimi të tillë. Vëllimi me titull *Gjergj Kastrioti-Athleta Christi* (Botime Françeskane, Shkodër, 2018) përbën një përmbledhje të gjetur në pikëpamje tematike, duke qenë se në të gjenden të radhitura e të përafuara një sërë trajtesash të përpiluara në vite nga klerikët shqiptarë katolikë e që kanë të bëjnë pikërisht me figurën e Kastriotit në studime dhe hulumtime kryesisht të etërve françeskanë të Provincës së Zojës Nunciatë.

Në një shkrim komemorativ të vitit 1968 e thellësisht tematik të Atë Paulin Margjokajt O.F.M. gjejmë të rimarra në elementet më qenësore

²³ Sirdani M. O.F.M., *Nji rival i Skanderbegut*, botuar në *Hyllin e Dritës*, n. 7-8, 1932, f. 385-395; pasqyruar në *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f. 43-65.

momente biografike të ndërmendura përherë e të bëra objekt i kërkimit shkencor nga shumë studiues, përfshirë vitin e lindjes dhe çështjen e saktësimin të tij, vitin a moshën e përafërt kur duhet të jetë vënë në shërbim të Sulltanit, vitin e kthimit të planifikuar në dheun mëmë, pjesëmarrjen në beteja vendimtare për fatin e principatave arbërore etj.²⁴

Momente jetësore që lidhen drejtpërdrejt me figurën e heroit dhe kthimin e tij në vendlindje, gjetja e një ndërlidhjeje mes pjesëmarrjes së tij në betejën e Nishit (1443) dhe synimeve me gjasë ekzistuese për t'u kthyer në dheun mëmë trajtohen në shkrimin e Atë Paulin Margjokajt O.F.M., me të cilin dhe çelet panorama e shkrimeve që sillen në këtë përmbledhje. Lëvizja strategjike e tërheqjes që Gjergj Kastrioti kryen duke u larguar me ushtarët që kishte mbas vetes për t'u drejtuar në vendlindje është përmendur gjatë dhe është interpretuar nga historianë që kanë ndjekur në veçanti momentet biografike më domethënëse të epopesë skënderbeiane.

Po të Paulin Margjokaj O.F.M. do të gjenden të përshkuara momente celebrative që lidhen me kthimin e Kastriotit në viset arbërore, ndër të cilat, dhe simbologjia e flamurit përbën një shenjë më vete të këtij festiviteti historik.

Vitet që do të pasojnë kthimin e Skënderbeut në atdhe dhe përpjekjet e tij për të koordinuar atmosferën mes principatave dhe prijësve të tyre do të shënohen nga ndeshje aspak të lehta mes arbërve dhe ushtrive turke. Këto beteja rimerren e përshkruhen nga mjaft kronikanë dhe historianë dhe në to mund të gjenden dhe nuanca të ndryshme në pikëpamje dokumentimi dhe evidentimi të realitetit historik. Një gjë është mjaft e qartë: këto beteja a ngjarje që më tej do të marrin një rëndësi të pamohueshme historike vënë në pah akoma më shumë aftësitë prej prijësi të Gjergj Kastriotit dhe burrëria e tij nuk mbetet as jashtë vëmendjes së Venedikut, interesat e të cilit luhateshin simbas ndryshimeve sa politike, aq dhe ekonomike. Sa i përket mbështetjes së ndërmendur a të supozuar të Venedikut apo faktit që Skënderbeu pati përkrahjen e tij në raste kritike të përbaljes së tij me turqit dhe me fuqinë otomane, në jo pak trajtesa nënvizohet fakti që Serenissima ndoqi dhe pati prioritet interesat

²⁴ Margjokaj P. O.F.M., *Perkujtojmë 500-vjetorin e dekadës së Skanderbegut me një jetëshkrim të shkurtër të tij*, në *Jeta Katolike Shqiptare*, n. 2, 1968.

ekonomike dhe tregtare, duke lënë të kuptohet kësisoj që një fakt i tillë nuk dëshmon se kjo e fundit e mbështeste Gjergj Kastriotin në situata të një shkalle kritike.

Janë pikërisht vite intensive në të cilat shënohen qoftë triumfe masive të forcave arbërore që ndeshen me turqit, qoftë dhe raste kur triumfon aftësia personale strategjike e Skënderbeut, dhe pse jo gjithmonë e pasuar nga një fitore e dëshirueshme e ushtrive të tij. Skënderbeu pa dyshim njeh fare mirë hollësi të ndërtimit dhe të avantazheve në pikëpamje përgatitjeje të ushtrive otomane, ndërkohë që sidomos në Rrethimin e Krujës (1450) së prirë nga Sulltan Murati, fortesa arbërore do të rrethohet nga një mizëri forcash të armatosura dhe prej një morie repartesh ushtarake që ishin karakteristike të organizimit militar otoman.

Përshkrimet që lidhen me të tilla momente të Rrethimit të Krujës, përveç se mbartin qartë elemente informative që hedhin dritë mbi ecurinë e kësaj ngjarjeje që është përmendur gjatë dhe në burimet otomane, përbëjnë dhe mundësi për të ditur më gjerësisht rreth kulturës së luftimit të secilës prej palëve të interesuara, ndërkohë që nuk mungojnë as hollësi të përgatitjes së palës otomane, e cila dihet tashmë se zotëronte mjete ekonomike për të prodhuar e përgatitur armë përherë e më të sofistikuarra për kohën.

Një gjë mbetet fare e qartë: kryezoti shqiptar nuk pati pothuajse asnjëherë sigurinë e një mbështetjeje permanente nga ana e shteteve evropiane që gjithsesi për shumë arsye ndiheshin të rrezikuara nga ideja e një avancimi përherë të synuar drejt tyre nga ana e Perandorisë Otomane. Një fakt i tillë ndërmendet prej mjaft studiuesve të historisë së Skënderbeut e në këtë pikëpamje konsiderohet qëndrimi dhe disponibiliteti i Raguzës, i Venedikut, i Milanos, i Napolit gjithashtu. Marrëdhënia me gjithsecilin prej këtyre shteteve që pa dyshim një preokupim më vete për Kastriotin, i cili në jo pak raste u gjend jo vetëm pa mbështetje, por dhe u dëmtua nga qëndrimi jo i vendosur apo i prirë nga interesat ekonomike a tregtare të tyre, në veçanti të Venedikut.

Një shkrim me mjaft interes në vitet '60 të shekullit të kaluar përbën kontributi i Atë Zef Valentinit S.I., i cili merr përsipër të trajtojë nëpërmjet trajtesave të natyrës diakronike dhe nocionin e evropianitetit që në kohën

kur jetoi e militoi Gjergj Kastrioti.²⁵ Është mjaft e qartë që dhe shekulli XV u shënuar nga përparime dhe arritje të konsiderueshme në fushë të kulturës së kontinentit në fjalë dhe veçanërisht bibliofilia si prirje është dalluar ndjeshëm në disa pikëpamje. Mbetet dhe ky shkrim i një natyre të qartë celebrative ndaj vetive të rralla dhe aftësive të dëftuara në mjaft raste dhe ngjarje nga heroi ynë, ndërkohë që nuk mungojnë as qasjet me të tjera figura mjaft të rëndësishme dhe monumentale për historitë përkatëse të disa vendeve të Evropës. Rëndësia e bëmave dhe e ndërhyrjeve jo të pakta të Gjergj Kastriotit dhe në rastet kur përballja i kalonte kufijtë e viseve arbërore nënvizohet jo pak herë dhe në këtë trajtesë të Atë Zef Valentinit S.I., ndërkohë që dhe ndërmendja e këtij të fundit si një mbrojtës i denjë i krishterimit dhe i evropianitetit nuk mungon të vihet gjithashtu në dukje.²⁶ Kontribute me interes të veçantë mbeten ato të Atë L. Marlekaj O.F.M., i cili ka përzgjedhur një argument mjaft origjinal për të shtjelluar, siç është dhe reflektimi i jehonës së figurës së Kastriotit në vëllime a korpuse biografike të përpiluara nën qëllimin e evidentimit të kontributeve të njerëzve të shquar në historinë e Evropës. Trajtesa e tij në lidhje me këtë argument përmban një numër të konsiderueshëm referencash dhe, për më tepër, arsyetime që hedhin dritë mbi një traditë shkrimtarie në shekujt që lidhen drejtpërdrejt me reflektimin e bëmave të Skënderbeut në autorë dhe vepra. Renditja e një biografie mbi Skënderbeun në përbërje të një korpusi me autor anonim e që përmbante jetët e njerëzve të shquar për bëma dhe prejardhje fisnike përbën një fakt që duhet trajtuar dhe thelluar për shumë arsye.²⁷ Autori vetë (Marlekaj) e

²⁵ Shih në veçanti shkrimin me titull *Skandërbegu në Europë t'atëbershme*, botuar së pari në *Shënjzat*, nr. 7-12, 1968.

²⁶ Shih në veçanti sythin me titull *Skënderbeu e Europa (po aty)*, f.28-29), në përbërje të kësaj trajtese me vlerë të Atë Zef Valentinit S.I.

²⁷ Shih në veçanti dhe vepërzën me titull *Vita di Scanderbego di uno storico cinquecentista italiano, con introduzione a cura di L.Marlekaj*, Romë, 1973, f.5-26. Bëhet fjalë për një studim mirëfilli filologjik nga ana e Atë Marlekaj O.F.M., i cili jo vetëm sjell të dhëna me vlerë mbi dorëshkrimin prej 395 fletësh në të cilin duhet të përmbahet dhe përshkrimi i jetës dhe i veprës së Gjergj Kastriotit, Skënderbeut, por dhe kategorizon mbi bazë parametrash tekstore dhe indicet që dallojnë fizikisht elemente të ndërtimit të kësaj vepre që ruhet në Bibliotekën Kombëtare të Firences. Nga ky studim i Marlekaj do të vilen dhe karakteristika të gjendjes fizike të këtij dorëshkrimi të ruajtur përgjithësisht mirë, pjesët e të cilit gjithsesi nuk paraqiten të ruajtura të gjitha në të njëjtën gjendje

konsideron një biografi të tillë si të tretën për nga rëndësia duke pasur parasysh si më me peshë kontributet e Barletit dhe të Dhimitër Frangut. Si dhe në rastin e sprovave të tjera të Atë Marlekajt O.F.M. e që janë konkretizuar si në gjurmime serioze dokumentare mbi jetën dhe veprimtarinë e autorëve të letërsisë së vjetër shqipe, ashtu dhe në artikuj shkencorë në të cilët janë trajtuar çështje të një rëndësie themelore për historinë e gjuhës shqipe, ky kontribut priret të nënvizojë rolin dhe rëndësinë që filologjia e tekstit merr sidomos kur studimi që duhet shpënë në përfundim duhet pikërisht të jetë i mbështetur nga kritere të natyrës së mirëfilltë shkencore. Luigj Marlekaj nuk është mjaftuar vetëm në studimin e tekstit që i është kushtuar heroit tonë kombëtar dhe që përbën një sfidë dhe në rang të zbatimit të kriterëve filologjike për ta studiuar dhe për ta bërë të përafërueshëm me studiuesit, por dhe ka analizuar elemente që mund të shpien gjithsesi drejt autorit vetë dhe kontekstit në të cilin ky i fundit ka operuar dhe në proces të përpilimit të kësaj vepre.²⁸ Nga ana tjetër, vëmendjes së Marlekajt nuk i ka shpëtuar as predispozicioni i vetë autorit anonim ndaj përfshirjes në punimin e tij të jetës së Skënderbeut, të cilën, sipas studiuesit tone, duhet ta ketë përpiluar pas përfundimit të trajtimit të biografive të personazheve të tjera që ndërmenden në këtë vepër dhe që në të vërtetë janë personalitete të një rëndësie të spikatur historike.²⁹ Vetë burimet që janë marrë në analizë nga ky autor kanë qenë objekt i një vështrimi kritik nga ana e Marlekajt, te i cili lexohet fare qartë

mirëmbajtjeje. Siç do të shprehet vetë Marlekaj në hyrje të këtij studimi të sipërcituar, f. 5: *Il manoscritto è ben conservato e soltanto in alcuni punti, dove la carta è corrosa dall'inchiostro, non si riesce a leggerlo.*

²⁸ Ndër të tjera do të veçonim dhe simpatinë e qartë që autori ruan për figurën e Gjergj Kastriotit. Shih në veçanti *Vita di Scanderbego di uno storico cinquecentista italiano, con introduzione a cura di L.Marlekaj*, Romë, 1973, f. 13: Una calda corrente di simpatia pervade le pagine della vita di Scanderbeg, in particolare la dove l'Autore tenta delineare la figura del condottiero albanese: "Se noi per tanto uogliamo hauere riguardo al ualore, alla prudenza, et insieme alla riligione e liberalità sua, egli fu tanto eccellente, e raro, che à me non darebbe l'animo trouare cotante uertù insieme unite in alcun soggetto degli Antichi?". (f.148 v).

²⁹ *Vita di Scanderbego di uno storico cinquecentista italiano, con introduzione a cura di L.Marlekaj*, Romë, 1973, f. 9-10. Shih në veçanti dhe pohimin e shprehur nga Marlekaj në f. 10 të këtij botimi të sipërcituar: La *Vita di Scanderbego* può essere quindi considerata come termine ultimo della composizione dell'opera, poiché essendo stata scritta dopo le altre, nel 1541, evidentemente il manoscritto era già stato ultimato prima di quella data.

interesi për të dalluar përfundimisht anën shkencore në këto burime që citohen dhe në dorëshkrim e për të thelluar më tej dhe studime të vetat mbi historinë e Skënderbeut.³⁰

Siç dhe u ndërmend më sipër, edhe çështja e njohjes së portretit të mundshëm të heroit tonë nëpërmjet burimesh që datojnë kryesisht në shekujt e parë që pasojnë Katërqindën, mbetet një argument me interes që nuk përfshin në këtë rasë vetëm studiuesit e historisë së artit shqiptar. Një trajtesë mjaft komplekse e që priret të sjellë prurje konkrete dhe në këtë drejtim është ajo e Atë Vinçens Malaj O.F.M., e përpiluar dhe e referuar pikërisht në vitet '60 të shekullit të kaluar e që u ribotua dhe tash së fundmi në kuadër të përmbledhjes tematike me titull *Gjergj Kastrioti-Athleta Christi*, në serinë e Botimeve Françeskane, Shkodër (2018).³¹ Një kontribut po aq themelor i këtij studiuesi, që, ndër të tjera, mbetet i mirënjohur për interesimin kërkimor ndaj një ngjarjeje me rëndësi shumëplanëshe siç ishte Koncili i Arbënit i vitit 1703, është dhe ai me titull *Nevoja e një bashkërendimi bibliografik kastriotian*, paraqitur gjithashtu në një veprimtari të rëndësishme shkencore në vitet '60, në një përvjetor komemorativ të 500-vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar.

Në çdo kontekst trajtimi të kontributeve mbi periudhën e Skënderbeut dhe vetë biografinë e Gjergj Kastriotit, ndihmesa e vyer që kanë dhënë etërit françeskanë të provincës shqiptare gjatë gjysmës së parë të shekullit të kaluar si me artikuj, si me vepra më të plota zë një vend të veçantë. Siç u tha dhe më sipër, janë një sërë shkrimesh që shtjellojnë një tematikë të tillë, e cila mbështetet në mjaft elemente dhe nga burime që

³⁰ *Vita di Scanderbego di uno storico cinquecentista italiano, con introduzione a cura di L.Marlekaj*, Romë, 1973, f.13. Pikërisht aty(f.13) do të lexohet qartë dhe interpretimi që Marlekaj shpreh ndaj prirjeve të autorit në përshkrimin e jetës së Gjergj Kastriotit dhe burimeve të konsideruara prej tij: Le fonti sono, nell'ordine seguito dall'Autore, il *Commentario de le cose de Turchi, et de S(ignor) Georgio Scanderbeg* che egli attribuisce a un Veneziano, perché stampato anonimo a Venezia, mentre è opera di Demetrio Franco, un albanese nativo di Drivasto e tesoriere di Scanderbeg che lo accompagnò nel suo viaggio a Roma nel 1466; la *Historia de vita et gestis Scanderbegj* dell'umanista scutarino Barlezio, dall'Anonimo detto Barlettano, il quale fu contemporaneo di Scanderbeg e compose la sua opera, tradotta in quasi tutte le lingue d'Europa, a quarant'anni circa dalla morte dell'eroe.

³¹ Malaj P.V. O.f.M., *Përfytyrimi i Skanderbegut dhe autenticiteti i tij*, botuar gjithashtu në *Të dhana albanologjike, folklor, bibliografi, histori*, Botime Françeskane, Shkodër, 2016, f.157-170.

janë shkruar kohë më parë e njihen si primare për çdo studiues të asaj kohe dhe të problematikës së saj. Në këndvështrimin tonë spikasin në veçanti trajtesat e tyre dhe në pikëpamje të interpretimit nga ana e studiuesve e elementeve më të ndërmendura biografike të Gjergj Kastriotit, mjaft të rëndësishme në kuptimin e rindërtimit të mbarë rrugëtimit të tij si individ dhe hero i një periudhe të veçantë për historinë e kombit tonë.

Studimet e kësaj natyre e në veçanti artikujt që në dekadat e para të shekullit të kaluar gjenden në faqet e të përkohshmeve më të rëndësishme kulturore të kohës përbëjnë burime me vlerë kryesisht në kuptimin që kanë vijuar t'u shërbejnë gjurmimeve të mëtejme që janë kryer mbi të njëjtat argumente, qoftë dhe për të saktësuar një hierarki të domosdoshme referenciale sa u përket burimeve më të besueshme në pikëpamje shkencore. Pavarësisht ecurisë së mëtejme që kanë marrë studimet mbi jetën dhe bëmat e Skënderbeut, të tilla shkrime mbeten pjesë e një tradite studimore që është konsoliduar dhe falë tyre dhe këndvështrimeve që janë rrahur dhe trajtuar në to. Ndër të tjera, dhe ribotimet e veprave të Marin Barletit e në veçanti të *Historisë së jetës dhe bëmave* të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut kanë shënuar hapa të mëtejme dhe në pikëpamje të studimit të përmbajtjes së tyre, aq më tepër pas pajisjes dhe me parathënie dhe sqarime mbi variantet e përdorura për të realizuar shqipërimin. Mbetet akoma aktuale perspektiva e qasjes së varianteve të shqipëruara nga filologët dhe medievalistët tanë me të tjera kësomblla ekzistuese në gjuhën latine dhe në gjuhë të tjera, ndërkohë që pikërisht rindërtimi i episodeve më të ndërmendura nga jeta e Kastriotit mund të bëhet mbi bazën e interpretimeve të pasazheve të caktuara nga vepra e Marin Barletit, si një ndër autorët më të afërt dhe në kohë me periudhën në të cilën jetoj heroj ynë. Vepra e Marin Barletit do të vijojë të jetë objekt kërkimesh shkencore për gjurmuesit e teksteve të kohës në të cilën jetoj ky autor, por dhe për kë ka interes të ndjekë realizimin e varianteve të veprave të tij kryesisht në gjuhën latine dhe më tej, në të tjera gjuhë të Evropës. Modelet tekstore që ofrohen në këto variante dhe elemente të veçanta të tyre që mbeten si rezultat dhe i inkoherencave të kohës e që mund t'i atribuohen si autorit,

por dhe realizuesve për shtyp të tyre janë një linjë interesante gjurmimesh që pasurojnë pikërisht kërkimet në fushë të filologjisë së tekstit.

Viti 2018 që veçanërisht shënues në shumë pikëpamje për perspektivat që ofroi dhe për një sërë veprimtarish shkencore që patën në qendër të vëmendjes figurën e Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Në ligjëratat magjistrale që u mbajtën gjatë këtij viti celebrativ që e mundur të ndiqej një strategji e arsyetuar që jo vetëm bënte të mundur të njëjët këndvështrimi i studiuesve të huaj mbi rolin që pati në të gjallë të vet ky hero i botës arbërore, por dhe një arsenal i tërë botimesh në gjuhë të huaj, që të para kryesisht në këndvështrimin filologjik dhe tekstor, bënë të mundur të receptohej qartë jehona e veprave që u përpiluan pikërisht mbi këtë figurë të rëndësishme të historisë së kombit tonë e të Ballkanit. Në të vërtetë, hulumtimi i këtyre veprave mbetet një linjë më vete studimore, duke qenë se nëpërmjet saj krijohet një ide mbi ç'përfaqësonte veçanërisht në atë kohë simbologjia e një hero i luftonte në kushte të pabarabarta me një njësi politike e ushtarake përherë në rritje dhe fuqizim, ndërkohë që pozicioni strategjik i viseve tona përbënte një arsye më shumë që ato të gjendeshin dhe më të ekspozuara ndaj synimeve otomane, duke qenë se përbënin dhe një rrugë kalimi për në viset përtej Adriatikut. Vetë brendësimi përmbajtësor i secilës prej këtyre veprave jep të kuptojë se jo përherë ndeshen të njëjtat qëndrime dhe konsiderata në lidhje me burimet më të hershme në të cilat ndërmendet Gjergj Kastrioti (Skënderbeu) dhe pikërisht ky diversitet e bën më të respektueshme dhe traditën përkatëse të gjurmimeve dhe kërkimeve në lidhje me të.

Bibliografi:

1. Bardhi F., *Skënderbeu (Apologji)*, (përktheu nga latinishtja Stefan I.Pristi), Tiranë, 1967.
2. Barleti M., *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, (përkthimi nga origjinali latinisht dhe hyrja nga S.J.Pristi), Tiranë, 1964.
3. Barleti M., *Historia e Skënderbeut*, (botim i tretë, përkthyer nga S.I.Pristi), Tiranë, 1982.

4. Barleti M., *Historia e Skënderbeut, Libri XI, Botimi IV, shqipëroi Stefan Prifti*, Infbotues, Tiranë, 2005.
5. Barleti M., *Rrethimi i Shkodrës, përktheje prej origjinalit latinisht nga H.Lacaj, Botimi i dytë i plotësuar*, Tiranë, 1967.
6. Barleti M., *Rrethimi i Shkodrës (përktheu H.Lacaj);përgatiti për botim D.Hosaflook*, Botime Onufri, Tiranë, 2012.
7. Degrand A., *Souvenirs de la Haute-Albanie*, Paris, 1901.
8. Ceka H., *Vërejtje mbi disa të dhana topografike rreth luftave të Skënderbeut sipas Barletit*, Buletin për Shkencat Shoqërore, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1952.
9. Cordignano F., *Geografia ecclesiastica dell'Albania*, në *Orientalia christiana*, XXXVI, n.4, 1934.
10. Di Miceli F., *I Francescani in Albania ai tempi di Skanderbeg*, në *I Francescani e la politica*, Atti del Convegno Internazionale di studio, Palermo, 2002.
11. Geci T., *Gjon Kastrioti dhe Dubrovniku*, në *Fjala*, n.8, 1968.
12. Jorga N., *Brève histoire de l'Albanie et du peuple albanais*, Bucarest, 1919.
13. Jorga N., *Histoire des États balcaniques jusqu'à 1924*, Paris, 1924.
14. Malaj V., O.F.M., *Përfytyrimi i Skanderbegut dhe autenticiteti i tij*, në: *Të dhana albanologjike, folklor, bibliografi, histori*, Botime Françeskane, Shkodër, 2016.
15. Malipiero D., *Annali veneti dall'anno 1457 al 1500*, në *Archivio storico italiano*, VII, Firenze, 1843.
16. Marlekaj L., *Scanderbeg nelle tradizioni popolari albanesi*, Bari, 1969.
17. Miceli F.M., *I Francescani in Albania ai tempi di Skanderbeg*, në *i Francescani e la politica*, Atti del Convegno internazionale di studio a cura di A.Musco, Palermo, 2002.
18. Nadin L., *Migrazioni e integrazione: il caso degli Albanesi a Venezia(1479-1552)*, Bulzoni editore, Romë, 2008.
19. Nadin L., *Albania ritrovata.Recuperi di presenze albanesi nella cultura e nell'arte del Cinquecento veneto,përktheu Pëllumb Xhufi*, Botime Onufri, Tiranë, 2012.

20. Nadin L., *Religiosi albanesi nelle terre della Serenissima tra Quattrocento e Cinquecento: uno scenario di incredibile ampiezza, tra storia di chiese e storie di arte*, në *Hylli i Dritës*, n.3-4, 2013.
21. Nadin L., *Marino Barlezio tra Venezia, Padova, Vicenza. Paesaggi veneto-scutarini*, në *Shëjzat-Pleiades*, n.1-2, 2016.
22. Nadin L., *Figura e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut (Nga historia te miti: shekujt XV-XVIII), përkthet nga origjinali dhe përgatiti për botim: Prof.As.Dr.Evalda Paci*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2018.
23. Noli F., *Historia e Skënderbeut, Kryezotit të Arbërisë(1405-1468)*, Tiranë, 1962.
24. Padiglione C., *Di Giorgio Castriota Scanderbech e de' suoi discendenti*, Napoli, 1879.
25. Pall F., *Marino Barlezio, uno storico umanista*, Bucaresti, 1938.
26. Pall F., *I rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV (documenti con introduzione e note storico-critiche)*, Società Napoletana di storia patria, Napoli, 1966.
27. Paci E., *Marin Sirdani O.F.M.: Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, në *Hylli i Dritës*, n.1, 2018.
28. Paci E., *Vepra e Marin Barletit, në një kontekst të historisë së letërsisë së shkruar shqipe*, në *Hylli i Dritës*, n.2, 2018.
29. Paci E., *Çështje të studimit të disa varianteve të botimit të veprave të Marin Barletit*, në *Shëjzat*, n.3-4, 2018.
30. Pipa A., *Umanisti italo-albanesi*, në *Albanica, Numër special*, 1992.
31. Plasari A., *Skënderbeu, një histori politike*. Instituti i Studimeve Shqiptare "Gjergj Fishta", Tiranë, 2010.
32. Plasari A., *Shqipëria dhe shqiptarët në Europën e Piut II*, IDK, Tiranë, 2014.
33. Petrotta G., *Popolo, lingua e letteratura albanese (a cura di M.Mandalà)*, Edizioni Mirror, Palermo, 2003.
34. Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932.
35. Scapolo E., *Venezia e Albania (saggio documentato delle relazioni Veneto-Albanesi nei secoli XIV-XV)*, Fascicolo I, Venezia, 1908.

36. Sirdani M. O.F.M., *Skanderbegu mbas gojdhânash*, në *Zâni i Shna Ndout*, n.III, 1920.
37. Sirdani M. O.F.M., *Kerkime mbî vorrin e Skanderbegut*, në *Hylli i Dritës*, n.4, 1932.
38. Sirdani M.O.F.M., *Nji rival i Skanderbegut*, në *Hylli i Dritës*, n.7-8, 1932.
39. Sirdani M. O.F.M., *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Botime Françeskane, Shkodër, 2017.
40. Ugolini L.M., *Pagine di storia veneta ai tempi di Scanderbeg e dei suoi successori*, në *SA*, T.III-IV, Romë, 1933-1934.
41. Valentini Z. S.I., *Skandërbegu n'Europë t'atëbershme*, në *Shëjzat*, n.7-12, 1968.
42. Zamputi I., *Lezhja, Rodoni, Durrësi dhe përpyekjet e fundit për rimëkambjen e principatave shqiptare*, në *Studime historike* n.1, 1964.
43. Zamputi I., *Gjendja e materialeve dokumentare dhe burime të reja vendase për historinë e Shqipërisë për tre shekujt e parë të pushtimit turk*, në *Buletin për Shkencat Shoqërore*, n.3, 1955.
44. Zamputi I., *Shënime mbi disa aspekte të lëvizjes çlirimtare shqiptare gjatë sundimit turk*, në *Studime historike* n.1, 1965.
45. Zamputi I., *Elemente të vetëdijes shqiptare në përpyekjet për liri, për gjubën shqipe e për arsim në shekujt XVI-XVII*, në *Studime historike* n.3, 1965.
46. Zoncada A., *Scanderbeg, Storia albanese del secolo XV*, Milano, 1874.

TRYEZA

Anton Nikë BERISHA

RRETH VEPRËS “KËNGËTORJA ARBËRESHE” TË FRANÇESK ANTON SANTORIT

“E çka është më e përjetshme sesa dashuria? Dashuria është më e lartë se ekzistenca, është kurorëzim i ekzistencës, e si është e mundur që ekzistenca të mos i nënshtrohet?”.

F. Dostojevski
(Nga “Demonët”)

I. VEPRA LETRARE SI PËRFYTYRIM, SHËMBËLLIM

Vepra e shkrimtarit arbëresh, Françesk Anton Santorit, *Il canzoniere albanese-Këngëtorja arbëreshe*¹, më shumë se çdo vepër tjetër e tij, të ballafaqon me dukuri të natyrës teorike dhe të shtjellimit të veçantë shprehës poetik të tekstit².

¹ Meqenëse në veprën “Il canzoniere albanese” nuk është shënuar data e botimit, disa autorë mendojnë se vepra u botua më 1839. Sipas të dhënave që jep F. Solano, vepra duhet të jetë botuar në vitin 1846 ose 1847, çështje që këtu nuk e bëj objekt shqyrtimi. Shih më gjerësisht Françesko Solano *Nota introduttiva*. Në Francesco Antonio Santori, *Il Canzoniere albanese*. Trascrizione, traduzione italiana e note a cura di Francesco Solano. “Radhonytë e zjarrit” & “Quaderni di Zjarri” n. 3, 1975, f. 29.

² Për disa nga veprat letrare të këtij shkrimtari arbëresh shih punimet e mia *Mbi dorëshkrimin e Rapsodive të Françesk A. Santorit*. Në Quaderni del Dipartimento di Linguistica. Università della Calabria. Albanistica 2. Rende 1997, f. 15-21; *Qenësia dhe moderniteti i tragjedisë sonë të parë*. Parathënie. Në Françesk Anton Santori, “Neomenia”. Tragjedia e parë shqipe. Transkriptimin Daniela Meringolo. “Shpresa”, Prishtinë 2001, f. 7 – 22; *Drama shoqërore dhe drama shpirtërore. Drama e parë shqipe “Emira” e F. A. Santorit*. Në “Atti del 3° Seminario internazionale di studi albanesi. A cura di F. Altimari e F. De Rosa. Centro Editoriale e Librario della Università degli Studi della Calabria. Cosenza2004, f. 173 – 185, ribotuar në veprën time *Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë*. Luigi Pellegrini Editore. Cosenza2008, f. 203 - 216.

Ballafaqimi në rrafshin teorik ngjet për arsye se në fillim të saj Santori thekson se dashurinë që e vështron në të e ka lexuar, e ka mësuar nga librat:

*Për dirë, për namurí shumë vjershe shkruajta,
Moj ndë këtë zemër namurí së ndieta:
Ndë gjellë sa mbeta ndonjë kopile së rùata,
e vetëm at[ë çë] dhjovasa anë rrefyeta³.*

*(Për epsb, për dashuri shumë vjersha shkrova,
por në këtë zemër dashuri nuk ndjeva:
sa qeshë në jetë një vajzë s'e shikova
vetëm atë që lexova këtu e rrëfej.)*

Në fund të “Kangjelit të valles” (që vjen pas *Vjershi IV*) Santori shkruan se ndihet “i lodhur” dhe se hartimin e veprës do të vazhdonte një ditë tjetër:

*Po u lodha; e zemë papá
Njetër ditë çë të kem gharé⁴.
(Po u lodha; e vijoj përsëri
një ditë tjetër, kur të kem haré.)*

Mendimi se në “Këngëtoreshë arbëreshe⁵” shpreh *dashurinë e lexuar në libra* e jo të përjetuar nga ai, përligj përcaktimin se krijesa letrare artistike nuk është imitim i pandërmjetëm i asaj që përjetohet në jetën e përditshme, po fryt i mendimeve dhe i përsiatjeve që (pastaj) shndërrohen në veprën artistike, në tekst. Me fjalë të tjera, kjo vepër e Santorit është

Të gjithë shembujt nga vepra “Këngëtoreshë arbëreshe” e Santorit janë marrë nga ky burim, pra transkriptimi është i F. Solanos, ndërsa përshtatja në shqipen e sotme është bërë nga autori i studimit.

³ Cituar sipas Francesco Antonio Santori, *Il Canzoniere albanese*, vep. epërm., f. 1.

⁴ Francesco Antonio Santori, *Il Canzoniere albanese*, vep. e përm., f. 11.

⁵ Vëllimin Frano Anton Santori, *Këngëtoreshë arbëreshe*. Poemë. Përshtatur në gjuhën e sotme nga Andrea Varfi. Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1980, nuk e shfrytëzova për arsye se në pjesën më të madhe përshtatja është larguar tepër nga origjinali.

krijesë e mendjes, e përvojës së tij (po ashtu e mësuar dhe nga librat), që, si e tillë, e shprehur përmes mesazheve poetike, bëhet përvojë për njerëzit.

Françesk Anton Santori me qëllim nuk imitoi dukuritë që i shihte në natyrë ose i përjetonte në mjedisin shoqëror arbëresh, por e krijoi veprën në bazë të përfytyrimit, të imagjinatës, koncept krijues letrar që e zbatuan shumë shkrimtarë para dhe pas tij.

Pa qëllim që të ndalem në mënyrë të veçantë rreth kësaj dukurie, për shumçka të rëndësishme, po sjell këtu mendimet e De Radës, të Fishtës e të Mjedës, që përligjin thellësisht rëndësinë e këtij parimi krijues letrar që e përdori Santori.

Në veprën *Parime të estetikës*⁶ De Rada thekson se “Kënaqësia që i japin shpirtit shumë sende, të cilat nuk i vlejnë gjë trupit, i është atribuar formës së bukur⁷” dhe se “Të vërtetat intelekti i nxjerr prej gjithësisë dhe i bart si nocione abstrakte [...] Pra, arti i përsosur mund të cilësohet edhe si një riprodhim inteligjent i vetë Krijimit [...] Kështu, arti, nga njëra anë, është instruktiv dhe, nga ana tjetër, është spastrues dhe shembullor. Pra, për shkak se me anën e fjalës, që është mjeti i saj, poezia zbulon dhe paraqet me qartësi dhe bukuri të madhe kuptimin dhe rendin e sendeve që paraqet, qëndron mbi artet e tjera paraqitëse reprezentative. Fjala shprehet me zë të plotë në gjuhën që bart idenë dhe shfaq arsyetimin e mënyrën vetjake të inteligjencës, si edhe trajtën e të menduarit brenda njeriut. Fjala e harmonizuar mund të pasqyrojë format e shpirtit, përmes veprimeve, bisedave, ashtu edhe fytyrën e madhërishtme të botës, e cila u jep jetë. Fjala ka mundësi, gjithashtu, duke u ndodhur në mes lëvizjes së përhershme të qenieve, të pasqyrojë dhe të shprehë kuptimin e këtyre qenieve, duke nxjerrë në pah shkakun e brendshëm intim⁸”.

⁶ Për konceptin krijues poetik të De Radës shih më gjerësisht në veprën time *Vëshime teorike dhe estetike të De Radës dhe të Fishtës*. Shtëpia botuese “Arbëria 07”, Tiranë 2011.

⁷ Girolamo De Rada, *Principii di estetica*. (estratti delle sue considerazioni su la Vita e i fini di essa). Napoli 1861, f. 10; Shihbotimin e ri Girolamo De Rada, *Opera Omnia. IX. Opera filosofiche e politiche*. Introduzione di Anton Nikë Berisha. Rubbettino, Soneria Mannelli, (Catanzaro) 2007, f. 35. Përkthimin e mora nga Jeronim De Rada, *Parime të estetikës*. Përgatiti për botim prof. Alfred Uçi, Globus R., Tiranë 2003, f. 32 – 33.

⁸ Girolamo De Rada, *Principii di estetica*, vep. e përm., f. 77; Jeronim De Rada, *Parime të estetikës*, vep. e përm., f. 148 – 149.

Duke folur për poezinë si art i fjalës, Fishta vë në dukje se ajo është jehonë e botës së brendshme të individit, shprehur nëpërmjet gjuhës, “t’bukurit *pulcrum* – bukuria⁹”, që e këndell dhe e ndriçon shpirtin: “Poezia, praa, si u paa, (e prandej deshtme ktû me folë pak si gjatë mii burrim t’sajë), âsht jehi i shpirtit t’nierit: pse ajo, n’gurrë t’vet s’âsht tjetër veç se një fshâme qi ep shpirti, kurr kndellet n’shkelxim t’rrezeve t’bukuriës. E tujë kânë se shkelximi i bukurisë i tfaqet nierit mas giênjes s’shpirtit, a se mas zhdrivillimit t’mëndjes e t’shies estetike t’tii: t’gjith nierzt nuk e kuptojnë bukurien si një një¹⁰...”

Edhe Ndre Mjedja, veçonte dy përbërës kryesorë të krijimit letrar poetik: “shembëllimin e bukurisë” dhe “të shprehurit e imagjinatës (përfytyrimit)”:

“Në dy mënyrë poeti mundet me shprehë bukurinë, d.m.th. a tuj përshkrue sendet e bukura të natyrës, a tuj krijue me mend të vet një send përnjimend të bukur”. Pra, “poeti në punë të vet do t’u përngajjë sendeve e jo t’i përshkruejë. Ngjasimi lyp që sendja t’i përngajjë sendes, por jo që të jetë njëjti me të” dhe se “[...] mënyrë fort më e çmueshme asht një hartim e krijim i mendes, ku të shëndrisi drita e një formës së naltë të idealit. Në këtë krijim danë fuqia e mjeshtria e poetëve¹¹”.

Mendimi i Santorit (në fund të “Kangjelit të valles”) se hartimin e mëtejshëm të veprës “Këngëtorja arbëreshe” do ta vazhdonte një ditë tjetër kur të ndjejë nevojën e krijimit: *Njetër ditë çë te kem gharé* lidhet me qëndrimin e tij të përmendur më lart: do ta vazhdojë hartimin e saj kur të ketë menduar më gjatë e kur do ta ndjejë veten të aftë për të krijuar diçka të veçantë e artistike, qoftë përballë asaj që e ka krijuar deri aty, qoftë ndaj asaj që do ta krijojë më vonë.

Me një fjalë, Santori “frymëzimin” nuk e “priti nga jashtë”, por brenda botës së tij; aty e kërkoi dhe e gjeti mënyrën për ndërtimin – shtjellimin e veprës poetike. Kjo strategji të kujton mendimin e Th. S.

⁹ P. Gj. Fishta, O. F. M, *A janë t’zot Shqyptarët me u majtë shtet n’vedi?* Në “Hylli i Dritës”, n. 3, Shkodër 1913, f. 75.

¹⁰ P. Gj. Fishta, O. F. M, *A janë t’zot Shqyptarët me u majtë shtet n’vedi?*, pun. i për., f. 77.

¹¹ Punimi i Ndre Mjedjes *Përmí Poezjé përgjithësishtu* botua (mbas vdekjes së autorit) në “Shkëndija”, Tiranë 1941, n. 8 – 9; u ribotua në vëllimin Ibrahim Rugova – Sabri Hamiti, *Kritika letrare*, “Rilindja”, Prishtinë 1979, f. 117 – 124.

Eliotit: “Poezia nuk është shkrim ndjenjash, po ikje nga ndjenja; nuk është shprehje e personalitetit, po ikje nga personaliteti”. Së këndejmi, “Këngëtorja arbëreshe” është shqiptim i botës së brendshme dhe i kënaqësisë vetjake të Santorit, që, sipas F. Nietzsche (Niçe), “*fjymon në përjetësi*”. Pikërisht, kënaqësia që shprehet përmes tekstit bartet te lexuesi dhe bën ndikimin e vet estetik në kohë të ndryshme. Pra, vepra letrare nëpërmjet strukturës gjuhësore krijon realitetin e veçantë, realitetin e mesazheve poetike që kushtëzojnë komunikimin dhe ndikimin¹². Kur krijesa letrare imiton atë që ngjet në natyrë, kur shpreh drejtpërsëdrejti tablo ose veprime konkrete, nuk e ka vlerën e mirëfilltë dhe si art nuk i përballon kohës.

Ndërliqësia e shqyrtimit – interpretimit të veprës “Këngëtorja arbëreshe” të Santorit përlijet, para së gjithash, nga shtjellimi dhe gërshetimi i formave të tekstit, i shtresave të rrëfimit lirik, i pjesëve dhe i vargjeve të ndryshme metrike.

II. MBËSHTETJE NË DISA TRADITA LETRARE

Santori e dinte mirëfilli se për të përftuar një vepër artistikisht cilësore, që do të çmohet e do të ndikonte estetikisht në lexuesin jo vetëm të kohës së tij, ishte e domosdoshme *aftësia krijuese, njohja e natyrës së artit të fjalës dhe njohja e veprave të veçanta*, qoftë të shkrimtarëve paraardhës, qoftë të atyre bashkëkohës.

Aftësinë krijuese letrare ai e përlijti me veprat që botoi sa qe gjallë: “Il Canzoniere albanese” – *Këngëtorja arbëreshe* (1846 ose 1847), “Il prigioniero politico” – *I burgosuri politik* (1848), “Rozari i Shën Mëris Virgjër të Misvulis” (1849); “Krështeu i shënjtëruor” (1855); dramën “Emira” (tri aktet e para të së cilës u botuan në revistën e De Radës

¹² Për çështjet teorike të artit të fjalës e të komunikimit poetik shih librin tim *Çështje teorike të letërsisë*. “Faik Konica”, Prishtinë 2005. Shih dhe H. Hasani, Sh. Vishaj, *Letërsia si art dhe komunikim poetik*. Bisedë me Anton Nikë Berishën. “Faik Konica”, Prishtinë 2011, sidomos pjesët “Përimtime teorike” (f. 11 – 56) dhe “Qenësia e artit krijues dhe e formave krijuese” (f. 57 – 116).

“Fjamuri i Arbrit¹³”), po dhe me veprat që i la në dorëshkrim, disa prej të cilave u botuan shumë kohë pas vdekjes së tij¹⁴.

Njohjen e letërsisë Santori e dëshmoi me vlerësimin që bëri për shkrimtarë të shquar e për vepra të tyre si, fjala vjen, të Virgjilit, Tassos, Aligerit, Ariostos, Petrarkës, Alfierit, të cilat dëshmojnë një rrafsh të lartë shtjellues dhe artistik, po dhe të *Biblës*¹⁵. Kjo gjë kushtëzoi që ai krijoi një shije të ngritur për artin e fjalës dhe, si rrjedhojë e kësaj, dhe përftoi disa nga veprat më të rëndësishme të letërsisë shqipe në fushën e tragjedisë, të dramës, të prozës, të satirës, të novelës (në vargje) dhe të kalimereve (këngëve fetare).

¹³ Francesco Antonio Santori, *Emira*. Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura del prof. Francesco Solano. Grottaferrata 1984.

¹⁴ Nga dorëshkrimet e veprave letrare të Santorit deri më tash u botuan: Frangjisk Andon Santori, *Brisandi, Lletixja e Ulladbeni*. A cura di Italo Costante Fortino. Cosenza 1977; Francesco Antonio Santori, *Panaini e Dellja - Fëmijapushhtjerote*. A cura di Giuseppe Gradilone, Roma 1979; Francesco Antonio Santori, *Alessio Ducagino*. Melodrama. Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura di Francesco Solano, Quaderni di “Zjarri”, Castrovillari 1983; Francesco Antonio Santori, *Emira*. Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura di prof. Francesco Solano, Grottaferrata 1984; Francesco Antonio Santori, *Tre novelle*. A cura di Italo Costante Fortino, Carmine Stamille, Ernesto Tocci, Cosenza 1985; Françesk A. Santori, *Satira*. Translitteruar e pajisur me shënime nga Karmell Kandreva dhe Gjovalin Shkurtaç, Tiranë 1998.

Rreth veprave të këtij shkrimtari shih sidomos punimet: Francesco Solano, *Francesco Antonio Santori e il teatro albanese*. Në “Zëri i Arbëreshëve”, Anno VI, 1977, p. 7 - 27; Klara Kodra, *Të dbëna të reja mbi krijimtarinë e F. A. Santorit*. Në “Studime për letërsinë shqiptare I. Probleme të letërsisë shqiptare të Rilindjes kombëtare”. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Tiranë 1981, f. 301 – 342; Italo Costante Fortino, *Una tragedia inedita di Francesco Antonio Santori. La Neomenia*. Në “Gli Albanesi d’Italia e la Rilindja Albanese”. Atti del XIV Congresso Internazionale di Studi Albanesi. A cura di Antonino Guzzetta. Palermo, 25 – 28 Novembre 1988, f. 183 – 196; Francesco Solano, *Nota introduttiva*. Në Francesco Antoni Santori, “Il Canzoniere Albanese”, vep. epërmendur, f. 25 – 30; Giuseppe Gradilone, *Francesco Antonio Santori, un romantico fra tradizione e realismo*. Në G. Gradilone, “Altri studi di letteratura albanese”. Roma 1974, f. 7 – 77.

Për ndihmesën e Santorit në fushën e gjuhësisë shih librin: Francesco Altimari, *Un saggio inedito di F. A. Santori sulla lingua albanese e i suoi alfabeti*. Quaderni di Zjarri n° 7, Cosenza 1982.

¹⁵ Pjesë të *Biblës* si, fjala vjen, *Psalmet* dhe *Kënga e këngëve* dëshmojnë për një rrafsh të lartë shprehës artistik. Shih për këtë Gianfranco Ravasi, *I Salmi*. Introduzione, testo e commento. Seconda edizione. Edizioni San Paolo. Cinisello Balsamo (Milano) 2007; *I Salmi*. Nuova versione, introduzione e commento di Tiziano Lorenzin. Figlie di San Paolo, Milano 2001; Gianfranco Ravasi, *Cantico dei cantici...come sigillo sul cuore*. Edizione San Paolo, Cinisello Balsamo (Milano) 2011.

Në shkrimin italisht *Lettore benigno* - Lexuesit të nderuar, që i prin tragjedisë së tij “Neomenia” (që mbeti në dorëshkrim për rreth një shekull e gjysmë¹⁶), Santori jep të kuptojë se e njihnte mirëfilli letërsinë. Në të ai vë në dukje se me “Neomeninë” s’kishte për qëllim të matej me krijuesit e mëdhenj botërorë, ku vlera poetike e veprave të tyre u dëshmuua nëpër shekuj, por të dëshmonte aftësinë e gjuhës arbëreshe – shqipe, e cila merrej si “e pavlerë dhe e dorës së dytë¹⁷”.

Pasi vë në dukje se një varg shkrimtarësh botërorë e pasuruan përvojën letrare në forma të ndryshme, siç ndodhi dhe në artet e tjera, në muzikë, në pikturë, në skulpturë, po dhe në shkencat ekzakto, të cilat e zgjeruan shtegun e dijeve të njeriut e të njohjes së botës, Santori thekson se tragjedinë “Neomenia” e hartoi në bazë të përfytyrimit – të imagjinatës, pra e tëra ishte fryt i mendjes, i fantazisë së tij – *qual è per altro tutta di fantasia*¹⁸, parim që e zbatoi dhe në hartimin e veprës “Këngëtorja arbëreshe”.

Arsyeja e veprimit të këtillë kuptohet vetvetiu: imagjinata nuk i nënshtrohet parimit të kufizimit e të shqiptimit të veprimit konkret jetësor dhe jep mundësi të mëdha krijuese, përligj lirinë e paskajshme në krijimin e veprës letrare artistike, përkatësisht përfitim e një realiteti sa të veçantë aq të pasur dhe të papërsëritshëm poetik. Shkrimtari i shquar italian, Françesko Grizi (Francesco Grisi), theksonte se fantazia *është mister, një lojë e kujtesës dhe ungjill i shpirtit*¹⁹, ndërsa David Maria Turollo e shpreh këtë përmes botës magjike të përrallës: “Çka është më e vërtetë se përralla? Çka mund të thuash të thellë dhe të përjetshme pa e kujtuar përrallën? Përralla është shprehja e parë e mendimit²⁰”.

Se Santori e njihnte mirë artin e fjalës dëshmon mjeshtëria e konceptimit dhe e shtjellimit poetik të “Këngëtores arbëreshe”, po dhe e

¹⁶ Françesk Anton Santori, *Neomenia*, vep. e përm., f. 28.

¹⁷ F. A. Santori, *Lettore benigno*. Në Françesk Anton Santori, “Neomenia”, vep. e përm., f. 28.

¹⁸ F. A. Santori, *Lettore benigno*. Në Françesk Anton Santori, “Neomenia”, vep. e përm., f. 26 – 29.

¹⁹ Francesco Grisi, *A futura memoria*. Newton Compton Editori, Roma 1986, f. 7.

²⁰ David Maria Turollo. *Il Dramma è Dio. Il divino, la fede, la poesia. I classici dello spirito*. Fabbri Editori. Milano 1997, f. 143.

veprave të tjera të tij, disa prej të cilave, siç u tha, vunë gurët e themelit në disa lloje letrare që u krijuaran në gjuhën tonë.

Për hartimin e “Këngëtores arbëreshe” Santori pati parasysh tradita të ndryshme letrare dhe një varg veprash të shkrimtarëve të shquar, arbëreshë e të huaj, por duhen veçuar katër burime kryesore: 1) Poezinë gojore arbëreshe, 2) “Këngët e Milosaut” (1836) të De Radës, 3) “Canzoniere” (Këngëtoren) të Françesko Petrarkës 4) “Këngën e këngëve” të Besëlidhjes së Vjetër.

1) Përkimet e “Këngëtores arbëreshe” me poezinë gojore arbëreshe janë të ndryshme e të shumta²¹. Santori lindi dhe jetoi në mjedisin arbëresh, ku poezia gojore cilësohej me vlera të ngritura shprehëse poetike dhe si e tillë bëri ndikim të thuash tek të gjithë shkrimtarët arbëreshë²², pa marrë parasysh kohën kur përfatuan. Ai u mbështet në traditën letrare gojore arbëreshe për arsye se, siç thuhet me të drejtë, e djeshmja është burimi i së sotmes, siç do të jetë e sotmja bazë për të nesërmen.

Santori mbledhi vetë një varg poezish gojore arbëreshe, të njohura me emrin *rapsodi*, disa prej të cilave u botuan në vëllimin *Rapsodie d'un poema albanese*²³ (Rapsodi të një poeme arbëreshe) të përgatitur nga De Rada e të botuar (bashkë me Nikollë Jenò de Koronej) më 1866 në Firenze, ndërsa

²¹ Dukurinë e përkimeve të “Këngëtores arbëreshe” me poezinë gojore arbëreshe, përkatësisht me Rapsoditë e ka vërejtur dhe Françesko Solano në *Nota introduttiva*. Në Francesco Antonio Santori, “Il Canzoniere albanese”, vep. e përm., f. 26 – 27.

²² Për përkimet poetike të disa veprave të shkrimtarëve arbëreshë me poezinë gojore arbëreshe shih pjesën “Përkime poetike” të librit tim *Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë*, vep. e përm., f. 449 – 487.

²³ *Rapsodie d'un poema albanese*. Raccolte nelle colonie del Napoletano. Tradotte da Girolamo De Rada e per cura di lui i di Noccolò Jenò de' Coronei. Tip. Di Federigo Bencini, Firenze, 1866, f. 54 – 60.

Rreth kësaj përmbledhje shih studimet e mia *Mbi rapsoditë e De Radës botuar më 1866*. Në “Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë”, vep. e përm., f. 52 – 83; *Delle Rapsodie albanesi del 1866*. Studio. Traduzione a cura di Vincenzo Belmonte. Luigi Pellegrini Editore. Cosenza, 2011.

një pjesë e Rapsodive mbledhur nga ai e të mbetura në dorëshkrim, u botuan më 1998²⁴, shumica prej të cilave kanë si temë dashurinë²⁵.

“Këngëtorja arbëreshe” afrohet sidomos me rapsoditë e llojit “Lart te çuka e një rrahi” (“Trimi zuri e ma puthi²⁶”), “Zgjomu, vashë, nisu të vemi”, “Mori ti, bukureza ime”, “Vasha, márr ti grollazit”, “Trimi bíri Fughies”, po dhe me këngët e dasmës, në të cilat shprehen aspekte të ndryshme të dashurisë dhe të riteve përkatëse që e përcjellin martesën. Në të vërtetë, në fillim të veprës së vet, “Këngëtorja arbëreshe”, si moto Santori vuri dyvargëshin “*Sa hjé të ka ajo kezë! / Rinë, Rinë! Ku vajte sot?*”, që mund të merret si hyrje në objektin poetik: dashurinë.

Afritë e kësaj vepre të Santorit me rapsoditë arbëreshe vërehen sidomos në shtjellimin dhe në sistemin shprehës poetik, si ndodh, fjala vjen, me katër këntëkët (këngët), pastaj në “Kangjel i valles” dhe “Të përjekurit”, por dhe me pjesët e tjera të “Këngëtores arbëreshe”.

Për të dëshmuar këtë dukuri do të mund të sillen shumë shembuj²⁷, duke i krahasuar me rapsoditë e “Dorëshkrimit të Kieutit” të vitit 1735 - 1750²⁸, të përmbledhjes “Rapsodie d’un poema albanese” (1866), po dhe me tekstet e tjera të rapsodive të mbledhura nga Santori e të botuara më

²⁴ Shih 18 rapsoditë e F. A. Santorit të botuara në vëllimin: Anton N. Berisha, *Antologji e poezisë gojore arbëreshe. Antologia della poesia orale arbëreshe*. Transkriptimin F. Altimari. Përkthimin V. Belmonte. Rubbettino, Soveria Mannelli, Catanzaro 1998 si dhe punimin tim *Mbi dorëshkrimin e Rapsodive të Françeskë A. Santorit*. Në “Quaderni del Dipartimento di Linguistica”, i përmendur, f. 15 – 21, ribotuar me disa ndryshime në “Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë”, vep. e përm., f. 84 – 90.

²⁵ Rapsoditë arbëreshe të mbledhura nga Santori që trajtojnë temën e dashurisë të botuara në *Antologji e poezisë gojore arbëreshe. Antologia della poesia orale arbëreshe*, vep. e përm., janë n. 13, 22, 27, 33, 39, 43, 45, 51, 60, 73, 76.

²⁶ Shih punimin tim për këtë krijim poetik *Situata metaforike e puthjes*. Në “Bota e re”, nr. 10 - 11, 25 maj, 1983, f. 25.

²⁷ Ndonjë varg si, fjala vjen, ai i “Kengjelit të valles”: *Zoti dha një sberëtimë* të kujton vargun nga rapsodia “Kostantini i Vogëlith” *keush më sberëtoi sonde; sberëtova unë i mjeri*.

²⁸ Dorëshkrimi u botua pjesërisht më 1908 nga Michele Marchianò, *Canti popolari delle colonie d’Italia*. Foggia, 1908, ndërsa i plotëmë 1995, Nicolò Figlia, *Il codice Chientino*. A cura di Matteo Mandalà, Istituto di Lingua e Letteratura Albanese della Facoltà di Lettere e Filosofia di Palermo, Comune di Mozzoiuso, 1995.

vonë²⁹ ose edhe me ato që aty–këtu ende jetojnë gojarisht në mjedisin arbëresh.

2) Për hartimin e “Këngëtores arbëreshe” Santori u mbështet edhe tek vepra e Jeronim De Radës, “Këngët e Milosaut” (1836)³⁰, padyshim njëra nga kryeveprat e letërsisë shqipe në përgjithësi. Në të poeti i Maqit bëri objekt trajtimi artistik dashurinë – ndjenjën më intime e më individuale, nëpërmjet së cilës shpalosi e shqiptoi përbërës të botës së vet shpirtërore e mendore, të botës e të realitetit jetësor e shpirtëror arbëresh, po njëkohësisht të jetës në përgjithësi, të njeriut dhe të fatit të tij. Pra, dashuria në këtë vepër nuk trajtohet si qenësi dhe si qëllim më vete e për vete; si kënaqësi individuale ose ngushëllim e lehtësim i çastit, po është amëza që ndërthur një varg kuptimesh të gjallimit, nga një anë gëzimet që ofron jeta e, nga ana tjetër, vuajtjen, pësimin, vdekjen dhe jetën e amshuar. Pra, siç do të thoshte psikiatri amerikan, Anthony Stern, *dashuria është zotim (veprim)*³¹.

Se Santori mësoi shumë nga vepra e bashkatdhetarit të tij, De Radës, po përmend këtu vargun “*Faqe moti kish ndërruar*” i përdorur në “Kangjelin e valles” që është krijuar sipas vargut të parë të kangjellit të parë të “Këngëve të Milosaut”, *Lis jeta kishë ndërruar*. Edhe 13 pjesët e veprës së Santorit, të emërtuara me “Vjershë”, që bëjnë pjesën qenësore poetike të “Këngëtores arbëreshe”, janë ndërtuar sipas modelit të “Vjershë” i të Biljës së Kolloghres” të “Këngëve të Milosaut”, që janë ndër pjesët më poetike të kësaj vepre të De Radës³².

²⁹ Në vëllimin *Antologji e poezisë gojore arbëreshe. Antologia della poesia orale arbëreshe*, vep. e përmendur, janë përfshirë 108 rapsodi arbëreshe të zgjedhura.

³⁰ Edhe këtë fakt e përmend F. Solano në *Nota introduttiva*. Në Francesco Antonio Santori, *Il Canzoniere albanese*, vep. e përm., f. 28.

³¹ *Le preghiere di Madre Teresa. Meditazioni e pensieri di una Santa*. A cura di Anthony Stern. Traduzione di Maria Moretti. Armenia, Milano, 2012, f. VI.

³² Shih Jeronim De Rada, *Poezi shqipe e shekullit XV. Këngët e Milosaut*. Bir i sundimitarit të Shkodrës. Transkriptimin Françesko Altimari. Parathënien Anton Nikë Berisha. “Shpresa”, Prishtinë 2001.

Pjesët “Vjershë” i të Biljës Kolloghres” në veprën e De Radës përdoret tri herë: pas Kangjellit IV, pas Kangjellit XII dhe pas Kangjellit XVII.

Nga vepra e De Radës “Këngët e Milosaut” Santori mësoi dhe për ndërtimin e veprës letrare ku nuk është e domosdoshme përfillja e vijimësisë së ngjarjes, po qenësia e të shprehurit gjuhësor dhe imazhet poetike, përkatësisht shtjellimi i veprës si mozaik poetik³³.

3) Burim të rëndësishëm për hartimin e “Këngëtores arbëreshe” Santori pati dhe veprën e Françesko Petrarkës “*Rerum vulgarium fragmenta*” & *Fragmente të shkruara në gjuhën popullore* e njohur si “Canzoniere” (Këngëtorja), nga e cila shfrytëzoi titullin, tematikën e dashurisë dhe pjesërisht çështje të shtjellitimit³⁴. Këtë ndikim vepra e Petrarkës e bëri dhe në shumë breza poetësh botërorë, duke u bërë kështu “përmbledhja lirike më e imituar në gjuhën italiane³⁵”.

“Këngëtorja” e Petrarkës nuk është poemë tërësore, por një përmbledhje e lirikave të dashurisë, ku këndohen dhe për çështje të moralit e të fesë³⁶. Edhe pse në të, siç thekson Alberto Chiari (Kiari), ngjarja nuk zhvillohet sipas një vijimësie të mirëfilltë e të qartë³⁷, nga struktura e soneteve dhe e poezive formash të tjera – të gjitha të krijuara me vargje metrike, rrezaton një shumësi mendimesh, ku ndërliqhen dashuria trupore, shpirtërore dhe hyjnore. E Dashura e Poetit, Laura, është vajzë që ka shkaktuar shqetësim dhe tronditje në shpirtin e tij:

*Ju që dëgjoni vargjeshe zërin tim,
Ato psherëtimë q’ushqyen zemrën time*³⁸(I)



*E imja shpresë e tretur po lëngonte
Si një qiri që dridhet, flakërin,*

³³ Për veprën “Këngët e Milosaut” të De Radës shih punimin tim: *Mbi strukturimin modern poetik dhe mbi shtresat kuptimore të “Këngëve të Milosaut”*. Në “Albanica”, nr. 9, Palermo 1995, f. 29 – 43, ribotuar në A. N. Berisha, *Mbi letërsinë e arbëresheve të Italisë. Pjesa e parë. Mësonjëtorja e parë*. Tiranë 2000, f. 71 – 105.

³⁴ Shih F. Solano, *Nota introduttiva*. Në Francesco Antonio Santori, “Il Canzoniere albanese”, vep. epërm., f. 28.

³⁵ Alberto Chiari, *Introduzione*. Në Francesco Petrarca, “Canzoniere”. Introduzione e note di Alberto Chiari, Milano 2008, f. 7.

³⁶ Alberto Chiari, *Introduzione*. Në Francesco Petrarca, “Canzoniere”, vep. epërm., f. 8.

³⁷ Alberto Chiari, *Introduzione*. Në Francesco Petrarca, “Canzoniere”, vep. epërm., f. 22.

³⁸ Përkthimet nga vepra e Petrarkës “Këngëtorja”, me një përjashtim, janë të Dhori Qiriazi.

Si ëndërr e fikur që sillte veç trishtim. (XXXIII)

Shkak i gjithë asaj që ndodh në veprën e Petrarkës është bukuria e jashtëzakonshme e Laurës; janë sytë e saj sa vrastarë, aq dhe të ëmbël që ë bëjnë natën ditë e ditën errësirë dhe nga helmi e thithin ëmbëlsirën:

*O sy të bukur që vrisni dhe pastaj
S'e mbyllni plagën, e lini të kullojë,
S'ka mirësi, as bar që ta shërojë,
As det me valë të thotë: po u ndaj! (LXXV)*



*E syt' e saj të bëjnë vetë çudinë:
Ta bëjnë drit' natën e ditën errësirë
Dhe në farmak të thithësh ëmbëlsirë. (CCXV)*

Duke kënduar dashurinë, Poeti e grish Laurën t'i përgjigjet dashurisë së tij në të njëjtën mënyrë (siç ndodh, fjala vjen, në *Këntëk II* të “Këngëtores arbëreshe”: *Po me gjithë se [më] jep ti mua / Këto vllëpe, s'u harrua / Nga ti shpirti e të luton*), po ka pak shpresë se kjo do të ndodhë.

Një pjesë e madhe e soneteve dhe e lirikave të “Këngëtores” së Petrarkës shqiptojnë zërin dëshpërues për vdekjen e Laurës. Mirëpo, siç theksojnë njohësit e kësaj vepre, shenja e përhershme e qartë e kësaj krijese poetike të Petrarkës, është edhe *dashuria për poezinë*, që i mundëson Petrarkës të tejkalojë realitetin konkret³⁹.

4) Një burimi tjetër, mbase më i rëndësishmi, ku u mbështet Santori për hartimin e “Këngëtores arbëreshe”, është “Kënga e këngëve” e Besëlidhjes së Vjetër. Kjo krijesë poetike është nga më të veçantat e më të ndërliqshmet që njih arti letrar i mbarë njerëzimit. Vështirë është të gjendet edhe një vepër tjetër poetike që ka zgjuar qasje e interpretime kaq të shumta e të ndryshme sesa “Kënga e Këngës”, qoftë për ta përligjur përfshirjen e saj në Shkrimin e Shenjtë, Biblën, pra si vepër e përrshpirtshme, qoftë si kryevepër e artit të fjalës.

³⁹ Alberto Chiari, *Introduzione*. Në Francesco Petrarca, “Canzoniere”, vep. e perm., f. 24.

Njohësi dhe studiuesi i shquar i saj, A. Chouraqui, vë në dukje se “Vepra (Kënga e këngëve – v. ime) nuk duhet të futet në rrafshin e një rrëfimi, të një drame, as të një krijese letrare apo poetike të zakonshme. Ajo, para së gjithash, është e ndryshme ndaj ndryshimeve të së qenmes (ekzistencës), aq më tepër ndaj përparimeve të saj; frymton një shndërrim (metamorfozë) kaq absolut të dashurisë që mund të vendoset në fillesën (pragun) e një shëlbimi, të një shpëtimi. Për këtë (arsye) ajo shtron një domosdoshmëri: t’i mbesë krejtësisht besnike absolute të dashurisë dhe, në këtë kontemplim marrëzor, të shkohet deri në fund në një marrëzi që përmbushet në shekull⁴⁰”.

Në të vërtetë, “Kënga e këngëve” i “kushtohet gëzimit të vijueshëm të jetës⁴¹” dhe është ballafaqim shpirtëror e mendor i të dashuruarve, dëshmi e dashurisë së çiltër e të pastër për njëri - tjetrin, ashtu si thuhet në Ungjillin e Gjonit: “S’ka dashuri më të madhe sesa të japësh jetën për personin që e do”.

Mënyrat e ndryshme të shqiptimit të dashurisë në “Këngën e këngëve”, po dhe në “Këngëtoren arbëreshe”, dëshmojnë se “Dashuria nuk është krejtësisht një fenomen ‘privat’, një histori e thjeshtë e dy ‘zemrave’ që dashurohen, po ngërthen në vete një ‘parim të ndërlidhjes’ së çmueshme për kolektivitetin” (A. M. Kollontaj) dhe se “Çdo akt i dashurisë, i përkujdesjes, i përdëllimit është një ringjallje” (Erich Fromm).

Monologët e të dashuruarve në “Këngën e këngëve” ballafaqohen e përplotësohen midis tyre⁴², siç ndodh dhe në “Këngëtoren arbëreshe” midis Vashës dhe Trimit, veçmas në “Këntëkët” (këngët) dhe në “Të përpjekurit”. Në “Këngën e këngëve” e Dashura dhe i Dashuri janë të njësuar: *Unë jam i të Dashurit tim / i Dashuri im është i imi...* (KK 6, 3). Vasha e dashuruar me bukuri të jashtëzakonshme është sa konkrete aq dhe hyjnore:

⁴⁰ Chouraqui A., *Il Cantico dei cantici e introduzione ai Salmi*. Città Nuova, Roma 1980, f. 24.

⁴¹ Cituar sipas Gianfranco Ravasi, *Cantico dei cantici...come sigillo sul cuore*, Gianfranco Ravasi, *Cantico dei cantici...come sigillo sul cuore*. Edizione San Paolo, Cinisello Balsamo (Milano) 2011, f. 22. Shih dhe *Cantico dei Cantici*. Nuova versione, introduzione e commento di Gianni Barbiero. Figlie di San Paolo. Milano 2004, f.7 – 8.

⁴² D. Colombo, *Cantico dei cantici*. Në “La Bibbia”. Novissima versione dai testi originali. Quindicesima edizione, vep. e përm., f. 995.

*E panë vashat dhe i thanë e lumtur,
mbretëreshat dhe shemrat e mbuluan me lavde:
Cila është ajo që shfaqet si agimi
e bukur si hëna, e shndritshme si dielli
e mahnitshme si ushtri flamujsh shpalosur⁴³.
(KK 6, 9-10)*

Pra, Santori u mbështet në “Këngën e këngëve”, qoftë për tematikën e dashurisë, qoftë për llojshmëri të imazheve poetike kushtuar dashurisë dhe martesës. Vajza e bukur në veprën e Santorit dhe vajza e bukur e “Këngës së këngëve” afrohen për disa tipare, që vërehen edhe nga një lexim i zakonshëm i teksteve të tyre. Arbëreshja ka bukurinë e yjeve, dritën e Hënës dhe ngrohtësinë e Diellit, me çka përlligjet koncepti i përjetësismit poetik të së Bukurës si ideal jetësor:

*O! via, prir ballin e bardhë
Çë shëron zemrat sëmurë.
Leshtë e arëm, çë si grurë
[i] marr nga era dridbet, ardhë
Nëng u pá nga rrasu dhé,
Ndo si jotja jetër hjé
O ndë gjëllë çë shkoi vo qe. (Odhí e I)
(O! Ma trego ballin e bardhë
që i shëron zemrat e sëmura.
Flokët e arta sikur grurin
që e tund era asnjë grua
nuk i ka mbi dhé si ti,
as s’ë patën birin tënd
dhe në kobët e kaluara.)
✧
Ftyrë-dritëm e gavnare*

⁴³ Përkthimet nga “Kënga e këngëve” janë të autorit të punimit, bërë sipas *La sacra Bibbia*. Conferenza Episcopale Italiana. Unione Editori e Librai Cattolici Italiani, 2008 dhe nga *La Bibbia*. Nuovissima versione dai testi originali. Quindicesima edizione, vepra e përmendur, 2002.

Si e ré monosare. (Këntek e II)

(Fytyrë ndritur dhe e hareshme

si një manushaqe e re.)



Bállët [t]ënd ylet gëzón,

Fton hënën të të shóbë,

Dielli vjen më ndën të njóbë

Bukurinë çë të larton. (Odhí e I)

(Balli yt yjet i gëzón

e grish hënën që ta shobë

dielli zëbret që ta njobë

bukurinë që të lartëson.)

Meqenëse Françesk Anton Santori vite me radhë studioi teologjinë dhe pjesën më të madhe të jetës shërbeu si prift në katundet arbëreshe, duke ia kushtuar jetën dashurisë së Hyjit dhe bartjes së kësaj dashurie tek besimtarët, mund të thuhet pa mëdyshje se për hartimin e veprës “Këngëtorja arbëreshe” u mbështet në “Këngën e këngëve” dhe se prej saj e “mësoi dashurinë nga librat” më shumë se nga çdo vepër tjetër.

Në qoftë se “Këngëtorja arbëreshe” vështrohet në bazë të mendimit të studiuesit japonez, Yukio Mishina: *Thelbi i kulturës është forma, që, në mënyrë metaforike, mund të përshkruhet si një kristal nëpërmjet të cilit mund të shohim shpirtin e një kombi*, atëherë themi se kjo vepër e Santorit është kristal nëpërmjet të cilit shohim shpirtin e autorit dhe të njeriut në përgjithësi, siç e shohim edhe shpirtin e shkrimtarëve të tjerë në veprat që i krijuan.

III. DASHURIA SI NDJENJË DHE DASHURIA SI JETË

Në “Këngëtoren arbëreshe” të Santorit dashuria vështrohet në një rrafsh sa të gjerë aq dhe të thellë: brenda saj bashkëjetojnë përbërës e kuptime të shumta; ajo shprehet si ballafaqim me veten e me të tjerët, me vështirësitë, me frikën e me dhembjen; ndërlidhet sidomos me marrëdhëniet midis dy qenieve njerëzore, siç thekson dhe filozofi dhe teologu i shquar grek, Christos Yannaras: “Tjetri bëhet ‘kuptimësia’,

përgjigjja e ndjeshme e dëshirës më të thellë e jetike të natyrës sonë. Ndoshta nuk jemi dashuruar në personin e Tjetrit, po në etjen tonë të mishëruar në personin e tij⁴⁴”. Pra, dashuria barazohet me vetë jetën: “Tjetri përbën mundësinë e vetme për arsye se marrëdhënia jonë me botën është e ndërsjellë. Tjetri është fytyra e botës, logosi i secilës qenësi objektive. Logosi që më drejtohet mua dhe më fton në universalen e bashkë-ekzistimit⁴⁵”.

Në qoftë se “njeriu, si njeri, përmes kulturës, bëhet përherë më shumë njeri⁴⁶”, atëherë një himn i dashurisë, një tufë vjershash ndërtuar me vargje formash të ndryshme, siç është “Këngëtorja arbëreshe”, e nxitin dashurinë mes njerëzve, që nënkupton dashurinë ndaj Hyjit dhe lumturinë. Santori ishte i vetëdijshëm se dashuria dhe martesja (si konkretizim dhe simbol i dashurisë), që e mbeti një nga dukuritë më të rëndësishme të ekzistimit të njeriut. Së këndejmi, ai e hartoi “Këngëtorja arbëreshe” për të përligjur parimin, siç do ta përkufizonte papa Gjon Pali II: “Dashuria nuk është diçka që mësohet, e megjithatë nuk ka gjë më të rëndësishme për të mësuar⁴⁷”.

Pikërisht qenësia e dashurisë, brenda së cilës nënkuptohet edhe martesja (që në vepër shprehet dhe përmes simbolikës së kezës, shenjës e nuses), kushtëzoi që Santorit të bënte atë objekt trajtimi poetik, siç u bë objekt trajtimi duke filluar nga krijimet letrare më të lashtat kur njeriu këndoi ose rrëfeu për dukuri të realitetit, të gjallimit, të veprimit jetësor ose për dukuri të botës së brendshme, të ndjesive e të mëdyshjeve.

Në veprën e Santorit dashuria shprehet si pasuri shpirtërore, si dramë, si tundim ose siç thotë Petrarca “*djeg me zjarr, me ç’ëmbëlsi na deb?*”. Pra, nëpërmjet dashurisë përligjet kënaqësia, bukuria dhe adhurimi për veten e për tjetrin, për jetën, për natyrën e për Hyjin, po dhe vuajtjet e pësimet, pikërisht ashtu siç thuhet në *Këntëk e I* të “Këngëtores arbëreshe”.

Një qanë e një këndon,

⁴⁴ ChristosYannaras, *Variazioni sul Cantico dei Cantici*, vep. epërm., f. 8.

⁴⁵ ChristosYannaras, *Variazioni sul Cantico dei Cantici*, vep. epërm., f. 9.

⁴⁶ Giovanni Paolo II, *Pensieri sparsi*. Coraggiosi nella verità generosi nell’amore. A cura di don Giovanni Battista Zilio. Neri Pozza Editore. Vicenza1998, f. 61.

⁴⁷ Gjon Pali II me Vittorio Messorin, *Të kapërçebët pragu i shpërsës*. Gjonlekaj Publishing Company, New York1998, f. 140.

*Kush qeshën e kush këcën
Një e lutën e një harën’
E ká e nëng e përdò.
(Njëri qan e tjetri këndon,
ndokush qesh e ndokush vallëzën
e dikush kërkon harenë
ai qe e ka s’e përjeton.)*

Santori e vështroi dashurinë nga fakti se ajo është *më e fortë se vdekja*; asgjë nuk shpreh më thellë dhe nuk lidhet më shumë me shpirtin e njeriut sesa ajo: “*Veç dashurisë asgjë s’të hyn në sy!*” (Petrarka, CCV); ajo “nuk e njeh turpin⁴⁸” (sipas Isakut nga Niniva); në këtë krijesë letrare arbëreshe ajo shprehet në mënyrë konkrete, simbolike e përfytyruese: “simboli shpreh maksimumin e realitetit: vë drejtpeshimin midis së dukshmes e të padukshmes, fizikës dhe shpirtërores, të mbarimit e të pambarimit⁴⁹”. Pra, në “Këngëtoren arbëreshe” Santori këndoi për dashurinë fizike, shpirtërore dhe hyjnore, që janë të njësuara me njëra – tjetrën, siç thekson papa Benedikti XVI: “Dashuria për Zotin dhe dashuria për të afërmin janë të pandashme, janë urdhërim i përnjëjtësuar. Të dyja, pra, jetojnë nga dashuria e ardhur nga Zoti⁵⁰...”.

Në “Këngëtorja arbëreshe” dashuria konkrete dhe dashuria shpirtërore janë më të dukshme, ajo hyjnore ka mbetur në rrafshin e thellë, siç ngjet dhe në “Këngën e këngëve”, që në vështrim të parë, fitohet përshtypja se flitet vetëm për dashuri njerëzore, pra, pa një ‘referim të qartë’ për Hyjin⁵¹. Mirëpo, duhet thënë se dashuria hyjnore është e pranishme në “Këngëtoren arbëreshe”. Për këtë dëshmojnë fjalët si *parajsa, urata* (urata, lutja a nuk është këngë e dashurisë drejtuar Hyjit?), *bekimi, drita, qielli, yjet, Enjëllina, Todbri* etj., pastaj vargjet *I lumë e i diellit*

⁴⁸ Cituar sipas Christos Yannaras, *Variationi sul Cantico dei Cantici*, vep. e përm., f.87.

⁴⁹ David Maria Turollo. *Il Dramma è Dio*, vep. epërm., f. 111.

⁵⁰ Benedetto XVI, *Deus caritas est. Lettera enciclica*. Libreria Editrice Vaticana. V Ristampa 2006, f. 42.

⁵¹ *La sacra Bibbia*. Conferenza Episcopale Italiana, vep. epërm., f. 989. Shih dhe *Cantico dei Cantici*. Nuova versione, introduzione e commento di Gianni Barbiero. Figlie di San Paolo. Milano 2004, f. 7.

rrëm'i; Bállët [t]ënd ylet gëzon, / Fton hënën të të shóbë, Dielli vjen më ndën të njóbë (Odhí e I); Ashtu, ti vashë, harénë mbi të tjera zëjon; Kur ti këndon mbi të qetë vëbet pubia / e trolli e drizë e bari rri të ndienj (Vjershi III) etj.

Natyrisht, dashuria konkrete është baza e çdo dashurie; ajo dëshmohet me dashurinë ndaj njëri-tjetrit, qoftë mes mashkullit e femrës, qoftë mes njerëzve në përgjithësi; ndërlidhet me dashurinë shpirtërore, e cila, po ashtu, e ka burimin në dashurinë hyjnore, siç thuhet në Letrën e parë të Gjonit: *Nëse e duam njëri-tjetrin, Hyji mbetet në ne dhe dashuria e tij në ne është e përkryer. Me këtë gjë e dimë se mbetemi në Të edhe Ai në ne: na e ka dhuruar Shpirtin e vet (...) Hyji është dashuri, dhe, kush mbetet në dashuri, mbetet në Hyjin dhe Hyji mbetet në të⁵². (1 Gjo, 4, 12 – 16). Ky përcaktim i qenësishëm përligjet dhe kur Krishti i drejtohet Hyjit, Atit të vet: lavdinë dhe dashurinë që ia kishte dhënë Ai, ua kishte dhuruar njerëzve që të jenë të bashkuar e ta duan njëri-tjetrin, të ndjehen si një krijesë e vetme:*

“Edhe unë ua dhashë lavdinë që ti ma dhe që të jenë një sikurse ne jemi një - unë në ta e ti në mua, që të jetë plotësisht një, që bota të dijë se ti më dërgove dhe si i deshe ata siç më deshe mua. (Gjn 17, 22 – 23)

Pra, dashuria (si përbërëse e rëndësishme) vihet në themel të jetesës, siç del në këto vargje: *“Ti je imja gjellë” – ti je jeta ime (Vjershi XII). Pa të (pa dashurinë) as jeta tokësore, as Mbretëria hyjnore nuk do të kishin kuptim e vlerë pse e tërë jeta e njeriut është, siç pati thënë papa Gjon Pali II, një “bashkekzistencë” e përditshme ”ti” dhe “unë” dhe se vetë Zoti është burimi i parë i kësaj dashurie⁵³.*

Me një fjalë, dashuria përmbush idealin jetësor, shtimin, shijimin e jetës dhe përjetimin e lumturisë, siç thuhet në Letrën e parë të Shën Palit drejtuar Korintianëve (1 Kor 13, 1–3):

Po t'i flisja gjuhët e njerëzve e të engjëjve, por po të mos kisha dashurinë, do të isha porsí bronzi që kumbon e porsí cimbalí që tingëllon. Po ta kisha dhuratën e profecisë e t'i dija të gjitha misteret e të gjitha dituritë; po ta kisha edhe fenë e plotë, me të cilën të mund t'u ndërroja vend maleve, por po të më mungonte dashuria, s'do të isha asgjë!

⁵² Përktimi i don Simon Filipajt. *Shkrimi Shenjt Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e re. Shoqëria biblike ndërkombëtare e Shqipërisë. Tiranë 2005.*

⁵³ Gjon Pali II me Vittorio Messorin, *Të kapërcehet pragu i shpresës*, vep. e përm., f. 37.

*Po ta ndaja lëmoshë mbarë pasurinë time dhe po të jepja trupin tim të digjej,
por, po të më mungonte dashuria, nuk do të më vlente asgjë!*

IV. DASHURI SI PËRJETËSIM POETIK

Qëllimi kryesor i hartimit të veprës poetike “Këngëtorja arbëreshe” ishte që përmes gjuhës arbëreshe – shqipe të përjetësohej dashuria si qenësi jete e mendimi, qoftë kur ajo është konkrete, qoftë shpirtërore dhe hyjnore. Gjithë këtë Santori e përligj përmes vashës arbëreshe me bukuri të jashtëzakonshme, që simbolizon dhe të bukurën në përgjithësi, brenda së cilës mund të nënkuptohet dhe poezia si art.

Shqiptimi i dashurisë, i përnjësuar me bukurinë dhe lumturinë në veprën e Santorit shqiptohet në rrjedhën dramatike, ku këmbehen skena e gjendje të ndryshme, siç ngjet edhe në “Këngën e këngëve”⁵⁴, po dhe në veprën e Petrarkës.

Santori e ndërliði dashurinë me bukurinë, për arsye se, siç thuhet, “Pikësynimi i fundit i botës është bukuria, pika e drejtimit të shpirtit është bukuria; ajo që nxit veprimin dhe është ngushëlluese përherë është bukuria misterioze dhe e papërcaktuar. Ajo që bën të këndosh, ajo që frymëzon çdo poezi dhe çdo muzikë dhe çdo veprim (ndërmarrje) është bukuria”⁵⁵ dhe se vetë *Hyji është triniteti i dashurisë*⁵⁶ dhe ekziston si plotni dhe marrëdhënie e dashurisë dhe e bashkimit të dashurisë.

Që në hyrje të pjesës që mban titullin “Odhí e P”, Santori jep disa nga tiparet kryesore të Vashës së bukur, të cilën e dashuron Trimi (Djaloshi). Pikërisht bukuria e saj është shkasi kryesor i hartimit të veprës dhe i gjithë asaj që shprehet në të.

Në vargun e parë shqiptohet shenja e kryesore e dashurisë – e kuqja, *kuqëllore*. Kjo ngjyrë në përrallë simbolizon dashurinë – pjekurinë seksuale, që shënjohej me fustanin ose me këpucët me ngjyrë të kuqe (të kujtojmë, fjala vjen, Kësulëkuqen ose këpucët me ngjyrë të kuqe të së Përhiturës). Pra, Vasha e bukur është shenja përcaktuese; ajo e nxit, e kushtëzon

⁵⁴ *La sacra Bibbia*. Conferenza Episcopale Italiana 2008, vep. epërm., f. 989.

⁵⁵ David Maria Turollo. *Il Dramma è Dio*, vep. epërm., f. 84.

⁵⁶ Giovanni Paolo II, *Pensieri sparsi*, vep. epërm., f. 28.

dashurinë e Trimit; vetëm ajo mund ta shndërrojë hidhërimin – helmin në gëzim.

*Ti pa zëmër kuqulore
Vajzë çë faqen mos e fsheb,
Të dashurt si nëng e njeh?
Çë vetë krahët gjelbulore
më buthton e dishëron
Se të klánj, e ngë ndërron
Me hadhí lipin njinjë. (Odhí e I)
(Faqekuqe e pazëmër
f'tyrën vashë ti mos e fsheb,
pse dashurinë ti nuk e njeh?
Parzëmën tënde në bulëzim
ma trego dhe dëshiron
që të qaj dhe pse vuajtjen
në gëzim nuk ma shndërron.)*

Bukuria e Vashës shtrihet paskajshmërisht në hapësirë dhe kohë. Ajo është më e bukura në rruzullin tokësor dhe në gjithësi; është E Bukura e Dheut, jo vetëm në kohën e poetit, por dhe në kohët e mëparshme. Pikërisht kjo bukuri shkakton tundime dhe vuajtje, siç thekson Shën Gjoni i Kryqit: “Për të arritur atë që tani nuk e gëzon, duhet kaluar andej nga nuk gëzon. Për të arritur atë që nuk e di, duhet kaluar andej nga nuk di. Për të arritur atë që nuk e ke, duhet kaluar andej nga tani nuk ke asgjë⁵⁷”.

Santori i shqiptoi dashurinë dhe bukurinë si qenësi të pandara.

*E një të ruar më dritësoi
Çë nga gjiu zemrën rrëzoi
Me një sperë haré çë jip. (Këntëk II)
(Ajo m'pa dhe më dritësoi
sa n'krah'ror zemra m'u dridh
nga ajo rreze që g'zim lëshoi.)*

⁵⁷ Cituar sipas Gjon Pali II me Vittorio Messorin, *Të kapërcehet pragu i shpresës*, vep. e për., f. 98.

Vasha e “Këngëtores arbëreshe” është *parajsë bukurie*; është kështjella ku Trimi mund të qëndrojë e të përjetojë lumturinë dhe kënaqësinë e jetës e të veprimt. Bukuria e saj është thesari, pasuria kryesore, magjikja; ajo duhet ta shfaqë e ta dëshmojë atë në çdo rast.

Atë parajsë bukurie

Pse [f]shbën e ngë buthton,

Me kë gjithë jetën ti hajdhon,

Është je i mbjedhur te ata krye.

Buthtoja [të]dashurit [t]ënd:

Mos e dua [të] mjërë, mos e rënd...(Odhí e I)

(Atë parajsë bukurie

pse e fsheb e s'na tregon,

ngase botën gjithë lumnon

atë ç'ke mbledhur në atë krye.

Ia trego të dashurit tënd.)

Pikërisht Vasha me bukuri të tillë, sa konkrete po aq hyjnore, është bërë pjesë e veprimeve konkrete të Trimit, po dhe pjesë e ëndrrave të tij.

Vjen ka gjumi të më zgjonjë

Ninëza e vashës pjono zjarr

Më e bukur se sà mëpara

Hërë harakxi; e me të lara

Faqe si herësh me bárrë.(Këntëk II)

(Më vjen n'gjumë të më zgjojë

ninëza e vashës krejt e zjarrtë

më e bukur se më parë

që shkëlqim rrezatonte

fajekulluar plot haré.)

Për bukurinë e Vashës dëshmojnë dhe epitetet: ajo është *manushaqe*, është *dallëndyshe*, është *lule, lule e gëzuar*, është *Trendafile që ndë maj fjetat gjelbon* (Vjershi II); bukuria e saj ngrihet mbi të gjitha vajzat e tjera *E të tjerat përtej nën kopile nxín* (Vjershi I); kudo që ndodhet ajo, bukuria e saj bartet edhe tek vajzat e tjera *Se ku ti gjënde vashat bukuron* (Vjershi II); bukurinë ajo e bart edhe tek objektet, edhe ato i bën të bukura, si fjala vjen, shtëpitë: *E*

shtpivët ku pushon me faqe i bën (Vjershi II); shikimi i saj i ndriçon vendet ku ajo rri: *E vendet prej shkëlqije me ata sy* (Vjershi VI), *O vashë që pjeksur siell ari këshhtën' / Sa syu gazor j'e qeshmja búzëvëlen* (Vjershi I), *Ndo na haraksi nga parrajset yll'i* (Vjershi IV), *Harakse ti si yll mbi dritësorë* (Vjershi VIII).

Trimi kërkon nga Vasha që ta përfillë dashurinë e tij (siç ndodh dhe në “Këngëtoren” e Petrarkës), të mundësojë bashkimin e dashurisë, për arsye se bukuria e saj vetëm për vete s’ka vlerë. Jeta tokësore është e shkurtër dhe një ditë ai mund të mos jetë më dhe ajo do ta kërkojë, do të pyesë se kush e dërgojë në dhé.

Po ndë zemrën ai të pastë,
“O snamure, - abiena thotë -
Kush ndë dhé të ftohtë të shtyti?”. (Odhí e I)
(Nëse n’zemër ai të sheh
“E dalë zemre” – atëherë thotë –
Kush në dhé të ftohtë të shtyu?”)

Ngjashëm ngjet dhe në “Këngën e këngëve”:

Në shtratim tim gjatë natës e kërkova
dashurinë e shpirtit tim;
*e kërkova e nuk e gjeta*⁵⁸. (KK 3,1)

Tablo të ngjashme shprehen dhe në vargjet e “Vjershit V”: *E kúr mua [më] sheh ndë pasetjâr ndërron. / Pse abonsina ndë ai, si taksën, ish / Hadhoje kët gjí kúr e heolon;* në vargjet e “Vjershit VI”: *Ni terjorisën, vashë, pa vënë ré / [Të], dashurit [t] ënd të llárgë varthur e zj, për të marrë një përmasë më të thellë e më tragjike në “Vjershin VII”: Prana ngá zjarmi që më digj hjimise / E stepash më t’ëgra e [të] tharta vjove, / Njera tek udha e varrit prá m’udhise* dhe në “Këngën III”: *Kopile kuqëlore / Pra që vdekja mua / Më muar nga syt’ e tua / Më shír ndë varr një lot.*

Në veprën e Santorit, siç ndodh edhe në jetë, dashuria bashkëjeton me dhembjen, me vuajtjen, me flijimin. Të duash domethënë dhe të vuash, siç thuhet dhe në Letrën e Shën Palit dërguar romakëve: “Dua vetë

⁵⁸ *La sacra Bibbia*. Conferenza Episcopale Italiana 2008, vep e përm., f. 993.

të bëhem një vetmallkues, i ndarë nga Krishti, për të mirën e vëllezërve të mi, të atyre që kanë gjakun tim” (Rom 9, 3 – 4). Pra, botën në të cilën jeton njeriu, e cilëson paqëndrueshmëria (Rom 8, 20), zvetënimi dhe vdekshmëria. Vetëm në Kopshtin e Edenit, dashuria ishte e virgjër, e panjollë, e mirëfilltë. Mirëpo, Santori poet thotë se ajo botë i përket më shumë ëndrrës, në jetën e përditshme gjithkush përjeton gëzimin dhe hidhërimin; kënaqësinë dhe vuajtjen, bukurinë dhe shëmtinë (*Se mosse ndë këtë dhë / Qe lip e hjadhi e harë, / Si ká, e naní kusbdo*); jeta tokësore nuk është burim i lumturisë përfundimtare të njeriut, as nuk e liron nga vdekja⁵⁹.

Një mënyrë të ngjashme të shqiptimit të dashurisë e të bukurisë Santori e zbatoi dhe në tragjedinë “Neomenia”, ku në përfytyrimin e Axhezellaut, vasha, Neomenia, perceptohet me një bukuri të jashtëzakonshme; ajo jo vetëm rri në diell dhe laget me vesë mëngjesi, po dhe:

*Çë më ndë diell rri, mëë ghaidbonet
Laghet me ves menatet, kurë zgjonet
E fjetat gjelëbullore
Nga një mbaghen te jetra [...]*

(Akti i dytë, Skena e parë⁶⁰)

Këto veçanti dalin në dritë dhe kur Neomenia kthehet nga vreshti me shoqet e saj; tiparet e bukurisë së saj përkojnë me ato të vajzës së “Këngëtores arbëreshe”.

*Nga vreshta prirëj, bashkë me Ifixhenien;
E sillij ndën sjetull një panare*

⁵⁹ Gjon Pali II me Vittorio Messorin, *Të kapërçehet pragu i shpresës*, vep. e përm., f. 62.

Në tragjedinë “Trankinëset” të Sofokliut thuhet:

*...Hyji i epërm sunduesi i rruzullimit
nuk u dha vdekatarëve gëzime pa idhnime;
por mbi gjithë njerëzjt sillen
e mira e e keqia bashkë duke u ndërthurur
si yjet e Harusbës ndër shtigje rrotull polt...
Por vrik nga njëri ikin – dhe shpejt i shkojnë një tjetri,
sa e gëzon njeriun e mira, fill e zbgënjën e liga.*

(Përkthim i Gjon Shllakut)

⁶⁰ Françesk Anton Santori, “Neomenia”. Tragjedia e parë shqipe, vep. e përm., f. 60.

*E pjot me verdh durak, pa skemandilë
Kështeti bardh shkëllqej si mali kurë
Ësht i mbuluarë me borë, e ku menatet
Kundrela Dielli delë e vete rrëmbi.
Më ruoiti m'ata si të zezë shum.*

(Akti i parë, Skena e katërt⁶¹)

Edhe tek vepra “Emira” Santori e mori në vështrim dashurinë për të shqiptuar më thellësisht dramën shoqërore dhe dramën shpirtërore të njerëzve, për të depërtuar sa më thellë në fatin dhe në tragjikën e tyre. Gjendjet dhe kontekstet e ndryshme jetësore, sidomos ato të rëndat, siç ngjet në gjallimin e arbëreshëve në një varg katundesh të Kalabrisë të periudhës pas rënies së qeverisë së Burbonëve, ndërliidhen dhe kushtëzohen nga dashuria ose nga pasojat dhe kundërthëniet që ajo shkakton në individin dhe në marrëdhëniet përkatëse shoqërore.

Në dramën “Emira” Santori e shqipton bukurinë e vajzës arbëreshe, Emirës, në forma të ndryshme dhe cilësitë dhe veprimet e saj e kushtëzojnë dramatiken e rrjedhës së ngjarjes e të shqyrtimit të dukurive. Në të ai e ndërliidh dashurinë me bukurinë, me lumturinë dhe me besimin në Hyjin, parim që e ka bazën në qenësinë dhe njësimin e dritës me bukurinë, siç thuhet dhe në *Bibël: Derisa të keni dritë, besoni në dritën, që të bëheni bijtë e dritës*. (Gjn 12, 36). Në veprën “Emira” kjo përliqjet, fjala vjen, në skenën e katërt të aktit të parë, kur Motmadhi, duke iu përgjigjur Valljes së ganjunëve (djelmohave), thotë: “*Drita është e bukur si gjella; e gjella është e bukur pse je shkëlqen drita. Njera e tjetra prana janë të mira, pse të kriësura ka Perëndia⁶²...*”.

Për ta përliqjur praninë e dashurisë në dramën e parë të shkruar në gjuhën tonë – “Emira”, po sjell vetëm një shembull, ku Allbenxi ia shfaq Kallinës ndjenjat e dashurisë së thellë, si dhe përshkrimin e bukurisë së vashës së zemrës së tij, që ka rrjedhoja të shumta në shtjellimin e ngjarjes dhe të veprës.

⁶¹ Françesk Anton Santori, “Neomenia”. Tragjedia e parë shqipe, vep. e përm., f. 48.

⁶² Francesco Antonio Santori, *Emira*. Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura del prof. Francesco Solano. Grottaferrata 1984, f. 42.

“Ndo pësuumja vej si e pandebe ti, qëndruomja është edhe ashtu. Moj u ndë sa herë të pé, nëng të thaç kurraj gjë. Ti më shture ca kopané; mos u nëng t’u përgjegja; e me gjithë se ti je një kopilez mirëbëme, e shëndoshme, e majmez e je bukur si një trondofile mirudhire asoshi që përhapen e rriten aq të bëshme Marailë, ti nëng më tunde kurraj zëmren. U nëng thashë një jerë për tyj: ”Sa është e bukurez kjo kopile!” Nani, thujme ti, që vjen me thënë ky shërbes? Nëng më kallëzon drej ky se zëmra ime s’është e bërë për tyj? Vërtetë është edhe se u jam keq trim, e kuazi ghanjùn, e s’kam synë ashtu të hollë sa të mund njohë se një dritëz është më e bardhez se një etër; moj kam besë se nëng kam përpkur edhe linarinçë ká të ndritinj e të harepsinj gjellën timë⁶³”.

Perceptimin dhe shqiptimin poetik të dashurisë dhe të bukurisë së vajzave e ndeshim dhe te veprat e shkrimtarëve të tjerë arbëreshë, në mënyrë të veçantë kjo shprehet në veprën e Zef Skiroit “Milli e Hajdhë⁶⁴”.

V. VEPËR E HAPUR PËR INTERPRETIME

“Këngëtorja arbëreshe”, siç u tha dhe më parë, nuk është një poemë e mirëfilltë, ku pjesët shkrihen natyrshëm në tërësi, që nuk e zvogëlon aspak vlerën e saj poetike. Sipas datave të botimit origjinal të veprës dy strofat e fillimit (ku tregohet objekti që trajtohet), Santori i shkroi më 1845 (f. 4 - 5); “Odhí e I” më 1837 (f. 6- 11), “Këntëk e IV” (lexo: Kënga IV) më 1839 (f. 52), ndërsa “Vjershi XIII” më 1840 (f. 56).

Se kjo vepra e Santorit është krijesë e përbërë prej pjesëve bindemi sikur t’i lejonim vetes që, fjala vjen, ta shmangnim për një çast, ndonjë nga pjesët e saj, si fjala vjen, “Kangjel i valles” (pjesa më e gjatë në vepër, 125

⁶³ Francesco Antonio Santori, *Emira*, vep. e përm., f. 178.

⁶⁴ Në këtë vepërtë Zef Skiroit dashuria dhe bukuria janë njësuar në arbëreshen e quajtur Hajdhë, të bijën e Jorgos, e cila aq sa është përfytyruese dhe e hyjnueshme, po aq është konkrete dhe tokësore. Këtë vajzë të bukur si yll menate (mëngjesi), të brishtë si vjollca, me sy si të pëllumbeshës, me buzë si burbuqe, me flokë shkëlqimi prej arit, Mili as që e ka takuar konkretisht në jetën e përditshme, mirëpo si e tillë ajo është përfutur dhe gjallon në përfytyrimin e tij, pra është krijesë e mendjes së tij: *Se një ‘ rëzë e trüvet ishe/ E pásbtate edhe flurorë. Mili mahnitet gjithnjë nga sytë magjikë të Hajdhisë: Sýt që kishin gjith magjín dhe me bukurí diellorë e sheh atë kudo: Ndë një rrëmp të diëllit t’árt / te pëshjtjellë, ai m’e shibte. Shih për këtë Giuseppe Schirò, Mili e Haidbia. Idhyl në gjuhë shqype (i përkëthyer edhe italisht fjalë pas fjale). Shpallëje e tretë. Napoli 1907, f. 12; Giuseppe Schirò, *Opere II. Vistari. Te dheu i huaj*(ed. del 1900).A cura di M. Mandalà. Rubbettino. S. Mannelli, Catanzaro 1997, f. 196 - 198.*

vargje) që gjakon të jetë më “konkretja”, më “historikja”: flet për dashurinë në kohën e Skënderbeut, kur arbërorët nuk derdhnin më “gjakun si lumë”, po bënë jetë të qetë e të denjë, ku dashuria ishte pjesë e pandashme e gjallimit.



“Këngëtorja arbëreshe” e Françesk Anton Santorit është vepër për shumçka e veçantë dhe e pasur. Edhe pse është përmbledhje e poezive, që ndryshojnë qoftë për mënyrën e krijimit të imazheve e të llojeve të vargjeve, ato afrohen për objektin e trajtuar dhe për synimin që nëpërmjet tekstit poetik të përftohet një himn poetik kushtuar dashurisë, bukurisë e lumturisë dhe *gëzimit të jetës*⁶⁵. Qëllimi i Santorit ishte që në “Këngëtoren arbëreshe” ta bënte objekt vështrimit poetik dashurinë, si dukuri qenësore e jetës së njeriut. Për hartimin e saj mbase ai zbatoi parimin krijues me të cilin De Rada e përftoi veprën e vet “Këngët e Milosaut”: “[...] *rendi artistik dhe harmonia e së tërës duhet kërkuar për secilin kuadër, mbasi në ta, patjetër, gjendet ngjasimi e fisnikëria e fabulës, e vërteta dhe idealiteti shërues i karaktereve dhe shqisa simbolike e sendeve*⁶⁶”.

“Këngëtorja arbëreshe”, e shtjelluar mbi bazën e një koncepti krijues të veçantë, ka një nëntekst të pasur poetologjik dhe përligj atë që David M. Turollo thotë për natyrën e tekstit poetik (ndërlidhur dhe me “Këngën e këngëve”): “*Askush nuk mund të thotë se çka përmban një poezi. Po, gjithçka mund të thuhet, po pa tradhtuar*”: pra, pa sforcime, pa improvizime e pa përjashtime. *Gjithçka*⁶⁷”.

Mbështetja e Santorit në disa tradita letrare, përkatësisht në veprat që i cilësoi arti i madh, nuk e mohon origjinalitetin e “Këngëtores arbëreshe”. Ai, njëmend, mësoi nga disa burime e vepra letrare, po gjithçka e përshkoi dhe e ngjyrosi me shpirtin dhe me dijen e vet, duke i dhënë veprës së vet përmasën origjinale. Pra, “Reminishencat”, siç i quan

⁶⁵ Klara Kodra, *Të dbëna të reja mbi krijimtarinë e F. A. Santorit*, pun. i përm., f. 326.

⁶⁶ G. De Rada, *Scanderbeccu i pa faan*. Libro IV, Napoli 1877. Përkthimi i J. Kastriotit. Në Jeronim De Rada, *Vepra letrare 2*, “Naim Frashëri”, Tiranë 1987, f. 370.

⁶⁷ David M. Turollo, *Postfazione*. Në Gianfranco Ravasi, “Cantico dei cantici... come sigillo sul cuore”, vep. epërm., f. 234.

Francesko Solano⁶⁸, nuk e zvogëlojnë vlerën dhe mëvetësinë e saj; ato dëshmojnë se “Çdo artist formohet duke asimiluar artin e së kaluarës dhe duke zhvilluar elemente origjinale të individualitetit të tij brenda botëkuptimit të shoqërisë në të cilën bën pjesë. Askush nuk rron i shkëputur nga tërësia, bile ai që konsiderohet më shumë origjinal, ka më shumë pika kontakti me tërësinë, sepse ai realizon atë që shumë aspirojnë por nuk arrijnë të shprehin⁶⁹”.

Është e vërtetë se Santori u nis nga njëmendësia (realiteti) arbëresh, po në vepër gjithçkasë i dha përmasën universale dhe gjithëkohore; ajo që ndodh midis Vashës dhe Timit mund t’i ndodhë kujtdo, në cilindo vend dhe në cilindo periudhë: “*Me kë gjithë jetën ti hardhon*” (*Meqë tërë botën ti e lumturon*).

Në qoftë se “Njeriu është ai (ajo) që mendon; janë mendimet, është kultura që shënojnë shtresimet gjeologjike të shpirtit të tij⁷⁰”, vepra *Këngëtorja arbëreshe* e Santorit është fryt poetik i mendjes (Dekarti thoshte: *Cogito, ergo sum* – mendoj, pra jam) dhe i dijes së tij, për shumçka e veçantë dhe e rëndësishme për letërsinë tonë.

⁶⁸ F. Solano, *Nota introduttiva*. Në Francesco Antonio Santori, “Il Canzoniere albanese”, vep. e për., f. 27.

⁶⁹ Odhise Paskali, *Shpirti i ripërtërirë. Ese*. Një jetë kujtime dhe shënime meditimesh. Argeta – LMG, Tiranë 1983, f. 135.

⁷⁰ David Maria Tuoldo. *Il Dramma è Dio*, vep. e për., f. 108.

KDU 008(=18)(092)

929(496.51) Pjetër, Bogdani

Don Lush GJERGJI

**IMZOT PJETËR BOGDANI, NJERI I ZOTIT DHE
POPULLIT (1625 – 1689)
(PROFILI SHPIRTËROR DHE KULTUROR)**

Abstrakt

Imzot Pjetër Bogdani në historinë e kulturës dhe letërsisë shqipe mbetet njëra nga figurat kryesore dhe me ndikim në historinë e kulturës shqiptare. Në këtë punim kemi trajtuar profilin kulturor dhe shpirtëror të Pjetër Bogdanit, rëndësinë e veprës së tij dhe ndikimet që pati ajo në rrjedhat historike të kohës dhe të mëvonshme.

Po ashtu, në këtë punim kam trajtuar rëndësinë që pati vepra e tij për ruajtjen dhe mbrojtjen e popullit shqiptar nga ndikimet dhe sundimet e huaja; gjendjen fetare dhe shoqërore në Kosovë sipas letërkëmbimeve me vlerë historike të Bogdanit, pastaj bashkëpunimin e Bogdanit me kardinalin Gregorio Barbarigo për të botuar veprën e madhe “Çeta e profetëve”, vlerat historike, kulturore dhe shpirtërore të kësaj kryevepre letrare.

Kështu, vepra e tij përbën një gur themeltar në historinë e kulturës shqiptare, meqë ajo është një vepër e madhe në të cilën luftohet për çlirimin e popullit shqiptar nga robëria e dyfishtë: injoranca, terri, primitivizmi, nëpërmes zgjimit fetar dhe kombëtar, si parakusht për vetëdijesim dhe çlirim nga sundimi shekullor turko-otoman.

Abstract

Pjetër Bogdani remains one of the leading and influential figures in the history of Albanian culture, in the history of Albanian identity and literature. In this study I have discussed the cultural and spiritual profile of Pjetër Bogdani, the significance of his work and the impact that his book has had on the historical and later historical currents.

Also, in this study I have analyzed the importance of his work in attempting to protect the Albanian people from foreign influences and rulings; the religious and social situation in Kosovo according to Bogdani's historical correspondence, then Bogdani's collaboration with Cardinal Gregorio Barbarigo to publish the great work "The Prophet's Cache", the historical, cultural and spiritual values of this literary masterpiece.

Thus, his work is a cornerstone in the history of Albanian culture, as it is a major work fought for the liberation of the Albanian people from double bondage: ignorance, darkness, primitivism, through religious and national awakening, as a precondition for self-awareness.

Profili shpirtëror dhe kulturor

Imzot Pjetër Bogdani lindi në “*Guri ndë Hasit*” në vitin 1625 dhe vdiq në Prishtinë në vitin 1689. Ishte meshtar, ipeshkëv, veprimtar i dalluar, atdhetar i kulluar, luftëtar për liri, shkrimtar i shquar, raportues i vëmendshëm dhe i saktë nga viset e ndryshme shqiptare, me një fjalë Njeri i Zotit dhe Popullit shqiptar.

Vendlindja nuk dihet sot ku gjendet, në Breg të Drinit, në Gjonaj apo diku gjetiu, disa thonë ndoshta në Zym apo në Zhur. “Guri i Hasit” përmendet qysh në vitin 1330, sot Shëngjeçi, afër Mazrekut, apo Guri, afër Zymit të sotëm.¹

Nipi i tij Don Gjon Bogdani jep informata që Pjetrin e kishte rritur dhe edukuar qysh në fëmijëri dhe në rini arqipeshkvi Andre Bogdani (1600-1683), ungi apo axha i tij, së pari në kolegjin françeskan të Cipovecit (Bullgari), pastaj në Kolegjin “Illiricum” në Loreto, afro 9 vjet, ku edhe ishte shuguruar meshtar në vitin 1649. Më vonë ka vazhduar studimet në “Propaganda Fide”, ku kishte doktoruar për filozofi dhe teologji (1655). Pas shugurimit meshtarak ka shërbye në Ipeshkvinë e Pultit, diku gjatë viteve 1651–1656.

Në vitin 1656 emërohet arqipeshkëv i Shkodrës, me shërbim 20-vjeçar, pastaj në Tivar në vitin 1677, afro 10 vjet, së fundi arqipeshkëv i Shkupit në vitin 1677, për 12 vjet, si dhe administrator apostolik i Serbisë dhe Bullgarisë, gati i gjithë Ballkanit.

Jeta dhe vepra madhore e Imzot Pjetër Bogdanit nuk mund të kuptohet, edhe më pak të interpretohet, pa dimensionin e thellë të fesë apo besimit në dy drejtime: me Zotin, Krijuesin dhe Shëlbuesin e botës, si dhe me Popullin ilir, arbëror dhe shqiptar, ideale këto që ishin gjithnjë frymëzim i pashtershëm për jetën dhe veprimtarinë e tij në rrethana tejet të vështira, gati të pamundshme.

Feja dhe jeta me Zotin dëshmohej bindshëm edhe me edukimin e tij familjar, thirrja e tij për jetën dhe shërbimin meshtarak, më vonë ipeshkëv, me zellin e tij të jashtëzakonshëm baritor për grigjën e besuar,

me përgatitjen e shkëlqyeshme filozofike, teologjike, shpirtërore dhe kulturore të nivelit më të lartë të asaj kohe.

Për shërbimin e tij baritor imzot Pjetër Bogdani pati këto synime:

- Ruajtjen dhe mbrojtjen e popullit shqiptar nga ndikimet dhe sundimet e huaja;
- Zhvillimin fetar, shpirtëror dhe kulturor të popullit shqiptar;
- Çlirimin e tij nga robëria e dyfishtë: injoranca, terri, primitivizmi, nëpërmjet zgjimit fetar dhe kombëtar, si parakusht për vetëdijësim dhe çlirim nga sundimi shekullor turko-otoman;
- Kjo mund të bëhet vetëm me fuqinë e fesë, ngritjen e kulturës, por edhe me luftë të armatosur, vëllazërisht dhe së bashku me aleatët dhe miqtë, sidomos Austro-Hungaria dhe gjenerali Piccolomini.

Mu për këtë, Imzot Pjetër Bogdani jetoi me Zotin dhe për Zotin, si njeri i kushtuar, meshtar dhe arqipeshkëv, me Popullin dhe për Popullin, me identifikimin e tij shembullor dhe ungjillor: Fati i Popullit tim është fati im.

Shpresa e tij ishte e mbështetur në fe, në Zotin, dhe në Popullin. Ai ia besonte shpresës këtë mision: çlirimin nga herezitë dhe apostazitë, si dhe sigurinë se binomi fe dhe atdhe, që për të konkretizohen në Zoti dhe Populli, ishte lidhje e pathyeshme, si vetëdije historike, skenderbegiane, por edhe aktuale, kthimin në krishterim dhe në kulturën dhe qytetërimin evropian, ku ishim me shekuj, që nga zanafilla e krishterimit, për të tashmen dhe të ardhmen tonë sa më të mirë.

Feja dhe shpresa do të ishin të mangëta, deri diku edhe abstrakte, pa zbatimin e dashurisë. Imzot Pjetër Bogdani ishte qenësisht, thellësisht dhe tërësisht i njësuar, bashkuar dhe dashuruar në Zotin dhe në Popullin tonë. Kjo dashuri, me krahët e fesë dhe shpresës, e bënte atë njeri të Zotit dhe të Popullit, veprimtar të shquar dhe të dalluar të kulturës, përpilues të kryeveprës “Çeta e Profetëve”, të shumë letrave, shkrimeve, relacioneve, shënimeve, dërguar Selisë Shenjte, gati nga të gjitha viset dhe trojet tona, diku 128 relacione dhe 308 letër-shkrime.

Pa jetën dhe veprën e frytshme dhe të gjithanshme të arqipeshkvit Pjetër Bogdani, shekulli XVII për ne do të ishte i errët, pasi raportet apo relacionet janë kryesisht turko-otomane apo greko sllave, dhe si të tilla shpesh të njëanshme dhe të mangëta me informata të rëndësishme për njohjen e kontekstit fetar, kombëtar, kulturor dhe shoqëror të asaj kohe.

Dashuria e shtynte atë në veprim si meshtar, famullitar, më vonë si arqipeshkëv dhe delegat apostolik në vende të ndryshme Tivar, Shkodër, Shkup, Bullgari dhe Serbi, gjithnjë në kërkim të besimtarëve të krishterë, në lëvizje dhe në veprim, si një lloj “Iypësi i Zotit” dhe “endacaku i Popullit”.

Për mua Imzot Pjetër Bogdani ishte dhe mbetet Gjergj Kastrioti – Skënderbeu i dytë, njeri i cili në mënyrën më të mirë të mundshme e kishte kuptuar dhe interpretuar historinë tonë, kishte krijuar një “hallkë” për t’u lidhur me të kaluarën tonë të lavdishme, por pa harruar kurrë edhe lidhjen me të tashmen dhe projektimin e së ardhmes tonë fetare dhe kombëtare.

Kjo e bënte atë filozof, teolog, biblicist, katekist, gjuhëtar, atdhedashës, veprimtar, vizionar të rrallë. Arqipeshkvi Pjetër Bogdani e shkriu jetën, punën, dijen, zemrën për Zotin dhe për Popullin, si paraardhës i largët i iluminizmit dhe rilindësve, duke u munduar që të na bënte të ngjashëm dhe të barabartë me popujt e tjerë evropianë.

Pa imzot Pjetër Bogdanin do të rrezikonim shkrirjen e dyfishtë, fetare dhe kombëtare, dhe si të tillë do të ishim pa ndonjë identitet dhe personalitet, një popull masë, grumbull, turmë dhe asgjë tjetër.

Në çdo shkrim, letër, relacion, vazhdimisht flitet për Zotin tonë Jezu Krishtin, për Virgjërën Mari, për Kishën Katolike, për Popullin Shqiptar, për shëlbimin apo shpëtimin tonë. Këto tema janë boshti i jetës dhe shkrimeve, veprimtarive të tija pothuaj në vazhdimësi.

Mendja e tij ndriçohej, ndërsa zemra e tij frymëzohej, për shërbim dhe flijim për Zotin dhe për Popullin.

Ai si rrallë kush e ka gjetur lidhjen dhe përplotësimin e hyjnore, njerëzore dhe kombëtare, dhe atë në rrethana kur çdo gjë ishte e rrezikuar.

Gjendja fetare dhe kishtare në Kosovë sipas letrave të Imzot Pjetër Bogdanit

Për ta njohur më për së afërmi gjendjen shpirtërore dhe kishtare të popullit tonë gjatë kohës së Imzot Pjetër Bogdanit, kemi botimin: *Pjetër Bogdani, Letra dhe dokumente nga Arkivi i Kongregatës “de Propaganda Fide” si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit, Shtëpia botuese “At Gjergj Fishta”, Shkodër, 1997, f. 579.* Unë do të kufizohem në disa të dhëna dhe dëshmi, që përshkruajnë dhe ilustrojnë këtë gjendje tejet të vështirë të katolikëve tanë kryesisht në Kosovë, që për mrekullinë e Zotit, si dhe kontributin e madh të klerit, në krye me Imzot Pjetër Bogdanin, më vonë edhe shumë të tjerëve, kemi mbijetuar.

“Ky botim, i përgatitur nga Motra e Vogël Odette Marquet, i kushtohet popullit shqiptar, kudo që gjendet..., si trashëgimtarë të denjë të Bogdanit, i cili ia dburoi jetën popullit të vet”.²

“Ai (mendohet për Imzot P. B., vr. ime) është njeri i terrenit që shkon me kalë duke rrezikuar jetën e vet nëpër malet e ashpra dhe të larta të Shqipërisë së Veriut. Duke u pajtuar me rrebtësinë e vendit, klëmën e vështirë dhe pengesat e shumta që armiqtë i vinin në rrugën e tij... Gjithë këtë e bën për t’u shjellë ngushëllime shpirtërore njerëzve të mjerë që jetonin në këto vende ose kishin gjetur strehim aty.

Dashuria e tij për Krishtin, shpirti i tij luftarak, për t’i fituar shpirtat Perëndisë, ndezin zemërgjerësinë e tij dhe e shtynjë ta dëshirojë martirizimin....

Në letrën e fundit, pasi i janë hakmarrë turqit, i lidhur ngushtë me mundimet e Mësuesit të dashur, e çuan lakuriq nëpër rrugët e Prizrenit, dhe i shpëtuar për mrekulli nga vdekja, do të nënshkruajë “Cuneus Prophetarum” duke e vulosur kështu jetën e tij me një vepër dhe një itinerar të pavdekshëm”³

Shkas për këtë studim, hulumtim dhe botim ishte 300-vjetori i vdekjes së tij, në vitin 1989, organizuar në Prishtinë. “Atëherë e kuptova që kishte shumë tekste dhe dorëshkrime, letra të pabotuara dhe të shkapërderdhura të Pjetër Bogdanit”.⁴

Unë do të përqendrohem në të dhëna dhe përshkrime që lidhen me Arqipeshkvinë e Shkupit, pra, kryesisht me Kosovën. Letra e parë nga Shkupi është më 7 nëntor 1677, ku përshkruhet armiqësia e theksuar turko-otomane dhe serbo-ortodokse, ardhjen e tij në Shkup dhe dhënia e kishës dhe të gjitha pasurive, si shtëpia, kopshti, vreshta, livadhi Etërve të Reformuar.⁵

Ja vetëm një shembull i thjeshtë që dëshmon bindshëm vështirësitë e shumta të komunikimit me Selinë e Shenjtë, me Vatikanin, pritja për ta marrë palinë arqipeshkvor. Ai nuk humbte kohë, por qarkullonte gjithnjë nëpër ipeshkvi “*duke u ndarë këtij Populli të Shenjtërueshmuit Sakrament, duke bërë gjithçka, herë predikues, herë famullitar, herë misionar...*”⁶

Ja një dëshmi konkrete e përndjekjeve serbo-ortodokse nëpërmjet Patrikut ortodoks të Pejës, i cili banonte në Janjevë. “*Patriku grek i Pejës, me banim në Janjevë, armik i paqes së krishterë, ka shpallur prapë këtyre kishtarëve të mi të shkrëtë dhe Popullit të Metropolisë së Shkupit dhe të Serbisë duke kërkuar taksa të padurueshme vjetore... Që të mos lënte në paqe, kishte dërguar nëpërmjet Vladikës, ipeshkvit të padenjë, për të më pyetur nga kush jam emëruar ai Arqipeshkëv? Ju përgjigja: Prej Zotit dhe Vikari të Tij... Reagimi i Vladikës ishte tejet i ashpër dhe vërsulës, duke ia kontestuar Bogdanit edhe Zotin e tij dhe duke iu kërcënuar se do të kërkojë nga turqit që ta gjykojnë*”⁷

Më 4 shtator 1679 arqipeshkvi Imzot Pjetër Bogdani, kryepeshkëv i Shkupit, emërohet Administrator i tërë Mbretërisë së Serbisë.

“*Duke ecur nëpër borë e nëpër ujra, shpesh herë pa ushqim dhe pa pushim, duke shkuar edhe atje ku s’kishte pasur kurrë priftërinj, duke derdbur djersë e gjak, duke predikuar dhe duke i kthyer njerëzit në fenë e tyre*”⁸

Ja një dëshmi tronditëse për përndjekjet e egra turke: “*Don Antoni (bëhet fjalë për Don Anton Pavloviqin, misionar për Trepçë, Vuçitërn dhe Prishtinë, vr. ime) ishte rrahur për vdekje nga turqit, për shkak se në rrugë për Romë kishte marrë me vete deri në Raguzë një djalosh të shkrëtë, të cilin turqit e kishin ndjekur dhe munduar deri sa e kishin detyruar ta mohojë fenë. Don Antoni e shpëtoi atë, por e kishin marrë vesh turqit dhe tani i ndjekin edhe atë*”⁹

Imzot Pjetër Bogdani tri herë u burgos, u keqtrajtua, u kërcënuar me vdekje shumë herë, dhe për mrekulli jetonte, mbijetonte, gjithnjë vepronte, me një fe të pathyeshme dhe me një vullnet të jashtëzakonshëm.

Nga letrat dhe relacionet e tija dërguar Kongregatës “Propaganda Fide” mësojmë edhe emrat e famullive të atëhershme: Shkup, Prizren, Has, Gjakovë, Pejë, Kratovë, Prokupë, Novi Pazar, Mali i Zi i Shkupit, Trepça.¹⁰

Vështirësitë ishin të shumëllojshme: largësia e famullive, mungesa e meshtarëve, tradita e gabueshme që mos t’i lejonin vajzat dhe gratë e reja të marrin pjesë në jetën sakramentale përpos një herë në vit, kryesisht të Ejten e Madhe.¹¹

Murtaja po ashtu ishte një armik i rrezikshëm për të krishterë. “*Mali i Zi i Shkupit, me varfëri të madhe. Vitin e kaluar këtu vdiqën 70 veta nga murtaja...*”. Në letërën e 20 shkurtit 1684 Imzot Pjetër Bogdani përshkruan vizitën e tij baritore në këto famulli: në Kratovë, “*famulli e varfër dhe e rrezikuar; Shkup, po ashtu e varfër dhe numri i katolikëve zvogëlobet; Gjakovë, me famullitarin Don Andrea Gjadhri, “person me cilësi të larta, shërben pa pushim dhe i tërheq për mrekulli shpirtat... Në Prizren famullitar Don Tomë Rapasani “duke shërbyer shumë mirë; Novobërdë, famullia më e pasur në Serbi...”*¹²

Ndoshta përshkrimi vijues është përmbledhja e mirë e gjithë baticave dhe zbaticave që i përjetonte Kisha jonë gjatë kohës së Imzot Pjetër Bogdanit, por edhe më vonë, gati gjithnjë. “*Këtu në Serbi katolikët e shkratë ikën para mendjemadhësisë së turqve dhe pranisë së tyre të padurueshme... duke zgjeruar barbaritë e tyre kundër katolikëve, aq më shumë kundër njerëzve të Kishës*”.¹³

Para kësaj gjendjeje vërtet të mjerueshme, arqipeshkvi përdoronte strategji të ndryshme, lëvizte natë e ditë, maskohej dhe vishej si lypës, vizitonte meshtarët dhe popullin e krishterë, ndante sakramentet, përforconte të gjithë në fe dhe në besnikëri ndaj Krishtit dhe kishës së tij.

Aty-këtu strehohej në ndonjë vend, si për shembull në Janjevë, për të shkruar, lexuar, medituar, për t’u lutur, për të mbledhë fuqi të reja shpirtërore. Nga Janjeva më 10 prill 1684 ai shkruante kështu: “*Nuk largohem prej shtëpisë për t’i ikur dyshimeve të Turqve, si dhe për të mos dëgjuar vajtimet e të krishterëve... Zoti i di fatkeqësitë e mia të mëdha...*”¹⁴

Bashkëpunimi me kardinalin Gregorio Barbarigo dhe “Çeta e Profetëve”

Bashkëpunimi me kardinalin Gregorio Barbarigo (1625 -1697), me të cilin ishte njohur dhe kishte shërbyer në Romë, ishte frytdhënës. Ai ishte përgjegjës i Kishës katolike për çështje lindore, dhe si i tillë kishte hapur një shtypshkronjë të veçantë në Padovë, “*Tipografia del Seminario*”, për botime në gjuhën hebraishte, aramaiste dhe arbërishte. Gregorio Barbarigon ishte mik dhe përkrahës i Pjetër Bogdanit, me këtë edhe i Kishës dhe Popullit tonë, si dhe njeri me erudicion dhe mirësi të madhe, bamirësi, përshpirtëri dhe shenjtëri të dalluar. Mu për këto veçori dhe karakteristika, Papa Shën Gjoni XXIII e ka shpallur shenjt në vitin 1958.

Prej vitit 1686 e tutje arqipeshkvi Pjetër Bogdani merrej intensivisht me idenë e kryengritjes së armatosur kundër sundimit osman, në bashkëpunim me gjeneralin Giovanni Norberto Piccolomini (1650-1689), me kontributin e pjesëmarrësve tanë. Në këtë lëmë pati sukses në çlirimin e Prishtinës, por në Prizren mori sëmundjen e mortajës, nga e cila edhe vdiq më 6 dhjetor 1689, ndërsa para disa kohe kishte vdekur edhe gjenerali Piccolomini. Imzot Pjetër Bogdani nuk e kishte lënë të vetmuar Gjeneralin në sëmundje, por e kishte shoqëruar në Prizren, ia kishte ndarë sakramentet, para vdekjes, në shenjë besnikërie dhe bashkëpunimi. Me vdekjen e këtyre dy kolosëve, Piccolominit dhe Bogdanit, vdiq edhe ideja dhe organizimi i kryengritjes së armatosur.¹⁵

Motivet e shkrimit dhe botimit të Çetës së profetëve

1. Atdheu dhe Populli po digjej në robëri të errësirës, *i verbuar me dy mjegulla të zeza mbi faqe, që janë mëkati dhe mosdija*, si pasojë e kësaj edhe robëria. “*Pjetër Bogdani shpreh shqetësimin e përhershëm: lufta me “errësirën e paditurisë” si rrezik më i madh për shpirtat*”.¹⁶
2. Motivi i dytë nuk ishte lavdia e tij, “*por për dobi të shtetës fe*”.¹⁷
3. Për të dhënë një kontribut të madh historik, gjuhësor, patriotik, për vlera të krishtera dhe evropiane, të vërtetat themelore të fesë së krishterë. Vetëdija e tij e lartë fetare, e krishterë, dhe kombëtare, arbërore-shqiptare, e frymëzonin atë për jetë dhe veprim të angazhuar në shumë lëmenj.

Arqipeshkvi Pjetër Bogdani ishte klerik, atdhetar, gjuhëtar, dijetar, filozof, teolog, prozator, poet, luftëtar për liri në të gjitha trojet shqiptare për afro 40 vjet. Mbi të gjitha bari i kujdesshëm për grigjën e besuar, për t'ia mësuar “doktrinën e krishterë”, për t'i mbrojtur nga ortodoksizmi dhe islamizmi. Ai si njeri i “vijës së parë”, pati shumë armiq dhe kundërshtarë, mbi të gjitha, osmanët dhe Patrikanën serbo-ortodokse të Pejës. Ishte një vizionar i jashtëzakonshëm panballkanik për liri, me qëndresë dhe luftë me fuqinë e fesë dhe përkrahjen e atdhedashurisë, që konkretisht domethënë me kulturë dhe qytetërim, tematikë që edhe sot është aktuale, për kërkimin dhe në gjetjen e ndonjë zgjedhjeje fatlume dhe përfundimtare për Ballkanin e trazuar.

Vuajtjen e popullit Shqiptar e krahasonte me vuajtjen e vetë Jezu Krishtit dhe të Virgjërës Mari, duke paraparë fitoren, ngjalljen. Ishte thellë i vetëdijshëm për rrënjët dhe prejardhjen ilire dhe arbërore, duke u kujdesur për pastërtinë shpirtërore dhe gjuhësore, apo pastërtinë e zemrës dhe të shpirtit të Shën Marisë Virgjër, që i krahasonte me pamjet e bukura gjeografike dhe historike të trojeve tona.

Ishte një lloj “*shtegtari*” apo njeriu në ikje dhe në lëvizje, si detyra e bariut për grigjën e besuar, për t'i njohur, parë dhe përkrahur personalisht, por edhe nga përndjekjet e ndryshme turko-otomane.

Në një bisedë me Dr. Ibrahim Rugovën, Presidentin e parë të Kosovës, studiuesin e njohur të Pjetër Bogdanit, e pyeta kështu: Për kë e ka shkruar ai librin Çeta e Profetëve, në një kohë të errët për Popullin tonë, kur nuk kishte shkolla, institucione, populli pothuaj ishte analfabet? Ai më dha këtë përgjigje: edhe atëherë ishte një lloj elite, aristokracie, pra, njerëz të ngritur. Pastaj Bogdani ka dashur ta ngritë nivelin shpirtëror, kulturor dhe gjuhësor të popullit tonë. Mu për këtë ai e ka shkruar dhe botuar këtë libër.

Porosia e jetës dhe veprës së tij

1. Imzot Pjetër Bogdani doli si pishtar i madh në një periudhë të errët dhe shumë të rrezikshme për shuarjen e vetëdijes kombëtare, me

këtë edhe të gjuhës, traditës, kulturës, fesë së krishterë, qytetërimit tonë evropian.

2. Fjalës së shkruar, librit, botimit, dijes, ua beson detyrën për ta luftuar errësirën, mëkatin, të keqen, robërinë, që të jenë “çeta” që do të luftojnë deri te arritja e lirisë së vërtetë nga e keqja, sundimi i huaj, tjetërsimi, harresa, shkrimi në popull anonim, pa identitet dhe personalitet.

3. Përshkrimet e gjendjes së mjerë ndoshta më së miri mund t'i përmbledhin këto fjalë: *“gjithkund vdekje, gjithkund vajë, gjithkund shkeretim, gjithkund përndjekje, gjithkund hidhërim...kishat e mbyllura, meshtarët e shpërndarë, populli në ikeje... Jam i rrethuar në të gjitha anët dhe është një mrekulli që jam gjallë (1687)”*.¹⁸

Atëherë Imzot Pjetër Bogdani ishte i vetmi arqipeshkëv katolik në Ballkan, shkruante ai, dhe tinëzisht kishte hyrë në Prishtinë të Enjten e Madhe, për shugurimin e vajrave të shenjtë, por nuk e di kush dhe si do t'i shpërndajë dhe përdorjë.

4. Për t'u ikur kontrollimeve dhe identifikimeve turke, ai vishej si “lypës”, “tevdil” apo si katundar, kremtonte meshën dhe ndante sakramentet në shtëpi private, ishte vazhdimisht aty ku mundej dhe ku kërkohesh. Figura e tij në popull ka mbetur si legjendë, me shumë emërtime të shpellave dhe vendstrehimeve të “Bogdanit”, ku ai fshihej dhe punonte, lutej, ndante sakramentet, gjatë natës, ndërsa gjatë ditës, pushonte dhe planifikonte hapat dhe vizitat baritore.

Flitet në popull që natën i vizitonte të krishterët, ndërsa ditën tërhiqej në male dhe vende të pabanuara, duke u ngritur në lisa, lidhej për të pushuar dhe për t'u mbrojtur prej bishave të egra. Disa njerëz, duke mos e njohur jetën dhe veprën e tij, ato shpella apo strehime i kanë identifikuar si serbe apo sllave.

5. *“Dija dhe edukimi kishtar”* ishin mjete për ta luftuar sundimin turko-otoman dhe robërinë nga errësira e mosdijes, si dhe skizmën. Këtë ai e shprehte me identitetin e dyfishtë: clericus et libertas, klerik dhe liri. Mu për këtë Imzot Pjetër Bogdani “Çetën e Profetëve” dhe kardinalin Barbarigo e konsideronte si *“një krua i gjallë ku mendja dhe shpirti do të gjejnë kënaqësi dhe shqetësim intelektual, ku shumëkush mund të marrë ujë, e s'do të shterret lehtë..”*; *“Varkë e Noes, strehim i sigurt për çdo njeri të pikëlluar, në të cilin unë vet,*

i trazuar nga uji i furishëm i persekutimeve otomane, gjeta hyrje të sigurt”, apo “ky libër do të jetë një kontribut në arsimimin e njerëzve nga i cili shenjat e shtypit, sikur rrezet e dritës, do t’u përhapin njohuritë e fshehtësive të fesë tonë të shenjt”,¹⁹ gjithsesi ogurmirë për Fe dhe Komb.

Përfundim

Imzot Pjetër Bogdani ishte klerik dhe atdhetar i madh, gjuhëtar dhe dijetar i shquar, shkrimtar me shije estetike dhe luftëtar i paepur për liri të popullit të tij, për çka ai u angazhua edhe në frontin politik e ushtarak, së bashku me fuqitë perëndimore.

Bogdani krahas veprimtarisë kulturore, shpirtërore dhe politike, shkroi edhe një vepër madhore për kulturën shqiptare “Çetën e Profetëve”, me të cilën u bë një fanar ndriçues për kohën e tij dhe brezat e mëvonshëm dhe ndihmoi popullin e tij që t’i shpëtonte dvarjes së plotë të identitetit autokton.

Imzot Pjetër Bogdani ishte besimtar dhe atdhetar i kulluar dhe shumë i dalluar, gjithnjë i frymëzuar dhe në veprim. Ideja e tij për bashkëpunim dhe solidaritet mes popujve, sidomos në luftë kundër robërisë dhe në kërkim të lirisë dhe pavarësisë, kishte nevojë për një organizim panballkanik, si parakusht për të arritur deri te motoja e Çetës së profetëve “*Salva nos Domine, perimus*” – Na shpëto, o Zot, u zhdokëm, (kr. Mt 8, 23 – 27; Mk 4, 35-41; Lk 8, 22-25), mbetet klithje feje dhe shprese, dëshmi dashurie, gjithnjë në emër të Kishës dhe Popullit, drejtuar Zotit, pra, si e tillë aktuale për të gjithë ne.

Referencat:

1. Kr. Gaspër Gjini, Ipeshkvia Shkup – Prizren nëpër shekuj, DRITA, Ferizaj, 1992, f.197.
2. Odette Marquet, Pjetër Bogdani, Letra dhe dokumente nga Arkivi i Kongregatës “de Propaganda Fide” si dhe nga

- Arkivat Sekrete të Vatikanit, Shtëpia botuese “At Gjergj Fishta”, Shkodër, 1997, f. 5.
3. Odette, Marquet, Pjetër Bogdani, vep. e cit, f. 14.
 4. Po aty, f. 20.
 5. Lexo: Odette Marquet, vep. e cit. f.343-344.
 6. Odette Marquet, f. 349; APF SC Servia, 1669 -1760, vol, I ff 71rv – 73 v.
 7. Po aty, f. 354 – 355.
 8. Po aty, f. 381.
 9. Po aty, f. 402.
 10. Lexo: Po aty, f. 399 – 340.
 11. Lexo: Odette Marquet, vep. e cit. f. 414.
 12. Lexo dhe krahaso: Odette Marquet, vep. e cit. f. 415 -4116.
 13. Po aty, f. 420; 423.
 14. Po aty, f. 432 – 433; 437.
 15. Kr. Gaspër Gjini, vep. e cit. f. 197 – 198.
 16. PJETËR Bogdani, përgatitur nga Oedette Marquet, LETËRSHKËMBIM, I peshkëv i Shkodrës dhe Administrator i Arkipeshkvisë së Tivarit, 1660 – 1670, Botimet IDK, Tiranë,m 2016, f. 20.
 17. Kr. Prof. Dr. Arshi Pipa, Bogdani dhe gjuha shqipe, në Imzot Pjetër Bogdani në New York, Seminari për Imzot Pjetër Bogdanin, Fordegam University, New York, Botues Tonin Mirakaj, 2009, f. 78 -87.
 18. At Daniel Gjeçaj, O. F. M. Në Imzot Pjetër BOGDani në New York, ver. E cit. f. 64.
 19. Pjetër Bogdani, Çeta e Profetëve, I, Rilindja, Redaksia e Botimeve, Prishtinë, 1989, f. 55, 67, 69.

KDU 821.18.09 (091)
[811.18 :801.82]:272

Evalda PACI

**CUNEUS PROPHETARUM (1685), NJË VEPËR
MADHORE NË SHËRBIM TË DIJES DHE
ATDHETARISË**

Abstrakt

Në këtë trajtesë janë ndërmendur disa elemente të rëndësishme të natyrës biografike dhe bibliografike mbi njërin nga autorët më të rëndësishëm të historisë së letërsisë së shkruar shqipe e, më saktë, të një periudhe që shënon mirëfilli një etapë themelore të historisë së shkrimit shqip e të lëvrimin të tij. Vepra e një autori si Pjetër Bogdani (Cuneus prophetarum, Patavii, 1685), e paraqitur në një format të veçantë dygjuhësh, përbën një kontribut të vyer në fushë të realizimeve a përpilimeve, që të paraqitura me një natyrë komplekse në pikëpamje ndërtimi e brendie, janë themelore për studimet gjuhësore, letrare dhe tekstologjike shqiptare. Bogdani mbetet një autor mirëfilli ezegjet, përpunues i zellshëm i shqipes dhe i mjeteve shprehëse të saj, ndërkohë që ofron në një optikë shumëdimensionale trajtesa sa filozofike, aq dhe teologjike e shkencore.

Abstract

This article looks at the personality of Pjetër Bogdani in the light of the documentation of the respective time. Firstly, it investigates the contribution of archive and historical research about the precursor of the renaissance of culture and thought. Secondly, Pjetër Bogdani is viewed in

the tradition of Albanian linguistics, literary and textology studies. A special attention is paid to the contribution of antic philosophy and classical literature in a cultural perspective. Furthermore, this study treats issues of text reception in a multidisciplinary optic concerning Pjetër Bogdani as a bibliophile and exegete in a bilingual work (*Cuneus prophetarum*, Patavii, 1685). Finally, I emphasize the work of Pjetër Bogdani in support to the study of European literature, but even to the consolidation of Albanian philobiblical writing tradition.

Në 330-vjetorin e kalimit në amshim të një prej autorëve më në zë të letërsisë së shkruar shqipe, po rendisim disa konsiderata që lidhen kryesisht me veprën e tij madhore që në vitin 1685 pa dritën e shtypit nën një titull kompleks në pikëpamje përmbajtjeje, por dhe kuptimplotë për një sërë arsyesh. Realizimi i një vepre të tillë shpie natyrshëm në hulumtimin e një konteksti që ka të bëjë me zhvillime konkrete në arealin në të cilin kjo e fundit pa dritën e botimit dhe u ushqye nga rrethana që e bënë të mundur daljen e saj në dritë të shtypit. Këto rrethana kanë të bëjnë, para së gjithash, me modele të ngjashme në pikëpamje ndërtimore dhe me një kulturë të caktuar që do të mbështeste dhe konkretizimin në botime të kësaj natyre të veprave si ajo e Bogdanit.

Gjashtëqinda në veçanti (shekulli i botimit të kësaj vepre të Bogdanit) do të shënohet nga ngjarje dhe sprova që kishin qëllim të nënvizonin një ndarje, me shumë gjasë, të pakthyeshme mes katolicizmit dhe luteranizmit, dhe një fakt i tillë dëshmohet dhe me tituj veprash e librash që ilustrojnë një dukuri të tillë. Po ky shekull do të njohë dhe realizime me vlerë të veçantë për nga rëndësia dhe përmbajtja dhe mund të thuhet që pikërisht në drejtim të lëvrimit të shkrimit shqip është një periudhë që njih arritje dhe botime unike. Një distancë kohore jo fort e madhe do të ndajë realizimin e veprës *Cuneus prophetarum* (Patavii, 1685) me daljen në dritë të shtypit të doracakëve doktrinarë që përmbledhin Doktrinën e Kërshtenë të përpiluar së pari nga Roberto Bellarmino S.I., por dhe *Pasëqyrën e të rëfyemit* (*Speculum confessionis*), të cilat mbeten dëshmi të faktit që dhe në viset tona u bënë përpjekjet e duhura për të konkretizuar në pikëpamje përdorimi ardhjen e libërthave që përbënin dhe elementet më themelore të edukimit me nocionet e besimit të krishterë.

Cuneus prophetarum (Patavii, 1685) shënoi ndjeshëm dhe vetë rrugëtimin jetësor të një prelati të kishës shqiptare dhe gjithë përpjekjet që autori vetë përpiqet të rendisë dhe të shpjegojë në *Të Primitë përpara letërarit* e dëshmojnë një fakt të tillë. Çdo vepër dhe aq më tepër një realizim kaq kompleks si nga përmbajtja, si nga vëllimi dhe ndërthurja e krerëve përbërës do të lërë gjurmë të ndjeshme në personalitetin dhe ecurinë

përkatëse të një autori dhe nëse ndiqet qoftë dhe në pikëpamje faktesh sa i kushtoi kjo vepër përpiluesit të saj, do të jetë e qartë që pikërisht për Bogdanin nuk do të jetë më pak e rëndësishme se përmbushja e çdo detyre që mund t'i jetë caktuar në vazhde të veprimtarisë së tij meshtarake dhe baritore. Përballja me një sërë argumentesh që kanë të bëjnë me elemente dogmatike themelore në teologjinë e krishterë do të kërkonte dhe gjetje e përzgjedhje emërtesash të posaçme në gjuhën shqipe dhe një fakt të tillë autori e ndërmend dhe në faqet e *Prefationës* me të cilën introdukton këtë vepër që për hir të së vërtetës gëzoi vëmendje dhe vijon të jetë objekt interesi për disa disiplina studimore.

Të Primitë përpara letërarit në shumë pikëpamje përbën një tekst ekzemplar jo vetëm sa i përket përmbajtjes ndaj modeleve të kohës që ndesheshin në hyrje dhe introduktive veprash që ishin paracaktuar të ishin traktate në disiplina të caktuara, por dhe në lidhje me elemente që kujtojnë, pa asnjë dyshim, qasje të ngjashme të autorëve paraardhës që përpiluan vepra jo krejt të njëjta në përmbajtje, por shumë të afërta sa i përket destinacionit dhe referimit ndaj një rrethi të përcaktuar lexuesish.

Siç dhe është theksuar nga gjurmues paraardhës të veprës dhe përmbajtjes së pjesëve të veçanta të saj, vetë autori merr përsipër të shtjellojë jo pak fakte në parashtrësën tipike me të cilën ka paraprirë një korpus ligjëratash që nuk diferencohen në pikëpamje shkencore nga trajtesat që veçanërisht në atë kohë përpiloheshin duke pasur parasysh sa delikate paraqiteshin argumente që kishin të bënin me nocione themelore teologjike. Fakti që ai vetë ndërmend një gramatikë dygjuhëshe (latinisht e shqip), me gjasë, të përpiluar prej ungjit të tij fort të nderuar, Andre Bogdanit, si pjesë të bibliotekës së tij personale, që do të përbente një tjetër ekzemplar të sprovave për të lëvruar shkrimin shqip dhe për të konsoliduar më tej traditën shkrimore në gjuhën tonë, dëshmon gjithashtu që për të kishte mjaft rëndësi dhe çështja e një kulture librare e shkrimore që pikërisht nga qasja mes gjuhësh që i përfronte dhe një kontekst i rëndësishëm gjeokulturor e bënte më domethënëse dhe përherë aktuale. Në shënimet e tij autografe do të receptohet qartë një interes i tillë, ndërkohë që dhe çështja e botimit sa më korrekt të modeleve librare që

kishin të bënin me doracakë të liturgjisë së përditshme në gjuhën shqipe mbetet gjithashtu në qendër të vëmendjes së tij.

Nëse ka tipare të denja për t'u gjurmuar dhe në pikëpamje vijimësie në këtë veper, për t'u veçuar dhe trajtuar gjerësisht mbeten thëniet jo të pakta të vjela prej vetë autorit nga tekste në gjuhën latine e që vetë referimi i bërë po prej tij në gjuhën shqipe mund të shpjerë me tej çështjen e studimit qasës ndaj përpjekjeve për shqipërimin e tekstit biblik në gjuhën tonë. Në të vërtetë, nëse do të duhej të ndërmerrej një studim gjithëpërfshirës mbi fillesat dhe vijimësinë veper pas vepre të çështjeve të shqipërimit të teksteve specifike nga Besëlidhja e Vjetër dhe ajo e Re në gjuhën tonë, pikërisht *Cuneus prophetarum* (Patavii, 1685) mbetet një binar për t'u ndjekur në përmbajtje dhe në veçori ndërtimore që kanë të bëjnë dhe me përfshirjen si të vetë tekstit ashtu dhe të perifrazimit të tij në ligjëratat kryesore të kësaj vepre.

Pikërisht në *Të primitë përpara letërarit* të tilla thënie e fjali në gjuhën latine dhe shpjegohen nga autori që i ka përzgjedhur për t'i pasur si argumentime ndaj trajtimit që ai merr përsipër të shpjerë deri në fund, po në pjesë të tjera të veprës mundësia e qasjeve kryesisht tekstore dhe semantike është e konsiderueshme, duke përfaqësuar kështu dhe një tjetër mundësi për të pasuruar studimet mbi variantet e teksteve biblike në gjuhën shqipe e më në veçanti në gjuhën e veprave të letërsisë më të hershme tonës. Janë gjithashtu dhe një perspektivë e pranëvënies së ndërtimeve që vijnë të mbijetojnë dhe në të folme të caktuara të shqipes, ndërkohë që shihet që autori i përdor në rangun e përdorimeve me një vlerë të qartë normative.

Modelet e formimit të fjalëve janë një tjetër tipar që dëshmon pasurinë e një vepre që pikërisht për argumentet që ngërthente nuk mund të mos paraqitet në një shkallë të vlerësueshme sa u përket ndërtimeve gjuhësore që do të reflektonin një gamë të gjerë nocionesh që gjithashtu ishin cekur më parë, por brenda formatit të veprave përkatëse si *Meshari* (1555), por dhe doracakët e sipërcituar që u përshtatën dhe u përgatitën në Gjashtëqindën edhe nga Pjetër Budi. Ndërtime që përfaqësojnë dhe prirje të shqipes ndaj sintetizmit gramatikor në përveçime a emërtime të caktuara me vlerë emërore përforcojnë këtë opinion tonin, që mund të

ilustrohet me shembuj nga pjesë të ndryshme të veprës. Larmia e formimeve me ndajshesa (*barrëni, burrëni, kundërshti, kusëri, dekëni, pleqëni etj.*) mbetet një tjetër veçori sa morfologjike, aq dhe semantike për t'u cilësuar, ndërkohë që vetë ndërtimet në të cilat dhe gjurmohen të tilla mjete formimi përbëjnë dëshmi konkrete të një shqipeje të pasur e të pajisur me mjete jo të pakta shprehësie. Për t'u kthyer te përveçime që lidhen me emërtime me interes në pikëpamje të kuptimit, do të citonim si formimin *Bāsi* që ndeshet dhe te *Meshari* e me një numër të konsiderueshëm shembujsh për t'u cituar, ashtu dhe formimin *Krijues* (it.creator), që do të ndeshet dhe me vlerë mbiemërore në sintagma të tipit *Hyji krijues*. (CP, I 11)

Në pikëpamje gjuhësore, *Cuneus prophetarum* (1685) i ka shërbyer konstituimit të një paraqitjeje të gjithanshme të ndërtimeve që nuk janë vetëm emërore dhe mbiemërore, ndërkohë që vetë sistemi foljor i shqipes shtjellohet në një sërë elementesh paradigmatiske që nënvizojnë një pasuri gjedhesh e modelesh që duhen kërkuar në pikëpamje vijimësie dhe në ditët e sotme. Përpilimi në një format dygjuhësh që, pas gjase, nuk ka qenë pikërisht çka dëshironte në krye të herës autori i kësaj vepre, gjithsesi ka bërë të mundur që përjasjet të shtrihen ndaj disa nënsistemesh e ndaj disa përdorimesh që vënë në dukje njëkohësisht veçantinë e secilës prej gjuhëve që u vunë përballë njëra-tjetrës në këtë realizim të vitit 1685. Vepra e Bogdanit ka ndikuar gjerësisht në botimet e mëvona që kishin, para së gjithash, objektivin të viheshin në përdorim në një areal në të cilin gjuha shqipe flitej dhe lëvrohej.

Në pjesën më të madhe të ligjëratave që ndërtojnë këtë vepër janë ndërmarrë për shqyrtim çështje themelore të një doktrine që sigurisht kishte kaluar shekuj të tërë e jo të paktë në pikëpamje konsolidimi dhe përvijimi dogmatik. Në këtë kuptim, gjendemi të paralajmëruar prej vetë autorit të saj që në *Prefationën* e sipërcituar që, përveç detyrimit për t'u përmbajtur një kanoni të caktuar e të cilin sigurisht e studiointe prej vitesh, referimet ndaj burimesh të tjera nuk do të mungonin në krejtë e saj. Në të vërtetë, vetëm po të marrim në analizë burimet referenciale që citohen në mjaft pasazhe të veprës së Bogdanit, do të rezultojë qartë jo vetëm një panoramë komplekse burimore dhe literaturash shkencore, por dhe një

qasje e mirëfilltë ndaj një konteksti kulturor që përfaqësohej dhe në atë shekull nga botime të së njëjtës natyrë e që të paktën në pikëpamje të përdorimit të referencave përkon më së miri dhe me vizionin e autorit tonë. Në vëmendjen e tij bota ebraike do të vijë jo rrallë e përfshirë dhe e trajtuar, ndërkohë që falë angazhimit të tij si përpilues do të parashtrohen pikëpamje dhe do të ndërmenden vepra, bashkë me regjistrat gjuhësorë përkatës që në vështrimin e sotëm kërkojnë një vëmendje pikë së pari kritike.

Janë pjesë të caktuara që lidhen pikërisht me këtë botë dhe me Besëlidhjen e Vjetër që kanë mundësuar dhe rindërtimin e një gjeografie gjuhësore që përbën një tjetër aspekt për t'u hulumtuar në përmbajtjen e saj. Është krejt e qartë që Bogdanit i kanë interesuar në veçanti librat e parë të Besëlidhjes së Vjetër, duke qenë se prej paragrafesh të veçantë, por dhe nga personazhe po aq të veçanta ai vetë ka gjetur fillin tematik që do t'i shërbente në shtjellimin e ligjëratave të veprës së tij. Pjetër Bogdani pothuaj është i vetmi ndër autorët e shekujve që pasojnë *Mesharin* e që u përmbahen kufijve kohorë e tematikë të letërsisë së vjetër shqipe që ndërmerret të sqarojë qenësinë e Hyjit dhe të operojë me emërtesa që në atë kohë duket se kishin fituar njëfarë konsolidimi në konceptim dhe përdorim në një regjistër gjuhësor më të specializuar që ka të bëjë me liturgjinë e përditshme dhe me teologjinë e krishterë. Në një vështrim të parë duket sikur gjerësia tekstore e ligjëratave që e ndërtojnë veprën e tij lejon fare mirë të shtjellohen trajtesa që nuk mund të gjenden në veprat që paraprijnë botimin e *Cuneus prophetarum* (1685), por, nga ana tjetër, vetë qëndrimi që autori shpreh në *Të Primitë përpara Letërarit* e që ka të bëjë me përmbajtjen e qartë të tij ndaj kanoneve kishtare dëshmon se pikërisht një vepër e kësaj natyre do të ishte një sprovë e mirëfilltë për të, aq më tepër në rasë të një përballjeje rresht mbas rreshti me një gjuhë të ndryshme nga shqipja që sigurisht dispononte dhe fjalë e ndërtime të konsoliduara dhe në fushë të ligjërimeve që ishin të përfshira falë tematikës së saj.

Puna e autorit të veprës *Cuneus prophetarum* (1685) me një sërë elementesh, që të përfshira në përmbajtjen e saj kërkonin dhe zgjedhjen e duhur në çdo kuptim, mund të vëzhgohet hap pas hapi në pjesë të veçanta të saj e ndërkohë dhe e vënë në përfaqje me të tjera botime, si ato që

shohin dritën e shtypit para vitit 1685, si dhe më vonë, merr një tjetër perspektivë në pikëpamje vlerësimi dhe konsiderimi.

Sigurisht që formati në të cilin vepra është paraqitur përbën vazhdimisht mundësi për të shqyrtuar dhe zgjedhjet që autori ka realizuar në lidhje me përdorime të caktuara, siç dhe do të veçonim nga ligjërrata që janë ndër më të kujdesuarat prej tij si në përmbajtje, si në pikëpamje citimesh nga burime biblike apo nga patrologjia latine. Nga ana tjetër, dhe vështirësitë për të përshtatur me fjalën e duhur kuptime të nocioneve themelore në një fushë mjaft delikate siç është ajo e teologjisë së krishterë ekzistojnë dhe sot e kësaj dite, pikërisht për të njëjtat raste me të cilat duket se është përballur dhe autori i Çetës së profetëve.

Shohim me vend dhe në objekt të kësaj trajtëse të ndërmendim dhe vlerën që marrin në ditët tona përveçime që autori i sjell siç dhe përdoreshin në atë kohë e që përbëjnë një tjetër dëshmi për këdo që shfaq interes si për emërtesa në pamje të parë të natyrës gjeografike deskriptive, ashtu dhe për çështje të një përndarjeje gjeografike kishtare, që evokon një panoramë komplekse në veçanti sa i përket historisë kishtare të viseve arbërore. Pjetër Bogdani është patjetër pjesë e një kuadri të gjerë historik në të cilin bëjnë pjesë rrethana dhe areale që vijnë të përfaqësojnë lokalitete në të cilat besimi i krishterë kishte një habitat të vetin dhe u bë objekt sprovash në shumë pikëpamje. E dëshmojnë një fakt të tillë jo pak referenca që mund të gjurmohen në relacione baritore të kohës në të cilën jetoi Pjetër Bogdani, por dhe burime që sintetizojnë momente të rëndësishme të historisë së kishës shqiptare, ndër të cilat dhe vëllimi i shtatë i veprës madhore *Illyricum Sacrum* (Farlati), si dhe shënime të tjera që konfirmojnë apo saktësojnë më tej rrethana jetësore që lidhen me angazhimin e autorit tonë në dioqeza dhe ipeshkvi. Për më tepër, vetë Bogdani konfirmon në hyrje të veprës së tij kohëzgjatjen e mbajtjes së detyrës së tij si ipeshkëv i Shkodrës dhe administrator i Tivarit, ndërkohë që në vitin 1677 caktohet prej Papës Inocenti XI arqipeshkëv i Shkupit dhe administrator i krejt regjienisë së Shërbisë. (*Të primitë*, CP, po aty, f.XV).

Autori ka marrë në konsideratë dhe shfaqje zakonore në botën shqiptare të kohës, pikërisht ndërsa u referohet pasazheve të caktuara

biblike dhe jehonës së një tradite të hershme të krishterimit në viset tona. Një dëshmi e këtij fakti mbeten dhe paragrafët kushtuar Pasionës së Krishtit, që ndryshe nga ç'figuron në tekstet e *Mesharit*, emërtohet nga autori me trajta mirëfilli sintetike si *Pësimi*, por që bëjnë të mundur të flitet prej atij vetë për zakone që ndeshen ndë dhe t'Arbënit e të Shërbisë e që lidhen me përjetimin e periudhës së Pashkëve në to.

Vepra e Pjetër Bogdanit e paraqitur para lexuesit të kohës në një format jo fort të zakonitë e që përfaqëson dhe përballjen e shqipes me një gjuhë kulture që ndërkohë dhe në pikëpamje të dëshmime shkrimore në fusha të ndryshme të letrave, kulturës librore dhe dijeve specifike ishte mjaft e lëvruar dhe e afirmuar, ka qenë dhe mbetet shtysë për përpilimin e mjaft punimeve që jo rrallë kanë arritur përmasat e monografive shkencore. Sprova e transkribimit të plotë të saj (2005) është paraprirë nga ndërmarrje që veçanërisht në gjysmën e parë të shekullit të kaluar e në dekadat e para të tij kanë orientuar dhe ndaj leximesh sa tematike, aq dhe edukative ndaj kulturës së shkrimit në gjuhën tonë dhe veçantisë së veprave që sot e kësaj dite i emërtojmë si vepra të letërsisë së vjetër shqipe.

Disponimi i një botimi të plotë kritik e filologjik (Tiranë, 2005) që ka marrë parasysh dhe përballjen në jo pak raste me variantin që qëndron në krah të tekstit shqip të përpiluar prej autorit ka lehtësuar jashtë mase dhe përafrimin me tekstin e përmbajtjen e tij e një fakt i tillë vlen dhe për studentët e fushave të dijës si filologjia dhe studimi historik i teksteve në gjuhën shqipe, një linjë studimore që qëndron dhe në themel të programeve studimore universitare dhe pasuniversitare në albanologji. Prej vitesh në auditorët tanë universitarë është bërë pjesë e një literature të qëndrueshme një botim i tillë i natyrës kritike dhe filologjike i përgatitur me akribi dhe pas një pune të gjatë studimore prej koleges sonë, Anila Omari, që ndërkohë që reflekton një shkollë të veçantë filologjike sa u përket kriterëve të transkribimit të tekstit dhe renditjes së aparatit përkatës kritik, mbetet një ndër instrumentet shkencore dhe didaktike më eficiente në kuptimin e shërbimit që ofron për studentët dhe të interesuarit për studime specialistike në fushë të albanologjisë.¹

¹ Bogdani P., *Cuneus prophetarum (Çeta e profetëve), botim kritik përgatitur nga A.Omari*, ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2005.

Vepra e Pjetër Bogdanit grish përherë dhe ndaj qasjesh me modele të përpilimit të botimeve të ngjashme veçanërisht në shekullin në të cilin kjo e fundit pa dritën e botimit. Në këtë kontekst, dhe vetë referimet e autorit tonë ndaj burimesh letrare, filozofike, por dhe teologjike mbeten një tjetër shtysë për të kërkuar drejt prirjesh të ngjashme dhe në autorë që kishin objektiv të trajtonin argumente të ngjashme e që dhe në pikëpamje të destinacionit të veprave të tyre shihet qartë që ndjekin të njëjtën linjë me Bogdanin. Është pikërisht dhe konteksti veneto-padovan që duket se mbështet të tilla realizime, duke qenë se dhe të dhënat mbi vepra të ngjashme njoftojnë dhe plotësojnë një sërë hipotezash qoftë mbi rrahjen e tematikave komplekse që nuk mungojnë as në *Cuneus Prophetarum* (1685), as në të tjera botime që përkojnë në kohë dhe në hollësi të tjera tematike me këtë të fundit. Nëse do të duhej të flisnim për përputhje në pikëpamje të trajtimit të argumenteve themelore që pikërisht në atë kohë merrnin një rëndësi dhe më të veçantë, por dhe sa u përket burimeve biblike që shërbejnë në raste citimesh dhe trajtesash që shtjellohen mbi argumente që kanë të bëjnë me historinë e besimit dhe me vetë traditën e njohjes së shkrimit të shenjtë, përkimet janë më se të qarta.

Në një vështrim kompleks që, mbi të gjitha, duhet të marrë parasysh përmbajtjen e kësaj vepre në funksion të një konteksti që pikërisht ushqehet nga botime si të natyrës së thjeshtë e didaktike që i shërbenin një edukimi bazilar me nocione të një doktrine që synonte të rrënjosej më bindshëm dhe në kushtet e reformimeve që karakterizojnë veçanërisht Pesëqindën dhe Gjashtëqindën, ashtu dhe nga realizime të një natyre tjetër që duhej të përfaqësonin dhe trajtime të lavdërueshme në fushë të ezegezës dhe analizave të natyrës filozofike e shkencore, do të rinëvizonim që pikërisht kjo vepër e Bogdanit përbën një kulmim në shkrimtari dhe në forcë mendimi për letërsinë e shkruar shqipe, duke qenë se pothuaj çdo lloj objektiv që synohej prej autorit vetë paraqitet i arrirë dhe i denjë t'u shtrohet analizave të disa disiplinave të dijes.

Kjo vepër ka qenë një shtysë e mirëfilltë për ndërmarrjen e studimeve të tematizuara kryesisht në fushë të filologjisë së tekstit, fakt që

dëshmohej nga një sërë përpjekjesh për të sjellë të përshtatura e të pajisura me shënime, po dhe të transkribuara në formate të mirëfillta shkencore pjesë nga vepra apo dhe krejt përmbajtjen e saj. Çdo hap i ndërmarrë në këtë këndvështrim nuk përbën tjetër veç një përafrim të domosdoshëm të brezave me një thesar të mirëfilltë të një trashëgimie jo vetëm gjuhësore, por dhe shpirtërore që gjeti realizimin e vet në një kontekst sa kompleks, aq dhe të vështirë për autorin dhe bashkatdhetarët e tij. Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit dhe reflektimet mbi shtresëzimet tipike që ndeshen në përbërje të tij janë në të vërtetë argumentet më të rrahura prej studiuesve të periudhës në të cilën u realizua kjo vepër dhe të vetë leksikografisë historike si një domen i veçantë në pikëpamje tematike dhe metodologjike. Metodologjia e përafrimit me leksikun e veprës diferencohet në autorë dhe punime (Sciambra, Ashta, Sedaj, Ismajli, Omari), ndërkohë që dhe vetë njohja përherë e më e mirë e shkollave të filologjisë së tekstit dhe pajisja e botimeve kritike e filologjike të veprave të letërsisë së vjetër shqupe me konkordanca dhe me tregues lëndorë që të shpien natyrshëm te fjala dhe konteksti që e përmban atë, përbën hapa të ndjeshëm në pikëpamje të një studimi përherë e më të përshtatshëm të vetë periudhës dhe të fakteve gjuhësore e letrare që e karakterizojnë atë.²

Pjetër Bogdani jeton po aq natyrshëm dhe përmes shënimesh dhe relacionesh baritore që evidentojnë dhe dëshmojnë përkushtimin e tij ndaj një konteksti që ka në vetvete atdheun bashkë me një taban të përshtatshëm për të kultivuar besimin dhe fenë, së cilës ai i ishte kushtuar me vetë jetën e tij. Ndërsa konsultohet një dokumentacion që hedh dritë mbi përpjekjet e tij dhe mbi të tilla dëshmi jete e vepre, orientohemi në një rrugëtim në një kohë relativisht të largët, por që studimet e përqendruara në analiza arkivore dhe tekstore e sjellin reale dhe me ngjyrimet që në të vërtetë kishte kur autori i shënimeve endet në dioqeza dhe kisha për të përforcuar zemrat e njerëzve si një bari i mirë dhe i përkushtuar. Pjetër Bogdani mbetet një figurë komplekse dhe pa dyshim

² Shih në veçanti Omari A., *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2016.

pjesë e pandarë e historisë kombëtare, mishërues i njeriut të përkushtuar që dhe dijen e kulturën shkrimore i vuri në shërbim të një kauze madhore.

Bibliografi:

1. Ashta K., *Disa shënime mbi gjubën e Pjetër Bogdanit*, në Buletin Shkencor, n.2, Shkodër, 1981.
2. Ashta K., *Leksiku historik i gjubës shqipe I*, Shkodër, 1996.
3. Ashta K., *Leksiku historik i gjubës shqipe II*, Tiranë, 1998.
4. Ashta K., *Leksiku historik i gjubës shqipe III*, Tiranë, 2000.
5. Ashta K., *Leksiku historik i gjubës shqipe IV*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2002.
6. Boerio G., *Dizionario del dialetto veneziano*, Reale Tipografia di Giovanni Cecchini, Venezia, 1867.
7. Bogdani P., *Cuneus prophetarum (Çeta e profetëve), botim kritik përgatitur nga A.Omari*, Tiranë, 2005.
8. Budi P., *Poezi, (Parathënia, tejsbkrimi dhe komentet: R.Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
9. Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960.
10. Demiraj B., *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ, 1635), per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
11. Demiraj B., *Grimca biografike për autorët tanë të vjetër. II. Andrea Bogdani(1607-1683); III. Rinia dhe formimi teologjik-intelektual i Pjetër Bogdanit; IV. Gjergj Toliq si hartues i Letrës së Pleqve të Gashit(1689)*, në *Hylli i Dritës*, n.2, 2016.
12. Domi M., *Pjetër Bogdani dhe letërsia e vjetër shqipe*, në *Studime filologjike*, n.4, 1989.
13. Fishta F., *Dorëshkrime të Bibliothekës Nacionale të Parisit*, në *Hylli i Dritës*, n.9, 1938.
14. Fishta F., *Gjurmimet e një mueji në Romë*, në *Hylli i Dritës*, n.10-11, 1940.

15. Fortino C.I., *Shkrimtari dhe koha. Pjetër Bogdani*, në *Hylli i Dritës*, 1995.
16. Ismajli R. *Tekste të vjetra*, Dukagjini-Pejë, 2000.
17. Marlekaj L., *Doli libri më i vjetri i gjubës shqipe*, në *Shëjzat*, nr. 1-2, 1959.
18. Marlekaj L., O.F.M., *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo*, Liantonio editore, Palo del Colle, Bari, 1989.
19. Mjedja N., *Jeta e së lumes Virgjin Mri nxjerrun prej veprës „Cuneus prophetarum“*, Shkodër, 1930.
20. Omari A., *Influenze latino-italiane nel “Cuneus Prophetarum” di Pietro Bogdani*, në: *Cinque secoli di cultura albanese in Sicilia*. Atti del XXVIII Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo – Piana degli Albanesi – Mezzojuso – Contessa Entellina, 16-19 maggio 2002, a cura di Matteo Mandalà, A.C.Mirror, Palermo, 2003.
21. Omari A., *Disa risi në fushën e botimit të teksteve të vjetra shqipe*, në Konferenca shkencore: *Çështje të studimeve diakronike të shqipes*, ASHAK, 2009.
22. Paci E., *Letërsia e vjetër shqipe në kontekstin e historisë së letërsisë shqiptare*, në *Hylli i Dritës*, n.2, 2011.
23. Paci E., *Për një vështrim tekstologjik të Mesharit të Gjon Buzukut*, në *Hylli i Dritës*, n.3, 2011.
24. Paci E., *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011.
25. Paci E., *Dom Ndre Mjedja, promovues i teksteve të vjetra shqipe*, në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 2013.
26. Paci E., *“Hylli i Dritës”, tribunë e përrurimit të studimeve albanologjike*, në *Hylli i Dritës*, numër jubilar me rastin e 100-vjetorit, Shkodër, 2013.
27. Paci E., *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2017.
28. Sciambra M., *Bogdanica (studi su Bogdani e l'opera sua), volume II, saggio sul lessico scientifico e culturale del Bogdani*, Pàtron editore, Bologna, 1965.

29. Sedaj E., *Shqipja arbërore*, Prishtinë, 2002.
30. Zamputi I., *Qëmtime mbi Pjetër Bogdanin*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, n.2, 1963.
31. Zamputi I., *Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare*, në *Studime filologjike* n.3, 1986.
32. Zamputi I., *Les circonstances historiques de la parution du "Missel" de Gjon Buzuku et sa place dans la littérature albanaise*, në *Studia Albanica*, n.1, 1988.
33. Zamputi I., *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjubën shqipe*, në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 1995.

GJUHËSI / LINGUISTICS

KDU 811.118'374
087.5(038)

Anila KANANAJ, Shezai RROKAJ

PËR HARTIMIN E NJË FJALORI TË GJUHËS SHQIPE TË ILUSTRUAR PËR FËMIJË

Abstrakt

Objekt i kësaj kumtese do të jetë hartimi i një fjalori të gjuhës shqipe të ilustruar për fëmijë. Domosdoshmëria e një fjalori shpjegues të shqipes standarde për fëmijët shqiptarë të shkollave nëntëvjeçare është diskutuar shumë herë në komunitetin shkencor shqiptar, por kjo zbraçeti mbetet ende e paplotësuar. Autorët e kësaj trajtese ka kohë që e kanë përqendruar vëmendjen e tyre në këtë çështje, prandaj në kumtesën tonë duam të trajtojmë parimet e përgjithshme dhe kritere të veçanta që hyjnë në punë për të hartuar një vepër të tillë madhore. Konkretisht do të flasim për leksikun bazë të kësaj moshe dhe korpusin prej nga mund të vilet ai. Shumë e rëndësishme është mënyra e paraqitjes, e shpjegimit dhe ilustrimit të lemave me fjali ose grupe fjalësh përfaqësuese të paradigmave përkatëse. Më tej, një fjalor i tillë ka nevojë për informacion gramatikor të veçantë të përshtatshëm për nevojat dhe formimin e kësaj grupmoshe. Gjithashtu, ky fjalor duhet të unifikojë dhe të përmirësojë kriteret leksikore dhe gramatikore që kanë ndjekur fjalorët e mëparshëm të gjuhës shqipe në lidhje me fjalët funksionale si parafjalët, lidhëzat, pjesëzat apo ndajfoljet, të cilat, në shumë raste, paraqiten të paqarta për një fëmijë. E veçantë tjetër e kësaj grupmoshe është nevoja për ilustrime me ngjyra, me foto dhe vizatime të kuptimit të lemave, veçanërisht të lemave që përfaqësojnë sende konkrete. Sigurisht, një fjalor i tillë është bashkëkohor dhe i krahasueshëm me fjalorë të të njëjtut lloj të botuar për gjuhë të tjera me leksikografi shumë të zhvilluar, si: anglishtja, frëngjishtja, etj. Së fundi,

theksojmë se një fjalor shpjegues i shqipes standarde për fëmijët e moshave 6-15 vjeç do të ishte jo vetëm shumë i dobishëm, por edhe një risi për shkollën shqipe dhe gjuhësinë shqiptare, për gjithë komunitetin që merret me edukimin e fëmijëve në gjuhën shqipe në diasporë dhe në hapësirat ku ka popullsi autoktone shqiptare, si dhe për të huajt që dëshirojnë të mësojnë gjuhën shqipe.

Fjalët çelës: *fjalor shpjegues, fjalor i ilustruar, shqipe standarde, fëmijë 6-15 vjeç, parime, kritere.*

Abstract

The focus of this paper will be the development of an Albanian illustrated dictionary for children. The necessity of a dictionary in standard Albanian for Albanian school children has been discussed many times in the Albanian scientific community, but this gap remains yet unfulfilled. The authors of this paper have attributed their attention to this issue for quite some time now, which is why in this paper we want to address the general principles and special criteria that come into play when one writes such a major book. Specifically, we will talk about the basic lexicon of Albanian school age children and the corpus to be used for that. Very important is the way of presenting, explaining, and illustrating the lemmas with specific clauses and phrases for proper paradigms. Furthermore, a dictionary of this kind needs special grammatical information appropriate to the school and cognitive needs of the target group. Also, this dictionary should unify and improve lexical and grammatical criteria followed in previous Albanian dictionaries, especially with regard to functional words such as prepositions, adverbs, conjunctions or particles, which are often unclear not only to a child, but for an adult as well. Another special feature of this age group is the need for colourful illustrations, with photos and drawings that represent the meaning of the lemmas, especially the meanings that refer to concrete objects in the real world. Of course, such a dictionary is certainly contemporary and comparable with dictionaries of the same type that have already been published in languages with highly

developed lexicography, such as English, French, and so on. Finally, we emphasize that a dictionary in standard Albanian for children of ages 6 to 15 would surely be very useful and a novelty for Albanian linguistics and Albanian teaching schools, for the entire community dealing with the education of children in Albanian language, as well as foreigners who wish to learn Albanian.

Key words: *explanatory dictionary, illustrated dictionary, Standard Albanian, 6-15 years old children, principles, criteria.*

1. Hyrje

Fjalor i ilustruar i gjuhës shqipe është fjalor shpjegues themelor i shqipes standarde për fëmijët në shkollat nëntëvjeçare në hapësirat me popullsi autoktone shqiptare, pikësëpari në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, por edhe në diasporë. Fjalori do të ishte ndihmues dhe udhëzues i paçmuar për mësuesin, prindin ose kujdestarin që merret me fëmijët për përgatitjen dhe detyrat e përditshme në lëndën e gjuhës shqipe. Bibliotekat e shkollave dhe të qyteteve në hapësirat shqipfolëse duhet ta disponojnë me patjetër këtë Fjalor, në mënyrë që t'u vijnë në ndihmë të gjithë atyre që duan të forcojnë dhe të thellojnë aftësitë e tyre në gjuhën shqipe. Fjalori mund të përdoret me sukses edhe nga të rriturit, shqiptarë ose të huaj, që duan të mësojnë në gjuhën shqipe.

Ai përbën një mjet të nevojshëm për zhvillimin e gjuhës dhe të kuptuarit e botës për fëmijët. Nëpërmjet përdorimit të rregullt të tij, në letër ose në variant digjital, fëmijët e moshave 6-15 vjeç nxiten të fitojnë themele të forta në gjuhën shqipe, të pasurojnë fjalorin dhe të forcojnë aftësitë për përdorimin e tij. Fjalori përmban 8000 lema, nga të cilat 7000 lema të shpjeguara drejtpërdrejt dhe 1000 lema të shpjeguara në çerdhen e tyre (p.sh., brenda lemës "*magjistar emër mashkullor*" gjendet edhe "*magjistare emër femëror*"), pa përfshirë në këtë numër format joveprore të foljeve. Në fjalor jepen rreth 20000 kuptime në total (për mjaftueshmërinë e fjalëve dhe kuptimeve shiko edhe Stalh, 1999; Treffers-Daller & Milton, 2013; Nippold, 2016). Një numër i tillë fjalësh dhe një rrjet i zgjeruar i strukturave kuptimore e bëjnë këtë *Fjalor* të dobishëm për çdo fëmijë, edhe pse grupmosha është e gjerë. Në këtë mënyrë, në këtë Fjalor çdokush mund të mësojë shumë, si ai fëmijë që ka fjalor pak të zhvilluar, edhe ai që ka fjalor të përpunuar. Për moshat e vogla shërbejnë fotot dhe vizatimet me ngjyra, të cilat përdoren kur kuptimi i fjalës i referohet një sendi konkret në botën reale, si p.sh.: *mace, zog, djalë, det, shtëpi, çadër, gërsbërë, gotë, shishe, etj.* Për moshat më të mëdha, përkufizimet me fjalë janë mënyra kryesore për të shpjeguar fjalët dhe kuptimet e tyre. Për më tepër, fjalitë

përbëjnë mjetin kryesor të ilustrimit të kuptimeve të fjalëve në Fjalor. Kjo është bërë jo vetëm për t'i bërë më të qarta kuptimet, por edhe që përdoruesi të mund të ndërtojë vetë fjali të tjera të ngjashme duke u nisur në fjalitë e dhëna.

Gjithashtu, Fjalori përmban një numër të konsiderueshëm antonimesh, shprehjesh frazeologjike ose sintagmash të qëndrueshme që shoqërojnë lemat në fjalor, informacion leksikor, semantik dhe gramatikor të përshtatur për nevojat e fëmijëve të moshës shkollore, unifikim dhe përmirësim të kriterëve leksikore dhe gramatikore të ndjekura në fjalorët e mëparshëm të gjuhës shqipe në lidhje me fjalët funksionale si: para-fjalët, lidhëzat, pjesëzat apo ndajfoljet, të cilat shpesh paraqiten të paqarta për një fëmijë. Fjalori ofron mbi 15000 fjali ilustruese të kuptimeve të fjalëve, larmi të konteksteve gjuhësore dhe shoqërore të fjalive ilustruese të përzgjedhura, të tilla që ndihmojnë nxënien dhe përvetësimin e shqipes. Gjithashtu, në të janë përdorur mbi 1500 ilustrime me foto ose vizatime. Kuptimi i fjalëve shpjegohet dhe përkufizohet në mënyrë origjinale dhe në përshtatje me zhvillimin gjuhësor e kognitiv të kësaj grupmoshe. Fjalitë që ilustrojnë përdorimin konkret të fjalëve sipas kuptimeve të ndryshme të tyre, japin në të njëjtën kohë informacion të përgjithshëm gjuhësor dhe kulturor, duke e bërë Fjalorin mjet të dobishëm për detyrat dhe esetë shkollore. Për të ndihmuar fëmijët sidomos në detyrat dhe testet e gjuhës, janë dhënë informacione gramatikore shtesë, veçanërisht për foljet. Janë dhënë gjithashtu sinonimet dhe antonimet e fjalëve të ndryshme, aty ku është parë e nevojshme. Në një rubrikë të veçantë janë shpjeguar togjet e qëndrueshme të fjalëve dhe shprehjet frazeologjike më të zakonshme. Në këtë mënyrë, Fjalori i pajis fëmijët me aftësi themelore për të arritur suksesin në shkollë dhe në jetë, teksa ata vazhdojnë të mësojnë nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Theksojmë se ky fjalor nuk është aspak i mërzitshëm, sepse ngjyrat dhe ilustrimet me foto e vizatime, të përgatitura dhe të përzgjedhura me kujdes të veçantë për këtë qëllim, e bëjnë atë shumë tërheqës për syrin.

Përse është i nevojshëm ky Fjalor? Së pari, nëse konsiderojmë përvojën e vendeve të tjera, fjalorët leksikografikë të specializuar për fëmijë janë hartuar prej vitësh. Së dyti, ky Fjalor plotëson kuadrin leksikografik të

nevojshëm për shqipen. Në leksikologjinë shqipe një fjalor i tillë mungon. Së treti, pamundësia e shfrytëzimit të fjalorëve monolingualë ekzistues të shqipes nga kjo grupmoshë për disa arsye: (a) zgjerimi i madh i fjalësit, (b) trajtimi i kuptimeve që kapërcejnë dimensionin e kësaj moshe, (c) zbërthimet kuptimore dhe terminologjia e përdorur në përkufizimet e fjalëve kapërcen aftësitë psiko-gjuhësore të fëmijëve, (d) mungojnë informacione të nevojshme leksiko-gramatikore për një fëmijë të moshës shkollore, (e) mungojnë ngjyrat dhe figurat ilustruese që të lehtësojnë përvetësimin sa më të shpejtë të leksikut. Fjalori ynë i kapërcen këto pengesa. Bota e perceptuar që ofron Fjalori është gati e barabartë me botën e perceptuar nga fëmijët e grupmoshës së përzgjedhur. Bota e perceptuar përfaqësohet nga fjalësi i përzgjedhur, zbërthimi kuptimor i tyre (numri i kuptimeve, renditja e kuptimeve), mënyra e shpjegimit të fjalëve në fjalor (gjuha e thjeshtë e përdorur), shembujt gjuhësorë ilustrues, kryesisht të tipit fjali, ngjyrat në lema dhe ilustrimet me vizatime dhe fotografi. Fjalori është hartuar në mënyrë bashkëkohore dhe është i krahasueshëm me fjalorë të të njëjtit lloj të botuar për anglishten nga shtëpitë botuese prestigjioze Oxford, Longman, DK Children, apo me fjalorët *Le Robert Junior* në frëngjishte.

Përse mund të përdoret ky Fjalor? Përdoruesi i drejtohet fjalorit kur ndeshet në ligjërimin e shkruar ose të folur me një fjalë të re ose një kuptim të ri që nuk e nxjerr dot nga konteksti ku është përdorur. Përdoruesi e hap fjalorin edhe kur ka një detyrë me shkrim ose një prezantim me gojë për të bërë dhe konsultohet me fjalorin se si ta përdorë në mënyrë korrekte, në aspektin kuptimor ose gramatikor, një fjalë që tashmë e njeh, por ka nevojë të sigurohet për përdorimin e saj në kontekstin e duhur. Fjalori mund të përdoret për të verifikuar si shkruhet një fjalë ose fjalëformat e saj, për të konfirmuar ekzistencën e një fjale që e di, për të saktësuar diçka për të cilën është i pasigurt ose i paqartë, për të mësuar sinonimet ose antonimet e një fjale, dhe sigurisht ka edhe përdorues të pasionuar të fjalorëve (Jackson, 2003, f. 28).

Autorët kanë punuar rreth katër vjet për hartimin e Fjalorit. Për të finalizuar këtë vepër, atyre u është dashur të kapërcejnë një mori pengesash, duke filluar nga mungesa e një korpusi gjuhësor të plotë

ekzistues të shqipes, mungesa e një korpusi me tekste gjuhësore dhe letrare të përshtatura për fëmijë të grupmoshave të ndryshme nga specialistët, mungesa e fjalorëve të mëparshëm të specializuar për fëmijë, si dhe mungesa e studimeve në përvetësimin e fjalorit dhe gramatikës së shqipes te nxënësit e shkollave shqipe.

Me këtë Fjalor, autorët plotësojnë një mungesë dhe sjellin një risi për shkollën shqipe dhe gjuhësinë shqiptare, për gjithë komunitetin që merret me edukimin e fëmijëve në gjuhën shqipe në diasporë dhe në hapësirat ku ka popullsi autoktone shqiptare, si dhe për të huajt që dëshirojnë të mësojnë gjuhën shqipe.

2.1. Puna konkrete e bërë për të ndërtuar këtë fjalor

Në fillim u përcaktua fjalësi duke u mbështetur në tekstet shkollore të arsimit nëntëvjeçar. Më tej, fjalësi u testua me tekstet shkollore nga klasa e parë deri në të nëntën (tekste të gjuhës, matematikës, histori, gjeografi, biologji). Fjalësi u testua te fëmijët e moshës shkollore (dy shkolla në Tiranë). Hapi tjetër ishte verifikimi me fjalorët normativë të shqipes. Pasi u përcaktuan kriteret dhe u ndërtua një draft i Fjalorit, ai u testua te fëmijët. Nga testimi morëm rezultatet në vijim. Së pari, u pëlqyen shumë nga nxënësit dhe mësuesit ilustrimet me vizatime dhe fotografi me ngjyra në fjalor. Mësuesit dhe nxënësit u shprehën të kënaqur për ilustrimet me fjali të plota të kuptimeve të fjalëve në fjalor. Gjithashtu, mësuesit vetë pëlqyen në mënyrë të veçantë dhënien e trajtës përfaqësuese të paradigmeve të zgjedhimit të foljeve në kohët e tashme, e pakryer, e kryer e thjeshtë dhe e ardhme në formën veprorë dhe joveprorë të mënyrës dëftore. Ata raportuan se nxënësit e panë këtë si informacion të dobishëm dhe shumë ndihmues. Pas reagimeve të nxënësve, mbiemrat u vendos të paraqiten në Fjalor me njëjën përkatëse të paravendosur dhe në të dyja gjinitë në numrin njëjës. Po kështu, nuk u përdorën shkurtime teknike për klasat e fjalëve. Këto përshtatje erdhën pas testimit të draftit fillestar të Fjalorit në dy shkollat nëntëvjeçare në Tiranë, ku mësuesit na raportuan se nxënësit nuk arrijnë të kuptojnë shkurtime, dhe as njëjën e mbiemrit të vendosur në kllapa prapa tij.

2.2. Tiparet dhe parimet e përgjithshme të *Fjalorit të ilustruar për fëmijë*

Audienca së cilës i drejtohet ky fjalor luan rol të madh, pasi në varësi të nevojave të grupit të përdoruesve, janë vendosur kriteret e përshtatshme dhe është bërë përzgjedhja e informacionit të përfshirë në të. Në hartimin e kriterëve të këtij Fjalori janë marrë parasysh arritjet e leksikografisë shqiptare dhe të huaj (Për leksikografinë shqipe shiko: Kostallari, 1962; FGJSH 1954; FGJSH 1980; FGJSH 2002; FGJSH 2006). Në përputhje me teorinë leksikografike botërore, është traditë që në fjalorët për fëmijë të mos përfshihen të gjitha informacionet që përmban një fjalor për moshë të rritura (Hudson, 1988; Apresjan, 2000; Jackson & Zé Amvela, 2000; Landau, 2001; Jackson, 2003). Për këtë arsye jepet një listë fjalësh më e ngushtë, paraqiten strukturat kuptimore më përfaqësuese dhe relevante dhe përkufizimet jepen me fjalë të thjeshta, si dhe frazeologjia jepet shumë e përzgjedhur. Kjo e përcakton Fjalorin tonë si fjalor të tipit të vogël. Përcaktimi "fjalor i vogël" nuk përfshin edhe vëllimin fizik të fjalorit, sepse grupmosha e fëmijëve ka disa kërkesa specifike të ndryshme nga grupmoshat e rritura. Në këtë aspekt, siç është tradita botërore e fjalorëve shpjegues për fëmijë, ky fjalor përmban ilustrime me fotografi ose vizatime për kuptime specifike të fjalëve. Të gjitha fotografitë dhe vizatimet janë punuar me ngjyra tërheqëse për fëmijët dhe në mënyrë të tillë që të shpjegojnë thjesht dhe të ngulisin në mendje kuptimin e ilustruar. Ilustrimet me fotografi dhe vizatime janë punuar me mjeshtrë nga një disenjator profesionist. Ato janë të gjitha ilustrime origjinale të disenjatorit dhe nuk janë marrë nga interneti apo diku tjetër.

Makro-struktura e Fjalorit përbëhet nga tri pjesë: 1. Parathënia; 2. Trupi; 3. Shtojca. Parathënia shpjegon qëllimin, risinë, tiparet dhe mënyrën e përdorimit nga audienca e synuar. Trupi i Fjalorit përmban në listë alfabetike lemat, të ndara dhe të renditura sipas germave të alfabetit shqip. Shtojca gramatikore përmban tabelat përmbledhëse të eptimit të emrave, mbiemrave, përemrave dhe foljeve në shqipen standarde. Në

mikro-strukturë, Fjalori përmban lemat përkatëse me strukturën e tyre të brendshme specifike për çdo klasë fjalësh. Në fillim jepet lema, kuptimet, sinonimet, shprehjet frazeologjike dhe grupe të qëndrueshme të fjalisë, si dhe antonimet. Sipas Hudson-it (1988), ‘faktet leksikore’ të një fjalori përfshijnë: formën e fjalës (shqiptimi dhe ortografia), strukturën, kuptimin, gramatikën, përdorimin, dhe origjinën e saj. Në Fjalorin tonë respektohen këto kritere, por është parë e arsyeshme që theksat e fjalëve dhe etimologjia të mos përfshihen si kriter i tij. Ndërkaq, identifikimi i klasave të fjalëve për secilën lemë është bërë duke ndjekur traditën e leksikografisë shqipe. Zakonisht, termat përkatës për klasat e fjalëve përdoren të shkurtuar, por në këtë fjalor, për vetë specifikën e tij, për klasat e fjalëve janë shënuar emërtimet e plota dhe nuk janë përdorur shkurtime. *Grafikisht*, lemat në fjalor janë paraqitur me ngjyrë të kuqe të theksuar. *Kuptimet* janë shënuar me numra rendorë në rritje, nëse një fjalë ka më shumë se një kuptim. *Shembujt ilustrues* janë në përgjithësi fjali të plota, por ka edhe grupe fjalësh që përfaqësojnë paradigma të ndryshme semantike ose gramatikore të lemës përkatëse. Shembujt ilustrues shënohen me shkronja të pjerrëta dhe lema përkatëse e përdorur është theksuar në ngjyrë. *Antonimet* shënohen me termin *e kundërta* në fund të strukturës kuptimore të fjalës. Çdo antonim shënohet me një yllth të gjelbër. *Lakimi dhe zgjedhimi i fjalëve* ndjek rregullat e morfologjisë së shqipes. Fleksioni nuk është një veçori idiosinkretike e një leme të caktuar. Për këtë arsye është traditë që të mos përfshihen në fjalor të gjitha fjalëformat që formon një fjalë e caktuar gjatë eptimit të saj. Sidoqoftë, janë bërë disa përjashtime nga ky rregull i përgjithshëm, të cilat do të paraqiten në mënyrë të detajuar më poshtë. *Sinonimia*, si rregull, është dhënë që në përkufizimet e fjalëve. Në rastet e sinonimeve identike, është zgjedhur një prej tyre si referencë dhe është zberthyer kuptimisht. Sinonimet e tjera i referohen të parit pa qenë nevoja të zberthen përsëri kuptimisht. Sa u takon *homonimeve*, në përgjithësi është ruajtur homonimia e zërave përkatës të njohur si të tillë në fjalorë shpjegues të mëparshëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (FGJSH 1954; FGJSH 1980; FGJSH 2002; FGJSH 2006). Nga ana grafike, homonimet janë shënuar me numra rendorë sipër në të djathtë të lemës. Në këtë variant të Fjalorit,

është vendosur që *regjistri i përdorimit* të lemave të mos përfshihet si kriter. Pra, nuk është shënuar nëse një fjalë i përket kryesisht ligjëritimit bisedor, zyrtar, dialektor, krahinor, etj. Arsyeja e parë për këtë është thjeshtimi i strukturës së Fjalorit nga tipare e kritere që paraqesin vështirësi për t'u konsultuar nga grupmosha e synuar. Një arsye tjetër është se një informacion i tillë paraqitet i pjesshëm edhe në fjalorët shpjegues të mëparshëm të shqipes (FGJSH 1954; FGJSH 1980; FGJSH 2002; FGJSH 2006). Një detyrë e tillë mund të përfundohej vetëm kur të kemi në dispozicion një korpus të plotë, i cili të përfshijë edhe kritere të kësaj natyre për gjuhën shqipe. Nga ana tjetër, është shënuar *fusha e përdorimit* për fjalë ose kuptime që i përkasin një fushe të veçantë të shkencës ose teknologjisë. Fjalori respekton *normën letrare të leksikut të shqipes standarde* të pasqyruar tashmë në manualë dhe fjalorë drejtshkrimorë ose shpjegues të gjuhës shqipe (Kostallari et al., 1976; Dhrimo & Memushaj, 2011).

2.3. Fjalësi dhe korpusi

Ky fjalor përmban 8000 lema, të cilat kanë përdorim më të gjerë në fusha të ndryshme të veprimtarisë gjuhësore të folur dhe të shkruar. Në fjalor janë përfshirë lema, përkatësisht kuptime dhe frazeologji, të cilat përfaqësojnë shtresën leksikore dhe semantike më aktive të gjuhës shqipe, kryesisht të shqipes standarde. Në një masë të vogël, ka edhe një numër fjalësh dhe kuptimesh që mund t'i përkasin kryesisht leksikut pasiv, por që paraqiten të domosdoshme për të kuptuar literaturën e detyruar ose të sugjeruar shkollore, emisione të ndryshme radiofonike dhe televizive, etj. Megjithëse bëhet fjalë për një leksik bazik, fjalori përmban edhe një numër fjalësh e kuptimesh të reja, si: *tablet, aplikacion*, etj. Të dhëna të plota mbi fjalët dhe kuptimet e reja të fjalorit tonë do të jepen në një studim të posaçëm në një të ardhme të afërt.

Për të vendosur mbi përkufizimin, renditjen dhe shembujt gjuhësorë ilustrues të kuptimeve u ndërtua nga autorët një *korpus* i posaçëm me synimin që të pasqyrojë sa më gjerë leksikun e synuar të gjuhës shqipe. Korpusi përfshin tekstet e lëndëve shkollore të klasave 1-9 të shtëpive të ndryshme botuese, tekste letrare për fëmijë dhe të rritur. Në

korpus janë përfshirë edhe materiale me përralla popullore të botuara, ose edhe të mbledhura nga interneti. Në një masë të vogël korpusi përmban edhe shkrime nga shtypi i ditës. Pjesa më e madhe e korpusit është me materiale të shkruara në shqipen standarde, por ka në një masë të konsiderueshme edhe tekste të shkruara në gegërisht, siç janë përrallat popullore, shkrime nga Koliqi, Qosja, etj. Ndërtimi i korpusit është mbështetur në teorinë e korpuseve (Atkins et al., 1991). Korpusi është shfrytëzuar me softuerin gjuhësor WordSmith Tools 7, i prodhuar nga Lexical Analysis Software në bashkëpunim me Oxford University Press. Gjithashtu, megjithëse paraqet shumë mangësi për qëllimin tonë, është konsultuar edhe Albanian National Corpus në faqen e tyre online <http://web-corpora.net>.

2.4. Zbërthimi, shpjegimi dhe ilustrimi i kuptimeve të fjalëve

Shpjegimet bëhen me perifrazime të thjeshta dhe sinonime, sa më përfaqësuese për botën e fëmijëve 6-15 vjeç. Jepen vetëm ato kuptime të fjalëve që mendohen të nevojshme për moshën target. Për çdo kuptim jepet një përkufizim i cili është shpjegim i tij. Shpjegimi bëhet në dy mënyra: a) duke zbërthyer çdo kuptim në semat e veta përbërëse, b) duke përdorur sinoniminë në rastet kur këto i përkasin leksikut më aktiv dhe më të njohur për përdoruesin, gjithmonë duke bërë kujdes që të shmanget tautologjia. Fjalët që përdoren për referenca të sinonimisë janë shpjeguar më parë në fjalor dhe me fjalë më të thjeshta se vetë ajo fjalë (Zgusta, 1971, f. 257). *Renditja e kuptimeve* bëhet mbi bazën e frekuencës që na jep korpusi dhe duke pasur parasysh botëkuptimin fëmijënor. Në parim, në fillim jepen kuptimet konkrete, pastaj kuptimet abstrakte të prejardhura prej tyre, më tej kuptimet teknike dhe në fund frazeologjia dhe grupet e qëndrueshme të fjalëve. *Shembujt gjuhësorë ilustrues* janë përzgjedhur që të jenë pedagogjikë dhe të ilustrojnë kuptimet në mënyrë të saktë dhe të thjeshtë. Shembujt gjuhësorë që ilustrojnë kuptimet e fjalëve jepen me shkronja të pjerrëta, ndërsa fjala e ilustruar bëhet me ngjyrë të zezë të theksuar. Antonimet, shprehjet frazeologjike dhe grupet e qëndrueshme

të fjalëve të përfshira brenda strukturës së lemës paraprihen nga simbole të veçanta me ngjyrë për t'i dalluar më lehtë vizualisht.

2.5. Struktura e artikullit për çdo klasë fjalësh

Foljet në Fjalor jepen në trajtën e tyre përfaqësuese, pra në vetën e parë, numri njëjës, koha e tashme, forma veprorë, mënyra dëftore (*lexoj, kap, di*). Për secilën folje është dhënë gjithashtu veta e parë, numri njëjës i kohëve të thjeshta të mënyrës dëftore. Brenda strukturës së një foljeje janë dhënë të njëjtat trajta foljore në mënyrën joveprorë. Shembulli i parë ilustrues të forma joveprorë është gjithnjë përdorimi pësor i foljes. Përdorimi vetvetor i foljes në përgjithësi nuk është shpjeguar më vete, përveç rasteve kur është vlerësuar se është i nevojshëm përkufizimi i tij në mënyrë që të kuptohet nga përdoruesi. Në fund të lemës është dhënë pjesorja e foljes. Si rregull, kuptimi pësor është dhënë i pari. Ai është ilustruar gjithmonë me shembuj, për të dhënë një pamje sa më të qartë të përdorimit të tij dhe për të lehtësuar përvetësimin e kësaj forme. Nëse në formën joveprorë të foljes dalin kuptime të tjera shtesë, të ndryshme nga kuptimet që dalin në formën veprorë të foljes, këto kuptime renditen pas kuptimit pësor të foljes joveprorë. Foljet e zgjedhimit të dytë, që në vetën e parë njëjës mund të dalin me -t, por edhe me -s, janë paraqitur në trajtën e tyre përfaqësuese në të dyja format, duke lënë si lemë përfaqësuese trajtën me -t, p.sh.: **mat** ose **mas**. **Emrat** jepen të trajtën e tyre përfaqësuese, që është rasia emërore trajta e shquar numri njëjës. Fjalëformat që dalin në rasat e tjera në njëjës ose në shumës jemi munduar t'i përfaqësojmë në shembujt ilustrues, sidomos kur ato paraqesin vështirësi ose parregullsi. Janë shënuar me germë të madhe *emrat e përveçëm*. **Mbiemrat** paraqiten në rasën emërore numri njëjës të gjinisë mashkullore dhe femërore. Në rastet kur ata janë të nyjzuar, ata janë shënuar të plotë së bashku me nyjën e tyre të paravendosur. Paravendosja e nyjës nuk ka ndikuar në renditjen alfabetike të mbiemrave. Në fillim shkruhet gjinia mashkullore, pastaj jepet dhe forma përfaqësuese e femërores. Aty ku është e mundur, jepen antonimet. **Përemrat** janë përfaqësuar nga trajta e rasës emërore, veta e parë, numri njëjës. Trajtat e tjera rasore ose supletive

që paraqiten gjatë lakimit të përemrit jepen në tabelën përmbledhëse në fund të fjalorit.

Numërorët paraqiten në trajtën përfaqësuese, me përjashtim të numërorit *tre*, për të cilin jepet edhe gjinia femërore *tri*. **Ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesësat** dhe pasthirrmat paraqiten të ngurta me vetëm një formë përfaqësuese, prandaj ato shoqërohen me informacion gramatikor në lidhje me klasën e fjalëve së cilës i përkasin dhe më tej jepen kuptimet e tyre semantike. Këto përkufizohen në fjalor semantikiisht dhe jo duke u nisur nga funksioni i tyre sintaksor, edhe pse ndonjëherë është e nevojshme t'i referohesh edhe këtij të fundit. Në vijim paraqiten disa shembuj konkretë të lemave të ndryshme të fjalëve, siç janë hartuar në Fjalor.

teshtij folje
teshtija, teshtiva,
do të teshtij

▪ nxjerr papritur dhe pa dashje një rrymë të fortë ajri nga goja dhe hundët

Ai **teshtiu** fort.

Ajo **teshtinte** dhe kollitej.

▪ pjesore **teshtirë**



gjelbëroj folje

gjelbëroja, gjelbërova, do të gjelbëroj

1. ka ngjyrë të gjelbër për shkak të barit, gjetheve dhe bimëve të gjelbra

Qytetin e **gjelbëronin** palmat.

2. mbushet me gjethe, bar e bimë të gjelbra

Druri i ullirit **gjelbëronte**.

3. mbjell bimë dhe pemë të gjelbra
Qytetarët janë munduar që ta **gjelbërojnë** qytetin.

♦ joveprore **gjelbërohet**

gjelbërohej, u gjelbërua, do të gjelbërohet

Toka **u gjelbërua** pasi ra shi.

▪ pjesore **gjelbëruar**

shënoj folje

shënoja, shënova, do të shënoj

1. shkruaj

Ajo **shënoi** emrin dhe e hodhi zarfën në kutinë e postës.

2. i vendos një gërmë, numër, shenjë ose simbol për ta dalluar

Shënojme me A bashkësinë e zogjve dhe me B bashkësinë e lepujve.

3. tregoj diçka, caktoj

Një rrip pishash

shënonte kufirin me detin.

4. kryej diçka me sukses; arrij një rekord ose fitore

Ata **shënuan** gol në fund të minutës së parë.

5. marr shenjë

Ai ngriti pushkën dhe **shënoi**.

6. dëshmon, vë në dukje, thekson
Marrëveshja **shënoi** një hap të rëndësishëm mes dy vendeve.

♦ **joveprore shënohem**

shënohesha, u shënova, do të shënohem

Goli i dytë **u shënu**a me kokë.

▪ pjesore **shënuar**



çift emër mashkullor

1. dy njerëz ose dy gjëra që i përkasin të njëjtit lloj ose që rrinë bashkë

çift kërcimtarësh, çift avionësh

2. dy njerëz që janë të martuar ose në një lidhje romantike

çift i martuar, çift i lumtur

3. dy zogj ose dy kafshë që rrinë bashkë për t'u çiftëzuar ose për punë



Një **çift** pulëbardhash po kërkonin ushqim anës detit.

• ndajfolje: çift

• dy e nga dy

Konkurrentët kërcyen **çift**.

i ëmbël, e ëmbël *m*biemër

1. me sheqer ose me shijen e sheqerit

Dardha është e ëmbël.

2. tërheqës, i këndshëm

Ajo ka fytyrë të ëmbël.

3. i butë, i mirë

Një fjalë e ëmbël të gëzon.

□ e kundërta për **1**: **i hidhur** □ e kundërta për **2,3**: **i**

vrazhdë, i egër

□□□□

mbrapsht ndajfolje

1. nga ana e prapme, jo nga e mbara

E kisha veshur bluzën mbrapsht.

2. prapa



Ai eci mbrapsht. Ktheu mbrapsht andej ng ke ardhur!

3. jo në mënyrën e duhur, keq, ters
E ke kuptuar mbrapsht. Punët shkuan mbrapsht.

midis parafjalë

1. në hapësirën që ndan ose bashkon dy njerëz ose dy sende, mes, përmes



Rruga kalonte midis pishave.

2. në periudhën që ndan dy kohë ose dy ngjarje

Filmi është midis orës 6 dhe 7. E diela

është midis të shtunës dhe të hënës.

3. duke ndarë ose duke përfshirë dy njerëz apo dy sende; në lidhje me, mes, ndërmjet
Duhet të zgjidhja midis ngjyrës blu dhe të verdhë. Isha i pranishëm në bisedën midis atyre të dyve.

4. në mes të dikujt ose diçkaje, përmes

Ai vraponte midis erës dhe shiut.

5. më i madh se numri, masa ose vëllimi i parë, por më i vogël se i dyti
Ky shalqi duhet të peshojë midis 8 dhe 10 kilogramë.

*përdoret me emra dhe përemra në rasën rrjedhore

ai përemërvetor

▪ tregon frymorin ose sendin e gjinisë mashkullore, për të cilin flasim ose që i referohemi

Rrugës takova vëllanë. Ai po shkonte në shkollë.

• përemër dëftor: tregon frymorin, sendin ose idenë e gjinisë mashkullore, që ndodhet larg

personit që flet ose që e kemi më pak në mendje

Ai djalë vrapon shpejt. E pëlqeva atë film.

Përfundime

Në historinë e leksikografisë shqipe është hera e parë që hartohet një fjalor shpjegues i shqipes standarde për fëmijë. Ky fjalor mëton të sjellë rezultatet më të mira duke konsultuar praktikën më të mirë leksikografike vendase, por edhe në gjuhë të tjera si anglisht, italisht, frëngjisht ose gjermanisht.

Parimet e këtij fjalori janë hartuar nga autorët duke u mbështetur në leksikografinë e huaj dhe atë shqiptare. Brenda disa muajsh autorët do të sjellin në duart e përdoruesit këtë Fjalor. Me gjithë punën shumëvjeçare dhe përkushtimin serioz, asnjë vepër leksikografike nuk mund të konsiderohet e mbyllur dhe e përkryer. Autorët mirëpresin sugjerimet e lexuesit, të gjuhëtarëve dhe gjithë dashamirësve të gjuhës shqipe me qëllim që t'i plotësojmë në botime të ardhshme.

Referencat:

1. Apresjan, J. 2000. *Systematic Lexicography*. Translated by Kevin Windle 2000. Oxford University Press: Oxford and New York.
2. Atkins, S, Clear, J., & Ostler, N. (1991). *Corpus Design Criteria*. Marrë nga:
<http://www.natcorp.ox.ac.uk/archive/vault/tgaw02.pdf>
3. Cipo, K., Çabej, E., Domi M., Krajni A., & Myderrizi O.(1954). *Fjalori i gjuhës shqipe*. Tiranë: Instituti i Shkencave.
4. Dhrimo, A. & Memushaj, R. (2011). *Fjalor drejtsbëkërimor i gjuhës shqipe*. Tiranë: Infbotues.
5. Hudson, D. (1988). The linguistic foundations for lexical research and dictionary design. *International Journal of Lexicography*, 1(4), 287–312. <https://doi.org/10.1093/ijl/1.4.287>
6. Jackson, H. & Zé Amvela, E. (2000). *Words, Meaning and Vocabulary: An Introduction to Modern English Lexicology*. London; New York: Cassell.

7. Jackson, H. 2003. *Lexicography: An Introduction*. London and New York: Routledge.
8. Kostallari, A, Thomaj, J., Lloshi, Xh., Samara, M., Kole, J., Daka, P., ... Hidi, A. (1980). *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe (me rreth 41.000 fjalë)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
9. Kostallari, A. 1962. Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhë së sotme shqipe". *Studime Filologjike*, 2, 43-128.
10. Kostallari, A., Domi, M., Lafe, E., & Cikuli, N. (1976). *Fjalor drejtsbërkimor i gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
11. Landau, S. (2001). *Dictionaries: the Art and Craft of Lexicography*. Cambridge: Cambridge University Press.
12. Nippold, M. A. (2016). *Later language development: School-age children, adolescents, and young adults* (4th Ed.). Austin, TX: Pro-Ed. Inc.
13. Stahl, S. A. (1999). *Vocabulary Development: From Reading Research to Practice*. Cambridge Ma: Brookline Books/Lumen Editions.
14. Thomai, J., Samara, M., Haxhillazi, P., Shehu, H., Feka, Th., Memisha, V., & Goga, A. (2006). *Fjalor i Gjuhës Shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
15. Thomai, J., Samara, M., Kole, J., Haxhillazi, P., Shehu, H., Feka, Th., & Sima, K. (2002). *Fjalor i shqipes së sotme (me rreth 35.000 fjalë)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
16. Treffers-Daller, J. & Milton, J. (2013). Vocabulary size revisited: the link between vocabulary size and academic achievement. *Applied Linguistics Review*, 4 (1), 151-172. doi: <https://doi.org/10.1515/applirev20130007>
Available at <http://centaur.reading.ac.uk/29879/>
17. Zgusta, L. (1971). *Manual of Lexicography*. (Reprinted in 2010). Berlin, Germany: de Gruyter Mouton.

Delina BINAJ

**PËRSHKRIMI I STRUKTURAVE GJUHËSORE TË
GJINIZUARA SI SFIDË PËR REFLEKTIMIN E
NDËRTIMIT TË IDENTITETEVE GJINORE NË
GJUHËN SHQIPE**

Abstrakt

Kategoria e gjinisë gramatikore konsiderohet si një kategori qendrore në strukturën e sistemit emëror të shqipes. Sipas gramatikave të shqipes emrat në gjuhën shqipe i përkasin një prej dy klasave gramatikore: femërore dhe mashkullore. Në gjuhën shqipe ka edhe disa emra asnjëanës, por gjinia asnjëanëse tanimë ekziston vetëm si një relik. Si gjuhë me gjini gramatikore, elementet brenda frazave emërore (p.sh. mbiemra, përemra etj.), por edhe ato jashtë frazave emërore (p.sh. përemrat anaforë) përshtaten me gjininë gramatikore të emrit. Si rezultat, gjuha shqipe karakterizohet nga struktura gjuhësore që janë të formësuara në një masë të madhe nga gjinia gramatikore.

Ky punim trajton strukturat gjuhësore të gjinizuara në shqipen e sotme duke u fokusuar te emërtimet e njerëzve. Mënyra se si strukturat gjuhësore të gjinizuara përshkruhen në gramatikat standardizuese legjitimon përdorimin e mashkullores androcentrike si një normë gjuhësore për praktikën e emërtimit të njerëzve duke i bërë gratë të padukshme në gjuhë. Analizat që do të prezantohen në këtë punim bazohen në qasjen konstruktiviste që fokusohet në përdorimin e gjuhës së individëve duke e analizuar atë brenda një konteksti specifik. Më shumë se ta interpretosh gjuhën si një pasqyrë të realitetit shoqëror në një këndvështrim konstruktivist, format gjuhësore konsiderohen elemente të qenësishme të ndërtimit të realiteteve shoqërore. Ky argumentim na mundëson t'i perceptojmë strukturat gjuhësore të gjinizuara jo si të

paracaktuara dhe statike, por si të formuara në kontekste sociale, kulturore dhe në mënyrë diskursive. Në këtë punim do të prezantohen gjetje të bazuara në analizimin e një larmie materialesh duke përfshirë grammatikat, si edhe përdorimin e gjuhës në medie dhe në sferën publike.

Fjalët kyçe: *gjinia gramatikore, identitet gjinor, përkatësi gjinore, konstruktivizëm, mashkullorja androcentrike*

Abstract

Grammatical gender is regarded as a central category in the structure of the Albanian nominal system. According to Albanian grammars, nouns in Albanian belong to one of two grammatical gender classes: feminine and masculine. Albanian also has a neuter gender, however this is no more than a relic. As a language with grammatical gender, elements within Albanian noun phrases (e.g. adjectives, pronouns etc.), but also outside noun phrases (e.g. anaphoric pronouns) require an agreement with the grammatical gender of the noun. In consequence, the Albanian language is characterized by linguistic structures, which are to a large extent shaped by grammatical gender.

This paper will discuss the gendered linguistic structures in contemporary Albanian while putting the focus on personal nouns. The way how gendered linguistic structures are described in standardizing grammars, legitimizes the use of androcentric masculine as a linguistic norm for naming practices of people by making women invisible in language. The analyses, which will be presented, are based on a constructivist approach. It focuses on the language use of individuals analysing them within the specificity of the context. Rather than interpreting language as mirror of the social reality, in a constructivist perspective linguistic forms are seen as crucial elements of shaping social realities. This enables us therefore to perceive gendered linguistic structures not as predetermined and static, but as in social, cultural contexts and hence discursively constructed. This contribution will

provide findings based on the examination of a variety of materials, including grammars as well as language use in the media and in public.

Keywords: *grammatical gender, gender identity, gender affiliation, constructivism, androcentric masculine*

1. Roli i gjuhës në ndërtimin e identiteteve gjinore¹

Angazhimi me temën e ndërtimit të identiteteve gjinore në gjuhë ka një traditë të gjatë në debatin shkencor në Evropë. Impulse të rëndësishme për ngritjen e një disipline të veçantë, atë të gjuhësisë gjinore që studion marrëdhënien midis gjuhës dhe gjinisë, kanë dhënë zhvillimet politike dhe lëvizjet emancipuese, si për shembull lëvizja e grave e viteve 1960 dhe 1970 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Evropën Perëndimore. Gratë e angazhuara në lëvizjen feministe sfiduan në atë kohë strukturat patriarkale në shoqëri dhe tematizuan në këtë kontekst edhe rolin e gjuhës. Gjuha u konsiderua nga lëvizja e grave dhe debati shkencor i iniciuar prej kësaj lëvizjeje jo vetëm si pasqyrë e realitetit shoqëror, por edhe si instrument dhe origjinë e diskriminimit.

Karakterit sociokritik në trajtimin e marrëdhënies midis gjuhës dhe gjinisë, si edhe kritika emancipuese që qëndron në themel të debateve për çështje që i përkasin fushës së gjuhësisë gjinore, kanë bërë që konceptet teorike dhe metodat në këtë disiplinë të reflektohen vazhdimisht dhe të zhvillohen më tej. Në debatin aktual në gjuhësinë gjinore gjuha kuptohet parimisht si përdorim i gjuhës. Përdorimi i gjuhës konsiderohet si çelës për prodhimin e kuptimit. Kjo do të thotë: kuptimi nuk është i dhënë dhe pjesë e pandarë e një forme gjuhësore, por prodhohet në përdorimin e gjuhës. Edhe ideja e një sistemi gjuhësor që i paraprin përdorimit të gjuhës hidhet poshtë. Në vend të kësaj fokusi vendoset në konvencionalizimin dhe autorizimin e gjuhës. Lann Hornscheidt e përshkruan këtë perspektivë konstruktiviste ndaj gjuhës si më poshtë:

Veprimet gjuhësore bazohen në funksionin e tyre ndërveprues në një rend simbolik të prodhuar gjuhësisht, i cili megjithatë nuk kuptohet se i paraprin veprimit gjuhësor, por gjithmonë konfirmohet dhe (ri)prodhohet përsëri vetëm në këtë. Një përsëritje

¹ Realizimi i këtij artikulli është mundësuar në kuadrin e punës sime si punonjëse shkencore në projektin „Gjuha dhe gjinia në Evropën Juglindore“ pranë Universitetit të Humboldt-it në Berlin, të financuar nga *Deutsche Forschungsgemeinschaft* (Fondacioni Gjerman për Kërkimin Shkencor).

e vazhdueshme mund të çojë në konvencionalizimin e një rendi simbolik gjuhësor, i cili nga ana tjetër mund të çojë në një ngurtësim të konceptimit të natyralitetit të vetë këtij. (Hornscheidt 2006: 21)

Një formulim i tillë e hedh poshtë idenë e një realiteti jashtëgjuhësor. Parë nga një këndvështrim konstruktivist, realiteti bëhet i perceptueshëm vetëm nëpërmjet emërimit gjuhësor. Më shumë se ta interpretosh gjuhën si një pasqyrë të realitetit shoqëror, në një këndvështrim konstruktivist format gjuhësore konsiderohen elemente të qenësishme të ndërtimit të realiteteve shoqërore. Për sa i takon të kuptuarit të gjinisë, kjo do të thotë se kategoria e gjinisë nuk është një fenomen natyror (në kuptimin gjini natyrore) – siç reduktohet rëndom, por është një fenomen social-kulturor që konstituohet, ndërtohet dhe negociohet në përdorimin e gjuhës.

Në studimet feministe që prej viteve 1970 bëhet dallimi midis gjinisë sociale „gender“² dhe gjinisë biologjike „seksi“. Ky diferencim bëhet për të dalluar „klasifikimin shoqëror të gjinive nga klasifikimi biologjik, i cili nuk përputhet domosdmesht me këtë“. (Hof 2005: 12) Përdorimi i konceptit të huazuar nga anglishtja „gender“ thekson rëndësinë e ndërvarësive shoqërore dhe implikimeve të tyre mbi marrëdhëniet gjinore. Edhe në hapësirën shqipfolëse në kuadrin e tematizimit dhe studimit të teorive gjinore në publikime të ndryshme të botuara, si p.sh. në Shqipëri, është futur nga gjuha angleze (gender) termi *përkatësi gjinore* për t’u referuar „atributeve shoqërore që mësohen ose përftohen gjatë socializimit si një anëtar i një komuniteti të caktuar“. (Aleanca Gjinore për Zhvillim 2009: 3) Edhe pse termi *përkatësi gjinore* gjen përdorim prej disa vjetësh në hapësirën shqipfolëse, në gramatikat e ndryshme të gjuhës shqipe të botuara deri tani dhe, të njohura për mua, përdorimi i këtij termi nuk reflektohet në përshkrimet përkatëse normative të tyre.

² Termit në anglisht *gender* i korrespondon në gjuhën shqipe termi *përkatësi gjinore*. Shih më poshtë po në këtë paragraf.

2. Marrëdhënia midis kategorisë gramatikore të gjinisë dhe përkatësisë gjinore – domosdoshmëria e një diferencimi konceptual

Marrëdhënia e ngushtë midis gjuhës dhe gjinisë në shqip bëhet e qartë nëpërmjet përdorimit sinonimik të konceptit *gjini* dhe ngatërimit që ndodh si rrjedhojë e kësaj midis kategorisë gramatikore të gjinisë dhe kategorisë sociale të përkatësisë gjinore. Për të dalluar midis të dy kategorizimeve, kategorizimit gramatikor dhe kategorizimit social, në gjuhën shqipe ekziston mundësia për ta përdorur konceptin *gjini* të shoqëruar me përcaktorë si p.sh. *gjini gramatikore*, *gjini femërore*, *mashkullore*, *asnjanëse*. Ndërsa opsioni i shoqërimit me përcaktorë të konceptit *gjini* në gramatikat e shqipes nuk përdoret në mënyrë konsekuente, mbiemrat e përdorur p.sh. *femëror*, *mashkullor* dhe *asnjanës* kanë përsëri kuptim të dyfishtë dhe mund t'u referohen si kategorisë gjuhësore ashtu edhe përkatësisë gjinore. Pra, një dallim midis dy kategorive shpesh mund të bëhet vetëm duke u nisur nga konteksti ku përdorimi konvencional i konceptit *gjini* në gjuhën shqipe si sinonim i emërimit të kategorizimit biologjik *seksi* shpesh sugjeron një interpretim esencialist të lidhjes së ndërsjellë.

Interpretimi esencialist i lidhjes së ndërsjellë midis kategorisë gramatikore dhe kategorisë sociale mund të ilustruhet me këtë citat nga *Gramatika e gjuhës shqipe*, 2002 botuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë:

Për përkatësinë e një emri në një gjini të caktuar, në disa raste luan rol edhe kuptimi leksikor i fjalës. Këtu është fjala për lidhjen ndërmjet gjinisë dhe seksit. Tek emrat e frymorëve (të njerëzve dhe të kafshëve) gjinia lidhet ngushtë me seksin. Emrat mashkullorë që emërtojnë frymorë, tregojnë njerëz ose kafshë përgjithësisht të seksit mashkullor, kurse emrat femërorë të frymorëve tregojnë njerëz ose kafshë përgjithësisht të seksit femëror. Kjo bën që gjinia tek emrat e frymorëve të mos jetë thjesht një kategori gramatikore, por leksiko-gramatikore, sepse një element i kuptimit leksikor të

fjalës (seksi i frymorit) gjen shprehje në anën gramatikore (në përfshirjen e emrit në këtë apo atë gjini). (Agalliu et al. 2002: 89)

Në këtë citat për emërtimin e kategorisë gramatikore përdoret koncepti *gjinë*, dhe, nga ana tjetër, për emërtimin e kategorisë së përkatësisë gjinore përdoret koncepti *seksi*. Në këtë mënyrë bëhet e qartë se përkatësia gjinore në këtë gramatikë kuptohet vetëm si një kategorizim biologjik dhe gjuha si një pasqyrim i realitetit. Kjo implikon një konceptim të gjuhës sikur ajo të ishte përkundrejt realitetit të pasqyruar prej saj një mjet neutral. Barazimi i kategorisë gramatikore me kategorinë sociale pengon njohjen mbi ndërtimin social-kulturor të identiteteve gjinore ku gjuha, siç u tha më sipër, luan një rol realitetbërës. Gjuha nuk është neutrale. Në mënyrën se si gjuha përdoret dhe njerëzit emërtohen me anë të gjuhës, identitete të caktuara bëhen të dukshme dhe identitete të tjera bëhen të padukshme, siç ndodh shpesh, për shembull, me përdorimin androcentrik të gjuhës.

Mashkullorja androcentrike, ose siç quhet ndryshe tradicionalisht mashkullorja gjenerike, është një praktikë konvencionale e emërtimit ku format gramatikore mashkullore përdoren si për emërtimin e burrave ashtu edhe për emërtimin përgjithësues të njerëzve. Në një fjali si për shembull: *Një student i mirë bën pyetje të zgjuara* – forma gramatikore mashkullore *një student* përdoret në mënyrë të konvencionalizuar për emërtimin përgjithësues të njerëzve. Shumë gjuhëtare dhe gjuhëtarë e kritikojnë përdorimin e mashkullores androcentrike, sepse këtu bëhet fjalë për një fenomen të vendosjes në normë të burrit si prototip i njeriut. Në këtë mënyrë burrat kthehen në normë, gratë përkundrazi barazohen me gjininë. Në këtë mënyrë gratë kanë më pak shanse për t'u menduar, perceptuar dhe përfytyruar, siç e vërtetojnë edhe shumë studime për perceptimin që analizojnë çfarë ndikimi dhe çfarë konceptualizimesh gjinore shkaktojnë format gjuhësore të njerëzit.

3. Kategoria gramatikore e gjinisë në gjuhën shqipe dhe mundësitë e emërtimit gjinispecificues të njerëzve

Në *Gramatikën e gjuhës shqipe, 2002* kategoria gramatikore e gjinisë konsiderohet si një kategori me rëndësi qendrore. Emrat në gjuhën shqipe sipas shpjegimeve në këtë gramatikë i përkasin një prej dy klasave gramatikore: femërore dhe mashkullore; vetëm një numër i vogël emrash, që nuk emërtojnë njerëz klasifikohen si asnjëanës.

Për emërtimin e njerëzve në *Gramatikën e gjuhës shqipe, 2002* si edhe në literaturën përkatëse përmenden një spektër i gjerë mjetesh gjuhësore ku theksohet numri i madh dhe produktiviteti i shumë prapashtesave për formimin e emrave. Kështu si prapashtesa shumë produktive për emërtimin gjinizues të njerëzve mund të dallohen prapashtesat e mëposhtme:

Prapashtesat mashkullorizuese produktive: *-(ë)s, -ar, -tar, -or, -tor, -an, -as, -ak, -ist* në fjalëformime si për shembull, mësues, gazetar, shkrimtar, drejtor, politikan, shtetas, boshnjak;

Prapashtesat femërorizuese: prapashtesa shumë e shpeshtë dhe produktive *-e*, si dhe prapashtesa më pak produktive dhe e shpeshtë *-eshë*. Të dyja prapashtesat mund të përdoren për të njëjtat forma fjalësh si për shembull, drejtoreshë/drejtoreshë, poete/poeteshë.

Në *Gramatikën e gjuhës shqipe, 2002* prapashtesat për emërtimin specifikues mashkullor nuk paraqiten si të tilla. Emrat përkatës, që formohen me anë të prapashtesave specifikuese mashkullore trajtohen nën titullin *Formimi prapashtesor* në mënyrë përgjithësuese si emërtime njerëzish. Për dallim nga kjo prapashtesat specifikuese femërore paraqiten nën titullin *Dallimi i gjinisë tek emrat e frymorëve*. Emrat përkatës, që formohen me anë të prapashtesave femërore specifikuese kuptohen si forma femërore ekuivalente të emrave mashkullorë. Nëpërmjet trajtimit të prapashtesave specifikuese femërore nën titullin *Dallimi i gjinisë të emrat për frymorët* gjinia gramatikore femërore shenjohe me gjininë. Specifikimi gjinor në këtë mënyrë paraqitet si identik me identitetin gjinor femëror.

Në *Gramatikën e gjuhës shqipe 2002* përdorimi i formave mashkullore për emërtimin e njerëzve në mënyrë përgjithësuese (androcentrizmi) nuk tematizohet. Duke e shenjuar gjininë gramatikore femërore me gjininë sociale dhe në të kundërt duke e paraqitur gjininë gramatikore mashkullore si neutrale dhe të pashenjuar, format mashkullore për

emërtimin përgjithësues të njerëzve autorizohen si praktika emërtuese të konvencionalizuara në shqipen standarde dhe kthehen në normë.

4. Praktika konvencionale dhe alternative për emërtimin e njerëzve në shqipen e sotme

Për emërtimin e grave në përdorimin aktual të standardizuar të gjuhës shqipe përdoren si rregull format gramatikore femërore – siç përdoren zakonisht format gramatikore mashkullore për emërtimin e burrave – kur bëhet fjalë për persona të veçantë konkretë. Ndërsa format femërore përdoren vetëm për emërtimin gjinispecificues të grave, format mashkullore përdoren si për emërtimin gjinispecificues të burrave ashtu edhe për emërtimin përgjithësues të njerëzve, kur bëhet fjalë për grupe njerëzish më përkatësi gjinore të ndryshme ose të panjohur. Shembujt e mëposhtëm e ilustrojnë këtë:

- (1) **Kryetarja** (*f*) e Kuvendit takon **homologun** (*m*) e saj nga Turqia. (Panorama, 16.05.2012)
- (2) „Gabimin për mungesën e 30% të grave në qeveri, **Kryeministri** (*m*) Berisha e ka korigjuar te përzgjedhja e **këshilltarëve** (*m*). (Shqip, 09.11.2009)

Në shembullin (1) bëhet fjalë për Kryetaren e Kuvendit Jozefina Topalli e cila në periudhën midis viteve 2005 dhe 2013 ka ushtruar këtë funksion të lartë zyrtar në Shqipëri. Pra, bëhet fjalë për një person konkret grua dhe homologun e saj burrë. Në këtë rast ku bëhet fjalë për persona konkretë, përdoret përkatësisht një formë gramatikore femërore dhe një formë gramatikore mashkullore për emërtimin gjinispecificues. Shembulli (2) ilustron përdorimin e konvencionalizuar të formave mashkullore si për emërtimin gjinispecificues ashtu edhe për emërtimin përgjithësues të njerëzve. Personi konkret burrë emërtohet me një formë përkatëse mashkullore. Edhe emërtimi i grupit të personave bëhet me anë të një forme mashkullore. Dhe pse në shembullin (2) nga konteksti është e qartë

se nuk bëhet fjalë vetëm për këshilltarë burra, por edhe për këshilltare gra, përsëri përdoret për emërtim e këtyre personave mashkullorja androcentrike.

Shembujt tregojnë se në përdorimin e konvencionalizuar të gjuhës shqipe format femërore përdoren gjerësisht për emërtimin e grave. Kjo vlen madje edhe në raste të tilla në të cilat gratë ushtrojnë funksione që deri vonë kanë qenë të destinuara për burrat dhe gëzojnë një status të lartë, siç u tregua më sipër. Në raste të tilla përdorimi i formave femërore lidhet me emërtimin e personave konkretë gra. Nëse bëhet fjalë në mënyrë eksplicite për emërtimin e funksionit, pavarësisht nga fakti se personi që e ushtron atë është burrë ose grua, përdoret forma mashkullore.

- (3) Ministria e Kulturës prej kohësh kishte shpallur vendin vakant për postin e **drejtorit** (*m*) të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, post të cilit e ka mbajtur Elvira Diamanti. Përmes një njoftimi zyrtar Ministria e Kulturës bën të ditur se në krye të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit është vendosur **regjisorja** (*f*) Iris Elezi. [...] *Znj. Iris Elezi emërohet në pozicionin “Drejtor (m), në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit”, thuhet në njoftimin e ministrisë. (Dita 14.10.2017)*

Në shembullin (3) bëhet një ndarje midis personit konkret grua që është përzgjedhur për ushtrimin e funksionit drejtues, nga njëra anë, dhe funksionit, nga ana tjetër. Kjo ndarje realizohet me mjete gjuhësore duke përdorur mashkulloren androcentrike, pikërisht formën mashkullore *drejtor* për emërtimin e funksionit. Favorizimi i një forme gjinispecifikuese mashkullore, siç ilustron shembulli, implikon dhe (ri)prodhon një përfytyrim androcentrik, sipas së cilit forma mashkullore shihet përkundrajt formës femërore si neutrale, ndërsa kjo e fundit konsiderohet si e shenjuar ekskluzivisht me gjininë.

Përdorimi i mashkullores androcentrike për emërtimin përgjithësues të njerëzve ndikon në mënyrë të pafavorshme për gratë, sepse ato në krahasim me burrat kanë më pak shanse për t'u menduar dhe për t'u adresuar direkt. Gratë në këtë mënyrë me anë të gjuhës bëhen të

padukshme. Kjo pengon perceptimin e grave dhe eklipson pjesëmarrjen e tyre në shoqëri.

Megjithatë përdorimi i mashkullores androcentrike vlen deri më tani si normë në shqipen standarde dhe vazhvon të mos vihet në pikëpyetje. Një shembull për këtë janë njoftimet për vende pune në sektorin publik. Kështu, për formulimin dhe publikimin e këtyre njoftimeve në portalin online të administratës shtetërore në Shqipëri përdoren vetëm format gramatikore mashkullore në funksionin përgjithësues. (shih Departamenti i administratës publike 2019)

Për dallim nga njoftimet e institucioneve shtetërore të përmendura më sipër dhe përdorimit në to pothuajse pa përjashtim të mashkullores androcentrike, në sektorin privat hasen herë pas here edhe njoftime në të cilat gjejnë përdorim forma alternative emërtuese, si për shembull, përdorimi paralelisht i të dyja formave (femërore dhe mashkullore) ose viza e pjerrët. Me anë të këtyre formave bëhet e qartë se njoftimet u drejtohen si burrave ashtu edhe grave. Një vëzhgim i ofertave për vende pune në sektorin privat tregon se edhe këtu mbizotëron përdorimi i mashkullores androcentrike. Megjithatë, bie në sy përdorimi edhe i formave të tjera alternative siç e tregojnë shembujt e mëposhtëm, si p.sh.: *ofroj vend pune Arkitekt/e, ofroj vend pune Dermatolog/e, ofroj vend pune Drejtor/esh i/e Burimeve Njerezore, ofroj vend pune Ekonomist/e, ofroj vend pune Farmacist/e, ofroj vend pune Jurist/e, ofroj vend pune Korrespondent/e Gazetar/e, ofroj vend pune Perkthyes/Perkthyesë, ofroj vend pune Programues/e Software, ofroj vend pune Receptionist/e, Kamarier/e, Barist/e, Ndihmës/e Kuzhine, ofroj vend pune Shef/e Finance* si dhe *ofroj vend pune Specialist/Specialiste Shitjesh*. (shih njoftime.com 2019)

Në mënyrë që format alternative emërtuese, siç u ilustruan më sipër me shembuj, të hyjnë gjerësisht në përdorimin e përditshëm të gjuhës, janë të nevojshme masa dhe politika gjuhësore, si për shembull, publikimi i udhëzimeve dhe rekomandimeve për mënjanimin e përdorimit seksist të gjuhës. Në shumë vende, si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada dhe Evropë publikime të tilla ekzistojnë. Ato kanë nxitur debatin publik, si dhe kanë rezultuar në iniciativa politike dhe ligjore për një reformë gjuhësore.

5. Konkluzione

Hyrja në përdorim e termit të ri *përkatësi gjinore* mund të konsiderohet si një kontribut për kapërcimin e pikëpamjes biologjike të të kuptuarit të identiteteve gjinore në shoqërinë shqiptare. Në të njëjtën kohë kjo paraqet një sfidë me të cilën duhet të përballet debati gjuhësor në Shqipëri dhe në hapësirën shqipfolëse nisur nga domosdoshmëria për të diferencuar qartë midis kategorisë gramatikore të gjinisë dhe kategorisë sociale të përkatësisë gjinore dhe për të kontribuar në këtë mënyrë në kapërcimin e ngatërrimit deri më sot të këtyre kategorive.

Hartimi i një gramatike të re të gjuhës shqipe duhet të reflektojë trajtimin e kategorisë gramatikore të gjinisë nisur nga pasojat që ka përshkrimi i strukturave të gjinizuara të gjuhës shqipe në ndërtimin e identiteteve gjinore. Mënyra si ndërtohen këto identitete me anë të përshkrimit të strukturave të gjuhës, si edhe paraqitja e mjeteve gjuhësore për emërtimin gjinizues të personave, çon në një marginalizim dhe përjashtim të identiteteve të caktuara gjinore. Një shembull për këtë është normimi i përdorimit të formave mashkullore për emërtimin e njerëzve në mënyrë përgjithësuese. Mashkullorja androcentrike redukton perceptimin e grave dhe pjesëmarrjen e tyre reale në shoqëri. Ka ardhur koha që kjo normë të vihet në pikëpyetje. Në përpjekjet dhe në debatin gjuhësor për hartimin e gramatikave të reja për gjuhën shqipe mashkullorja androcentrike duhet të kapërcehet. Në këtë mënyrë gjuhësia shqiptare ka shansin të tregojë ndërgjegjësimit për rolin realitetbërës të gjuhës dhe të japë një kontribut të rëndësishëm në kapërcimin e ideologjive gjinore dhe emancipimin e shoqërisë.

Referencat:

1. Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, Sh., Dhrimo, A., Hysa, E., Lafa, E., & Likaj, E. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe. 1. Morfologjia*.

Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

2. Aleanca Gjinore për Zhvillim. (2009). *Koncepte dhe përkufizime: Përkatësia gjinore dhe zhvillimi*. Tiranë: Aleanca Gjinore për Zhvillim.
3. Hof, R. (2005). Geschlechterverhältnis und Geschlechterforschung – Kontroversen und Perspektiven. In H. Bußmann & R. Hof (Eds.), *Genus: Geschlechterforschung / Gender Studies in den Kultur- und Sozialwissenschaften. Ein Handbuch* (fq. 2-41). Stuttgart: Alfred Kröner Verlag.
4. Hornscheidt, A. (2006). *Die sprachliche Benennung von Personen aus konstruktivistischer Sicht: Genderspezifizierung und ihre diskursive Verhandlung im heutigen Schwedisch*. Berlin: De Gruyter.

Gazeta:

1. *Dita* 14.10.2017: „Largimi i Elvira Diamantit, ja kush është drejtoresha e re e Arkivit të Filmit“. <http://www.gazetadita.al/largimi-i-elvira-diamantit-ja-kush-eshte-drejtoresha-e-re-e-arkivit-te-filmit/>[04.11.2019]
2. *Panorama* 16.05.2012: „Kreu i Parlamentit turk fton Topallin: Më telefono një javë para“. <http://www.panorama.com.al/kreu-i-parlamentit-turk-fton-topallin-me-telefono-nje-jave-para/>[04.11.2019]
3. *Shqip* 09.11.2009: „Prapavija e re e Kryeministrit“.

Institucione:

1. <http://dap.gov.al/vende-vakante/shpallje> (04.11.2019)
[04.11.2019]

Faqe interneti:

<http://www.njoftime.com/showthread.php?415036-Tirane-ofroj-vend-pune-Arkitekt-e#.Xb8hui2X-b8>
(03.11.2019) [03.11.2019]

<http://www.njoftime.com/showthread.php?439759-Tirane-ofroj-vend-pune-Dermatolog-e#.Xb8kni2X-b8>
(21.10.2019) [03.11.2019]

<http://www.njoftime.com/showthread.php?427362-Prishtine-ofroj-vend-pune-Drejtor-esh-i-e-Burimeve-Njerezore#.Xb8mIS2X-b8>
(05.08.2019) [03.11.2019]

<http://www.njoftime.com/showthread.php?292095-Tirane-ofroj-vend-pune-Ekonomist-e&highlight=ekonomist#.Xb8gQS2X-b8> (11.02.2019) [03.11.2019]

<http://www.njoftime.com/showthread.php?444394-Fier-ofroj-vend-pune-Farmacist-e-Drejtues-Teknik&highlight=farmacist#.Xb8ffY2X-b8>
(31.10.2019) [03.11.2019]

<http://www.njoftime.com/showthread.php?434954-Tirane-ofroj-vend-pune-Jurist-e&highlight=Jurist%2Fe#.Xb8Zay2X-b8>
(29.08.2019) [03.11.2019]

<http://www.njoftime.com/showthread.php?435526-Gjirokaster-ofroj-vend-pune-Korrespondent-e-Gazetar-e-per-Gjirokaster#.Xb8jFy2X-b8> (02.11.2019) [03.11.2019]

<http://www.njoftime.com/showthread.php?111212-Tirane-ofroj-vend-pune-Perkthyes-Perkthyes&highlight=perkthese+ode+perkthyes#.Xb8qrC2X9PN> (30.05.2012) [03.11.2019]

<http://www.njoftime.com/showthread.php?438544-Tirane-ofroj-vend-pune-Programues-e-Software#.Xb8lDC2X-b8>
(20.09.2019) [03.11.2019]

<http://www.njoftime.com/showthread.php?402341-Tirane-ofroj-vend-pune-House-keeping-Receptionist-e-Kamarier-e-Barist-e-Ndihm%EBs-e>

[Kuzhine&highlight=Kamarier%2Fe#.Xb8eFC2X-b8](#)

(20.03.2019) [03.11.2019]

<http://www.njoftime.com/showthread.php?429749-Tirane-ofroj-vend-pune-Shef-e-Finance#.Xb8miy2X-b8> (30.07.2019)

[03.11.2019]

[http://www.njoftime.com/showthread.php?356762-Tirane-ofroj-vend-pune-Specialist-Specialiste-Shitjesh-\(prezantues-e-produkti-ne-Showroom\)#.Xb8n6y2X-b8](http://www.njoftime.com/showthread.php?356762-Tirane-ofroj-vend-pune-Specialist-Specialiste-Shitjesh-(prezantues-e-produkti-ne-Showroom)#.Xb8n6y2X-b8)

(07.04.2018) [03.11.2019]

Elsa SKËNDERI RAKIPLLARI
TRI METAFORA KONCEPTUALE NË
LIGJËRIMIN POLITIK NË SHQIPËRI

Abstrakt

Objekti i këtij artikulli është përdorimi i tri metaforave konceptuale dhe skenarëve metaforikë në diskursin politik shqiptar. Qasja teorike që zbatohet ka të bëjë me analizën kritike të diskursit politik dhe me analizën e mekanizmave gjuhësorë në funksion të strategjisë retorike. Të dhënat empirike për kryerjen e këtij hulumtimi janë vjelë nga procesverbalet e seancave plenare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe nga fjalime a intervista të figurave politike të rëndësishme. Përmes qasjes së Analizës Kritike të Diskursit, vihet re se në tri metafora konceptuale mjaft gjenerike të diskursit politik në Shqipëri, janë PUSHTETI ËSHTË USHQIM, QEVERISJA ËSHTË AUTOMJET dhe MEDIA ËSHTË KAZAN. Ndër përfundimet që arrihen këtë punim, është ai se politika e prekur nga sindromi i ligjërimit populist, i përdor metaforat konceptuale si truk komunikativ, por edhe për të ndërkallur në ligjërim forma të shprehuri dhe të konceptuarit të realitetit, që janë në përputhje me ideologjitë politike përkatëse.

Fjalë kyçe: *metafora konceptuale, varietet diskursiv, diskursi politik, populizmi, Analiza kritike e diskursit.*

Abstract

The aim of this paper is to shed light to the employment of some conceptual metaphors and metaphorical scenarios in the Albanian political discourse. The theoretical framework of the paper is focused on

concepts related to the political discourse, ideology and the analysis of language devices that serve for the rhetorical strategy. The empirical data for this research is collected from the minutes of the plenary sessions of the Albanian Parliament and from various speeches of important political leaders. The conceptual metaphors in this discursive variety are either used in the same way that other Albanian speakers use them or connotatively especially for the sake of polemics, irony and satire. Through a Critical discourse analysis, it is noticed that there are some very generic conceptual metaphors in the Albanian Political Discourse, such as POWER IS FOOD, GOVERNING IS A VEHICLE, and MEDIA IS A CALDRON etc. The present paper draws the conclusion that the Albanian politics suffers the populist syndrome and thus conceptual metaphors could be interpreted as a communicative trick employed not only to address the political adversary but also to interpose textual features that are very common to the daily informal speech of the people.

Key words: *Critical Discourse Analysis, conceptual metaphors, discursive variety, political discourse, populism.*

1. Analiza e ligjërimit politik

Është i njohur fakti se shoqëria shqiptare konsumon shumë politikë dhe se diskursi politik është një ndër diskurset më të lëvruara. Cilësori *politik* është në thelb të ekzistencës njerëzore, këtë e kemi të farkëtuar si ide, që prej Aristotelit, i cili zgjedh ta quajë njeriun kafshë politike. Ndonëse të qenit politik në thënien e Aristotelit, është interpretuar si aftësi për të arsyetuar, thënia përdoret shpesh në çdo kontekst, ku diskutohet për politikën, si edhe për ligjërimit politik. Për të përkufizuar se çfarë është ligjërimit politik duhet të përqendrohemi te autorët dhe aktorët e këtij diskursi, pra te ata që merren me politikë. Por vetëm kaq nuk do të mjaftonte, pasi ka një sërë aktorësh të tjerë të cilët tërthorazi merren me politikë apo janë të ndikuar prej saj. Një prej emrave më të njohur të studimeve të diskursit, T. Van Dijk, shprehet se ligjërimit politik do të konsiderohen “praktikat e të gjithë pjesëmarrësve të përfshirë në procese politike” (Van Dijk, 1998).

Diskursi politik gëzon disa cilësi që e dallojnë atë nga diskurset e tjera, përtej tematikës politike. Të tilla janë: pushteti që gëzojnë një pjesë e pjesëmarrësve të përfshirë në proceset politike, roli si folës model, që fitojnë disa prej këtyre pjesëmarrësve, përdorimi i teknikave retorike për bindjen e audiencës, prirja për të formësuar jo vetëm opinionin e dëgjuesve, por edhe realitetin.

Analiza kritike e diskursit është fusha që merret me studimin e diskurseve në përgjithësi dhe të nxjerrjes në pah të marrëdhënieve të pushtetit në diskurs, të ushtrimit të pushtetit dhe të ideologjisë. Një përbërës thelbësor i diskursit është përbërësi gjuhësor. Ndaj analiza kritike e diskursit shqyrton strategjitë dhe përzgjedhjet e njësisve të caktuara gjuhësore në fragmentet diskursive. Sipas studiuesit N. Fairclough (1995), për ta studiuar diskursin apo një fragment diskursiv lipset që analiza të kryhet në tri nivele: në nivel teksti, praktike diskursi dhe praktike socio-kulturore. Në rastin e ligjërimit politik, analiza e detajuar gjuhësore në nivel teksti, është ajo çka e diferencon në mënyrë të qenësishme analizën

kritike të diskursit nga analiza politike apo komenti politik¹. Nga ana tjetër, analiza tekstore, sipas teknikave të tekstlinguistikës, merret thjesht me njësitë përbërëse dhe ndërtuese të tekstit; pra e studion atë në vetvete dhe për vetvete, pa e çuar interpretimin më tej te praktikat diskursive, efektet retorike apo praktikat socio-kulturore. Thënë thjesht, analiza kritike e diskursit e interpreton tekstin në lidhje me kontekstin diskursiv dhe me kontekstin social e kulturor.

Në një diskurs të tillë si diskursi politik, pushteti dhe ideologjia janë dy përbërës që e ndikojnë mënyrën se si përdoren shenjat dhe e përforcojnë faktin se gjuha është kryekëput në funksion të synimeve të folësve. Një ndër aksiomat teorike të analizës së diskursit është se “diskurset janë ideologjike dhe në to nuk ka shenja arbitrare” (Wodak, Cillia 2006:713). Në këtë kuptim, çdo strukturë e caktuar gjuhësore, strategji diskursive apo element verbal i përdorur në fragmente të diskursit politik, si për shembull, fjalime apo deklarata, nuk mund të konsiderohet si arbitrar apo i rastësishëm. Për t’iu rikthyer N. Fairclough-it dhe modelit të tij të analizës kritike të diskursit, duhet thënë se në nivel teksti, ky studiues sugjeron që, ndër të tjera, të analizohen fjalësi i fragmentit diskursiv (pra i tekstit të dhënë), si dhe metaforat e përdorura. Këto të fundit kanë vlerë të veçantë jo vetëm nga pikëpamja stilistikore e tekstit, por edhe nga pikëpamja konjitive, njohëse. Metafora konceptuale është një mekanizëm gjuhësor mjaft i fuqishëm jo vetëm për të komunikuar në mënyrë të efektshme, por edhe për të ngulitur në ligjërimin e përgjithshëm mënyra të shprehuri, të cilat duke qenë se lidhen me mekanizma konjitivë, mund të shndërrohen edhe në mënyra të menduari.

2. Teoria e metaforave konceptuale

Teoria e metaforave konceptuale është një ndër teoritë që kanë ndryshuar mënyrën sesi janë vështruar tradicionalisht metaforat e metonimitë. Kësisoj, sipas kësaj teorie, të përvijuar nga Lakof-i dhe Johnson-i (1980) në veprën e tyre “Metaphors we live by” , metaforat

¹ Më tepër rreh Analizës kritike të diskursit, shih Skënderi-Rakiplari 2017.

kanë funksion konjitiv, tepër domethënës, sesa thjesht funksion letrar apo artistik. Përtej efektit stilistikor, metaforat janë mekanizma përmes të cilave folësit organizojnë dhe klasifikojnë dijen dhe konceptet. Për të përpunuar informacionin që lidhet me koncepte abstrakte, dukurish të paprekshme, folësit nisen nga konceptet konkrete. Nocionet abstrakte krahasohen me anë të mekanizmit të krahasimit metaforik me nocionet konkrete. Në thënien “më zien koka” trysnia mendore përvijohet si shëmbëllesë konceptuale me enën, ku diçka zien. Pra, njerëzit e njohin trysninë që gjendet në një enë që zien, pasi kjo i përket përvojës së tyre konkrete, të prekshme dhe e përdorin këtë përvojë për të gjuhësuar një përvojë abstrakte si ajo e trysnisë mendore apo psikologjike. Në këtë rast, sipas kësaj metafore konceptuale, koka është enë që zien (p.sh. me tenxheren).

Metaforat konceptuale shndërrohen fitojnë karakter konvencional në gjuhë dhe prirën të formohen përgjithësisht në mënyrë të pavetëdijshme. Kështu, Lakoff-i dhe Turner-i (2009, 51) theksojnë se “Metaforat konceptuale themelore janë pjesë e aparatit të përbashkët konceptual që bashkëndajnë të gjithë anëtarët e një kulture... Zakonisht i kuptojmë këto metafora bazuar në përvojat e përbashkëta. Ato janë kryesisht të pavetëdijshme... Veprimi i tyre në konjicion është kryesisht automatik. (Këto metafora) janë gjerësisht të konvencionalizuara në gjuhë, çka do të thotë se ka një numër tepër të madh fjalësh dhe shprehjesh idiomatike në gjuhë interpretimi i së cilave varet nga këto metafora konceptuale.

Në një artikull tepër të rëndësishëm, të titulluar “Metaforë dhe luftë”, Lakoff-i (1991) e qëmton mekanizmin e metaforës konceptuale në diskursin politik. Ai shprehet se, ndonëse të menduarit metaforik është as i mirë dhe as i keq, sepse abstragimet dhe situatat tepër të ndërlikuara në mënyrë rutinore kuptohen përmes metaforash, në fakt “metafora mund të vrasë” (Lakoff 1991: 25). Autori përpiket të nxjerrë në pah faktin se shpesh përmes metaforave konceptuale e vërteta, që mund të jetë e hidhur, maskohet dhe shërben për t’i fshehur disa aspekte të qenësishme të realitetit. Sipas tij, duke përdorur në mënyrë të pavetëdijshme sistemin e metaforave për të kuptuar realitetin, ajo çfarë arrihet përmes metaforash

është që të kufizohet çfarë është e dukshme dhe të theksohet më tepër ajo çka paraqitet si e vërtetë. Problemi në këtë rast, thekson Lakoff-i, nuk është përdorimi i metaforave konceptuale, por padija për t'i përkapur këto metafora në ligjërimin politik (të luftës) dhe paaftësia për të qëmtuar në mënyrë sistematike çfarë fshehin këto metafora, sepse “metaforat të mbështetura nga bombat mund të vrasin”.

Një tjetër studiues i njohur në fushën e analizës së diskursit politik dhe të metaforave konceptuale, A. Mussolf, thekson se në ligjërimin politik metaforat konceptuale² u japin folësve mundësi që të shprehin dhe të nënkuptojnë qëndrime e pikëpamje nga më ekstremet, nën petkun e një ligjërimi “të ngjyrosur subjektivisht” (Mussolf 2012: 303).

Mekanizmi i metaforave konceptuale iu vjen për shtati ndërtimit të narrativave shpeshherë edhe populiste. Në këtë artikull, që për arsye hapësire dhe kohe nuk mund të qëmtojë larminë e metaforave konceptuale të ligjërimin politik në Shqipëri, do të shqyrtohen disa metafora konceptuale, të cilat janë shfaqur këto tri-katër vjetët e fundit dhe po nguliten dita-ditës në diskursin publik shqiptar.

Sa i takon qasjes metodologjike, është ndjekur modeli i quajtur AKM (Analiza kritike e metaforës) i Charteris-Black (2004). Sipas këtij modeli, analiza kritike e metaforës kalon në tri nivele. Së pari, identifikimi i metaforave, çka arrihet përmes një leximi të kujdesshëm të teksteve dhe gjetjes në to të fjalëve më të shpeshta, që duken se kanë kuptime metaforike. Në rastin tonë, identifikimi i metaforave ka qenë i thjeshtë si pasojë e kontaktit të vazhdueshëm me ligjërimin politik në Shqipëri, për arsye studimore. Dy nivelet e tjera të analizës kritike të metaforës janë: interpretimi i metaforës dhe së treti shpjegimi i saj. Interpretimi i metaforës ka të bëjë me “nxjerrjen në pah të lidhjes mes metaforave dhe faktorëve konjitivë e pragmatikë që i përcaktojnë ato”, që ka të bëjë pikërisht me mënyrën sesi lexuesit e kuptojnë metaforën (Charteris-Black, 2004: 37–8). Ndërsa, shpjegimi i metaforës ka të bëjë me gjetjen e arsyeve ideologjike ose retorike me të cilat lidhet përdorimi i metaforave konceptuale.

² Për më tepër rreth teorisë së Metaforave konceptuale shih Skënderi-Rakiplari 2017: 82-83.

Materialet e analizuara janë mbledhur nga procesverbalet e punimeve të Kuvendit të Shqipërisë, intervista televizive dhe/ose deklarata për shtyp të politikanëve shqiptarë të profilit të lartë.

3. Media është kazan

Metafora konceptuale MEDIA ËSHTË KAZAN është një metaforë shumë e përhapur, që duket se është krijim lingvistik i kryeministrit aktual të Shqipërisë, Edi Rama. Në rastin e kësaj metafore konceptuale, përvijohet një analogji midis *kazanit* dhe medias (që mund të jetë një institucion privat mediatik, portal lajmesh ose madje edhe një gazetar i caktuar, i cili me profilin e tij dhe punën, që kryen, konceptohet si një lloj institucioni mediatik).

Nëse shohim fjalën *kazan* në fjalorin e Gjuhës shqipe, përkufizimi i dhënë për të është: *kazán,-i m. sh. -ë(t) 1. enë e madhe e metalte, që shërben për ujë, për të zier diçka etj.: kazan rakis; gjellë kazan (në ushtri); kazan distilimi (tek.). 2. edhe fig., mospërf. vend a mjedis ku zhvillohet një veprimtari e etshbme; burimi i një sajese a i një trillimi: zjen kazan aty. Siç shihet, kuptimi i dytë që ka zhvilluar fjala është kuptim i figurshëm negativ, mospërfillës. Le të shohim disa fragmente diskursive nga intervistat apo fjalimet e kryeministrit Rama, ku shfaqet kjo metaforë konceptuale.*

Çani (gazetari): Ylli Rakipi?

Rama (kryeministri): Ooo, kazan. Vetëm shikoje foton e tij.

Çani: Po se ka ai fajin që është ashtu.

Çani: Artur Zheji?

Rama: Se di, nuk e ndjek, ku është ky?

Çani: Ka një portal.

Rama: Është kosh, jo kazan.

Çani: Henri Çili?

Rama: Kujt i referohesh? Çani: Gazetës

Mapo... Rama: Ooo, kazan. Çani:

Armand Shkullaku? Rama: Patjetër kazan

Çani: Bushati? Rama: O, thellë na kazan.
Çani: Fatos Lubonja? Rama: Kazan.
Çani: Andi Tela? Rama: Nuk është një person i ekspozuar, nuk është si këta. Kam respekt në distancë.
Çani: Robert Rakiplari?
Rama: Kazan komplet.
Çani: Mustafa Nano?
Rama: Kazan, kazan.
Çani: Artan Hoxha (presidenti)?
Rama: Thellë në kazan, thellë.
Çani: Çim Peka? Rama: Çimi është kazan komplet, asgjë tjetër përveç kazanit.
(Çani, Rama 2019)

...unë nuk e di se ku do shkojnë 100 studentë që janë në vit të parë për gazetari në Elbasan, nuk po llogaris ata që janë në vit e dytë, e me radhë. Me gjithë respektin për këtë profesion kaq të rëndësishëm për sistemin tonë, por e imagjinoj ju se sa kazanë duhen plus për të punësuar gjithë këta njerëz që studiojnë për gazetari?
(Rama 2019a)

Sot pashë edhe disa reagime në kazanin e diasporës për këtë samitin, se dhe diaspora ka kazanët e vet dhe më bëri shumë përshtypje negativiteti reagimeve, njëri thoshte është samiti i vakisë, tjetri i përçarjes e me radhë, por po ti besosh mikut tim budist, Pandeli Majkos të gjitha këto janë shenja të mira (Rama 2019b).

Miqhtë e mi, unë ju jam shumë mirënjohës e mos dëgjoni zhurmën e kazanit. E di që është e vështirë, se mjafton të hapësh televizorin dhe kazanin e ke në shtëpi. Por telekomanda ka shumë numra, kur shfaqet kazanin, çojeni te “Bang-Bang” dhe bëni dy gjëra në të njëjtën kohë, e para, kompenconi kohën që ju keni borxh fëmijëve tuaj; E dyta, nuk i prezantoni fëmijët me gogolin. (Rama 12 tetor 2016)

Zanafilla e kësaj metafore konceptuale në ligjërimin politik shqiptar lidhet me një debat të fortë publik e politik për importin e plehrave në Shqipëri (2016-2017). Asokohe leksema **kazan** ishte shumë e pranishme, për të ilustruar problemet ekzistuese me menaxhimin e mbetjeve urbane, si dhe për të përshkruar procesin e riciklimit të këtyre mbetjeve. Ky debat publik pati si aksion proteste edhe shkrimin e emrave të disa deputetëve të partisë socialiste nëpër kazanët e plehrave të qytetit. Kësisoj diskutimi për importin e plehrave riaktivizoi një sërë përbërësish të fushës leksikore të plehrave, përfshirë këtu edhe leksemën *kazan*. Këtë njësi Edi Rama e rimori dhe e aktivizoi për të shënjuar zhurmën, demagogjinë (sipas tij), diskutimet, pikëpyetjet dhe teoritë e ngritura rreth arsyeve përse po lejohej importi i plehrave nga jashtë, në një kohë kur vetë ai dhe partia e tij dikur në opozitë (2013) e kishin kundërshtuar një ligj të tillë (shih për më tepër Skënderi Rakiplari 2019). Në një intervistë televizive pikërisht për këtë çështje, Rama do të shprehej:

Kur thua ka dalë në shtyp, mos kujto se thua ka dalë te këndi i të vërtetës. Ka dalë në shtyp do me thënë ka dalë në kazan. Dakord? Se për mua, për mua... përmendja e emrave, marrja nëpër gojë e njerëzve, hedhja baltë mbi lloj-lloj njeriu,

që del në shtyp, nuk është ka dalë në shtyp
është ka dalë në kazan... Nëse ju më thoni
a ka njerëz të qeverisë suaj të përfshirë se
ka dalë në shtyp. Unë ju them po ç'po më
thua ka dalë në shtyp, ka dalë në kazan.
(E. Rama 2016).

Më tej, në të gjitha daljet e tij publike, në mënyrë thujtase të rregullt, Edi Rama e ripërdor këtë leksemë tanimë metaforikisht, për ta krahasuar me kazanin herë politikën e opozitës apo të klasës politike, e herë të tjera medien. Veçanërisht metafora MEDIA ËSHTË KAZAN ngulitet në ligjërimin publik thujtase si një klishe ligjërimore.

Kjo metaforë konceptuale është shndërruar në skemë konjitive (njohëse) dhe ekziston një prirje, që kurdo që të flitet për mediet, në varësi të gjykimit të individëve, mediet të klasifikohen si kazanë ose jo. E çelur si hulli diskursive nga kryeministri i vendit, E. Rama, kjo metaforë konceptuale është përhapur së tepërmi. Kjo metaforë konceptuale është shndërruar në skemë konjitive (njohëse) dhe ekziston një prirje që kurdo që të flitet për mediet, në varësi të gjykimit të individëve, mediet të klasifikohen si kazanë ose jo. Herë të tjera, skenari metaforik MEDIA ËSHTË KAZAN aktivizohet edhe në formën: INFORMACIONI MEDIATIK ËSHTË USHQIM, si në rastet e mëposhtme:

Pavarësisht nga gjithë çfarë gatuhet, çfarë
përzihet dhe çfarë i ofrohet publikut prej
kazanit të medieve lidhur me
funksionimin e shtetit... (Rama 2016)

Ligjërata me play back e çadrës së lirisë
ishite tamam si ajo gjella e mbetur nga
dreka, që ngrohet për t'u ngrenë në darkë.
Shpresoj që ta mbaroni atë gjellë. Nuk e
kuptoj sa i madh paska qenë ai kazan.

Mbarojeni dhe kthehuni në debatin real,
konkret, produktiv (Rama 2017).

Duke qenë se politikanët gëzojnë pushtet e prestigj, sidomos politikanët e një rangu të lartë, si kryeministri i një vendi, ata shndërrohen në folës modelë dhe paradigma diskursive që ata çelin, përhapet kësisoj edhe te masa e gjerë e folësve. Kësisoj, metafora konceptuale MEDIA ËSHTË KAZAN është bërë pjesë e diskursit të figurave të tjera politike ose jopolitike: Raste të tilla janë për shembull:

Nuk besoj te këto shkëmbimet që thuhet në media. Larg qoftë t'ia jepnim të gjitha arsyet kazanit për largimin e zotit Xhafaj. U largua për të ruajtur dinjitetin e tij. (E. Spiropali 2018)

Propaganda vijon të shpikë e të servirë lajme të rreme për emrin tim. Sot u njoha me një tjetër fake news nga njëri prej kazanëve të pushtetit, ku më përmend mua si person që paskam përfituar 10 pasuri të paluajtshme në kohën që jam në krye të Bashkisë së Shkodrës. (V. Ademi 2017)

Vazhdon kazani i mediave shqiptare, zjen e zjen e nuk ka të sosur... Po plaçi që vend o ju plastë bomba në dorë. Se mbi të gjitha jeni edhe të pasaktë. Mirë që na ka mbytur injoranca mediatike dhe dashakeqe por të paktën jini koherent... (E. Tarifa këngëtare).

Qytetarët e thjeshtë po ashtu, kur reagojnë me komente nëpër faqet online të mediave të ndryshme shpesh e ripërdorin metaforën

MEDIA ËSHTE KAZAN për të shprehur kundërshtinë e tyre me lajmin e publikuar. Kjo tregon ngulitjen e kësaj metafore konceptuale në ligjërimin publik. Por, si realizohet synimi komunikativ i kryeministrit Rama teksa përdor këtë metaforë konceptuale? Vlen të kujtojmë këtu postulatën e analizës kritike të diskursit “në diskurs nuk ka shenja arbitrare”, gjë që do të thotë se çdo formulim i caktuar gjuhësor është për t’u interpretuar. Duke përdorur një metaforë të tillë konceptuale, Rama jo vetëm arrin të zhvlerësojë informacionin që vjen nga gazetarët, shtypi apo media, që mund të jetë në kundërshtim me qëndrimin e tij politik, por edhe të ngulitë konjitivisht te masa e publikut, faktin se media është e pabesueshme, është kazan.

Pra, ky cilësim denigrues i ka pasojat më afatgjata sesa thjesht në çastin e ligjërimin; ai bëhet shkak për zhvlerësimin *a priori* të rolit dhe funksionit të medias, si pushteti i katërt, i një shteti demokratik. Këtë qëndrim e kanë vënë në pah herë pas here edhe raportet për lirinë e medias në vendin tonë (FEJ 2019, Taylor 2019). Në një raport të Federatës Europiane të Gazetarëve theksohet se, sipas gazetarëve “kur Rama i quan “kazan”, ata përballen me ngacmime të menjëhershme *online* kundër gazetarëve nga pjesëtarë të publikut, të cilët përdorin të njëjtat fraza, si edhe kryeministri e, madje, disa herë, edhe gjuhë më të ashpër dhe kërcënime. ... Delegacioni e ngriti këtë çështje edhe me kryeministrin Rama, i cili i doli në mbrojtje të përdorimit të kësaj gjuhe, por u zotua që në të ardhmen të mos i cilësonte më gazetarët si kazanë” (FEJ 2019).

Rasti në fjalë tregon për domethënien që ka përdorimi i turqizmimeve në diskursin politik, pasi ky ligjërim i riaktivizon ato njësi që më parë mund të kenë qenë periferike e me frekuencë të ulët në fondin e leksikut të shqipes. Duke qenë se politikanët gëzojnë pushtet e prestigj, ata shndërrohen në folës modelë dhe paradigma diskursive që ata çelin, përhapet kësajsoj edhe te masa e gjerë e folësve.

4. Pushteti është ushqim

Një tjetër metaforë konceptuale mjaft gjeneruese, është metafora PUSHTETI ËSHTE ËSHQIM. Në literaturën për metaforat konceptuale

gjedhja më produktive është IDETË JANË USHQIM. Ndërsa PUSHTETI ËSHTË USHQIM është një metaforë konceptuale që në shqipe zanafillën mund ta ketë të shprehja *ha bukë*, kur përdoret me kuptimin “siguron mjetet e jetesës”. Kur dikush merr pushtetin apo të drejtën për të qeverisur në ligjërimin popullor dëgjohen thënie të tipit “është koha që dhe këta të hanë”, që përdoret me idenë është koha që edhe këta të përfitojnë.

Metafora konceptuale PUSHTETI ËSHTË USHQIM fillesën e pati në prag të fushatës zgjedhore të vitit 2017 në Shqipëri dhe u përdor edhe më tej, për t’iu referuar numrit të mandateve parlamentare, që mori partia socialiste, si dhe të drejtës për të krijuar e vetme qeverinë. Në disa raste në kuadër të kësaj metafore konceptuale përdoren metonimi si *tepsi*, *lugë*, *garuzhde* me të cilat gatuhet, shërbehet ose hahet ushqimi. Ndërsa ndër llojet e ushqimeve të përmendura në kuadër të kësaj metafore konceptuale janë: *byreku*, *keku*, *hallva*, *bakllavaja* etj, të cilat janë ndër ato ushqime që përgatiten e serviren përmes një tepsie.

Le të shohim disa shembuj ku përdoret kjo metaforë konceptuale:

Dhe pavarësisht lukut apo romaneve, Ben Blushi është një njeri që ka një lidhje shumë të fortë me tepsinë. Për fat të keq, vazhdon edhe këtu dhe persiston, si zëdhënës i të gjithë atyre që ndihen të privuar në pjesën e tyre të tepsisë, sepse është thënë, është rithënë dhe në fund është bërë jo një ndryshim në qeveri për të ndarë tepsinë. [...] mbas marrëveshjes një lukuni e tërë personazhesh të katundit politik dhe mediatik u turrën për të hedhur baltë mbi marrëveshjen dhe nuk gjetën asnjë mënyrë më elegante për ta bërë këtë, sesa për t’u marrë nga fillimi deri në fund me byrekun, me kekun, me bakllavanë me sultjashin, me paçen dhe me të gjitha

asortimentet e kuzhinës, ku të tërhequr nga erërat dhe nga pangopësia e tyre, shumëkush prej tyre hyn. (Edi Rama 22 maj 2017).

Praktikisht, ju ka sjellë manualin e tepsisë bosh: si të përdorni tepsinë për katër vjetët që vijnë. [...] Ramës i intereson administrimi banal i tepsisë. Ndaj sot, në këtë manualin për përdorimin e tepsisë, ai përmend votimin e emigrantëve [...] Nëse ka një tipar dallues të tepsisë së hallvës që gatuhej katër vjet në qeverisjen e shkuar, ishte destabilizimi i administratës. [...] Sot kenë shpallur riorganizimin e ministrive dhe të institucioneve të varësisë, i cili do ta bëjë administratën të duket si tepsi hasudeje. Në vitin 2017 rrëmbyen mandatin me paratë e drogës dhe të korrupsionit, duke folur vetëm për timon, tepsi dhe tavë. (Bylykbashi 2017).

Kush është pjesë e jona dhe sillet keq me njerëzit nuk është më pjesë e jona. Ne jemi për njerëzit, nuk jemi për pjesën tonë. Nuk kemi marrë votat për ta marrë tepsinë për vete. I kemi marrë votat që ta çojmë tepsinë për skrap. Këtë kemi thënë dhe këtë do bëjmë. Nuk kemi marrë votat që të zgjerojmë hapësirat, ku të fusin duart më shumë njerëz te byreku (Rama 2017). Na thotë që ka qeveri të vogël. Në fakt ka zvogëluar llokmat dhe racionet për të gjithë këta, sepse shumicën e tepsisë e do

për vete. [...] Këtë radhë luftoi që ta kishte të gjithë tepsinë për vete dhe në fakt e mbajti të gjithën për vete. I shikoni këta këtu? Iu ka dhënë jo garuzhde, por nga një lugë, sepse pjesën tjetër të tepsisë e mban në prehër. Ju nuk keni shans këtë mandat të shihni lugën. Mos shpresoni kolegë socialistë. (Noka 2017).

Përbërja e qeverisë është një tepsi e rrotulluar për të provokuar mijëra shqiptarë [...] Do të jetë kabinet nën dhunë, . [...] Cilat janë kriteret e ministrave në tepsinë e dytë të Ramës? Skënderbeu i Elisës erdhi dje në Kuvend me Kalin e Trojës, me atë që programi nuk e ka. Edi Rama e ka bërë në plan ta bëjë të gjithë Shqipërinë një tepsi. (Vokshi 2017).

Çfarë halli kanë ata? Asnjë hall nuk kanë ata. Ata duan tepsinë. Tepsi nuk ka. Ne po luftojmë çdo ditë që tepsinë ta çojmë për skrap. Kemi akoma shumë halle dhe probleme me tepsinë se unë e kam thënë përpara dhe e them dhe sot, sëmundja e tepsisë nuk ishte vetëm e tyre, na kishte prekur dhe ne. Patjetër, kemi dhe ne njerëzi që nuk e meritojnë besimin tonë dhe tuajin dhe do t'i heqim të gjithë. (Rama 2 prill 2019).

Siç shihet nga fragmentet e mësipërme diskursive metafora konceptuale PUSHTETI ËSHTË USHQIM shërben për të krahasuar menaxhimin e pushtetit me menaxhimin e një ene ku qëndron ushqimi.

Qartësisht, paralelen midis të dy fushave, pushtetit (si pjesë e arealjes së të paprekshmes) dhe ushqimit (pjesë e arealjes së konkretes) e përvijon Rama (2019) në fragmentin e mëposhtëm diskursiv:

Është një qeveri që nuk është ndërtuar mbi logjikën e pazareve me parti të tjera, nuk është ndërtuar me logjikën e të ashtuquajturave koalicione, që pastaj e merrnin shtetin dhe e ndanin siç ndahet byreku apo bakllavaja në një tepsi, por është ndërtuar mbi dëshirën e madhe dhe vullnetin për të bashkëqeverisur me njerëzit (Rama 19 shkurt 2019).

Përgjithësisht ushqimet me të cilat krahasohet pushteti janë ushqime të ëmbla dhe që e duan njëfarë përpjekjeje për t'u gatuar, por që edhe janë tipike për kuzhinën tradicionale shqiptare. Për shembull, askush nuk flet për ndonjë tepsi *tiramisuje*, apo për picë, por flitet për bakllava, për hallvë, hasude e byrek.

Por, kur pushteti supozohet se është marrë në mënyrë të paligjshme ose kur keqpërdoret, ushqimet që përmenden janë të hidhura ose të prishura. Përdorime të tilla i shohim në fragmentet diskursive në vijim:

Ata socialistë të ndershëm që nuk kanë zhytur turinjtë, duart apo bërrylat në çorbën e prishur të krimtit dhe të drogës (Basha 28.06.2018).

Manuali i tepsisë, zoti Kryeministër tregon se çfarë hallve po u gatuan ju shqiptarëve për 4 vjetët që vijnë. Sigurisht, që ajo është e hidhur.

(Bylykbashi 2017).

Ndërsa ata që marrin pjesë në menaxhimin e pushtetit krahasohen me instrumentet e kuzhinës, që shërbejnë për të ngrënë ushqimin, siç shfaqet në fragmentet diskursive në vijim:

“...të mbash nën kontroll të përqendruar tepsinë, të cilën e do vetëm për vete. E do për vete dhe me garuzhdet e tua do t’ia ndash krimin, me të cilin ke ardhur në pushtet, dhe oligarkëve me të cilët qeveris”. (Basha, 2017b)

Avazi i vjetër vazhdon me tepsitë të re. Kësaj radhe tepsinë e ke të gjithën për vete, me dy garuzhdet e tua Arben Ahmetaj dhe Damian Gjiknuri dhe disa ministra e tjerë si peceta për të fshirë buzët. (Basha, 2017a).

5. Qeverisja është automjet

Kjo metaforë konceptuale është përdorur gjerësisht nga kryeministri Edi Rama, veçanërisht gjatë fushatës elektorale të vitit 2017. Në hullinë e kësaj metafore konceptuale qeverisja konceptohet si drejtimi i një automjeti, posti i kryeministrit si timonier, aleatët në qeverisje si bashkudhëtarë ose pilotë rezervë.

Aktualisht unë jam kryeministri dhe kam timonin, por nuk e kam vetëm. Domethënë, ka një dorë këtu që e lëviz, ... jo timonin të të prekin, por e ke dëgjuar atë mos i fol shoferit. Tani ti thua pak shumë. Njëri dorë, tjetri një gisht këtu. Edhe ti duhet të çosh makinën përpara. Tjetri thotë ndalu këtu se kam nevojë të zbres pak... edhe ti duhet të ndalosh. Po s’ndalove ta hedh makinën. Tani ajo që

them unë është. Bashkudhëtarët janë histori tjetër. Timonin ma jepni. Më ndihmoni që unë të bëj shumë më tepër për ju. Se në atë moment nuk ka më histori jo po mbaje këtu, se përndryshe kështu, jo po ktheu këtu... Jo s'po i shaj. Kemi bërë shumë gjëra së bashku, po them. Por gjërat që unë mendoj se mund të bëj.. nuk është çështje vetëm. Kjo është çështje... më jepni gjithë përgjegjësinë që unë mos kem nevojë që të bëj sikur s'dëgjoj kur ju flisni gjëra të vërteta, por s'i kam unë në dorë. ... Unë kam këtë program. Ti ke këtë program për të ngarë këtë makinë. Tani unë jam te timoni, timonieri. (Rama 2017)

Në këtë fragment diskursiv bëhet e qartë se si konceptohet metaforikisht pushteti dhe ndarja e pushtetit mes forcave të ndryshme politike. Pretendimet e aleatëve për të PASUR pjesë nga pushteti qeverisës krahasohen metaforikisht me ndërhyrjet te timoni, kërkesën për të marrë pjesë nga makina “*dua serbatorin, dua dy sedilje*” (Rama 2017) ose me çmontimin e makinës. Nga ana tjetër, sipas skenarit metaforik, QEVERISJA ËSHTË AUTOMJET *timoni* është metonimia e makinës dhe kur thuhet jepjani partisë socialiste timonin, në fakt është thënë “jepjani partisë socialiste të drejtën për të qeverisur e vetme”.

Ti do ulësh këtu, je piloti rezervë dhe tani kilometrazhin, stacionet, destinacionin ne do i përcaktojmë bashkë në fillim dhe pastaj jam unë. Programi nuk ka rëndësi këtu. Rëndësi ka tepsia. Ulesh dhe vjen tjetri dhe të thotë. O Ramë, dua... Administrata është makina. Tani nuk mund të vish dhe të thuash unë dua

serbatorin, tjetri thotë unë dua dy sedilje. Ndarja e ministrive në një koalicion është programore, nuk është ndarje copash. Pra unë dua të kem kaq drejtori. Kur voton populli voton thjesht për shoferin, nuk voton për çmontimin e makinës... Po nuk pate timonin, pra po nuk pate autonomi, që tjetri të mos kondicionojë, ... prandaj them jepjani partisë socialiste timonin. (Rama 2017d).

Metafora konceptuale QEVERISJA ËSHTË AUTOMJET përdoret krahas metaforës konceptuale të udhëtimit, ku PIKËSYNIMET E QEVERISJES JANË DESTINACION UDHËTIMI.

Shpresoj që të kemi mundësi që të vijmë në korrik për të bërë një takim më konkret pune pas zgjedhjeve dhe shpresoj shumë që t'ia dalim në zgjedhje dhe në fakt Fatosi e tha bukur mbrëmë nuk është punë timoni, po destinacioni. Ai është edhe shoferi i sprovuar dhe i ka të gjithë ingredientët e nevojshëm të eksperiencës dhe të teknikës së dhënies së makinës për të kuptuar se nuk është qëllim në vetvete (Rama 2017a).

Pas Ramës, skenarin metaforik QEVERISJA ËSHTË AUTOMJET, si dhe metaforat apo metonimitë konceptuale të gjeneruara prej saj, si: KRYEMINISTRI ËSHTË TIMONIER apo QEVERISJA ËSHTË TIMON, filluan që t'i përdornin edhe politikanë të tjerë, veçanërisht të spektrit opozitar. Le të shohim disa fragmente nga fjalimet e deputetëve të opozitës në kuvend:

“Qeveria është kthyer në pronare e vendit. Ajo imponon te qytetarët bindjen se çdo gjë varet prej saj; se e mira dhe e keqja, e drejta dhe e padrejta, e ligjshmja dhe e paligjshmja, përcaktohet vetëm nga qeveria me në krye timonierin me interesat e tij... ai tashmë kishte përgatitur edhe aktin e fundit të manipulimit të zgjedhjeve, për ta pasur për vete atë që ka aq dëshirë të madhe ta thotë, tepsinë e pushtetit, dhe të kthehej në timonierin e pushtetit absolut dhe marrisë absolute... (Mediu 2017, 105)

“Pasi manipuloi dhe bleutimonin për të rrëmbyer gjithë tepsinë si tahmaqar, tani nuk ka më hallin si të qeverisë shqiptarët, por ka merak të madh se si ta drejtojë opozitën përmes diversioneve, blerjeve, presioneve dhe shantazheve.” (Kryemadhi 2017, 113).

Si gjithmonë Rama i mirëfilltë! Pa fillim, pa mes, pa fund, në idetë dhe konceptet e tij. Një njeri i kapur fort pas timonit, me duar që i dridhen, por që nuk posedon as busull klasike, jo më GPS! ... Çështja nuk është timoni, por destinacioni. Ky njeri është kapur fort pas këtij timoni, që në fakt nuk di se nga ta drejtojë. (Dule 2017, 157-158).

Unë prisja që timonieri të na tregonte rrugën se ku do të ecte Shqipëria, por

timonieri nuk e kishte idenë e rrugës. Ai vetëm mbante i gëzuar timonin.... Si u katandisën që edhe 200 mijë shqiptarë të tjerë kanë aplikuar për të ikur në SHBA? Kush i katandisi? Qeveria e parë e këtij timonieri. Pse po vazhdojnë të ikin shqiptarët? Po ikin, sepse kanë parë që ai përveç timonit, ka marrë edhe tepsinë dhe e ka vënë në prehër. (Noka 2017, 173-174).

Siç shihet, skenari metaforik QEVERISJA ËSHTË AUTOMJET dhe PUSHTETI ËSHTË USHQIM janë mjaft të përafërta dhe shpesh në diskursin parlamentar shfaqen së bashku. Por, sidomos te metafora konceptuale QEVERISJA ËSHTË PUSHTET, synimi i Ramës ishte që të shprehte në mënyrë sa më të qartë nevojën për të qeverisur i vetëm, duke e krahasuar qeverisjen me një automjet. Nga ana tjetër kundërshtarët e tij politikë e rimarrin këtë metaforë konceptuale për të treguar instrumentalizimin e pushtetit nga ana e Ramës dhe në përpjekje për të ridikulizuar qasjen e tij simpliste ndaj një detyre të rëndësishme, siç është qeverisja e vendit, të cilën Rama në diskursin e tij politik e ka klasifikuar konjitivisht si të ngjashmen e një automjeti.

5. Përfundime

Siç trajtuam në këtë punim, metaforat konceptuale përgjithësisht formohen në mënyrë automatike e thujtë të pavetëdijshme. Megjithatë, në ligjërimin politik metaforat konceptuale mund të jenë rezultat i një kalkulimi të mirë retorik.

Nisur nga pesha e veçantë që ka ligjërimi politik në Shqipëri, që lidhet edhe me sa shumë politikë konsumojnë shqiptarët në përditshmërinë e tyre, veçanërisht krahasuar, për shembull, me fusha të tjera si arti apo kultura, metaforat konceptuale të ligjërimin politik ndërkalen lehtësisht dhe nguliten në ligjërime të tjera, si ligjërimi mediatik

dhe bisedor. Në ndërkalljen dhe ngulitjen e këtyre metaforave konceptuale rol luan jo vetëm natyra e konvencionalizuar e këtyre shprehjeve gjuhësore, por edhe pushteti e prestigji që gëzojnë politikanët, sidomos figurat qendrore të politikës, si kryeministri, kryetari i opozitës apo deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Ato metafora konceptuale që hasen në diskurset e politikanëve të profilit të lartë zënë vend në mënyrë më të efektshme në ligjërimin politik e më tej edhe në ligjërimet e tjera. Përmes këtyre metaforave konceptuale të cilat janë, në gjykimin tonë, të përdorura jo në mënyrë arbitrare, politikanët përvijojnë narrativën e kahut politik, të cilit i përkasin. Metaforat konceptuale përdoren gjerësisht në funksion të populizmit. Metafora konceptuale MEDIA ËSHTË KAZAN, QEVERISJA ËSHTË AUTOMJET, si dhe metafora PUSHTETI ËSHTË USHQIM evokojnë realie tepër të njohura e të pranishme në përditshmërinë e publikut.

Metaforat konceptuale si modele diskursive në dukje të vetvetishme jo vetëm përkojnë me skemën ekzistuese konjitive të klasifikimit të dukurive të realitetit, por edhe evokojnë ligjërimin popullor. Ndërkallja në një medium ligjërimi të ngritur, siç duhet të jetë ligjërimi në parlament, e njësisive leksikore si kazan, enë kuzhine, lloje ushqimesh etj., është një taktikë, ndër të tjera, edhe populiste, pasi, siç shprehen Mudde dhe Kaltwasser (2017), liderët politikë përgjithësisht flasin me një ligjërim “tavoline” dhe e paraqesin veten si një prej njerëzve të popullit (64). Shmangia nga kodi gjuhësor është një prej mënyrave sesi politikanët rreken ta tregojnë veten në krah të popullit. Pra, funksioni i metaforave konceptuale që trajtuam është i trefishtë: ato jo vetëm injektohen më tej në ligjërim, përmes paraqitjes së modeleve konjitive lehtësisht të pranueshme; shndërrohen në korniza diskursive që shërbejnë për të kuptuar e formësuar më tej realitetin dhe shërbejnë si mekanizma gjuhësorë tepër funksionalë të qasjes populiste në politikë.

Referenca:

1. Charteris-Black, Jonathan. 2004. *Corpus Approach to Critical Metaphor Analysis*. Basingstoke: Palgrave Macmillan.

2. Fairclough, Norman. 1995. *Critical Discourse Analysis*. Londër: Longman.
3. Lakoff, George dhe Turner, Michael. 2009. *More than cool reason: A field guide to poetic metaphor*. University of Chicago press.
4. Lakoff, George. 1991. "Metaphor and war: The metaphor system used to justify war in the Gulf." *Peace Research* (1991): 25-32.
5. Mudde, Cas, Cristóbal Rovira Kaltwasser. 2017. *Populism: A very short introduction*. Oxford University Press.
6. Mussolf, Zlatan. 2004. "The study of metaphor as part of critical discourse analysis", në *Critical Discourse Studies*, 9:3, fq. 301-310.
7. Skënderi Rakiplari, Elsa. 2017. *Analizë kritike rreth diskursit politik në Ballkan. Shtëpia botuese "LuisPrint"*.
8. Skënderi Rakiplari, Elsa. 2019. *A framing analysis to the debate about waste import in Albania*. (kumtesë mbajtur në konferencën Words as a Battlefield: Persuasion in Contemporary Political and Media Discourse, 5 prill 2019 Universiteti i Mariborit, Slloveni) –Në proces botimi.
9. Van Dijk, Teun. 1998. "What is political discourse analysis." *Belgian journal of linguistics* 11.1 (1997): 11-52.
10. Wodak, Ruth, De Cillia, Rudolf. 2006. Politics and Language: Overview Linguistics in Brown, K. (Ed.) *The Encyclopedia of Language and Linguistics*, faqe 707-719. Oxford: Elsevier Ltd.

Tekste të analizuar

1. Ademi, Voltana. 2017. Voltana kopjon Ramën, flet për 'kazan' dhe nxjerr listën e pasurisë. 13 nëntor 2017 Gazeta panorama <http://www.panorama.com.al/voltana-kopjon-ramen-flet-per-kazan-dhe-nxjerr-listen-e-pasurise/>
2. Basha, Lulzim. 2017a. Fjalimi në seancë plenare, mbajtur më 12 shtator 2017. PUNIME TË KUVENDIT Seancat plenare Viti 2017 nr. 3 Botim i Kuvendit, Tiranë.

- <https://www.parlament.al/Files/PunimeKuvend/2017/3.pdf>, faqe 35-40.
3. Basha, Lulzim. 2017b. Fjalimi në seancë plenare, mbajtur më 28.09. 2017. PUNIME TË KUVENDIT Seancat plenare Viti 2017 nr. 3 Botim i Kuvendit, Tiranë. 357-362
 4. Bylykbashi, Oerd. 2017. Fjalimi në seancë plenare, mbajtur më 12 shtator 2017. PUNIME TË KUVENDIT Seancat plenare Viti 2017 nr. 3 Botim i Kuvendit, Tiranë.
<https://www.parlament.al/Files/PunimeKuvend/2017/3.pdf>, faqe 62-65.
 5. Çani, Arjan, Rama, Edi. 2019 *Intervistë: Kazan Mediatik, jo Kazan Mediatik*. 19 tetor 2018.
https://www.youtube.com/watch?v=4_LKYatbvCA
(Kontrolluar së fundmi më 25 korrik 2019).
 6. Dule, Vangjel. 2017. Fjalimi në seancë plenare, mbajtur më 12 shtator 2017. PUNIME TË KUVENDIT. Seancat plenare Viti 2017 nr. 3 Botim i Kuvendit, Tiranë.
<https://www.parlament.al/Files/PunimeKuvend/2017/3.pdf>, faqe 157- 160.
 7. FEJ. 2019. *Mission preliminary findings: Press freedom is deteriorating in Albania*. European federation of journalist. Botuar më 21 qershor 2019
<https://europeanjournalists.org/blog/2019/06/21/albania-preliminary-findings-of-joint-freedom-of-expression-mission/>
 8. Kryemadhi, Monika. 2017. Fjalimi në seancë plenare, mbajtur më 12 shtator 2017. PUNIME TË KUVENDIT. Seancat plenare Viti 2017 nr. 3 Botim i Kuvendit, Tiranë.
<https://www.parlament.al/Files/PunimeKuvend/2017/3.pdf>, faqe110- 114.
 9. Mediu, Fatmir. 2017. Fjalimi në seancë plenare, mbajtur më 12 shtator 2017. PUNIME TË KUVENDIT Seancat plenare Viti 2017 nr. 3 Botim i Kuvendit, Tiranë.
<https://www.parlament.al/Files/PunimeKuvend/2017/3.pdf>, faqe 104-108.

10. Noka, Flamur. 2017. Fjalimi në seancë plenare, mbajtur më 12 shtator 2017. PUNIME TË KUVENDIT. Seancat plenare Viti 2017 nr. 3 Botim i Kuvendit, Tiranë.
<https://www.parlament.al/Files/PunimeKuvend/2017/3.pdf>, faqe 173-176.
11. Rama, Edi. 2016. Intervistë në Emisionin “Opinion”, 25. 07. 2016, transkriptuar sipas <https://www.youtube.com/watch?v=64EoCLDXr9M>
12. Rama, Edi. 2016. *TAP, nis shtrimin e tubacioneve të gazit*. Fjalim 30 shtator 2019.
13. Rama, Edi. 2016. *Tjetër rrije rrogash për policinë e shtetit*. Fjalim. 12 tetor 2016 <https://kryeministria.al/newsroom/tjeter-rritje-rrogash-per-policine-e-shtetit/>(kontrolluar së fundmi më 15 qershor 2019).
14. Rama, Edi. 2017a. “S'është punë timoni, por destinacioni, dakord me Nanon”. Ekstrakt nga deklarata për shtyp. Gazeta “shqiptarja.com”, 11.06.2017
<https://shqiptarja.com/lajm/rama-s-39-eshte-pune-timoni-por-br-destinacioni-dakord-me-nanon?r=app>
15. Rama, Edi. 2017b. Fjala e Kryeministrit E. Rama në dëgjuesën publike me qytetarë të Librazhdit. Bashkëqeverisje me njerëzit në gjithë procesin politikbërës e vendimmarrës 14 Korrik 2017
<https://kryeministria.al/newsroom/an-efficient-and-responsible-public-administration-at-the-service-of-citizens/>
16. Rama, Edi. 2017c. Fjala e Kryeministrit Edi Rama në mbyllje të debatit parlamentar për programin qeverisës dhe votimit të qeverisë re. 13 Shtator 2017
<https://kryeministria.al/newsroom/replika-finale-pas-perfundimit-te-debatit-te-kuvendit-dhe-perpara-votimit-per-qeverine-e-re/>(Kontrolluar së fundmi më 25 korrik 2019).
17. Rama, Edi. 2017d. Intervistë në emisionin “Zonë e lirë”, 25. 07. 2016, transkriptuar sipas <https://www.youtube.com/watch?v=TzBpWkX9MXg&t=5249s>
18. Rama, Edi. 2019a. *Program Kombëtar për Rilindjen e Universitetit*. Fjalim.22 shkurt 2019.

- <https://kryeministria.al/newsroom/program-kombetar-per-rilindjen-e-universitetit/> (kontrolluar së fundmi më 15 qershor 2019).
19. Rama, Edi. 2019b. “Rama u përgjigjet kritikave: Na shau “kazani i diasporës”, por po t’i besoj mikut tim budist Majkos...” Mar 1, 2019 <http://www.panorama.com.al/rama-u-pergjigjet-kritikave-na-shau-kazani-i-diaspores-por-po-ti-besoj-mikut-tim-budist-majkos/>
 20. Rama, Edi. 2019c. Fjalim “Me qytetarët e Librazhdit për bashkinë që duam”. 2 prill 2019. <https://kryeministria.al/newsroom/me-qytetaret-e-librazhdit-per-bashkine-qe-duam/>(Kontrolluar së fundmi më 25 korrik 2019).
 21. Rama, Edi. 2019d. Pukë , takim publik “Bashkia që duam” 19 shkurt 2019. <https://kryeministria.al/newsroom/puke-takimi-publik-bashkia-qe-duam/>
 22. Salianji, Ervin. 2017. Fjalimi në seancë plenare, mbajtur më 12 shtator 2017. PUNIME TË KUVENDIT Seancat plenare Viti 2017 nr. 3 Botim i Kuvendit, Tiranë. <https://www.parlament.al/Files/PunimeKuvend/2017/3.pdf> , faqe 161-164.
 23. Spiropali, Elisa. (2018) Intervistë televizive. <https://www.faxweb.al/xhafaj-iku-me-nder-elisa-spiropali-larg-qofte-tia-jepnim-te-gjitha-arsyet-kazanit/> (kontrolluar më)
 24. Taylor, Alice Elizabeth. 2019. International Media Freedom Delegation: Albania Not Meeting Human Rights Obligations. Botuar më 21.06. 2019. <https://exit.al/en/2019/06/21/international-media-freedom-delegation-albania-not-meeting-human-rights-obligations/>
 25. Vokshi, Albana. 2017. Fjalimi në seancë plenare, mbajtur më 12 shtator 2017. PUNIME TË KUVENDIT Seancat plenare Viti 2017 nr. 3 Botim i Kuvendit, Tiranë. <https://www.parlament.al/Files/PunimeKuvend/2017/3.pdf> , faqe 80-84.

Hysnie HAXHILLARI (HYSKA)

VËSHTRIM GJENERATIVIST I KLASËS SË PËREMRAVE NË GJUHËN SHQIPE

Abstrakt

Struktura morfologjike e gjuhës së sotme shqipe mbart një larmi të madhe trajtash morfologjike, të cilat në gramatologjinë shqipe jo gjithmonë janë analizuar në mënyrë adekuate. Mjaft njësi morfologjike nuk kanë marrë trajtimin e duhur gramatikor. Kjo dukuri vihet re në dy aspekte: në klasifikimin e tyre në klasa fjalësh dhe, në trajtimin jobashkëkohor të mjaft prej pjesëve të ligjëratës.

Nisur nga arsyet e sipërpërmendura objekt i kësaj kumtese bëhet klasa e përemrave në gjuhën shqipe, të cilët mëtohet të trajtohen nga pikëpamja e teorisë gjenerative mbi caktuesorët ose determinantët e sintagmave emërore ku ata luajnë rolin e kokës së këtyre sintagmave. Metoda mbi bazën e së cilës do të realizohet ky punim është analiza e të dhënave të marra nga paradigma përemërore e ndërthurur me përshkrimin dhe paraqitjen e disa trajtimeve të studimeve gjenerative që lidhen me këtë çështje.

Në këtë punim përemrat që qëndrojnë para emrave siç janë dëftorët, pronorët e paravendosur, pyetësit dhe të pacaktuarit do të trajtohen si anëtarë të një klase të re përbërësish, si caktuesorë të emrit që ata shoqërojnë. Rrjedhimisht, punimi do të analizojë nga pikëpamja e teorisë gjenerative pozicionin e gjenerimit të tyre, tiparet që i klasifikojnë ata në klasën e caktuesorëve, funksionin sintaksor që ata mbartin në lidhje me emrin, përndarjen në lidhje me caktuesorë të tjerë, si për shembull, nyjën e pashquar *një* etj.

Fjalët çelës: *gramatikë, pjesë ligjërata, klasifikim, gjenerativist, përemra, caktuesorë, kokë, tipare gramatikore, pozicion gjenerimi*

Abstract

The Albanian morphological structure owns a large morphological forms which not always have been analyzed correctly in the Albanian grammatology. Many of the grammatical items are not analyzed in an adequate way according to: the classification of this items as parts of speech and their old traditional analyses.

The object of this working paper is the class of pronouns in Albanian language. The framework here is the one of the generative studies on the Determinative Phrase Theory, which analyzes the pronouns as the functional heads of DP.

The method of this article consists on the analysis of the pronominal system of the Albanian language, also it will operate through some generative approaches on the determines of the Determinative Phrase, like the pronominal pronouns in several languages as in Albanian, Rumanian, Greek etc.

This article will analyze the demonstrative pronouns, some of the possessive pronouns, the interrogatives and the indefinite pronouns as determines, which are functional heads of the Determinative Phrases, according to S. P. Abney theory (1987). Further, it will analyze their generate position, their grammatical features which allow them wether to be determines or not, their functional features as heads in the Determinative Phrase, their distribution according to other determines as articles etc.

Key words: *grammar, parts of speech, classification, generative, pronouns, determiners, head, grammatical features, derive position*

Objekt i këtij punimi janë përemrat që i paraprijnë emrit si përemrat dëftorë, pyetësit, pronorët dhe të pacaktuarit. Këta përemra, përveç kuptimit të tyre tregues të sendeve, personave, objekteve, që i bashkon me llojet e tjera të përemrave, kanë edhe kuptim caktues, individualizues, përgjithësues ndaj emrit që i paraprijnë. Kur paraprijnë emrin, këta përemra funksionojnë si një gjymtyrë e vetme me të duke u kthyer në fjalë shërbyese, servituda të emrit. Pikërisht, ky aspekt i shfaqjes së tyre përbën edhe interesin kryesor të trajtimit të këtyre përemrave në këtë punim.

Përemrat përbëjnë një klasë heterogjene të pjesëve të ligjërates në gjuhën shqipe, si nga pikëpamja leksikore, ashtu edhe nga pikëpamja gramatikore. Ndryshimet formale gramatikore që vihen re ndërmjet përemrave kanë vështirësuar edhe klasifikimin e tyre në një klasë të përbashkët. Kështu, vihet re se ka përemra të cilët nga ana formale strukturore ngjajnë me mbiemrat dhe shumë lehtë mund të bëhen pjesë e klasës së tyre, si përemrat dëftorë *i tillë, i këtillë*, përemrat e pacaktuar *shumë, pak, mjaft* etj., janë të njëjtat fjalë që shërbejnë edhe si ndajfolje sasive. Megjithatë funksionet gramatikore i kanë të ndryshme në të dy përdorimet, kuptimi leksikor i tyre mbetet i ngjashëm në mos i njëjtë: *erdhën shumë njerëz, erdhën shumë, fola shumë*. Ndaj, funksioni dhe përkatësia e tyre në këtë apo atë pjesë ligjërate shpesh vihet në diskutim në gramatikat e shqipes.

Klasifikimi që gramatika tradicionale u bën përemrave është mjaft i diskutuar në gramatikën gjenerative, sepse jo të gjitha nënlojet e përemrave mbartin tiparin kategorial të të treguarit dhe, gjithashtu, vihen re ndryshime të mëdha kuptimore dhe strukturore ndërmjet tyre. Këtë pikëpamje mbron edhe studiuesi italian G. Graffi në veprën “Sintassi” kur vëren se përemrat vetorë tregojnë një njësi (ose grup njësisë) të individualizuar me saktësi; përemrat pyetës, në të kundërt, nuk individualizojnë ndonjë njësi me saktësi, por tregojnë mjedisin apo vendin ku kërkohet (gjendet) kjo njësi; lidhorët dhe të pacaktuarit duket qartë se nuk kanë shumë të përbashkëta me përemrat vetorë: lidhorët paraqesin disa ngjashmëri morfologjike me pyetësit. Të pacaktuarit tregojnë një sasi, që mund të jetë shuma / e gjitha (p.sh. të gjithë, çdo), ose vetëm një pjesë (p.sh., disa, ndonjë) dhe, si pasojë, mund të jetë më e përshtatshme, duke

marrë një shprehje të huazuar nga logjika formale, t'i quajmë sasiore (kuantifikues) (Graffi, G., 1994, f. 45).

Në gramatikat më të hershme të gjuhës shqipe si ajo e Da Lecce-s, J. De Radës, A. Dozon-it, P. Vasës, A. Xanonit, J. Rrotës, O. Myderrizit, S. Rizës, K. Cipos, klasa e përemrave ndahet në dy grupe: përemra dhe mbiemra përemërorë, sipas rastit të përdorimit të tyre pa emrin ose me të. Kjo ndarje vjen si pasojë e ndikimit të këtyre autorëve nga gramatikat e gjuhëve perëndimore si italishtja, frëngjishtja, anglishtja etj. Këtë dallim e ndeshim edhe në gramatikën e S. Frashërit në shpjegimin e tij për dëftorët:” përemri dëftonjës, kur përdoretë vetëm, zë vënt emëri; kur përdoretë përpara një emëri, zë vënt mbiemëri” (Frashëri, S., 1886, f. 144) duke dalluar qartë dy funksionet e ndryshme të përemrave të pashoqëruar dhe të shoqëruar me emrin.

Një çështje tjetër me rëndësi në trajtimin e përemrave të gjuhës shqipe është edhe përcaktimi i kuptimit të qartë leksiko-gramatikor të tyre, gjë që nuk realizohet njëjloj në gramatikat e shqipes. Nga kjo pikëpamje, disa përemra të pacaktuar përbëjnë fokusin kryesor të kësaj çështjeje, duke u dyzuar mes dy a tri kategorive gramatikore në varësi të sintaksës ndaj emrit, siç janë përemrat *një*, *ca*, *aq*, *kaq*, *shumë*, *pak*.

Përemrat *një* dhe *ca* në gramatikat e shqipes përgjithësisht janë parë vetëm si përemra të pacaktuar duke mos vënë në dukje edhe përdorimin e tyre si nyja të pashquara të njëjësit dhe shumësit. Mund të përmendim këtu gramatikën e S. Frashërit, P. Vasës, K. Cipos etj.

Për shembull, K. Cipoja në shembullin “*Erdhi një dhe trokiti në derë; paska qenë motit një plakë.*” fjalën *një* e merr si përemër të pacaktuar në të dyja përdorimet duke mos bërë dallimin midis përdorimit të fjalës *një* si përemër i pacaktuar tek *erdhi një* dhe përdorimit si një e pacaktuar te *një plakë* (Cipo, K., 1949, f.104-106). Ndërsa J. Rrota në gramatikën e tij dallon qartë tri funksionet e fjalës *një*: si numëror, si përemër dhe si “artikull i pacaktuar” (Rrota, J., 1930, f. 311-314).

Një risi në lidhje me përdorimin e përemrit të pacaktuar *një* vihet re në dispensën e Sh. Demirajt “Morfologjia e gjuhës shqipe” ku autori përmend edhe origjinën e tij nga numërori *një*, edhe përdorimin e tij si një e pashquar. Si përdorime më të zakonshme si përemër i pacaktuar sheh

ato kur *një* ndiqet nga një fjali e varur lidhore me përemrin lidhor *që* ose nga një plotës i ndërtuar me parafjalët *nga* ose *prej*: *ka ardhur një (dikush) që kërkon të flasë me ty; dje takova një nga Shkodra* (Demiraj, Sh., 1961, f. 148) Sipas mendimit të tij, përemri i pacaktuar erdhi e u përdor në rolin e një nyje të trajtës së pashquar, duke marrë kështu një kuptim edhe më të përgjithshëm, edhe më abstrakt.

Ndërsa përemrave të pacaktuar *ca* e *disa* Demiraj u njeh edhe statusin e nyjave të trajtës së pashquar kur shprehet në një shënim se përemrat e pakufishëm *ca, disa, do*, kur përdoren në bashkëvajtje me emra, luajnë më tepër rolin e një nyje të trajtës së pashquar (Demiraj, Sh., 1961, f. 155)

Vepra “Gramatika e gjuhës shqipe, I”, botim i Akademisë së Shkencave, i bën trajtimin më të plotë klasës së përemrave në gjuhën shqipe. Në këtë vëllim dallohen qartë tri funksionet e fjalës *një*, duke sqaruar se si përemër dallon nga numërori homonim, se s’shërben për të numëruar, por për të treguar një frymor a send në mënyrë të pacaktuar, kurse si nyjë e pacaktuar ndiqet nga një emër në trajtën e pashquar të numrit njëjës: *Mund të gdhend një njeri që t’i ngjajë heroit* (Gramatika e gjuhës shqipe, I, 2002, f. 215). Gjithashtu, bëhet dallimi i fjalëve *shumë, pak, ca, aq* e *kaq* të përdorura si përemra dhe si ndajfolje sasive, por nuk përmendet edhe një funksion i tretë i tyre si fjalë shkalle te mbiemrat dhe ndajfoljet.

Përemrat e pacaktuar *aq* dhe *kaq* gjithashtu tërheqin vëmendjen për trajtimin e tyre në disa gramatika të shqipes, në të cilat shpesh nuk bëhet dallimi në përdorimin e tyre si përemra të pacaktuar, si ndajfolje apo si fjalë shkalle. S. Frashëri për fjalët *aqë* e *kaqë* thotë se “janë përemëra kur ndodhenë përpara emërash, si: *aqë njërës, kaqë ujë*”, por ndajfolje kur ndodhen para mbiemrash; për ta pranon se përdoren edhe më vete (Frashëri, S., 1886, f. 147-148).

Në gramatikën e A. Xanonit fjalët *aq* dhe *kaq* klasifikohen si përemra kur ndodhen para emrash, si: *aq niers, kaq ujë*; dhe ndajfolje kur ndodhen para mbiemrave: *aq i mirë, kaq i madh; tanë e gjithë* (Xanoni, A., 1909, f. 83-86). Në këtë grup fut edhe *shumë* e *pak*, të diskutuara nga mjaft gjuhëtarë për statusin e tyre të ndërmjetëm. Për *shum, pak, maa tepër, aq, kaq, sado, mieft* thotë se përdoren edhe si ndajfolje. Ndërsa I. D. Sheperi të

pacaktuarit *kaq* dhe *aq* i përfshin në grupin e përemrave dëftorë, por i quan përemra vetëm kur plotësojnë emra (ose mbiemra që përdoren si emra): *kaqë punë, aqë të mirë (aq njerëz të mirë*. Kur plotësojnë mbiemrin ose foljen e ndajfoljen janë ndajfolje: *shkrova kaqë, aq'i mirë, aqë shpejt* (Sheperi, I. D., 1927, f. 65)

Në gramatologjinë shqipe jo gjithmonë është përcaktuar qartë funksioni sintaksor i përemrave që u paraprijnë emrave, duke i marrë ata si gjymtyrë më vete dhe jo si një e vetme me emrin që paraprijnë. Por duke qenë se këta përemra shoqërojnë emrat, ata përbëjnë një gjymtyrë të vetme sintaksore, prandaj edhe nuk mund të shihen si fjalë më vete, por si fjalë shërbyese të emrit.

Mund të veçojmë këtu trajtimin e K.Cipos në veprën e tij “Sintaksa” ku përemrat që i paraprijnë emrit nuk i merr si përcaktorë. Këtu, kur analizohen plotës të llojeve të ndryshme, fjalët përcaktuese të emrit merren si gjymtyrë fjalie bashkë me emrin, si në shembullin *kjo makinë është e një shoku*, ku si kryefjalë merret togu përemër dëftor + emër: *kjo makinë* (Cipo, K., 1952, f.83). Si një gjymtyrë e vetme i trajton ai edhe togjet numëror + emër. Kjo do të thotë që në këtë vepër Cipoja ka hedhur një hap përpara në zbulimin e funksionit të vërtetë të përemrave-mbiemra, duke pranuar se përemrat që i prijnë emrit nuk shërbejnë si gjymtyrë fjalie.

Po kështu në vëllimin e dytë të Gramatikës së Akademisë klasa e përemrave merr një trajtim të ri, bashkëkohor, duke qenë se përemrat quhen fjalë përcaktontjese ose caktuesorë. Funksioni i tyre sintaksor realizohet si në një gjymtyrë të vetme me emrin që përcaktojnë dhe jo si gjymtyrë më vete, duke e shpjeguar këtë me faktin që “në shqipen e sotme emri ka një mëvetësi të kufizuar në funksionimin e tij si gjymtyrë e fjalisë”. Dhe si fjalë që i vendosen para emrit të pashquar në mënyrë që ai të bëhet gjymtyrë fjalie, pranohen përemrat dëftorë, pyetës, të pacaktuar, si dhe fjala *një*, të cilat quhen fjalë përcaktontjese, ose caktuesorë (Gramatika e gjuhës shqipe, II, 2002, f.83, 84).

Megjithëse Gramatika e Akademisë shënon një hap përpara në trajtimin e përemrave si caktuesorë, vihet re një kundërshtim me pohimin se caktuesorët bashkë me emrin funksionojnë “si një gjymtyrë e vetme e

fjalisë”, kur autorët e saj u njohin atyre funksionin e përcaktorit në përkufizimin “përcaktorët e shprehur me përemrat *ky, kjo, ai ajo* varen nga gjymtyrë fjalie të shprehura me edhe me emër të pashquar”, si. p.sh.: *Jehona e këtyre ngjarjeve u përhap në të katër anët e vendit. Matanë atyre mullarëve ishin fushat e mbjella me grurë. Unë kisha edhe një qëllim të caktuar që isha shtruar në atë kuvend etj.* Po kështu, si përcaktorë shihen në fjalitë që vijojnë edhe përemrat pyetës: *Cilët miq pret, more burrë? Mecilin brisk e preve?*; përemrat e pacaktuar: *Asnjë njeri nuk dukej bregut të detit. Mos është ndonjë njeri i dëgjuar? Unë do të bëj si bëjnë të gjitha shoqet etj.* (Gramatika e gjuhës shqipe, II, 2002, f. 223, 224, 226)

Statusin e përemrave që paraprijnë emrin si fjalë shërbyese e pranon edhe gjuhëtari R. Memushaj, i cili në librin parauniversitar “Bukuria e gjuhës shqipe” nënvizon se “përemrat që ndodhen para emrit, nuk shërbejnë si gjymtyrë fjalie, po si fjalë që saktësojnë a përcaktojnë kuptimin e emrit, me funksione të ngjashme me ato të nyjës joshqese *një* ose të mbaresave shquese”, duke sjellë si shembull përemra dëftorë *ky, ai* dhe pronorët para emrit, që e bëjnë emrin të caktuar (Memushaj, R., 2008, f.155).

Për t’u vlerësuar është edhe qëndrimi që mban gjuhëtari M. Çeliku, i cili, duke u nisur nga perspektiva gjenerative e teorisë mbi sintagmën emërore, caktuesorët përemra i sheh si elemente që nuk mund të shërbejnë si përbërës sintaksorë, pasi nuk janë fjalë emërtuese, po fjalë shërbyese: *Ca makina parkuan para hotelit. Ai djalë u shërua në spital. Ky djalë është i panjobur për mua. Ime motër ka punuar në arsim. Ndonjë shoqe mund ta dijë* (Çeliku, M, 2012, f.68-69).

Përmes kësaj paraqitjeje përshkruese mbi trajtimin e klasës së përemrave në gramatikën e shqipes shpalosen mjaft çështje të cilat duhet të rishihen në kuadrin e teorive të reja gjuhësore, siç është edhe teoria e sintagmës caktuesore, ku roli i përemrave që qëndrojnë para emrit përcaktohet qartë si kokë funksionale e saj. (teori e parashtruar së pari nga gjuhëtari amerikan S.P. Abney në 1987)

Edhe në gramatikën e gjuhës shqipe lind nevoja që të gjithë caktuesorët e emrit, duke pasur vetinë e përbashkët të caktuesisë gramatikore ndaj emrit dhe tiparin [+N], të trajtohen në një klasë të vetme,

në klasën e determinantëve apo caktuesorëve të emrit, që simbolikisht shënohet me shkronjën D. Përpyetje për t'i analizuar përemrat që paraprijnë emrat si caktuesorë vihen re te punimet e disa autorëve si R. Memushaj, M. Çeliku, G. Turano etj. Po veçojmë sintaksën e dy autoreve Koleci–Turano ku përemrat që i paraprijnë emrit si dëftorët, pyetësit, pronorët dhe të pacaktuarit bëjnë pjesë në klasën e determinantëve dhe trajtohen si koka të sintagmës DP (Koleci, F., Turano, G., 2011, f.65). Gjithashtu, është për t'u përmendur edhe trajtimi i studiuesit B. Bokshi në veprën “*Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipërisë*” ku dallon caktuesorët e emrit me emërtimin *determinues* duke i shënuar me simbolin A₁. Përemrat që bëjnë pjesë në grupin nominal A₁ janë: përemri dëftor, përemrat pronorë, përemrat e pakufishëm dhe pyetësit. (Bokshi, B., 2005, f. 150, 151)

Përemrat që i paraprijnë emrit në gjuhën shqipe si dëftorët, pronorët e paravendosur, pyetësit e të pacaktuarit trajtohen në këtë punim si pjesëtarë të klasës së caktuesorëve të sintagmave caktuesore. Duke iu referuar S.P. Abnit, si një ndër themeluesit e kësaj teorie, renditim disa nga argumentet që dëshmojnë statusin e përemrave të lartpërmendur si caktuesorë. Në monografinë e tij “*English NP in its sentential aspect*” i trajton përemrat si elemente të kategorisë sintaksore Determinant. Abni ndahet nga pikëpamja se përemrat janë të barabartë ose funksionojnë ashtu si emrat, sepse përemrat nuk shfaqen dot me çdo specifikues të emrit: nyjat (determinantët), pronorët, mbiemrat, kuantifikuesit, të gjithë janë të ndaluar.

*[my she] has always been good to me. (Abney, S.P., 1987, f.281)

[ime ajo ka qenë gjithmonë e mirë me mua

Ky autor thekson se përemrat dhe caktuesorët kanë një veti të përbashkët: ata janë rrjeta bazë (basic sites) të tipareve gramatikore të sintagmave emërore (NP) si veta, numri dhe gjinia, Abni shton më tej se, përgjithësisht, përemrat janë elemente funksionale në mënyrë të qartë. Ata i përkasin një klase të mbyllur leksikore, edhe pse ata referojnë, përshkruajnë dhe nuk prodhojnë (japin) një predikat mbi individët, por kryesisht shënojnë tipare gramatikore.

Në vijim të pikëpamjes së Abnit për përemrat si caktuesorë (determinantë) vjen edhe trajtimi i studiueses rumune Cornilescu, e cila sqaron se të gjithë përemrat e njohur tradicionalisht ndajnë vetinë e të qenit zëvendësues të DP-ve; ata zëvendësojnë NP-të duke pasur përndarjen e NP-ve, siç tregohet në shembujt e mëposhtëm:


[_{DP} the tall boy] came to the party “djali i gjatë erdhi në festë”
[_{DP} he] came to the party “ai erdhi në festë”

Përfundimi i Kornileskut është se përderisa përemrat janë homonime ose alomorfe të elementeve D⁰, ata janë kokë D⁰ me komplemente zero në shumë gjuhë (Cornilescu, A., 1996, f.234).

Një tjetër studiues që ka paraqitur gjerësisht teorinë e sintagmës caktuese është edhe D. Adger, i cili përfshin në klasën e caktuesorëve edhe përemra vetorë në përdorimet e tyre para emrit: [We linguists] love to argue (Ne gjuhëtarëve na pëlqen të debatojmë) (Adger, D., 2002, f. 201)

Duke iu kthyer gjuhës shqipe, si caktuesorë “par excellence” të sintagmave caktuese shërbejnë përemrat dëftorë ky, kjo; pronorët im, ime, yt, jot, pyetësit cili, cila, ç’, çfarë. Ndërsa përemrat e pacaktuar bëjnë pjesë në klasën e sasioreve, të ashtuquajtur në literaturën gjenerative si kuantifikues. Këtu bën pjesë edhe përemri pyetës *sa*, të cilin, duke u pajtuar me gramatikën e bashkautorëve Newmark-Prifti, e përfshijmë në grupin e sasioreve meqë me anë të tij pyesim për sasi: sa libra, sa njerëz etj. (Newmark, Ph, H., Prifti, P., 1982, f.122).

Përemrat dëftorë funksionojnë si caktuesorë të emrit që shoqërojnë. Këtë funksion e përcakton pozicioni i tyre para emrit, roli i tyre individualizues ndaj tij si dhe mbartja e tipareve gramatikore emërore si numri, gjinia dhe rasa. Në sintagmat caktuese **ky djalë**, **këta djem**, **kjo vajzë**, **këto vajza**, dëftori përbën kokën funksionale D⁰ të sintagmës, kurse emri është plotësori i saj. Këta përemra janë koka funksionale të sintagmave caktuese ku shfaqen, pasi janë në përndarje plotësuese mes tyre dhe me caktuesorë të tjerë: **ky/ im/ ai/ cili vëlla*. Struktura e një sintagme të tillë është kjo:



Në gjuhën shqipe përemri dëftor mund të paraprijë edhe një emër të shquar në raste të rralla, të cilat përbëjnë ndërtime gramatikore si: *ky djali, kjo vajza, këta djemtë* etj. Këta shembuj paraqesin një strukturë më të ndërlikuar duke qenë se edhe përemri dëftor, edhe nyja përbëjnë caktuesorë në literaturën gjenerative dhe si të tillë duhet të zënë të njëjtin pozicion në pemën e sintagmës. Përemri dëftor në gjuhën shqipe ka një tipar të përbashkët me nyjën shquese: të dy realizojnë caktuesinë e emrit, pra mbartin tiparin e caktuesisë. Të dy elementet e dallojnë emrin që shënojnë nga klasa ku bën pjesë, e veçantësojnë atë si në shembujt:

Në klasë hyri një nxënës. Ky nxënës u ul në bangën e parë.

Në klasë hyri një nxënës. Nxënësi u ul në bangën e parë.


Gramatikaliteti i shembujve të tillë, siç e shpjegon edhe J. Mita, çoi në idenë se nuk është caktuesori në vetvete që duhet të jetë një dhe i vetëm brenda SE, por është një vend përpara SE-së ku duhet të dalë caktuesori. Problemi këtu, shton autori, është se kemi të bëjmë me dy caktuesorë dhe jo me një siç thotë teoria (Mita, J., 2017, f.93)

Nëse i referohemi veprës bashkëkohore “Noun Phrase in the Generative Perspective” të tre autoreve A. Alexiadou, L. Haegeman, M. Stavrou shohim hipotezën se dëftorët paraqiten sintaksorisht si projeksione maksimale të sintagmave determinative në gjuhët ku ata nuk janë në përndarje plotësuese me determinantë të tjerë (Alexiadou, A., Haegeman, L., Stavrou, M., 2007, f. 106). Në gjuhën shqipe përemri dëftor

del në përndarje plotësuese me disa caktuesorë si *një/ ai/ cili libër, ndërsa në shembujt *ky djali*, *kyo vajza* nuk është në përndarje plotësuese me një shqese, secili ka pozicionin e vet.

Hipotezën se dëftori është projektion maksimal në pozicionin e specifikuesit të DP, ndërsa nyjat shqese janë koka D e mbështet edhe studiuesja italiane G. Gusti (1997, 112). Në fjalinë e parë *Di chi hai la foto sulla tua scrivania?* (*E kujt është fotografia mbi tavolinën tënde*) Giusti sqaron se nyja shqese *la* nuk e bllokton nxjerrjen e elementit *di*. Ndërsa në shembullin e dytë përemri dëftor **questa** e bllokton nxjerrjen e tij në **Di chi hai questa foto sulla tua scrivania?* (*E kujt është kjo fotografi mbi tavolinën tënde*) (Alexiadou, A., Haegeman, L., Stavrou, M., 2007, f. 107).


Nëse i kthehemi shqipes, shohim se fjalia e parë *E kujt është fotografia mbi tavolinën tënde?* është gramatikore, përemri pyetës *e kujt* nuk bllokohet nga nyja shqese ‘fotografia’. Në shembullin e dytë vërejmë një ndërtim jo aq gramatikor për gjuhën shqipe: *E kujt është kjo fotografi mbi tryezën tënde?* Kjo do të thotë se dëftori i shqipes sillet sintaksorisht si ai i italishtes. Fjalia do të ishte më e pranueshme me emrin *fotografi* në trajtë të shquar: *E kujt është kjo fotografia mbi tavolinën tënde?* Në këto kushte na mbetet të pranojmë mendimin e Xhustit se dëftori është në pozicionin spec.DP, ndërsa nyja në pozicionin kokë D.



Dëftori dhe nyja shqese gjenerohen në D, si koka të sintagmës determinative *ky djali*, nga të dy caktuesorët ai që duhet të lëvizë është dëftori, sepse duhet të marrë tiparin e referencialitetit që ndodhet në pozicionin spec. D, ndërsa emri lëviz nga pozicioni i komplementit për t’u pajisur me një shqese.

Hipoteza se dëftori gjendet në pozicionin Spec DP si rezultat i lëvizjes nga një pozicion më i ulët ndahet nga një grup gjuhëtarësh, si Giusti, Bruge, Panagiotidis e Shlonsky (Alexiadou, A., Haegeman, L., Stavrou, M., 2007, f. 109).

Caktuesorët pronorë të sintagmave emërore të shqipes janë në numër të kufizuar, duke qenë se këtë funksion e përmbushin vetëm përemrat pronorë të paravendosur ndaj emrave të farefisnisë: *im atë, yt vëlla, ime ëmë, jot motër*. Ashtu si edhe caktuesorë të tjerë, edhe pronorët e caktojnë kokën emër, domethënë e shënojnë atë si të caktuar. Duke qenë se emri në këto sintagma del i pashquar, atëherë caktuesori pronor merr edhe rolin individualizues të këtyre individëve, nëpërmjet tij dëgjuesi merr një të dhënë fillestare rreth personit për të cilin flitet. Gjithashtu, caktuesorët pronorë, ashtu si caktuesorë të llojeve të tjera, bëhen rrjetë e tipareve gramatikore të emrit që paraprijnë: *im vëlla* gjinia mashkullore, numri njëjës, rasa emërore, po kështu edhe emri që ai cakton shfaqet me të njëjtat tipare gramatikore. Caktuesorët pronorë zënë pozicionin e kokës D⁰ në sintagmën determinative ku shfaqen, ndërsa emrat janë komplemente të tyre. Skema përkatëse e kësaj sintagme:




Në grupin e përemrave pyetës shërbejnë si caktuesorë përemrat *cili, ç', çfarë*, sepse vetëm këta shfaqen në bashkëvajtje me emrin. Caktuesori *cili* ka tiparet e një caktuesori leksikor, ai shfaq përshtatje me emrin në gjini, numër, rasë: *cili djalë, cilin djalë, i cilit djalë, cila vajzë, cilën vajzë* etj.

Ndërsa pyetësit e tjerë *ç', çfarë* nuk shfaqin përshtatje me emrin, prandaj ata përbëjnë caktuesorë funksionalë.

Ashtu si caktuesorë të tjerë edhe përemrat pyetës pozicionohen para emrit si *cili qytet, cila vajzë* etj., janë në përndarje plotësuese me elemente të tjera **cili ky djalë*, gjithashtu ata janë rrjetë e tipareve gramatikore të emrit, përshtaten në gjini, numër, rasë me emrin.

Skema:




Nga klasa e përemrave bëjnë përjashtim përemrat e pacaktuar, të cilët nuk përfshihen në klasën e caktuesorëve, por në atë të sasiorëve (kuantifiukesve). Ashtu si caktuesorët, edhe përemrat e pacaktuar shërbejnë si koka Q të sintagmave sasiore. Dallimi ndërmjet caktuesorëve dhe sasiorëve qëndron në atë që caktuesorët shërbejnë për të dalluar njësinë që shënon emri, për ta veçuar e individualizuar atë në gjithë llojin e njësive ku ajo bën pjesë, ndërsa sasiori shërben për të dhënë sasinë e kësaj/ këtyre njësive, duke afruar më shumë me numërorët themelorë dhe ndajfoljet përemërore *shumë, mjaft, plot* etj. Sasiori nuk përbën një kategori funksionale të emrit ashtu si caktuesori, në kuptimin që ai nuk është rrjetë e tipareve gramatikore të emrit. Këtë e vëmë re në mjaft forma të sasiorëve të pacaktuar, si p.sh. *shumë njerëz, pak libra, disa të dhëna, ndonjë vajzë, mjaft studentë* etj. Vetëm disa sasiorë tregojnë përshtatje me emrin që paraprijnë si p.sh. *i gjithë fshati, e gjithë bota, të tjerë djem, të tjera vajza, ndonjëri, ndonjëra, secili, secila* etj. Në të vërtetë, përshtatja këtu realizohet jo me anë të

përemrit, por me anë të nyjës së përparme e cila përbën një caktuesor dhe merr tri format *i, e, të*, gjithashtu tek format e tjera, përsëri gjinia dallohet nga një nyjë shquese që ka evoluar historikisht në trupin e përemrit.

Ashtu si edhe disa caktuesorë, edhe në rastin e sasioreve të pacaktuar vihet re se këta mund të përdoren edhe me plotësorin emër, edhe pa të. Mirëpo tek sasioret e pacaktuar vihet re se disa prej tyre shfaqen në fjali vetëm nëse kanë një emër plotësor, si p.sh., *çdo, njëfarë, gjithë* (në raste të rralla *gjithëka, gjithë atë që*), *çdolloj, gjithfarë* etj. Sidoqoftë përdorimi i tyre, me apo pa plotësorin emër, do të pranojmë që ata bëjnë pjesë në klasën e sasioreve.

Në gjuhën shqipe ka ndërtime në të cilat sasioret shfaqen në përndarje të lirë me caktuesorët si p.sh. *këta dy djem* dhe *gjithë këta njerëz*. Kjo tregon se ata u përkasin dy kategorive të ndryshme, përkatësisht kategorisë D dhe kategorisë Q. Në shembullin e parë caktuesori ndodhet në një pozicion më të lartë se sasiori, ndërsa në shembullin e dytë ndodh e kundërta, sasiori ndodhet më lart se caktuesori. Skema:



Përfundime

Klasa e përemrave në gjuhën shqipe është një klasë heterogjene për sa i përket kuptimit leksikor dhe gramatikor. Në gramatologjinë shqipe trajtimi i përemrave shfaqet i paplotë dhe me mangësi, si në përcaktimin e saktë të kuptimit të tyre leksiko-gramatikor, ashtu edhe në përcaktimin e funksionit sintaksor kur u paraprijnë emrave.

Në këto kushte, del i nevojshëm një trajtim i ri i klasës së përemrave, sidomos i atyre që i paraprijnë emrit, të cilët funksionojnë në fjali si një gjymtyrë e vetme me të, duke u kthyer kështu në fjalë shërbyese.

Teoria e sintagmës determinative në gramatikën gjenerative i quan përemrat që i paraprijnë emrit me termin “caktuesorë” (determiners), duke i klasifikuar si elemente funksionale. Në sintagmën caktuesore, ku shfaqen, përemrat janë kokë D e sintagmës caktuesore, ndërsa emri është plotësor i saj.

Caktuesorë përemra në gjuhën shqipe janë: përemrat dëftorë ky, kjo, ai, ajo; përemrat pronorë të vetës I, II që u paraprijnë emrave të farefisnisë im, yt, jot, sat; përemrat pyetës çili, cila, ç, çfarë. Ndërsa përemrat e pacaktuar klasifikohen në grupin e sasioreve (kuantifikuesve) ku funksionojnë si koka Q të sintagmave sasiore çdo njeri; ndonjë libër, shumë njerëz etj.

Bibliografia:

1. Abney, S. P., *The English NP in its sentential aspect*, vol. 1, B.A., Indiana University (1983), MIT, 1987.
2. Adger, D., *Core Syntax: A Minimalist Approach*, 2002.
3. Alexiadou, A., Haegeman, L., Stavrou, M., *Noun Phrase in the Generative Perspective*, Mouton de Gruyter, Berlin, New York, 2007
4. Bokshi, B., *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2005

5. Cipo, K., *Gramatika e shqipes*, Instituti i Shkencave, 1949
6. Cipo, K., *Sintaksa*, Tiranë, 1952
7. Cornilescu, A., *Concepts of Modern Grammar*, Universitații din București, 1996.
8. Demiraj, Sh., *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1961,
9. Frashëri, S., *Shkronjëto e gjuhës shqip*, Dritë, Bukuresht, 1886
10. Graffi, G., *Sintassi*, Il Mulino, Bologna, 1994
11. *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Inst. i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2002
12. *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Inst. i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002
13. Koleci, f., Turano, g., *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2011
14. Memushaj, R., *Bukuria e gjuhës*, 2, Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore, Podgoricë, 2008
15. Mita, J., *Teori e sintaksës gjenerative dhe veçanti të gjuhës shqipe*, F. Konica, Prishtinë, 2017
16. Newmark, L., Hubbard, Ph., Prifti, P., *Standard Albanian – a reference grammar for students*, Standford University Press, Standford, California, 1982
17. Rrota, j., *Gramatika e shqipes*, Shkodër, 1930.
18. Sheperi, I. D., *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927
19. Xanoni, A., *Gramatika Shqyp*, Shkodër, 1909.
20. Çeliku, M., *Sintaksë e gjuhës shqipe, (Përbërësit sintaksorë)* ILAR, Tiranë, 2012

Julie KOLGJINI KDU 811.18'26

**ZHVENDOSJA E TRAJEKTORES SË STIGMËS:
DUKURIA SHIBBOLETHNË SHQIPEN
BASHKËKOHORE**

Abstrakt

Viteve të fundit, qarqe të ndryshme akademike kanë vënë në qendër të vëmendjes konstruktet dhe repertorët heteroglosikë. Shfaqjet e variacioneve rajonale me elemente të llojlojshme gjuhësore, shiheshin si destabilizuese të ideologjive gjuhësore hegjemonike, me pretendimin se kontaminojnë gjuhën. Në fakt, këto konfigurime përfshijnë diaglosinë, me anë të së cilës format dialektore ndërthuren me standardin. Në këtë investigim po orienjtojmë vëmendjen në një fushë më pak të studiuar; në situatën gjuhësore të komuniteteve të folësve të shqipes ku përdorimi i formave të perjashtuara, të indeksuara, me shkallë të ndryshme të stigmës dhe prestigjit, na sjell në mend fenomenin *shibboleth*, ndalesën e hyrjes së elementeve gjuhësore të marginalizuara në diskursin e zakonshëm, qoftë edhe kur elementët centripetale bashkëjetojnë me ato centrifugale. Përkunder atitudës gjuhësore të fiksuar në zbatueshmërinë ortolinguistike standard-gardiste, duket se konfigurime të veçuara diaglosike si forma (dikur) të debuara dhe *shibboleth*-e, p.sh. *si me thënë* (*si të thuash*; *si me thanë*), megjithatë, po fitojnë terren, si divergjenca të pranueshme nga standardi, në krahasim me të ngjashmet psh. *si me shku(e)* (*si të shkoh*). Qëllimi i këtij punimi është hulumtimi i dinamikës së shqipes bashkëkohore, duke përfshirë edhe agoren digjitale, si dhe korpuset online, ku shpërfaqen *shibboleth*-et destandardizuese dhe demotike.

Fjalët kyçe: *gjuha shqipe, shibboleth, destandardizim, repertorë diaglosikë, variacion gjuhësor*

Abstract

In various academic circles heteroglossic constructions and repertoires driven in part by speaker agency have been in the limelight throughout the past few years. These amalgams, including those exhibiting regional variation and areal features with elements of contact-induced language change, are often accompanied by concerns of destabilization of hegemonic language ideologies, thereby testing purist stances that such constructions demonstrate linguistic contamination and deficiencies. The resulting configurations also may involve diagglossia, whereby dialectal forms are enmeshed with the standard. In this paper we turn our attention to a less frequently studied realm, namely Albanian speech communities where employment of various prescribed constructions indexed with varying degrees of stigma and prestige serve as shibboleths, whereby the admittance of given marginalized linguistic elements into mainstream discourse is obstructed, including when centripetal elements are concomitant with the centrifugal. Influenced by language attitudes entrenched in ortholinguistic standard-gazing gatekeeping, among other variables, select diagglossic configurations containing (once) proscribed forms, e.g. *si me thënë* ('as/like to say'; *si të thuash*; *si me thanë*), may be in the process of qualifying as felicitous divergences from the standard, particularly when compared to an utterance such as *sime shk(u)e* ('as/like to go'; *si të shkosh*). The aim of this paper is to examine dynamic spoken and written modes of contemporary Albanian, including in the digital agora and online corpora, where destandardizing and demotic shibboleths surface.

Keywords: *Albanian, shibboleth, destandardization, diagglossic repertoires, language variation*

1. Trajektoret kundër-hegjemonike: Rishikimi i ideologjisë gjuhësore dhe i varianteve

Gjatë dekadave të fundit rivlerësimi i peisazheve gjuhësore aktuale, ka përfshirë konsiderueshëm ideologjitë hegjemonike gjuhësore, në raport me variantet e ndryshme. Në të kundërt, përgjatë gjithë shekullit të kaluar, ka dominuar fortifikimi i kulturave gjuhësore standarde, ku inxhinierimi i gjuhës, ishte prioritet (Ricento, 2000; Milroy, 2001). Homogjeniteti i standardit konsiderohej modernizim, ndërsa variacioni gjuhësor pengesë për përparim. Këmbëngulej në gjuhën legjitime, të pandryshueshme, uniformitetin statik diktuar nga gramatika e fiksuar standarde (Ricento, 2000), kundër varianteve alternative jo-standarde (Milroy, 2001).

Imponimet e gjuhës hegjemonike u lëkunden nga dinamika e praktikave gjuhësore heteroglosike. Heteroglosia përfshin ndërthurjen e kodeve divergjente, regjistrave, varianteve, lekteve dhe gjuhëve dhe/ose mënyrave të shprehësisë (shih. Schilling, 2016). Thelbësore tek heteroglosia Bakhtin-*esque* janë variabiliteti dhe hibriditeti i gjuhës, që lidhet me kufizimet hapësinore, kohore dhe diatopike (Pietikäinen & Dufva, 2014). “[Ç]do fjalë konkrete është një mikrokozmos i luftës midis forcave ‘centripetale’ dhe ‘centrifugale’ që njëkohësisht unifikojnë dhe shtresojnë gjuhën në të gjitha fazat e ekzistencës së saj historike” (Nouguerón-Liu & Warriër, 2014, f. 182). Kjo dinamikë shtytëse dhe tërheqëse mund të përcaktojë gjithashtu shtresimin e folësve në varësi të formave gjuhësore që ata përdorin (Bell, 2011). Elementi integruar i zhvillimit të gjuhëve të gjalla është konflikti midis centripetalit, gjuhës unitare dhe centrifugalit demotik, pra ndryshueshmërisë gjuhësore (shih. Schilling, 2016).

Destandardizimi dhe diaglosia janë gjithashtu të lidhura fort me diskutimin e praktikave të gjuhës hegjemonike. Davies (2012, f. 50–1) thekson: “Koncepti ‘destandardizim’...zakonisht u referohet dy proceseve të ndryshme: (i) ndryshueshmërisë më të madhe strukturore brenda variantit standard dhe (ii) dukshmërisë dhe pranueshmërisë në rritje të varianteve jo standarde në domenet e rezervuara më parë për standardin.” Destandardizimi lejon tipare të formave jo-standarde dhe rajonale (më

parë) të stigmatizuara, të rishfaqen në hapësirat e okupuara nga standardi (shih. Auer, 2005; Rutten, 2016). Repertorët që shfaqin destandardizimin përfshijnë “centrifugalizimin [,]...ikjen nga standardi në të gjitha drejtimet, si dhe çlirojnë gjuhën nga prangat e idesë së një standardi” (Bell, 2011, f. 179). Kur normat e përcaktuara janë tolerante, mund të kultivohen edhe repertorët diaglosikë, ku sistemet gjuhësore centripetale dhe centrifugale konkurojnë në peisazhin e gjerë gjuhësor. Auer (2005, f. 22) shpjegon: “Një repertor diaglosik karakterizohet nga variante të ndërmjetme midis standardit dhe dialektit (bazë).” Pasi një standard eksoglosik dhe më vonë endoglosik i përafërt me vernakularin, e kalon rrjedhën e vet, peisazhi gjuhësor mund të prodhojë diaglosinë. Diaglosia mund të shfaqet kur (nën)variantet jo standarde ndërthuren me bazën e standardeve pa pengesa (shih Rutten, 2016; Cerruti & Regis, 2014), duke frymuar kështu në “hapësirën midis...dialektit dhe standardit” (Auer, 2005, f. 22).

Demotizimi është një tjetër nocion me rëndësi rreth diskutimit të praktikave gjuhësore heteroglosike. Siç shpjegojnë Auer dhe Spiekermann (2011, f. 162), kur varianti standard bëhet aq i përhapur duke u vënë në shërbim të njerëzve (d.m.th. *demōs*), përsëri, ai mund të pësojë demotizim. Meqenëse standardi kalon nëpër përvoja ndryshimesh gjatë demotizimit, sidomos nga presioni i forcave centrifugale, ai reflekton ndryshueshmëri. Komuniteti i përdoruesve ka mundësi të larmishme në rastet kur dalin në pah divergjenca midis centripetalit dhe varianteve të ndryshueshme. Mund ose të këmbëngulet në shigjetimin e formave të ‘gabuar’ të stigmatizuara ose në të kundërt, të adaptohet një qasje e bazuar në normën që pranon variacionet. Gjatë demotizimit, vlerësimi për mënyrat e të folurit pëson ndryshime, ndërsa ideologjia standarde e gjuhës është ende e pranishme; “besimi se ekziston, dhe duhet të jetë, një ‘gjuhë më e mira’ nuk braktiset (Kristiansen 2003), por ideja se cila është, apo tingëllon si ‘më e mira gjuhë’, ndryshon. (...) Demotizimi është rivlerësim...i gjuhës me ‘status të ulët’ në atë të statusit të ‘gjuhës më të mirë’” (Auer & Spiekermann, 2011, f. 161). Ndërsa destandardizimi reflekton dobësim të forcave centripetale, demotizimi ndihmon në forcimin e variantit standard me hapje ndaj forcave centrifugale (shih. Kristiansen, 2016).

Së fundi, nocioni *shibboleth*, është shumë i rëndësishëm në lidhje me proceset gjuhësore. Përdorimi i një *shibboleth*-i, p.sh. i një fjale, fraze ose togfjalëshi si fjalëkalim (*password*), nënkupton pranimin ose jo në një rrjet të caktuar shoqëror. Shembujt janë të bollshëm që përfshijnë, jo vetëm shqiptimin e bashkëtingëlloreve fishkëllore semite (p.sh. šibbōlet, krh. sibbōlet ‘kalli gruri; lumë, përrua’; Woodhouse, 2003, f. 271), por dhe fonemat rotike të anglishtes së hershme (Gasiorowski, 2006), paraqitjet ortografike të gjatësisë së zanoreve në rrokje të mbyllura, shenjat e rasës kallëzore në njëjësën e gjinisë mashkullore të rasës emërore, si dhe diakritikën në holandishten e Flanders të shekullit të tetëmbëdhjetë (Vosters & Rutten, 2015).

Repertorët gjuhësorë që përmbajnë shkallë të ndryshme variacioni - duke përfshirë amalgamat që shfaqin destandardizim, diaglosi dhe anashkalim të *shibboleth*-eve - sfidojnë forcat hegjemonike të ditës. Ndërsa folësit dhe komunitetet gjuhësore rishkartisin dhe rinegociojnë kuptimin, formën, funksionin dhe identitetin, mundësojnë procesin e ngritjes së prestigjit dhe zbehjes së stigmës (shih. Pietkäinen & Dufka, 2014).

2.0 Shqipja Bashkëkohore: *Shibboleth*-et

Studimi i tanishëm merr në shqyrtim infinitivin (e shkurtë) perifrastik me parafjalën *me* dhe përshtatjen e tij në praktikën e përditshme të gjuhës, përfshirë *shibboleth*-et, në peisazhin bashkëkohor të gjuhës shqipe (shih. Riza, 2002, f. 19-20).

Sheperi (1927), Cipo (1949) dhe Vokshi (1959) e përmendin konstruktin perifrastik. Sheperi (1927) e krahason infinitivin e shkurtër, të tipit *me shkerue*, me a.) mënyrën lidhore të dialektit toskë (p.sh. *të shkeruar*), si dhe b.) infinitivin me parafjalën *për* (p.sh. *për të shkeruar*, f. 166-7), duke sqaruar se këto dy struktura alternative morfosintaksore mund të shërbejnë si kuazi-zëvendësuese të infinitivit të shkurtër, meqenëse ato përcjellin kuptime të ngjashme me gjithë dallimet në formë (shih. gjithashtu f. 78-124); por ai (f. 167) gjithashtu, shënon se infinitivi i shkurtër analitik përdoret për të krijuar kohën e ardhme kur paraprihet nga folja *kam*, p.sh. *kam me shkerue*, si dhe për të krijuar mënyrën kushtore,

kishje me shkrue (f. 167, 175). Tek Cipo (1949, f. 120-1) p.sh. *me ardhë*, si dhe kohën e shkuar (*infinitivi i shkuar*), *me pasë folë*, duke theksuar se shqipes i mungon infinitivi sintetik (krh. me latinishten) dhe që i nevojitet një alternativë analitike (shih f. 120-179; shih gjithashtu Topalli, 2011). Cipo, ashtu si dhe Sheperi, tregon se infinitivi paraqitet pas foljes *kam*, p.sh. *kam me punue*, dhe siç ai e quan, trajta e dytë e të *primit të dëftores* (f. 153-4). Nuk po marrim në diskutim këtu gramatikën e Vokshit (1959, f. 152, 167; shiko dhe f. 147-202) apo të ngjashmet, të cilat ishin bazuar në variantin e elbaskanishtes, ku përdorimi i infinitivit në fjalë ishte në përbërjen normative të kohës.


Xhuvani (1980 [1956]), ndërsa komenton pozicionin e Sandfeld-it (rreth vitit 1930), përmend zhvillimin e infinitivit, përfshirë praninë e tij në variantin toskë. Për të përforcuar qëndrimin e tij, Xhuvani sjell shembuj nga Dozon-i (1879): *me mbaruar, tuk me thënë*; Vreto (1886): *me qenë, përme mundurë*; Naim Frashëri (1886): *po me mos dashurë, me qenë*; Sami Frashëri (1889): *duk me mos pasurë, duk me mos shkruar' e kënduarë*; dhe De Rada (rreth 1896): *me pasur, me (i) dajtur, me (e) bëen*. Këto ilustrime gjenden në shqipen bashkëkohore, duke filluar nga Rilindja në fillim të shekullit XIX (shih. Riza, 2002, f. 19; Camaj, 1984; Joseph, 1983).

Siç do të ilustrohet më poshtë në bazë të gjetjeve të pasqyruara në korpuset online, diversiteti gjuhësor që përfshin infinitivin e shkurtër perifrazik, vazhdon të jetë i pranishëm edhe sot në shekullin XXI (shih. Gjinari et al., 2007–2008, f. 168-71, 376, 387, 432-3).

Siç shihet në Fig. 1, sipas korpusit të gjuhës shqipe (Albanian National Corpus¹, ANC) për infinitivin perifrazik, përkatësisht (Ø/si/do/kam/për) *me* + pjesore, për një grup të zgjedhur të pjesoreve (n = 14; 671 gjetje totale), *me thanë* dhe *me thënë* rezultojnë në sasi të barabartë (n = 102; 15.2% secila). Ndërsa, *me pasur/patur* nuk pati gjetje të përfillëshme, *me pasë* rezultoi në 83 gjetje (12.4%). Ngjashëm, *me ba* kishte shumë më shumë gjetje (n = 112; 16.7%) sesa *me bëre/bë* (1.3%; 1.2%) respektivisht. Ndërsa *me shkuar* u shfaq vetëm një herë, *me shkue* dhe *me shku* 41 (6.1%) dhe 22 (3.3%) herë përkatësisht. *Me qenë* kishte një numër të konsiderueshëm të gjetjeve (n = 142; 21.2%), sidomos në krahasim me *me kanë/kenë* (5.4%; 1.6%), që është e kuptueshme duke marrë parasysh

që pjesorja *qenë* u përket të dyja dialekteve. Këto gjetje ilustrojnë në një farë mase se infinitivi (i shkurtër) ka qenë në përdorim me intensitet të ndryshëm, në materiale të shkruara që i përkasin sidomos një grupi të zhanreve si (p.sh. letrare, artistike, artikuj gazetash, publicistike, etj.) për pjesën më të madhe të shek. 20 dhe fillimit të këtij aktual, pavarësisht përjashtimit të saj të qartë nga standardi i 1972-it. Nganjëherë si manifestim heteroglosik, ku pjesorja është toskizëm centripetal e paraprirë nga një gegizëm centrifugal *me* p.sh. *me thënë* (khs. *me thanë*).

Figura 1: Sasia e gjetjeve të paskajoreve perifrastike të zgjedhura (me pjesore geqe dhe toske) në ANC




Sa i përket praktikave gjuhësore bashkëkohore në komunikimet verbale, në platformat e ndryshme në internet, ku komunikimi oral është mënyra qendrore, siç janë programet e debateve apo bisedave për tema të ndryshme në Shqipëri dhe rajon gjatë viteve të fundit, shpërfaqet konsiderueshëm targeti i synuar, infinitivi perifrastik i tipit *me + pjesore*.

Metodologjia dhe mbledhja e të dhënave të këtij studimi përfshijnë dëgjimin e tetë videove² (folës = 50; meshkuj: n = 38, 76%; femra: n = 12, 24%), shënimet dhe transkriptimin e objektivit përkatës, pjesoret e shkurta (p.sh. *ndodhë*) janë ndarë në tri kategori të ndryshme për qëllime kodimi sipas elementit paraprak, përkatësisht a.) *me*, b.) *për të*, dhe c.) *pa*

me ose *për të*, pas së cilës u llogarit sasia për secilën, siç shihet në Fig. 2. Pjesorja e shkurtër me parafralën *me* u vërejt në 41.7% (n = 140) të rasteve, *për të* 3.3% (n = 11), dhe pa *me* ose *për të* (p.sh. format me *kam* ose *jam*) në 55% (n = 185) të rasteve. Pjesoret gjithashtu u ndanë dhe u kodifikuan sipas llojit.

Figura 2: Gjetjet e pjesoreve të shkurtra sipas kategorive me dhe pa elementin paraprijës



Së pari do të përqendrohemi në kategorinë *me* + pjesoren e shkurtër në videot e korpusit për këtë investigim.


Tema e videos së parë është *Kulla e Prek Calit*, e regjistruar në Tiranë në vitin 2017; mysafiri E. Hasmija, përdori të paktën dy infinitivë, p.sh. (*kam*) *me thënë*, ndërsa B. Fevziu, drejtuesi i emisionit, afër fundit të programit, shqiptoi (*dubet*) *me apliku*. Në transmetimin *Opozita në protestë, po më pas?* në Opinion në fillim të korrikut të vitit 2019, gjatë debatit u përmend forma e synuar nga i ftuari P. Zogaj, p.sh. (*don*) *me tregu*. Mbrëmjen tjetër kur tema ishte *Gatime moderne*, i ftuari L. Hoxha shqiptoi të paktën dy infinitivë, p.sh. (*si*) *me qenë*, O. Gërdeci (*s'ka çka*) *me ba*, dhe A. Marku *me hangër*. Në një emision tjetër, kur tema e programit ishte *Dasburia për kafshët*, i ftuari M. Llazani përdori konstruktin me pjesore të shkurtër (*për*) *me manipul*. Mbrëmjen tjetër tema ishte *Shpikësit e Rinisë* 2019, duke nënvizuar ceremoninë e fundit të ndarjes së TIK-ut; gjatë diskutimit televiziv, tre nga të ftuarit përdoren infinitivin perifrask,

përkatësisht F. Meqa (një 12-vjeçare nga Gjakova, përfituesja e "Rising Star"): *me siguru, me ardhë*, mes shumë të tjerave; A. Avdimetaj (Washington, D.C.): *me vepru, dashtë*, etj; dhe M. Myftari (Podujeva): (*për*) *me marrë*. Në programin Talk (Koha TV), regjistruar në Prishtinë në vitin 2019, i ftuari, neuropsikiatri, Dr. Afrim Blyta, përdori infinitivin perifrazik, nga ku strukturat morën larmi funksionesh në shprehjen e qëllimores, modalitetit (Camaj, 1984, f. 153 shën. 183, f. 155-6 shën. 186), kushtores (f. 161 shën. 1), dhe kohës së ardhme (f. 152-3 shën.182), p.sh. *me pasë*, (*dubet*) *me qenë*; (*kisha*) *me fokus*, etj.

Fig. 3 paraqet, pjesoren e shkurtër të paraprirë nga parafjala *me*, 47.1% (n = 66) me mbaresën

-*u(e)* (p.sh. *me punu*), ndërsa 39.2% (n = 55) janë të kategorisë me bashkëtingëllore + zanoren fundore *ë* (Bë;p.sh. *me qenë*); dhe 13.7% (n = 19) përmbajnë mbaresë tjetër ose nuk kanë mbaresë fare (p.sh. *me ba, me ble, me hangër*).


Figura 3: Gjetjet e infinitivit perifrazik *me* + pjesore sipas tipeve



Për sa i përket pjesoreve të shkurtra të prira nga *për të*³, një formë e përbërë e infinitivit që gjithashtu shpreh qëllimoren (Camaj, 1984, f. 129-30, shën. 169, 166), 72.3% (n = 8) me mbaresën

-*u(e)*, ndërsa 18.2% (n = 2) ishin të kategorisë *Bë*; dhe 9% (n = 1) përmbajnë mbaresë tjetër ose nuk kanë mbaresë fare, siç tregohet në Fig. 4, të tilla si *për të shku*, *për të prishë*, dhe *për t'u ba* (Murrizi).


Figura 4: Sasia e pjesoreve të shkurtra për të + pjesore sipas tipit



Siç shihet në Figurën 5, një pjesë e konsiderueshme e pjesoreve të shkurtra, të cilave nuk u paraprijnë as *me*, as *për të*, por një element tjetër, p.sh. folja *kam* në kohën e tashme të përkryer⁴ (Camaj, 1984, f. 152-3 shën. 182); 43.8% (n = 81) me mbaresën -*u(e)*, ndërsa 45.4% (n = 84) rezultuan të kategorisë *Bë*, dhe 10.8% (n = 20) përfundojnë me mbaresë tjetër ose pa ndonji mbaresë. Disa shembuj përfshijnë: (*kam*) *jetu* (Hoxha) dhe (*kane*) *mbaru* (Murrizi); (*ka(m)/kemi*) *pasë* (p.sh. Tare, Fevziu, Mema, Shala, Bregu), (*ka*) *ndodhë* (Hasimja) dhe (*kam*) *ardhë* (Trola); (*kane*) *ble* (Zogaj). Përcjellorja dhe shënuesi progresiv *duke* (Camaj, 1984, f. 130, 149-50, 166 shën. 198), gjithashtu shfaqet si paraprijës i pjesores së shkurtër, p.sh. *duke fitu* (M. Marku) dhe *duke (mos) shku* (P. Zogaj). Është rasti të kujtojmë se Topalli thekson (2005, f. 71), në disa rajone togzanoret ue/ua janë reduktuar në *u* (p.sh. *me shku*), e cila nuk shkon më herët se në fillim të shekullit të 18-të.

Akomodimi i bashkëbiseduesit është fenomen linguistik me rëndësi në të tilla raste, si p.sh. kur moderatori i Opinion-it Fevziu po bisedonte me A. Markun, për t'u përshtatur përdori format si (*ke*) *gjetë*, (*keni*) *themelu* me Avdimetajn si dhe (*ke*) *ky*, me Myftarin etj.

Figura 5: Gjetjet e pjesoreve të shkurtra pa *me* ose *për të* + pjesoren, sipas tipit



Kodifikimi jozyrtar i formave jostandarde dikur të stigmatizuara, mund të sjellë dobësimin e *shibboleth-ëve* të vjetra. Hickey (2019) vë në dukje se, nëse folësit, në veçanti ata të një varianti të kodifikuar, “nuk e përceptojnë një strukturë apo veçori si vernakular, atëherë, mund t’i shpëtojnë rretës dhe të përfshihen në...variantin e kodifikuar.” Kjo ndihmon që, format jostandarde të ndërthuren me ngrehinën e standardit; përfshirja e të cilave “mund të manifestojë...preferencë ose tolerancë për struktura ose shprehje të veçanta” (Hickey, 2019), si p.sh. pjesorja e shkurtër e sidomos ajo me mbaresën *-Bë*, e ndoshta edhe së bashku me infinitivin si *me thënë/ thanë, me qenë, me pasë*. Hickey (2019) shkruan se “disa tipare të cilat paraprakisht të stigmatizuara duke qenë tipike për variantet vernakulare, mund të depërtojnë lart drejt variantit mbirajonal dhe të çlirohen prej stigmës gjatë procesit.” Kjo do të thotë që, toleranca ndaj varianteve gjuhësore dhe destigmatizimi shkojnë dora-dorës, siç tregojnë shembujt në rastin e pjesores së shkurtër, p.sh. *pasë, ndodhë, ardhë*, e mbase edhe *shku, çu, caktu* e tj. *Shiboleth-ët* e vjetra si pasojë mund të dobësohen duke pasur parasysh tolerancën për variacionin gjuhësor. Praktika të tilla gjuhësore vërehen tek intelektualët si Elvis Hoxha⁵, në rastin e infiltrimit të infinitivit p.sh. (*për*) *me i zhdukë*, apo nga figura politike si Ilir Meta⁶, si p.sh. me pjesoren e shkurtër (*për të*) *caktu, (ka) vendosë* dhe (*kam*) *çu*.

Më tej, në disa ekosisteme gjuhësore në internet ku përdoruesit e shqipes, herë pas here anashkalojnë *shiboleth-ët* gjuhësore përmes qasjes transgresive të normave të shqipes standarde; edhe pse kodifikime të institucionalizuara në dukje, funksionojnë si një standard gjysmë-*zombie*

(shih. Deumert, 2010), që paraqiten me titra kur folësi përdor një gjuhë tjetër përveç shqipes.

3.0 Implikimet dhe Përfundimet

Në shqipen bashkëkohore format heteroglosike shpërfaqen në shkëmbimet verbale online në diskutime e biseda, si dhe në tekste (gjysmë-) formale, me ç'rast shumëllojshmëria e matricës, p.sh. centripetali, shfaqet - në shkallë të ndryshme – duke konkurruar me centrifugalin, ose vise versa. Rezultati i kësaj konkurrence, herët a vonë mund të përfshijë në diskutet publike format si pjesorja e shkurtër e pse jo edhe infinitivi gegë; praktikat gjuhësore diaglosike dhe demotike shpërfaqen duke ekspozuar kështu elemente të kodifikimit implicit të pazyrtarizuara që përfshijnë zbehjen dhe dobësimin e stigmës ndaj ndërtimeve gjuhësore të përjashtuara më parë. *Shibboleth*-et e epokës së kaluar, në kontekstin gjuhësor ku p.sh. infinitivi i shkurtër (gegë) ishte verboten, tani po pranojnë kalimin e formave të tilla, ndërsa në rajone ku po ringjallen rregullisht amalgamat e zhvleftësuar dikur – po hyjnë qoftë edhe përmes anashkalimit të tyre. Procesi i destandardizimit dhe *shibboleth*-et demotike ilustrojnë një trajektore të zhvillimit të një standardi bashkëkohor të paqtë evolutiv.

4.0 Referencat:

1. *Albanian National Corpus*.
<http://webcorpora.net/AlbanianCorpus> (accessed 7 May 2019).
2. Auer, P. (2005). Europe's sociolinguistic unity, or: A typology of European dialect/standard constellations. In N. Delbecque, J. van der Auwera, & D. Geeraerts (Eds.), *Trends in linguistics. Studies and monographs [TiLSM]: Perspectives on variation: Sociolinguistic, historical, comparative* (pp. 7–42). Berlin/Boston, DE: De Gruyter Mouton.

3. Auer, P., & Spiekermann, H. (2011). Demotisation of the standard variety or destandardization? The changing status of German in late modernity. In T. Kristiansen & N. Coupland (Eds.), *Standard languages and language standards in a changing Europe* (pp. 161–176). Oslo: Novus Press.
4. Bell, A. (2011). Leaving home: De-europeanisation in a post-colonial variety of broadcast news language. In T. Kristiansen & N. Coupland (Eds.), *Standard languages and language standards in a changing Europe* (pp. 177–198). Oslo: Novus Press.
5. Blackledge, A., & Creese, A. (Eds.). (2014). *Heteroglossia as practice and pedagogy*. Dordrecht: Springer. doi:10.1007/978-94-007-7856-6
6. Byron, J. L. (1976). *Selection among alternatives in language standardization: The case of Albanian*. The Hague: Mouton.
7. Camaj, M. (1984). *Albanian grammar*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz.
8. Cerruti, M., & Regis, R. (2014). Standardization patterns and dialect/standard convergence: A northwestern Italian perspective. *Language in Society*, 43(1), 83–111. doi:http://dx.doi.org.ezproxy.rit.edu/10.1017/S0047404513000882
9. Cipo, K. (1949). *Grammatika shqipe*. Tiranë: Instituti i Shkencave.
10. Coupland, N., & Kristiansen, T. (2011). SLICE: Critical perspectives on language(de)standardization. In T. Kristiansen & N. Coupland (Eds.), *Standard languages and language standards in a changing Europe* (pp. 11–35). Oslo: Novus Press.
11. Davies, W. V. (2012). Myths we live and speak by: Ways of imagining and managing language and languages. In M. Hüning, U. Vogl, & O. Moliner (Ed.), *Standard languages and multilingualism in European history* (pp. 45–69). Amsterdam, NLD: John Benjamins Publishing Company.

12. Deumert, A. (2010). Imbodela zamakhumsha – reflections on standardization and destandardization. *Multilingua*, 29, 243–264. doi:10.1515/mult.2010.012
13. Gasiorowski, P. (2006). A shibboleth upon their tongues: Early English /r/ revisited. *Studia Anglica Posnaniensia*, 42, 63.
14. Gjinari, J., Beci, B., Shkurta, G., & Gosturani, Xh. (Eds.). 2007–2008. *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, 2 vols. Napoli: Univ. degli Studi di Napoli l'Orientale.
15. Hickey, R. (2019). Re-examining Codification. *Language Policy*. <https://doi.org/10.1007/s10993-019-09523-2>
16. Joseph, B. (1983). *The synchrony and diachrony of the Balkan infinitive: A study in areal, general and historical linguistics*. Cambridge: Cambridge University Press.
17. Joseph, B., & Krapova, I. (Eds.). (2018). *Balkan syntax and (universal) principles of grammar*. Retrieved from <https://ebookcentral.proquest.com>
18. Kristiansen, T. (2016). Contemporary standard language change: Weakening or strengthening? *Taal en Tongval Language Variation in the Low Countries* 68(2), 93–117. Uitgave: Amsterdam University Press. <https://doi.org/10.5117/TET2016.2.KRIS>
19. Milroy, J. (2001). Language ideologies and the consequences of standardization. *Journal of Sociolinguistics*, 5(4), 530–555.
20. Nouguerón-Liu, S., & Warrier, D. S. (2014). Heteroglossic practices in the online publishing process: Complexities in digital and geographical borderlands. In A. Blackledge & A. Creese (Eds.), *Heteroglossia as practice and pedagogy* (pp. 179–197). Dordrecht: Springer.
21. Pietikäinen, S., & Dufva, H. (2014). Heteroglossia in action: Sámi children, textbooks and rap. In A. Blackledge & A. Creese (Eds.), *Heteroglossia as practice and pedagogy* (pp. 59–74). Dordrecht: Springer.

22. Ricento, T. (2000). Historical and theoretical perspectives in language policy and planning. *Journal of Sociolinguistics*, 4(2), 196–213.
23. Riza, S. (2002 [1956]). *Vëpra 3*. Botim të veçanta XLIV Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
24. Rutten, G. (2016). Historicizing diaglossia. *Journal of Sociolinguistics*, 20(1), 6–30. doi:10.1111/josl.12165
25. Rutten, G. J., Vosters, R., & Vandenbussche, W. (2014). The interplay of language norms and usage patterns: Comparing the history of Dutch, English, French and German. In G. J. Rutten, R. Vosters, & W. Vandenbussche (Eds.), *Advances in historical sociolinguistics: Norms and usage in language history, 1600–1900: A sociolinguistic and comparative perspective* (pp. 1–17). Amsterdam, NL: John Benjamins Publishing Company. ProQuest ebrary.
26. Schilling, C. (2016). *Heteroglossia online*. Bern, Switzerland: Peter Lang D. Retrieved from <http://ebookcentral.proquest.com/lib/rit/detail.action?docID=4740790>.
27. Sheperi, I. D. (2001 [1927]). *Grammatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe: Sidomos e toskënishtes*. Tiranë: Albin.
28. Sonnenhauser, B., & Widmer, P. (2019). Prefixal articles across domains: Syntactic licensing in Albanian. *Folia Linguistica*, 53(1), 25-49. <https://doi.org/10.1515/flin-2019-2003>
29. Topalli, K. (2005). *Bazat e fonetikës historike të gjuhës shqipe*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
30. Topalli, K. (2011). *Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
31. Vallejo, C., & Dooly, M. (2019) Plurilingualism and translanguaging: Emergent approaches and shared concerns. Introduction to the special issue. *International Journal of Bilingual Education and Bilingualism*. doi: 10.1080/13670050.2019.1600469

32. Vokshi, H. (1959). *Gramatika për klasën e VII e VIII të shkollave fillore*. Prishtinë: Rilindja.
33. Vosters, R., & Rutten, G. (2015). Three southern shibboleths: Spelling features as conflicting identity markers in the low countries. *Written Language and Literacy*, 18(2) 260-274.
34. Vosters, R., Rutten, G. & Vandenbussche, W. (2012). The sociolinguistics of spelling. A corpus-based case study of orthographical variation in nineteenth-century Dutch in Flanders. In A. van Kemenade & N. de Haas (Eds.), *Historical linguistics 2009. Selected papers from the 19th International Conference on Historical Linguistics* (pp. 253–273). Amsterdam: John Benjamins. DOI: 10.1075/cilt.320.13vos
35. Woodhouse, R. (2003). The Biblical shibboleth story in the light of late Egyptian perceptions of Semitic sibilants: Reconciling divergent views. *Journal of the American Oriental Society*, 123(2), 271-289. doi:10.2307/3217684
36. Xhuvani, A. (1980 [1956]). *Vepra 1: Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

<http://webcorpora.net/AlbanianCorpus>

¹² Videot e perdorura: <https://tvklan.al/opinion-kulla-e-prek-calit-komuniste-e-nacionaliste/> Opinion - Kulla e Prek Calit, komuniste e nacionaliste! (19 shtator 2017); <https://opinion.al/opinion-opozita-ne-proteste-po-me-pas/> (8 korrik 2019); <https://opinion.al/opinion-gatime-moderne/> (9 korrik 2019); <https://opinion.al/opinion-dashuria-per-kafshet/> (16 korrik 2019); <https://www.youtube.com/watch?v=sKlZ3ovsDTE;> <https://opinion.al/opinion-shpikesit-e-rinj-2019/> Shpikësit e rinj 2019 (18 korrik 2019); Report Tv - 45 Minuta, i ftuar Myslim Murrizi (6 qershor 2019); <https://www.youtube.com/watch?v=grMvtSoNWR0> Flori si alpinist në Bjeshkët e Kosovës - Pushime On Top (23 korrik 2019); <https://www.youtube.com/watch?v=ifw4DzbYfEE> Prindërimi, të udhëzosh gjeneratën e ardhshme dhe të falësh gjeneratën e kaluar (24 shkurt 2019).

³ Shenim: Përveçse kur pjesoret *qenë* dhe *marrë* paraprihen nga *me*, në shumicën e rasteve janë përjashtuar nga numrimi.

⁴ duke përfshirë formën jo-veprorë me *jam*, edhe në kontekste kur përdoret për foljet jokalimtare.

⁵ Shih. <https://www.kohajone.com/2019/05/31/bernabic-fytyra-me-e-fundit-e-civilit-terrorist/> (31 maj 2019).

⁶ Tempora-President i Republikës Ilir Meta 23 korrik 2019

<http://www.oranews.tv/emisionet/tempora/presidenti-republikes-ilir-meta-ekskluzivisht-ne-tempora>

Marek MAJER

PARAHISTORIA INDOEVROPIANE E FJALËS SHQIPE PËR 'MOTRËN'

Abstrakt

Shq. motër (në disa dialekte dhe në gjuhën e vjetër edhe motrë, motërë) konsiderohet përgjithësisht si refleksi i drejtpërdrejtë i fjalës indoevropiane për 'nënë' – *meh₂ter- (khs. skt. mā₂tr-, gr. mētēr, lat. māter, sll. mati etj.). Dallimi kuptimor shpjegohet ose si rezultat i një ndryshimi semantik të gjerë – ndoshta me disa hapa të ndërmjetëm (p.sh. 'nënë' > 'çdo femër e afërt' > 'motër') – ose si pasojë e ndryshimeve në strukturën e përgjithshme të terminologjisë së farefisnisë për shkak të zhvillimeve jashtëgjuhësore (p.sh. është supozuar se motra e madhe përmbushte rolin e nënës). Ky mendim shprehet në të gjithë fjalorët etimologjikë të shqipes (Meyer 1891: 287–288; Çabej 1976: 371; Huld 1984: 96; Demiraj 1997: 279; Orel 1998: 275; Topalli 2018: 1009) dhe të indoevropianishtes (p.sh. NIL: 457–460), si dhe në punimet që trajtojnë historinë e leksikut të shqipes nga perspektivat indoevropiane (p.sh. Barić 1955: 57–58, Tagliavini 1965: 118; Matzinger 2018: 1789). Megjithatë, një ndryshim aq rrënjësor semantik nuk duket shumë i besueshëm; gjithashtu, nuk ka arsye për të supozuar një ristrukturim të përgjithshëm të terminologjisë së farefisnisë (meqenëse emërtimet e tjera të trashëguara të farefisnisë shfaqen pikërisht me kuptimet e tyre të pritura, p.sh. vjehërr < pie. *swekuro- [khs. skt. svásura-, gr. hekurós, lat. socer, sl. svekrъ] ose nip < pie. *nepot- [khs. skt. nāpāt-, gr. anepsiós, lat. nepōs, sl. netъjъ]). Në fakt, autoritetet etimologjike më të kujdesshme (p.sh. Demiraj 1997) pranojnë që zhvillimi semantik i fjalës motër mbetet një mister i plotë.

Pra, në këtë studim shq. motër analizohet jo si refleksi, por si derivat mjaft i vjetër i fjalës indoevropiane për ‘nënë’. Domethënë, kemi të bëjmë ose me një mbiemër pronor *meh2t-(e)r-o- ‘i cili ka të njëjtën nënë’, ose me një mbiemër relacional *meh2t-(e)r-o- ‘nga e njëjta nënë’, ‘i së njëjtës nënë’. Trajta femërore e një mbiemri të tillë (*meh2t-(e)r-eh2- > *māterā) mund të ketë qenë leksikalizuar si ‘gruaja që ka të njëjtën nënë’ / ‘gruaja që vjen nga e njëjta nënë’ dhe të ketë zëvendësuar fjalën e trashëguar për ‘motrën’ (pie. *swesor-). Zëvendësime të tilla leksikore janë shumë të përhapura në gjuhët indoevropiane, p.sh. gr. adelph(e)ós ‘vëlla’ < *sm̥g^welb^h-es-o- ‘që vjen nga e njëjta mitër’, span. hermano ‘vëlla’ < lat. germānus ‘nga [i njëjti] fis/farë’ ← germen ‘farë’. Siç dihet mirë, edhe shq. vëlla mendohet të ketë origjinë të këtij lloji: *swe-lowd^h-eh2- ‘[nga] fisi i vet’. Me sa duket, një ide e ngjashme në lidhje me fjalën motër është paraqitur në disa vepra të Hamp-it (1986: 110; 1996: 140), por me disa dallime dhe pa një analizë të hollësishme të sfondit indoevropian. Duke ditur që vërejtjet e Hamp-it rreth kësaj fjale fatkeqësisht nuk janë përfshirë në asnjë fjalor etimologjik dhe mungojnë nga debati i përgjithshëm, punimi i pranishëm është një përpjekje për të ofruar një analizë të plotë dhe moderne.

Fjalet kyçe: *motër, nënë, etimologji, terminologji ne farefisnisë, ndryshim semantikë, derivacion*

Abstract

Alb. *motër* (dialectal and Old Albanian also *motrë, motërë*) is universally considered to be a direct reflex of the Proto-Indo-European word for ‘mother’ – *meh₂ter- (Sanskrit. mā^{tr̥}, Gr. μέ^τēr, Lat. māter, Slav. *mati *matere etc.). The difference in meaning is explained either as far-reaching semantic change – possibly including intermediate steps (e.g., ‘mother’ > ‘any female relative’ > ‘sister’) – or as the product of changes in kinship terminology caused by extra-linguistic developments (e.g., it has been assumed that the older sister fulfilled the role of the mother). However, such a radical semantic change does not appear likely; similarly, there is

no reason to assume any general restructuring of kinship terminology, given that other inherited kinship terms surface precisely with their expected meaning (*vjebërr* ‘father-in-law’ < PIE **swek*□*uro-*, *nip* ‘grandson/nephew’ < PIE **nepot-*). Thus, in the present study – which draws on a little-known idea by Eric Hamp – Alb. *motër* is analysed not as a reflex but as an early derivative of the IE word for ‘mother’. Namely, we are dealing either with a possessive adjective **meh₂t-(e)r-o-* ‘having the [same] mother’ or with a relational adjective **meh₂t-(e)r-o-* ‘of the [same] mother’. The feminine form of such an adjective (**meh₂t-(e)r-eh₂>* **mäterā*) may have been lexicalized as ‘woman having the same mother’ / ‘woman of the same mother’ and replaced the inherited word for ‘sister’ (PIE **snesor-*). Such lexical replacements are widespread; cf. Greek *adelph(e)ós* ‘brother’ < **sm₂-g^welb^h-es-o-* ‘of the same womb’ or Spanish *hermano* ‘brother’ < Lat. *germānus* ‘real, *from the [same] seed’.

Keywords: *sister, mother, etymology, kinship terminology, semantic change, derivation*

1. Hyrje¹

Dihet mirë që në gjuhën shqipe ruhet vetëm një pjesë e vogël e terminologjisë së farefisnisë paraindoeuropiane. Siç mund të shihet më poshtë, shumica e leksemave kryesore të kësaj fushe – p.sh. **ph₂tēr* ‘baba’, **b^hreb₂tēr* ‘vëlla’, **swesōr* ‘motër’, **subnus* ‘bir’ dhe **d^hugh₂tēr* ‘bijë’ – janë zëvendësuar me elemente të tjera dhe nuk kanë lënë asnjë gjurmë në shqipe:

fjalë pie.	reflekte kryesore	zëvendësime shqipe
<i>*ph₂tēr</i>	sanskr. <i>pitṛ-</i> , lat. <i>pater</i> , gr. <i>patḗr</i> , ang. <i>father</i>	→ <i>atë, baba</i> etj.
<i>*b^hreb₂tēr</i>	sanskr. <i>bhrā-</i> <i>tr-</i> , lat. <i>frāter</i> , sll. <i>*bratrŭ</i> , ang. <i>brother</i>	→ <i>vëlla</i> etj.
<i>*swesōr</i>	sanskr. <i>svásr-</i> , lat. <i>soror</i> , sll. <i>*sestra</i> , [nord. vjet. →] ang. <i>sister</i>	→ <i>motër</i> etj.
<i>*subnus</i>	sanskr. <i>sūnú-</i> , sll. <i>*synŭ</i> , lituan. <i>sūnūs</i> , ang. <i>son</i>	→ <i>bir, djalë</i> etj.
<i>*d^hugh₂tēr</i>	sanskr. <i>dúhitṛ-</i> , gr. <i>thygátēr</i> , sll. <i>*dūt’i</i> <i>*dūt’ere</i> (rus. <i>dóčdóčeri</i> , serb. <i>kći kćeri</i> , bullg. <i>dāšterjā</i>), ang. <i>daughter</i>	→ <i>bijë, vajzë</i> etj.

Nga paraindoeuropeanishtja u trashëguan vetëm disa leksema më pak qendrore, si p.sh. *vjehërr* (< pie. **swek-* *uros*, me disa vështirësi fonologjike; khs. sanskr. *śvāsura-*, gr. *hekurós*, sll. **svekrъ*, gjerm.

¹ Ky studim është paraqitur edhe në konferencën *Ljubilej – Ljubljäum – Ljubilee – Ljubljanniversaire. IG / SIES / SÉIE Arbeitstagung (100 years of comparative linguistics at the University of Ljubljana)*, Lubjana, 4–7 qershor 2019. Deshiroj të shpreh mirënjohjen time për pjesëmarrësit e këtij Seminari dhe të konferencës së lartpërmendur, si dhe për kolegun tim Sergio Neri (Mynih), për disa vërejtje shumë të dobishme. Gjithashtu, do të doja ta falënderoj kolegun tim Plator Gashin (Prishtinë), i cili ka korrigjuar tekstin tim në shqip. Një version në anglisht i këtij artikulli do të botohet në aktet e konferencës së Lubjanës së lartpërmendur, në serinë *Studien zur historisch-vergleichenden Sprachwissenschaft* (Baar-Verlag, Hamburg).

Schwieger[vater]), *nip/mbesë*² (< pie. **nepōts*/**neptih*₂, khs. sanskr. *nāpāt*, lat. *nepōs*, sll. **netjǫ*, lituan. *nepuotis*, gjerm. *Neffē*) dhe *gÿsh* (< postpie. **subsÿos*, **subsēn* ose ngjashëm³; khs. sanskr. *sūs*□ *ā*□), me interpretime të ndryshme; shih Mayrhofer EWAia: 714).⁴

Megjithatë, ka një përjashtim interesant edhe në grupin e termave kryesorë. Bëhet fjalë për leksemën *motër* (në disa dialekte dhe në gjuhën e vjetër edhe *motërë*, *motrë*), e cila duket se përbën një refleks të drejtpërdrejtë të fjalës indoevropiane për ‘nënë’ – **meh*₂*tēr* (khs. sanskr. *mā*□ *tr*-gr. *mētēr*, lat. *māter*, sll. **mati***matere*, angl. *mother* etj.)⁵. Kjo analizë gjendet në të gjithë fjalorët etimologjikë të shqipes (Meyer 1891: 287–288, Çabej 1976: 371, Demiraj 1997: 279, Huld 1984: 96, Orel 1998: 275, Topalli 2018: 1009) dhe të paraindoevropianishtes (p.sh. NIL: 457–460), si dhe në punimet që trajtojnë historinë e leksikut të shqipes nga perspektiva indoevropiane (p.sh. Matzinger 2018: 1789). Prapëseprapë, dallimi kuptimor midis leksemës paraindoevropiane burimore (‘nënë’) dhe refleksit të saj në shqipë (‘motër’) është shumë i habitshëm dhe përbën një problem të famshëm të etimologjisë shqipe.

² Nëse jo të huazuar nga latinishtja.

³ Në çdo rast bëhet fjalë për një term inovativ të prejardhur ngarrënjë **sewb-* ‘lind’, i cili e zëvendëson termin paraindoevropian **b₂ewb₂os* (khs. hetit. *huhh*□*aš*, lat. *avus*, sll. **ujj*□*pol. wuj*, serb. *ŭj(ak)*, maq. *wuj(ko)*], tochar. B *awe*, armen. *haw* ‘gjysh’).

⁴ Ka pak të ngjarë që termat *vajzë* dhe *joshë* kanë prejardhje të drejtpërdrejtë indoevropiane (pavarësisht nga mendimi i Mallory & Adams 2009: 216, Hamp 1986 etj.; shih diskutimin në Demiraj 1997). Në anën tjetër, me sa duket, fjala *vëlla* është një inovacion i përbërë nga elemente indoevropiane; shih më poshtë në seksionin 4.

⁵ Kjo fjalë rindërtohet zakonisht si **meh*₂*tēr* në gjuhësinë indoevropiane moderne, domethënë me rrënjën e dukshme **meh*₂; mirëpo, është jo më pak e mundshme se ajo bazohet në rrokjen e gjithpranishme të gjuhës femijërore [ma(:)] (khs. p.sh. Ringe 2017: 16; ideja i atribuohet Weissit, i cili, mëgithatë, rindërton **meh*₂*tēr* në botimet e veta; Weiss 2009: 42). Argumenti për rindërtimin **meh*₂*tēr* do të mund të forcohej nëse do të gjendej një lidhje me një rrënjë **meh*₂- me kuptimin e përshtatshëm; deri tani, kjo nuk duket të jetë rasti (khs. diskutimin në NIL: 459; një hipotezë e re në u propozua kohët e fundit në Ackermann 2018).

2. Shpjegimet ekzistuese

Në përgjithësi, në literaturën ekzistuese, kjo çështje është rrokur në dy mënyra. Teoria e parë mund të përshkruhet si ndryshim semantik ‘i pastër’. Sipas këtij mendimi, fjala paraindoevropiane **meh₂tër* thjesht ka pësuar një zhvillim kuptimor nga ‘nënë’ drejt ‘motër’ dikur mes epokës paraindoevropiane dhe shqipes së dëshmuar. Trajektorja e saktë nuk diskutohet shpesh, por në parim do të mund të mendohej që së pari ndodhi një zgjerim semantik (p.sh. nga ‘nënë’ drejt ‘e afërme’ ose ‘femër’ në përgjithësi) dhe pastaj një ngushtim semantik (drejt ‘motër’). Cilatdo të jenë hollësitë e këtij zhvillimi, ky rast është përdorur gjerësisht në literaturën linguistike si shembull i shquar i proceseve jotipike semantike; p.sh. në Eska & Ringe (2004: 572): „One may note that Albanian *motër* ‘sister’ continues a form of Proto-IE **meh₂ter-* ‘mother’, thus demonstrating that semantic shifts in female kin terms are possible and that the meanings cannot be taken for granted“.

Ky shpjegim, natyrisht, nuk mund të përgënjeshtrohet përfundimisht; megjithatë, supozimi se një nga elementet kryesore të trashëguara të terminologjisë së farenfisnisë ka pësuar dy (ose më shumë) ndryshime aq rrënjësore semantike njëra pas tjetrës nuk duket shumë i besueshëm. Paralelet e ndryshme të përmendura në literaturën etimologjike nuk duken bindëse: ato, në fakt, nuk pasqyrojnë një proces identik, por zakonisht ilustrojnë poliseminë e parashikueshme të fjalëve të shumëllojshme fëmijërore (p.sh. Jokl 1923: „sanskritisht *attā* ‘nënë, motra e madhe, (...) altaikisht-tatarisht *ača* ‘baba’, por edhe ‘vëllai i madh, xhaxha’⁶). Prandaj, nuk është për t’u habitur që janë eksploruar edhe qasje të tjera.

Sipas teorisë së dytë – me sa duket, më të përhapur – dallimi kuptimor midis fjalës pie. **meh₂tër* ‘nënë’ dhe refleksit të saj shqip *motër* pasqyron disa rrethana specifike të shoqërisë dhe të familjes (para)shqiptare. Domethënë, sipas kësaj hipoteze, kuptimi i ri i fjalës *motër* mund të shpjegohet si pasojë e ndryshimeve në strukturën e përgjithshme

⁶ „ai. *attā* Mutter, ältere Schwester, (...) altaisch-tatarisch: *ača* Vater, aber auch älterer Bruder, Onkel“; perkth. MM.

të terminologjisë së farefisnisë për shkak të zhvillimeve jashtëgjuhësore; p.sh., është supozuar se motra e madhe përmbushte rolin e nënës. Ky mendim mund të gjendet në fjalorin etimologjik të Gustav Meyerit (1891: 287–288); më pas, ai është pranuar p.sh. nga Tagliavini (1965: 118), Pudići (1978: 115), Çabej (1976: 371), dhe kohët e fundit Topalli (2018: 1009). Pra, sipas kësaj qasjeje, mendohet që kuptimi i fjalës *motër* në fakt mund të na zbulojë disa informacione të çmuara për tërë sistemin e farefisnisë së shoqërisë (para)shqiptare. Për një shembull mjaft ekstrem i cili tregon sa shumë konkluzione janë marrë me mend nga kjo fjalë e vetme, khs. konstatimin vijues të Martin Huldit (1984: 96): „In Omaha-kinship systems of terminology as is reconstructed for Proto-Indo-European, the term ‘mother’ extends to the mother’s sister and her daughters (...). If the intermediate kinship terminology of the pre-Albanians was of the Hawaiian type, then these cousin terms would come to mean ‘sibling’ as well. The transfer to ‘sibling’ only was facilitated by the rise of Eskimo-type terms in the early Middle Ages when ‘cousin’ was borrowed from Latin“.⁷

Në të vërtetë, sidoqoftë, e gjithë kjo është një hamendësim i mbështetur vetëm në kuptimin e papritur të leksemës *motër*. Ndryshe, nuk ka asnjë arsye për të supozuar një ristrukturim të përgjithshëm të terminologjisë së farefisnisë në historinë e gjuhës shqipe. Përkundrazi, emërtimet e tjera të trashëguara indoevropiane shfaqen pikërisht me

⁷ Përfundime disi të ngjashme janë nxjerrë p. sh. nga Barići (1955: 57–58), i cili pohon se ndryshimi semantik në fjalën tonë është shkaktuar nga kontakti me një substrat joindoevropian të pranishëm në Evropë para ardhjes së popujve indoevropianë. Ai thekson që në shqipe, termat e trashëguar indoevropianë për ‘birin’ (pie. **subnūs*) dhe për ‘bijën’ (pie. **d^hugh²tēr*) janë zëvendësuar nga leksemat *bir* dhe *bijë*, që ngjajnë me fjalën mesape *bilia* ‘bijë’ (mesapishtja është një gjuhë e deshmuar shumë dobët në Italinë antike, e cila mendohet nga disa gjuhëtarë të jetë e lidhur posaçërisht ngushtë me shqipen brenda familjes indoevropiane). Në lidhje me këtë, Barići shton: „Po me këto ndikime shpjegohet, me shumë gjasë, pse në gjuhën shqipe fjala *motër* nuk ka kuptimin „nënë“ që ka në gjuhët tjera indoevropiane, por „motër“, sepse në terminologjin familjare të shqipes ka ushtruar ndikim sistemi matriarkal mediteran, i cili shihet aq qartë edhe në gjurmat *couvade*“. (*Couvade* është një zakon ose rit – i njohur në fushën shqiptare si *mërkosb* – sipas së cilit burri që do të bëhej baba pritet të imitojë procesin e lindjes dhe, pasi që gruaja e tij e lind fëmijën, të sillet si lehonë. Ky zakon është i dokumentuar p.sh. në fjalorin e Kristoforidhit.)

kuptimet e tyre të pritura, p.sh. *vjehërr* < pie. **swek* □ *uros* (khs. sanskr. *śvāsura*-, gr. *bekurós*, lat. *socer*, sll. **svekrǫ*) ose *nip* < pie. **nepōts* (khs. sanskr. *nāpāt*, lat. *nepōs*, sll. **netъjъ*, lituan. *nepuotis*, gjerm. *Neffe*). Pra, ka shumë pak të ngjarë që është bërë një revolucion terminologjik në këtë fushë ndonjëherë në historinë e shqipes.

Për ta përmbledhur, asnjë prej të dy hipotezave kryesore s'duket e pranueshme. Në fakt, autoritetet etimologjike më të kujdesshme (p.sh. Demiraj 1997: 279) pranojnë që zhvillimi semantik i fjalës *motër* mbetet një mister i plotë⁸.

3. Vërejtjet e Hampit

Studiuesi i vetëm që ka ofruar një alternativë të vërtetë për hipotezat e lartpërmendura është Eric Hamp. Sugjerimi i tij në lidhje me fjalën *motër* gjendet në dy artikuj shumë të shkurtër (1986: 110; 1996: 140); hipoteza e tij është në fakt vetëm një shënim anësor i shtuar teorisë së tij për leksemën *vajzë*. Kjo teoria e fundit – interesante, por shumë spekulative – thotë se fjala *vajzë* (në disa dialekte edhe *varzë* etj.) është një refleks i fjalës së lashtë **swesōr*, e cila kishte kuptimin 'motër' në gjuhën paraindoevropiane. Sipas Hampit, trajta **swesōr* është bërë parashqip **var* përmes një kombinimi të ndryshimeve fonologjike dhe analogjike. Ai përfundon se kur fjala **swesōr* zhvilloi kuptimin e ri 'girl', lindi nevoja për ta shprehur qartë kuptimin 'sister', që u arrit me anë të një fraze 'mother's girl': „**mātrā uor*->*var*-, i.e. *motrë (var-)*“ (1986: 110). Edhe pse Hampi nuk e thotë drejtpërdrejt, duket se ai kishte ndërmend një lloj rrjedhoje relacionale të leksemës paraindoevropiane për 'nënë' (domethënë, 'motherly, amënor') dhe jo një formë paradigmatiche të saj (domethënë, 'mother's', 'e nënës'). Ndoshta për shkak të karakterit të tyre lakonik dhe të vendit relativisht të panjohur të botimit, vërejtjet mendjemprehta të Hampit për prejardhjen e fjalës *motër* praktikisht janë injoruar në debatin

⁸ Fakti që refleksi i pie. **meh2ter* ka një kuptim të papritur edhe në lituanishte (*motė* 'grua, bashkëshorte', *móteris* 'femër') nuk ka shumë rëndësi për rastin tonë: boshllëku semantik është dukshëm më i vogël, derisa kuptimi i trashëguar 'nënë' ruhet si brenda lituanishtes (*motė* – kuptimi dialektor 'nënë') dhe në gjuhët e tjera baltike (leton. *māte*, prus. *mūti* 'nënë'; kuptimi i vetëm).

etimologjik (Hamp 1986 përmendet në fjalorin e Topallit, por hipoteza nuk është përfshirë në diskutim). Mirëpo, duket qartë se analiza e Hampit shkon në drejtimin e duhur, dhe është e mundur për të zhvilluar një teori më të plotë dhe më pak të lidhur me historinë e fjalës *vajzë*, e cila, duhet ta pranojmë, mbetet mjaft e paqartë (khs. Demiraj 1997: 406–407).

4. Teori e plotë

Prandaj, në vend se ta analizojmë fjalën *motër* si refleks të drejtpërdrejtë të leksemës paraindoeuropiane për ‘nënë’, mund të supozojmë që kemi të bëjmë me një rrjedhojë mjaft të vjetër të kesaj lekseme – me shumë gjasë, një rrjedhojë fillimisht mbiemërore me **-o/-eb₂-*, domethënë një trajtë **meh₂t(e)r-o-* / **meh₂t(e)r-eb₂* (që nga **māt(e)r-o-* / **māt(e)r-ā*)⁹.

Kjo hipotezë na jep mundësi të gjejmë një shpjegim të thjeshtë për semantikën e fjalës *motër*. Në parim, rrjedhoja mbiemërore (post)paraindoeuropiane **meh₂t-(e)r-o-* duhet të jetë kuptuar ose si ‘i cili ka një nënë’ ose si ‘i nënës, amënor’. Idealisht, kuptimi i parë (domethënë pronor, ‘i cili ka një nënë’) do të mund të pritej të shfaqte gradën e reduktuar ose të pandryshuar apofonike të rrënjës (NIL: 575–578; Höfler 2017: 48–49); khs.:

- i. pic. **rot-eb₂* ‘rrotë’ → **rot-h₂-o-* ‘i cili ka rrota’ (> sanskr. *rātha*-‘koçi’)
- ii. pic. **b₂melg* ‘qumësht’ → **b₂melg* -o- ‘i cili ka qumësht’ (> paragjerm. **melka*-‘që jep qumësht’ > angl. vjet. *melc*, angl. *milch* [*cow*] ‘lopë qumështi’)

Në anën tjetër, kuptimi i dytë (domethënë relational, ‘i nënës, amënor’) do të mund të pritej të shfaqte procesin *vr̥ddhi*, domethënë ngritjen e gradës apofonike (NIL: 72–79, 529–537, Nikolaev 2015: 466);

⁹ Duhet të theksohet se këtu nuk bëhet fjalë vetëm për një rregullim të tipit morfologjik sinkronik të leksemës *motër*. Siç dihet mirë, shqipja nuk i ruan temat më *-r-* të paraindoeuropianishtes si tip morfologjik të dallueshëm, dhe fakti që fjala *motër* duhet se rindërtohet si parashqipe **māt(e)ra* (domethënë një temënë *-ā-*) është e qartë prapëseprapë (khs. format *motërë* dhe *motrë*, të dëshmuara në dialekte dhe në gjuhën e vjetër). Përkundrazi, analiza jonë vepron me një proces derivacional të vërtetë, që përfshin një ndryshim të kuptimit. Shih gjithashtu poshtëshënimin 11.

khs.:

- i. pie. **dīm-* ‘qiell i ndritshëm, perëndi i qiellit’ → **deym-o-*i qiellit të ndritshëm, hyjnor’ (> sanskr. *devá-*, lat. *deus*, lituan. *diẽvas* ‘perëndi’)
- ii. pie. **ped-*‘këmbë’ → **pēd-o-*‘i këmbës, këmbësor’ (gr. *pēdon*‘pjesa fundore e rremit’)

Mirëpo, duke pasur parasysh statusin e paqartë apofonik të rrënjës së fjalës paraindoevrpiane për ‘nënë’ (**meh₂ter-?* **mā₂ter-?* **mā₂ter-?* – shih poshtëshënimin 5), është vështirë për të vendosur cila prej të dy mundësive formale ka më shumë të ngjarë të jetë e saktë.

Megjithatë, secila prej tyre mund të ketë zhvilluar lehtësisht semantikën ‘motër’ duke qenë kuptuar si ‘e cila ka [të njëjtën]¹⁰ nënë’ ose ‘nga [e njëjta] nënë’, respektivisht. Kështu, **meh₂t(e)r-e-b₂* > **māt(e)rā*¹¹ ‘gruaja që ka të njëjtën nënë’ ose ‘gruaja që vjen nga e njëjta nënë’ mund të leksikalizohet me kuptimin ‘sister’ dhe ta zëvendësonte fjalën e trashëguar (pie. **swesōr*). Në fakt, zëvendësimet të motivuara në këtë mënyrë njihen nga disa gjuhë të tjera. Një shembull shumë të famshëm përfaqësojnë termat grekë *adelphéas/adelphós* ‘vëlla’ dhe *adelphé/adelphé* ‘motër’, që vijnë nga postpie. **sm₂-g^welb^h-es-o/eh₂* ‘nga e njëjta mitër’ (një kompozim i përbërë nga prefiksi **sm-* ‘i njëjti’ dhe nga emri **g^welb^h-es-* ‘mitër’). Vlen të përmendet që, në shqip, termi i trashëguar për ‘vëllanë’ (pie. **b^hreb₂tēr*) gjithashtu është zëvendësuar nga një leksemë inovative e përbërë prej elementeve indoevropiane – domethënë, *vëlla*, shum. *vëllezër* (me sa duket < postpie. **swe-low^d-eh₂*‘[nga] fisi i vet’ ose ndoshta **swe-log^h-eh₂*‘[nga] i njëjti shtrat’; shih diskutimin në Demiraj 1997: 417).¹²

¹⁰ Në rastin e tillë, për arsye pragmatike, koncepti ‘i njëjti’ mund të nënkuptohet dhe të mos shprehet hapur; khs. një fjali si erdhi nëna, ku është krejtësisht e qartë se erdhi nëna e njeriut konkret për të cilin bëhet fjalë.

¹¹ Ndoshta pikënisja duhet në fakt të kërkohet në trajtën e kallëzores **meh₂terah₂m* (ose **meh₂trah₂m*), e cila me siguri do të jepte parashq. **mā□ te/uran* > *motërë*, ndërsa emërorja **meh₂terah₂* (ose **meh₂teriyeh₂*, me një prapashtesë tjetër – **iyō*) mund të zhvillohej në parashq. **mātērā* > shq. †*mëjtjërë* (Sergio Neri, per litteras electronicas).

¹² Inovacionet e tilla bazohen në ndërtimet eliptike: **sm₂g^welb^hesos* [domethënë **b₂nēr*] ‘[njeri] nga e njëjta mitër’ etj. Po ashtu, në rastin e paraqitur, semantika e nënkuptuar mund të ketë qenë **meh₂t(e)reb₂* [domethënë **g^wenb₂*] ‘[gruaja] që ka [të njëjtën] nënë’ ose ‘[gruaja] që vjen nga [e njëjta] nënë’. Megjithatë, kjo frazë kurrsesi nuk duhet të shqiptohet

Rrjedhoja të ngjashme (post)paraindoevropiane në **-t(e)r-o-* të krijuara në bazë të termave të farefisnisë në **-ter-*, me kuptime dhe funksione të llojllojshme, mund të gjenden në disa gjuhë të ndryshme. Tipi **meh₂tr-eh₂* shihet në greqisht *métrā* ‘mitër’ (nga kuptimi fillestar mbiemëror ‘*e nënës, amënore’); kjo fjalë, siç dihet, është huazuar më vonë në shqipë (*mitër*). Më shumë shembuj të këtij lloji (**b^hreb₂tr-o/eh₂-* ‘i vëllait, vëllazëror’, **ph₂tr-o/eh₂-* ‘i babait, atëror’ etj.) mund të gjenden p.sh. në NIL.

5. Kronologjia dhe sfondi më i gjerë

Risia që po trajtohet – domethënë, zëvendësimi i termit paraindoevropian **swesōr* me një rrjedhojë **meh₂t(e)reb₂* ‘që ka [të njëjtën] nënë’ ose ‘që vjen nga [e njëjta] nënë’ – me shumë gjasë, ndodhi mjaft herët në historinë e shqipes. Kuptohet që, në kohën kur u krijua rrjedhoja **meh₂t(e)reb*, ajo duhet të ketë bashkekzistuar me fjalën themelore **meh₂tēr* ‘nënë’, domethënë me bazën derivacionale të saj. Megjithatë, një kontrast midis **meh₂tēr* dhe **meh₂t-r-eh₂* ishte i mundshëm vetëm në një sistem morfologjik mjaft konservator për ta ruajtur dallimin e qartë midis temave femërore me *-r-* dhe temave femërore me *-eh₂*, që nuk është askund afër shqipes së trashëguar¹³. Kjo do të ishte në përputhje me disa zëvendësime

në tërësinë e saj, meqenëse trajta eptimore femërore në **-eh₂e* garantonte interpretimin e saktë. Ka mundësi, gjithashtu, që fraza fillestare ishte në fakt **meh₂t(e)reb₂[*swesōr]* ‘[motra] që ka [të njëjtën] nënë’ ose ‘[motra] që vjen nga [e njëjta] nënë’. Kjo do të përputhej me idenë e Hampit të paraqitur më lart; gjithsesi, sipas skenarit tonë, ky zhvillim nuk varet nga etimologjia e leksemës *vajzë* ose të ndonjë termi tjetër të farefisnisë. ‘Forcimi’ e leksemës **swesōr* drejt **meh₂t(e)reb₂[*swesōr]* – domethënë, ‘sister’ drejt ‘mother-sister’ – mund të jetë motivuar nga nevoja për ta theksuar se bëhet fjalë për një motër të vërtetë, në kundërshtim me një kushërirë ose një të afërme më të largët (khs. serb. *rōđeni brāt*, domethënë literalisht ‘vëlla i lindur’, përkundër *brāt od strica*, literalisht ‘vëlla nga xaxha’, domethënë ‘kushëri’).

¹³ Shih gjithashtu poshtëshënimin 9.

¹⁴ Statusi i tillë i inovacionit përkon edhe me disa ndryshime në strukturën gramatikore – mund të përmendim p.sh. ngritjen e njëjës shquese postpozitive, historia fonologjike e së cilës tregon se ajo daton më shumë se një mijëvjeçar më parë se tekstet shqipe më të vjetra (Kümmel 2017: 79–80). Edhe krijimi i rrjedhojës **meh₂t(e)reb₂* ‘që ka [të njëjtën] nënë’ ose ‘që vjen nga [e njëjta] nënë’ dhe leksikalizimi i saj në rolin e fjalës për ‘motrën’

të tjera leksikore shqipe në fushën semantike që po shqyrtohet. Për shembull, fjala e gjuhës femijërore *at(ë)*, e cila e ka zëvendësuar termin e lashtë **ph₂tër* (khs. sanskr. *pítṛ*-, lat. *pater*, gr. *patḗr*, angl. *father* etj.), shfaq disa karakteristika morfologjike shumë arkaike, të dëshmuara vetëm në gjurmë tashmë në shqipen e vjetër (gjurmët e gjinore me *-*t̃*: shqipe vjetër *et* ‘i babait, i atit’, nga **att̃*; khs. mbaresën e gjinore -*t̃* në latinishte (Klingenschmitt 1992: 102–104, Matzinger 2006: 98). Pra, është e qartë se leksema *at(ë)* i përket shtresës shumë së lashtë së leksikut shqip, ndonëse ajo ka një karakter inovativ përballë termit të trashëguar paraindoevropian **ph₂tër*, i cili nuk ruhet fare në shqipe. Edhe fjala *vëlla*, me trajtën e saj të shumësit tërësisht të izoluar dhe sinkronikisht plotësisht të errët, që mund të shpjegohet vetëm në kontekstin paraindoevropian, ka një status të ngjashëm brenda leksikut të shqipes.¹⁴

6. Vërejtje përfundimtare

Prandaj, diskutimi për kuptimin e fjalës *motër* mund të ndahet prej çdo spekulimi rreth sistemeve të ndërmjetme të farefisnisë ose teorive të tjera për zhvillime të dyshuara në strukturën e shoqërisë (para)shqiptare. Mund të vërehet se edhe vëzhgimet e mprehta të Hampit për fjalën *motër* nuk janë krejtësisht të lira nga ky lloj arsytimi, meqenëse ai e përmend “the social structure and terminology of a Southeast European village” (1996: 140) si një faktor kyç i cili gjoja e ka shkaktuar zhvillimin që po trajtohet. Në kontrast të thellë me këto, ne theksojmë se leksikalizimi i fjalës që kishte kuptimin ‘e nënës, amënor’, ‘që ka [të njëjtën] nënë’ ose ‘që vjen nga [e njëjta] nënë’ si një term inovativ për ‘motrën’ është një inovacion mjaft i zakonshëm dhe banal; rasti i shqipes nuk është më befasues sesa shembujt grekë të përmendur më sipër, ose p.sh. zëvendësimi i fjalëve latine *frāter* ‘vëlla’ dhe *soror* ‘motër’ për *hermano* dhe *hermana*, respektivisht, në spanjishte (këta terma inovativë vijnë nga latinishtja *germānus* dhe *germāna* ‘i vërtetë, i plotë, i vet’, fillimisht ‘*i farës’,

(duke zëvendësuar termin e trashëguar paraindoevropian **svēsōr*) duket të ketë qenë një risi e tillë.

të prejardhur nga *germen* ‘farë’). E thënë ndryshe, një zhvillim i tillë mund të ketë ndodhur praktikisht në të gjitha kushtet dhe në çdo gjuhë – por në një gjuhë me një leksik aq inovativ si ai i shqipes, kjo duket veçanërisht jobefasuese.

Për ta përmbledhur, mund të nxjerrim përfundimin se leksema paraindoevropiane **meh₂tēr* ‘nënë’ thjesht nuk pasqyrohet fare në shqipen e dëshmuar, duke qenë zëvendësuar nga *ëmë*, *nënë*, *mëmë* dhe fjalë të tjera. Nga ana tjetër, para se të ndodhte kjo, leksema paraindoevropiane **swesōr* u zëvendësua nga një rrjedhojë e hershme e fjalës së lashtë **meh₂tēr* ‘nënë’, domethënë **meh₂t(e)reb₂* (që nga **māt(e)rā*) ‘[grua] që ka [të njëjtën] nënë’ ose ‘[grua] që vjen nga [e njëjta] nënë’.¹⁵

Bibliografia:

1. Ackermann, K. (2018). Undiscovered (O)CS corpus: On the trails of certain Slavic kinship terms in time and space. Kumtesë e prezentuar në konferencën *13th Slavic Linguistics Society Annual Meeting*, Eugene, Oregon, SHBA, 28–29 shtator 2018.
2. Barić, H. (1955). *Hýmje në historín e gjuhës shqipe*. Prishtinë: M. Bakija.
3. Çabej, E. (1976). *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. Bleu 5. K–

¹⁵ Artikulli për fjalën shqipe *motër* në WikiFjalorin (Wiktionary) anglishtfolës, i shkruar nga përdorësi Torvalu 4 (<https://en.wiktionary.org/wiki/mot%C3%ABr>, versioni nga 1 maj 2019), thotë se kjo leksemë vjen nga “Proto-Indo-European **mēh₂trēh₂* (“mother’s sister”), variant of **mēh₂trub₂* (compare Old English *modrige*, Ancient Greek *μητρικά* (*mētrúá*, “stepmother”)), from **mēh₂tēr* (“mother”)”. Ky shpjegim ka disa gjëra të përbashkëta me atë që u propozua nga Eric Hamp dhe që zhvillohet në këtë studim. Asgjëmangut, pavarësisht nga disa probleme formale të analizës së këtillë dhe të paraleleve të ofruara, duket e pamundur se boshllëku midis kuptimeve ‘nënë’ dhe ‘motër’ mund të kapërcehet duke supozuar një hap të ndërmjetëm ‘motra e nënës’. Edhe pse kjo mundësi mund të duket e arsyeshme në nivelin abstrakt, është e vështirë të imagjinohet se një risi e tillë do të mund të kryhej në realitetin gjuhësor, ku koncepti i një tezeje është mjaft i larguar nga ai i një motre prototipike. Prapëseprapë, duhet se pranohet që edhe sipas WikiFjalorit fjala shqipe *motër* duhet të trajtohet si një rrjedhojë (dhe jo një refleks) e leksemës paraindoevropiane për ‘nënë’.

L – LL – M. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë.

4. Demiraj, B. (1997). *Albanische Etymologien*. Amsterdam/Atlanta: Rodopi.
5. Eska, J. & Ringe, D. (2004). Recent work in computational linguistic phylogeny. Në: *Language* 80, 569–582.
6. Hamp, E. (1986). Alb. *vajzë, motër*. Në: C. M. Roncaglia & G. B. Pellegrini (red.), *Studi albanologici, balcanici, bizantini e orientali in onore di Giuseppe Valentini*. Firenze: Olschki, 109–110.
7. Hamp, E. (1996). The nominative singular of *r*-stems. Në: *Baltistica* 31, 139–140.
8. Höfler, S. (2017). *Der Stier, der Stärke hat. Possessive Adjektive und ihre Substantivierung im Indogermanischen*. Punim i doktoratës, Universität Wien.
9. Huld, M. (1984). *Basic Albanian Etymologies*. Bloomington: Slavica Publishers.
10. Jokl, N. (1923). *Linguistisch-kulturbistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*. Berlin: de Gruyter.
11. Klingenschmitt, G. (1992). Die lateinische Nominalflexion. Në: O. Panagl & Th. Krisch (red.), *Latein und Indogermanisch*. Innsbruck: Institut für Sprachwissenschaft der Universität Innsbruck, 89–135.
12. Kümmel, M. (2017). Is ancient old and modern new? Fallacies of attestation and reconstruction (with special focus on Indo-Iranian). Në: D. Goldstein, S. Jamison & B. Vine (red.), *Proceedings of the 27th Annual UCLA Indo-European Conference*. Bremen: Hempen, 79–96.
13. Mallory, J.P. & Adams, D.Q. (2009). *The Oxford Introduction to Proto-Indo-European and the Proto-Indo-European World*. Oxford: Oxford University Press.
14. Matzinger, J. (2006). *Der altalbanische Text Mbsuame e krështerë (Dottrina cristiana) des Lekë Matrënga von 1592. Eine Einführung in die albanische Sprachwissenschaft*. Dettelbach: J.H. Röhl.
15. Matzinger, J. (2018). The lexicon of Albanian. Në: J. Klein, B.

- Joseph & M. Fritz (red.), *Handbook of Comparative and Historical Indo-European Linguistics*, vëll. 3. Berlin/Boston: de Gruyter, 1788–1800.
16. Mayrhofer EWAia = Mayrhofer, M. (1986–2001). *Etymologisches Wörterbuch des Altindoarischen*, vëll. 1–3. Heidelberg: Winter.
 17. Meyer, G. (1891). *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*. Strassburg: Trübner.
 18. Nikolaev, A. (2015). The Germanic word for ‘sword’ and delocative derivation in Proto-Indo-European. Në: *Journal of Indo-European Studies* 37, 462–488.
 19. NIL = Wodtko, D., Irlinger, B. & Schneider, C. (2008). *Nomina im indogermanischen Lexikon*. Heidelberg: Winter.
 20. Orel, V. (1998). *Albanian Etymological Dictionary*. Leiden/Boston/Köln: Brill.
 21. Pudić, I. (1978). Verwandtschaftswörter in den Balkansprachen. Në: *Actes du II^e congrès international des études du sud-est Européen (Athènes, 7–13 mai 1970), tome IV, Linguistique et littérature*. Athènes: AIESEE, 111–117.
 22. Ringe, D. (2017). *From Proto-Indo-European to Proto-Germanic*, bot. 2. Oxford: Oxford University Press.
 23. Schumacher, S. & Matzinger, J. (2013). *Die Verben des Altalbanischen*. Wiesbaden: Harrasowitz.
 24. Tagliavini, C. (1965). *La stratificazione del lessico albanese. Elementi indoeuropei*. Bologna: Pàtron.
 25. Topalli, K. (2018). *Fjalor etimologjike i gjuhës shqipe*. Durrës: Jozef.
 26. Weiss, M. (2009). *Outline of the Historical and Comparative Grammar of Latin*. Ann Arbor: Beech Stave Press.

Rozana RUSHITI

STRUKTURA E SHQIPES AKTUALE NË STILIN E LETËRSISË ARTISTIKE (VEPRA ORIGJINALE E I. KADARESË DHE PËRKTHIMI NË ITALISHTE)

Abstrakt

Struktura e shqipes aktuale ballafaqohet dhe bashkëvepron me struktura të gjuhëve të tjera fqinje, por jo vetëm. Në fakt, po përmendëm sintagmën “strukturë e shqipes aktuale” ajo duhet sjellë përballë një strukture a strukturave të gjuhëve të tjera, ndaj edhe kumtesa jonë do të ketë për qëllim përjasjen e strukturës së shqipes aktuale me struktura të gjuhëve në kontakte shumëvjeçare kulturore.

Për t’ia arritur këtij synimi, përqendrimi dhe hetimi ynë do të fokusohet në struktura të shqipes në stilin e letërsisë artistike. Konkretisht, do të studiohen fraza të veprave të autorëve shqiptarë të përkthyer në gjuhë të tjera, kryesisht në anglishte a në italishte, duke i ballafaquar ato nga pikëpamje të ndryshme lidhur me zhvillimin e strukturave të reja, rendin, mjetet eptimore e të lidhjes, praninë e subjektit a elipsën e kryefjalës etj.

Fjalët kyçe: *strukturë, shqipja aktuale, letërsi artistike, përjasje, gjuha dhënëse, gjuha marrëse, frazë, mjete eptimore, rend.*

Abstract

The current Albanian structure faces and interacts with structures of other neighboring languages, but not only. In fact, if we said the syntagm "the Albanian current structure" should bring it in front of a structure or structures of other languages, therefore our papers will be

aimed at confronting the structure of the current Albanian with the structure of languages in multi-year cultural contacts.

To achieve this goal our focus and our investigation will focus on the structures of Albanian in the style of artistic literature. Specifically, will be studied phrase works of Albanian authors translated into other languages, mainly in English or in Italian, having faced them from different points of view regarding the development of new structures, the topic of words topic, flexion elements, connectivity elements, means of connectivity, presence the subject or the ellipse of the subject, etc.

Dihet nga të gjithë se në aktin e krahasimit, nevojiten dy anë, në rastin e kumtesës sonë, dy gjuhë: ajo që krahasohet dhe tjetra që shërben për krahasim, përndryshe, shqipja dhe gjuha apo gjuhët që do të përjasen me të, duke vijuar me përcaktimin e treguesve a niveleve studimore të rrafshve nga do të niset krahasimi: bëhet fjalë në strukturën gramatikore, e zëmë, fjalëformimi, eptimi; apo në atë sintaksore: fjalia, gjymtyrët, rendi, mjetet gramatikore të lidhjes; fraza a thënia, paragrafi apo teksti gjuhësor, ku përfshihen shumë anë të hulumtimit gjuhësor. Objekti i vënë para nesh në këtë punim, është romani "Kukulla", botuar nga I. Kadareja më 2015 ("Kukulla": 2015), i përkthyer në gjuhën italiane nga Liljana Cuka Maksuti, në vitin 2017 ("La Bambola":2017).

Theksojmë që në hyrje të punimit se përkthimi i veprës nga gjuha dhënëse - shqipja (**L1**), në gjuhën marrëse - italishtja (**L2**) është bërë nga një folës i lindur i gjuhës sonë amtare, ku edhe është formuar gjuhësisht, (sqarojmë se është marrë italishtja si gjuhë marrëse, sepse veprat e Kadaresë të përkthyer në gjuhë angleze kanë përgjithësisht si L1 frëngjishten dhe jo shqipen), prandaj në përjasjen e dyfishtë, do të mund të shënojmë se nga ky krahasim dalin në pah edhe veçoritë natyrore të secilës gjuhë, në të gjitha rrafshet e studimit, por në mënyrë të veçantë, në nivelin sintaksor, ku konvergojnë edhe nivelet e tjera: morfologjia, semantika, leksiku, frazeologjia; rendi, marrëdhëniet funksionale të njëjive përbërëse të fjalisë, të frazës, të thënieve, të paragrafit dhe të tekstit. Në Gramatikën shkencore të shqipes, nënvizohet se *në kohën e sotme (tani) po bëhet fjalë edhe për njësi më të mëdha sintaksore se periudha (fjalia e përbërë) apo fjalia. Është pak a shumë e njohur qenia e njësisë semantiko-strukturore të përbërë prej fjalish të mëvetësishme a periudhash të ndryshme, e cila ka një përmbajtje të lidhur, të organizuar zakonisht me mjete gramatikore e cila mund të quhej **thënie e lidhur**...* (Gramatika e gjuhës shqipe: 1996, f. 64), njësi sintaksore e prekur pak, duke mos u bërë ende objekt vëzhgimi i veçantë, megjithëse në dekadat e fundit tashmë është krijuar mendimi i padiskutueshëm se gjuhësia nuk përfundon te fjalia. Gramatika e tekstit përfshin *tekstin* dhe *diskursin* në një gamë të vetme (B. Rugova & L. Sejdini-Rugova: 2015, f.13-14), duke studiuar kështu njësi më të mëdha se fjalia në dy rrafshje edhe si produkte (B. Rugova & L. Sejdini-Rugova: 2015) edhe si procese.

Nëse shkëpusim një frazë me dy përbërës predikativë, atë të fillimit, nga miniteksti që kemi zgjedhur për paraqitje:

Në prill të vitit 1994, im vëlla na lajmëroi nga Tirana se nëna ishte duke dhënë shpirt-

përqasur me po këtë njësi në gjuhën italiane:

Nell'aprille del 1994, mio fratello ci avisò da Tirana che nostra madre stava rendendo l'anima-

themi se të dyja frazat vijnë e përputhen pothuajse në të gjithë treguesit sintaksorë: në numrin e përbërësve kallëzuesorë (2), në rendin e vendosjes së tyre ndaj njëri-tjetrit: fjalia drejtuese në fillim, e varura pas saj, në funksionin e kësaj të fundit si njësi argumentore (objektore), në rendin e temës (T) dhe të remës (R) - një vendosje e drejtë sa i takon komunikimit, përputhen në praninë e argumenteve (im vëlla /mio fratello) dhe të rrethorëve *në prill të vitit 1994/ nell'aprille del 1994*, që shpjegojnë një aspekt të kësaj marrëdhënieje (Graffi: 2008, f. 62)- kohën e veprimit të shprehur nga folja.

Po kështu, për dy rastet, themi se vendosja e sintagmës parafjalore (SP) në fillim të frazës, për shqipen dhe italishten krijon cezurën, pasi në një rend tjetër, ai do të gjendej pas foljes. Më tej, në planin stilistik, frazema "*jap shpirt/ po jep shpirt,*" "*stava rendendo l'anima*"(duke dhënë shpirt) lidhet me një mendësi besimi e, më të shumtën e rasteve, përdoret për njerëzit e afërt e që na dhimbsen së tepërmi, në vend të foljes "vdes", që do të ishte pa ngjyrim, asnjëse.

Në krahasimin e tyre natyror e sidomos strukturor, këto dy gjuhë ngjajnë, megjithatë, duhet marrë në konsideratë edhe pëlqimi i përkthyesve, gjë që duket në zgjedhjen e sinonimeve, pse jo, edhe në rendin sintaksor të përbërësve caktuesorë. Te fraza më e gjatë e pasazhit hyrës që kemi sjellë, ka një dukuri interesante të vendosjes së subjektit që kryen veprimin, mes dy segmenteve përcaktuese:

Kushëriri im i parë, Besnik Dobi, njeriu që e kishte çuar në krabë deri te motra...

Mio cugino di primo grado, Besnik Dobi, colui che l'aveva portata in barcciofino a casa di sua sorella,...

pra, te kjo frazë, ka një liri vendosjeje: ato mund të dalin ose para subjektit *B. Dobi*, ose edhe ta ndjekin atë radhazi, me një fjalë: mund të barten ose para ose pas kryefjalës:

Kushëriri im i parë, njeriu që e kishte çuar në krahë deri te motra, Besnik Dobi.....ose:

Besnik Dobi, kushëriri im i parë, njeriu që e kishte çuar në krahë deri te motra....:

Kushëriri im i parë, njeriu që e kishte çuar në krahë deri te motra, Besnik Dobi.....ose:

Besnik Dobi, kushëriri im i parë, njeriu që e kishte çuar në krahë deri te motra....:

ndërkohë që në shqipërim, shquarsia e emrit “parole” në origjinal del me përemrin dëftor “queste”, ndërsa në shqipe me trajtën e shumësit të shquar me -t (fjalë-t).


Mio cugino di primo grado B. Dobi, colui che l'aveva portata in barccio fino a casa di sua sorella, ...aggiunse queste parole: perché era leggera.

Kushëriri im i parë, B. Dobi, njeriu që e kishte çuar në krahë deri te motra,... shtoi fjalët:veç kësaj ajo ishte tepër e lehtë.



Këtë “liri strukturore” do ta ndeshim jo rrallë në prozën e shkrimtarit tonë të shquar, për shembull:

“Pas tri javësh, **ne**, dy djemtë e shtëpisë, unë dhe im vëlla, që kishte hyrë në Fakultetin e Mjekësisë, u nisëm me një kamion “për të marrë plaçkat e shtëpisë”,

ku argumenti përemër “ne”, jo vetëm që vihet pas rrethanorit të kohës, pas SP-së, por ndiqet nga tre segmente përcaktuese. (Kadare: Kukulla, 2015)

... n e ... 

Pas tri javësh,

 dy djemtë e shtëpisë,
unë dhe im vëlla, 
që kishte hyrë në Fakultetin e
Mjekësisë, ..

Shqip

“Në prill të vitit 1994, im vëlla na lajmëroi nga Tirana se nëna ishte duke dhënë shpirt. U nisëm të dy me Helenën, me avionin e parë nga Parisi, me shpresë për ta gjetur ende gjallë. Në të vërtetë ishte ende në jetë, por nuk kuptonte asgjë. Ndodhej në koma, në apartamentin e emtës sime, në rrugën “Qemal Stafa”, ku e kishin çuar disa javë më parë, për ta pasur më mirë në kujdes.

Kushëriri im i parë, Besnik Dobi, njeriu që e kishte çuar në krabë gjer tek e motra, pasi më shpjegoi përse e kishte parapëlqyer atë mënyrë bartjeje, për një distancë aq të shkurtër, nga Rruga e Dibrës te fillimi i “Qemal Stafës”, shtoi fjalët: Vec kësaj, ajo ishte tepër e lehtë.

Në përpjekje për të sqaruar diçka më tepër, ai përsëriti pak a shumë të njëjtën gjë: e pabesueshme, sa e lehtë ishte! Do të thosha prej letre. Si një kukull prej letre...”

(Kukulla: 7-8)

Italiano

“Nell’aprilo del 1994 mio fratello ci avvisò da Tirana che nostra madre stava rendendo l’anima.

Mia moglie Helena e io partimmo con il primo aereo da Parigi, sperando di trovarla ancora in vita.

La trovammo ancora viva, ma in coma. Si trovava nell’apartamento di mia zia in via Qemal Stafa, dove l’avevano portata alcune settimane prima, per accudirla nel migliore dei modi.

Mio cugino di primo grado, Besnik Dobi, colui che l’aveva portata in barcio fino a casa di sua sorella, dopo avermi spiegato perché avevano questo metodo di trasporti per coprire la distanza da via Dibra all’inizio di Qemal Stafa, aggiunse queste parole: perché era leggera.

Cercando di spiegarsi meglio ripeté quasi la stessa cosa: incredibile quanto fosse leggera! Come se fosse di carta. Come una bambola di carta”

Pa u ndalur në çështje drejtshkrimore të të dyja gjuhëve, pasi ato i takojnë kodit të veçantë të secilës dhe traditës së formuar, shënojmë se në fjalinë e dytë, shqipëruesi ka pëlqyer që sintagmën parafjalore (SP) "*me shpresë për ta gjetur ende gjallë*" ta sjellë me përcjelloren "sperando"- *duke shpresuar*, ashtu si *trajtën e lidbores*, e jep me formën e paskajores, që këtu funksionon si përcaktues i sintagmës e në përbërje të saj, ndërsa për ndajfoljen "viva" (gjallë), që nuk është e natyrës së italishtes së folur, e zgjedh për SP , "në jetë". Në vijim, në segmentin ku del folja "ishte", vjen me të edhe sintagma e mësipërme.

Nga ana tjetër, shqipja, por në këtë pikë, edhe italishtja, gjatë këtij akti, e krijojnë mundësinë e përdorimit të teknikave të ndryshme, ku përemrat (një mënyrë e zakonshme për të rimarrë atë që është thënë, pa përsëritur të njëjtën fjalë a sintagmë) zëvendësojnë emra, ose lënë shteg që, me qëllim përforcimi, të mund të sjellim edhe shtesa të tilla, si: "*colui*" (*njeriu*) dhe "*veç kësaj*".

II. Për strukturën: përsëri mbi baza krahasimi, lëndë e punës na bëhen ***njësitë sintaksore***, nga sintagmat, njësitë predikative, frazat, thëniet, paragrafët dhe teksti gjuhësor, të cilat, përveç sintagmave si njësi ndërtimore, janë masa komunikative të gjuhës.

Për arsye praktike, do të sjellim ***një tekst anaforik***, të shkëputur nga romani që kemi në dorë, për t'u ndalur në strukturën e tij dhe sidomos, për të ndjekur si bëhen zëvendësimet e referentit kryesor Bardhyl B., dhënë fillimisht në **E1** dhe ato të autorit që rrëfen në vetën e parë, në rasi të zhdrejta E5:

Shqip

“Bardhyl B. kishte ikur fill pas meje, ngaqë, sipas tij, pas largimit tim, siç më shkruante në të parën dhe të fundit letër të tij, kishtëhumbur kuptimit e jetës në Gjirokastrë. Qysh nga ajo kohë, ndonëse do të pyesja disa herë për të, s’do ta takoja më kurrë. Një herë më thanë se ishte bërë shofer taksie në Vlorë, dhe ndjesia e fajit se, pa dashur ndoshta, isha bërë shkaktar për këtë, m’u zbut nga mendimi ngushëllues se midis dy ndodhive të jetës sime, miniburgut dyditësh dhe taksisë, së paku kishte zgjedhur si model këtë të fundit...” (Kukulla: 66)

Italisht

“Bardhyl B. se ne andò immediatamente dopo di me, dato che secondo lui, dopo il mio allontanamento, come mi scriveva nella sua prima e ultima lettera, aveva perso il senso della vita ad Argirocastro. Da allora, anche se avrei domandato tante volte di lui, non l’avrei più incontrato. Una volta mi dissero che era diventato tassista a Valona, e il senso di colpa che, forse senza volerlo, mi diceva che ero io la causa di ciò, si attenuò pensando che tra i due eventi della mia vita, il minicarcere di due gioni e il taxi, lui almeno aveva optato per quest’ultimo.” (La bambola: 59-60)

Sipas lidhjeve me vija korrelative, mund të shënojmë se: kemi dy ndërrime kohësh foljore "do të pyesja" - avrei domandato (*do ta kisha pyetur*); "s'do ta takoja kurrë më" - non l'avrei più incontrato" (*nuk do të takohesha kurrë*); "isha bërë - ero io", kur për të dyja gjuhët janë të mundura fjalitë foljore vetore (Siç dihet, lidhja e subjektit me foljen -predikat realizohet me anë të mbaresave foljore, të cilat në të dyja gjuhët bëjnë të mundur gjenerimin e fjalive të tilla); por në ndonjë rast përkthyesja ka shoqëruar me përemër vetor foljen "avevo optato" - "kishte zgjedhur, çka në shqipe nuk ndjehet nevoja për të dalluar folësin nga bashkëfolësi.

Në këtë mënyrë, për natyrën e tyre të ndryshme strukturore, vërejmë dallime mes vendosjes së mbiemrave dhe përemrave pronorë para emrave, çka në shqipe mbizotëron pozicioni i kundërt: *pas largimit tim - dopo il mio allontanamento; të jetës sime - della mia vita...*etj. Aty ku mungojnë zëvendësuesit, gjuha jonë ka mundësi të operojë nëpërmjet mbaresave flektive për dallimin e folësit.

Struktura e tekstit kataforik është ndërtimi i kundërt me të parin: referenti a referentët dalin në mbyllje të tij, që këtu rastis të jenë emra abstraktë: "kuptim/moskuptim", "jetë/mosjetë", ndërkohë 6 paragrafët e kreut të 12-të, f. 130-131, kanë dhënien e referentit kryesor: *francez/francezja në avionin e kthimit të autorit për në Shqipëri.*

Nga të gjitha ato që më kujtoheshin në avion, kjo më dukej më e padurueshmja. Kështu më që dukur në kthimin e parë, në mars të vitit 1992. Rrinte e heshtur në kanape, ndërsa një gazetar TV-it francez e filmonte. Gëzohu, i thoshin të gjithë. Të shkuara, të harruara.

Bënte përpjekje të gëzohej, por, me sa dukej s'mundte. Në sytë kishte po atë shprehje fajtoze ku ndodhej përpara moskuptimit të gjërave. I vetm ndryshim ishte se gëzimi kërkonte një mundim më të madh.

Po, po, thoshte me njëfarë vonese. Jam gëzuar... Vetëm sytë nuk i kam mirë.

Biseda e fundit me të kishte ndodhur në një nga ditët e nisjes sonë të radhës për Paris. Ng

vështrimi i saj nuk ishte vështirë të merrej me mend pyetja që shumica e nënave do të bënin në kësi rastesh: vallë, do të më gjesh më gjallë?

Pas një vështrimi të gjatë, ma bëri më në fund pyetjen, që, për habinë time, ishte më befasuesja nga gjithë pyetjet e mundshme.

Çfarë? i thashë, me shpresë se nuk e kisha dëgjuar mirë.

Por shpresa kishte qenë e kotë.

Kukulla e përsëriti dhe pyetja ishte ajo që kisha dyshuar.

Francez je tani?

Më pas, sa herë që e sillja ndër mend, në vend që të mësohesha me të, më dukej përherë e më e pamundur nga çdo anë që ta merrje. Ishte sa e qartë, aq edhe e errët, njëherësh fëmimore dhe pa kohë, që të gjente gjithsesi të papërgatitur. Shkurt, ishte stili i saj, kuptim e moskuptim bashkë, të bëra njësh, në jetë e në mosjetë.

Ishte ndoshta kjo arsyeja që më dukej e natyrshme që përgjigjen për pyetjen e saj, t'ia jepja qoftë edhe me vonesë, tani që ishte shtrirë në arkëmnori, e bardhë, me pakëz të kuq në faqe, krejt Kukull, në arkëzën e lodrave.

Tek e shihja ashtu, më dukej se prej vitesh ishte përgatitur për këtë kapërcim. Kishte vënë pak grim, si për një shfaqje të fundit.

Tekst kataforik

Shqip

“Më pas, sa herë që e sillja ndër mend, në vend që të mësohesha me të, më dukej përherë e më e pamundur nga çdo anë që ta merrje. Ishte sa e qartë, aq edhe e errët, njëherësh fëminore dhe pa kohë, që të gjente gjithsesi të papërgatitur. Shkurt, ishte stili i saj, kuptim e moskuptimbashkë, të bëra njësh, në jetë e në mosjetë”. (Kukulla:131)

Italisht

“Piu tardi, ogni volta che mi tornava in mente, questa domanda mi sembrava impossibile, in qualsiasi modo potessi interpretarla. Era così limpida quanto oscura, allo stesso tempo infantile e senza età, tuttavia mi colse di sorpresa. In breve, era nel suo stile, comprensibile e incomprensibile, tutte e due le cose insieme, nella vita e nella non-vita. “ (La bambola: 118)

Si mund të vërehet, mungon fare segmenti -fjali lejore “*në vend që të mësohesha me të*”, po kështu fjala “sorpresa” nuk vjen aq adekuate me “i papërgatitur”, ose përkthyesja e ka parë më shprehëse të ndërrojë rasën e emrit “stil” nga E1 (bashkë me pronorin “e saj”) në E4 “nel suo stile”, siç e ka quajtur të drejtë që ndajfoljen “bashkë” ta përcjellë me “tutte e due le cose insieme”.

Për të zbritur te **fraza**, themi se struktura e gjuhës sonë për këtë njësi kumtuuese, ashtu si mund të dalin me ndërtime të drejta, përndryshe të prira nga njësi predikative drejtuese në fillim dhe të nënrenditurat funksionale pas saj (ose pas tyre, kur bashkimet janë me parataksë), pra kjo strukturë, i ka të mundura edhe frazat e ndërlikuara, edhe me takime të dy mjeteve të lidhjes sintaksore me hipotaksë, të cilat u përgjigjen mendimeve të tilla jo pak të sofistikuara, si në modelin poshtë; vështirësitë janë më të dukshme:

Shqip

“Më pas, mahnitja, në vend të binte, sa vinte rritej, aq sa kur nisa ta kopjoj me dorë tekstin, e sidomos kur nisa të zemërohesha me të, njëllorj si me Bardhyl B., u binda se isha jo veç i afërm, por gati-gati si kushëri me Shekspirin.”

(Kukulla:115)

Italisht

“*Col tempola meraviglia*, invece di diminuire, cresceva sempre di più, tanto che quando *avevo cominciato a ricopiare a mano il testo*, e soprattutto quando *avevo iniziato a cavillare e disquisire con lui proprio come facevo con Bardhyl B.*, *ero convinto* non soltanto di essere a lui *molto vicino*, ma quasi mi sentivo *un parente* di Shakespeare. “

(Labambola:104)

- segmenti “*njëllorj si me Bardhyl B.*” në shqipe mund të qëndrojë pa përsëritur predikatin e përbërë "nisa të zemërohesha", kurse në italisht ka lindur nevoja të silltë “*come facevo*” - siç bëja; jo përherë kohët e thjeshta dalin me përgjegjëse në italishte me ato të përbëra, si: “u binda” – “ero convinto”; apo me ndryshime shkallësh të mbiemrave e ndajfoljeve “i afërt” - me “molto vicino”; “si kushëri” – “mi sentivo parente” - ndjehesha i afërt....etj.

Konkluzione:

Nga kjo paraqitje e shkurtër, mund të thuhet se gjuhët njerëzore mbështeten fort në identitetin e tyre natyror, ku treguesit e përbërësit sintaksorë zënë vendin e parë, nga pikëvështrimi i strukturës.

Vetë stili artistik, gjuha e letërsisë, përveç funksioneve të tjera, ka edhe funksionin e ruajtjes, e zhvillimit të kulturës gjuhësore, e studimit dhe e ballafaqimit të saj, si dhe luan një rol të veçantë për marrëdhënien e gjuhës së normuar me format e tjera jostandarde.

Më shumë se kudo tjetër, struktura themelore e gjuhëve, pra edhe e gjuhës sonë, del në pah në procesin e përkthimit, i cili vjen njëherësh edhe si proces përballjeje kulturore, mënyrë së menduari dhe të veçorive psikolinguistike për përdoruesit e gjuhës, në një situatë të caktuar.

Duke mbetur në rrafshin e sintaksës, kjo ngjashmëri apo me dallues strukturorë mes dy gjuhëve duhet parë që nga njësitë ndërtuese: sintagmat, pastaj tek ato kumtuese, siç janë: fjalia, fraza thënia, paragrafi dhe teksti gjuhësor, gjë që në kufijtë e një punimi do të ishte e pamundur.

Secila prej masave ligjërimore që përmendëm më sipër do të kërkojë një trajtim më vete, duke menduar se ka tregues sintaksorë, siç është rendi dhe përcaktuesit nga Shkolla e Pragës (Tema, Rema) që janë bashkëshoqërues të të gjitha strukturave: nga fjalia deri te teksti.

Këto pak gjëra që u vunë në dukje gjatë paraqitjes sonë, përveç fushave studimore, mund të dalin edhe si punë redaktorie aq të domosdoshme pranë shtëpive botuese, për çështje që mund t'u kalojnë vetë përkthyesve.

Bibliografi:

1. ASH, IGJL, *Gramatika e gjuhës shqipe II*. (1996) Tiranë.
2. Rugova B. & L. Sejdini-Rugova (2015). Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe. Prishtinë: Trembelat, 2015, 492 f.
3. Graffi, G. (2008). Sintaksa - Strukturat e ligjërimin. Tiranë: Dituria, 466 f.
4. Mujaj H. (2014). Gjuhësia e tekstit. Prishtinë, 258 f.

5. Lloshi Xh. (2005). Stilstika e gjuhës shqipe dhe pragmatika. Tiranë: Albas, 356 f.
6. Topalli T. (2019). Ushtrime për stilstikën e gjuhës shqipe, botimet Fishta. 625f.
7. Topalli T. (2011). Gjuhësi teksti, ISA. Shkodër, 385 f.
8. Dibra, K.&Varfi, N. (1999). Gjuhësi teksti. Shtëpia botuese e Librit Universitar, 168 f.

Autor dhe vepra letrare:

1. Ismail Kadare (2015). Kukulla. Onufri:Tiranë, 142 f.
2. Ismail Kadare (2017). La Bambola. Romanzo. La nave di Teseo, 127 p.

TRYEZA E DOKTORANTËVE

Agnesa HASIMJA

KOMPETENCA GRAMATIKORE E NXËNËSVE TË KLASAVE XII NË PRISHTINË

Abstrakt

Termi 'kompetencë gramatikore' i përdorur fillimisht nga Chomsky (1965:3) i referohet aftësisë së lindur të njerëzve për të gjeneruar një pafundësi frazash; njohurive gjuhësore (sistemit të rregullave) të këtyre individëve për të kuptuar gabimet gramatikore dhe paqartësi të ndryshme. Ndërsa, Hymes-i (1972:269) flet për aftësinë ose kompetencën komunikuese si dije ose njohuri që i nevojitet një folësi ose dëgjuesi, por që ka një bazë më të gjerë sesa kompetenca e gjuhësisë çomskiane.

Kompetenca komunikative përmbledh në vetvete: kompetencën gramatikore, kompetencën sociolinguistike, kompetencën e ligjërimit dhe kompetencën strategjike.

Kompetenca gramatikore mbetet e lidhur me zotërimin e vetë kodit të gjuhës, që përfshin karakteristikat dhe rregullat e gjuhës, siç janë: fjalori, morfologjia (formulimi i fjalëve), sintaksa, shqiptimi, drejtshkrimi dhe semantika gjuhësore.

Rrjedhimisht, duke qenë se përbërësit gjuhësorë, bashkë me komponentët e tjerë luajnë rol në zhvillimin e aftësive komunikuese të nxënësve, si një ndër objektivat kryesorë të planprogrameve të gjuhës shqipe, do të jenë pjesë e hulumtimit tonë.

Në këtë hulumtim do të pasqyrohet gjendja e tanishme e njohurive gramatikore të nxënësve të klasave XII në Prishtinë, duke i nxjerrë të dhënat nga hulumtimi në terren, përmes metodës së anketimit.

Për të pasur vështrim kritik ndaj rezultatit të dhënë, hulumtimi do të përqendrohet te planprogramet e Gjuhës shqipe për klasat XII.

Fjalët çelës: *kompetencë, gramatikë, pranprogram.*

Abstract

The term “grammatical competence”, first used by Chomsky (1965:3), refers to the born ability of people to generate an infinity of phrases; linguistic knowledges (systems of rules) of these individuals to understand grammatical errors and different ambiguities. Whereas, Hymes (1972:269) speaks about the communication ability or competence, as knowledge or cognition a speaker or listener needs, but which has a broader basis than the competence of Chomsky linguistics.

Communicative competence includes in itself: grammatical competence, socio-linguistic competence, lecturing competence and strategic competence.

Grammatical competence remains linked to the mastery of the language code itself, which includes the characteristics and rules of the language, such as: vocabulary, morphology (word formulation/building), syntax, pronunciation, spelling and language semantics.

Consequently, since the linguistic components, along with other components play a role in the development of communication abilities of students (pupils), as one of main objectives of Albanian language curricula, they will be part of our research.

In this research will be depicted the current state of grammatical knowledge of twelfth grades students (pupils) in Prishtina, obtaining the data from the field research, through the method of polling.

In order to have a critical view against the given result, the research will be focused on Albanian language curricula for the twelfth grades.

Key words: *competence, grammar, curricula.*

Sfondi teorik

Termi „gramatikë“, që përdornin grekët në kërkimet gjuhësore, sipas Lyons-it, është një dëshmi: në fakt, se vetë fjala „gramatikë“ do të thotë „arti i të shkruarit“. Historia tashmë është e njohur e polemikës midis analogjistëve dhe anomalistëve. Sipas pretendimeve të të parëve (konvencionalistëve), gjuha në thelb ka karakter sistematik dhe të rregullt, ndërsa natyralistët, kishin pikëpamje të kundërta me ta. Kështu, duke shpënë në teorinë se gjuha ka „rregullsi“ të caktuara, të dy palët kontribuan në sistematizimin e gramatikës (Lyons, 2001:25-26).

Koncepti i gramatikës në periudhën aleksandriane lidhej me korrektësinë e përdorimit të gjuhës së Homerit, gjuha e veprave të të cilit konsiderohej normative, dhe e cila ishte e ndryshme me gjuhën në përdorim në atë kohë. Përkufizimi, dallimi, si dhe klasifikimi i klasave gramatikore ndryshonte nga njëra periudhë në tjetrën (greke, romake, Mesjetë, Rilindje, Romantizëm), nga njëri vend në tjetrin (Greqi, Itali, Indi), nga njëri gjuhëtar (apo diskutues) në tjetrin (Platoni, Aristoteli, Trakasi, Diskoli, Protagora; Varroni, Donatusi, Prishiani; Panini; Erasmusi, mësuesit e Port Royal-it etj.).

Ndryshe nga pikëpamjet e gramatikave tradicionale, ku mbizotëronte qasja se gjuha letrare e shkruar është në një nivel më të lartë se gjuha e folur, gjuhësia deskriptive, themeluar nga Sosyri, ndërton qasje të ndryshme nga ajo. Sipas tij, të folurit mund të shfaqet edhe në një mjedis tjetër, përmes gjuhës së shkruar. Së këndejmi, nga gjuhësia preskriptive, studimet kaluan në gjuhësinë deskriptive.

Gjuhësia moderne, sipas drejtimeve studimore të ndryshme që pati në shekullin XX, u nda në dy periudha, në gjysmën e parë dhe të dytë të këtij shekulli. Rryma strukturaliste ishte drejtimi i ri që u përhap në pjesën e parë të këtij shekulli. Ndryshe nga gramatikat tradicionale, të cilat ua imponojnë përdoruesve se si duhet ta përdorin një gjuhë, gramatikat strukturaliste, me përfaqësues si Boasi, e më vonë Bloomfieldi, përshkruajnë një gjuhë si përdoret nga përdoruesit e saj. Strukturalistët e

mëvonshëm, përkrahës të psikologjisë bihejvioriste, e kundruan gjuhën si sjellje të caktuar komunikimi, duke e ndarë atë në disa nivele gjuhësore: fonologji, morfologji dhe sintaksë, elementet e të cilit sistem janë të lidhura strukturalisht me njëra-tjetrën e që kanë kapacitetet për të përcjellë kuptim.

Chomsky, themelues i gramatikës gjenerative, në gjysmën e dytë të shekullit XX, hodhi poshtë qasjen bihejvioriste ndaj përdorimit të gjuhës, duke i kritikuar strukturalistët që u mjaftuan vetëm me përshkrimin e fakteve, pa mundur t'i shpjegojnë ato. Sipas tij, zotërimi i gjuhës nga fëmija nuk mund të shpjegohet me teorinë bihejvioriste të Skinner-it. Këtë ai e argumenton përmes disa provave: varfërisë së stimulit dhe gramatikës universale. Chomsky shpjegon se shumë veçori gjuhësore nuk mund të shpjegohen përmes stimuljeve, pra është varfëria e stimulit ajo që të shpie te hipoteza se të gjitha qeniet njerëzore zotërojnë një mekanizëm të lindur të caktuar për përvetësimin e gjuhës. Prandaj, hedh poshtë konceptin bihejviorist (ngacmim-reagim) se gjuha e mësuar nga fëmija nuk është tjetër veçse një varg përgjigjesh verbale ndaj ngacmimeve të mjedisit rrethues. Gramatika universale, sipas Chomsky-t (Graffi, 2008:41-45), mund të shihet si një teori e mekanizmave të lindur, një lloj matrice biologjike e nëntëshme që shërben si një kuadër brenda të cilit zhvillohet gjuha. Parimet e propozuara të gramatikës gjenerative mund të merren si një shpjegim abstrakt dhe i pjesshëm i programit gjenetik që i lejon fëmijës t'i interpretojë disa ngjarje si përvoja gjuhësore dhe të ndërtojë mbi bazën e kësaj përvoje një sistem rregullash dhe parimesh.

Pohimi i Chomsky-t (2002:17) për autonominë e gramatikës si sistem „që përmban vetveten“ pavarësisht prej kuptimit, si sistem kognitiv, vijon edhe sot brenda kuadrit të gramatikës gjenerative. Gramatika kognitive është përkufizuar si një teori në të cilën leksiku, morfologjia dhe sintaksa formojnë një vazhdimësi njësisish simbolike, të cilat janë në shërbim të strukturës së koncepteve për qëllime shprehëse (Robins, 2007:358).

Në vitin 1971, sociolinguisti amerikan, Dell Hymes, reagoi kundrejt konceptit të Chomsky-t (Savignon, 2002:3), sipas të cilit, çdo individ lind i pajisur me një aftësi gramatikore për të prodhuar thënie të padëguara

më parë. Kritika e Hymes-it ndaj Chomsky-t lidhet me faktin se ky i fundit nuk merr parasysh situatat konkrete të komunikimit ku zbatohen rregullat e përdorimit të gjuhës, të cilat ndryshojnë në situata të ndryshme. Për të vënë në dukje këtë perspektivë sociolinguistike, Hymes-i (1972:273) propozoi konceptin e aftësisë komunikuese duke përfshirë këtu jo vetëm njohuritë e mirëfillta gramatikore, por edhe njohjen e rregullave të përdorimit të gjuhës që zotërojnë folësit e çdo gjuhe. Si rrjedhojë, gjuhëtarët po studiojnë strukturat gramatikore përtej fjalive, duke i dhënë shtysë studimit të ligjërimit (diskursit). Në qasjen funksionale të analizës gjuhësore, gramatika shihet si një burim për të realizuar kuptimin; gjuha perceptohet, para së gjithash, si një fenomen social, ku, nëse qëllimi është komunikimi, duhet të plotësohet kriteri i përshtatshmërisë së formës gjuhësore me kontekstin e komunikimit (Larsen-Freeman, 2001:34).

Rrjedhimisht, qasjet e ndryshme që u bënë ndër shekuj në gjuhësinë në përgjithësi, ndikuan, disa në mënyrë direkte, të tjera në mënyrë indirekte, në zbatimin e ndryshëm të gjuhës, së këndjemi edhe të gramatikës në sistemin arsimor, parauniversitar dhe universitar.

Hulumtimi dhe studimi i njohurive, zotësive (kompetencave) gramatikore të nxënësve të klasave 12 në Prishtinë, përbën qëllimin e punimit tonë. Me pak fjalë, synojmë t'i përgjigjemi pyetjes problemore: sa i zotërojnë këto njohuri, zotësi e shprehi gjuhësore nxënësit gjatë procesit mësimor në shkollë. Synimi është formimi gjuhësor i nxënësve për aftësimin e tyre në përdorimin e gjuhës për qëllime komunikimi. Zotërimi i këtyre shprehive çon konkretisht në përshkrimin, analizën dhe interpretimin e gjedheve të folura e të shkruara, në komunikimin e folur dhe të shkruar gjatë praktikave të ndryshme mësimore në lëndën e gjuhës shqipe.

Mësimi i gjuhës shqipe në shkollë nisur nga objekti i saj si lëndë parësore, synon zhvillimin e përgjithshëm intelektual dhe komunikues të çdo individit, për realizimin e të gjitha marrëdhënieve shoqërore komunikuese, që realizohen përmes tij (Gjokutaj, 2009:7).

Kuptimi i dijes sot ka evoluar nga të qenët i aftë për të kujtuar informacionin, në të qenët i aftë për ta gjetur dhe për ta përdorur atë. Për përmbushjen e këtij qëllimi, pikësëpari nxënësit duhet të jenë të aftë të

lexojnë, të zotërojnë shprehi që të interpretojnë duke konunikuar në mënyrë aktive.

Sipas Fjalorit të gjuhës shqipe, termi kompetencë shpjegohet kështu: “Njohuri të thella, të plota e të përpikta që ka dikush në një fushë të dijes ose për një problem të caktuar dhe që i japin atij siguri; aftësi” (1980:885). Termi ‘kompetencë gramatikore’ i përdorur fillimisht nga Chomsky (1965:3) i referohet aftësisë së lindur të njerëzve për të gjeneruar një pafundësi frazash; njohurive gjuhësore (sistemit të rregullave) të këtyre individëve për të kuptuar gabimet gramatikore dhe paqartësi të ndryshme. Kompetenca gramatikore është zotërimi i vetë kodit të gjuhës, që përfshin karakteristikat dhe rregullat e gjuhës, siç janë: fjalori, morfologjia (formulimi i fjalëve), sintaksa, shqiptimi, drejtshkrimi dhe semantika gjuhësore. Ajo është jo vetëm aftësia që kanë folësit për të njohur dhe zbatuar rregullat gramatikore të një gjuhe, por edhe mënyra e përdorimit dhe shfrytëzimi i duhur i tyre. Trajtimi tradicional mbi kompetencën gjuhësore, nga njëra anë, përvijoi filozofinë e mësimdhënies me në qendër mësuesin, dhe, nga ana tjetër, krijoi modelin e një nxënësi, subjekti, që ndërtohej dhe formohej gjuhësisht në kushtet e një laboratorit të gjuhës, e jo si subjekt i gjallë, me një zhvillim dinamik mendor e gjuhësor. Rezultat i kësaj mësimdhënieje ishin nxënësit me një repertor të varfër gjuhësor në shprehi gjuhësore e komunikuese, pasivë, riprodhues dhe jo të pavarur e kritikë ndaj dijes gjuhësore në veçanti dhe njohurive të përgjithshme në tërësi. Ndërsa, në vitet ‘70, Hymes-i, por edhe Savigno-n (1972:269), flasin për aftësinë ose kompetencën komunikuese si dije ose njohuri që i nevojitet një folësi ose dëgjuesi, por që ka një bazë më të gjerë sesa kompetenca e gjuhësisë çomskiane. Hymes-i flet për kompetencën e komunikimit, e cila përfshin dy tipa të dijes: gjuhësore dhe sociokulturore. Sipas tij, qëllimi i studiuësit të gjuhës është të kuptojë faktin që një fëmijë normal fiton njohuri për fjalitë jo vetëm si fjali gramatikore, por edhe si të përshtatshme, për ta përdorur në mënyrë korrekte gjuhën sipas situatave ligjërimore. Ai ose ajo fiton kompetencë se duhet të flasë ose të mos flasë, çfarë duhet të thotë dhe me kë?, kur?, ku?, si? (Yano, 2003:75). Pra, kompetenca komunikative e aftëson individin, ndër të tjera, kur të flasë, kur të heshtë, si mund të flitet me personat me statuse dhe role të

ndryshme etj (Saville-Troike, fq.18). Pak më ndryshe është modeli i kompetencës komunikative i propozuar nga Canale dhe Swain (1980), më tej i përpunuar nga Canale (1983), i cili dallon katër përbërës: 1) gramatikor, 2) diskursiv, 3) sociolinguistik, 4) strategjik.

Ndërsa Bachman (1990) ka propozuar një model tjetër të kompetencës që ai e quan ligjërimore, ndryshe prej Hymes-it, Canale dhe Swain. Bachman-i i jep shumë më tepër rëndësi aspektit gjuhësor të komunikimit në kompetencën e tij ligjërimore. Kjo kompetencë ndahet në dy përbërës kryesorë: përbërësja organizuese që përfshin përbërësen gramatikore dhe tekstore dhe përbërësja pragmatike që është në vetvete e ndarë në dy përbërës: ilokutive (efekt përfituese) dhe sociolinguistike (Plangarica, 2014). Pra, kompetenca komunikative përmbledh në vetvete, pos kompetencës gramatikore edhe: b. Kompetencën sociolinguistike, njohuritë e lidhjes mes gjuhës dhe kontekstit jogjuhësor, duke ditur si të përdorë dhe t'u përgjigjet në mënyrën e duhur tipave të ndryshëm të aktit të folurit, të tillë si: kërkesë, falënderim, ftesë etj. Është një nga tre përbërësit e aftësisë së komunikimit gjuhësor (KE, 2001:21) (aftësia sociogjuhësore) që ka të bëjë me parametrat sociokulturorë të përdorimit të gjuhës; c. Kompetencën e ligjërimit që do të thotë të dish e të jesh i aftë si të fillosh e të mbarosh bashkëbisedimet; d. Kompetencën strategjike, aftësitë e folësit për të përdorur strategji komunikative verbale dhe joverbale për të kompensuar dobësitë në komunikim ose për të përmirësuar efikasitetin e komunikimit, p.sh.: një nxënës nuk gjen fjalën a shprehjen e duhur dhe i duhet të përdorë një parafrazë ose perifraksim për ta sqaruar atë.

Një komunikim i suksesshëm është i lidhur pra ngushtë me saktësinë gramatikore, pasi aftësia gramatikore është një përbërës i rëndësishëm i aftësisë komunikuese. Njohja e mjaftueshme e gramatikës dhe përvetësimi efikas i saj i ndihmon nxënësit dhe të tjerët të kuptojnë dhe të shprehin qartë një mesazh të caktuar, në ligjërimin me gojë dhe me shkrim.

Sfondi metodologjik

Metoda sasiore zë vend të rëndësishëm në këtë hulumtim, sepse përmes kësaj metode do të paraqiten rezultatet e nxjerra nga anketimi që u është bërë nxënësve të klasave XII për zotërimin e gramatikës së shqipes në Prishtinë. Popullacioni i këtij problemi është i madh dhe homogjen, pasi atë e përbëjnë të gjithë nxënësit e klasave të dymbëdhjeta në Prishtinë për vitin akademik 2018/2019. Prandaj, për realizimin e këtij hulumtimi kemi qenë të detyruar të përzgjedhim një mostër paraprakisht. Mostër e këtij hulumtimi janë 143 nxënës, në dy gjimnaze në kryeqytet. Anketa përmban 10 detyra nga Morfologjia. Përgjigjet e pyetjeve janë me alternativa, nga katër prej mundësive, vetëm njëra është përgjigje e saktë.

Përmes kësaj ankete, mëtojmë të nxjerrim:

- se cili është niveli i njohurive të nxënësve të klasave 12 në Prishtinë;

- cilët janë faktorët që mund të kenë ndikuar për një gjendje të tillë të rezultatit të dalë nga anketimi;

- a janë në përputhje njohuritë gramatikore të nxënësve me objektivat e planprogrameve mësimore në këtë cikël shkollimi.

Rezultati i hulumtimit

Interpretimi i rezultateve të anketës

Dhjetë kërkesat e anketës përfshijnë detyra nga sistemi emëror dhe foljor i shqipes, si dhe fjalëformimi, më konkretisht, kërkesa që lidhen me formimin e një fjale; me emrin; përemrin dhe me foljen.

Në kërkesën e parë: *Fjala "bekurudhë" është formuar me anë të:* 10% e nxënësve kanë dhënë përgjigje nën *a) prejardhjes*, 62% prej tyre kanë përzgjedhur alternativën *b) përngjijtes*, ndërsa nën *c) kompozimit*, janë përgjigjur 28%. Asnjë nga të anketuarit nuk ka shënuar si përgjigje të mundshme opsionin *d)*, konversionin (0%).

Në pyetjen e dytë: Në fjalinë: *"Poezinë që do ta dëgjoni në vazhdim e ka shkruar Ismail Kadareja"*, e-ja është: *a) nyjë e përparme*, janë përgjigjur 12% e nxënësve, 15% kanë zgjedhur alternativën *b) pjesëz*. Pak më shumë se gjysma e gjimnazistëve të anketuar, 56%, kanë dhënë si përgjigje të mundshme opsionin *c) lidhëz*, duke u zvogëluar kështu numri i atyre që

kanë dhënë realisht përgjigje të saktë. Vetëm 16% e kanë identifikuar përgjigjen e duhur, *trajtë e shkurtër*.

Kur është bërë pyetja se çfarë veçorish gramatikore jep *mbaresa*: 25% e nxënësve janë përgjigjur se *mbaresa tregon veçoritë gramatikore të fjalës; të rrokjes*, 22% prej tyre; nën c) *veçoritë tingullore të fonemës*, e kanë përzgjedhur 18% e të anketuarve, ndërsa përqindjen më të lartë e kanë dhënë për alterantivën d), *të rrënjës*, 35%.

Në pyetjen e katërt: Se çfarë togfjalëshi është "*libri i një nxënësi*", 13% janë përgjigjur se është togfjalësh: *emër + mbiemër; emër + emër i shquar* kanë menduar afërsisht gjysma e nxënësve, 49%. Për opsionin *emër + emër i pashquar* janë përgjigjur 34% e të anketuarve, ndërsa një numër relativisht i vogël, 5%, kanë përzgjedhur mundësinë *emër + paskajore*.

Në fjalinë "*Konstandin, biri im, ti po flet kështu?*" detyra ka qenë që nxënësit t'i indetifikojnë përemrat: 42% e tyre janë përgjigjur duke rumbullakosur alternativën e parë: *përemri pronor, veta e parë dhe përemri vetor, veta e dytë*; 38% e maturantëve kanë dhënë si përgjigje të mundshme të saktë opsionin tjetër me radhë: *përemri vetor, veta e parë dhe përemri pronor, veta e dytë*. Përqindje më të ulëta të përzgjedhjes kanë pasur opsionet c dhe d, (c) *përemri pronor, veta e parë dhe përemri vetor, veta e parë*, 13%, dhe, përkatësisht 7% *përemri pronor, veta e tretë dhe përemri vetor, veta e parë*.

Numri më i madh i të anketuarve, 69%, kanë menduar se folja në fjalinë e dhënë "*Mësuesi ua dëshironte të mirën nxënësve.*", është në mënyrën dëshirore, ndërsa për mënyrën dëftore janë përgjigjur saktë vetëm 29% prej tyre. Përqindje e ulët, vetëm 2% kanë përzgjedhur mënyrën habitore, ndërsa asnjë nxënës nuk është përgjigjur për alternativën e fundit, mënyrën urdhërore (0%).

Në pyetjen e shtatë: *Folja ka kategorinë gramatikore: a) të kohës, të vetës, të rasës, të diatezës, të mënyrës* janë përgjigjur 41%; 24% e nxënësve kanë përzgjedhur opsionin b) *të vetës, të numrit, të diatezës, të mënyrës, të kohës*; c) *të numrit, të vetës, të shquarsisë, të mënyrës, të kohës* janë përgjigjur 19%, dhe vetëm 16% kanë përzgjedhur alternativën d) *të diatezës, të vetës, të numrit, të gjinisë, të kohës*.

Në pyetjen e tetë, për fjalinë: "*Mbasi ka ra nana me fjetë, kam marrë Dilocën n'odë teme.*" 16% e nxënësve kanë menduar se fjalia është

gramatikore, ndërsa pjesa më e madhe, 84%, janë përgjigjur se fjalia është *jogramatikore*.

Në pyetjen e radhës nëse në fjalinë: “*Unë jam nxënës shembullor.*”, përdoret kryefjala në numrin shumës dhe kallëzuesi i shprehur me folje në kohën e kryer të thjeshtë, 4% e nxënësve janë përgjigjur nën *a) Unë qeshë nxënës shembullor*; alternativën *b) Unë isha nxënës shembullor* e kanë menduar si të saktë 16% prej tyre; *c) Ne qemë nxënës shembullorë* janë përgjigjur 13%, ndërsa mbi gjysma, 67% e nxënësve të klasave 12, kanë përzgjedhur opsionin *d) Ne ishim nxënës shembullorë*.

Në pyetjen e fundit: Në fjalinë “*Më vonë Artanit ia kishin treguar të vërtetën.*”, folja është në kohën: *a) e kryer të thjeshtë* kanë menduar 33% e nxënësve; për mundësinë tjetër *b) e kryer* janë përgjigjur 28% prej tyre, 22% e nxënësve kanë përzgjedhur opsionin *c) më se të kryer*, ndërsa 17% e këtyre nxënësve janë përgjigjur nën *d) e kryer e tejshkuar*.

Përfundimi

Planprogramet, tekstet shkollore, metodologjia e mësimdhënies, si dhe mësimdhënësit, janë faktorë të rëndësishëm që nxisin nxënësit për të fituar e zotëruar kompetenca: gjuhësore, gramatikore, komunikative etj. Këto kompetenca mund të bëhen më të pasura, më të larmishme, në mënyrë që nxënësit të krijojnë përvojat e tyre dhe të komunikojnë lirshëm e me kuptim për qëllime të ndryshme, në situata të ndryshme, duke i dhënë kuptim të menduarit, qoftë nëpërmjet të folurit apo të shprehurit me shkrim.

Rezultati i anketës në pjesën hulumtuese të këtij punimi nuk është në përputhshmëri me objektivat që pritet t’i zotërojnë nxënësit pasi ta kenë përfunduar këtë cikël shkollimi. Prandaj, për planprogramet dhe tekstet shkollore kemi pasur vështrim kritik. Përfundimisht, shtrirja e çështjeve gramatikore nuk është e njëtrajtshme në cilin shkollor dymbëdhjetëvjeçar të lëndës së Gjuhës shqipe. Planprogrami i klasës IX i përfshin pothuajse të gjitha njohuritë gramatikore (morfologji dhe sintaksë), ndërsa njohurive gramatikore në klasën XII, përgjithësisht në shkollimin e mesëm të lartë, nuk u lihet pothuajse aspak hapësirë. Një

trajtim i tillë në sistemin arsimor, duke përfunduar mësimi i gramatikës nga nxënësit në klasën e nëntë, e duke qenë në një moshë relativisht të re për konsolidimin e saj, është një ndër faktorët kryesorë që rezultatat e anketës të kenë dalë jo të kënaqshme të nxënësit e klasave XII në Prishtinë.

Për shkak të njërive të pakta mbi gramatikën e shqipës që përfshihen në tekstet shkollore të ciklit të shkollës së mesme të lartë, u është bërë vështrim kritik edhe teksteve përpara këtij niveli për të parë shpërndarjen e njohurive gramatikore dhe trajtimin e tyre nga klasa në klasë. Nga ky vështrim kemi ardhur në përfundim se njohuritë gramatikore nuk janë dhënë çdoherë në mënyrë të përshkallëzuar sipas nivelit shkollor. Ka njësi mësimore apo edhe përkufizime krejtësisht të njëjta që përsëriten edhe në klasat pasrendëse, ose anasjelltas, ndonjë njohuri e re gramatikore, për herë të parë trajtohet në klasën XII pa u përfshirë më parë edhe në klasat pararendëse. Për shembull, një njohuri e caktuar gjen zbatim në secilin tekst të çdo klase, ndërsa disa të tjera lihen mënjandë, p.sh. dy nga mënyrat e fjalëformimit, si prejardhja dhe kompozimi trajtohen më shpesh, duke u përfshirë gjatë gjithë ciklit shkollor, në krahasim me mënyrat e tjera, të cilat diskutohen vetëm një apo dy herë. Gjithashtu, mungojnë sqarime më të detajizuara për dallimin e dy dukurive të cilat nxënësit mund t'i përceptojnë si të përafërta, bie fjala për kompozimin dhe përngjitjen. Edhe pjesa e ushtrimeve në fund të njërive mësimore, që mendohet se mund t'i ndihmojë nxënësit të jenë më aktivë në procesin e nxënies, përfshin veprimtari të tilla si të përgjigjurit e pyetjeve dhe të shkruarit e fjalive për të ilustruar me shembuj funksione dhe ndërtime të caktuara gramatikore. Në këtë mënyrë, këto tekste gramatikore mundësojnë që nxënësit t'i kuptojnë e zbatojnë më me vështirësi këto njohuri gramatikore, së këndejmi të kenë edhe përdorim të kufizuar të gjuhës.

Përgjithësisht mund të thuhet se në këto tekste nuk është arritur një lidhje e natyrshme dhe e përshtatshme ndërmjet njohurive për sistemin e shqipës dhe të aktit të ligjërimit; në shumë mësimë, tematika dhe situata konkrete të komunikimit në rubrikat *gramatikë*, *drejtskrim*, *gjuhë e folur* dhe *e shkruar*. *Të flasim dhe hartojmë* nuk u paraprin njohurive në përbërësin

pasardhës *gramatikë* apo *drejtskrim*. Madje, ato mësohen të shkëputura krejtësisht nga konteksti. Janë vetëm disa njësi të pakta mbi zhvillimin e aftësive komunikuese. Varësisht nga situata e komunikimit do të duhej të ndryshonte edhe struktura gjuhësore.

Në këto tekste këto njohuri gjuhësore do të duhej harmonizuar me aftësitë dhe shprehitë komunikuese, që ato të jenë të përzgjedhura jo si qëllim më vete, por në funksion të zhvillimit të aftësive komunikative të nxënësve, të ndërjegjësimit të tyre për zbatimet praktike.

Bibliografia:

1. ASHSH. (2002). Gramatika I. Tiranë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Shqipërisë.
2. Ballhysa, A. (2000). Formimi i aftësive gjuhësore komunikuese tek nxënësit. Elbasan: AEDP.
3. Chomsky, N. (1988). Gjuha dhe problemet e njohjes. Tiranë: Toena.
4. Chomsky, N. (2011). Strukturat sintaksore. Prishtinë.
5. Cook Vivian (2009). Introduction to Contemporary Applied Linguistics.
6. Gjokutaj, M. (2009). Didaktika e gjuhës shqipe. Tiranë: ShBLU.
7. Graffi, G. (2008). Ç'është gramatika gjenerative. Tiranë: Toena.
8. Harmer, J. Teaching and learning grammar. New York: Longman.
9. Hoti, I., Kazazi, Nj. (2009). Didaktikë e gjuhës shqipe. Tiranë: ShBLU.
10. Hymes. D. (1972). On Communicative Competence. Në J.B. Pride & J. Holmes (eds). Sociolinguistics. Selected Readings. Harmondsworth: Penguin.
11. Larsen-Freeman, D. (2000). Techniques and Principals in Language Teaching. Oxford University Press.

12. Littlewood, W. (1981). *Communicative language teaching*. United Kingdom: Cambridge University Press.
13. Lyons, J. (2001). *Hyrje në gjuhësinë teorike*. Tiranë: Dituria.
14. Neeleman and Van de Koot. (2010). *The relation between the linguistic competence and performance and the architecture of the grammar*.
15. Robins, R. (2007). *Historia e Gjuhësisë*. Tiranë: Dituria.
16. Savignon, S. (2002). *Interpreting communicative language teaching (Contexts and concerns in teacher education)*. London: Yale University Press.
17. Shashaj, Ali. (2007). *Metodikë e mësimin të gjuhës amtare*. Tiranë: ADA.

Anila SHORRI

A JANË NJËSI TË VEÇANTA LEKSIKORE FOLJET VETVETORE NË GJUHËN SHQIPE?

Abstrakt

Gjuha shqipe ka në leksikon e saj me dhjetëra klasa leksikore, semantike e fjalëformuese, të cilat presin të studiohen më në thellësi, kryesisht në anën më të rëndësishme të tyre, në rrafshin semantik. Një klasë e tillë përbëhet nga foljet pësore e vetvetore, të cilat, deri më sot, janë bërë objekt i studimeve me vështirësi thjesht gramatikore e fjalëformues, pra mungon një studim i plotë i përqëndruar në përmbajtjen a semantikën leksikore të tyre për t'i dhënë përgjigje pyetjes: foljet vetvetore e pësore, a janë njësi të veçanta leksikore, d.m.th. njësi me kuptim leksikor tërësor e të mëvetësishëm, kundrejt foljeve veprare përgjegjëse apo janë trajta që rrjedhin prej tyre? Përgjigja për këtë pyetje lidhet, **së pari**, me natyrën e përmbajtjes së tyre leksikore dhe, **së dyti**, me konceptin për diatezën e për zgjedhimin e foljeve. Në gramatika a fjalorë diateza jepet herë si kategori gramatikore dhe përfshihet si element i zgjedhimit të foljeve dhe herë si kategori leksiko-gramatikore. Ndërsa zgjedhimi i foljeve shihet nga pika të ndryshme kundrimi dhe shpesh studiuesit mbajnë qëndrime të ndryshme e jo rrallë edhe kundërthënëse.

Janë shqyrtuar, vënë në analizë, rreth 2500 folje vetvetore, vjelë nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 1980. Nga një shqyrtim i kujdesshëm, si edhe nga grupet dhe nëngrupet leksikore mëtojmë t'i përgjigjemi pyetjes: a janë njësi të veçanta leksikore foljet vetvetore në gjuhën shqipe? Punimi synon të hedhë dritë me metodën e analizës përbërëse (komponenciale), brenda kufijve të vet, mbi semantikën leksikore të foljeve vetvetore në gjuhën shqipe, e cila është objekt i tezës sonë të doktoratës.

Fjalë kyçe: *semantikë leksikore, analizë përbërjesore (komponenciale), folje vetvetore, folje veprorë, diatezë e foljes, zgjedhim i foljes etj.*

Abstract

The Albanian language contains dozens of lexicological, semantic and word-forming classes in its lexicology, which need to be further studied, especially regarding their most important aspect, i.e. the semantic one. Such a class is composed of passive and reflexive verbs, which have so far been subject to pure grammatical and word-forming research. There is no comprehensive research that focuses on their lexicological content or semantics to answer the question whether reflexive and passive verbs represent separate lexicological units, i.e. units of an entirely independent meaning from the respective active voices or whether they are forms that derive from them. The answer to this question is **first of all** related with the nature of their lexicological content, and **secondly** with the concept of the diathesis and conjugation of verbs. In grammar and vocabularies, diathesis is at times defined as a grammar category and included as an element of verb conjugation, and at others as a lexicological-grammatical category. While verb conjugation is seen from different perspectives, researchers have often different, and more than rarely even contradictory views.

The research analyses 2390 reflexive verbs extracted from the *Dictionary of the modern Albanian language*, 1980. A careful review of the lexicological groups and sub-groups tries to answer the question: are reflexive verbs separate lexicological units in the Albanian language? The research intends to shed light, using the componential analyses approach, within its limits, on the lexicological semantics of reflexive verbs in the Albanian language, which is the scope of our PhD thesis

Key words: *lexicological semantics, componential analyses, reflexive verbs, active verbs, verb diathesis, verb conjugation etc.*

Hyrje

E kemi vështruar këtë çështje në formën e një pyetjeje, sepse ende në studimet tona për këtë grup foljesh nuk është marrë një përgjigje, me gjithë përpjekjet e herëpashershme, për ta zgjidhur problemin e pranishëm në gjuhësinë shqiptare: të jenë fjalë më vete apo trajta fjalësh.

Punimi, brenda faqeve të tij, rreket të japë një përgjigje të argumentuar nga shqyrtimi i kujdesshëm dhe tërësor i një korpusi prej gati 2500 foljesh vetvetore, vjelë nga *Fjalori i gjubës së sotme shqipe*, 1980. Ai synon të hedhë dritë me metodën e analizës përbërjësore (komponenciale), brenda kufijve të vet, mbi semantikën leksikore të foljeve vetvetore e mesore në gjuhën shqipe, e cila është objekt i tezës sonë të doktoratës.

Përgjigjja për çështjen e mësipërme mendojmë se, **së pari**, lidhet me natyrën e përmbajtjes leksikore të këtyre foljeve dhe, **së dyti**, me konceptin për diatezën e për zgjedhimin e foljeve. Në gramatika a fjalorë diateza jepet herë si kategori gramatikore dhe përfshihet si element i zgjedhimit të foljeve dhe herë si kategori leksiko-gramatikore. Ndërsa zgjedhimi i foljeve vështrohet nga pika të ndryshme kundrimi dhe shpesh studiuesit kanë qëndrime të ndryshme e jo rrallë edhe kundërthënëse. Në këtë punim, ne i jemi referuar *Gramatikës së gjubës shqipe 1*, botim i *Akademisë së Shkencave*¹, dhe duke parë me kujdes mënyrën se si e trajton kjo vepër diatezën, me gjithë arritjet e padiskutueshme që i ka sjellë zhvillimit të gjuhësisë shqiptare, mendojmë se ka mungesë të karakterizimit semantik dhe strukturor. Le të ndalemi konkretisht:

Mungojnë kritere të qarta, sidomos semantike dhe distributive që na japin ndarje të prera mes foljeve kalimtare dhe jokalimtare apo të atyre që herë përdoren si kalimtare e herë si jokalimtare. Përkatësia e një foljeje në grupin e kalimtareve ose të jokalimtareve varet nga kuptimi i saj

¹ *Gramatika e Gjuhës Shqipe, I*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002, f. 270-272.

leksikor në kontekstin ku është përdorur². P.sh.: *Rrinte gjithmonë shtrirë e atje qante dhe e qanim. Pranë tij shkoi e ndenji edhe Flamuri. Shkoi edhe njëherë pëllëmbën mbi fytyrë e sikur u qetësua* etj.

Nuk mund të flitet për një përcaktim të saktë semantik të foljeve kalimtare në formën veprorë, pasi jo të gjitha foljet në këtë formë emërtojnë vetëm veprime. Është fakt se ka folje kalimtare, të cilat mund të shprehin gjendje (*mërzit dikë, pikëlloj dikë, gëzoj dikë*), procese (*vihoj punën*) etj.

Nuk është dhënë ndonjë përcaktim gjithëpërfshirës semantik e strukturor i përcaktuar qartë për dallimin mes diatezës veprorë dhe asaj mesore. Në të dyja diatezat foljet emërtojnë një veprim që e kryen kryefjala dhe dallimi është te kriteri formal dallues veprorë/joveprorë³.

Folja është në diatezën veprorë kur ka formë veprorë dhe emërton një veprim që e kryen vetë kryefjala, p.sh.: *Unë lexova një libër të ri. Nëna hapi dritaren.*

Përcaktimi i dhënë nga *Gramatika e Gjuhës Shqipe* në lidhje me diatezën si kategori morfologjike (me përcaktimet e saj formale, semantike dhe distributive), sipas nesh, nuk është i drejtë dhe nuk të jep mundësi përcaktimi të saktë të foljeve të ndryshme. Përcaktimet mbështeten kryesisht në një model përdorimi dhe nuk krahasohen me modele të tjera. Ndalemë këtu në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe (1980)*, në të cilin foljet që *Gramatika e Gjuhës Shqipe* i merr në diatezën mesore pasqyrohen si vetvetore. Po kështu, në këtë fjalor, shpesh pasqyrohen forma të së njëjtës paradigme si dy njësi më vete, p.sh.: *acaroj/acarohem, boshatis/boshatisem, copëtoj/copëtohem, çel/çelem, dallgëzoj/dallgëzohet, godit/goditem, handakos/handakosem, kyç/kyçem, laj/lahem, majm/majmem* etj.

Mendojmë se problematika e ngritur më sipër, për fat të keq, nuk është shteruese, prandaj, sipas nesh, dhe jo vetëm, ajo kërkon një përcaktim më të saktë të nivelit ose niveleve ku do të konceptohet, pasi

² *Gramatika e Gjuhës Shqipe, I*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002, vepra e cituar, f. 266.

³ *Gramatika e Gjuhës Shqipe, I*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002, vepra e cituar, f. 270-272.

kërkon koordinim analize të nivelit semantik, sintaksor dhe morfologjik. Po kështu, një folje duhet analizuar jo vetëm në marrëdhënien e saj me kryefjalën, por me gjithë rrethimin specifik të saj, në modele të ndryshme me të cilat shfaqet.

Në gjuhën shqipe, ajo për të cilën gjuhëtarët janë të një mendimi është fakti se i njohin shqipes katër diateza: *veprorë, pësore, mesore e vetvetore*.

Duke i rimarrë pohimet e studiuesve të njohur të gjuhësisë shqiptare si J. Thomai, E. Hysa, L. Buxheli, R. Memushaj, V. Memishaj⁴ etj. duhet thënë se është pranuar nga secili prej tyre se çelësi për të dhënë një përgjigje të prerë e të argumentuar lidhet pazgjidhshmërisht me konceptin e diatezës. Për të, në gjuhësinë tonë ekzistojnë dy mënyra këndvështrimi. Sipas këndvështrimit të parë, *Gramatikës së gjuhës shqipe*⁵, botim i *Akademisë së Shkencave*, diateza trajtohet si kategori gramatikore e foljes, e cila shpreh lidhjen midis veprimit të emërtuar nga folja dhe kryefjalës së fjalisë.

Sipas të dytit, atij të *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe, 1980*, diateza trajtohet si një kategori foljore që shpreh marrëdhëniet e ndryshme ndërmjet veprimit dhe subjektit ose objektit të tij, e që lidhet ngushtë edhe me fjalëformimin, me ndryshimin e kuptimeve e të përdorimeve të fjalëve. Pra, diateza trajtohet si kategori leksiko-gramatikore, që luan rol në fjalëformim.

Sipas këtyre dy këndvështrimeve, akademikët J. Thomai, E. Hysa dhe L. Buxheli, janë mbështetës të këndvështrimit të parë, dhe konkretisht, edhe pse nga mënyra të ndryshme analize,

ndajnë foljet vetvetore në dy grupe: a) folje vetvetore të cilat janë trajta të foljeve veprorë prej nga rrjedhin dhe b) folje vetvetore, të cilat,

⁴ J. Thomai, *Rreth semantikës leksikore të foljeve veprorë, pësore e vetvetore në gjuhën shqipe*, në Gjuha jonë, Nr. 3. 1984.

E. Hysa, *Gramatika në fjalorët e shqipes*, në përmbledhjen Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë, Tiranë, 2005.

L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2008.

R. Memushaj, si udhëheqës i një punimi diplome për cirkumfiksset e shqipes (S. Agolli, *Cirkumfiksset në gjuhën shqipe*, Tiranë 2004).

V. Memisha, *Rreth intelektualizimit të leksikut të shqipes*, në Studime për fjalën shqipe, 1, Tiranë, 2011.

⁵ *Gramatika e Gjuhës Shqipe, I*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002, vepra e cituar, f. 270.

për shkak të zhvillimeve semantike që kanë marrë si në gjuhën e folur e të shkruar, paraqesin zhvillime sasiore dhe cilësore, prandaj qëndrojnë si fjalë më vete.

Sipas këndvështrimit të dytë (mbështetës të të cilit janë gjuhëtarët R. Memushaj, V. Memishaj, por edhe të tjerë, ashtu siç jemi edhe ne në këtë punim - pasi na duket më i plotë dhe gjithëpërfshirës), i është lënë rrugë arsytimit se foljet vetvetore, të cilat, edhe pse i kanë trajtat gjegjëse në veprorë, duhet të merren si fjalë të veçanta.

Ashtu siç e kemi theksuar në hyrje të punimit, lëndën e kemi vjelë nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980*, pasi mendojmë se është vepra më e mirë e hartuar deri më sot në gjuhën shqipe, si për pasqyrimin e strukturave kuptimore, ashtu edhe në dhënien e shembujve ilustrues. Një arsye tjetër është se të gjithë fjalorët e hartuar pas këtij botimi (si shpjegues, ashtu edhe ata dygjuhësh), janë mbështetur tërësisht në pasurinë leksikore e frazeologjike që mbart kjo vepër. Po kështu, sipas kritikës leksikografike, dhe, sipas nesh, është fjalori më i mirë që ia ka dalë të kodifikojë pasurinë leksikore, semantike, frazeologjike të shqipes mbi parime dhe kritere të shëndosha shkencore.

Nga një shqyrtim i kujdesshëm i strukturës kuptimore të këtyre foljeve, i kemi ndarë në tri grupe leksikore:

Folje vetvetore me strukturë të njëjtë kuptimore me atë veprorë⁶ (*abstraktobem, acarobem, acidobet, afrobem, ajobet, ajrobet, ajroset, akordobet, aktivizobem, alarmobem, alkoolizobem, amortizobet, angazhobem, argjendobet, armatosem, arnobem, arsem, arsyetobem, arrihet, asnjansobem, ashpërobem, automatizobet, avullohem, azburnobem etj.*).

Folje vetvetore me strukturë të ndryshme kuptimore nga ajo e foljeve veprorë (*afitësobem, ajkëtohet, ajkobem, akullohem, ambientobem, amerikanizobem, amshobem, andrallosem, anësobem, angështobem, ankobem, ankorobem, anobem, anosem, argasem, argëtobem, armiqësobem, arsimobem, arrakatem, arratisem, atrofizobem, athem, athtëtohet, athtësobem, avitem, azdisem etj.*).

⁶ Shembujt ilustrues janë listuar sipas shkronjës së parë të alfabetit të gjithës shqipe, marrë nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980*, f. 1-79.

Folje vetvetore që nuk kanë folje gjegjëse në veprorë (*afshobet, agullobet, ajkoset, alivanosem, amëtohet, amullobet, angërdufem, argalisem, argoshem, avrobem etj.*).

Ashtu siç edhe u shprehëm më sipër, folja *abstraktobem* (*acarobem, boshatisem, copëtohem, çelem, dallgëzobem, goditem, handakosem, kyçem, labem, majmem, ndreqet, përgjithësohet, rubem, rreshkem, stisem, strebobem, shkatërrobem, tundem, vesobem, zbardhet etj*) është nga ato raste, kur struktura e foljes vetvetore përputhet me atë të strukturës kuptimore të foljes veprorë përgjegjëse. Edhe për këto folje në punimin tonë, sidomos për ato që kanë një shumësi kuptimesh të reja, të ndryshme nga veprorja, do të thoshim se nuk janë zhvillime të brendshme të fjalës, por një fjalëkrijim. Këtu bëhet fjalë jo vetëm për ndryshime në anën sasiore, pasi këto të fundit të çojnë në një cilësi të re, ashtu siç ndodh gjatë kalimeve nga polisemia në homonimi, nga një trajtë fjale në një trajtë të re. P.sh. *ballafaqobem* me katër kuptime, krahasuar me *ballafaqoj*, vetëm në kuptimin e katërt lidhet me të.

Ndalem i në shembujt e mëposhtëm: **ABSTRAKTÓHEM**⁷ *vetv. libr.***1.** Largohe me anë të të menduarit nga tiparet konkrete të sendeve e të dukurive dhe i përfytyroj ato në mënyrë abstrakte. *Abstraktobem nga e veçanta.*

2. Pës. e **ABSTRAKTOJ.**

ABSTRAKT/ÓJ *kal., ~ÓVA, ~ÚAR libr.* Veçoj me anë të të menduarit dhe përgjithësoj tiparet e lidhjet e veçanta të sendeve e të dukurive, bëj abstraksion. *Abstraktoj veçoritë (anët...)*

Abstraktobem është folje me dy kuptime, ndërsa veprorja gjegjëse *abstraktoj*, është folje monosemantike. Përsa i takon zhvillimit të kuptimeve, *abstraktoj* lidhet me *abstraktobem*₁ në thelbin kuptimor, pra nuk është tërësisht i njëjti kuptim.

⁷ *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 3.

BÍNDEM⁸ *vetv.* 1. Më mbushet mendja se diçka është e vërtetë a e drejtë, besoj plotësisht për këtë; **pranoj diçka pa asnjë dyshim si të vërtetë e të drejtë; sigurohem për diçka.** *Bindem vetë. U bind më në fund.*

2. **Veproj sipas kërkesave dhe urdhrave të dikujt,** e dëgjoj dikë dhe i nënshtrohem pa e kundërshtuar. *U bindem prindërve. I bindem urdhrimit. Bindem pa fjalë.*

3. *bised.*; **pranoj diçka pa asnjë dyshim si të vërtetë e të drejtë; sigurohem për diçka** *Bindeshin të gjithë me të.*

4. *Pës.* E **BIND.**

* **U bind dreqi** *thjeshtligj.* ndodhi diçka e jashtëzakonshme, u bë një përshtjellim i madh. **I bindet shkoptit të dirigjentit (të dirigjuesit)** *libr. shib te DIRIGJENT,~I.*

BIND *kal.,~A, ~UR.* 1.**I mbush mendjen dikujt** me arsyetime, me fakte e me prova se diçka është e vërtetë a e drejtë dhe e bëj të besojë plotësisht për këtë; **e bëj të pranojë diçka si të vërtetë e të drejtë** dhe të mos dyshojë për këtë. *Bind shokët. Bind masat. Bind me fjalë (me fakte, me prova). Përpiqem (arrij) ta bind.*

2. *bised.* **Bëj dikë të çuditet së tepërmi, e habit, e mahnit.** *Bindi botën.*

Nga ballafaqimi i strukturave të plota semantike të foljeve *bind* e *bindem* del se *bind*₁ “I mbush mendjen dikujt me arsyetime, me fakte e me prova se diçka është e vërtetë a e drejtë...” është një me *bindem*₁ “Më mbushet mendja se diçka është e vërtetë a e drejtë, besoj plotësisht për këtë; pranoj diçka pa asnjë dyshim si të vërtetë...”. Kuptimi i dytë i foljes *bind*₂ duket se ka dallime me kuptimet e tjera të foljes *bindem*.

Rasti i mësipërm, në kalimin nga veprimi në vetvetore, është akoma më interesant, jo vetëm se makrosistemi i foljes *bind* me dy kuptime pasqyrohet me katër të tillë si vetvetore *bindem*, por edhe sepse brenda makrosistemit të foljes ***bind*** janë pasqyruar 5 sinonime (të dalluara me shkronja të zeza), ndërsa brenda makrosistemit të foljes vetvetore

⁸ *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 146

bindem, janë pasqyruar 6 sinonime (të dalluara me shkronja të zeza). Duke u mbështetur te fushat leksikore e semantike, që kanë hyrë gjerësisht edhe si dukuri, edhe si metodë për studimet strukturore edhe në gjuhësinë shqiptare, themi se folja **bindem** me 4 kuptimet e saj formon një fushë të veçantë semantike.

Kurse grupi sinonimik, i përbërë nga *më mbushet mendja se diçka është e vërtetë a e drejtë; pranoj diçka pa asnjë dyshim si të vërtetë e të drejtë; sigurohem për diçka;veproj sipas kërkesave dhe urdhrave të dikujt; pranoj diçka pa asnjë dyshim si të vërtetë e të drejtë; sigurohem për diçka*, formon një fushë të re leksikore. Brenda kësaj fushe dallojmë vargje sinonimike që krijojnë nënfusha leksikore, si nënfusha e kuptimit 2.

Ndryshime nuancash e ngjyrimesh që duhen vlerësuar janë veçanërisht kuptimet e veçanta, të prejardhura nga kuptime të foljeve veprorë përgjegjëse. Fjalori që ne kemi marrë në shqyrtim, ka mjaft shembuj të tillë (*argëtohem, barazohem, cikem, çlodhem, çuditë, dëfrehem, emancipohem, gurosem, gjunjëzohem, hardallosem, infektobem, jargosem, kalbem, larosem, mallëngjebem, nervozohem, oksidohem, përlohem, qelbësohem, revoltobem, sëmurem, shastisem, tërbohëm, thinjem, urtësohem, vapohem, zalisem, zbulohem etj.*).

Nga ballafaqimi i strukturave të plota semantike të foljeve *ankoj* e *ankohem*⁹ del se *ankoj*₁ “Shpreh dhembjen me ahe e me ohe, rënkoj, qahem për një dhembje a sëmundje...” është një me *ankohem*₁ “Shpreh dhembjen me fjalë e psherëtima për një sëmundje a një të keqe ...”; *ankoj*₂ “qahem për diçka të padrejtë ose për një të keqe a një hall...” është një në thelbin semantik me *ankohem*₂ “Shpreh pakënaqësinë për diçka që nuk më pëlqen ose që e shoh të padrejtë...”; te *ankoj*₃ kal. “Ja qaj hallin dikujt...” duket sikur ka dallime me *ankohem*₃ “Paraqit një ankesë, bëj një ankesë me shkrim...”.

Ndryshimet semantike në shembullin e mësipërm mendojmë se na japin të drejtë t’i shohim si dy fjalë më vete dhe jo *ankohem* si trajtë e fjalës (foljes në veprorë në rastin konkret). Shembuj të tillë, por ajo që është më e rëndësishme, që janë më të zhvilluar përsa i takon zhvillimit semantik, janë në numër të konsiderueshëm brenda faqeve të fjalorit në fjalë.

⁹ *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 37.

Një rast interesant përbën edhe grupi i foljeve vetvetore që nuk kanë folje gjegjëse në veprorë (*argalisem, bakërosem, cipërohet, çmekem, drogohem, esëllohem, fosilizohet, gangrenizohet, gjumëtisem, kollavitem, jetosem, kënetëzohet, lëngatohem, mallohem, nevojitem, orvatem, përgjigjem, qimëzohet, rrëfatet, skandalizohem, shpërmallohem, tinëzohem, vardisem, zgjeboset etj.*). I sjellim këto folje në këtë punim, jo se dyshojmë në qenësinë e tyre si fjalë me kuptim të mëvetësishëm, por për të treguar se në një kohë më të hershme edhe këto folje e kanë pasurgjegjësen e tyre si në gjuhën e folur, edhe në atë të shkruar.

Sigurisht, në këtë përfundim dalim duke u mbështetur në *Fjalorin e gjuhës shqipe* të vitit 1954, si një ndër fjalorët më të vjetër të gjuhës shqipe. P.sh.: folje të tilla si *fosilizohet*, e cila në fjalorin e 1980-ës, përfshihet në grupin e tretë, në atë të vitit 1954, f. 127, vjen si *fosilizoj* ft., fosilizohem. Po kështu edhe folja *konsultohem* në fjalorin e 1980-ës, e ka pasur në atë të vitit 1954 *konsultoj*, f. 229, *konsultohem* etj.

Pra, duke u bazuar në zhvillimet semantike leksikore, të cilat janë jo vetëm sasiore, por edhe cilësore; mospërputhjet kuptimore veprorë-vetvetore dhe zhvillimet e mëvetësishme që kanë marrë foljet në vetvetore, zgjerimi kuptimor në polisintonimi; prezenca e foljeve veprorë në fjalorin e vitit 1954, por që mungojnë në atë të vitit 1980, janë tregues objektivë dhe jo të hamendësuar në përgjigje të çështjes së ngritur në fillim të punimit: foljet vetvetore nuk janë trajta të foljes veprorë gjegjëse, por qëndrojnë si fjalë më vete.

Bibliografia:

1. A. Kostallari, *Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes*, “Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike”, 1965.
2. A. Kostllari, *Parimet themelore për hartimin e fjalorit shpjegues të gjuhës shqipe*, “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, II, Tiranë, 1972.

3. E. Hysa, *Gramatika në fjalorët e shqipes*, në përmbledhjen Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë, Tiranë, 2005.
4. E. Likaj, *Disaçështje të kategorisë së diatezës në gjuhën shqipe*, SF 4, 1970.
5. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.
6. *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954.
7. *Fonetika dhe Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II*, Tiranë, 1976.
8. *Gramatika e Gjuhës Shqipe, I*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002.
9. G. Mounin, *La semantique*, 1997.
10. J. Thomai, *Rreth polisemisë dhe homonimisë në gjuhën shqipe*, SF, 4, 1981.
11. J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
12. J. Thomai, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe* (semantikë leksikore), Tiranë, 2009.
13. J. Thomai, *Rreth semantikës leksikore të foljeve veprore, pësore e vetvetore në gjuhën shqipe*, në Gjuha jonë, Nr. 3. 1984.
14. L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2008.
15. S. Agolli, *Cirkumfiksset në gjuhën shqipe*, Tiranë 2004.
16. V. Memisha, *Dukuria e polisemisë të foljet e prejardhura në gjuhën shqipe*, mbajtur në Seminarin ndërkombëtar për gjuhën, për letërsinë dhe për kulturën shqiptare, Prishtinë, 2002.
17. V. Memisha, *Rreth intelektualizimit të leksikut të shqipes*, në Studime për fjalën shqipe, 1, Tiranë, 2011.

Behar HOXHAJ

LËVIZJET SEMANTIKE GJATË PROCESIT TË SHNDËRRIMIT TË PARAFJALËS PËR NË PARASHTESË

Abstrakt

Parashtesa *për-*, me prejardhje parafjalore, është një nga mjetet më të përdorura për formimin e fjalëve të reja, kryesisht të foljeve, në gjuhën shqipe. Nga shqyrtimi i korpusit të fjalëve të formuara me këtë parashtesë në tre fjalorë (Fjalori i gjuhës së sotme shqipe 1980, Fjalori i gjuhës shqipe 2006 dhe Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe me mbi 81.000 fjalë i autorëve A. Dhrimo–R. Memushaj) dalin disa dukuri interesante për t'u studiuar. Vërehet se formimet me parashtesën *për-* janë të shumta, mbi 300. Parashtesa *për-* është ndër parashtesat më aktive në gjuhën shqipe. Kategoria leksiko-gramatikore e cila është pasuruar e pasurohet më shumë nga formimi i fjalëve të reja me këtë parashtesë, është folja. Gjatë parashtesimit, përveç formimit të një njësie të re leksiko-gramatikore, formohet edhe një strukturë e re kuptimore, semantike, me përbërësit e vet, të cilët mund të jenë të trashëguar nga tema fjalëformuese apo, më saktë, nga tema semantike ose mund të jenë përbërës të rinj të fjalës së re. Pikërisht, kjo është në qendër të këtij studimi, struktura kuptimore dhe lëvizjet semantike gjatë formimit të fjalëve të reja me parashtesën *për-*. Studimi i prejardhjes kuptimore në gjuhën shqipe jep historinë e lëvizjeve kuptimore, motivimin e njësisë të reja semantike, tipat dhe modelet e prejardhjes semantike, si dhe rolin e njësisë të ndryshme që marrin pjesë në këtë proces. Këtë përpiket që të arrijë studimi ynë “Lëvizjet semantike gjatë procesit të shndërrimit të parafjalës *për* në parashtesë”.

Fjalët kyçe: *lëvizje semantike, fjalëformim, parafjalë, shndërrim, parashtesë.*

Abstract

The prefix *për-* is one of the most used tools for the formation of new words, mainly verbs, in Albanian language. From the examination of the corpus of words formed by this prefix in three dictionaries (Fjalori i gjuhës së sotme shqipe 1980, Fjalori i gjuhës shqipe 2006 dhe Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe me mbi 81.000 fjalë i autorëve A. Dhrimo–R. Memushaj) there are interesting phenomenon to be studied. It is noted that the formations with the prefix *për-* are numerous, over 300. This prefix is one of the most active prefixes in the Albanian language. The lexical-grammar category, which is enriched and enriched by the formation of new words with this prefix, is the verb. In addition to the formation of a new lexical-grammatical unit, a new meaningful, semantic structure with its own components can be formed, which can be inherited from the word-forming theme or, more precisely, from a semantic theme or can be new components of the new word. Precisely, this is at the center of this study, semantic structure, and semantic movements during the formation of new words with the prefix *për-*. The study of the semantic descent in Albanian language gives the story of the semantic movements, the motivation of the new semantic units, the types and models of semantic origin, and the role of the different units participating in this process. This strives to reach our study “Semantic movements during the process of transformation of the preposition *për* in prefix”.

Keywords: *semantic movement, word formation, preposition, transformation, prefix.*

Lëvizjet kuptimore dhe parashtesimi

Në qendër të këtij studimi janë lëvizjet semantike gjatë procesit të formimit të fjalëve me anë të parashtesës *për-*, e cila ka prejardhje parafjalore. Për këtë është shfrytëzuar një pjesë e madhe e fjalëve të formuara me parashtesën *për-*, të vjela nga “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” 1980, “Fjalori i gjuhës shqipe” 2006, si dhe nga “Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe” 2015 i autorëve A. Dhrimo dhe R. Memushaj, meqë përmban një korpus të madh fjalësh (rreth 81 mijë), krahasuar me të gjithë fjalorët e gjuhës shqipe deri më tani.

Gjatë procesit të fjalëformimit, përkatësisht të parashtesimit, përveç formimit të një njësie të re leksiko-gramatikore, formohet edhe një strukturë e re kuptimore, semantike, me përbërësit e vet. Këta përbërës mund të jenë të trashëguar nga tema fjalëformuese apo më saktë nga tema semantike ose mund të jenë përbërës të rinj të fjalës së re. Për të hetuar se çfarë ndodh me këta përbërës dhe me krejt strukturën semantike gjatë parashtesimit, duhet përdorur analiza semantike, e cila është një operacion gjuhësor që ka disa objektiva themelore. Së pari, synon të zbulojë atë që në semantikë quhet organizimi semantik i leksemës, pra të gjejë rrjetën e semave të leksemës, që ka thurur leksema. Së dyti, të hetojë e të zbulojë derivacionin semantik (prejardhjen kuptimore) të fjalës, d.m.th. të gjejë vijën, nëpër të cilën kalon derivacioni semantik. Shkurt, gjen skemën semantike ose skemën e prejardhjes kuptimore të fjalës. Në themel të analizës semantike qëndron zbërthimi semantik (Metani, 2010). Me anë të këtij zbërthimi, kuptojmë më mirë edhe *lëvizjen kuptimore*, si shprehje e zhvillimit gjuhësor. Lëvizja kuptimore, si një dukuri e përgjithshme dhe e pandërprerë, është një kategori tjetër themelore në semantikë. Pa lëvizje kuptimore nuk mund të flitet as për prejardhje kuptimore, as për strukturë të kuptimit (Thomai, 2002, f. 88). Prejardhja fjalëformuese është e lidhur ngushtë me prejardhjen kuptimore. Nga studimet në fushën e formimit të fjalëve del se në gjuhën shqipe ka rreth 200 modele fjalëformuese; p.sh. me parashtesën *për-* + temën e emrit *buzë*, formohet folja *përbusz*; me parashtesën *për-* + temën e foljes *forvoj*, formohet folja *përforvoj*... (Thomai, 2002, f. 126). Pa dyshim, fjala e re që krijohet ka edhe një kuptim të ri, të

ndryshëm nga kuptimi i fjalës, nga tema e së cilës është formuar. Kuptimi i temës fjalëformuese është burim, temë semantike për kuptimin e fjalës që formohet, sikurse është një kuptim i një fjale temë semantike për një kuptim tjetër të prejardhur prej tij. Por, gjatë formimit të fjalëve, lëvizjet kuptimore kanë edhe veçoritë e tyre, sepse këtu marrin pjesë madhësi të ndryshme, me funksione të ndryshme, ndikon kuptimi kategorial i modelit fjalëformues, krijohet një njësi tjetër leksikore etj. (Thomai, 2002, f. 127).

Fjalët e formuara me parashtesën *për-* në tre fjalorët e shqyrtuar

Parashtesa *për-*, e cila është me prejardhje parafjalore, është mjeti më i përdorshëm për formimin e foljeve në gjuhën shqipe në përgjithësi (Mulaku, 1998, f. 54). Kështu, nga shqyrtimi i korpusit të fjalëve të formuara me parashtesën *për-* në tre fjalorë (Fjalori i gjuhës së sotme shqipe 1980, Fjalori i gjuhës shqipe 2006 dhe Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe me mbi 81000 fjalë i autorëve A. Dhrimo e R. Memushaj, 2015) dalin disa dukuri interesante për t'u studiuar. Vetë vjelja e këtyre fjalëve përbën një vështirësi, për arsye se nuk ka një prerje me thikë të rasteve të formimit me parashtesë nga ato të formuara me përngjijtje apo raste kur motivimi i fjalëve të prejardhura mund të bëhet në dy mënyra. Ndaj, edhe mund të bëhen gabime në identifikimin e fjalëve të formuara me anë të parashtesës *për-*. Për lehtësi studimi dhe duke iu përmbajtur analizës sinkronike të fakteve gjuhësore, në këtë studim janë marrë si fjalë të formuara me parashtesën *për-* ato fjalë, tema fjalëformuese e të cilave gjendet si fjalë e veçantë të paktën në *Fjalorin* e Akademisë së Shkencave të vitit 1980, në të cilin jepet edhe një strukturë më e pasur kuptimore e fjalëve. Me një fjalë, që të bëhet sa më e dukshme dhe e lehtë ndarja e dy përbërësve.

Pas vjeljes së fjalëve nga tre fjalorët e mësipërm, vërehet se formimet me parashtesën *për-* janë të shumta, mbi 300. Për t'u theksuar është fakti se në *Fjalorin drejtshkrimor 2015* gjenden, të paktën, sipas nesh, 23 fjalë me parashtesën *për-* që nuk bëjnë pjesë në dy fjalorët e tjerë. Kjo e dhënë, numri mbi 300 i fjalëve të formuara me parashtesën *për-*, flet në

të mirë të këtij modeli fjalëformimi, i cili ka ardhur gjithnjë duke u bërë më aktiv. Këtë e tregojnë edhe fjalët që janë formuar jo vetëm në gjuhën e folur, por sidomos në gjuhën e shkruar, në fusha të ndryshme të jetës. Kjo, duke u ndikuar ndoshta edhe nga gjuhët e huaja, pasi vihen re edhe kalkime apo gjysmëkalkime.

Fjalët e formuara me parashtesën *për-* në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* 1980

Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* 1980, dalin 357 njësi të formuara me parashtesën *për-*:

282 folje

27 ndajfolje

12 emra

11 mbiemra

3 parafjalë.

Te ky fjalor, numri i fjalëve (ose më saktë i njësive) të formuara me parashtesën *për-* është më i madh se dy fjalorët e tjerë, për faktin se janë dhënë si njësi më vete format vetvetore dhe pësore të foljeve (të paktën, 31 forma pësore foljesh dhe 109 forma vetvetore). Kjo gjë sjell si pasojë edhe një shifër më të madhe për sa u përket njësive të formuara me parashtesën *për-*.

Fjalët e formuara me parashtesën *për-* në *Fjalorin e gjuhës shqipe* 2006

Në *Fjalorin e gjuhës shqipe* 2006 gjenden 248 njësi të formuara me parashtesën *për-*:

182 folje

27 ndajfolje

13 emra

4 mbiemra

2 parafjalë.

325 fjalë të formuara me parashtesën *për-* në *Fjalorin drejtshkrimor* të autorëve A. Dhrimo dhe R. Memushaj:

249 folje

39 ndajfolje

14 emra

12 mbiemra

2 parafjalë.

Parashtesa *për-* si parashtesa më aktive gjatë fjalëformimit

Parashtesa *për-* është ndër parashtesat më aktive në gjuhën shqipe. Kategoria leksiko-gramatikore, e cila është pasuruar e pasurohet më shumë nga formimi i fjalëve të reja me këtë parashtesë, është folja. Kjo duket qartë edhe nga shqyrtimi i fjalorëve. Po kjo dukuri është vënë re edhe nga studiues të tjerë (Buxheli, 2008). Me këtë parashtesë janë formuar një numër relativisht i madh foljesh të prejardhura kryesisht nga vetë foljet edhe nga emrat. Kjo parashtesë mund t'u paravijet foljeve të çdo tipi zgjedhimi, si p.sh. *për-caktoj*, *për-hap*, *për-mbyt* etj.

Parashtesa *për-* u jep foljeve të prejardhura nga foljet: 1. Një kuptim intensiv dhe, 2. Një kuptim intensiv të shoqëruar me ngjyrimë të reja kuptimore. Po të krahasojmë, p.sh., strukturat kuptimore të fjalëve *punoj* e *përpunoj*, na del kjo pasqyrë: *punoj* 20 kuptime, *përpunoj* 4 kuptime (Thomai, 1983, f. 56). Sipas E. Hysës, në njësitë e formuara me parashtesën *për-* mund të dallohen këto kuptime:

1. Kuptimi më i përgjithshëm është kuptimi intensiv (përforcues, shënim yni – B.H.), i cili vihet re më dendur në njësitë foljore dhe mbiemërore, (por edhe ndajfoljore – B.H.): *përafroj*, *përbashkoj*, *përçoj*, *i përvishem*, *përzë*; *i përastë*, *i përçuditsbëm*, *i përndritsbëm*; *përbrinjazi*, *përyashta*, *përplot*, *përtej*.

2. Jep idenë e një veprimi të zgjatur: *përendem*, *përkujdesem*, *përndjek*, *përshpall*.

3. Kuptimin e përfundimit të veprimit: *përkryej*, *përmbaroj*, *përmbledh*, *përmbyll*.

4. Një veprim të përsëritur: *përdyj*, *përjap*, *përlind*, *përpunoj*, *përzgjedh*.

5. Kuptim afërsie ose afërie e krahasimi: *përavulloj, përfiket, përbumb, përngjaj; i përtafërm, i përgjumshëm, i përngjashëm.*

6. Veprim i dobët, veprimi sapo ka filluar, në një shkallë të ulët realizimi: *përdjeg, përndez, përnxe, përthaj, përuroj, përvak.*

7. Disa njësive u jep kuptim pejorativ: *përbuz, përçmoj, përflas, përqesh, përthem.*

8. Në disa raste, tregon përhapje, shpërndarje: *përderdh, përfush (përhap), përhap, përndaj.*

9. Folje (nga tema emërore – B.H.) me kuptim faktitiv-kauzativ: *përbalt, përbarr, përflak, përgjak, përloç, përmjalt, përudh.*

10. Formon folje në formë joveprore, që nuk kanë përgjegjësen e tyre veprore: *përanem, përbrihem, përgrykem, përkeqem, përkujdesem, përsbpirtem* (Hysa, 1972, f. 96-98).

Sa i përket çështjes se në cilat raste është më aktive parashtesa *për-*, në Gramatikën e Akademisë thuhet se prejardhja parashtesore në formimin e emrave është pak prodhimtare. Dallohen mbi njëzet parashtesa, por vetëm disa prej tyre janë bërë prodhimtare. Parashtesat me prejardhje parafjalore kanë një përdorim të kufizuar dhe hasen më të shumtën në fjalë që janë krijime të gjuhës letrare, p.sh... **për-**: *përvojë, përmasë* etj. (Gramatika e gjuhës shqipe, 2002, f. 145). Siç edhe pohon J. Thomai, mbi 80% e fjalëve në leksikun e gjuhës shqipe dalin në fjalorin shpjegues të 1980-ës me më shumë se një kuptim... Siç duket, gjuha shumë funksione të saj ua beson njësive të lindura nga zhvillimi i kuptimeve, jo nga formimi i fjalëve (Thomai, 2009, f. 77). Posaçërisht nga kjo shpjegohet edhe pesha që zë parashtesa *për-* në formimin e fjalëve të reja. Nga studiuesit tanë është vërejtur me kohë kjo gjë, ku natyrisht një vend të rëndësishëm zë studimi i Xhuvani-Çabejtë për parashtesat. Në këtë studim thuhet se parashtesa *për-* u ngjitet emrave, mbiemrave, ndajfoljeve e foljeve, duke u dhënë kuptime të ndryshme (Xhuvani dhe Çabej, 1980, f. 395).

Çfarë ndryshon kur parashtesa *për-* u bashkohet temave fjalëformuese?

Në Gramatikën e Akademisë thuhet se parashtesa nuk ia ndërron kategorinë leksiko-gramatikore fjalës me të cilën bashkohet, por i jep asaj vetëm një kuptim të ri plotësues. (Gramatika e gjuhës shqipe, 2002, f. 61). Duke i krahasuar formimet parashtesore me ato prapashtesore, J. Thomai dallon se “tek formimet parashtesore lidhjet janë më të ndërlukuara, shumëfijëshe, pra, me një shkallë më të lartë përgjithësimi; së dyti, tek formimet parashtesore parashtesa ka një rol më të madh abstraktues, më përgjithësues se prapashtesa tek formimet prapashtesore” (Thomai, 1983, f. 57). Ai thekson gjithashtu se vendosja e urës kuptimore ndërmjet njësisë leksikore prodhuese dhe fjalës së re nënkupton edhe shndërrime kuptimore: zgjerim, ngushtim a ndërrim të bërthamës së parë semantike (Thomai, 1983, f. 63).

Megjithëse ndajshtesat janë kryesisht mbartëse të kuptimeve leksikore suplementare, ato mund të jenë mbartëse edhe të dy përbërësve semantikë themelorë: së pari, të kuptimit leksikor kategorial, që përcaktohet nga përkatësia në një pjesë të ligjëratës, bën pjesë në kuptimin leksikor të fjalës së formuar dhe mbartet kryesisht nga prapashtesa; së dyti, të kuptimit leksikor të klasës së fjalëve ose të grupit paradigmatic të dhënë. Për shpjegimin e prejardhjes kuptimore dhe për zbulimin e veçorive të tij ka rëndësi njohja e vijës së formimit të fjalëve, pasi zbulimi i fjalës prodhuese, më drejtpërdrejt i temës fjalëformuese, na jep mundësinë e krahasimit dhe të ballafaqimit të strukturave kuptimore (Thomai, 1983, f. 80-81).

Lëvizje semantike gjatë formimit të fjalëve me parashtesën *për-*

Në sistemin fjalëformues të shqipes së sotme, sipas L. Buxhelit, foljet e prejardhura me parashtesën *për-* zënë një vend të rëndësishëm, si për nga prodhimitaria, ashtu edhe nga aktiviteti. Kemi të bëjmë me një nga ndajshtesat më të gjalla e më prodhimitare. Parashtesa *për-* krijon folje me

kuptime të ndryshme, por mbizotëruese janë kuptimi intensiv, përforcues, përsëritës, i përhapjes e ndonjë tjetër (Buxheli, 2008, f. 127). Nga studimet në fushën e formimit të fjalëve del se në gjuhën shqipe ka rreth 200 modele fjalëformuese; p.sh. me parashtesën *për-* + temën e emrit *buzë*, formohet folja *përbusz*; me parashtesën *për-* + temën e foljes *forvoj*, formohet folja *përforvoj*... (Thomai, 2002, f. 126).


Po të studiojmë strukturën kuptimore të dy foljeve të mësipërme, *forvoj* dhe *përforvoj* (shkëputur nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* 1980), vëmë re se kuptimet kanë ardhur duke u ulur, nga shtatë të *forvoj* në gjashtë të *përforvoj*. Por e rëndësishme, sipas edhe vetë strukturës kuptimore të foljeve të mësipërme, është ndryshimi i semave përkatëse. Në një rast tjetër: emri *gjak* dhe folja *përgjak*. Te ky rast shihet se nga 11 kuptime tek emri *gjak*, kemi vetëm tri kuptime të folja *përgjak*, e formuar me parashtesën *për-*. Sipas J. Thomait, fjala e re që krijohet ka edhe një kuptim të ri, të ndryshëm nga kuptimi i fjalës, nga tema e së cilës është formuar.

Parashtesat, ndryshe nga prapashtesat, në një radhë të tërë fjalësh, nuk kanë kuptim klasifikues, domethënë nuk i sjellin ndonjë ndryshim temës lidhur me përkatësinë e saj në ndonjë pjesë tjetër të ligjëratës (Hysa, 1973, f. 86). Parashtesa nuk ia ndërron kategorinë leksiko-gramatikore fjalës me të cilën bashkohet, por i jep asaj vetëm një kuptim të ri plotësues. Ka edhe një varg fjalësh të formuara me parashtesa, që i përkasin një pjese të ndryshme të ligjëratës në krahasim me temën fjalëformuese (nga një temë emërore formohet një folje), p.sh.: *përbalt* (*baltë*), *përbusz* (*buzë*), *përgjak* (*gjak*), *mburr* (*burrë*) *shfaq* (*faqe*) etj. Në këto raste fjala është formuar jo thjesht me parashtesim, po me një mënyrë të përzier, parashtesim dhe prejardhje pa ndajshesë (si te *shosh* < *shoshë*, *ndryshk* fol. < *ndryshk* em.). Parashtesat e gjuhës shqipe, si sasi, janë sa rreth një e treta e prapashtesave dhe, veç kësaj, nuk e kanë prodhimtarinë e këtyre të fundit... (Gramatika e gjuhës shqipe, 2002, f. 61).

Fjala e re dhe koka leksikore

Pasi trajtohet çështja e kategorisë leksiko-gramatikore të fjalës së re që formohet me anë të parashtesës *për-*, lind problemi në këndvështrimin

e gjuhësisë gjenerative. Cila shërben si kokë leksikore e fjalës së re? L. Buxheli në studimin e saj “Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe, 2008”, ka dhënë një skemë të thjeshtë binare të fjalës *përforcoj*.



Nisur nga aspekti formal, në këtë studim “kokën leksikore” të foljes jo të parme e shohim si një kategori të realizuar me një mjet fjalëformues, roli i së cilës, si rregull, është të përcaktojë kategoritë leksiko-gramatikore të fjalës jo të parme, përkatësisht të foljes. Pra, foljet jo të parme kanë një *kokë leksikore (K)*, e cila përcjell ose përçon te fjala tiparet karakteristike si pjesë ligjrate. Në shqipen e sotme *koka leksikore* jo gjithmonë është e barabartë me ndajshesën fjalëformuese, pra jo në çdo rast ndajshesa fjalëformuese shërben si kokë leksikore. Ka dhe raste kur koka leksikore e një foljeje të prejardhur realizohet vetëm nga tema fjalëformuese. Këtë dukuri e ndeshim te foljet me parashtesa. Kështu, nëse krahasohen foljet me parashtesa dhe prapashtesa, përkatësisht ndajshesat fjalëformuese *për-* dhe *-o* te foljet *përfitoj* dhe *punoj*, vërehet se roli i tyre nuk është i barabartë. Parashtesa *për-* e foljes *përfitoj* shërben thjesht për modifikimin kuptimor të temës fjalëformuese *-fito*. Folja e prejardhur *përfitoj* dhe tema fjalëformuese *-fito* nuk ndryshojnë nga pikëpamja leksiko-gramatikore. Kjo do të thotë që kokë leksikore e foljeve të prejardhura nga tema foljore nuk është parashtesa *për-*, por tema fjalëformuese *-fito*, sepse kjo e fundit përcakton kategorinë leksiko-gramatikore të foljes *përfitoj*. Ky pohim vlen për të gjitha foljet e prejardhura me parashtesa nga tema fjalëformuese foljore (Buxheli, 2008, f. 106-107).

Ndërkaq, për këtë çështje ka meritën që e ka trajtuar ndër të parët R. Memushaj, i cili ka kontributin se ka futur “erën” e re të studimeve gjuhësore sipas drejtimit perëndimor apo gjuhësisë gjenerative. Në

botimin e tij, “Gjuhësia gjenerative”, Memushaj shqyrton, mes të tjerash, edhe çështjen e formimit të fjalëve në këndvështrimin gjenerativist. Ai merr në analizë, sipas teorisë *X-bar* edhe fjalë konkrete të formuara me parashtesim. Teoria *X-bar* bazohet në konceptin e projektimit të sintagmave. Në thelb, kategoritë leksikore të gjuhës (emri, mbiemri, folja, parafjala) shërbejnë si koka leksikore që projektojnë sintagma, që përfshijnë këto koka dhe sintagma të tjera ose elemente leksikore (Memushaj, 2003, f. 128).

Ai thekson se kategoritë joleksikore nuk mund të jenë kokë e sintagmës, roli i tyre është ndihmës. Ato shërbejnë për të treguar veçoritë gramatikore të kokës së sintagmës, prandaj quhen *specifikues*. Në specifikuesit përfshihen nyjat, përemrat, foljet modale, fjalët e shkallës dhe llojet e ndryshme të fjalëve shërbyese (Memushaj, 2003, f. 129). Ndryshimi midis sintagmave dhe fjalëve të prejardhura shtroi nevojën e modifikimit të teorisë *X-bar*, në mënyrë që kjo teori të përdorej edhe për shpjegimin e fjalëve jo të thjeshta. Ky modifikim lidhet me emrin e E. Uiliamsit, i cili futi rregullën e quajtur «koka në të djathtë». Sipas kësaj rregulle, kokë e një fjale të derivuar është elementi në të djathtë të saj (1981: 248). Mirëpo shpejt u pa se kjo rregull nuk ishte universale, pasi ka gjuhë në të cilat morfema në të majtë përcakton kategorinë e fjalës së derivuar. Lieber-i e kundërshton rregullën e Uiliamsit, duke u mbështetur, së pari, në të dhëna të anglishtes, ku ka disa parashtesa që përcaktojnë kategorinë e fjalës së prejardhur, si p.sh. parafjala *en-*, e cila formon emra nga folje: *encase* “mbështjell, mbyll”, *entomb* “varros, gropos” etj. Po jo vetëm në anglishte; edhe në shqipe ka parashtesa të tilla, si *z-* në *zbardh*, *zverd* etj., që del si kokë e fjalës së prejardhur. Së dyti, ka gjuhë në të cilat kokë e fjalës së derivuar është morfema në të majtë të temës bazë, siç janë ato që njohin vetëm parashtesimin (Memushaj, 2003, f. 171-172).

Pra, shihet se ato problematika që nuk u jepte dot zgjidhje gjuhësia tradicionale, fare mirë mund të gjejnë rrugëdalje te drejtimet bashkëkohore të gjuhësisë siç është gjenerativizmi apo drejtimet e tjera që lindën prej tij apo si oponencë e tij. Në këtë drejtim duhet të ecë edhe gjuhësia jonë, duke qenë një model tashmë që ka pasur sukses jo vetëm në Perëndim, por edhe më gjerë se atje.

Përfundime

Nga shqyrtimi i fjalëve të formuara me parashtesën *për-*, të vjela nga tre fjalorët që janë marrë në studim, vihet re se numri më i madh i tyre u përket foljeve, ndërsa klasat me numrin më të vogël janë emrat dhe parafjalët. Kjo tregon për aktivitetin e kësaj parashtese të foljet, për vetë faktin se kjo klasë fjalësh, në përgjithësi, shpreh veprim, krahas kuptimeve të tjera, si gjendje etj. Në këtë mënyrë, edhe struktura kuptimore e fjalëve të reja ndryshon, si në sasi të kuptimeve, semave, ashtu edhe në cilësinë e tyre. Kështu, siç u pa edhe më sipër nga dy shembujt e cekur të formimit: *përforcoj* nga *forcoj* dhe *përgjak* nga *gjak*, numri i kuptimeve ka ardhur duke u zvogëluar. Përkatësisht, në rastin e parë, nga 7 kuptime të *forcoj* në 6 të *përforcoj*; kurse nga 11 kuptime tek emri *gjak*, kemi vetëm 3 kuptime të folja *përgjak*. Por më shumë rëndësi ka risia që sjell ky proces gjuhësor, që shoqërohet me kuptime dhe nuanca të reja kuptimore, ndër të cilat dallon: kuptimi *intensiv*, *përforcues*, *përsëritës*, por edhe disa kuptime të tjera. Ndërkaq, kuptimet e parashtesës *për-* në *Fjalor* jepen vetëm 3: *përforcues*, *fillimi i veprimit* dhe *veprimi*.

Një fakt interesant del nga përqsja e kuptimeve të parafjalës *për*, nga e cila vjen parashtesa përkatëse, me kuptimet e fjalëve të reja që formohen me këtë formant. Kjo, për arsye se vetëm në kuptimin 20 të parafjalës *për* flitet për një nuancë kuptimore, që ka lidhje me idenë e përforcimit (Përdoret zakonisht si fjalëz përforcuese me emra asnjës në rasën rrjedhore, në shprehje ndajfoljore me kuptime të ndryshme – *Fjalori i gjuhës shqipe*, 1980). Nga kjo shohim lëvizjen dhe zhvillimin gjuhësor të fjalës *për*, nga parafjalë, parashtesë e në fund pjesë përbërëse e një fjale të prejdardhur.

Bibliografi:

1. Buxheli, L. (2008). Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe, Tiranë: Akademia e Shkencave.

2. Dhrimo, A. Memushaj, R. (2015). Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe.
3. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980).
4. Fjalori i gjuhës shqipe (2006).
5. Gramatika e gjuhës shqipe, I, Morfologjia, (2002). Tiranë: Akademia e Shkencave.
6. Hysa, E. (1972). *Formimet me parashtesën për- në gjuhën shqipe*, në Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II, Tiranë: Akademia e Shkencave.
7. Hysa, E. (1973). *Disa çështje të parashtesave në gjuhën shqipe*, në Studime filologjike, nr. 3, Tiranë.
8. Memushaj, R. (2003). Gjuhësia gjenerative, Tiranë: SHBLU.
9. Metani, I. (2010). Leksione për lëndën e Semantikës, Master i Nivelit të Dytë, dega Gjuhësi, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës.
10. Mulaku, R. (1998). Parashitesat e prapashtesat e gjuhës shqipe në shkrime të vjetra (shek. XV-XVIII), Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
11. Thomai, J. (1983). *Formimi i fjalëve dhe prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, në Studime filologjike, nr. 3.
12. Thomai, J. (2002). Leksikologjia e gjuhës shqipe, ribotim, Tiranë: SHBLU.
13. Thomai, J. (2009). Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe, Tiranë: botime EDFA.
14. Xhuvani, A. Çabej, E. (1980). *Parashitesat e gjuhës shqipe*, në Xhuvani, A. Vepra I, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH.

KDU 811.18'27
811.18 '26 -112

Edona JAHIU

**NDIKIMI I GJINISË NË GJUHË TEK
ADOLESHENTËT NË PRISHTINË**

Abstrakti

Gjinia së cilës i përkasim, edhe pse është biologjike, pashmangshmërisht, drejtpërsëdrejti ose në mënyrë indirekte, ka ndikim edhe në zgjedhjet përkatëse gjuhësore, gjegjësisht, në të shprehurit gjuhësor.

Ky punim ka synim të dëshmojë lidhjen mes gjinisë si faktor sociolinguistik dhe mënyrës së të shprehurit apo modelimit të gjuhës, si strukturë individuale.

Përgjithësisht, diskursi i vajzave njihet si më i kujdesshëm, më i matur, i pasur me fjalë modale, mbiemra e ndajfolje, derisa djemtë, bazuar edhe në shumë studime botërore, përdorin më shumë gjuhën “vulgare”, sharjet, vetën e parë, janë më të drejtpërdrejtë etj. Kjo pasqyrohet praktikisht (jo plotësisht) në bisedat e analizuara, ku kemi dhënë disa veçori të të shprehurit, duke u fokusuar tek adoleshentët.

Për ta argumentuar lidhjen mes gjuhës dhe gjinisë, për ta evidentuar efektin e saj, janë incizuar biseda mes vajzash e djemsh adoleshentë të moshës 17-19-vjeçare në gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë, ku si tematikë e diskutimit, kanë qenë temat e përditshmërisë që janë tipike në këtë moshë, për ta parë shkallën ndikuese të kësaj ndryshoreje në zgjedhje gjuhësore.

Është bërë përpjekje për incizim të bisedave me rrjedhë të natyrshme, spontane, në mënyrë që rezultatet të jenë më transparente dhe më të sakta.

Kemi arritur në përfundim se janë disa struktura të paracaktuara të diskursit të kultivuara nga ideologjia, që ndërlidhen me gjininë dhe, për afërsisht, e parashikojnë përzgjedhjen e mënyrës së të shprehurit, por jo plotësisht.

Pra, ndryshorja sociolinguistike *gjini*, siç do ta shohim, ka ndikim të padiskutueshëm edhe në të shprehur ose, më saktë, në disa kufizime e liri gjuhësore.

Fjalët çelës: *gjuha, sociale, gjinia, adoleshentët, ndikimi, të shprehurit, zgjedhje gjuhësore*

Abstract

The gender to which we belong, although it is biological, inevitably, directly or indirectly, has an impact on the corresponding language choices, specifically, in linguistic expression.

This paper aims to demonstrate the link between gender as a sociolinguistic factor, and the way of expressing or modeling the language as an individual structure, but influenced by the social factors. Generally, the discourse of girls is known as cautious, prudent, full of modal words, adjectives and adverbs, while boys, based on many studies, use the "vulgar" language, swearings, first person singular, are more direct linguistically. This is practically (not completely) reflected in the analyzed conversations, where we have given some linguistic features, focusing on adolescents. In order to argue the link between language and gender and to highlight its effect, conversations between girls and teenagers (aged 17-19) were recorded at Gymnasium "Xhevdet Doda" in Prishtina, where topics of discussion were everyday topics, that are typical of this age, to see the degree of influence of this variable in language choices. Efforts have been made to record conversations with a natural, spontaneous flow, so that the results are more transparent and accurate. We have come to the conclusion that there are some predetermined structures of sex-cultivated gender-related discourse, and, roughly, envisage the choice of the way of expression, but not completely. So, the gender, as a sociolinguistic variable, as we shall see, has an indisputable impact in expression or more accurately, in linguistic retritions.

Key words: *language, social, gender, adolescents, influence, expression, language choice*

Hyrje

Megjithëse gjuhët ndryshojnë në shkallë të ndryshme nga njëra-tjetra, edhe brenda së njëjtës gjuhë, ka veçori të dallueshme gjuhësore sipas variablave të ndryshme sociolinguistike. Në përditshmëri, hasen shprehje si: *gjuha e vajzave, gjuha e djemve*. Është e vërejtshme që djali e vajza, edhe kur janë në të njëjtën moshë, status social, kanë veçori të dallueshme nga njëri-tjetri, në mënyrë të shprehurit, në dendurinë e përdorimit të tipareve linguistike etj. Ky dallim është i dukshëm dhe i qëndrueshëm jo vetëm në pamje të jashtme e stil, por edhe në performancën gjuhësore.

Njerëzit bëjnë pjesë në një grup të caktuar social dhe kanë një gjini¹, e cila, qoftë në mënyrë implicite, ka ndikim në shqiptim, variacion, fjalor e në shpeshësinë e përdorimit të fjalëve, ndërtimeve gramatikore etj.

Si objekt studimi në këtë punim është kushtëzimi i njërës ndryshore, saktësisht, gjinisë, e cila, në sociolinguistikë, nuk u referohet diferencave të tipareve biologjike, por dallimeve të sjelljes sociale, përfshirë të shprehurit gjuhësor – që është fokus i këtij hulumtimi. Janë incizuar gjithsej 55 biseda spontane mes adoleshentëve në mjedis shkolle ose kafeneje: 24 vajzë-vajzë, 19 djalë-djalë, 12 vajzë-djalë – që përbëjnë korpusin e punimit. Respondentët janë të moshës 17-19-vjeçare dhe nxënës të Gjimnazit “Xhevdet Doda” në Prishtinë. 87% prej tyre janë me vendbanim në Prishtinë.

Kjo temë është fushë studimi e disiplinës që merret me sintetizimin e gjuhës me shoqërinë (sociolinguistikës).

Hipoteza e këtij punimi është: *Vajzat (adoleshente në rastin tonë), konvencionalisht, u kushtojnë më shumë vëmendje përdorimeve dhe formave gjuhësore, megjë ende është mbizotërues mendimi se ato duhet të jenë më “të matura” para se të flasin dhe kanë konstrukte karakteristike apo tipare të veçanta leksikore e gramatikore të ngulitura shoqërisht.*

1. Gjinia si faktor sociolinguistik

Përkatësia në një klasë sociale ose të qenët djalë ose vajzë, nuk ka ndikim në nxënien ose në potencialin për të folur, por influencën stilin e përdorur të gjuhës, pasurinë leksikore në një domen të caktuar, performancën gjuhësore, formësimin e fjalive, sjell diversitet nga pikëpamja ekonomike etj. Këtë mund ta shohim në përditshmëri, në karakteristikat e bisedave të personave me të cilët rrethohemi.

Sa u përket dallimeve gjinore, Deborah Tannen, më 1990, e ka përdorur termin *genderlect* për të treguar se bisedat e djemve dhe vajzave

¹ Termi gjini në këtë punim nuk përdoret në kuptim biologjik, por social.

nuk janë në asnjë rast të gabuara dhe, sipas saj, të dyja gjinitë kanë mënyrat e tyre të të folurit dhe të të bërit biseda, por asnjëra gjini nuk ka forma më të drejta ose më superiore se tjetra. Megjithatë, s'mund të mohohet që ka në një masë diskriminime në kuptimin që vajzat, kryesisht, “duhet” të jenë më të kujdesshme në të shprehur.

Pajtohemi me faktin se deri në njëfarë mase, siç është vërtetuar nga shumë studime: (Labov 1972) (Wenjing 2012) (Lakoff 1985) (Holmes 1993, 2003), (Pauwels 1998), vajzat kanë tema të preferuara thashethemet, mallkojnë më shumë, ankohen më shumë, djemtë janë më të “shthurur” gjuhësisht, parapëlqejnë gjuhën vulgare, por nuk do të thotë se nuk ka pabarazi në shumë raste, p.sh., siç thotë edhe Wardhaugh (2006:322) “vajzave u kërkohet të mos flasin në situata të caktuara, ku flasin djemtë, derisa djemve u lejohet të flasin në të gjitha rastet. Gruaja ideale është “e qetë në prani të burrit të saj dhe në takime ku ka prezentë djem, ajo duhet të flasë pa zë ose fare”. Ose, edhe më bindshëm e thotë Robin Lakoff (1973:48): “efekti fundamental në pabarazi është se grave sistematikisht u mohohet qasja në pushtet me arsyetimin se ato nuk janë të gatshme ta mbajnë atë, e që demonstron edhe me sjelljet e tyre gjuhësore me të tjerët dhe ironia këtu qëndron se vetë gratë nxiten që të ndihen se e meritojnë një trajtim të tillë, për shkak të mangësive në inteligjencën e tyre ose në arsimim”. Të folurit e secilit realizohet jo vetëm nën ndikimin reciprok mes personave që kalojnë pjesën dërrmuese të kohës bashkë duke ndërvepruar gjuhësisht, por edhe gjinisë. E, meqë ka ndasi, djemtë dhe vajzat “markohen” me disa veçori më tipike.

Pas sqarimit teorik të ndryshores sociolinguistike: *gjini*, fokusi tani është te pjesa hulumtuese, ku janë dhënë biseda të incizuara me respondentë, për të evidentuar rolin e gjinisë në të shprehur, e në të cilat do të shihet se si bashkëveprojnë qëndrimet tona ndaj të tjerëve në zgjedhjet gjuhësore, duke u mbështetur në gjininë e bashkëbiseduesit.

Siç do të shihet, ka dallime të dukshme si në qasje, ashtu edhe në strukturimin gjuhësor mes të dyja gjinive. Do të shohim edhe biseda mes të rinjve të së njëjtës gjini, nga të cilat disa do të analizohen.

1.1 Bisedat vajzë/vajzë (adoleshente)

Sipas Romaine (1999:66), faktorët ideologjikë e kulturorë që janë për vajzat në përgjithësi ndikojnë edhe në sistemin gjuhësor, edhe pse zgjedhjet gjuhësore presupozohet të jenë plotësisht arbitrare te të dyja gjinitë. Do të thotë se si rezultat i faktorëve socialë, vajzat fillojnë t'i përvetësojnë format gjuhësore që janë karakteristike për to.

Biseda e mëposhtme është mes dy shoqeve 19-vjeçare me shoqëri të gjatë e të kultivuar:

A: *Kur kəjke aɟ, eðe be:ba kəjke, nək dıke tʃka mi: bə, ʊ tətke tʃka kə:*

B: *Tʃaʃtə ɟʃt se ti a dın s'dı na tʃka: me bo:*

A: *Be:ba sđın me katdzu:*

B: *Vetʃ a kə ma mi:r se kur ke:ʃ beba*

A: *kəkə: taf ni vit, mɔj me ko:n statzɔ:n*

B: *Jo: mɔ:nəʃ pə be:soj sət 1 vit ti:.. ʊne dɟ:l kə:m tʃeʃʃom'*

A: *Zoti mɔs mʃti:ʃt ndzɣnəeðe ʊne..*

B *Pɔ:ʃ zoti:n eðeʊne, normal vetʃ me ko:n ʃnof, amɔ dɟ:l du:*

Kjo është një bisedë tipike “femërore”², si nga ana e tematikës, edhe nga shprehjet e përdorura emotive, modale që i përgjigjen instinktit mëmësor: *munesh me kon shtazan, zoti mos m'shtift ngjyna, kuku etj.*, por edhe shenjon perceptimin e përvojën e bisedimit në këtë domen.

Në fillim, flitet për një person të tretë, duke e menduar edhe vetveten si nënë, e pastaj shprehin edhe dëshirën e frikën për të qenë nënë: *a ka ma mi:r se kur kesh beba, kuku tash ni vit muj me kon shtazan, djal kom qef ma shum, djal du.*

Format gjuhësore përputhen me përkatësinë dialektore dhe me afërsinë që kanë folëset, që u jep liri për shprehje më të lirshme: e pakryera

² Për ta cilësuar si të tillë, thjesht mbështetemi në konventa të ngulitura për bisedat që zakonsht i zhvillojnë femrat. Kjo s'do të thotë se meshkujt nuk flasin tema të tilla.

përdoret me mbaresat *-jke (tutke, kajke, dike)*, reduktimin e grupeve *nd (munet, mun)*, paskajoren (*me kon, me bo*) etj.

Gjithashtu, kjo bisedë u përgjigjet konvencave sociale të mënyrës se si shprehen vajzat në shoqëri, që është instinkti i nënës, thashethemet, shprehja e emocioneve, lidhja e ngushtë. Vështruar nga ky drejtim, përdorimi kësaj gjuhe diktohet edhe nga shoqëria e afrimiteti që kanë 2 subjektet mes vete.

Vajzat, në shumicën e bisedave të incizuara, (70.83%) janë të fokusuara te funksioni afektiv i gjuhës, më shumë flasin për probleme sociale, ushqim, ndjenja, libra, dashuri, probleme të përditshme, ndërsa djemtë më shumë për sport, vetura, femra, politikë.

Ato përdorin më shumë forma të mirësjellshme, i shprehin më shumë emocionet: *“sa bukur u dokoje”, ko me ble tesha (e ardhmja në dialektin gegë), a e ke pa qat k'mi:sh, jom n'diet, osht ka m'pëlqen bre, m'kallii* - kur pëlqimi për dikë është në shkallë të lartë, *po ha pem'ma shum'* - e tashmja e përdorur në kuptim gjithëkohor, *diqa uni* - në kuptimin *vdiqua nga uria*, e ndërtuar me foljen në të kryerën e thjeshtë dhe emrin në rrjedhore me funksion të rrethanorit të shkakut, por me kuptimin në të tashmen, që është nuancë kuptimore interesante e kësaj kohe, që parimisht lidhet me veprime të përfunduara, *kish fol mas shpinës për mu, sa mir folke, a e pe qysh mkqyri, o zot kqyrma barkun* etj.


Koha foljore që dominon në bisedat e incizuara është e pakryera në trajta dialektore (*sbkqojsha, e kqyrsha, folsha, dojsha*) dhe veta e tretë, që tregon se vajzat janë të prira për të folur për persona që nuk janë të pranishëm në bisedë.

Ato janë më të vëmendshme dhe më të interesuara në përgjithësi në krahasim me djemtë. Gjithashtu, dalin më shprehëse të ndjenjave të të tjerëve në rastet: *“o qysh u prek”, “a ia pe ftyrën”, “smujke as me fol”, “qysh u qart o zot”, “e shifsha që ma ka inati”, “qysh xhelozon o zot”, “gjith bobet kishë s'po sbob”, “gjith kesh falls”* etj.

Por, në këtë punim nuk duam të paragjykojmë, meqë këto janë përgjithësime. Madje, në 29.16% të incizimeve që kemi bërë, edhe pse gjuha e vajzave ka më shumë norma të paracaktuara sociale, paraqitet, të themi, “më e lëshuar”, e pabazuar në konvenca. P.sh. *“du me nejt deshun ton*

ditën,” *mo nuk mvjen interesant kurgjo*”, *“adaptona n’gjethtëka*”, *“jom ma e mira*”, *“i kisha myt djemt*”, *“djemt jon idiota*”, *s’ki nevoj’ mu marr me at’ t’poshtër*”, *“tung e kini krejt*”. Do të thotë se në kohën tonë, ka grupe vajzash që nuk kanë ndonjë kufizim gjuhësor, në shumë raste nuk e ruajnë intimitetin, privatësinë, janë ndërgjegjësuar për barazi dhe luftojnë që të shprehen lirshëm, duke i sfiduar dhe përmbysur format konvencionale gjuhësore, pa pranuar udhëzime se si të flasin.

Njëra-tjetrën e thërrasin rëndom me nofkat përkëdhelëse: *“syne*”, *zemër*, *“loçkë*”, *“rrush*”, por edhe *“qur*”, *“bajatic”*” *“majmunkë”*,”e *poshtër*”, e *trentë*”, *“menemadhbke*” (me nuanca humori dhe intimiteti), e në disa raste *“dost”*,”*bir*”, *“sbok*”, *“haver*” si ato mes djemve, të prira për t’i thyer këto stereotipe e për të treguar lirshmëri në komunikim dhe barazi gjinore.



Kjo tematikë është mbizotëruese, sidomos në shoqërinë e ngushtë, por duke u shmangur me personat që i shohin “të pabesë” ose “pjesëtare të grupit tjetër”.

Por, nëse i marrim rastet mbizotëruese, s’mund ta lëmë mënjanë faktin se ka dallime apo ndasi, në kuptimin që vajzat e kanë një ligjërim, përgjithësisht, më ndryshe nga djemtë. Siç thotë edhe Wardhaugh (2006:326), “vajzat bëjnë pyetje më shumë sesa djemtë, i nxisin të tjerët të flasin, përdorin mbushës joverbalë si *hmmm...*, përdorin më shumë përemrat *ti*, *ne* dhe nuk protestojnë aq sa djemtë kur ndërpriten gjatë bisedës. Në anën tjetër, djemtë ndërpresin më shumë, sfidojnë,

kundërshtojnë dhe injorojnë më shumë. Ata duan të kenë nën kontroll temat që diskutohen dhe janë të prirë të bëjnë deklarata më kategorike”. Gjithashtu, përdorin një gjuhë të kontrolluar, të matur dhe më pak forma të stigmatizuara, meqë janë më të dhënë pas modeleve gjuhësore të prestigjit.

Kështu, nuk mund të shpërfilllet prania e ndryshimeve gjinore në gjuhë, prandaj edhe populli ka arritur në përdorimin e shprehjeve “llafe, muhabete grash”, “fjalë burrash”.

1.2 Bisedat djalë/djalë (adoleshentë)

Dale Spender më 1980 ka publikuar librin *Man made language*, ku bën një lloj inspektimi të domeneve në të cilat shfaqet gjuha diskriminuese dhe se si djemtë e kanë strukturuar historikisht mënyrën e të shprehurit gjuhësor. Me çështjen e parë, do të merremi më poshtë, ndërsa në këtë pjesë, do ta elaborojmë gjuhën mes djemve, të parë në lidhje të ngushtë me ndryshoren e gjinisë, duke analizuar tiparet gjuhësore në bisedat që janë incizuar ku normalisht ka lëkundje, nuk mund të bëhen përgjithësime absolute. Pra, interes studimor paraqet ndryshimi mjaft i dukshëm i të shprehurit me të njëjtën gjini, krahas raportit vajzë-djalë.

Gjuha konsiderohet “mashkullore”, kur ka të shara, për më tepër, gjuha negative, dominuese menjëherë cilësohet si gjuhë e djemve.

Si shembull, le ta marrim këtë bisedë:

A: Tjyf nɔk ju vrɔ ati:j trupɪ, tjyf ka mu:jt mɛ ja hje:k e:fnat, tjyf ka mu:jt mɔs mɛ ju lɔndu: trupɪ, a mɔs mɔ grɪ:θ sa pɛrplɔsjen e ka pɔs, a naj brɪ t'θym a

B: Nkɛrr u kɔ:n

A: Tjyf brɛ kɛrr, baf n'kɛrr ɔ bir tɔmi:tɔt nɛrɪ

C: Po vata e rrok vɔlɔnin a e rok atɔ a, aɪ tʃɛlɛn eɪ rɛgat 100 mɪlɔn sɛnɛ jɔn ɔ bu:rr

A: A θu kɔf e ka vrɔ:

B: Baf mɛ dɔft mɛ dʒɛt, e dʒɛjn bi:r pɔ krynwe sjɔ han

C: eðe tʃɪkʒ tʃɪ kan dʒɛ:t lɑrg nɔni tʃɛrɪt

A: Si dibat aty, Ja për atë bi:r skifa thon, për t'firi kan dze:t larg, s'ka lidje ajë, mas p'akti p'om b'om p'arstypje, atë n'om, t'fj:f rre:ð L'epentst

B: Ëse k'u me di:t kan r'ç: p'o:ft kan hi: n'om, kan thon hajde p'ç hi:na p'ç l'om

A: Kan k'sy: terr, i ka m'çr lu:mi. Ia ka bo p'oni k'orr s'gud'çn

Këtu kemi bisedë mes tre shokësh, lidhur me një ngjarje të ndjeshme, saktësisht vdekje, ku secili prej tyre tregon versionin e vet se si mund të ketë ndodhur, pa e pasur problem përdorimin e fjalëve “të rënda”: *me ia h'jek esbnat, mos me iu l'endu trupi, m'u grith, bri t'thym, l'omitet n'jeri, e ka vra, kan k'çy n'terr*, që na tregon për gjuhën të çliuar dhe të shprehurit e lirshëm edhe për nga tema, e cila për vajzat përgjithësisht do të konsiderohet si jo e përshtatshme apo aspak e lehtë për t'u diskutuar a përfolur në mënyrë të qetë, siç bëhet mes djemve në këtë rast.

Kemi vërejtur se nuk përqendrohen në keqkuptime gjuhësore aq sa vajzat, madje i arsyetojnë rastet: *s'um han bre bir, p'o e di që s'um thu me at k'uptim, jo bre s'kom vakt tybe mu mar me to, hajt bre rrasja se s'pom dubet sen*, përdorin më shumë vetën e parë (68%)

Ky përemër është përdorur më dendur nga gjinia mashkullore: *une p'o shkoj n'sony bir, kom lujt dje me to ton ditën, kur p'o luj basket s'p'o di ka e kom kryt, me vjet s'kom bo detyra, une çka t'kom, ta thom n'sy*, derisa ai i vetës së tretë, më shumë nga gjinia femërore. Emrat me të cilët i drejtohen njëri-tjetrit përputhen me natyrën që zakonisht i karakterizon djemtë: *bir, dost, kryemadh*, si dhe me fjalë banale me ngjyrim humoristik, që shenjojnë marrëdhënie mes shokësh etj.

Fushat tematike më të diskutuara nga djemtë janë kryesisht: sporti, veturat, lojërat, vajzat, ndodhitë e jashtëzakonshme.

Në bisedat e incizuara vihet re edhe përdorimi i fjalëve banale, bisedat e fshehta me kode, lidhje të gabuara gramatikore qëllimisht etj.

1.3 Raporti vajzë/djalë (adoleshentë)

Gjinia, siç e kemi potencuar më lart, përbën një faktor të ndërlidhur me gjuhën. Kësisoj, kur individi flet dhe përzgjedh forma gjuhësore, është

edhe nën ndikimin e gjinisë së cilës i përket, që i jep liri ose vështirësi e ngurrim gjatë të shprehurit.

Për më tepër, disa forma gjuhësore që e kanë tërhequr vëmendjen e gjuhëtarëve, konsiderohen si diskriminuese. Siç thotë edhe Lakoff (1975:45), “ne e përdorim gjuhën, aq sa gjuha na përdor ne”.

P.sh. kur në një grup shoqëror që përbëhet prej 10 vajzash dhe një djali, është duke ecur bashkë, kur e përdorim deiksin vector për t’iu referuar atyre, në gjuhën shqipe thuhet: “*Ata po ecin bashkë*”, që është përemër vector i gjinisë mashkullore të vetës së tretë shumës. Do të thotë se ky vector përdoret si mjet gramatikor përgjithësues, gjë që e përforcon paragjykimin për t’i dhënë dominancë gjinisë mashkullore në gjuhë³.

Gjithashtu, edhe në rastet kur thuhet: *qytetarët, studentët, profesorët, nxënësit*, përfshihen të dyja gjinitë, megjithëse forma gramatikore është e gjinisë mashkullore.

Kur janë pyetur respondentët për arsyen pse konceptohet si e drejtë kjo trajtë e gjinisë mashkullore si gjithëpërfshirëse tek emrat e përgjithshëm, që në vete i referohet edhe gjinisë femërore, përgjigjet e tyre kanë qenë të parashikuara dhe të pritshme.

Thuajse të gjithë nga ata që janë përgjigjur, e marrin të mirëqenë, madje kur u thuhet se ka përbrenda një ideologji dhe se ka nevojë për shqyrtim sociolinguistik, e refuzojnë këtë, duke e marrë madje si shaka këtë pyetje. Vetëm një pjesë e vogël e vënë në pikëpyetje këtë shprehje të ngulitur gjuhësore.

Në anglishte, njerëzimit i thuhet *mankind* me fjalën *man* (burrë), që gjithashtu shihet si ndërtim favorizues për gjininë mashkullore. Po edhe në shqipe emri *njeri* zakonisht u referohet vetëm djemve.⁴

Vepra e Robin Lakoffit, *Language and Woman’s Place* (1975), është konsideruar si libër në tlin, ndër të tjera, ka lindur çështja e diferencave gjinore në gjuhë. Në këtë libër, ajo dëshmon, njëkohësisht kritikon, duke

³ Gjithashtu, në rastin kur prezantohet një femër bëhet shpesh dallimi “zonjë”, “zonjushë”, që nënkupton nevojën e gjinisë femërore për ta treguar statusin martesor, kurse për meshkuj përdoret vetëm “zotëri”.

⁴ Këtë fakt mund ta vërtetojmë kur vijmë 2 njerëz të panjohur (burrë e grua), mund ta përfolim “*erdh ni njeri dhe një gru*”

dhënë raste të bindshme dhe duke nxjerrë në pah diskriminimin gjinor direkt që bëhet në gjuhë.

“Nëse një vajzë e vogël flet ashpër, “si djalë”, ajo do të paragjykohet, qortohet dhe do të bëhet shaka me të” (Lakoff 1975:47). Sipas saj, vajzat duhet të flasin si djem, në rast se dëshirojnë të kenë barazi për ta shprehur një pikëpamje për ndonjë çështje. E nëse ato mësojnë të flasin “si vajza”, do t’u thuhet se nuk po flasin mençur.

Holmes dhe Stubbe (2003:574) propozojnë një klasifikim në lidhje me tiparet tipike të stilit mashkullor dhe atij femëror

STILI FEMËROR	STILI MASHKULLOR
I tërthortë	I drejtpërdrejtë
Pajtues	Kundërshtues
Lehtësues	Konkurrues
Bashkëpunues	Autonom
kontribuues minimal (në publik)	Dominues në kohën e ligjërimit (në publik)
Mbështetës ndaj bashkëbiseduesit	Ndërprerje agresive e bashkëbiseduesit
I orientuar te personi/procesi	I orientuar te qëllimi/rezultati
I bazuar te ndjenjat	I bazuar te referencat

Biseda tjetër (18-vjeçarë)⁵

A: *bej fɔ:m' ε mi:r' tʃɪkjɔ: tʃafɔ:rɛ!*

B: *Pərnime a? Falemnde:ɾɪt ε kɔm ble: kɔr kɛʃ nLondəɾ.*

A: *tʃɪtʃɪ nLondəɾ jɛ kon a ?*

B: *Po, pʂɛ?*

A: *S'ɪf kon ide: ε ke: tʃɛ mɛ ʃku: ɛðɛʊnɛ.*

B: *Po vata ven ɪ mi:r fɔ:m, unɛ ko mɛ ʃku: pɾa:p*

A: Ani de pɔ skɔjɫ:m bafk'.

B: Tʃka je: more tu: θo:n s'kɔke nve:ti ɫ:!

A: Pse jo more, mɔjna mɛ bo: fu:m sene nɫ dy:

B: Le: sɛ skɔke mi:r

⁵ A: Djali

B: Vajza

Këtu kemi një bashkëbisedim mes dy të rinjve që kanë dalë për herë të parë bashkë, megjithëse në dukje nuk pandehet si herë e parë e takimit, për shkak të mënyrës së qasjes së djalit.

Karakteristikat e lartpërmendura nga Holmes dhe Stubbe përputhen me ato që i kemi në këtë bisedë. Djali paraqitet i drejtpërdrejtë, i orientuar te qëllimet, më shumë dominues në bisedë, duke shprehur interesim direkt për femrën.

Nisja e bisedës me *hej shumë e mi:r' qikjo qafore!*, nuk është e përputhshme me pritshmërinë e marrëses, pra ka shkallë të lartë befasueshmërie në këtë rast. *Çka je more tu thon abahaab s'koke nveti ti!* është edhe një lloj sinjali indirekt për një interesim reciprok, marrë parasysh fonacionin e vajzës, që është i shoqëruar me buzëqeshje, butësi e ndjeshmëri.

Përdorimi i shprehjes *s'ish kon ide e keqe me shku edhe une*, jep indikacion tërthorazi që do të donte të shkonte me të dhe përgjigja e vajzës *une ko me shku prap'*, ia “hap rrugën” ta thotë drejtpërdrejt atë. Vajza shihet se është më e rezervuar, më e ndrojtur dhe më e tërthortë.

Pse jo more, mujna me bo shu:m sene na dy - shpreh afrimitet, njëkohësisht edhe humor, në mënyrë që të kuptohet nga marrësja dëshira për më shumë se shoqëri.

Tiparet e përdorura nga vajza janë tipike, karakteristike për ligjërimin femëror. Ajo ka gjuhë më të mirësjellshme, më të druajtur, me rezerva.

Pra, duhet pasur parasysh se gjuha të cilën e zgjedhim, gjithashtu, tregon edhe çfarë qëndrimi e bindje kemi për bashkëbiseduesit dhe mund të influencojë reflektimin e tyre ndaj mënyrës se si u flasim. Të dy i

përshtatin fjalët në përputhje me kontekstin e jashtëm, duke u munduar t'i përzgjedhin të duhurat. Djali njëkohësisht dëshiron të shprehë dominimin e tij, meqë, përgjithësisht, megjithëse pa të drejtë, djemtë shihen si më të ngritur dhe më mbizotërues në bisedë.

Sipas Coats (1993:45), “gratë parapëlqejnë fjalët dhe sjelljet e hijshme, kurse burrat parapëlqejnë më shumë të sharat. Pra, gratë janë ato që i shmangin fjalët e pista dhe kanë të shprehur më të rafinuar.

Ato përdorin më shumë fjalët dhe shprehjet modale dhe priren të jenë më të buta gjatë të shprehurit.

Në bisedën tjetër, pas fjalëve tallëse për një person, vajza i thotë, “*s’je normal*” “*gjeni je*”, ku me këtë kallëzues emëror e shpreh edhe superioritetin e djalit, derisa ai i flet në mënyrë urdhërore (duke u tallur) “*shuf*”, “*mos e ngrit zënin*”.

Pastaj, kemi vajzën (18-vjeçare) që nuk ndihet rehat në takim me një djalë (19-vjeçar) dhe përdor vazhdimisht mbushës joverbalë (*mmm...,ëëë*), duke pasur gabime të panumërta në lidhje të fjalive, ose, thënë më mirë, në koherencë të diskursit.

Pasi djali porositi picë pa asnjë ndikim të jashtëm, me qetësi, në momentin kur i kërkohet ta bëjë porosinë vajzës, i shmanget instinktivisht përgjigjes, duke bërë përzjerje temash dhe rrit paqartësinë (*unë nuk jom këtu, kom pu:n*). Ndërkohë, djali nuk e humb rastin të tallet: *kejo nuk osht këtu*, shoqëruar me të qeshura, derisa ajo vazhdon të mbetet në të njëjtën temë, pa e kuptuar se po bëhet shaka me sinqeritetin dhe frikën e saj: *s’kom qef me u krijë thashetheme për neve, me bo m’u bo naj llaf, tmys, a po çobem*.

Kjo dëshmon se mënyra e strukturimit të gjuhës është e lidhur ngushtë me faktorët sociolinguistikë (në këtë rast me gjininë), meqë duke e “ngurtësuar” individin psikikisht një faktor i jashtëm, edhe gjuha del e tillë, fragmentare, me mungesë kohezioni.

Pauwels (1998:228) me të drejtë thotë se “qëllimi i shumë përpjekjeve të feministëve në planifikimin gjuhësor është t’i ekspozojnë pabarazitë në portretizimin gjuhësor, të cilat reflektojnë dhe kontribuojnë në pozitën e pabarabartë të grave në shoqëri dhe që të ndërmerren veprime për ta korrigjuar këtë zhbalancim gjuhësor”.

Shprehjet e përdorura nuk janë gjithmonë fyese, por kemi hasur madje shoqëri të ngushtë mes të dyja gjinive, duke iu drejtuar me nofkën “*dost*”, “*bir*”, zakonisht me vajzat që kanë stil “më ndryshe” ose të ngjashëm me atë të djemve.

Ato përdorin fjalë me domethënie “më të ekzagjeruar” siç janë mbiemrat: *e mrekullueshme, fantastike, e shtrenjtë, magjepsëse, tepër e madhe, e bukur shumë, n’ekstrem e vogël*, i kanë të pranishme më shumë mjetet e modalitetit, prandaj, studiuesit e shohin të shprehurit e vajzave si më “elegant”, më të matur.

“Nëse vajza refuzon të flasë si “zonjë”, ajo përqeshet dhe kritikohet duke u cilësuar jofemërore; nëse mësohet të flasë ashtu, ajo gjykohet se nuk mendon mençur dhe nuk mund të bëhet pjesë e një diskutimi serioz” (Lakoff 1975:48). Sipas Lakoff-it, vajzat kanë diskriminim në gjuhë në dy mënyra: në mënyrën se si ato mësohen ta përdorin gjuhën dhe se si gjuha i trajton ato.

Edhe në bisedat e tjera të incizuara, shfaqet i njëjti rezultat, me pak përjashtime, pra dalin disa forma gjuhësore diskriminuese: *ti mos fol se je çikë, s’ke tru ti, veç dubesh me shujt*, e shprehje të tjera që i kemi potencuar në pjesën e anketimit.

Kjo i rimerr ideologjikisht mendimet për vajzat, që nuk mund ta kenë saktësisht të njëjtën performancë, për shkak se nuk i kanë pozitat e njëjta sociale. E kemi vërejtur gjithashtu se vajzat janë përgjithësisht të pasigurta në mendimet që i shprehin edhe elementet paralinguistike i kanë ndryshe nga djemtë.

Duhet të theksojmë se nuk ka ndonjë rregull të paracaktuar ose të lindur për sintaksën, apo fjalët që duhet t’i përdorin vetëm vajzat apo anasjelltas, ato sendërtohen dhe pranohen nga vetë shoqëria dhe përcillen brez pas brezi, por kjo nuk do të thotë se s’mund të ndryshojnë.

Dallimet që i kemi evidentuar si teorikisht, bazuar edhe nga studiues të huaj, (nga shumë vende të botës), edhe praktikisht në vendin tonë, në fakt, janë të dukshme në shumë raste. Duhet theksuar se ato, parimisht, nuk janë gjenetike. Dallimet në mënyrën se si do ta modelojnë gjuhën, apo fjalorin më të shpeshtë mësohen kur invididët “takohen” me bashkësinë

ku jetojnë e veprojnë. Këto dallime rrjedhin si pasojë e ideologjisë, mendësisë së ngulitur, shoqërisë.

Përfundimet

Për fund, mund të thuhet se gjatë diskursit, gjinia, në shumicën e rasteve, është përmasë ndikuese dhe e determinon ndërtimin e fjalive, qasjen ndaj bashkëbiseduesit.

Studimi ka shpënë aty ku është pritur, fakt që e përforcon bindjen e pranisë së këtyre diferencave, edhe pse, siç është theksuar, nuk mund të jepet përgjigje kategorike ose përgjithësim absolut, sepse kemi pasur raste të reaguesve ose shoqërive djalë-vajzë.

Përemri i vetës së parë është përdorur më dendur nga gjinia mashkullore, derisa ai i vetës së tretë, më shumë nga gjinia femërore. Kjo e pasqyron edhe faktin e njohur që vajzat priren të merren me thashetheme, duke përmendur persona që nuk janë të pranishëm gjatë komunikimit, e djemtë janë të fokusuar më shumë të flasin për veten.

Gjithashtu, bazuar në literaturën e shfrytëzuar dhe në hulumtim, ndryshorja sociolinguistike e gjinisë, e cila i jep dorë diferencimit të shoqërisë në grupe, tek adoleshentët del mjaft determinues në format ligjërimore të përdorura, me qëllimin për të qenë më sundues (djemtë), më “të rezervuara” (vajzat). D.m.th. ekzistojnë pritshmëri të caktuara në ndërtimin e gjuhës te vajzat, por jo plotësisht.

Pabarazia në shkallën e lirisë të të shprehurit nuk është problem gjuhësor, por social, – por reflektohet edhe në të shprehur.

Hipoteza e lartpërmendur është pjesërisht e saktë, meqë janë hasur raste të lirisë në të shprehur nga grupe vajzash, duke i shpërfillur konvencat gjuhësore që lidhen me gjininë.

Referencat:

1. Coats J. 1993. *Women, Men and language (2nd ed)*. London & New York: Longman.

2. Holmes, J. 1992. *An Introduction to Sociolinguistics*. London: Longman. (përkthyer në shqip më 2015 nga Kristina Jorgaqi; Irena Kapo).
3. Lakoff, R. 1973. *Language and Woman's Place* në: https://web.stanford.edu/class/linguist156/Lakoff_1973.pdf shikuar së fundi më: 14.06.2019
4. Pauwels, A. 1998. *Women Changing Language*. London: Longman.
5. Spender, D. 1980. *Man Made Language*. London: Routledge & Kegan Paul.
6. Tannen, D. 1990. *You Just Don't Understand. Women and Men in Conversation*. New York: Ballantine Books.
7. Wardhaugh, R. 2006. *An Introduction to Sociolinguistics (5th ed.)* Oxford: Basil Blackwell.

Entela MAZE (KORE)

TIPARE TË PËRBASHKËTA ARKAIKE MES ÇAMËRISHTES DHE AUTORËVE TË VJETËR

Abstrakt

Në këtë artikull kemi sjellë disa tipare arkaike që çamërishtja, si një e folme periferike, i ruan ende si të tilla. Shembujt janë sjellë nga të gjitha nënsistemet e gjuhës, fonetika, morfologjia e më pak nga sintaksa. Për çamërishten ata i kemi vjelë nga subjekte që bartin këtë të folme e këngë popullore. Kjo na dha mundësinë që të bëjmë një shqyrtim krahasues me tekstet e autorëve të vjetër, si të L. Matrangës, autorëve të Veriut, në veçanti me "Mesharin" e Gj. Buzukut (1555) dhe "Çetën e profetëve" (1685) e P. Bogdanit, si dhe me të folme të arbëreshëve të Greqisë e Italisë. Qasjet krahasuese na shpjen vetvetiu në përfundimin se shqipja ka qenë më unitare dhe dialektet e saj më të afërta sesa paraqiten në ditët e sotme.

Fjalët kyç: *çamërishte, tipare, zanore të gjata, djelme, pësore-mesore, autorë të vjetër, të dem, vinjënë, ulk, të folmet e shqipes.*

Abstract

In this article we have brought some archaic features that Cham Albanian dialect as a peripheral dialect still preserves them as such. We have brought examples from all subsystems of language, phonetics, morphology and less from syntax. Regarding the Cham Albanian dialect the examples have been collected from all the individuals that still speak it and from Cham songs. This enabled us to compare the earliest known texts in Albanian written by authors, such as L. Matranga, northern authors, in particular the "Meshari" by Gjon Buzuku (1555) and "The

Band of the Prophets" (1685) by P. Bogdani with the dialect of Arbëreshë people living in Greece and Italy. The comparative approaches lead us to the conclusion that the Albanian language has been more uniform and its dialects were closer than they are today.

Key words: *Cham dialect, Cham Albanian dialect, archaic, conclusion*

Çamërishtja, si e folme e skajit jugor e vendit tonë, është një e folme e konservuar veçanërisht te brezi i vjetër. Nga ana tjetër, për shkak të rrethanave që përshkoi në jetë popullsia që e fliste, ajo nuk pësoi të njëjtin evolucion si të folmet e tjera të shqipes. Për këtë arsye, në të gjen ende njësi të vjetra leksikore, forma arkaike që nuk pësuan evolucion. Ato janë të ngjashme dhe me trajta të ruajtura si në të folmet gege periferike ashtu dhe me ato arbëreshe.

Afëritë midis dialekteve, veçanërisht midis të folmeve të skajeve të trojeve shqiptare janë vënë re herët nga gjuhëtarët. M. La Piana, pas analizës krahasuese që i bën veprës së parë në gjuhën shqipe, shkruar në gegërisht "Mesharit" dhe asaj të L. Matrangës, shkrimtarit më të vjetër të toskërishtes, vuri re një varg përkimesh mes gegërishtes së librit të parë dhe arbërishtes së Sicilisë, duke arritur në përfundimin se ekziston një ngjashmëri e madhe ndërmjet gegërishtes së vjetër të Buzukut dhe dialekteve të shqipes, veçanërisht në periudhën e tyre më të hershme, përpara ndarjes në dialektet moderne.¹ Edhe E. Çabej e vuri re këtë dukuri kur studioi "Mesharin" e Gjon Buzukut dhe arriti në të njëjtin përfundim, se dialektet periferike ruajnë tipare më të vjetra se ato qëndrore.² Të gjitha këto përfundime na japin dorë për të bërë krahasime midis çamërishtes, tekstit të L. Matrangës, atyre të autorëve të Veriut dhe të folmeve të arbëreshëve të Greqisë.

Çamërishtja ruan *gjatësitë e zanoreve*, një tipar që ekziston edhe sot në gegërishte. Nga të folmet toske, edhe labërishtja e ruan këtë tipar të vjetër,

¹ M. La Piana, "I dialetti siculo-albanesi", in: *Studi linguistici albanesi. Varia* 1949, ribotuar në *Albanesi in Sicilia*/ F. Giunta... [et al.]; a cura di Matteo Mandalà, A.C. Mirror, Palermo, 2003, f. 100.(conclusionone).

² E.Çabej, "Disa aspekte të fonetikës historike të shqipes në dritën e gjuhës së Gjon Buzukut", në: Studime Gjuhësore VI, f. 183.

po ashtu dokumentohet te Dhiata e Re (1827), te arbëreshët e Italisë, paraqitet në gjuhën e Lekë Matrangës dhe pjesërisht në të folmet e Greqisë³, ndërsa të tjerat e kanë humbur. Te Buzuku: E mbasandaj shtiu ujë ndë një govadë, e zu me lam *ka:mbëtë* dishepujet (Mesh. 219/a); qi të denjë janë me u bam *pa:r*, buri e gruoja (Mesh. 81/a).

Te Bogdani⁴ *baajtekescine, gaatuem* (II 126 5; 153 8), *ndeernem, Deetaretë* (II 35 12; I 142 1), *mrijmaga* (II 79 26) etj., ashtu si dhe te Matranga: *e vdeku:rë e kallturë*, e fuqi të *pasosme*, shpirt e *tri* fuqi etj. Te Dhiata e Re: do të *jeetë* fajtuarë ndë *gjiq* (Meksi: 209); që *rrijnë* ndë varkë (Meksi: 208), *e mbretëriisë perdiisë*. (Meksi: 208)

Një tjetër tipar fonetik arkaik gjendet në këtë të folme, që na rezulton i përbashkët edhe me autorët e parë, është *ruajtja ende*, madje jo rrallë, *e ë-së* së patheksuar fundore në fjalët preparoksitone, si: *kartëratë*⁵, *dbëndërinë*, *të bukurinë*⁶. Kjo vihet re edhe në të folmen e Gjyrokastres⁷ në brezat e moshuar: *fëndratë, gjithënjë, nënënë, kóshtratë, zëmrenë, núsënë* etj. Këtë e vërejmë edhe te libri i parë: Përpara *ditësë Páshkëë* tue ditunë Jezu...(Mesh. 219/a); E mbasandaj shtiu ujë ndë një govadë, e zu me lam *ka:mbëtë* dishepujet (Mesh. 219/a) etj. Edhe te Bogdani⁸ e hasim këtë tipar të shqipes së vjetër: *zëmërrë, letërrësë, bukëllënë, emënitë*. Te arvanitasit: ujt e *Kamaresë*: moj *vetullë* prëzuarë; Moj *e bukurë* nga tërë / çëlja mëmë të ka bërë. (Th. Moraitis: 145, 139)

Përveç këtyre ngjashmërive që përmendëm më sipër, në fushën e fjalëformimit kemi përsëri ngjashmëri me gjuhën e Buzukut. Po përmendim këtu prapashtesën –*shim* dhe *çim*; *i friksuacim*, *i kollajçim*.

³ A. Klosi, “Hyrye: Një thesar gjuhësor që fjeti 150 vjet”, në: Netët pellazgjike, vep. cit., f. 32.

⁴ A. Omari, Tipare arkaike në gjuhën e Bogdanit: përkime me të folmet e jugut.

⁵ E. Çabej “Gjon Buzuku”, vep. cit., f.44, cituar sipas Pedersenit, Albanesische Texte mit Glossar, 1895.

⁶ Q. Haxhihasani, art. cit., DSH I, f. 144, cituar sipas Pedersenit.

⁷ M. Kore, Gjyrokastira, vështrim historik, gjuhësor dhe etnologjik, “Dudaj”, 2014.

⁸ A. Omari, art,cit.

Nga ana tjetër, në të dy skajet dialektore të shqipes ka ndodhur një dukuri në kah të kundërt, që është rënia e hundores dhe ruajtja e okluzivit

në këto grupe. Eqrem Çabej i ka kushtuar vëmendje kësaj dukurie që haset te Buzuku, por dhe te autorët e tjerë të vjetër, si dhe nëpër dialekte⁹.

Në çamërishte: Trëndafil i bardhë / *birë* mu në shkallë “mbirë” (Rëzanj); *më gërrijti* “më ngriu”; çel zjarrë shpejt se na *gërrijti* (Janjar); Dua ta them *e trubem* “ndruhem”; Vate n pallat të *bretit* e këndon “mbreti”; se mos kanë *kome*, se *komet* e vrasin ullirin “kombe” (Tekste, dial.II, 129); E mund të vijojmë me një varg shembujsh *baj* “mbaj”, *bathtë* “mbathë”, *besa* “mbesa”, *bjell* “mbjell”, *bledh* “mbledh”, *bërthen* “mbërthen”; *dërtoj* “ndërtoj”, *dërroj* “ndërroj”, *dihmë* “ndihmë” *derë* “nderë”, *daj* “ndaj”; *greu* “ngreu”, *gri* “ngri” *garkoj* “ngarkoj”, *gushtë* “ngushtë”.

Po ashtu nga arbërishtja e Greqisë¹⁰: *Blijdhni* ljuljezëtë e malit “mblihdni”; Mere bie nënëso / djalit mos i *u da* “nda”. Te Bogdani¹¹ dëshmohet ruajtja e okluzivit në grupin /ng/ në leksemat *shtërguem*, *meguem* (p.sh. II 16 14 krahas *menguem* I 92 24, II 2 2, II 25 7 etj.),

Në çamërishte është ruajtur togu *lk* në fjalët: *ulk*, *ulkë*, *alkë*, *balgë*¹². Buzuku: Hinje se të vinjënë ditë qi të afëronetë *bulku* me korësit (Mesh.299/a); E rogetari që s anshtë bari e që nukë janë dhentë e ti, aj në patë *ulknë* se vjen, le dhentë e ikën e *ulku* i grabitën e i përnda (Mesh. 253/b).

Bogdani¹³ e ruan këtë grup bashkëtingëllor në leksemën *bulk* që del në 3 fjalëforma I 177 I, II 64 3, II 64 3 dhe në leksemën *ulkonjë* që del vetëm në një rast *Ulkonja* I 167 2, përndryshe *l*-ja është spirantizuar në *j* në leksemën *ujk*: *ujk* I 49 6, *ujku* I 161 1. Në çamërishte është ruajtur togu *lk* në fjalët: *ulk*, *ulkë*, *alkë*, *balgë*: *Ulku* nuk vihet çoban (Filat, Dialekt.,II).

⁹ E. Çabej, “Hyrje” në: ‘Meshari’ i Gjon Buzukut (1555), botim kritik, Tiranë, 1968, f. 83-84.

¹⁰ Th. Moraitis, vep.cit.

¹¹ A. Omari. art. cit.

¹² Q. Haxhihasani, studim i cit., DSH I, viti f. 155.

¹³ A. Omari, artik. Cit.

Te Dhjata e Re, Grigor Gjirokastriti ka raste në numrin shumë: e dha atë në *bulqër*; janë *ulqër* që rëmbejnë. Në këngët e arvanitasve të

Grequisë¹⁴ e ndeshim po kështu: Eja të të puth një çikë / lfej të haj *uljekudhitë*.

Nga ana tjetër, në këtë të folme gjejmë ende të paevoluar grupin *kl, gl*: ka *klënë* edhe një gravë e thellë; sharka të gjata jaram në *glu*. ...të psë *glishtërit* më vanë në tru; *i zgledhëm* mos kanë kome ...(Tekste, Dial..II. f.126, 127). Tek Matranga: Çë shërbes ishtë *klisba* shejtë katholicë. Te arvanitasit: do t'a pres koçidhet *gljatë* / po çë turpen nga it'atë. (Th. Moraititis, 55)

Në këtë të folme zanorja /o/ që ka dalë nga kontraksioni i togut /ua/ në lidhore apo të kryerën e thjeshtë shndërrohet në /e/. Në çamërishte lidhorja e foljes *them*, në v. III del *thetë: të thetë, të thenë* dhe e foljes *dua: të detë, të denë*: a të hollë/ a të trashë si të *deshtë*; *dua të më theçë/ çish mëriri ke?* (Dial.II, f.117). Kjo formë del edhe në shqipen e Grequisë, te Reinholdi: *çë të na thetë*¹⁵. Edhe Matranga ka *t'thetë* 45v; *të de* 10r, ku trajta e lidhores *dē<doe*.

Edhe asimilimi është tipar fonetik i kësaj të folmeje. Nga e folmja çame mund të sjellim disa shembuj asimilimesh nga kërkimet e Q. Haxhihasanit:

- për asimilimin *rrn > rr*: *Trëndafil i bardhë* / birë *mu në shkallë / zuri lëshon fletë, të valoj beharë* (Rëzani); për *Isuf buzëshqerrë, / në Janin' e dhanë haberrë* (Dial.II, f.9) e mund të vazhdojmë me fjalë si: *të birrë, manarrë, varrë, zjarrë, u therrë, bëngërrë, muarrë* etj. Te Matranga: *qiellë e dhenë, e mbë Isus / Krishnë, të birrë e ti të vetëmë*.

- për asimilimin *lln > ll*: t'i març edhe *mallë* që u ka marrë...; *puallë, suallë, vuallë; dhn > dh*: *u mblyadhë, e lidhë, ardhë (<ardhnë), e zgloodhë; tn > n*: *surrinë, pallanë, na mbenë, denë (> detnë)*¹⁶. Matranga *lln > l*: *qiellë* 11v; *rrn > rr* *birrë* 17r; *të birrë* 11v; *të mërkurrë* 32v; *tn > n* *pont pilanë* 11v; *tënëzënë* 11v; *krishnë* 15v. Te këngët e arvanitasve: *burbuqasnë mollatë /u rrinë* ato të

¹⁴Th. Moraitis, Antologjia e këngëve arvanite në Greqi.viti

¹⁵C. Reinhold, Netët pellazgjike, bot. cit., f. 201.

¹⁶Q. Haxhihasani, vep. cit., f. 156.

hollatë. (Th. Moraitis, 107) çë tiposi

Një tjetër asimilim është *tsb* në *ç*. Në çamërisht *i mënçim, fjeç, Më paç* pa di si në ballë!; Mos *paça* djelmt. (Dialektologjia, II, f.31) Te Dhjata e Re: nuk është profit *i panderçurë*. Te Bogdani: ...ndë mos *paça mbëledhë syt e mi...*(p.I,f.6); e ndë *mbajç* urdhënimetë mia. p.II,f.111. Ngjashmëri mes dy skajeve gjuhësore të shqipës ka edhe në disa asimilime të tjera tingujsh. Te Bogdani kemi asimilimin e grupit *svb* në *ç* në mbaresa foljore si: I 88 10 të *flaç*, I 101 18 të mos më *ngaç*. Në çamërisht haset e njëjta dukuri në: *të nglaç, të pjeç, të flaç*.¹⁷

Karakteristikë është se fonema /r/ nuk është shndërruar në /l/ te fjala *palë* (çift). Në çamërishte: edhe një *parë* patiqe për qilime / vajza për palën e saj; edhe mer e ben një par palate atje// n'anë të sqelit. Te shqipja e Greqisë: Pse më shjet moj mëmë/ për një *par* kondurë? ; pse më shjet vre vllaçko për një *par* çurapë?¹⁸ Në të folmen e Gjirokastrës: U bë dasmë na të di *par* anët (M. Kokalari: 207). Buzuku: E vote, e muor dhjetë copë rgjand,e gjashtë mijë dukat t artë, e dhjetë *pār* petëka (153/a); ...qi të denjë janë me u bam *pār*, buri e gruoja (Mesh. 81/a).

Si tipar **morfolojk**, në sistemin rasor do të vërenim mungesën e mbaresës së re *-ve*, të rasave të zhdrejta në emrat që mbarojnë me temë më bashkëtingëllore. Në çamërishte ruhen më mirë mbaresat e vjetra: edhe mall' e *vëllezre*, edhe mall tënt; u dhanë ka një pampuar *djelme* (Dialekt. Tekste, f.120) në dasmë të *djelmet*, kushtu u thomi *monjet* neve, na apin *krushqet*, u thotë *nipëret*, kujdestare e *vashazet*, të mësoç gluhëtë... e *shpezëret* edhe *zogjet*.¹⁹ Ky tipar vërehet edhe te Dhiata e Re, si: të marrë njeriu bukën e *djelmet*, e tua shtjerë *qenet*. (280); *viçret*; ndë mes *t'uqëret*.(220)

Ky është tipar i vjetër i mbarë shqipës, i cili gjendet ende në brezat e moshuar në qytetin e Gjirokastrës, si: për kokë të *djelme*; dëgjoje fjalën e *pleqe*; folu *njerëze*; Buzuku: Me u dhanë ndër duor të *njerëzet* (Mesh.141/a);

¹⁷ Q. Haxhihasani, DSH I, 183.

¹⁸ Th. Moraitis, vep. cit. f.261.

¹⁹ Q. Haxhihasani, studim i cit, DSH I, f. 169.

...porsi gjithë mā *pleqet* popullsisë (Mesh. 167/a).

Në tekstin e Matrangës dalin pak raste me mbaresën e vjetër: ndë këtë gropë të lotet; ja dha dishipuljet tij; të japsh të hënë të vabëgjet²⁰

Në sistemin emëror do të veçonim ruajtjen e gjinisë asnjane ende në të këtë të folme. Gjinia asnjane ka përdorim të dendur në emrat e lëndëve, si: të grihet *misht* kështu?; po qelbej *ujt* / i vin erë si barut. (Dialekt.II, Tekste). Edhe tek Buzuku gjejmë: e *ujtë* që u t i ap, ka me klenë ndë gurë të gjallë (Mesh, II, 161); e kaha ke ti ata *ujë* të gjallë? (Mesh. 161/b); E përmbi ju banj të ritetë *mishtë* (Mesh. 237/b).

Nga fusha e përemrave, me interes është forma e vetës së parë të përemrit vetor, numri njëjës, që del me trajtën *u*. Përemri *u* del në brezin shumë të moshuar, p.sh.: në filan sqelë e të gjeta *u*; kam *u* do t'u jap dhe juve.; u kam pënuar qeraxhi. (Dial.II, f123, 124) Ende gjendet në të folmen e Gjirokastrës në një këngë popullore: i vanë lotët rëke / U ja fshi, po s'kam me se (këngë popullore dasme). Me këtë trajtë përemri, e folmja e çamërishtes ruan një gjendje shumë të vjetër, gjeografia e së cilës është e shtrirë më tepër në të folmet skajore të shqipës, si të folmet e tjera labe, të Himarës, të arbëreshëve të Italisë e të Greqisë, si dhe në të folmet veriore të Nikaj-Mërturit, Dukagjinit, Lohes, Reçit e Buzë Ujit, Kelmendit dhe Hasit²¹. Te Buzuku: A e dini ju qish *u* juve bana? (Mesh. 219/a); Përse *u* juve thom se shumë përfetë...(Mesh. 291/b)

Në këtë të folme përdoret fjala *drejt* në trajtën *dreq* si parafjalë dhe si ndajfolje: Po këndojë pula, e therëm *dreq* (Marrgëllëç). Kokoshi u ngrit përnjëherë e *dreq* te palku // plak i tha. (dial.II, 130) Edhe e folmja e Gjirokastërs me të cilën ka shumë ngjashmëri e përdor po kështu: Erdhi *dreq* e në shtëpi. Rri shtrëmbër e fol *dreq*. Tek Buzuku: E i tha Jezu: *dëreq*

²⁰ M. Mandalà, bot. cit., f. 179, 171, 218.

²¹ M. Totoni, E Folmja e Bregdetit të Poshtëm, SF, Tiranë, 1964, 1, f. 148; Q. Haxhihasani, Vështrim i përgjithshëmmbi të folmen e banorëve të Çamërisë, Dialektologjia Shqiptare, I, 1971, f. 172; E. Lafe, E Folmja e Nikaj-Mërturit, SF3, Tiranë, 1964, f. 122; Gj. Shkurtaç, E folmja e Rranxave të Mbishkodrës, Dialektologjia Shqiptare, IV, 1982, f. 208; E folmja e Kelmendit, Dialektologjia Shqiptare, III, 1975, f. 45; Xh. Gosturani, E folmja e Hasit, Dialektologjia Shqiptare, III, 1975, f. 231; Pino Siciliano, Fjalorth i së folmes arbëreshe të Qanës, Dialektologjia Shqiptare, VI, 1990, f. 483; R. Memushaj, Vendi i së folmes së Himarës në dialektin jugor të shqipës

u përgjegje (Meshari 291/b); E u në mos shtifsha dorënë teme *dëreq* zemëresë ti, u nuk besonj (Meshari, 319/a).

Në sistemin foljor të shqipes së vjetër, në foljet me temë në bashkëtingëllore mbaresat e vjetra të së tashmes të vetës I e III shumës merrnin zanoren mbështetëse *-ë-*, e cila është më e vjetër se zanorja mbështetëse *-i-* e shqipes së sotme²². Në çamërishte: Po këndoje pula, *e therëm* dreq (Marrgëllëç); kush mirr shumë e *zijasjëm* me kandarë; se komet e vrasën ullirin // i marrim i *djegëm... i xerrëm* u qërojmë cepën. (Dialekt. II, Tekste) Edhe te Matranga i gjejmë këtë dukuri arkaike: *vëljenjënë* 40r, *të trashëgonjënë* 42r, *psonjënë* 42v; *të ikënjëmë* 33r; *vinjënë* 19r; *presëmë* 19r; *vdesënë* 18v; *thërresëmë* 24v. Te Bogdani²³ si dhe te autorët gegë para tij dokumentohen vetëm këto lloj mbaresash: *banjënë* I 26 34, *ndjekëmë* II 26 10, *ndjekënë* II 160 22, *apëmë* II 67 14, *apënë* I 27 38, *dalënë* I 36 17, *flasmë* XVII (pa *-ë-* mbështetëse), *flasënë* II 67 14; *gjanjëmë* I 12 1, *gjanjënë* II 160 21, *dajënë* I 36 16, *thërresënë* II 36 16; *presëmë* I 122 14, *presënë* I 96.

Në çamërishte gjendet hundorja qiellëzore /nj/, tipar i vjetër i përbashkët i shqipes që sot është spirantizuar në /j/ në të dy dialektet: edhe Jaça *të thoshnjë* // edhe Jaça je. Këtë tipar e ka vërejtur dhe A. Omari²⁴ kur krahason tiparet arkaike në veprën e Bogdanit me çamërishten. Te “Meshari”: *mbë* qish anë muo të më *vinjë* ndima (19/a); e forco të *binjënë*, aqë sa shtëpia eme të jetë *mbushunë* (Mesh.279/a); të mos *kërkonjënë* në darket sime (Mesh.279/a); qi *banjinë* arkënë e Tinëzot (Mesh.239/b). Ashtu si në të folmen e Gjirokastrës (*florinj*, *kushburinj*, *ftonj*, *gjinj*, *thonj*, *hunj*, *gjunj*, *kronjëre*, *pënj*, *udhinj*) edhe në çamërishte ndeshim qiellzorjen /nj/ e cila gjendet ende në mbaresa shumësi: e mori e e billi në sepet të *florinjët* // e la di javë atje. (Dial.II.130)

²² Sh. Demiraj, Gramatikë historike e shqipes, Tiranë, 1986, f. 658v.

²³ Shih A. Omari, art.cit.

²⁴ A. Omari, “Tipare arkaike nëgjyhen e Bogdanit: përkime me të folmet e Jugut”, në: Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gëidmet, Albanische Forschungen 29, Hgg. Von Bardhyl Demiraj, Harrassoëitz Verlag, Eiesbaden, 2010, f. 356-374.

Çamërishtja paraqet një tipar të fazave të vjetra të shqipës, sepse e formon shumësin me prapashtesën -z, e cila nuk ka pasur vetëm funksion zvogëlues: kanë rarë *këmbazt* e ullirit; kanë klenë *vreshtaz* atje / po tani janë ngosur me ulli ergjest. Shumësa me -z dalin qysh te libri parë i toskërishtes i L. Matrangës²⁵ *djaljazit*. Shumësa me z dalin edhe në të folme të diasporës të shqipës, të cilat ruajnë tipare të fazave të hershme. Në shqipën e Greqisë gjejmë (Reinhold): di drurëz; lumërez; lulezëtë²⁶ Te Bogdani: *djelz* XL;

Folja e parregullt supletive *them*, në vetën e parë njëjës e shumës në të tashmen e mënyrës dëftore e lidhore del në këtë të folme në trajtën *thom*, të *thom*, *thomi*, të *thomi*: mos u mërzit të të *thom* u; atyre që ngasin lutruvinë // u *thomi* lutruvjar (D.II.126). Në Gjirokastrë del edhe sot në këngë apo të folurën e brezit të moshuar: Ç'kam di qelqe me raki / *thom* t'i pi / *thom* mos t'i pi (këng.pap). Buzuku: A nukë *thomi* na se ti je Samaritan (Mesh. 187/b); për të vërtetë u juve *thom* (Mesh.187/b).

Përsa u përket tipareve sintaksore, do të veçonim paraqitjen pa shumë rregullsi në renditjen e fjalëve, tipar ky i ligjërit të thjeshtë: të *pesëmbëdhjetën ditë* / njerzit e vajzës venë e shohin me revani; të tretën ditë / të shtunën ... Buzuku që është pranë gjuhës popullore: kjo tue klenë *mae para vepër* (Mesh. 387/b). Te Matranga: të *tretën ditë* u anastis mortjet. *Të tretën natë*, ajo i thotë djalit...(M. Kokalari:89) .

Me veçorinë e fundit në rrafshin sintaksor kemi përfunduar tiparet e përbashkëta të kësaj së folmeje; tipare që i ndeshim tek autorët e vjetër dhe në të folmet e tjera të gjuhës sonë. Këto ngjashmëri na shpjen vetvetiu në përfundimin se shqipja ka qenë më unitare dhe dialektet e saj më të afërta sesa paraqiten në ditët e sotme.

²⁵ L. Matranga, E mbsuame e krështerë, Romë,1592.

²⁶ A. Klosi, Netët pellazgjike të Karl Reinholdit, Tekste të vjetra shipe të Greqisë mbledhur nga Karl Reinhold 1850-1860, Tiranë, 2005, f. 58, f. 62, f. 73.

Bibliografia:

1. Çabej, E. “Disa aspekte të fonetikës historike të shqipërisë në dritën e gjuhës së Gjon Buzëkut”, në: Studime Gjuhësore VI.
2. Çabej, E. “Hyrje” në: *Meshari’ i Gjon Buzëkut (1555)*, botim kritik, Tiranë, 1968.
3. Demiraj, Sh. *Gramatikë historike e shqipërisë*, Tiranë, 1986.
4. Gosturani, Xh. *E folmja e Hasit*, Dialektologjia Shqiptare, III, 1975.
5. Haxhihasani, Q. *Vështrim i përgjithshëmmbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, Dialektologjia Shqiptare, I, 1971.
6. Klosi, A. Netët pellazgjike të Karl Reinholdit, Tekste të vjetra shipe të Greqisë mbledhur nga Karl Reinhold 1850-1860, Tiranë, 2005.
7. Kore, M. *Gjirokastra, vështrim historik, gjuhësor dhe etnologjik*, “Dudaj”, 2014.
8. La Piana, M. “I dialetti siculo-albanesi”, in: *Studi linguistici albanesi. Varia* 1949, ribotuar në *Albanesi in Sicilia/ F. Giunta...* [et al.]; a cura di Matteo Mandalà, A.C. Mirror, Palermo, 2003.
9. Lafe, E. *Folmja e Nikaj-Mërturit*, SF, 3, Tiranë, 1964.
10. Matranga, L. *E mbsuame e krështerë*, Romë, 1592.
11. Omari, A. “*Tipare arkaike në gjuhën e Bogdanit: përkime me të folmet e Jugut*”, në: *Ëir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Camaj, M. (1925-1992) geëidmet*, Albanische Forschungen 29, Hgg. Von Bardhyl Demiraj, Harrassoëitz Verlag, Wiesbaden, 2010.
12. Pedersen, H. *Albanesische Texte, mit Glossar*, Leipzig, 1895.
13. Shkurtaç, Gj. *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, Dialektologjia Shqiptare, IV, 1982; *E folmja e Kelmendit*, Dialektologjia Shqiptare, III, 1975.
14. Siciliano, P. *Fjalorth i së folmes arbëreshe të Qanës*, Dialektologjia Shqiptare, VI, 199
15. Totoni, M. *E Folmja e Bregdetit të Poshtëm*, SF, Tiranë, 1964.

Hana RADONIQI

VLERA DALLUESE DHE KONTRASTIVE E THEKSIT NË GJUHËN SHQIPE

Abstrakt

Marrë në përgjithësi, theksi i shqipes si veçori prozodike është studiuar nga pikëpamje të ndryshme: veçohen studimet që e vlerësojnë shqipen për theksim parafundor (Dodi 1970, 2004, Dodi & Gjinari 1983, Bevington 1974, Topalli 1995, Quiles 2007, Friedman 2004, Max Bane & Jason Riggle 2008), për theksim fundor (Newmark, Hubbard & Prifti 1982, Maynard 1997, Hulst, Hendriks & Weijer 1999), por edhe duke i specifikuar në bazë të kategorive leksiko-gramatikore, sipas së cilave, shqipja vë theksin në rrokjen e fundit të temat foljore dhe të parafjalët; ndërsa, emrat shpeshherë kanë theks parafundor (Beekes 2011).

Praktikisht, vlera dalluese e theksit do të përfshijë raportet e llogaritura sasiore për çdo fjalë me shkronjën A të Fjalorit (“Fjalor i shqipes së sotme” (2002)), posaçërisht për pozicionin e theksit dhe, ndryshimin e tij që përcaktohet sipas dallimit të kategorive leksiko-gramatikore.

Kontributi themelor i teorisë gjenerative metrike të theksit është trajtimi formal i tij, për shkakun e marrëdhënies që mban ndërmjet rrokjesh. Disa rrokje janë metrikisht të forta: reflektohet në mënyrën e tërheqjes së theksit; ndërsa, të tjerat janë metrikisht të dobëta dhe kështu e refuzojnë theksin. Së këndejmi, shqipja është e ndjeshme ndaj sasisë metrike ose kuantitetit të rrokjeve.

Fjalët çelës: *theks, rrokje tejfundore, rrokje parafundore, rrokje fundore, morë, fonologji metrike.*

Abstract

Generally speaking, the Albanian stress as a prosodic feature has been studied from different points of view: some studies evaluate Albanian language for penultimate stress (Dodi 1970, 2004, Dodi & Gjinari 1983, Bevington 1974, Topalli 1995, Quiles 2007, Friedman 2004, Max Bane & Jason Riggle 2008), for final stress (Newmark, Hubbard & Prifti 1982, Maynard 1997, Hulst, Hendriks&Weijer 1999), but also specifying them based on lexical-grammatical categories, according to which the Albanian accented the last syllable of the verbal stems, and the last syllable of prepositions; nouns are often stressed on the penultimate syllable (Beekes 2011).

Practically, the distinctive value of the stress will include the quantitative calculated reports for each word with the letter A of the Dictionary (“Fjalor i shqipes së sotme” (2002)), especially for the position of the stress, and its change that is determined by the distinction of the lexical and grammatical categories.

The fundamental contribution of the generative metrical stress theory is its formal treatment, because of the relation between the syllables. Some syllables are metrically strong: reflected in the stress-attracting; while the others are metrically weak and thus reject the stress. Thus, Albanian is sensitive to metrical quantity or syllables quantity.

Keywords: *stress, antepenultimate syllable, penultimate syllable, final syllable, mora, metrical phonology.*

Hyrje

Shkolla e Pragës (Jakobson 1971) përshkruan caktimin e theksit jo në aspektin e rrokjeve, por në aspektin e morave. Shumica e shpjegimeve parajenerative dhe jogenerative i janë referuar rrokjes dhe brenda fonologjisë gjenerative ka pasur rritje të vlerësimit që tingujt të grupoheshin në rrokje të peshave të ndryshme prozodike dhe se, rrokja ishte pjesë e hierarkisë prozodike; pra, rrokja e njeh këmbën dhe fjalën prozodike si njësi më të larta të strukturës dhe, si njësi më të ulët, morën.

Në anën tjetër, në kuadër të Teorisë së Optimalitetit, në vitin 2002 u zhvillua edhe një qasje tjetër e tipologjisë së sistemeve të theksit – pandjeshmëria ndaj sasisë¹. Modeli teorik i optimalitetit i Matthew Gordon-it (2002) për theksin e pandjeshëm ndaj sasisë parashikon gjithsej 152 modele të mundshme të theksit, të cilat, sipas autorëve të Universitetit të Çikagos, Max Bane-it dhe Jason Riggles-it (2008), përfaqësojnë përpjekjet më të mira aktuale të kriterit të përfshirjes dhe të përjashtimit për theksin e pandjeshëm ndaj sasisë, mungesën për të gjeneruar vetëm dy modele të vërtetuara të theksit (të panjohura për Gordon-in në atë kohë) dhe gjenerimin e 128 modeleve të pavërtetuara.

Dmth., sistemet e theksit të pandjeshëm ndaj sasisë, ato në të cilat pesha e rrokjes nuk është e rëndësishme për përcaktimin e vendosjes së theksit, mund të ndahen në dy grupe bazuar në atë nëse theksi bie rregullisht në një rrokje brenda hapësirës së një fjale ose nëse fiksohet në një rrokje në (pranë) njërin ose në të dyja skajet (në të majtin ose në të djathtin) e një fjale.

Tutje, Jeffrey Nicholas Heinz-i (2007), konstaton se në mesin e një mostre prej 306 gjuhëve me sisteme të theksit të pandjeshëm ndaj sasisë, janë gjetur 26 modele të theksit, ndërsa mbi 60% e gjuhëve të analizuara përdorin një nga vetëm 3 prej këtyre modeleve (tri modelet më të

¹ Baza e të dhënave të theksit *StressTyp* që aktualisht mirëmbahet nga Harry van der Hulst-i dhe Rob Goedemans-i nuk u bë e disponueshme në internet derisa ky projekt ishte duke u zhvilluar. Baza e të dhënave është në dispozicion këtu: <http://stresstyp.leidenuniv.nl/>. Faqe e ngjashme me këtë është edhe *The World Atlas of Language Structures* (WALS): <http://wals.info/>.

zakonshme: theksi fundor, nistor dhe parafundor). Duke e ndjekur rrugën e Heinz-it dhe të Gordon-it, Bane-i dhe Riggle-i (2008) shtojnë se te sistemet e theksit të pandjeshëm ndaj sasisë caktimi i theksave në rrokjet e një fjale varet vetëm nga numri i pranisë së rrokjeve (një sasi që supozohet të jetë vendosur kur caktohet theksi) dhe jo në përmbajtjen segmentale të rrokjeve. Si dy shembuj konkretë të sistemeve të theksit të PS e konsiderojnë shqipen dhe malakmalaken (gjuhë australiane). Këto modele janë ilustruar në Tabelën 1, për fjalët me gjatësi prej dy deri në gjashtë rrokje²:

Tabela 1. Caktimet e theksit të fjalëve me n -rrokje, si $2 \leq n \leq 6$ në modelet e theksit të PS të shqipes dhe të malakmalakes

n	Shqipja	Malakmalakja
2	$\acute{\sigma}\sigma$	$\acute{\sigma}\sigma$
3	$\sigma\acute{\sigma}\sigma$	$\sigma\acute{\sigma}\sigma$
4	$\sigma\sigma\acute{\sigma}\sigma$	$\sigma\acute{\sigma}\sigma\grave{\sigma}$
5	$\sigma\sigma\sigma\acute{\sigma}\sigma$	$\sigma\acute{\sigma}\sigma\grave{\sigma}\sigma$
6	$\sigma\sigma\sigma\sigma\acute{\sigma}\sigma$	$\sigma\acute{\sigma}\sigma\grave{\sigma}\sigma\grave{\sigma}$

Me fjalë të tjera, sipas tyre, shqipja ka një sistem të thjeshtë të palëvizshëm, në të cilin theksi primar është gjithmonë i vendosur në rrokjen e parafundit, ndërsa asnjë rrokje tjetër nuk mban theks. Malakmalakja është më komplekse, duke e caktuar theksin në rrokje të njëjta nga e djathta, kurse e para nga e majta ka theks primar. Si konkluzion, asnjëri sistem nuk është i ndjeshëm ndaj nocioneve si pesha e rrokjes, as për tipare të tjera të përmbajtjeve të rrokjeve; të dyja sistemet japin caktime identike të theksit për fjalët me dy ose tri rrokje, veçse i dallojnë fjalët me katër ose më shumë rrokje. Konfuzioni është se

² σ i referohet rrokjes së patheksuar, $\acute{\sigma}$ tregon rrokjen që mban theksin sekondar dhe $\grave{\sigma}$ tregon theksin primar.

numri prej pesë e më shumë rrokjesh të shqipes nuk gjendet në asnjë sistem/ model tjetër të Gordon-it.

Mirëpo, në shqipen, theksi primar mund të jetë i ndjeshëm në aspekte të ndryshme të rëndësisë së rrokjeve, ndërsa këmbët metrike janë të ndjeshme vetëm për sasinë moraike, pra dallimi binar midis rrokjeve të gjata dhe të shkurtra. Sasia moraike është tipar i dimensionit kohor – një rrokje mund të jetë e rëndë dhe ta tërheqë theksin për shkak të gjatësisë së saj. Sipas Rugovës (2019: 107), shqipja është përgjithësisht gjuhë që ka orientim në të djathtë.

Së këndejmi, ekzistojnë dy mënyra për ta shqyrtuar dallimin midis gjuhëve të ndjeshme ndaj sasisë dhe atyre të pandjeshme ndaj sasisë. Dukshmëria e pandjeshmërisë ndaj sasisë (baza e të dhënave të Bailey-t (1995) e modeleve të theksit primar), rezulton kur kufizimet mbi përshtatshmërinë e theksit e vendosin theksin në të njëjtën distancë nga skaji i një fjale, pa marrë parasysh peshën e rrokjeve në fjalë. Pandjeshmëria ndaj sasisë së theksit parafundor kërkon një mospërparësi mjaft të fortë të skajit, për ta bërë zanoren fundore të papërshtatshme për theks, qoftë kjo në rrokje të rëndë ose të lehtë.

Rezultatet – tipologjia e rrokjeve dhe theksi i fjalëve të shqipes

Korpusi i këtij punimi, i përbërë gjithsej nga 1.512 fjalë me shkronjën A të Fjalorit (2002: 21–71), vërteton se 436 fjalë ose 28.83% mbarojnë me zanore, ndërkaq 1.076 ose 71.16% mbarojnë me bashkëtingëllore. Numri më i madh i rrokjeve të mbyllura në krahasim me rrokjet e hapura del si rrjedhim i rënies së shpeshtë së ë-së në pozicion fundor, kryesisht tek emrat e gjinisë femërore (*adresë>adre:s*). Në një punim si bashkautor me Bernadet Hendriks-in dhe Jeroen van de Weijer-in, van der Hulst-i ka përmbledhur se vetëm rrokjet fundore që përmbajnë shva llogariten si të lehta (dmth., të hapura BZ). Kështu, sipas tyre (1999: 464–465), shqipja ka theks fundor, përveç nëse rrokja fundore ka një shva.

Fillimisht, bashkëtingëlloret janë të ndara në dy klasa kryesore: obstruente dhe sonante (Sawicka & Dargiel 2018). Obstruente janë shpërthyeset, fërkimoret dhe afrikatet. Sonante janë zanoret, likuidet (lëngëzoret l, ll, r, rr), glajdet (gjysmëzanorja i) dhe hundoret.

Në kategorinë e fjalëve që fillojnë me A, gjithsej me theks tejfundor janë 42 fjalë dhe se, gati në të gjitha rastet, fjalët në fund dalin në rrokje të

hapura – 95.23%. Në kuadër të rrokjeve të theksuara te fjalët me theks tejfundor janë gjetur 7 tipa të rrokjeve dhe numrin më të madh të tyre e ka tipi **Obstruent + Zanore** (21 sosh), psh. a.ci.de.**da**.sh(ë).se, at.dhe.**da**.sh(ë).se (te mbiemrat me prapashtesën *-se* × 24) etj.

Tabela 2. Rrokjet e theksuara të fjalëve me theks tejfundor

Tipi	Rrokje
Obstruent + Zanore	shú, dá × 3, ká, kú × 2, té, sý, dé, qú, sú, tú × 5, zú, thý × 3
Sonant + Zanore	rú × 5, njá, má, llú, lú, rú
Obstruent + Obstruent + Zanore	ftó
Obstruent + Sonant + Zanore	frú × 2
Sonant + Obstruent + Zanore	mbí, ndá
Sonant + Obstruent + Sonant + Zanore	ngró, nxjé
Sonant + Obstruent + Zanore + Sonant	mbáj × 4

Në bazë të të dhënave të mësipërme mund të konstatohet se pjesa më e madhe e rrokjeve të theksuara kanë në përbërje bashkëtingëllore shpërthyes *d* (obstruent i zëshëm), *k*, *t*, *q* (obstruentë të shurdhët) ose fërkimore *sh*, *s*, *th* (obstruentë të shurdhët), *ç* (obstruent i zëshëm) + zanore të ngritjes së lartë *u*, *y*, të ulët *a*, të mesme *e*.

Tutje kësaj, fjalët me theks parafundor janë gjithsej 413 dhe numri në mes të rrokjeve të hapura dhe të mbyllura në fund të fjalëve është pothuaj i barabartë – 9.20% krahasuar me 10.16%. Në kuadër të rrokjeve të theksuara te fjalët parafundore janë gjetur 19 tipa rrokjesh, ku numrin

më të madh të tyre e ka tipi **Obstruent + Zanore** (151 sosh), psh. a.so.**he**.re, a.shi.**qa**.re (ndajfolje); a.so.**do**.re (përemër dëftor) etj.

Tabela 3. Rrokjet e theksuara të fjalëve me theks parafundor

Tipi	Rrokje
Zanore	í × 4, á × 4
Obstruent + Zanore	sé × 2, sý, cá, bí, fí × 2, gá × 6, gó, çó × 2, shú × 2, hó, kó × 4, kú × 4, pó, vá × 2, ví × 4, dá × 4, dí × 2, tá × 9, tí × 35, tý × 2, gjé, pí, gjë□, dhá × 2, qá, bá, bí, pá × 2, pé, sí × 5, sú × 2, cá, cí × 3, có × 2, gjí × 4, tó × 16, tú × 11, ká × 3, kí × 2, kó, zú × 2, zhó, hé, dé × 2, só × 11, dó × 2, çá, thý × 2, vó, shá, bé, hú, shí × 3, dá × 2, xhá, zó × 4
Sonant + Zanore	rá × 6, rí × 14, rrí × 3, ná × 6, ní × 15, nó × 7, nú × 7, rú × 6, jó × 2, ró × 10, rró, lé × 2, mí × 13, njá, një□, lú × 3, llú × 2, lí × 9, né, má × 7, ré, mé × 3, mó × 6, llé, ló × 3, lló × 9, llá
Obstruent + Obstruent + Zanore	sfá, skú, fshó, kthó, ktí, stú, ftó, stí × 3, stá, ksí
Obstruent + Sonant + Zanore	frí × 2, fró, frú, grú, grá, vró, glí, tjé, sjé × 2, brí, frë□, trá, tró, vrá, trí
Obstruent + Zanore + Obstruent	vís, vít, kóh × 2, tís × 2, dásh, dít, tós, vésh, dák, tét

Sonant + Zanore + Sonant	mór × 2, rál
Obstruent + Zanore + Sonant	sám, súr, dál, hér × 2, túr, dhán, gán
Sonant + Zanore + Obstruent	rrít × 2, rós, llít
Sonant + Obstruent + Zanore	ngó, ngjé, ndó × 2
Sonant + Obstruent + Sonant + Zanore	ndré, ngró, nxjé
Sonant + Obstruent + Zanore + Sonant	ndán, ndéj × 2, mbáj × 4
Obstruent + Obstruent + Zanore + Sonant	shkúr
Obstruent + Obstruent + Zanore + Obstruent	vdék
Sonant + Zanore + Sonant + Obstruent	línd, ménd × 2
Obstruent + Sonant + Zanore + Sonant	sjéll
Obstruent + Sonant + Zanore + Obstruent	práp, vrás
Obstruent + Obstruent + Sonant + Zanore	shkrú × 2, strú
Obstruent + Obstruent + Sonant + Zanore + Obstruent	strák

Sipas shembujve të gjetur, arrihet në konkluzionin se pjesa më e madhe e rrokjeve të theksuara kanë në përbërje bashkëtingëllore

shpërthyes *b, d, g, gj* (obstruentë të zëshëm), *k, p, t, q* (obstruentë të shurdhët), afrikate *c, ç* (obstruentë të shurdhët), *xh* (obstruent i zëshëm) ose fërkimore *f, th, s, sh, h* (obstruentë të shurdhët), *dh, ç, çh, v* (obstruentë të zëshëm) + zanore të ngritjes së lartë *i, u, y*, të ulët *a*, të mesme *e, ë, o*.

Së fundi, fondin më të madh të fjalëve në kuadër të këtij hulumtimi e kanë fjalët me theks fundor – gjithsej 923 dhe numri i rrokjeve të mbyllura të theksuara është dukshëm më i madh në krahasim me atë të rrokjeve të hapura – 83.74% me 15.92%. Rrjedhimisht, edhe sasia e tipave të rrokjeve të mbyllura është më e madhe (35 sosh, krahasuar me 6 e të hapurave). Janë gjetur 41 tipa rrokjesh të theksuara dhe tipi mbizotërues i rrokjeve fundore është **OZS** (tërësisht 207), psh. a.ven.tu.r(ë): ë si shënues i gjatësisë së zanores paraprake (dy mora) etj.

Tabela 4. Rrokjet e theksuara të fjalëve me theks fundor

Tipi	Rrokje
Zanore	í, é
Zanore + Obstruent	át × 2, ík, út, ázh, óz × 2, ák × 2, íd
Zanore + Sonant	ón × 11, ól × 3, óm, án × 6, ál × 2, ár, úm, ér
Zanore + Sonant + Obstruent	ánc, ánt, ént, énc
Zanore + Obstruent + Obstruent	íst × 2
Obstruent + Zanore	gá, há, çí, tí × 11, pó, ká, só, tá, dhé, tó, tý, bá × 2, cí × 5, dí, shé, fí × 2, kí × 2, cë□, sí × 18, bí, kú × 2, xhí × 3, zí × 2, xhá, gjé, pí, gjë□ × 3, gjí × 9, kó, ví

Sonant + Zanore	mí × 12, jó, rí × 25, má × 2, ní × 4, né × 2, mé, një□ × 2, lí × 2, lé, lí
Zanore + Sonant + Obstruent	Órt
Obstruent + Obstruent + Zanore	fshí, skí, spó, shtú, shtí × 2, stí, psí
Obstruent + Sonant + Zanore	frí, tjé, trá, trí
Obstruent + Zanore + Obstruent	bák, bát × 2, fíb, gésh, cíd, çík, dásh, dét × 2, fát × 2, zót × 2, kós, kút, kúz × 2, vís × 2, kés, két, tík × 30, gás, gát × 2, gósh, kív, qít, tís × 2, shéf, shík, vásh, váz, vít, dés, zát, dís, kík, sív, tát, shís, gját × 2, gjík × 4, tázh, gés, tés × 2, sád, cák × 2, téz, cít × 2, çát, pásh, pésh, tós, kát × 2, káh, kóh, gáč, bót × 2, bút, kúsh × 3, qýsh, dót, bét × 2, vík, tét × 6, tív × 5, gjét, bús
Sonant + Zanore + Sonant	mír, jár, jój, rór × 8, lémm, mán, mén, mél, mín × 3, món × 2, ním × 8, nój × 4, nór × 2, náj × 2, rár, rén, rrír, rrij, róm, rrór, nóm × 2, mój × 2, mór × 5, mímm, rím × 13, rójj × 12, rál × 3, llím × 4, llín, llój × 2, llón, rónj, llém, lín, lúm, mál, lím × 6, lój × 6, lór, lár, nál × 2, jér, rín × 4, mún, rán, nóm, lén, nár, réll, jór, lón, llór
Obstruent + Zanore + Sonant	pér, púl, búmm, cár, gím, gón × 2, gór, tár × 14, gán × 3, shím × 3, shój × 3, shól, hójj, húr, kój × 4, shám, tón × 4, tór × 17, bán, kál, pín, çín × 2,

	kím × 3, tén, pél, gjíl, séj, túll, kín, tóm, vár, dáll, zíl, zhúr × 2, kán × 3, sár, sím × 11, sín, sój × 7, zím × 10, súj, tím × 12, tír × 2, tój × 13, zój × 10, zhím × 2, zhój × 2, sór × 7, tém, túr × 7, dhím, dím × 2, dój × 2, dón, ván, vér, gám, zón, fél, vím × 2, vój × 2, vól, vór, vál, zán, shán, fár × 2, hér × 2, tán, cím, cój, hán, gjén, dór, cór, fój, hér, gól, bíl, fál, dál
Sonant + Zanore + Obstruent	rásh, rós, lét × 2, lláh, méb, náç, nák × 2, nés × 2, nód, ráb, ríth, máç, rúsh, njét, lás, llás, nóz, llós, lóg × 4, lút, mík × 11, llëk × 4, llít, lláç, llósh, rídh, mét, nás, nét, rét, lázh, líz, léz, ját, lóp, rát × 5, résh, rák, lósh, mút, nát, lík × 3, ník × 7, mát × 3, lág, rík × 3, llák, rísh, róz
Sonant + Obstruent + Sonant + Zanore	ndrí, mblé
Sonant + Obstruent + Zanore + Sonant	ndéj, ndáj, ngjín, mbán, ndór, ndím, ndój, ndár
Obstruent + Obstruent + Zanore + Sonant	fshón, kthím, kthój, skúrr, sqér, stár, sfér, stój × 3, stím × 2, shtór
Obstruent + Zanore + Sonant + Obstruent	súrd, gímt, cárt, gjént, héng, kórd, kánd, dháng, gjénd, kónd, vánc, tánt, dént, kënd, qárk × 2, gánt, kúnd × 2, sénd, gánc, pórt, párk, vínc

Obstruent + Obstruent + Zanore + Obstruent	skét, skúsh, spák, shtíq, stík × 4, stát, shtét
Obstruent + Zanore + Obstruent + Obstruent	fékt, hísh, tíst, tísh × 2, bést, vásht, kíst, víst × 3, sísh × 4, vísh × 2, bísh, páshk, tékt, káfsh, shíst, císt, kísh × 3, síst, dákt
Sonant + Zanore + Sonant + Sonant	Lárm
Sonant + Zanore + Obstruent + Obstruent	néks, ríçk, nísh × 3, rúshk, rrést, rrísh, llást, ríst × 3, mísh, llísh, míst × 3, rísh × 6, níst × 5, líps, lísh × 2, líst × 5
Sonant + Zanore + Obstruent + Sonant	Jázm
Sonant + Zanore + Sonant + Obstruent	mórf × 2, rénd, mént × 5, mínt, ménd × 2, múrg, lánc × 2, lë nd, nác, ránt, lánt
Obstruent + Sonant + Zanore + Sonant	frím, frój, sllán, troll, sjéll × 3
Obstruent + Sonant + Zanore + Obstruent	drés, krép, trít, shllë k, brík, trázh, trík, mjét, kláv, gráf, krát, trét
Obstruent + Sonant + Zanore + Sonant	grár, trór, trár, dróm, klón, plán
Obstruent + Zanore + Sonant + Obstruent + Obstruent	Gjéndt

Obstruent + Obstruent + Zanore + Sonant + Obstruent	sfált, skúnd, sténc, stént, spórt
Obstruent + Obstruent + Zanore + Obstruent + Obstruent	spákt, spékt, ksíst
Obstruent + Obstruent + Sonant + Zanore + Obstruent	strít, stróf × 2, strát
Obstruent + Obstruent + Sonant + Zanore + Sonant	shkrím, strím, strój
Obstruent + Sonant + Zanore + Obstruent + Obstruent	frésk, prápt
Obstruent + Sonant + Zanore + Sonant + Obstruent	grímč, blind
Sonant + Zanore + Sonant + Obstruent + Obstruent	Méndsh
Sonant + Obstruent + Zanore + Sonant + Obstruent	Ndárt
Sonant + Obstruent + Zanore + Sonant + Sonant	ndéjm, mbájn
Sonant + Obstruent + Sonant + Zanore + Sonant	ndráll, ngrír
Sonant + Obstruent + Sonant + Zanore + Obstruent	ngléz, ndrít

Sonant + Obstruent + Sonant + Zanore + Obstruent + Obstruent	nglisht, mblíst
Obstruent + Obstruent + Sonant + Zanore + Obstruent + Obstruent	Strákt

Për më tepër, përbërja e tingujve të radhitur sipas shpeshëtisë është: bashkëtingëllore shpërthyes *b, d, g, gj* (obstruentë të zëshëm), *k, p, t* (obstruentë të shurdhët), afrikate *c, ç* (obstruentë të shurdhët) ose fërkimore *f, s, sh, h* (obstruentë të shurdhët), *dh, z, zh, v* (obstruentë të zëshëm) + zanore të ngritjes së lartë *i, u*, të ulët *a*, të mesme *e, o* + sonante hundore *m, n*, glajd *ç* ose lëngëzore *l, ll, r*.

Përfundime

Modelet e rrokjeve që përfaqësojnë shtresën prozodike si një seri morash sigurojnë një model që pasqyron rolin e peshës në caktimin e theksit, duke llogaritur pozicionet fonologjike dhe duke bërë dallimin në mes të rrokjeve të lehta (monomoraikë) dhe të rënda (bimoraikë).

Tri modelet më të zakonshme të vendosjes së theksit primar nga korpusi i hulumtuar, janë: theksi fundor (61.04% e fjalëve), theksi parafundor (33.39% e fjalëve) dhe theksi tejfundor (2.77% e fjalëve). Ndërkaq, fjalët e korpusit nga pikëpamja e numrit të rrokjeve, përbëhen nga:

- 2 rrokje (23.61%), 3 rrokje (43.98%), 4 rrokje (21.45%), 5 rrokje (8.01%), 6 rrokje (2.27%), 7 rrokje (0.65%) – fjalët me theks fundor;

- 1 rrokje (4.35%), 2 rrokje (12.47%), 3 rrokje (20.39%), 4 rrokje (36.63%), 5 rrokje (16.83%), 6 rrokje (7.32%), 7 rrokje (1.18%), 8 rrokje (0.79%) – fjalët me theks parafundor dhe,

- 4 rrokje (30.95%), 5 rrokje (45.23%), 6 rrokje (14.28%), 7 rrokje (9.52%) – fjalët me theks tejfundor.

Në kuadër të rrokjeve të theksuara te fjalët me theks tejfundor janë gjetur 7 tipa të rrokjeve dhe numrin më të madh të tyre e ka tipi **Obstruent + Zanore** (21 sosh); në kuadër të rrokjeve të theksuara te fjalët parafundore janë gjetur 19 tipa rrokjesh, ku numrin më të madh të tyre e ka tipi **Obstruent + Zanore** (151 sosh) dhe, tipi mbizotërues i rrokjeve të theksuara te fjalët fundore është **Obstruent + Zanore + Sonant** (tërësisht 207), në të cilat janë gjetur 41 tipa rrokjesh.

Që këtej, zanorja me dendurinë më të madhe sa i përket theksimit është *i* me 35.71%, *o* 20.95%, *a* 17.75%, *e* 9.31%, *u* 7.41%, *ë* 1.08% dhe *y* 0.74%.

Bibliografia:

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002). *Fjalor i shqipërisë së sotme*. Toena: Tiranë.
2. Bailey, Todd Mark (1995). *Nonmetrical Constraints on Stress*. Ph.D. thesis. University of Minnesota: Ann Arbor, Michigan.
3. Bane, Max & Riggle, Jason (2008). Three correlates of the typological frequency of quantity-insensitive stress systems. *Proceedings of the Tenth Workshop of the Association for Computational Linguistics' Special Interest Group in Morphology and Phonology*. Columbus, Ohio: USA (29–38).
4. Gordon, Matthew (2002). A Factorial Typology of Quantity-Insensitive Stress. *Natural Language & Linguistic Theory*, vol. 20, no. 3. (491–552).
5. Heinz, Jeffrey Nicholas (2007). *Inductive Learning of Phonotactic Patterns*. Ph.D. thesis. University of California: Los Angeles.
6. Hulst, Harry van der, Hendriks, Bernadet & Weijer, Jeroen van de (1999). A survey of word prosodic systems of European

- languages. *Word prosodic systems in the languages of Europe*. Mouton de Gruyter: Berlin (425–475).
7. Jakobson, Roman (1971). *Selected Writings II (Word and Language)*. Mouton & Co.: The Hague.
 8. Rugova, Bardh (2019). *Leksikon i termave të fonetikës dhe të fonologjisë*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës: Prishtinë.
 9. Sawicka, Irena & Dargiel, Karolina (2018). *Struktura e rrokjes shqipe*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës: Prishtinë.

KDU 811.18'373.4

Labinot KRASNIQI

**FORMIMI I SHUMËSIT TË EMRAVE NË SHQIPE
ME PRAPASHTESAT ME BURIM TURK -LLARË / -
LERË**

Abstrakt

Populli shqiptar, duke qenë një popull që ka jetuar vazhdimisht nën sundim të popujve të tjerë, ka bërë që edhe gjuha që flet të ndikohet nga gjuha e sunduesit. Një prej sunduesve të fundit, që ka sunduar më shumë se pesë shekuj është sundimi osman, i cili ka lënë gjithashtu gjurmë nga gjuha e vet osmane, rrjedhimisht turke. Gjuha turke ka shtrirë ndikimin e saj në shqipe, sidomos në fushën leksikore, por ka raste të ndikimit të saj edhe në gramatikë të shqipes. Në këtë punim, ne do të diskutojmë për

shtrirjen e dy elementeve gramatikore të mbaresave të shumësit të gjuhës turke, mbaresat -llarë / -lerë dhe përdorimin e tyre në formimin e fjalëve të gjuhës shqipe. Do të trajtojmë së pari përdorimin e këtyre mbaresave në vetë gjuhën turke, pastaj do të trajtojmë shembuj për rastin e shqipes, se sa është përhapur, cilat fjalë marrin shumësin me këto mbaresat, a është e përhapur kjo dukuri edhe në fjalë me burim jo-turk, apo vetëm turk etj.

Fjalët çelës: *turqizma, mbaresat e shumësit, përhapja dialektore*

Abstract

The Albanians are people who have constantly lived under the rule of other peoples. This situation has made that also their language has been influenced by the ruler's language. One of the last rulers who has ruled for more than five centuries are Ottomans, who have left traces of its Ottoman language, hence the Turkish. The Turkish language has extended its influence in Albanian, especially in the lexical field, but there are cases of its influence in the grammar of the Albanian language too. In this paper, we will discuss the extension of the two grammatical elements of the Turkish language plural formation, and their use in the formation of the Albanian language plural. We will first discuss the use of these terms in the Turkish language itself, then we will deal with the case of Albanian, its spread; we will see that which words take the plurality with these endings; is this phenomenon spread just in Turkish loanwords, or also in non-turkish loanwords etc. During this paper we will also consider the work of other scholars in this field. At the end of this work we expect to determine the extent of this phenomenon in Albanian, its first using, in what words has been spread and how much it is present now.

Key words: *Turkish loanwords, plural suffixes, dialectical spread*

Ky punim trajton formimin e shumësit të emrave në gjuhën shqipe me mbaresat e burimit turk /llār/ dhe /lēr/. Në gjuhën shqipe disa emra, përgjithësisht me burim turk, e rrallëherë me burim jo-turk, formojnë shumësin me formante turke, gjë që vërteton ndikimin e turqishtes edhe në kategorinë e numrit të emrave të shqipes. Ndikimi i gjuhës turke në të folmen shqipe ka filluar qysh prej fillimit të sundimit osman në Ballkan. Me ardhjen e osmanëve në Ballkan, në shekullin XIV, gjuhë zyrtare u bë osmanishtja, rrjedhimisht turqishtja e sotme me pak ndryshime. Kështu që, brenda shumë gjërash të tjera, filloi të përhapej edhe gjuha e popullit sundues në trevat e Ballkanit. Ky sundim zgjati plot pesë shekuj. Brenda këtyre pesë shekujve, si në kulturë, ashtu edhe në gjuhën e tyre u bënë ndikime të ndryshme, të cilat lanë gjurmë që kanë ngelur edhe në ditët tona.

Brenda ndikimeve të gjuhës turke, në Ballkan, e veçanërisht te shqiptarët, pati ndikime të ndryshme në gjuhën shqipe. Ndikimet së pari filluan të shtrihen në shtresën e leksikut e pastaj u përhapën deri diku edhe në morfologji të gjuhës. Prej ndikimeve të gjuhës turke në morfologjinë e shqipes, kemi edhe dy formante të shumësit të emrave, për të cilat është bërë edhe ky punim në veçanti. Është fjala për mbaresat /llār/ dhe /lēr/.

Këto mbaresa kanë hyrë në përdorim të shqipes, duke u bërë një nga mënyrat e formimit të shumësit të emrave nëpërmjet mbaresave. Shqipja, duke qenë edhe gjuhë sintetike, ka pranuar këto dy formante të turqishtes, ashtu siç i ka edhe ajo, pra në fund të fjalës.

Në punimin e tij “On the Use of the Turkish Pluralizer – lx^2r in South Slavic and Albanian”, Alf Grannes (1977), pohon se Franc Miklosich, qysh në vitin 1890, kishte vënë re për përdorimin e mbaresave të shumësit të turqishtes me – lx^2r , në sllavishten jugore. Ndërsa më vonë, edhe Kristian Sandfeld e kishte përmendur këtë dukuri edhe për gjuhën shqipe.

Përpos Mikloshiçit e Sandfeldit, për formimin e shumësit në shqipe, duke trajtuar edhe formantet me $/lx^2r/$ të burimit turk, është marrë edhe Gustav Meyer, i cili në vitin 1883 (1883) pati botuar një monografi për formimin e shumësit në gjuhën shqipe, të titulluar “*Die Pluralbildung der albanischen Nomina* (Formimi i shumësit të emrave të shqipes)”, duke u bërë me këtë autori i parë i një monografie për formimin e shumësit të emrave në shqipe. Ndërsa kohët e fundit, Wilfried Fiedler në vitin 2007 ka botuar gjithashtu një monografi për formimin e shumësit në gjuhën shqipe.

Shaban Demiraj në veprën e tij “Gramatikë historike e gjuhës shqipe” (1988) pohon se këto mbaresa të shumësit “kanë hyrë në gjuhën shqipe bashkë me huazimet turke të tipit kadi ~ kadi-lerë, bej ~ bej-lerë, sheh ~ sheh-lerë, efendi ~ efendi-lerë, aga ~ aga-llarë, baba ~ baba-llarë, pasha ~ pasha-llarë, qahja [duhet të jetë *qehaja*] ~ qahja-llarë [*qehaja-llarë*].

Përsa i takon theksimit të formanteve të shumësit të huazimet turke të tipit baba ~ baba-llarë, aga ~ aga-llarë, efendi ~ efendi-lerë etj., pra me dysinë -llarë / -lerë, kemi të bëjmë me një dukuri karakteristike të turqishtes, e cila është ruajtur edhe në shqipe në njëfarë forme.

Në turqishte¹ përdorimi i këtyre dy varianteve është i kushtëzuar nga “sinharmonia vokalike”, siç e quan Demiraj (2015), e cila vepron në atë gjuhë. Si rrjedhim, varianti $/-ler/$ përdoret në shumësin e emrave, tema e të cilëve ka zanore të përparme, kurse varianti $/-llar/$ përdoret me emra, tema e të cilëve ka zanore jo të përparme.

Kështu, në gjuhën turke, fjalët të cilat përfundojnë me zanoren a, ı [ë e shkurtër], o, u marrin /lar/² në fund të fjalës. P.sh.: *kitap – kitaplar, snif – sniflar, okul – okullar* etj.

¹ Shih për këtë gramatikën e gjuhës turke të Mehmet Hengirmen (2007), si dhe gramatikat tjera të gjuhës turke.

² Gjuha turke ka shkronjën “L”. “LL” nuk ka. “L”-në e shqipton edhe si /l/ edhe si /ll/, varësisht nga rrethimi fonetik. E shqipton /l/ kur zanorja që e paraprin l-në është e, i, ö [ë e gjatë], ü [y]. P.sh. shkruhet “gel” /lexohet gel/. Ndërsa e shqipton /ll/ kur zanorja që e paraprin l-në është a, ı [ë e shkurtër], o, u. P.sh. shkruhet “mal” /lexohet mall/. Kështu edhe prapashtesa -lar p.sh. te babalar shkruhet /l/ ndërsa shqiptohet /ll: baballâr/.

Ndërsa, fjalët të cilat zanore fundore të tyre kanë e, i, ö [ë e gjatë], ü [y] e formojnë shumësin me mbaresën /ler/. P.sh.: *deve - develer, hacı [haxhi] – haciler [haxhilër], otobüs - otobüsler* etj.

Në gjuhën turke, të gjithë emrat e formojnë shumësin me njëren nga këto dy mbaresa. Sipas zanores fundore, marrin -ler apo -lar. Mirëpo këto mbaresa nuk kanë vetëm këtë përdorim. Ato përdoren edhe për pjesët e tjera të ligjëratës, e jo vetëm për emrat. Përdoren edhe për foljet e përemrat e mbiemrat, kur janë në numrin shumës. P.sh.:

O gidiyor [Ai po shkon] / **Onlar** gidiyor**lar** [Ata/Ato po shkojnë]

Në gjuhën shqipe këto formante janë të pranishme vetëm te një grup emrash, të huazimeve turke, ruajtja e të cilave është mundësuar në radhë të parë “nga fakti se ato kanë hyrë në shqipe si forma të gatshme me kundërvëniet njëjës-shumës të turqishtes, duke mbetur kështu të izoluara brenda sistemit të kundërvënieve të shqipes.” [Demiraj (1988)]. Pra, këto mbaresa kanë hyrë në shqipe së bashku me fjalët e huazuara, nuk kanë hyrë veçanërisht. Mirëpo me analogji, janë shtrirë edhe në disa raste që nuk gjejnë përdorim të përgjithshëm.

Në gjuhën turke, e përmendëm se këto mbaresa u vihen emrave në bazë të zanores fundore që kanë, e që mund të ishin deri në katër të

ndryshme për secilën mbaresë. Ndërsa në gjuhën shqipe, e cila nuk i ka të gjitha zanoret që ka turqishtja, ky numër është reduktuar.

Prapashtesa /llār/ u shtohet emrave, që në njëjës zanoren e theksuar të temës e kanë -a. P.sh.: *baba-baballarë*, *hoxhë-hoxhallarë*³, *pasha-pashallarë*, *axha-axhallarë*, *aga - agallarë* etj.;

Prapashtesa /lēr/ u shtohet emrave që zanoren e theksuar të temës e kanë -e ose -i. P.sh.: *efendi-efendilerë*, *sheb-sheblerë*, *baxhi-baxhilerë*, *kadi – kadilerë*, *myfti – myftilerë* etj.

Sa i përket hyrjes së këtyre mbresave në shqipe, këto kanë hyrë në shqipe drejtpërdrejt me fjalën në numrin shumës. Nuk kanë hyrë vetëm si prapashtesë më vete, ngase kjo prapashtesë nuk ka qenë prodhimtare.

³ Këtë fjalë dhe fjalët e e këtij tipi do t'i shpjegojmë më poshtë.

Për më tepër, nëse e marrim shembull fjalën “hoxhë” në gjuhën turke kjo fjalë është “hoca” [lexohet hoxha, theksi bie te a-ja]. Forma e shumësit në shqipe është hoxhallār, sikurse edhe në turqisht hocalar /hoxhallar/. Hoxhë-hoxhallar. A-ja që i shtohet këtu në vend të ë-së, nuk është për shkak të harmonisë së fjalës, për të hequr hiatin. Kjo fjalë kështu ka qenë në gjuhën burimore, në turqisht [hocalar] dhe kështu ka hyrë në shqipe. Ndërsa fjala hoxhë, e cila ka qenë hoxha, e ka bjerrë theksin oksiton, duke u bërë fjalë paraoksitone. Njëjtë është edhe fjala “babë”, megjithëse në toskërisht ekziston edhe “baba”. Ndërsa fjala “hoxhë” ekziston si e tillë në të dyja dialektet. Në shqipe nuk kemi diçka si “hoxha”, përpos në trajtën e shquar. Andaj, si rrjedhim, pohojmë se këto fjalë kanë hyrë në shqipe drejtpërdrejt në numrin shumës. Edhe numri i vogël i fjalëve me këto prapashtesa në shqipe, në krahasim me numrin e madh të turqizmeve, është në të mirë të këtij qëndrimi.

Përsa i përket kohës së hyrjes së këtyre prapashtesave në shqipe, këto mbaresa nuk dalin në asnjë rast për formimin e shumësit të emrave të vepra e Buzukut. Duke pasur parasysh edhe numrin e paktë të turqizmeve në veprën e Buzukut⁴, kjo tregon se ndikimi i turqishtes në shqipe, në kohën e Buzukut ishte fare i paktë dhe se këto mbaresa shumësi kanë hyrë në shqipe bashkë me fjalët që përdoren, pas Buzukut. Kjo prapashtesë haset, së pari herë, te vepra e Bogdanit.

Në veprën e Bogdanit, kemi së pari herë përdorimin e mbaresës “llār” në një rast të vetëm.

“... e nde atüne ajo gjelema sciye u kaa, se *Pascialarevet*, e Sangiachevet miscij kingiavet... ” (Bogdani I,VI,15)

Sipas kësaj, mund të themi se këto mbaresa kanë filluar të përdoren në shqipe nga shekulli XVII e këndej. Këtu e kemi fjalën pascia [pasha] me formën e shumësit “Pascialarevet” [Pashallarëvet].

Fjalë me burim turk, me prapashtesën e shumësit -llarë / -lerë, kemi edhe në fjalorët e shqipes. Fjalori i 54-ës, ka disa fjalë të këtilla. P.sh. fjalë me prapashtesën -llarë / -lerë janë:

⁴ Shih për këtë Demiraj 2013, Çabej (1988), ku gjithsej përmenden gjashtë – shtatë turqizma.

me -llarë:

agá/ agallárë

at/ atllárë

babá/ baballárë

daí/ dajllárë

daí/ dajllarë burrë trim e bujar

hoxhë/ hoxhallarë

pashë/ pashallarë

qebajá/ qebajallarë

ustá/ ustallarë

xhaxhá/ xhaxhallarë

me -lerë:

beg/ beglérë

bej/ bejlérë

haxhi/ haxhilérë

kadi/ kadilérë

myfti/ myftilerë

sheh/ sheblerë

Në fjalorin e Bashkimit (1908 (1977)) gjithashtu kemi një fjalë të huazuar nga turqishtja me prapashtesën -llarë: *Byhykbash*, i, vm. shum. *byhykbashllare*, t. T. Ner maltsina t'Shkodres nenkamsi i Sundimit...

Disa fjalë të këtij tipi të huazuara nga turqishtja, përpos mbaresës -llarë / -lerë, marrin edhe mbaresë të shqipes. Pra, mund të formojnë shumësin në mënyra të ndryshme. E formojnë shumësin me mbaresat inj, enj, ë. Në fjalorin e 1954-ës, krahas *myfti-myftilerë*, për *kryemyfti* kemi *kryemyftinj*. Te Fjalori i Bussetit kemi *agá: agait*, por gjithashtu kemi edhe

mbaresën 0: agë-a / agë-t. Vetëm për fjalën agë në fakt jepen tri forma të ndryshme të shumësit në të folmet e ndryshme shqipe: - ishin *agë* të ri; - tridhet *agaj* qi i ka marrë; - përmbas tij tridhetë *agallarë*

Haxhihasani gjithashtu jep për fjalën *boxhë* shumësin *boxhenj*. Pra, këtu kjo formë e shumësit është e njëjtë sikur për emrat e tipit lumë-lumenj. (Fiedler, 2007)

Përpos këtyre shembujve, në shqipe kemi edhe shembuj të tjerë, të cilët u janë larguar mbaresave me origjinë turke dhe u janë përshtatur fjalëve të shqipes, si *dajë* / *dajë-t*, *bylykbash* / *bylykbashë-t*, *myfti* / *myftinj-të* etj.

Një karakteristikë e këtyre turqizimave është se i përkasin gjinisë mashkullore. Qofshin ata emra që marrin -lerë, si dhe ata që marrin -llarë, që të dy grupet janë emra të gjinisë mashkullore.

Gjuha turke nuk i shquan emrat, si ata në numrin njëjës ashtu edhe ata në shumës. Nuk e ka këtë kategori. Kështu që një emër që merr mbaresën e shumësit lx^2r është në trajtën e pashquar. Shqipja ka bërë edhe përshtatjen e kësaj fjale sipas strukturës së vet. Kështu që, këta emra i shquan me mbaresën -t: *baballarë-t*, *dajallarë-t* etj.

Disa prej studiesve kanë pohuar plotësisht se këto mbaresa turke në shqipe ekzistojnë vetëm në disa emra me burim turk.⁵

Megjithatë, në disa të folme të shqipes, të cilat i ka vërejtur Fiedler (2007), kemi disa emra me burim joturk, të cilët marrin mbaresat -llarë ose -lerë. Më poshtë po japim disa shembuj të nxjerrë nga Fiedler:

mbret [nga lat. *imperator*], megjithëse ka shumësin e përgjithshëm mbretër, mbretën; kjo fjalë është hasur edhe me trajtën *mbretlerë* në dy vende që janë larg njëra-tjetrës (në gegërishten qendrore dhe në toskërishten qendrore).

prift [nga lat. *presbyter*] haset edhe me shumësin *priftlerë*.

dhespot [nga gr. *dhespotis*] – *dhespotlerë* (Shih për këtë edhe fjalorin e T. Dizdarit).

gjysh – për rrethin e Dumresë jep edhe përdorimin e formës *gjysbllar*.

trim – *trimlerë* (Në “Ditërrëfenjësi (kalendari) kombiar për vitin e ri 1898: 32)

Te këto përdorime, në dy nga rastet e mësipërme kemi shkarje nga rregulli që karakterizon formimin e shumësit me -llarë apo -lerë. Fjala “gjysh” zanore të temës ka y-në, gjë që do të duhej të merrte -lerë si prapashtesë, e jo -llarë siç kemi në këtë rast “gjyshllar”. Njëjtë vlen edhe për “komshi”, ku duhej të ishte “komshilerë” e jo “komshillarë”, sipas rregullit. Mirëpo gjuha, turke ka fjalën komşu, sipas kësaj, merr mbaresën -lar: komşular. Edhe shqipja duhet ta ketë marrë drejtpërdrejt formën e shumësit komşular, vetëm se e ka ndryshuar /u/-në në /i/, mirëpo pa e përshtatur edhe mbaresën e shumësit me fjalën e re *komshi*, gjë që do të duhej të dilte *komshilerë*.

⁵ Shih për këtë Demiraj 1986, 2013. Te Demiraj kemi këtë pohim: Me emra prej burimi jo turk në shumës kjo prapashtesë nuk ndeshet. (Demiraj 2013)

Përpos këtyre rasteve, prapashtesa -llarë përdoret edhe në disa llogape të formuar nga singularizimi i temës së shumësit të emrave të përveçëm. Kështu formohen mbiemra (emra familjesh) duke i shtuar mbiemrit njëjën e shquar të mashkullores njëjës. Kështu shumësi *Mujollarët* formuar prej *Mujo*-s ka dhënë mbiemrin e ri (Omer) Mujollari.⁶ Është për të vënë re se të tilla forma janë “moderne” dhe të reja; ato kanë zënë vend vetëm pas formimit të shtetit shqiptar, dhe kanë dalë nga nevoja për të pasur emra zyrtarë të familjeve.⁷ Kështu, në këtë mënyrë, janë formuar disa emra, si: *Ahmet-llari*, *Mujo-llari*, *Stefan-llari*, *Thoma-llari*, *Kosta-llari*, *Sadik-llari*, *Selim-llari* etj.

Edhe te formimi i mbiemrave të tipit të këtillë, nëpërmjet singularizimit, të bërë me prapashtesën -llarë, është përshtatur me rregullin në shumicën e emrave të mësipërm. Disa prej tyre (Ahmetllari, Selimllari, Sadikllari) i kanë ikur rregullit. Zanozja “e” dhe “i” që është zanore fundore e temës pranon mbaresën -lerë. E, në këtë rast, do të duhej të ishte Ahmetleri, Selimleri, Sadikleri sipas rregullit.

Po ashtu, ky formant na shfaqet dhe në toponimin Maqë-llarë, që gjendet në Dibërën e Vogël. (Çausi 2016).

Sa i përket përhapjes dialektore, këto mbaresa janë të përhapura në të folme të ndryshme të shqipes.

Waclaw Cimochowski, në punimin e tij për të folmen e Dushmanit, të cilin punim e pati bërë pas një qëndrimi ku pati mbledhur të dhëna gjuhësore të asaj të folmeje, kishte nxjerrë se “...disa emra përdoren madje edhe në trajtën turke të shumësit: hōž, hóža, hožālār, -t, pāš, páša, pašalār,-t. (Cimochowski 2004)

Hilmi Agani, në punimin e tij “Rreth kategorive të gjinisë, të numrit dhe të rasës së emrit në të folmen e qytetit të Gjakovës”, jep gjithashtu disa shembuj të përdorimit të disa emrave me prapashtesat e shumësit të turqishtes, një pjesë e të cilave përdorin mbaresën origjinale

⁶ Shih gjithashtu edhe te Dushi, Udha 14: ”...pas fjalëve të Katroshllarëve...”, te Xoxa “Puna është se Gjurgëzallarët...” (Fiedler 2007)

⁷ Shih për këtë: Çabej (1976), Demiraj (2013), Çausi (2016).

si alternative. Kështu, kemi: bāb-a, baba-t (për baballart); dāj-a, daja-t (dhe dāj-t); hōxh-t, efendī-t, kadī-t etj., por bēg-i, begler-t, shēh-i, shehler-t por dervīsh-i, dervīsh-t etj. (Agani 1978)

Për të folmen e Peshterit, e cila i përket gegërishtes veriore, Latif Mulaku & Mehdi Bardhi (1978) kanë dhënë disa përdorime si: pashallar-t, hoxhallar-t, shehler-t, begler-t etj.

Mehmet Halimi (1978), në “Vëzhgime mbi të folmen e Moravës së Poshtme”, jep këta emra me -llar: āg-agallār, bāb-baballār, hōxh-hoxhallār; me -ler: haxhī-lēr, dervīsh-lēr, beg-lēr, sheh-lēr.

Hasan Kelmendi, në “Disa veçori morfologjike të së folmes së lokalitetit të Turiçevcit⁸” (Kelmendi 1978), jep këta shembuj me -llār, -lēr, si baballār (bāb), hoxhallār (hōxh), beglēr (bēg).

Abdullah Zymberi, për të folmen e fshtravet të lugut të Drinit të Bardhë” (Zyberi 1978), pohon se “Emrat e burimit turk e bëjnë shumësin me mbaresë turke: baballār, agallār, beglēr.”

Qemal Murati, në “E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës” (Murati 1989) jep këta emra me prapashtesat turke -llar, -ler: hoxhallar, agallar, haxhiler, begler;

Naim Basha, në punimin “E folmja e qytetit të Dibrës” (Basha 1989) jep këta emra me mbaresat -llar: usta-ustalla:r, Feta-fetalla:r, axhi-axhilla:r, Dac-dacalla:r, mixh-mixhalla:r etj.

Si përfundim, mbaresat turke, të cilat i ka huazuar shqipja, kanë një përdorim të kufizuar. Pjesërisht përdoren në disa turqizma, e rrallëherë me anë të analogjisë kanë kaluar edhe te disa emra me burim joturk. Këto dy mbaresa, në rastin e turqizmeve i janë përshtatur “sinharmonisë vokalike” që ka gjuha turke, ndërsa në rastin e fjalëve me burim joturk, nganjëherë edhe i kanë ikur kësaj sinharmonie.

⁸ Zonë në Drenicë, të cilën e përbëjnë fshatrat: Brojë, Vojnik, Kopiliq i Epërm, Kopiliq i Poshtëm dhe Turiçevci.

Bibliografia:

1. Agani, Hilmi. 1978. «Rreth kategorive të gjinisë, të numrit dhe të rasës së emrit në të folmen e qytetit të Gjakovës». Në *Studime Gjuhësore I (Dialektologji)*, 227-273. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
2. Basha, Naim. 1989. «E folmja e qytetit të Dibrës.» Në *Studime Gjuhësore II (Dialektologji)*, 137-221. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
3. Boretzky, Norbert. 1975. *Der türkische Einfluss auf das Albanische. Teil 1: Phonologie und Morphologie der albanischen Turzizmen.* Wiesbaden: Harrassowitz.
4. Çabej, Eqrem. 1976. «Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes.» Në *Studime Gjuhësore IV.* Prishtinë.
5. Çabej, Eqrem. 1976. «Shumësi i Singularizuar në Gjuhën Shqipe.» Në *Studime Gjuhësore III.* Prishtinë: Rilindja.
6. Çausi, Elvira. 2016. *Formimi i shumësit të emrave të Meshari i Buzëkut (Disertacion i Doktoratës).* Tiranë. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2016/07/ELVIRA-%C3%87AUSHI->

FORMIMI-I-SHUM%C3%8BSIT-T%C3%8B-EMRAVE-TE-MESHARI-I-BUZUKUT.pdf.

7. Cimochoowski, Waclaw. 2004. «E Folmja e Dushmanit.» Në *Për gjuhën shqipe*. Prishtinë: ASHAK.
8. Demiraj, Shaban. 2015. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe (botim i dytë i përmbledhur)*. Bot i 2-të. Redaktuar nga Bardhyl Demiraj. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë.
9. —. 1988. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Prishtinë: Rilindja.
10. Demiraj, Shaban. 2004. «Rreth huazimeve turke në gjuhën shqipe.» *Studime Filologjike* 19-28.
<https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=191036>.
11. Dizdari, Tahir. 2005. *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*. Tiranë: AITC.
12. Fiedler, Wilfried. 2007. *Die Pluralbildung im Albanischen (Formimi i shumësit në gjuhën shqipe)*. Prishtinë: ASHAK.
13. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe [A-M, N-ZH]*. 1980 (1981). Prishtinë: Rilindja.
14. *Fjalor i gjuhës shqipe*. 1954 (1976). Prishtinë: Rilindja.
15. *Fjalori i Bashkimit "Fialuuer i ri i schypes"*. 1908 (1977). Prishtinë: Rilindja.
16. Friedman, Victor. 2002. «Makedonia ve Civar Bölgelerde Balkan Türkçesi / Balkan Turkish in Macedonia and Adjacent Areas.» *The Turks* 455-463.
<http://humstatic.uchicago.edu/mahimahi/media/faculty/vfriedm/168Friedman02.pdf>.
17. Friedman, Victor. 1994. «Turkisms in a comparative Balkan context.» *Septième Congrès International d'Études du Sud-Est Européen* (Greek National Committee for Southeast European Studies) 521-543.
<http://humstatic.uchicago.edu/mahimahi/media/faculty/vfriedm/081Friedman94.pdf>.
18. Friedman, Victor. 2006. «West Rumelian Turkish in Macedonia and Adjacent Areas.» *Turkic Language Contacts* (Wiesbaden) 27-45.

<http://humstatic.uchicago.edu/mahimahi/media/faculty/vfriedm/200Friedman06.pdf>.

19. Grannes, Alf. 1977. «On the Use of the Turkish Pluralizer – Lx²r in South Slavic and Albanian.» *New Zealand Slavonic Journal*, no. 2 83-93. <http://www.jstor.org/stable/40921043>.
20. Halimi, Mehmet. 1978. «Vëzhgime mbi të folmen e Moravës së Poshtme.» Në *Studime Gjuhësore I (Dialektologji)*, 403-452. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
21. Hengirmen, Mehmet. 2007. *Türkçe Dilbilgisi*. Engin.
22. Kadiu, Spartak. 2014. «The Morphemes -lar/-ler and -lik/-lık/-luk/-lük of Turkish Language Into Albanian and Romanian Languages.» *Mediterranean Journal of Social Sciences (MCSER)* 5. <http://www.mcser.org/journal/index.php/mjss/article/view/4300/4206>.
23. Kelmendi, Hasan. 1978. «Disa veçori morfologjike të së folmes së lokalitetit të Turicevcit.» Në *Studime Gjuhësore I (Dialektologji)*, 453-479. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
24. Kostallari, Androkli. 1978. «Rreth depërtimit të turqizimave në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII.» *Gjurmime Albanologjike* (Instituti Albanologjik i Prishtinës).
25. Latif Mulaku, Mehdi Bardhi. 1978. «Mbi të folmen shqipe të Peshterit.» Në *Studime Gjuhësore I (Dialektologji)*, 275-325. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
26. Latifi-Xhanari, Lindita. 2012. *Turqizmat dhe semantika e tyre në fjalorët e shqipes*. Tiranë: Dudaj.
27. Mehdiu, Feti. 1989. «“Orientalizmat: hyrja dhe përdorimi i tyre në gjuhën shqipe.» *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*.
28. Meyer, Gustav. 1883. *Die Pluralbildung der albanischen Nomina*. Wien.
29. Mulaku, Latif. 1977. «Turqizmat në gjuhën shqipe.» *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare* 55-62.

30. Murati, Qemal. 1989. «E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës.» Në *Studime Gjuhësore II (Dialektologji)*, 3-113. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
31. Zymberi, Abdullah. 1978. «Vëzhgime mbi të folmen e fshatravet të lugut të Drinit të Bardhë.» Në *Studime Gjuhësore I (Dialektologji)*, 481-502. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.

Majlinda BUSHAJ

DISA VEÇORI TË NJËSIVE FRAZELOGJIKE NË KRAHINËN E POSTRIBËS

Abstrakt

Ky punim përqendrohet në pasurinë frazeologjike të së folmes së Postribës, duke u përpjekur të sjellim në vëmendje dhe të analizojmë veçoritë më tipike të saj. Krahina e Postribës përmban një pasuri të madhe me frazeologjizma, me aftësi të veçanta e me vlera të shumta origjinale që nuk janë shfrytëzuar sa duhet. Ato jo vetëm begatojnë fondin leksikor të shqipes, por zbkurojnë ligjërimin, e zhdërvjelltësojnë dhe e ngjyrosin atë si: *mbaj barkun me dorë, ka një dërrasë mangut, nuk ia han qeni shkopin, nuk ja mân goja arrat, e ka ha:l n sy* etj. Gjithashtu, vihet në dukje se fjalët janë të zgjedhura, si nga përmbajtja ashtu edhe nga shprehësia. Frazeologjia e mbledhur në gojën e banorëve të Postribës është e pasur dhe shumë origjinale. Populli i kësaj krahine shquhet për një liri në strukturë e formë, përdorimin e frazeologjizmave të njohura e të panjohura, përshtatjen e tyre në krijimet e modifikimet e shumta, duke ndikuar kështu dukshëm në rritjen e intensitetit të funksioneve shënuese e vlerësuese të tyre. Veçori të ndërtimeve janë: si: ndërrimi i rendit të gjymtyrëve (inversioni), ndërfutja e fjalëve të tjera, zgjerimi a cungimi i njësisë frazeologjike, pa e shpërbërë atë dhe kthimi formal i trajtës mohuese duke ruajtur përmbajtjen mohuese të saj.

Fjalë dhe shprehje kyçe: *Postribë, fond leksikor, frazeologjizma, funksione shënuese etj.*

Abstract

This paper will focus on the phraseological wealth of the spoken language of Postriba, trying to bring attention to and analyze its most typical features. The province of Postriba contains a wealth of phraseology, with special skills and many original values that have not been utilized enough. They not only make wealthy the Albanian lexical fund, but enrich the discourse, unravel and color it as: mbaj barkun me dorë “belly laugh”, ka një dërrasë mangut “missing brain cells”, nuk ia han qeni shkopin “be on the ball”, nuk ja mân goja arrat “spill the beans”, e ka ha:l n sy “hate the sight of someone” etc.

It is also noted that the words are chosen, both by content and expression. The phraseology gathered from the oral communication of the inhabitants of Postriba is rich and very original. The people of this province are distinguished for a free structure and form, the use of familiar and unfamiliar phraseologies, in adapting them to numerous creations and modifications, thus significantly affecting the increase of intensity of their marking and evaluative functions. Features of the phraseological constructs are: the change of word order (inversion), the insertion of other words, the expansion or truncation of the phraseological unit, without disintegrating it, and the formal recovery of the denying form by maintaining its denial content.

Key words and expressions: *Postribe, lexical fund, phraseologies, marking functions etc.*

HYRJE

Krahina e Postribës shtrihet në verilindje të qytetit të Shkodrës, në të ashtuquajturën zona e Mbishkodrës. Postriba kufizohet në veri me komunën Gruemirë dhe konkretisht me përroin e Vrakës, fshatrat Rrash e Vorfë, në lindje me fshatin Xhan të zonës së Dukagjinit dhe Dajc të bajrakut të Sumës, në jug me zonën e Temal Dushmanit, fshatin Vukaj, Ukbibaj të zonës së Shllakut dhe Bardhaj të komunës Rrethina, në Perendim kufizohet me Hotin e Ri, Grudë e Re, Guci e Re të komunës Rrethina. Banori vendas quhet Postribas/e. Sot në këtë zonë përfshihen 12 fshatra: Boks, Dragoç, Kullaj, Mes, Myselim, Drisht, Vilzë, Ura e Shtrenjtë, Prekal, Domen, Shakotë dhe Fshati i Ri. Kjo krahinë bën pjesë në të folmen veriperëndimore. Sipërfaqja e saj është 180 km². Rreth 20% e sipërfaqes së saj shtrihet në fushë. Pjesa tjetër është kodrinore dhe malore. Lartësia e saj më e vogël është në luginën e Shtodrit, me 37 m mbi nivelin e detit. Lartësia e saj më e madhe është maja e Cukalit, me 1722 m mbi nivelin e detit.

Rëndësia e kësaj zone qëndron në disa aspekte. Së pari kjo lidhet me historinë, trashëgiminë dhe kulturën. Një ndikim të veçantë ka edhe pozicioni gjeografik, larmia e territorit, afërsia me qytetin e Shkodrës. Postriba ka pozitë gjeo-strategjike shumë të rëndësishme. Kjo zonë lidh Shkodrën me zonën turistike të Thethit dhe komunën e Dukagjinit me zonën e Shllakut. Në Postribë ndodhet “Ura e Mesit”, një monument i rrallë me vlera kulturore dhe arkitektonike në Shqipëri.

Postriba është një nga krahinat më të vjetra të Veriut. Fshatrat e saj, po t’i ndjekim nëpër dokumente, na dëshmojnë mjaft herët. Kryet e vendit për nga lashtësia e zë Drishti, kryeqendra e kësaj krahine që, siç shkruan prof. Çabej “Ky emër na shfaqet për herë të parë në shek. VIII të erës sonë, por burimet i ka në kohën më të vjetër”

¹. Pastaj dalin me radhë edhe fshatra të tjera si: *Mesiz, Domni* (në vitin 1485)², *Myselimi* (më 1621)³, *Ura e Shtrenjtë* (më 1685)⁴ etj. Si krahinë ka mjaft gjëra karakteristike nga krahinat e tjera. Për këtë gjë H. Koplíkaj shkruan: “*Banorët e kësaj krahine ...për kab doket, zëkonet e më tepër kab veshja kanë ndryshim prej atyre të vendeve të tjera duket se këta banorë...trashëgojnë disa gjëra prej të parëve, qi banojshin këtu, ndoshta prej qytetarëve të Drishtit të dikurshëm.*”⁵

Ky punim bën objekt trajtimi pasurinë frazeologjike të krahinës së Postribës, e cila është e pasur dhe shumë origjinale. Ajo dallohet për përmbajtje të gjerë e të thellë, figuracion të pasur, ngjyrim të fortë emocionues. Frazeologjizmat me burim popullor përbëjnë pasurinë kryesore të frazeologjisë së gjuhës shqipe. Duke u mbështetur në thënien e Thomait “...në këtë frazeologji më shumë se në fjalët e veçanta, shfaqet veçoria kombëtare e gjuhës, historia e zhvillimit të saj.”⁶, po paraqesim disa njësi që paraqesin interes në këtë të folme.

Këtu do të ndalem në fushat konceptore që paraqiten përmes frazeologjisë, duke i lënë vendin kryesor pasurisë së vjelë. Materiali leksikor i mëposhtëm është mbledhur në 12 fshatrat e krahinës së Postribës. Fjalët dhe shprehjet e përzgjedhura janë një pjesë e pasurisë së mbledhur gjatë viteve të fundit. Njësitë frazeologjike kanë gjerësi e denduri të madhe përdorimi në gjuhën e folur, ato mbushin zbrazëtitë e leksikut aty ku për diçka nuk kemi emërtim me një fjalë të vetme. Ajo zgjerohet vazhdimisht “sepse dita-ditës rritet me njësi të reja dhe zhvillohet me kuptime e përdorime të reja, që farkëtohen në gurrën e

¹ E. Çabej, *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të të vendeve*, “Studime rreth historisë së gjuhës shqipe”, Tiranë, 1977, f. 15.

² *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës*, i vitit 1485, vëllimi I, Tiranë 1974, përkthyer nga Selami Pulaha, f. 362, 405, 398 etj.

³ *Relacion mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XV/II*, vëllimi II, f. 258, 308, 384.

⁴ P. Bogdani, *Cuneus Prophetarum*, I/IV/17, cituar sipas Simon Pepës, *Gjurmime kulturore*, Shkodër 2000, f.58.

⁵ H. Koplíkaj, vep e cituar, *Cirka* nr. 19, 11 prill 1937, f.74.

⁶ J. Thomai, *Aspekti shoqëror-kulturor në formimin e frazeologjisë shqipe*, SF 3/75, f.116.

pashtershme popullore.”⁷Në këtë punim janë përfshirë njësi që paraqiten për herë të parë, por mund të ketë edhe ndonjë njësi të botuar, kur ajo është gjetur me kuptim të ri ose me nuancë të re kuptimore.

VEÇORITË KUPTIMORE TË FRAZEOLOGJIZMAVE

Tërheqin vëmendjen larmishëria e njërive që u përkasin fushave të ndryshme të jetës materiale e shpirtërore të banorëve të kësaj treve. Veçojmë këtu njësi që lidhen me fushat konceptore të **blegtorisë**, bujqësisë etj. Një përdorim të dendur kanë në këtë krahinë edhe shumë njësi frazeologjike, që lidhen me të folurin shprehës e figurativ.

Dihet se figurshmëria është veçori themelore e frazeologjisë⁸ dhe realizimi i kësaj figurshmërie bëhet me mjete më të larmishme si: me krahasim **si plesht dhish, si dhitë në krane, si dhi e nërkyme** etj. Me metaforë: **dhi e egër** vajzë a grua e gjallë a e shkathët, por jo e afrueshme etj.

FRAZELOGJI NGA FUSHA E BLEGTORISË

Populli i kësaj krahine merret me blegtori dhe bujqësi dhe njësitë frazeologjike janë të shumta. Pjesa më e madhe e njërive kanë në përbërjen e tyre emra kafshësh. Duke u mbështetur në cilësitë pozitive dhe negative (të përgjithësuara në mënyrë të figurshme) populli i kësaj krahine ka krijuar njësi frazeologjike të ndryshme, nëpërmjet të cilave ka shprehur qëndrimin dhe ndjenjat e tij, një shaka, një dëshirë, dashurinë dhe urimin për njerëzit e mirë, por, nga ana tjetër, ka shprehur edhe përbuzjen, talljen etj. Njësitë frazeologjike që lidhen me botën e kafshëve janë ndërtuar me emra të tillë si: **qen, mace, lopë, mushkë, gomar, emra shpendësh, insektesh** etj. si: **me bisht nën shalë** i turpëruar; **si baloshi i bulls** gjumash; **si çoban dhish** i paqytetëruar; **dhi e egër** vajzë a grua e e gjallë

⁷ J. Thomai, *Frazeologjia e gjuhës shqipe dhe vlerat e saj*, “Teksti dhe gjuha”, Tiranë, 1999, f. 148.

⁸ V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe I*, Tiranë, 2011, f. 58.

a e shkathët, por jo e afrueshme; **kcen si plesht dhish** flet pa u menduar vend e pa vend, dhe krejt papritur; **si dhi e nërkyme** e hutuar, thuhet për njerëzit që janë jo të zgjuar; **si dhinë në krane** keq. tall, iron. si të babësitur, shumë të uritur; **si dhinë pa çoban** pa kontroll; **si kamt e dhisë** të dobëta; **terr n'bri t'dhisë** natë shumë e errët, nuk shihet asgjë; e mājnë **si edhin n'drrasë** “shumë mirë”; **je si e:dh majs** shumë i dobët, ushqehesh, por nuk të bën mirë; **s'din ku ka bishtin gomari** nuk merr vesh as nga gjërat më të thjeshta, s'di të bëjë as një gjë të vogël, s'është i aftë për asgjë; **s'din me i dhan ujë gomarit** njeri i paditur(mospërfillje), nuk kupton ende, nuk di gjë, është i trashë nga mendja ose është fare i pazoti, s'di të bëjë as diçka të vogël; **si gomari n'baltë** kokëfortë; **i bân gjeli vó përditë** nuk punon dhe jeton mirë në saj të mundit të të tjerëve; (kakarit) **si gjeli n'pleh** shet mend me njerëz kur nuk është askushi; **shkojnë si mica me minë** herë shkojnë mirë e herë shkojnë keq; **si mica nëpër kâ:m** sillesh kot pa efekt pune. *Silleshsi mica nëpër kâ:m; si miza n'qull* njeri qëi fut hundët kudo, aty ku nuk duhet dhe mbytet në fjalët e veta, njeri pa takt; **si të pimë mizashi** dobët etj.

Lidhur me botën e kafshëve janë formuar edhe disa njësi frazeologjike me strukturë proverbiale, që u ngjajnë proverbave, fjalëve të urta, gjëgjëzave p.sh: **dy gjela një kotec nuk rrinë** dy njerëz nuk komandojnë në shtëpi vetëm një, shtëpia nuk ka dy drejtues. Sinonime me shprehjen: **dy gjela një pleh nuk knojnë; dy gjela një pleh nuk knojnë** dy njerëz nuk komandojnë në shtëpi vetëm një, shtëpia nuk ka dy drejtues. **Shkojnë njiqin kija para deshve** vdesin të rinjtë përpara të moshuarve etj.

FRAZELOGJI NGA BOTA BIMORE

Krahina e Postribës shtrihet në verilindje të qytetit të Shkodrës. **Relievi i saj është përgjithësisht kodrinor dhe malor.** Rreth 20% e sipërfaqes së saj shtrihet në fushë. Pjesa tjetër është kodrinore dhe malore. Ajo ka male të larta, shpatet e të cilave janë të veshura me bimësi të dendur e të shumëllojshme. Në të dy anët e lumit Kir shtrihen toka pjellore, në të cilat vendasit kultivojnë bimë të ndryshme bujqësore. Duke jetuar shpesh

me bujqësi, e përmes saj duke njohur nga afër, banori i këtyre anëve ka krijuar dhe një pasuri të llojit tjetër, atë që përfshin njësitë frazeologjike të lidhura drejtpërdrejt a tërthorazi me këtë botë. Nuk ka folës postribor, qoftë i moshës së re a madhore, i shkolluar a i pashkolluar, mashkull a femër, në jetën e përditshme a në ceremoni, në dasmë a në mort, në rrugë a në shtëpi që të mos i përdorë me mjeshtëri, me zgjuarsia e me vend këto njësi. Ato janë pjesë e pandashme e ligjëtimeve dhe përmes folësve, të portretizojnë, të lartësojnë, por edhe të tallin, të ironizojnë, të përbuzin, të përqeshin a të përçmojnë.

Frazeologjia nga bota bimore është e pasur dhe e shumëllojshme: **si me e pas shtryll prej kungullit** pa mend n'krye. *Beci e ka bas si me e pas shtryll prej kungullit, i ka mbi bari mbi kry* ka kohë që ka vdekur. *Aj qi the ti ka koh qî i ka bî bari mî kry* etj.

Urtësia e popullit, ndjenja e hollë e këtij krijuesi të madh, e mishëruar në këto shprehje të shkurtra, i japin ligjërimin një gjallëri e larmi të këndshme. Ato, shpesh sjellin në gjuhë vlera edhe më të mëdha sesa fjala, në përmbajtje edhe në ngjyrimin emocionues, sjellin nuanca të holla kuptimesh e përdorimesh, e zhdërvjelltësojnë komunikimin, sjellin vështrim e vlerësim të botës ku jeton postribori e më tej: **si gogla maje ujit**. “ka peshë të vogël ose s’ka peshë fare”. *Punt e tija janë si gogla maje ujit; sa pak more t paska xân n hasull; mos puf si gshteja n’zjerm; janë shtu të kqit si fara e hithave; rri si hu gardhi; korr e mos lidh; s’dibet ku mbidhet as ku korret; ma ba rrodhe; rritet si shtogu n’fekale; ju bë therra Brahim; vujti t’zitë e ullinitetj.*

FRAZELOGJI ME PJESË TË TRUPIT TË NJERIUT

Fryma popullore e frazeologjisë duket si në pikënisjen e ndërtimit të njësive frazeologjike, ashtu edhe në anët e tjera të tyre. Gjymtyrët kryesore të njësive janë fjalë që shënojnë pjesë të trupit, ose fjalë të jetës së përditshme, p.sh. si gjymtyrë drejtuese shërbejnë fjalët: **hundë, kokë, vesh, mendje, zemër, gjak, këmbë, qafë, fjalë, gojë, vesh** etj. Shembujt janë të shumtë si: **se merr hunën me i ra n tokë** e ka mendjen e madhe; **e kap për hune** bën si të dojë me të; **ia nxori për hune** ia nxori me zor;

i ka xanë goja lesh ha edhe ai po nuk i japin; *e ka gjuhën e gjatë* flet shumë; *nuk i pushon dhambi* (dhëmbi) *kurrrë* rrin duke ngrënë gjithë ditën; *është me shpirt nër dha:m* në prag të vdekjes; *i kanë ra dhambët* nuk ka fuqi më; *të shkuli dhamt* të vras, të pres; *i njeh me dha:m e dhëmallë* e njeh me rrënjë, ia di të gjitha; *e bani veshin cingare* dëgjon shumë; *iu zgjatën veshët* iu rrit mendja; *i ra në qafë* foli pa të drejtë për të; *e bani barkun fuqi* hëngri shumë etj.

VEÇORITË STRUKTURE TË FRAZELOGJIZMAVE

Në të folmen e banorëve të krahinës së Postribës duke i klasifikuar sipas ndërtimit, ato ndeshen në në formë togëfjalëshi si emër+emër, emër+mbiemër, folje+emër+mbiemër, por ka edhe tipa të tjerë strukturorë, në të cilët bëjnë pjesë si: *dergjë e dekë, çoban dhish, m'i than brit* etj. Njësitë frazeologjike me strukturë fjalie janë të shumta si: *herë n bark e herë n shpinë, ku rrah krapit e vjerret çjapi* etj.

Sipas vlerës leksiko-gramatikore, njësitë frazeologjike i ndajmë në katër grupe kryesore: emërore, mbiemërore, foljore, e ndajfoljore.⁹

Nga këto njësi frazeologjike të përdorura në gjuhën e popullit pjesën më të madhe e përbëjnë njësitë frazeologjike foljore. Ky përdorim kaq i shpeshtë i njësive të tilla frazeologjike vjen për dy arsye: së pari, për arsyen e thjeshtë objektive se prania e veprimit a gjendjes në fjali, e shprehur nga folja, është kurdoherë e nevojshme, sepse ajo përfaqëson gjymtyrën ndërtuese kryesore më të domosdoshme, kallëzuesin, e shprehur në këtë rast me një frazeologji foljore¹⁰.

Një këtë krahinë gjendet një numër i madh njësisish frazeologjike foljore, prej të cilave kemi shkëputur disa shembuj, si: **të shkuli dhamt** të vras, **dredh bishtin** bën gjëra të pamoralshme, **m'i than brit** më lodhën shumë, **e bani çorap** e ngatërroi muhabetin, **nuk ma nep i dorë**

⁹ J. Thomai, *Leksikologji e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f.227.

¹⁰ Th. Feka, *Pasuria frazeologjike në krijimtarinë letrare të Martin Camajt* botuar në Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare 24 shtator 2010 “Martin Camaj në kulturën shqiptare me rastin e 85 -vjetorit të lindjes”, botuar Tiranë, 2015, f. 272.

nuk më ndihmon, **i ran durt përtokë** u lodh shumë së punuari, **i ka qit n fik** bën shpërdorime të mëdha, **kcen si plesht dhish** flet pa u menduar, **e qet fare** (dikë a diçka), e shfaros, **t ka xan n hasull** të ka zënë gabim në muhabet, e në punë, **i ka hip atij kali** e ka nisë atë punë, **t' thajn n' kryq** të dënojnë rëndë etj.

Për nga ndërtimi paraqesin një larmi strukturash, që nga togjet e qëndrueshme dykryegjymtyrëshe e deri ato shumëgjymtyrëshe, nga ndërtimet në trajtë fjalie e deri në ato që janë afër fjalëve të urta.

Njësitë frazeologjike **ndajfoljore janë** të ndërtuara kryesisht me elemente krahasuese, kryesisht njësi frazeologjike që nisin me lidhëzën *si* dhe *sa* dhe ndërtime frazeologjike që nisin me parafjalë, por edhe në mënyra të tjera si: (punon) **si sëpata pa bisht** njeri pa mend në kokë, punon kot, keq; **si dhinë pa çoban** vetëm; **hu gardhi** bosh; **kur të fluturojë gomari** kurrë, asnjëherë; (rrah) **si kali në lamë** shumë; (të don) **si krypën në sy** aspak etj.

Njësitë frazeologjike mbiemërore, duke u përdorur me një ngjyrim të theksuar emocional, shërbejnë si mjete me vlerë stilistike. Në këtë krahinë ndeshim të përdorura tipa të ndryshëm strukturorë, si: **si baloshi i bullës** gjumash, **si dhi e nërkyme** e hutuar, **si kamt e dhisë** të dobëta, **si edh majs** i dobët, **me një kâ:m nën dhé**, **si pula pa krye** etj.

Frazeologjitë emërore janë shumë të pakta në krahasim me llojet e tjera të njësive, si: **gafe mbas gafesh** gabime; **rren me bisht** gënjeshtër e plotë etj.

Veçori të ndërtimeve frazeologjike të kësaj krahine janë: modifikimet e ndryshme të njësive, si: ndërrimi i rendit të gjymtyrëve (inversion), ndërputja e fjalëve të tjera, zgjerimi a cungimi i njësisë frazeologjike, pa e shpërbërë atë dhe kthimi formal i trajtës mohuese duke ruajtur përmbajtjen mohuese të saj. Po japim disa shembuj: *Kur xebe për diçka ban shamat hajt se* **dy durt për i krye jan me marr hak me m ngacmue jan.** *Vene i fije pshtym n goj se* **e kan marr djalin msysh syni i keq i ka bërë dëm e ka hedhur përtokë.** **Pa ba furrikun ska si ban vënë. Mos bash hajr sa mini n mur!** etj.

Ndërtimi i njësive frazeologjike bëhet edhe mbi bazën e shkrirjes, bashkimit a ndërthurjes të dy a më shumë njësive në një ndërtim të vetëm

për ta ngjeshur atë, për të mënjeluar përsëritjen e gjymtyrëve dhe për të rritur forcën shprehëse të saj. *Filani ka ba djalë nuk ju dridh kama as dora kur mori me ba kurban lopen, e rrxoi me i her përtok.*

Një përdorim të veçantë kemi edhe kur një njësi frazeologjike i bashkëngjitet një tjetre ose ndërfitet në të edhe me këmbim të gjymtyrëve, për të përforcuar përmbajtjen e saj kuptimore dhe emocionuese. **Të rrinë urtë e butë** *se ja thej turit, po nuk diti me nejë.*

E reja që sjellim nuk është vetëm pasuria e madhe frazeologjike e krahinës, por edhe nuanca kuptimore që ndeshim në shumë frazeologji të njohura. Këto nuanca të reja kuptimore e pasurojnë frazeologjinë shqipe duke zgjeruar përmbajtjen kuptimore të këtyre njësive. Këto raste janë të shumta në këtë të folme si: **i ka tretë çoku** i ka ikë mendja, **bani gushë** iu rrit mendja etj. **Dolme n'dynja tjetër.** 1. u shua fisi. 2. Pas një vështirësie vjen lehtësimi. *Fisi ka kentuj dal faret krejt pranaj më moren 9 vjeçe, doke me sbtu fisin se dolme n'dynja tjetër. I ka mët n derë.* 1. Thuhet për një vajzë që nuk martohet. 2. Një mik i papërshtatshëm. *Mos ia qit zoti n bise kujt me një t marrë me t met n der.* **S'ka ça i han dreqi mas darke.** 1. Shumë të varfër. 2. Njeri bosh që nuk ka fëmijë që e shqetësojnë. *Mos u merr me te se s'ka ça i han dreqi mas darke.* Shprehja frazeologjike **më zuri goja lesh** në Fjalorin e Thomait ka kuptimin: “u lodha duke folur shumë e duke përsëritur po atë gjë” (Fjalor:283) në këtë krahinë ndeshim një kuptim të ri: *I ka xan goja lesh.* Nuk flet kur duhet për të folur. *Fole i fja:l be bu:rr a t'ka xan goja lesh, nuk rribet qasbtu.*

Përveç njësive frazeologjike gjuhësore, në këtë krahinë ndeshim edhe mjaft të ashtuquajtura “frazeologji letrare”¹¹ si shprehje të mençurisë popullore, urime, betime, lutje, proverba, fjalë të urta si: **Dy gjela një kotec nuk rrinë** dy njerëz nuk komandojnë në shtëpi vetëm një, shtëpia nuk ka dy drejtues, sinonime me shprehjen: **Dy gjela një pleh nuk knojnë. Dy gjela një pleh nuk knojnë** dy njerëz nuk komandojnë në shtëpi vetëm një, shtëpia nuk ka dy drejtues. **Të dhasha ujë me lugë!**= u sëmursht rëndë; i jepet ujë me lugë njeriut që është në prag të vdekjes.

¹¹ J. Thomai, *Leksikologji e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f.235.

Jara bin t dhaça uj me lugë! **Të raftë kabaklia!** Përdorin nga pleqtë e vjetër. Sëmundje si epilepsia. **Të me:t prehni thatë!** Mallkim u thuhet nuseve që të mos lindin fëmijë. *U t met prehni tha:t si ma nise fmin tem n mal vetëm.* **Mos bash hajr sa mini n mur!** **Të ra:ft kolerja!** **Të ra:ft lija** atij atje ku qoftë! **T’hañrt dreqi armikun tan!** **T’hañrt gjarpri i parë që da:lt n’pranve:r!** **Të ra:ft lija atij atje ku qo:ft!** **Të shko:ft shkoza si t’ka: shku:!** Shkoza ka gërrxha shumë, dru me shumë degë e nuk ka hall pa t’kap një prej tyne. *Shkoza kur rritet si pem babet kular kular mandej t thon t met n fyt si shkoza kular kular, t shko:ft shkoza!* **Dalsh me faqe t’zezë!** **Dalsh faret!** **Iu thaftë dora!** **Qoftë larg me i rra fminë thubet iu thaftë dora/ si e bani kët punë ia griftë qimja doren.** **I hañrt shpirti thera** atje ku â! **Preftu nafaka!** E ndeshim edhe si shprehje “ *Nafaka e gjen gjithmonë rrugën e ve!*”. **T’u preftë leqja!** Mallkim. *Pse e bane at pun bë t’u preft leqja!* **Të raftë kabaklia!** **Të me:t prehni thatë!** Mallkim u thuhet nuseve që të mos lindin fëmijë. *U t met prehni tha:t si ma nise fmin tem n mal vetëm.* **Mos bash hajr sa mini n mur!** **Mos ja pash hajrin vedit!** **Ulu u ulsh pa majt!** **T tha:ft vera qí t ka tha!** **T hañrt ora e ze:z!** **T ra:ft e mira!** **Bje moj t ra:ft plasja!**

Gjuha e kësaj krahine dallohet edhe për një pasuri të begatë njësisht frazeologjike që futen në lidhje sinonimie, si sinonime të mirëfillta a si variante sinonimike me gjeçjëset e tjera sinonimike të shqipes duke pasuruar kështu vargjet sinonimike përkatëse e duke përmirësuar më tej strukturën sinonimike të gjuhës shqipe. Mund të përmendim njësi të tilla, si: **si me i pa hy luma në bark/** si me i pa hi dreqi në bark; **je ba si lopë rracet/** je ba si lopë vendit; **e din ku i ka morri syt/** e din ku i ka pleshti/morri syt; **ja ka ba mendjen pshesh/** ja ka ba mendjen çorbë; **as pite as simite/** as mish as peshk. Frazologjizmat kurdoherë kanë ngjyrim të fortë emocional, por edhe motivim të duhur, prandaj edhe konsiderohen si mjete të rëndësishme për shprehësinë e gjuhës.¹²

Ngjyrimi i theksuar emocional i frazeologjisë, ngjeshja në përmbajtje, dendësia e informacionit specifikimi gjuhësor e stilistik që sjell edhe variacione në frazeologji, janë shprehje e frymës popullore dhe e veçantisë kombëtare. Ligjërimi popullor është burim i pasurimit të gjuhës

¹² Sh. Islamaj, *Sinonimia frazeologjike në gjuhën shqipe*, SF, 4, 1986, f. 120.

letrare shqipe me sinonime frazeologjike dhe një burim i pafund për një fjalor frazeologjik sinonimik të gjuhës shqipe¹³.

PËRFUNDIME

Frazeologjia është një dukuri e spikatur në gojën e banorëve të Postribës, ka gjetur përdorime me vlera të shumta kuptimore, stilistike e shprehëse. Ajo është pjesë përbërëse e atij pasqyrimi të gjerë të frymës popullore, ku paraqitet përshkrimi i zakoneve e i mënyrës së jetesës shqiptare, i kushteve kombëtare e historike të vendit tonë, i tërë atij mjedisi social, historik e shoqëror të cilit i drejtohet populli ynë. Populli i kësaj krahine nuk paraqitet vetëm njohës i mirë i frazeologjisë, por mjeshër i përdorimit të saj. Shembujt e shumtë të sjellë në punim tregojnë edhe një herë se në frazeologji më shumë se në çdo fushë tjetër *shfaqet veçoria kombëtare e gjuhës, historia e zhvillimit të saj*.¹⁴

Vlerat e frazeologjisë së banorëve dalin qartë si në shprehjen e mendimeve ashtu edhe në shprehjen e ndjenjave. Ajo është fryt i shumë brezave, në përputhje me ligjësitë gjuhësore shqipe.

Pasuria e madhe frazeologjike dëshmohet jo vetëm nga njësitë e shumta, por edhe nga nuancat e reja kuptimore që ndeshen në shumë frazeologji të njohura. Këto kuptime të reja zgjerojnë përmbajtjen kuptimore duke pasuruar gjuhën shqipe.

Më poshtë po japim një fjalorth të njësive të kësaj krahine, të cilat po i rendisim alfabetikisht sipas gjymtyrës kryesore dhe kemi nënvizuar fjalën bazë.

¹³ H. Shehu, *Rreth vlerave letrare potenciale të frazeologjisë popullore në gjuhën e sotme shqipe*, botuar në veprën “Studime për leksikun dhe leksikografinë shqipe, Tiranë, 2015, f. 43.

¹⁴ Thomai, *Aspekti shoqëror-kulturor në formimin e frazeologjisë shqipe*, SF, 3, 75, f. 116; Jani THOMAI, *Studime për gjuhën shqipe*, II (Frazeologjia gjuhësore), Tiranë, 2017, f. 211-222.

FJALORTH I NJËSIVE FRAZEOLOGJIKE NË KRAHINËN E POSTRIBËS

BAGËTI,~A *Si va:th bagtish*: “Të papastër, rrëmujë”. *E bajn shpin si vath bagtishbajn gafe mbas gafesh.*

BAHÇE,~JANuk *m’ka le n’baçe*: “1.Nuk mund ta detyroj të bëjë një punë që nuk i takon, sepse nuk kam detyrime ndaj tij. 2. nuk e njoh”. *Nuk e njof at insane se nuk m ka le n baçe.*

BAKLLAV/~Ë *Aj qî vjen shpesh han psbesh, âj qî vjen rrallë han bakllavë.*
Thënie e urtë.

BALOSH,~I *Si baloshi i bulls*: “Gjumash, njeri që flen gjithë ditën”. *Ça po flen si baloshi i bulls.*

BALTË,~A *Si balta për shkarpë*:“Të ngjitet shumë”.*Kur një njieri kapet me t marr diçka thubet kapet si balta për shkarpë, e nuk t len kurrkun. T kapet si balta nëpër shkarpë e nuk t shkoqet kurrë.*

BAR,~I *I ka mbî bari mbi kry*: “Ka kohë që ka vdekur”. *Mos pyt për te ka kohë që i ka mbi bari mî kry.*

BARK,~U *Herë n bark e herë n shpinë*: “Njeri bosh, i cili nuk punon asgjë”.
Tanë ditën e lume herë n bark e herë n shpinë.

BARK,~U *I nxjerr zorrt e barkut* (dikush): “Nuk di të mbajë gjë të fshehtë, i nxjerr të gjitha të fshehtat jashtë”. *Mos fol me at batalle se qaja i nxjerr tana zorrt e barkut e nuk i man fja:lt e të rrinë urtë e butë se ja then turit, po nuk diti me nejë.*

BARK,~U *N bark t nanës*: “Shumë të vegjël, pa lindur akoma”. *Jan feju njerzît n bark t nans ma përpara ka ken than ty nse t len vajza t baj mik, nse tlen djal ty ma t parën t baj kumar.*

BARK,~U *Si me i pa hy luma n’bark*: “Llups, njeri që ha shumë, shumë i uritur”. *Han si me i pa hy luma n’bark.*

BËJ *E kanë ba rup*: “E kanë ngrënë krejtësisht, e kanë zhdukur të tërën”.
Pulat e bajnë rup gjithëka.

BIR/Ë,~A *Sa bira ka muri aq punë ka burri*: “Burri ka punë shumë”.*Gjendet edhe shprehja: Nuk mëllen birat e gardhit me fjalët e hallkut; sa mëllen birat e gardhit aq mëllen fjalët e hallkut.*

- BISHT,~I** (Punon) *si sëpata pa bisht*: “Njeri pa mend në kokë, punon kot, keq”. *Nuk merret n pu:n ai kafshari aj punon **si spata pa bisht***.
- BISHT,~I** *Dredh bishtin*: “Bën gjëra të pamoralshme”. *Nuk i bjen n men për rangt e shpisë rrin tuj **dredh bishtin** ta:n ditën e lume*.
- BISHT,~I** *Me bisht nën shalë* (shkoi): “I turpëruar”. *Shkoi si qeni **me bisht nën shalë**,ia kana nreq mi:r qefin filanit*.
- BISHT,~I** *Rren me bisht*: “Gënjeshtër e plotë”. *Është e vërtetë se **âsht rrence**. I ka **rrenat me bisht** âsht rrence e madhe*.
- BRINJË,~A** *M'i than brit*: “Më lodhën shumë”. *Më futen n kooprativ **e m'i tha:n brit kur kam ke:n e re***.
- BUALL,~I** *E ban miçen buall*: “I zmadhon shumë gjërat”. *Mos i xen be:s qati robi se ta ban miçen buall*.
- BULLAR,~I** *I kanë dhanë trutë e bullarit*: “E kanë bërë budalla”. ***I kanë dhanë trutë e bullarit** e i kanë marrë mendtë*.
- ÇAKARE,~JA** *Ç'po gri si çakare*: “Po flet shumë dhe pa pushim”. *Ç'po grin si çakare ta:n ditën e lume, pusho i he:r he bre: bu:rr*.
- CANGËL,~A** *Ka nej n cangla*: “Ka qëndruar në pritje të një fjalës, të një lajmi, në ankth”. *Kam **nej tan ditën n cangla** tuj m prit ça po m thue*.
- CJAP,~I** *Ku rrah krapë e vjerret cjapë*: “Kam qenë prej në breg të liqenit e në majë të malit” *Kam ken atje **ku rrah krapë e vjerret cjapë***.
- ÇOBAN,~I** *Je si çoban dhish*: “Njeri i paqytetëruar”. *Ku ka men aj **çoban dhish**, ta:n ditën n mal rrij me berre*.
- ÇOK,~U** *I ka tretë çoku*: “I ka ikë mendja”. *Njerëzve që kanë humbur kujtesën thuhet u ka tretë çoku. Mos u merr me ate **se i ka tret çoku***.
- ÇORAP,~I** *E bani çorap*: “E ngatërroi muhabetin, e bëri rrëmujë të madhe”. *E përçieju muhabetin **e bani çorap***.
- DALLG/Ë,~Ë**. *Janë rrit n dallgë*: “Janë rritë në vështirësi dhe me prova të vështira”. *Sa fmi t mirë janë tan ja:n rrit n dallgë, e nuk ja gjen sot shogin*.
- DASH, ~I** *Shkojnë njëqin kija para deshve*: “Vdesin të rinjtë përpara të moshuarve”.
- DER/Ë,~A** *I ka më t n derë*. 1. Thuhet për një vajzë që nuk martohet. 2. Një mik i papërshtatshëm. *Mos ia qit zoti n bise kujt me një t marrë **me t met n de:r***.

- DER/Ë,~A** *Ia ka mshel derën me there:*“Nuk ka lënë njeri pas, trashëgimtar”. *Kur des djali i dëshirit ka mshel derën me therrë ene kur merr një nuse t keqe që nuk i pret bijat ta mëll derën me therrë.*
- DERGJ/Ë,~A** *Dergjë e dekë:* “Sëmundje e vdekje e shpejtë”. *I ka pasë dergjë e dekë për një mu:j.*
- DET,~I** *Bane n det se e gjen n kry:p:* “Bëj mirë se gjen mirë”. *Po bane mirë gjen mirë. Bane n det se e gjen n kry:p.*
- DHI,~JA** *Dhi e egër:* “Vajzë a grua e e gjallë a e shkathët, por jo e afrueshme”. *Je si dhi e egër* Ndeshet edhe shprehja *âsht gjaku me gjak* shumë e egër.
- DHI,~JA** *Si dhi e nërkyme:* “E hutuar, thuhet për njerëzit që janë jo të zgjuar”. *Qajo âsht si dhi e nërkyme.*
- DHI,~JA** *Si dhitë në krane keq.* Tall, iron. “Si të babësitur, shumë të uritur”. *Janë sblu: me hanger gshteja t zime si dhi:t n krane.* (Shakotë).
- DHI,~JA** *Si dhitë pa çoban:* “Pa kontroll, vetëm”. *I kanë lshu fminë si dhitë pa çoban.*
- DHI,~JA** *Si kām̄t e dhisë:* “Të dobëta, të holla”. *I ka kām̄t si kām̄t e dhisë.*
- DHI,~JA** *Terr n’br̄i t’ dhisë:* “Natë shumë e errët, nuk shihet asgjë”. *Âsht shpja terr si n br̄i t dhis nuk shiqoj me bâ asnj̄i pu:n mre:n.*
- DOR/Ë,~A** *Âsht do:r me një* (diçka): “E sigurtë, është krejt e sigurtë, është pikërisht ajo që duhet ose ashtu si duhet, vlen për atë që duam”. *I kja vōja e djegun âsht do:r me një me sbnosh t’ djegnit.*
- DOR/Ë,~A** *Âsht mi:r mos me ta pa as dora tjetër kur nep nej gjâ:* “Bëja një të mirë tjetrit pa i thënë kujt”. *Mos rri tuj kalllxu gjines se kena falë për sevap se âsht mir mos me ta pa as dora tjetër kur nep nej gja.*
- DOR/Ë,~A** *Âsht rrit n’shpla:k t’ dors:* “Është rritur mirë, me shumë kujdes”. *Qajo âsht rrit n’shplak t’ dors/ / për dy tri vjet e prun t’dekun/ / u pruni lek primve sa s’ dishin ka me u dhan/ / sot me than mjeri aj që u nep rrugat.*
- DOR/Ë,~A** *Dy du:rt për î krye:* “Në qoftëse se i bën dikujt një të keqe ja kthen në të njëjtën mënyrë”. *Kur nxebe për diçka ban shamat hajit se dy durt për i krye jan me marr hak me m ngacmue ja:n.*
- DOR/Ë,~A** *Erdhi me dur tha:t* (dikush): “Erdhi pa sjellë ndonjë dhuratë, erdhi fare pa gjë”. *Ka ardhë me dur thatsi ka ardh marre t pa ftyres, â i vibet kujt qashtu?*

- DOR/Ë,~A** *I ran durt përtokë*: “U lodh shumë së punuari, u rraskapit së punuari, u dërrmua në punë”. ***I kan ra durt përtokë tan ditën tuj la tesha, e tuj bâ pu:nt e shpisë.***
- DOR/Ë,~A** *Kur ke mashë pse i djeg duart*: “Kur ke një person që e çon nga të duash, pse shqetësohesh vetë. Shpeshherë njerëzit përdoren si mashë, vegël e dikujt”.
- DOR/Ë,~A** *Nuk ma nep i dorë*: “Nuk më ndihmon”. *U jam tuj plas n’arë ta:n ditën e lume e nuk ma nep î dorë burri jem e mjera ú!*
- DREQ,~I** *S’ka ça i han dreqi mas darke*. 1. Shumë të varfër. 2. Njeri bosh që nuk ka fëmijë që e shqetësojnë. ***Mos u merr me te se s’ka ça i han dreqi mas darke.***
- DUA** *Ma don qiefi* “Më pëlqen”. *Me hanë të re fillojmë temelin e shpisë fejesa e martesë, presim një kostum t’ri/ e kam vesh me hane të re se me bjen mir një ky kostum ma don qiefi me e vesh.*
- DYNJA,~JA** *A sjell dynjaja dollap*. 1. A risjellë edhe një herë koha e kaluar. 2. Është prishur dynjaja. *Nuk ja:n ma pu:nt e maparshme a sjell dynjaja dollap e nuk t vet kush.*
- DYNJA,~JA** *Dolme n’dynja tjetër*1.U shua fisi. 2. Pas një vështirësie vjen lehtësimi. *Fisi ka ken tuj dal faret krejt pranaj më moren 9 vjeçe, doke me shtu fisin se dolme n’dynja tjetër.*
- EDH,~I** *E mājnësi edhin n’drrasë* “E mbajnë shumë mirë. Edhave në dimër në vendin ku flenë u shtrajnë dërrasa që të flenë sa më ngrohtë, kjo shprehje thuhet për fëmijë të cilët rriten me përkujdesje të madhe”. *E kanë majt si edhin n’drrasë.*
- EDH,~I** *Je si e:dh majs*: “Shumë i dobët, ushqehesh, por nuk të bën mirë”. *Edhi majs pi dy nana, dhe nuk ka shndet. Ça ke si rrin tuj hangër si edhi majs tan ditën tuj bubrrue.*
- FAQE,~JA** *Si sho:ll kpuce*: “Nuk i bën më përshtypje asgjë. Nuk ka turp për asgjë” *Ja ba faqja si sho:ll kpuce.*
- FAR/Ë,~A** *E qet faret* (dikë a diçka): “E shfarosi, e zhduku krejt, sa si duket më asgjë”. *Teja kallomoqin e qet faret.* Ndeshim edhe mallkimin ***Të tretë fara!***
- FJAL/Ë,~A** *E man fjalën sa e mban shporta ujt*: “Nuk e mban fjalën aspak, është e pabesë”. *Qe kjo seman fjalën sa e mân shporta ujt.*

- FJAL/Ë,~A** *I peshon fjalët me kandar*: “I mat fjalët, din kur e flet fjalën”. ***I peshon fjalët me kandar*** e nuk i bjen *i fja:l n to:k*.
- FJAL/Ë,~A** *Ja kan kput: t fjalën* (etnografi): “I kanë caktuar kur do të bëhet dita e martesës, bënë marrëveshje e caktuan afatin për diçka”. ***E kan kput fjalën*** me u martu n praverë, se a koba ma e mir.
- FJAL/Ë,~A** *Si bite një fjal n'to:k* : “Nuk gabon, e ka mendjen në rregull”. ***Tetëdhjetë vjeç ka ke:n e si bite një fja:l n'to:k***.
- FLOK,~U** *Si flo:ket e harapit*: “Janë ngatërruar keq”. ***Si flo:ket e harapit*** janë ngatrrue për një gjá.
- FURRIK,~U** *Bane furrikun përpara jo kur t vi:n vója*: “Gjeje vendin pastaj bëje punën”. ***Pa ba furrikun ska si ban vënë***sinonime *pa gjet venin s ke si ban punën*. Ndeshim edhe fjalën e urtë: *Edhe pula e din ku e ka furrikun e ti nuk e din ku e ke shtëpinë*.
- FYJT,~I** *E ka porcin n fyt*: “Flet shpejt”. *E ka porcin n fyt e i del e dyta fjalë para t pares, t shurdhon gjith ditën e lume*.
- FYJT,~I** *Më ka shku laku n fyt*: “Kam një mërzi të madhe shumë, jam lodhur shumë nga ajo punë”. ***Më ka shku laku n fyt*** e nuk mund ta baj njat gja vallahi.
- FYTYR/Ë,~A** *I ra fytyra përtokë*: “U turpërua shumë”. *Kur ia përmena borxhin i ra fytyra për tokë*.
- GABZHERR,~I** *E ke gabzherrin shkurt*: “E qet fjalën pa e menduar, fjalën e fundit e qet n’fillim. Është një njeri që nuk duron shumë dhe nuk e mban diçka të fshehtë, flet pa u matur dhe pa u menduar mirë”. *Menoju kur flet e ke gabzherrin shkurt, nuk i ke menu shu:m gjanat*.
- GËSHTENJ/Ë,~A** *Puf si gshteja n’zjerm*: “Thuhet zakonisht për njerëzit që janë gjaknxeh të e nuk pranojnë logjikë”. ***Mos puf si gshteja n’zjerm***.
- GISHT,~IE** *la me gisht n gojë*: “E la pa asgjë”. *Iku ja:sht e i la ta:n gjind e shpisë me gisht n gojë*.
- GJAK,~U** *I merr gjak n vetull*: “Bën të pamundurën, është trim, i erdhi hakut”. *Ruje vedin prej tij se t merr gjak n vetull*.
- GJAK,~U** *Me gjak e me hanrak*: “Të sëmurë shumë”. *E kam pas plaken me gjak e me hanrak e ja kam ba hyzmetin e sot bijat e sodit s dojn me nej me pleqt që i ka:n shnos e kollonisin vedin*.

- GJAK,~U** *Me gjak t zemrës*: “Me vështirësi të madhe, me shumë mund”. *I kana ble me gjak t zemrës e mos i prish kot.*
- GJARPËR,~I** *Si gjarpër cubel*: “Njeri i idhët, dinak”. **Â si gjarpër cubel á** *i shkurtë e shum e egër, t shiqon n së si gjarpër.*
- GJEL,~I** *Dy gjela në kotec nuk rrinë*: “Dy njerëz nuk komandojnë në shtëpi vetëm një, shtëpia nuk ka dy drejtues”. **Dy gjela në kotec nuk rrinë** *mos u lodh kot dubet me u nda djelmohat secili n shpi t vet.*
- GJEL,~I** *Dy gjela një pleh nuk knojnë*: “Dy njerëz nuk komandojnë në shtëpi vetëm një, shtëpia nuk ka dy drejtues”. **Dy gjela një pleh nuk knojnë** *nuk ka ba vaki nej her veç n kanakun tuj.*
- GJEL,~I** *I bân gjeli vó përditë*: “Njeri me përfitime të mëdha nga zgjuarsia e tij”. *Qaj rob nuk ka nevo: me punu se i bân gjeli vó përditë.*
- GJEL,~I** *Kakarit si gjeli n’pleh*: “Shet mend me njerëz kur nuk është askushi”. *Kush ja ven veshin qatij robi aj kakaritsi gjeli n’pleh.*
- GJEL,~I** *Si gjeli n qerr*: “Njeri që rri bosh pa punë”, *nieri qí rrin si gjeli n qerr á një njieri që rrin pa punë, dembel.*
- GOGËL,~A** *Si gogla maje ujit*: “Ka peshë të vogël ose s’ka peshë fare”. *Punt e tija janë si gogla maje ujit.*
- GOJ/Ë,~A** *Qet melhem prej gojet*: “Njeri i dashur, kurues me fjalën e tij”. *E kam marrë nusen si se ka shoqen, qet melhem prej gojet, lum burri qí e ka.*
- GOJË,~A** *E tha sa me la gojen*: “Përdoret kur thërrasim dikë sa për të thënë, jo me dëshirë për të ardhur, po sa për zakon”. *Më ka çu nana me la gojen. Të thërret për darkë sa me la gojën.*
- GOJË,~A** *I doli goja*: “Ka filluar të flasë pa druajtje, ka marrë guximin të flasë e të kërkojë diçka, ka zënë e flet shumë për të tjerët, ka filluar të mbajë nëpër gojë të tjerët; ka zënë të përdorë fjalë të rënda, të ulëta etj. Sinonime me shprehjen **ka vënë gojë** (Thomai, Fjalor:151).” *Ka fillu me i dalë goja gjelins teme. Flet la pa la.*
- GOJË,~A** *I ka xan goja lesh*: “Nuk flet kur duhet për të folur”. *Fole i fja: l be bu:rr á t’ka xa:n goja lesh, nuk rribet qashtu.*
- GOJË,~A** *I shkoi goja te veshi*: “U lodh shumë së foluri për të njëjtën gjë, i ra goja së foluri”. *M’doli goja mrapa tuj fol, më shkoi goja te veshi.*
- GOJË,~A** *Me gisht n’gojë*: “Pa asgjë, fukarallëk i madh, shumë i varfër”. *Aj nieri ka met me gisht n’gojë.*

- GOJË,~A** *Shplaje gojen kush ásht ai*: “Mendohu mirë përpara se ta përmendësh atë”. ***Shplaje gojen kush ásht ai binet mileti me ta nigju kush.***
- GOMAR,~I** *Kur të fluturojë gomari*: “Kurrë. Asnjëherë. Thuhet për një punë që nuk ka për t’u bërë kurrë”. *Prit ta bajn at pu:n se deri athe:r ka me fluturu gomari.*
- GOMAR,~I** *Me çu gomarin prej veshve*. Sinonime me shprehjen *nuk çalon gomari prej veshëve.*
- GOMAR,~I** *Më kanë ftu si gomari n’darsëm*: “Më kanë ftuar në dasmë të punoj; gomari në dasëm merret vetëm për mbajtje ushqime”. ***Më kanë ftu si gomari n’darsëm nuk kam ardh për qiej.***
- GOMAR,~I** *S’din ku ka bishtin gomari*: “Nuk merr vesh as nga gjërat më të thjeshta, s’di të bëjë as një gjë të vogël, s’është i aftë për asgjë”. Sinonime me shprehjen e Thomait *s’di nga lidhet gomari.* (Thomai, Fjalor: 152).
- GOMAR,~I** *S’din me i dhan ujë gomarit*: “Njeri i paditur(mospërfillje),nuk kupton ende, nuk di gjë, është i trashë nga mendja ose është fare i pazoti, s’di të bëjë as diçka të vogël”.
- GOMAR,~I** *Sa goma:r buzbardhë janë*: “Sa njerëzit janë me vese të këqija. S’është po ajo gjë, s’është ai ose s’është e atij që mendon ai, ka edhe të tjerë si ky”.
- GOMAR,~I** *Si gomari n lakna*: “Ka shku në një vend të papërshtatshëm për të”. *Nuk ke dit ku shkon je fut **si gomari n lakna.***
- GOMAR,~I** *Si gomari n’baltë*: “Kokëfortë”. *Ngul kam **si gomari n’baltë,** gomari s’ka tjera men kur i mushet menja s’lëviz.*
- GOMAR,~I** *Të qesh gomari nën abër*: “Flet kot, flet pa u menduar”. *Mas ja thuj kuj se të qesh gomari nën abër, mast a njin kusha nja gja. Aq budallalëll ke bas a t qesh gomari nen abër.*
- GRIJ f.***Me gri katërsht nuk kam t ngopun*: “Ndjenja që shprehet për një njeri që është shumë i keq”. *Isballa nuk m del përpara seme **gri katërsht nuk kam t ngopun.***
- GUR,~I** *Nuk ta nep i gur me ça kryt*: “Është koprrac, njeri dorështërnguar”. Sinonime me shprehjen *s ta rron vō me vō.*

GUR,~I *Si len dy gur bashkë*: “Njeri shumë sherr”. *Ësht njëri shum i keq si len dy gur bashkë ka dorën e keqe me përkit.*

GUXOJ *Nuk guxon me ba çek*: “Me folë një fjalë”. *Nusja jeme nuk guxon me ba çek*. Gruaja nuk guxon me bërë asgjë pa fjalën e burrit.

HAN/Ë,~A *Ësht hanë-hanë*: “Ka sjellje të ndryshueshme, herë të dëgjon herë jo. *Nuk merret vesht se ça don me bâ se âsht ba:n -ba:n.*

HASËLL,~I *T ka xân n hasull*: “Të ka zënë gabim në muhabet, e në punë”. *Sa e ke shtitë lopen? Sa pak more t paska xân n hasull*. Kjo shprehje nuk gjendet në *Fjalorin* e 1980.

HITH/Ë,~A *Janë shtu si fara e hithave*: “Janë shtuar shumë e shpejt” Me të njëjtin kuptim në *Fjalorin* e 1980, (f.453). *Janë shtu të keqit si fara e hithave*.

HU,~RI *Rri si hu gardhi*: “1. Njeri bosh. 2. Rri si i shastisur ngaqë nuk kupton se çfarë thuhet a ç’bëhet, nuk mund të them asnjë fjalë a s’di të veproj përpara një të papriture; jam i shtangur, kam ngrirë”: *Mos rri hu gardhi shpja nuk qet gja/ / a rribet n’shpi shul/ / rrin një pensionist/ / kuku për ju djel të ri*.

HUND/Ë,~A *Të qyr me hundë*: “Të shikon me neveri se të ka bezdi”. *T qyr me hu:n se nuk don me t pa me së, s ke pse shkon te aj*.

KA,~U *Pret një ka e han një thelë*: “Bën një punë shumë të madhe e nuk të takon asgjë”.

KA,~U *Si ka i tërbuem*: “Nuk merr vesht”. *Aj njëri âsht si ka i tërbuem*.

KA,~U *Vlen sa i ka kularit*: “Ka një çmim shumë të mirë, kushton shtrenjë”. *A po munesh me e ble qat gja-jo besa qajo vlen sa i ka kularit*.

KAKI,~NI *Si furraç kakinit*: “Shumë i dobët nga trupi”: *Mushe barkunje ba si furraç kakinit*.

KAL,~I *Ec si kali n livadh*: “Mendjemadh, njeri që ec me kokën përpetjet”. *Ça ec si kali n livadh*.

KAL,~I *I ka hip atij kali*: “E ka nisë atë punë”. *Kur jam nis me ba një punë i kam hip atij kali*.

KAL/Ë,~I *Si ka:l hamshur*: “Njeri i pa frenuar”. *U je Asht si kal hamshur s’don me dit gjâ nuk ka kufi askun, bân çdo gja nuk llogjikon*”.

KAL/Ë,~I *Si kali n lamë*: “Shumë,pa dhimbje”. *Jam rrah si kali n lamë prej burrit*.

KËMB/Ë,~A *Nuk i dridhet kama e dora*: “Nuk ka frigë nga asgjë, është guximtar”. *Filani ka ba djalë nuk ju dridh kama as dora kur mori me ba kurban lopen, e rrxoi me i her përtok.*

KËMB/Ë,~A *Si themer kamet*: “Të egra nga puna e madhe dhe e vështirë”. *Durt e saj ba si themer kamet tuj punu nepër to:ke.*

KËPUC/Ë,~A *Ka dalë me këpucë të kuqe*: “Ka dalë i humbur, e nxorën të humbur”. *Ka dalë me këpucë të kuqe me shitjen e qî bani qaj njeri.*

KOK,~Ë *Me kry n’thes*: “E mbyllur, me fenatizëm”. *Veçse me marrë burrin e ri e me kalue me kalue me kry n’thes// n’qosh vet e mir vet ja le venin e nuk t’qet kurrkush.*

KOK/Ë,~A *Ia ka kput kryt nans t vet*: “I ka ngjarë krejtësisht”. *Uu ça ja ke kput kryt nans tane, si dy pika uji.*

KONAK,~U *Ma mir i bij konakut se i çifllak*: “Më e dobishme është një grua me zakone dhe tradita familjare se një pasuri shumë e madhe”. *Ma mir i bij konakut se i çifllak gruja e keqe o t’le fjalën o t’le djalin.*

KONOP,~I *Nuk lshon konop hiç*: “Nuk toleron, sinonime me shprehjen nuk shlon pe për asgjë”. *E ka nanen rojse e nuk lshon konop hiç.*

KORR *Korr e mos lidh*: 1. Flet pa lidhje. 2. Bën një punë gjysmake dikush, nuk e çon deri në fund një punë. *Kush i njëjke okonomatet prej shtetit atherë/un çobaneshë me bagti veç fol korr e mos lidh.*

KORR *S’dihet ku mbidhet as ku korret*: “Nuk dihet nga shkon, as nga vjen”. *Asht harushane nuk dihet ku mbidhet as ku korret.* Ndeshet edhe shprehja: **Ku mbidhet nuk korret** “njeri jo i fjalës, njeri shumë i lëvizshëm si te fjala ashtu edhe te veprimet”.

KRIP/Ë,~A *Të don si krypën n sy*: “Nuk të don aspak”. *Të don si krypën n sy mos u merr me te maj.*

KRYQ,~TË *T’thajn n’kryq*: “Të dënojnë rëndë, paguan një shumë të madhe, sa nuk mund ta përballosh”. *T’gjobisin e t’thajn n’kryq me të kapë n’dru.*

KUMON/Ë,~A *I kanë vu kumonem*: “E tallin, e përqeshin”. *Nuk m shkon djali n shkoll ja ja kan vu kumonem ta:n katuni e nuk rrin kush me të”.*

KUNGULL,~I *Si me e pas shtryll prej kungullit*: “Pa mend në kokë”. *Beci e ka bas si me e pas shtryll prej kungullit.*

- LAK,~U** *Ma ka vu lakun n fyt* (për borxh). “Kërkon medoemos t’i ktheje atë që i ka marrë”. **Ma ka vu lakun n fyt**për borxh.
- LAK,~U** *Nuk ta pret lakun*: “Nuk ta kryen punën”. *Mos shko te filanja me i hyp gjë se nuk ta pret lakun.*
- LEPUR,~I** *Sa me metë lepuri mrenë*: “E punoi shkrifët kundrejt e punoi imël”.
E punoi tokën sa me metë lepuri mrenë ja baft zoti ballall lekun.
- LEPUR,~I** *Trim si lepuri e kamalec si gomari*: “Shumë frikacak dhe shërbëtor i dobët si gomari”.
- LESH,~I** *Lan lesh n të*“Bën çfarë të duash me të”. *Është i marrë lan lesh n’të*.**Lan lesh n’mu** më vjen hakut. *Jam e butë e lan lesh n’mu*. *Shyqyr si s’të kam gjet se kisha me la lesh n’ty* përdoret kur e zëmë ngushtë dikë, të kisha bërtitë. **Ka shku për lesh**= nuk i punon mendja, ka mbaruar si njeri. *Vallahi e bilahin për be:s të zotit njeshtu e di.*
- LLALLT/Ë,~A** *U ba llalltë*: “U mërzhit shumë”. **Ma ba kryt llalltë**, *tuj nej me t ma:rr tan ditën e lume.*
- LOP/Ë,~A** (I hap sytë) *si lopa n’brrakë*: “I hap kot, je e hutuar, lopa kur shkon me pi ujë i hap sytë shumë se mendon se po i mbarohet uji”. *Ça i hap sët si lopa n bra:k’.*
- LOP/Ë,~AI** *lëshon fja:lt si lopa baglën*: “Flet pa u menduar, e thotë a e bën diçka pa pasur parasysh se ku ndodhet a në ç’rrethana është, flet me vend e pa vend, pa i peshur fjalët; sillet pa përgjegjësi e pa u menduar fare”. Fjalë sinonime me shprehjen *e lëshon si pula glasën* (Thomai:391).
- LOP/Ë,~AJ** *Je ba si lopë venit*: “Je shëndoshur shumë nga trupi”. *Moj rri tuj hanger tan ditën je ba si lop venit.*
- LOP/Ë,~A***Lopa e qet tâmlin për gojet*: “Sa më shumë të ushqehet aq më shumë nxjerr qumësht”.
- LOP/Ë,~A***Me e ditë lopa pse ia napin ballgurin nuk e han*: “Shprehje popullore që përdoret për njerëzit që bëjnë një punë pa ditur pasojat e saj”.
- LOP/Ë,~A***Me ju sjellë si lopës pa viç*: “Me i shku sipas dëshirës”. *Është njeri që nuk merr vesht e dubet me ju sjellë si lopës pa viç*. **Ka nej si lopa pa viç.**
- LOP/Ë,~A***Si lopa n va:th*: “Në mënyrë të papastër”. *Çonu e pastroni nej gjë mos rrini si lopa n vath.*

LOP/Ë,~A *Si lopa në teqe*: “Më kanë blerë, jam martuar pa pajë”. *Më kanë marrë si lopë n’teqe kur jam martu.*

LUG/Ë,~A *E din luga ç’ka ka vegshi*: “Disa gjëra që nuk i di njeriu duke gërmuar i gjen”.

LUG/Ë,~A *Me lugë n’brez* ironi. “njeri koprrac”. *Gjelinat tona e kanë pas zakon që kur t vinte kush me vu lugen n brez mos me hanger gjinja shum ku gatujshin, e sot e tan ditën a shprehja mos rri me lug n brez.*

LUG/Ë,~A *Mos u myt një lugë ujë*: “Mos dështo një punë të lehtë, mos u lodh në një punë të vogël”.

LUG/Ë,~A *Pikë e lugë*: “Krejt e saktë, nuk ka dyshime”. *Djali ka të drejtë pikë e lugë. U:n po tham ça thot qitabi pik e lugë.*

MACE, ~JA *Ja han mica pshesht* (mospërfillje). “Është i ngathët, nuk di të bëjë asgjë”. Sinonime me shprehjen *sja man dora lugen*. *Qaj djali i vogel kujt i ka ngja ta po ja han mica pshesht.*

MACE, ~JA *Kanë lodrat e micave n’tavan*: “Bëjnë aheng”. *Mos u merr me ata rob se janë për serit kanë lodrat e micave n’tavan.*

MACE, ~JA *Rri si mica nën sofër*: “Njeri pa të drejta”. *Kur des burri ka de:ke ora, s ke vler ma rrin si mica nën sofër.*

MACE, ~JA *Shkojnë si mica me mine*: “Herë shkojnë mirë e herë shkojnë keq”. *Shkojnë si mica me minë.*

MACE, ~JA *Si mica nëpër ka:m*: “Sillesh kot pa efekt pune”. *Sillesh si mica nëpër ka:m.*

MACE,~JAI *preftë macja e zezë rrugë!* Mallkim që i bëhet një njeriu që është shumë tersli kur e takon në rrugë sidomos në mëngjes.

MARR *Marr mysish*: “Syri i keq i ka bërë dëm e ka hedhur përtokë”. *Vene i fije pshtym n goj se e kan marr djalin mysish.*

MENDJE,~A *E ka mendjen qefull*: “E ka mendjen të shëndoshë, e ka kujtesën në rregull”.

MENDJE,~A *I nxjerr fjalt si mica thonjtë*: “Tregon egërsi në mënyrë të papritur”.

MENDJE,~A *Ia ka ba menen*(mendjen) *pshesh*. Ironi.: “Ja ka ngatërru mendjen”. Sinonime me fjalën *ia bani menen çorap*.

MENDJE,~A *Ka dal me:ç*: “Është llastuar”. *Kjo ka dal me:ç prej smirash.*

MENDJE,~A *Kam marrë mend*: “Jam rritur”. *U njeshtu jam qysh se kam marr men nuk kam ndryshue asi fije për bes, jam bij konakut besa, jana rrit me ner e me erz.*

MENDJE,~A *T’ba me lujt meç* “Të çmend”. *Bija e tjetër kujt t’ba me lujt meç.* E ndeshim edhe në këngë: *Moj e mirë ça t qiti meç/buk pogaç e tamël dheç.* (Bajram Avdija, Kullaj).

MEZE,~T *T kam për meze*: “Të kam për gjënë më të mirë”. *T kam për meze ti je e mira e shpis tonë.*

MI,~US *’ka ça i han mini mas darket*: “Shumë i varfër”. *Mos i shkoni kot n shpi t shkretits’ka ça i han mini mas darket.*

MIZ/Ë,~A *E ban mizën ka*: “I zmadhon shumë gjërat, e paraqet diçka më të madhe se sa është”. Sinonime me shprehjen *e bën qimen tra*. *Hajt be bu:rr nuk âsht qeshtu mos e ban mizen ka.*

MIZ/Ë,~A *E din ku i ka miza syt*: “Është i zgjuar”. *E din ku i ka miza syt djali i filanit s’asht me i than babaxhan atij.*

MIZ/Ë,~A *I dogji miza n’ksulë*: “I hyri frika se mos zbulohet diçka që nuk dëshiron ta dinë të tjerët”. *Të dogji miza n’ksulë ça ke pse nuk flet.*

MIZ/Ë,~A *Mi hjek mizat*: “Duhet me më mbajtë, duke m’i zgjidh problemet”. *Edhe mu baba âtuj mi hjek mizat.*

MIZ/Ë,~A *Shizë e mizë*: “Me bollëk, pasuri e madhe. Thuhet zakonisht në rastin e të korrave të prodhimit kur banorët marrin shumë prodhim”. *E ka ba zoti shizë e mizë kana gjet grosh boll besa a ken sene kët vit e ka ba zoti misir.*

MIZ/Ë,~A *Si miza n qull*: “Një njeri që hyn në muhabet pa të thënë kush”. *Ke me:t si miza n qull.*

MIZ/Ë,~A *Si miza n’qull*: “Njeri qëi fut hundët kudo, aty ku nuk duhet dhe mbytet në fjalët e veta, njeri pa takt”. *Futet si miza n’qull.*

MIZ/Ë,~A *Si të pimë mizash*: “Të dobët”. *E ka fmi:n si të pimë mizash.*

MORR,~I *Si morri n’rrasht t’kre:s*: “Ngjitesh pas diçkaje më shumë se ç’duhet”. *Ça kapesht si morri n’rrasht t’kre:s.*

MUHABET,~I *Ka muhabet paragon*: “Një nieri i cili është shumë i drejtë, bisedon duke i bindur të gjithë me argument dhe baza të forta dhe të gjitha fjalët e tij qëndrojnë”. *Vallabi duket me shku me nigju Hysin seka muhabet paragon.*

- MUSHK,~A** *Mâs mushkës e para pushkës mos rri*: “Mushka gjuan shqelm e pushka të vret”.
- MUSHK,~U** *Nuk merr vesht me sa mushku*: “Është kokëfortë, nuk merr vesht”. *Kot po i thu qatij aj nuk merr vesht me sa mushku*.
- MUSHK/Ë,~A** *Ngul këmbë si mushka*: “Kokëfortë, kërkon diçka edhe kur nuk ka të drejtë”.
- MUSHK/Ë,~A** *Si mushka me kumonë*: “Plot e plotpërplot”. *U martua si mushka me kumonë*. Përdoret kur martohen vajzat që sjellin shumë pajë.
- MUSHK/Ë,~A** *Si mushka në ur*: “Mushka në urë këmbëngul e nuk lëviz vendit”. *Mos i ndreh ka:mt si mushka n u:r*.
- NAFAK/Ë,~A** *pre nafaka*: “Njeri i paaftë në të gjitha drejtimet”. Ndryshe në të folmen e kësaj krahine thuhet: ***I vramë oret***.
- NUSE,~JA** *Me një nuse zë dy dhëndra*: “Bëhet fjalë për një njeri që u premtonte dy personave të njëjtën gjë”. *Mos xen me një nuse dy dhendra se nuk i shkon për shtat njati konaku*.
- PËLLËMB/Ë,~A** *Asht një pllam mbi tokë*: “Është i vogël nga trupi”. *Ka met e shkurt një pllam mbi tokë. Sa kurrkushi një pllam mbi tokë*.
- PIK/Ë,~A** *Për pik: k t'piks*: “I shkathët, i zgjuar”. *Ky fmija asht për pik t'piks tpin gjak n'vetull*.
- PI TE,~JA** *As pite as simite*: “As kështu, as ashtu, njeri i pavendosur”. *Si venose nuk lehen gjanat ksbtu as pite as simite* sinonime me shprehjen: *as mish as peshkë*.
- PLESHT,~I** (Kcen) *si plesht dhish*: “Flet pa u menduar vend e pa vend dhe krejt papritur”. *Nale pak gojen mos kece si plesht dhish*.
- PRESH,~I** *Me presh në dorë*: “U zu duke vjedhur një material apo diçka tjetër”. *Boll u ruj filani po e kapen me presh n dorë, Zoti shef e njien*.
- PUL/Ë,~A** *Hup si shurra e pulës*: “Ka hup krejtësisht, nuk jemi takuar nuk jemi parë”. *Ke hup si shurra e pulës*.
- PUL/Ë,~A** *Ik moj pu:l se dy kâmt t'i kam ngul*: “Thuhet zakonisht nga nusja kur vjen në shtëpi dhe ngul rrënjë”. *Nusja i thot ik moj pül se dy kam t'i kam ngul*.
- PUL/Ë,~A** *Kur s'ke pula mos ban “ishsh”*: “Mos u përziej në punë që nuk të takojnë, mos ndërhyj në diçka që nuk ke lidhje”.

- PUL/Ë,~A** *Në shpi nuk kakarit pula, po kakarit gjeli*: “Në shtëpi nuk zotëron gruaja, por zotëron burri”.
- PUL/Ë,~A** *Si pula bërtet një orë për dhjetë lek që ban*: “Fjalë shumë e punë pak”. **Qaj është si pula bërtet një orë për dhjetë lek që bân**.
- PUL/Ë,~A** *Si pula pa krye*(mospërfillje). “Njeri pa mend, ec pa e ditur se ku po shkon”. *Shije mir rrugen ka t shkosh mo sec si pula pa krye*.
- PUL/Ë,~A** *Si pulë e lagun*. 1. mbeti pa fjalë, 2. rri në qoshe i vetmuar e pa fjalë. *Mbeti si pulë e lagun; mos rri si pulë e lagunose rrin si pulë e lagun*.
- PUN/Ë,~A** *E ka ba xhade kë të punë*: “E ka publiku, e ka ba të rrugës, e ka përsëritur disa here”.
- PUN/Ë,~AI** *merr punët maje*: “Punon në mënyrë të shkujdesur”. *Askush se fut n ar filanen se i merr punet maje e t met toka djerr*.
- PUSHK/Ë,~A** *Pushka top tu bafte!* “Bëj si të duash se unë nuk ndryshoj mendim apo veprim, këtu më ke dhe jam gati të vazhdojmë më tej, këtë që ke nisur. (ngatërresë).”
- PUT/Ë,~Ë** *Shkoi puta me nxjerrë brienat e la edhe veshhtë*.Fjalë e urtë. **Mos u bân si puta si ka shku me brienat e ka lan veshhtë**.
- PYK/Ë,~A** *Rrotë pyke* : “I trashë, njeri pa mend”. **Rrotë pyke që s’din gja**.
- QAF/Ë,~A** *Gratë e kanë qafën e shkurtë*: “Flasin shumë e nuk i përpunojnë fjalët”. **Gratë e kanë qafën e shkurtë** *Kush i nigjon ata*.
- QAF/Ë,~A** *O qafa o nafaka*: “O me shku o me guxu”. **O qafa o nafaka**.
- QEN,~I** *Haja qenit e pija qenit*: “Thuhet zakonisht për një person që ha e pi pa ia ditur për nder”. *Me hangër e me pi pa tu dhimë gja te personi që nuk e meriton burrërinë. Një person kot me hangër e me pi pa nder. Për një njeri që vjen shpesh thuhet haja qenit e pija qenit*.
- QEN,~I** *Ka shku si qeni n’rrush*: “Thuhet për një njeri që vritet në vend të një tjetri”. *Ka shku si qeni n’rrush si keje vojti*.
- QEN,~I** *Ka vu sënin e qenit n’ballë*: “I ka dalë turpi”, *nuk ka marre ka vu sënin e qenit n ball e s ja nep kujt i gur me ça kryt*.
- QEN,~I** *Nuk kam mish për qen*: “Nuk dua të futem në këtë telash se jam i humbur”. **Nuk kam mish për qen** *mu marrë me njasi punsh, kam fmite rrsbanë për tok me majt*.

- QEN,~I** *Po leh si qeni n'ha:n*: “Flet kot, por nuk mund të arrish asgjë”.
Po leh si qeni n'ha:ne nuk ta ven kush veshin.
- QEN,~I** *Qeni leh edhe ujku pjerdh*: “Flet kot se nuk të merr vesh kush, nuk të ka frigë askush”.
- QEN,~I** *S'ia han qeni shkopin*: “Është i zgjuar”. *A shu:m e sjut xhelina nuk ja han qeni shkopin qasaj.*
- QEN,~I** *Si qen zorrsh*: “Rrugaç”. *Ka nej tuj shëtit rrugash e ka met si qen zorrsh.*
- QEN,~I** *Yyy ti hangsh në gërnaç t'qenit* (Mallkim). “Nuk ke vlerë vetëm sa i qen”. *Yyy ti hangsh në gërnaç t'qenit* jarabin (Mallkim).
- QEP/Ë,~A** *A po mjell qep*: “A po më dëgjion”. *Puna e mar peep a je tuj mjell qep* kindemek *jam tuj fol po nuk je tuj m vu veshin.*
- QES f.** *I ka qit n fik*: “Bën shpërdorime të mëdha”. *Kjo maki:n i ka qit n fik* se barxhon shumë.
- QIME,~JA** *Më bjen qimja n dorse ta baj kët punë*: “Nuk ta bëj kurrë”. *Më bjen qimja n dor* se ta baj kët punë.
- QIME,~JA** *Si burri n shpi si qimja nëpër gojë*: “Është i tepërt”. *Kur e rrin burri n shpi t sillet si qimja nëpër gojë/ / kur e ke burrin n shpi t sillet nëpër kâ:m.*
- QULL,~I** *Nuk din me i fry qullit*: “Është i paditur”. *Ai njeri i paditun filani nuk din as me i fry qullit, si dubet gja kujt.*
- ROG/Ë,~A** *Pikë n'rogë*: “Vetëm pa njeri”. *Sot ka met pikë n'rogë/ / si e turitun/ / plak me ken asht ma mir se mos t'synoft i keqi.*
- RAH f.** *Je ba me t rrah n tpi*: “Je rritur shumë”. *Lumja u për njat sokol nanetâsht ba me e rrah n tpi.*
- RRAS/Ë,~A** *Gjen rrasa vegshin*: “Gjen tenxherja kapakun, thuhet për dy njerëz që janë njëlloj”. *Mos u mërçit se gjen rrasa vegshin.*
- RRIT** *Janë rrit n dallga*: “Janë rrit pa i munguar asgjë. Janë rrit me lezet dhe me lumturi pa e ditur se ç'është vuajtja”. *Janë rrit n dallga.*
- RRODHE,~JA** *Ma ba rrodhe*: “Më ngjitet pas, nuk më lë rehat, njeri që afrohet shumë për qëllime përfituese. *M vehet bisht mrapa si rrodhe. Ç'po kapesh si rrodhe.*
- SAMAR,~I** *Ja ka ndreqë samarin filanit*: “E ka rrahur mirë, i dha një mësim të mirë, ia mori hakun plotësisht”. *Ja ka ndreqë samarin filanit, ja dha i dorë t mirë.*

- SËPAT/Ë,~AI** *ka ra spata n mjaltë*: “Është bërë shumë rehat, ka rënë në një famijle shumë të mire”. **Të ka ra spata n mjaltë** *ku e gjete atë fat.*
- SHAT,~I** *Jo vetëm shat, por edhe lopatë*: Jo vetëm merr, por edhe duhet të japësh. *Mos ji jo vetëm shat, por edhe lopatë.*
- SHENDOSH** *Tumir e shnosh*: “Papritur”. *Des i shoqi tumir e shnosh tuj pi i kafe ka ken pa prit pa menue sja ka marr menja kujt se ka ken shnosh si kokërra e molls.*
- SHEQER,~I** *Sa qet zehër qit sheqer*: “Sa flet fjalën e keqe fol fjalën e mirë”. **Sa qet zehër qit sheqer** *moj bijë se e mira t vjen me t mirën.*
- SHERR,~I** **Molla e sherrit**: “Ngatërrestar. Shkak grindjeje e përçarjeje ndërmjet dy njerëzve”. Kur bëhet pak zhurmë thuhet **ka ken molla e sherrit**.
- SHKOZ/Ë,~A** **Të shkoftë shkoza për lug t shpins**: “Mallkim që i bëhet një njeriu të keq. Mallkimi shprehet me rrahje me thupër shkoze, e cila ka shumë rezistencë pa u thyer duke u përdorur”.
- SHOH f.** **Njî vjen me t qâ e njiqind vijnë me t pâ**: “Një vjen për të qarë hallin e njëqind vijnë për të bërë sehir”. *Maje pastër shpin se e ke plakun n der t vorrit se njî vjen me t qâ e njëqind vijnë me t pâ.*
- SHPATULL,~A** *E vë me shpatulla për mur*: “E detyroj me zor të bëjë diçka”. *T ven me shpatulla për mur po s nigjove me e bâ at pu:n.*
- SHPËRGAJ** *Si kanë tretë shpërgajt*: “Nuk është rritur akoma”. *Ti si ke hjek shpërgajt ala e rrin tuj folë.*
- SHPIN/Ë,~A** *Me ta bâ shpinën mâ t büt se barkun*: “E rrah shumë, sinonime me shprehjen **po ti fus dhāmt n gojë**”. *Me t rrah si me ta ba shpinen ma t but se barkun.*
- SHPIRT,~I** *Pa gja mas shpirtit*: “Të varfër shumë”. *Kana ken të shkuem n’goj t’varrit pa gja mas shpirtit / Fukara pa gja mas shpirtit, pa buken e gojs pre t’pa punet.*
- SHTANG,~U** *U bë shtang (dikush)*: “Ngrirë prej të ftohtit”. *Jam ngri e ba shtang pej t ftohtit. Qajo kishte vdek naten e ishte ba shtang.*
- SHTAT,~I** *S’i shkon për shtat*: “Nuk i ka hije ajo punë, ajo sjellje”. **S’i shkon për shtat** *qajo gja.*
- SHTOG,~U** *Si shtogu n’fekale*: “Rritet keq”. *Rritet si shtogu n’fekale.*

SY,~RI *E din ku i ka morri syt*: “Di gjithçka, është shumë e zgjuar”. **E din ku i ka morri sët** qajo vajzë besa.

SY,~RI *I bie sënit qerpik*: “Nuk mund të bësh asgjë pa urdhër të zotit”.
Erdh e lypj boll bukur/ / nuk mun i bish sënit qerpik/ / pa urdhën t’zotit.

SY,~RII *kan xan syt lesh*: “Nuk shikon veprimet që ndodhin përpara tij”.
Tanë gjinja flasin për t shoqen e t shoqiti kan xan sët lesh.

SY,~RI *I kan xan sët (syt) perde*: “Është verbuar e nuk e sheh se çfarë po i bëjnë, nuk e sheh të keqen që i kanoset nga afër. **I kan xan sët (syt) perde** e se shesh ça ndodh rreth tij.

SY,~RI *Me sy çilë*: “E mirëpritur”: *Shaj qukulokes ktu, rri n’shpi tane, sa t’kemi vllanë ktu vini me së (sy) çilë itho:n bij sa ke t vllan ke derën çil, vjen me sy çilë.*

SY,~RI *Si ban sëni vek*: “Nuk trembet fare”. *Mora me i rrejtë fmit e nuses se ka xhin jashtë mos me dal se ftofen po nuk u ban sëni vek.*

TEL,~I. *Je bâ si me pa hângër tel*: “Njeri shumë i dobët, je dobësuar shumë”.
Ça e ka gjet djalin e Brahimit që a ba si me pa hângër tel, qvaja nana për te.

THERR/Ë,~AJ *u bë therra Brahim*: “Dyshon shumë”. *Na lodhi shumë qaj djalë me atë muhabet ju bë therra Brahim.*

THIK/Ë~A *Shkojnë thikë e briskme njëri –tjetrin*: “Kanë mosmarrëveshje të mëdha me njëri tjetrin, grinden zihen shumë”. **Shkojnë thikë e briskme njëri –tjetrin.**

THUA/THONI *Me lanë thojt n te*: “Shumë e shijshme”. *Ke marrë një kungull e ke gri n’brushë, i kena qit pak oris e pak sheqer e kena qit pak miell grunit e kena pjekë e lakuriqi ka dalë si me lanë thojtë n’të.=i shijshëm.*

TOK,~Ë *Prush për tokë*: “Shumë të vegjël dhe nën moshë”. *Tan fmit i kanë prush për tokë, e nuk munet me dal te dera.*

TYM,~I *Si me na pa tha m’ tym*: “Njeri i dobët”. *Ësht aq e do:bt si me e pa tha: n tym.*

UJ/Ë,~I *Nuk ia trazon ujt kuj*: “Është njeri i butë, nuk përzihet në punët e të tjerëve”. *Aj njëri që nuk ja turbullon ujt kujt ban sabër.*

UJ/Ë,~I *Se ka vu ujt n’zjerm*: “Nuk e ka nis aspak”. *Se ka vu ujt n’zjerm për at’ punë.*

- UJ/Ë,~I** *T'çon me pi ujë e të len pa pi*: “Njeri i zgjuar”. *Skenderi t'çon me pi ujë e të len pa pi duket i but qashtu po á i meçem boll besa.*
- UJË,~II** *ka ardhë ujë me blua*: “Ka krijuar mundësi të mira, kushte të mira, ka patur fat”. *Sa me fat me ken aj djal i erdh uje me blua.*
- ULLI,~RI** *Vujti t'zjtë e ullinit*: “Vuajtja shumë”. *U vujta t'zjtë e ullinit n'shkollë tuj bajt drutë n'shkollë.*
- VAJ,~I** *E rrahun me vaj e me ufull*: “E zgjuar, njeri i kalitur me prova të ndryshme në jetë”. *Ásht bija e Sebijes e rrahun 99 herë me vaj, e rrahun me vaj e me ufull femutja na solli i kile pjesbka.*
- VEZH,~IE** *ka veshin cingare*: “dëgjon shumë”. *Ruaju qati njieri se e ka veshin cingare, e ti merr vesh mileti punt e shpisë tane.*
- VEZH,~I** *Vesh m'vesh*: “Duke qeshur, në të gjithë fytyrën nga njëri vesh te tjetri, me kënaqësi të madhe”. *I ka shku goja vesh m'vesh duke qeshur.*
- VEZ/Ë,~A** *Si vö skllukë*: “Qyqe, e ngathët në punët e shtëpisë”. *Qajo femën ásht si vö skllukë.*
- VEZ/Ë,~A** *Ta nep vón pa t kuq*: “Është dorështërnguar, është shumë koprrace”. *Ta nep vón pa t kuq e s ke pse i shkon n konak qasaj.*
- VEZ/Ë,~A** *Vón për vó sta rron*: “Koprrac, dorështërnguar”. *Ásht harrijats ta nep një gur me ca kryt, vón për vó s ta rron.*
- VRIM/Ë,~A** *Mos hap vrima n ujë*: “Mos fol kot, mos fol pa vlerë, kjo është gjë e paarritshme”. *Mos hap vrima n ujë se nuk bahet qaja gjá.*
- XHIND,~I** *Ka shkel n xhin*: “Xhindi është një qenie e padukshme që të dëmton, thuhet zakonisht për njerëzit që humbasin mendjen”. *Nuk m duket se e kam djalin mi:r ka shkel n xhinlet me veti ta:n ditën.*
- XHINGËL,~A** *Xhingla-mingla*: “Punë boshe, gjëra të vogla, punë kote”. *Mos u merr me xhingla-mingla.*
- ZAGAR,~I** *Zagar rrugësh*: “Njeri i poshtër, pa dinjitet, pi zakonisht lokaleve dhe kthehet vonë në shtëpi. Burrë a djalë që sillet rrugëve kot dhe bredh pas femrave; rrugaç”. (Domën). *Mos u merr me qatzagar rrugash*
- ZËR,~I** *Merrke zani dhenë*: “U përhap fjala”. *Me dal me u than katunit merrke zani dhene/i ka le fílanit fmija.*
- ZOG,~U** *Si zog gomari*: “Njeri i llastuar”. *Hajt be dreq si me ken zog gomari, tuj u rrit e tuj u çorodit si zogu i gomarit.*

ZOG,~U *Ma mirë i zog n dor se një qind n hava*: “Më mirë të marrësh sot se çfarë të takon se me pritë diçka që nuk do të vijë kurrë”. **Ma mirë i zog n dor se një qind n hava**.

ZORR/Ë,~A *Puf si zorra n’prush*: “Thuhet zakonisht për njerëzit që janë gjaknxehtë e nuk pranojnë logjikë sinonime mos puf si *gshteja n’zjerm*”. **Mos puf si zorra n’prush!**

ZOT,~I *E ka ba zoti misir*: “Ka mbajtë shumë, thuhet zakonisht në rastin e të mbjellave kur bujqit nxjerrin prodhime të mëdha, të shumta”. *A keni gjet prodhim shu:m këtë vit, -besa boll e ka ba zoti misir, ja paçim ba zotit shyqyrin*.

ZOT,~I *I ka dhanë zoti bereqet*: “I ka dhanë zoti pasuri, prodhim”. Ndeshtet si urim. **T dhasht zoti bereqet!**

ZOT,~I *Ia shti zoti n’shteg*: “Ia kujton”. *Ia shti zoti n’shteg me dit kur ta njëën*.

Bibliografia:

1. AA VV, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, bot. i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), Tiranë, 1980.
2. Hajri Shehu, *Studime për leksikun dhe leksikografinë shqipe*, Tiranë, 2015.
3. Jani Thomai, *Leksikologji e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.
4. Jani Thomai, *Frazeologjia e gjuhës shqipe dhe vlerat e saj*, “Teksti dhe gjuha”, Tiranë, 1999, f.148.
5. Jani Thomai, *Aspekti shoqëror-kulturor në formimin e frazeologjisë shqipe*, «Studime filologjike» nr. 3, 1975, f.111-119.
6. Jani Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë 1981.
7. Jani Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë 2010.
8. Jani Thomai, *Studime për gjuhën shqipe*, II (Frazeologjia gjuhësore), Tiranë, 2017.
9. Shefkije Islamaj, *Sinonimia frazeologjike në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike» nr. 4, 1986, f. 119-123.

10. Thanas Feka, *Pasuria frazeologjike në krijimtarinë letrare të Martin Camajt* botuar në Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare 24 shtator 2010 “Martin Camaj në kulturën shqiptare me rastin e 85 -vjetorit të lindjes”, botuar Tiranë, 2015, f. 272.
11. Valter Memisha, *Studime për fjalën shqipe I*, Tiranë, 2011.

Mjellma ZHARA

BILINGUALIZMI SHQIP–TURQISHT NË QYTETIN E PRIZRENIT

Abstrakt

Bilinguizimi shqip–turqisht dhe shpjegimi i disa dukurive të tij, si: përzierja e kodit, të huazuarit dhe zëvendësimi i kodit, përbëjnë objektin e këtij punimi. Punimi është realizuar në terren dhe ka zgjatur nga data 24 nëntor deri më 27 nëntor 2017 me gjithsej 100 të anketuar. Sa i përket mënyrës së anketimit pjesa më e madhe kanë qenë mostra të rastit. Të anketuarit kryesisht kanë qenë studentë dhe të punësuar të fushave të ndryshme. Punimi është realizuar në atë mënyrë që të verifikojmë se sa flitet gjuha turke nga shqipfolësit në qytetin e Prizrenit. Gjithashtu, kemi dashur të shohim se sa i shpeshtë është komunikimi i folësve të shqipes me ata të gjuhës turke dhe jemi munduar të kuptojmë se në cilat domene i zhvillojnë këto kontakte. Një gjë tjetër që ka shfaqur interesim ka qenë edhe përdorimi i kodit konkretisht ajo se cilin kod do ta përdornin folësit e shqipes gjatë komunikimit me një folës të turqishtes. Jo më pak e rëndësishme është shkalla e ndikimit të gjuhës turke në ditët e sotme në breza të ndryshëm, me nivele të ndryshme arsimimi si dhe qëndrimi i të anketuarve ndaj gjuhës turke.

Fjalët kyçe: *bilinguizmi, zëvendësimi i kodit, të huazuarit intim, përzierja e kodit, ndërndikimi.*

Abstract

This paper aims at describing the code shifting, code switching and code copying along with loanwords among Albanian – Turkish bilinguals

in the Prizren area. The data were collected in a fieldwork conducted in November 2017 with a total of 100 respondents. Data were stratified according to speakers social background and identity. Data interpretation showed clear patterns of audience design and register. Code switching and code shifting were based on the audience, topic of the conversation and participants roles. The identity of an individual was represented through evocative style. Turkish elements among Albanian speakers in Prizren mostly evoke citizen elements, but religious element is also present. Data have also shown presence of Slavic loanwords which are due to the Slavic influence until 1999.

Key words: *bilingualism, code shifting, register, audience design, loanwords.*

Synimi i këtij punimi është të përshkruajë mekanizmat e përzierjeve të kodit gjuhësor të folësit bilingë në qytetin e Prizrenit.

Qyteti i Prizrenit njihet si një qytet që ka popullatë të përzier në pikëpamje etnike dhe fetare, ndërsa turqishtja si gjuhë e amvisërisë ka shërbyer si shënjeshtëri i dallimit shoqëror qytetar–fshatar.

Për nevoja të këtij punimi, jemi përpjekur ta marrim një përkufizim të thjeshtuar të termit.

I pari që e ka përkufizuar bilingualizmin ka qenë Bloomfield (1935), i cili mendon se bilingu duhet të ketë njohuri thuajse native të të dyja gjuhëve. Këtë e relativizojnë fillimisht Weinrich (1953) dhe më pas Mackey (1957) që bilinguizmin e shohin si përdorim të shkëmbyeshëm të dy a më shumë gjuhëve nga i njëjti individ. Hockett (1958) sjell termin semillingë për përdorimin jo të barabartë të dy gjuhëve, term ky që kundërshtohet nga Doria (1983) që fut termin bilingë marginalë.

Beardstone (2016) sjell termat bilingë receptivë dhe bilingë produktivë varësisht nga shkalla e aftësitë prodhuese në gjuhë, ndërsa Fitou (1983) flet për bilingë bikulturalë dhe monokulturalë.

Sipas Hudsonit (2002), zëvendësimi i kodit është rrjedhim i paevitueshëm i bilinguizmit ku folësi zgjedh mes gjuhëve në përshtatje me rrethanat dhe patjetër bëhet zgjedhja në bazë të asaj se cila do të jetë më e kuptueshme për bashkëbiseduesin.

Në studimin tonë jemi përqendruar në bilingualizmin shqip–turqisht, ndonëse një studim më i gjerë do të përfshinte edhe sllavishten.

Për kontaktet dhe ndikimin e turqishtes në shqipen ka pasur studime të shumta. Meyeri (1891) sheh 5000 fjalë të turqishtes në shqipen, ndërsa ndër studimet më të detajuara që shpjegojnë ato fjalë në shqipen ofron Boretzky (1975). Studimet të ngjashme kanë ofruar edhe Çabej (1975), L. Mulaku (1977), Kostallari (1978), Polisi (2006), Morina (2008). Lindita Xhanari (2012) ka ofruar një listë fjalësh, por nuk ka përfshirë shqipen kolokuiale të Kosoëvs, ndërsa Dizdari (2005) ka përpiluar një fjalor me afër 5000 fjalë orientale në gjuhën shqipe.

Anila Omari (2014) ka ofruar një regjistër të fjalëve turke sipas periudhave, sipas dokumentimit të tyre të autorët e vjetër. Jashar-Nasteva

(2001) e Friedman (2012) krahas Boretzky-t kanë ofruar një sfond më të gjerë ballkanik të turqizimave – pra në gjuhët e Ballkanit.

Për ndikimin e turqishtes në serbishten e Prizrenit kanë shkruar Irfan Morina (1987) dhe së fundi Svetlana Petroviq (2012).

Lindita Sejdiu-Rugova (2017) ka një punim për fushat e përdorimit të turqizimave në gjuhën shqipe.

Përdorimi i këtyre gjuhëve ka ndryshuar ndër vite, me ç'rast gjatë pushtimit otoman turqishtja ka qenë gjuhë dominante kundrejt shqipes e serbishtes, dominimi i së cilës është vërejtur më shumë në zonat e qyteteve gjë e cila vërehet edhe sot e kjo sipas Vehbiu (2014).

Sipas Demirajt (2012), kontaktet e shqipes me turqishten kanë filluar në gjysmën e dytë të shekullit XIV për të arritur kulmin e ndikimit në shqipe përgjatë shekujve XVII–XVIII, mirëpo ndikimi i saj filloi të dobësohej në gjysmën e dytë të shekullit XIX, kohë në të cilën filloi të vepronte lëvizja kombëtare shqiptare dhe lëvizja për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës.

Sipas Vehbiut (2014), qytetet më të prekura të asaj kohe nga përdorimi i turqishtes si gjuhë qyteti kanë qenë Shkodra, Berati, Elbasani e Gjirokastra. Në Kosovë, turqishtja, pos Prizrenit, është folur si shënues qytetarie në Pejë, Gjiilan, Prishtinë, Vushtri, - në vilajetin e Kosovës edhe në Shkup, Preshevë e kështu me radhë.

Sa i përket Prizrenit, aty luan rol edhe identiteti. Shpesh brenda së njëjtës familje ka identifikime të ndryshme: turk ose shqiptar. Kjo është shprehur edhe në deklaratimet e popullatës – në censuse.

Sipas të dhënave demografike në vitin 1991, në Prizren kanë jetuar 7.227 turq, në vitin 1998 12.250, numër i cili mbeti i pandryshueshëm deri në janar të vitit 2000, si dhe në mars të vitit 2001, mirëpo gjendja ndryshoi në maj të vitit 2002 duke pësuar një rënie nga 12.250 në 11.965, përderisa të dhënat e dhjetorit të vitit 2002 tregojnë një ngritje të sërishme, ku tanimë në Prizren kishte 14.050 turq, të dhëna këto sipas (Komuna e Prizrenit).

Sot, turqishtja, si gjuhë e popullatës me mbi 5 përqind në komunë, ka status zyrtar në qytetin e Prizrenit, që nënkupton përdorimin e detyrueshëm publik të saj.

Në këtë punim do të përdorim termin huazim, por do të mbështetemi në teorinë e Lars Johanssonit (2012) për kopjimin e kodit.

Johanssoni i kundërshton termat huazim e transfer, duke thënë se nuk janë metafora të përshtatshme gjuhësore (pra, nuk është dakord me termat e Haugenit e të Bloomfieldit). Sipas tij, një element që hyn nga një gjuhë në tjetrën nuk është huazim, sepse ai element: 1. Nuk është kurrë identik me atë të gjuhës prej nga është marrë dhe 2. Elementi i futur vazhdon të qëndrojë në gjuhën e parë. Po të ishte huazim ai nuk do të ishte më në gjuhën e parë. Pra, kur ia huazojmë dikujt një libër, ai nuk do ta ketë librin, derisa ia kthejmë.

Johansson përdor termin kopjim, të cilin e ndan në kopjim global – që janë njësitë më të plota (fjalë të tëra, trajta gramatikore si –llarrë në turqishten për shumës) dhe kopjim selektiv që janë më shumë kallet. Shembull: mos shih kusur (Kusura bakma) – lidhet me nocionin biling monokulturor.

Në vazhdim do të tregojmë situata, kur folës bilingë të turqishtes bëjnë kalime kodesh nga njëra gjuhë në tjetrën, duke realizuar atë që Hudson (2002) e quan përzierje e kodit.

Çok güclü bu gruba muzikore. Nëse hasim në raste të krijimit të fjalive të tilla, atëherë kemi të bëjmë me përzierje të kodit, me ç’rast bilingu në mënyrë të pavetëdijshme, për ta mbushur boshllëkun në njërën apo tjetrën gjuhë, bën një përzierje të tillë.

Ky punim është realizuar duke u mbështetur në punën në terren. Hulumtimi është kryer nga data 24 nëntor deri më 27 nëntor 2017. Sa i përket mënyrës së anketimit pjesa më e madhe kanë qenë mostra të rastit. Të anketuarit kryesisht kanë qenë studentë dhe të punësuar të fushave të ndryshme. Gjithsej të anketuar kanë qenë 100 nga ta 54 meshkuj dhe 46 femra, mosha e të cilëve ka qenë nga 13–80.

Hulumtimi ka qenë i fokusuar në qytetin e Prizrenit, duke pasur parasysh se gjuha turke këtu flitet me një intensitet më të madh. Gjatë hulumtimit kemi marrë informata edhe për gjininë, moshën dhe profesionin. Të anketuarve u është bërë e ditur se anketimi është kryer për qëllime studimi dhe se të dhënat e tyre do të mbeten e drejtë e autorit të studimit.

Pyetjet e hartuara kryesisht kanë qenë të mbyllura me një numër të vogël prej atyre të hapurave, në të cilat të anketuarit kanë pasur mundësi që të japin opinionet e tyre. Kryesisht anketat janë plotësuar nga respondentët, përveç në raste të caktuara kur është kërkuar ndërhyrje, gjithashtu atyre u janë dhënë sqarime për paqartësi. Anketimi ka pasur për qëllim që të hetojë opinionet e të anketuarve lidhur me bilinguizmin shqip–turqisht e sidomos lidhur me përhapjen e gjuhës turke.

Meqë synimi ynë ka qenë hetimi i jetëgjatësisë së gjuhës turke, denduria dhe përdorimi i saj, atëherë për kryerjen e anketimit jemi fokusuar në vende ku folësit edhe kryejnë më shumë ndërveprime gjuhësore mes vete qofshin ato domene ku ata kalojnë kohën e lirë me të tjerët, qofshin ato domene ku ata kryejnë aktivitete të ndryshme, gjithashtu kemi qenë të fokusuar edhe në lagjet ku dominon më shumë gjuha turke, me ç'rast kemi hasur edhe në familje të cilët janë të regjistruar si turq. Kështu, gjatë anketimit ne kemi vizituar lagjet Kurillë, Tabahane (Tabakhane), Jeni Mëhallë (Mëhalla e re), lagjen e Marashit, Shatërvanin, Ortakollin etj., dhe, përveç këtyre lagjeve, ne kemi vizituar edhe dyqane, kafene, pastiçeri e shkolla të ndryshme.

Rezultatet e hulumtimit

Me qëllim që të merren të dhëna më të detajuara, të anketuarve u janë shtruar 20 pyetje, përfshirë edhe nga ato personale, si niveli i arsimimit, profesioni etj. Me qëllim që të vërehet sa më qartë ndikimi i gjuhës turke në atë shqipe në folës të brezave të ndryshëm, ne jemi munduar që të jemi sa më gjithpërfshirës duke anketuar kështu folës të moshave të ndryshme. Kështu, mosha e tyre përkon si më poshtë:

I 13 – 20

II 20 – 40

III 40 – 60

IV 60 – 80.

Të anketuarit u takojnë nacionaliteteve të ndryshme prej të cilëve 74 apo 74% i takojnë nacionalitetit shqiptar, 21 apo 21% atij turk dhe 5 apo 5% u takojnë nacionaliteteve të tjera, prej të cilëve 3 apo 3% romë dhe 2 apo 2% boshnjakë. Duke pasur parasysh se të anketuarit e

praktikojnë turqishten në domene të ndryshme dhe se 30 apo 30% prej tyre e kanë mësuar në të njëjtën kohë me shqipen, atyre u është shtruar pyetja: Cila është gjuha superiore (mbizoëruese) për ju?, për 63 apo 63% nga të anketuarit gjuhë superiore është shqipja, kurse 37 apo 37% nga ta gjuhë superiore kanë turqishten. Për të parë se prej cilës moshë fillon përvetësimi i gjuhës turke te shqipfolësit, ne atyre u kemi shtruar pyetjen: Prej cilës moshë e flisni turqishten?, 30 apo 30% nga ta janë përgjigjur që e kanë mësuar në të njëjtën kohë me shqipen, kurse 70 apo 70% nga ata e kanë mësuar nga mosha të ndryshme. Në pyetjen: Në çfarë niveli e njihni turqishten?, të anketuarit kanë dhënë këto përgjigje:

- Sa për t'u kuptuar – 6 apo 6%
- Mirë – 21 apo 21%
- Shumë mirë – 73 apo 73%.

Për të parë nëse shqipfolësit e përdorin turqishten në ambiente familjare, ne i kemi pyetur të anketuarit: Cilën nga gjuhët e flisni më shpesh në shtëpi?, 49 apo 49% nga ta kanë thënë shqipen, 40 apo 40% turqishten dhe 11 apo 11% nga ta i flasin të dyja gjuhët, ndërsa në të shkruar 62 apo 62% e përdorin shqipen, 10 apo 10% turqishten dhe 28 apo 28% të dyja. Nga këto të dhëna shihet qartë se dygjuhësia në Prizren zbatohet mjaft shumë dhe ka ndikuar në numër të konsiderueshëm të popullsisë së Prizrenit, duke qenë se ajo thuhet përdoret në përqindje të përafërt me shqipen në ambiente familjare.

Duke qenë se ndikimi i kësaj gjuhe ka arritur në të gjithë brezat, atëherë është e logjikshme që ajo edhe përdoret në sfera të ndryshme të jetës, andaj, për të kuptuar dendësinë e përdorimit të kësaj gjuhe, ne u kemi shtruar atyre pyetjen: Cilat janë domenet (fushat) në të cilat e përdorni turqishten?, përgjigjet e të cilëve vijnë si më poshtë: shtëpi, shkollë, rrugë, lagje, në ambiente pune, me shoqëri. Në pyetjen Sa mendoni se ju shërben turqishtja për t'u punësuar?, 18 ose 18% janë përgjigjur me shumë, 32 apo 32% mesatarisht, 33 apo 33% pak dhe 17 apo 17% aspak. Kur pyeten Çfarë mendimi keni për gjuhën turke?, 85 apo 85% nga ta thonë se kanë mendim pozitiv për këtë gjuhë, kurse 15 apo 15% përgjigjen duke thënë që s'kanë asnjë mendim. Në pyetjen: A do të dëshironit që gjeneratat e ardhshme ta mësonin turqishten?, 90 apo

90% nga ta përgjigjen me po, kurse 10 apo 10% me jo. Arsyeja përse 90 nga të anketuarit dëshirojnë që turqishtja të përcillet në brezat e ardhshëm është se “Gjuha është pasuri”, ndërsa pjesa e mbetur apo 10 nga të anketuarit nuk duan që gjuha turke të përcillet, pasi, sipas tyre, “Gjuha turke është imponim dhe është gjuhë e mbetur nga prindërit”.

Kur dy bilingvë të zhdërvjellët flasin në mes vete, ndryshojnë gjuhën pa u vënë re në situatë. Kjo dukuri është e pranishme edhe në qytetin e Prizrenit e që e kemi rastisur gjatë anketimit. Respondentëve u është kërkuar që të krijojnë fjali duke bërë përzierjen e këtyre dy gjuhëve. Mirëpo duhet cekur se vetëm 44 apo 44% kanë ndërtuar fjalitë, 39 apo 39% nga respondentët nuk kanë dhënë përgjigje sa i përket krijimit të fjalive, 14 apo 14% nga ta kanë dhënë përgjigje të gabuara dhe 3 apo 3% të tjerë kanë pohuar se nuk bëjnë një përzierje të tillë. Bazuar në rezultate, del që kjo përzierje bëhet në mënyrë të pavetëdijshme, duke qenë se, kur u kërkohet të bëjnë një përzierje të tillë, ata nuk ia dalin dot, sepse nuk u kujtohet ndonjë shembull konkret, por në të folur një përzierje të tillë e bëjnë pa asnjë pengesë. O karancanın *shoqesi. Gittim opshtinaja alma vërtetim. Gidiyoruz mbledhjeje bu gün aliyoruz notalari Ajo babi yt, shumë mirë po flas turqishten!* Nga shembujt e dhënë më sipër vërehet se pos dygjuhësisë qytetarët e Prizrenit me raste i karakterizon edhe shumëgjuhësia, meqë ata janë të prirë që të fusin brenda fjalisë edhe fjalë nga gjuha serbe, në të njëjtën kohë që ata përdorin edhe fjalë të gjuhës shqipe dhe asaj turke. Përveç kësaj, në fjalinë e fundit vërehet qartë se ata kanë tendencë që të bëjnë edhe gabime gramatikore, si p.sh. të ngatërrojnë gjininë dhe vetën. Gjithashtu, gjatë anketimit është vërejtur se fjalët e shqipes në të shumtën e rasteve i shqiptojnë me ton të gjuhës turke.

Në pyetjen: *Pse mendoni se ndodh kejo përzierje?*, respondentët si shkak kryesor e kanë parë “ekzistimin dhe përdorimin e këtyre gjuhëve njëherësh”.

Sa i përket asaj se nëse do ta takonin një folës gjuha amtare e të cilit është turqishtja si do t'i drejtoheshin, 41 apo 41% do t'i drejtoheshin në gjuhën shqipe, kurse 59 apo 59% në gjuhën turke.

Sa i përket dukurisë së përzierjes së kodit, ne edhe këtë e kemi hasur, mirëpo disa nga të anketuarit kanë ndërtuar disa fjali të përziera të cilat i

përdorin apo i dëgjojnë më së shpeshti e që brenda tyre ka edhe elemente nga gjuhët sllave, kurse pjesa tjetër e të anketuarve që nuk kanë dhënë përgjigje na ka çuar drejt asaj se ata këtë përzierje e bëjnë në mënyrë të pavetëdijshme e sidomos gjatë bashkëbisedimit. P.sh., këtë e kemi vërtetuar, kur një të anketuarë i kemi kërkuar që të krijojë një përzierje të tillë, ajo ka pohuar se nuk po i kujtohet, mirëpo, pas një kohe të shkurtër, në mënyrë të pavetëdijshme, ajo i është drejtuar fëmijës së saj “ah mori anam po t’shkel kerri”.

Si përfundim, nga tërë të dhënat e nxjerra del se ndikimi i gjuhës turke nuk është se ka rënë, përkundrazi ai çdo herë e më shumë po rritet sidomos në brezat e rinj, pasi gjuha turke edhe mësohet në kuadër të disa shkollave në Prizren. Ky ndikim do të jetë vështirë i evitueshëm, pasi folësit kanë ndërveprim të vazhdueshëm qoftë në nivelin arsimor, qoftë në lagje apo përmes kontakteve të drejtpërdrejta me turqit, duke qenë se ata kryejnë një sërë aktivitetesh në këtë qytet. Sa i përket mësimin të gjuhës turke, disa kanë pohuar se ajo u është imponuar, kurse, sa u përket prindërve, ata janë të kënaqur që fëmijët e tyre e zotërojnë edhe gjuhën turke, sepse, sipas tyre, gjuhët janë pasuri dhe do t’u shërbejnë atyre në shumë sfera të ndryshme të jetës qoftë në punësim, apo shkollim.

Bibliografia:

1. Blumfeld L. (1990) Të huazuarit intim. Në: Vesel Nuhiu *Ndikimet ndërghjuhësore*. Prishtinë: Rilindja.
2. Bufli Gj. *Interlinguistic phenomena in Albanian Turkisms*, artiukull reviste.
3. Demiraj Sh. (2002). *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. Rilindja. Prishtinë.
4. Ferguson Charles. A. (1996). *Sociolinguistic perspectives*. Edited by Thom Huebner. Oxford University Press. New York.
5. Fishman J (1990) Raporti në mes mikro–sociolinguistikës dhe makro–sociolinguistikës në studimin kush flet cilën gjuhë me

- kënd dhe kur. Në: Vesel Nuhiu *Ndikimet ndërgjuhësore*. Prishtinë: Rilindja.
6. Fishman J. (1965) *Who speaks what language to whom and when*. Në: Journal of social issues, vol.23, nr.2. Yeshiva University.
 7. Haspelmath M. *Aspects of Language Contact: Loanword typology: Steps toward a systematic cross – linguistic study of lexical borrowability*, Edited by Thomas Stolz, Dik Bakker and Rosa Salas Palomo. New York.
 8. Haugen E. (1990) *Analiza e të huazuarit gjuhësor*. Në: Vesel Nuhiu *Ndikimet ndërgjuhësore*. Prishtinë: Rilindja.
 9. Holmes J. (2015). *Hyrje në sociolinguistikë. (Përktheu Kristina Jorgaqi)*. Pegi. Tiranë.
 10. Hudson R. (2002). *Sociolinguistika. (Përktheu Mariana Ymeri)*. Dituria. Tiranë.
 11. Kadiu S. (2014). *Tipologjia e fjalëformimit në gjuhën turke dhe në gjuhën shqipe*, disertacion i doktoratës. Universiteti i Tiranës. Tiranë.
 12. Kajana M., Godeni J. (2013). *Turkish loanwords in Albanian language*, artikull reviste, Linelt.
 13. Lyons J. (2001). *Hyrje në gjuhësinë teorike. (Përktheu Ethem Likaj)*. Dituria. Tiranë.
 14. Meki U. (1990) *Dyguhësia individuale*. Në Vesel Nuhiu *Ndikimet ndërgjuhësore*. Prishtinë: Rilindja.
 15. Munishi Sh. (2009). *Barazja e gjuhëve në Kosovë dhe prespektiva evropiane*, kumtesë e lexuar në Kongresin e Parë Ballkanik (në botim), maj, Prishtinë.
 16. Munishi Sh. (2009). *Planifikimi i statusit të gjuhëve në Kosovë*, sesion shkencor, Art Club. Ulqin.
 17. Nagel Olga V., Temnikova Irina G., Wylie J & Koksharova Natalia F (2015). *Functional Bilingualism: Definition and Ways of Assessment*. Tomsk Polytechnic University. Russia.
 18. Najvirtova A., Burema L. *Assesing Minority Language Rights in Kosovo*.

19. Rugova B. (2011). Pozita dhe statusi i shqipes kundruall gjuhëve të tjera të ballkanit. Në: *Shqipja dhe gjuhët e ballkanit*. ASHAK. Prishtinë.
Shih në:
https://www.ashak.org/repository/docs/SHQIPJA_DHE_GJUHET_E_BALLKANIT_-_Konferenca_shkencore_659049.pdf, qasja për herë të fundit më 7 tetor 2018.
20. Sejdiu, Rugova L. (2017). *The formal and informal status of Turkish loan words in Albanian*. Trakya Universitesi. Edirne.
Shih në:
http://www.academia.edu/31092904/VERSCHIEDENE_KULTUREN_ÄHNLICHE_JUGENDPROBLEME-ZWEI_ROMANE_AUS_DER_PROBLEMORIENTIERTEN_JUGENDLITERAT, qasja për herë të fundit më 7 tetor 2018.
21. Shukriu M. (2001). Prizreni i lashtë – *Morfologjia e ecurive për ruajtjen e kulturës materiale*. Prizren.
22. Vehbiu A. (2014). *Turqizmat në shqipe, pse nuk u zhdukën*.
23. Xhanari, Latifi A. (2016). *Vëçori të shqipes së shqiptarëve të Turqisë përmes fjalorëve dygjuhësh të studiuesit me origjinë shqiptare Necip Alban*. Fakulteti i Filologjisë. Prishtinë.

Korpusi:

1. Shih në:
https://sq.m.wikipedia.org/wiki/Komuna_e_Prizrenit, qasja për herë të fundit më 16 shtator 2018.
2. Shih në:
https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuha_turke, qasja për herë të fundit më 23 shtator 2018.
3. Shih në:

<https://kk-arkiva.rks-gov.net/prizren/City-guide/Geography.aspx>, qasja për herë të fundit më 23 shtator 2018.

Senad NEZIRI

VARIANTET AKTUALE TË SHQIPES NË PRIZREN E RRETHINË

Abstrakt

Bartja ose shpërngulja e popullatës nga një zonë në një zonë tjetër është faktor kryesor i bartjes së tipareve folëse në atë zonë ku individi, familja, grupi i një zone folëse vendosen për banim ose për të jetuar e punuar. Zonë e tillë është regjioni i Prizrenit me rrethinë, ku gravitojnë disa etni, por edhe disa varietete të së njëjtës gjuhë, arsyeja që na ka frymëzuar të hulumtojmë gjendjen dhe përshkrimin e varieteteve folëse aktuale të shqipes në këtë zonë të Prizrenit.

Në kumtesën tonë, me të cilën planifikojmë të paraqitemi në këtë seminar (38), do të mundohemi ta sqarojmë pozitën dhe rolin e shqipes aktuale përballë varieteteve të saj, duke i trajtuar varietetet folëse shqipe të zonës së Hasit, zonës së Anadrinisë, zonës së Opojës, zonës së Lumës e Vërrinit, zonës së Podgurit, zonës së Grykës së Lumbardhit dhe zonës së qytetit të Prizrenit, zona të cilat janë edhe objekt hulumtimi. Përveç trajtimit ndarazi të varieteteve të shqipes sipas zonave, do ta trajtojmë edhe varietetin e shqipes i cili është specifik e gjithëpërshirës brenda zonës së qytetit, ku kemi ngërthime të ndryshme gjuhësore.

Për ta realizuar këtë punim, kemi realizuar takime të vazhdueshme bashkëbiseduese me respodentë të të gjitha zonave të lartpërmendura, kemi mbajtur shënime karakteristike gjuhësore, kemi incizuar bisedat e ndryshme dhe kemi krijuar mostrat e varietetve të shqipes aktuale në zonën e Prizrenit me rrethinë. Rezultatet e këtij punimi do të kenë rëndësi për këtë fushë të gjuhësisë.

Fjalë kyçe: *shqipja standarde, varietetet lokale, gjeografia gjuhësore, dygjuhësia, sociolinguistika.*

Abstract

Moving or displacement of population from one area to another area is a major factor in the transfer of speaking features in those areas where the individual, family, the group of speaking area are settled for housing or to live and work. Such area is Prizren and surroundings, where gravitating some ethnicities, but also some varieties of the same language, the reason that inspired us to research the state and description of the current Albanian speaking varieties in this area of Prizren.

In our paper, which we plan to present in this seminar (38), we will try to explain the position and role of current Albanian in the face of its varieties, dealing with, treating the Albanian speaking varieties of Has area, Anadrini area, Opoja area, Luma and Vrini area, Podgur area, the Lumbardh Gorge area and city area of Prizren, areas that are the object of our research. Besides the separated treatment of varieties of Albanian due to areas, we will also treat Albanian variety which is specific and inclusive within the city area where we have different linguistic engagement.

To realize this paper, we have realized ongoing conversation meetings with respondents of all above-mentioned areas, we have kept characteristic linguistic notes, and we recorded different conversations and created samples of the varieties of Albanian in the Prizren area with surroundings. The results of this paper will be relevant to this field of linguistics

Keywords: *standard Albanian, local varieties, linguistic geography, bilingualism, sociolinguistics.*

1. Hyrje

1.1. Qëllimi dhe metodologjia

Me këtë punim jemi munduar ta sqarojmë pozitën dhe rolin e shqipes aktuale përballë varieteteve të saj, si ato të zonës së Hasit, zonës së Anadrinisë, zonës së Opojës, zonës së Lumës e Vërrinit, zonës së Podgurit, zonës së Grykës së Lumbardhit dhe zonës së qytetit të Prizrenit, zona të cilat janë edhe objekt hulumtimi, gjithashtu edhe ato të etnive minoritare.

Përveç trajtimit ndarazi të varieteteve të shqipes sipas zonave, do ta trajtojmë edhe varietetin e shqipes i cili është specifik e gjithpërfshirës brenda zonës së qytetit, ku kemi ngërthime të ndryshme gjuhësore.

Për ta realizuar këtë punim, kemi realizuar takime të vazhdueshme bashkëbiseduese me respondentë të të gjitha zonave të lartpërmendura, kemi mbajtur shënime karakteristike gjuhësore, kemi incizuar bisedat e ndryshme dhe kemi krijuar mostrat e varieteteve të shqipes aktuale në zonën e Prizrenit me rrethinë.

Për ta realizuar këtë punim, kemi vëzhguar të folmet e zonave të përmendura. Për të qenë më objektivë, kemi kërkuar që respondentët tanë të jenë persona të moshuar, ku edhe kemi arritur qëllimin, sepse nga të gjitha fshatrat e përmendura respondentët ishin përtej të gjashtëdhjetave, por kishim raste që kemi kontaktuar edhe gjeneratat e reja dhe të kualifikuara.

1.2. Varietetet në zonat folëse

Bartja ose shpërngulja e popullatës nga një zonë në një zonë tjetër është faktori kryesor i bartjes së tipareve folëse në atë zonë ku individi, familja, grupi i një zone folëse vendosen për banim ose për të jetuar e punuar. Zonë e tillë është regjioni i Prizrenit me rrethinë, ku gravitojnë disa etni, por edhe disa varietete të së njëjtës gjuhë, arsyeja që na ka frymëzuar të hulumtojmë gjendjen dhe përshkrimin e varieteteve folëse

aktuale të shqipes në këtë zonë të Prizrenit. Gjuha e grupit minoritar RAE është e përqëndruar në qytetin e Prizrenit. Gjuha shqipe me varietetet e saj dhe varietetet e gjuhëve të minoriteteve do të studiohen në rrafshin sociolinguistik, duke u bazuar në udhëzimet e Hudsonit (2004), Labovit (2006), Galit (1988), Ismajlit (2005, 2012), Munishit (2009, 2012) etj., të cilët kanë kontribuar me studimet e tyre në metodologjinë e realizimit të hulumtimeve me karakter sociolinguistik.

Duke u nisur nga përkufizimi i Hudsonit (2004) i cili thotë se varietetet s'është asgjë tjetër përpos një gjuhë, dialekt ose stil i një gjuhe, jemi përpjekur që të japim një pasqyrë aktuale të shqipes dhe varieteteve të saj në zonën e Prizrenit me rrethinë.

Prizreni si lokalitet shumetnik i Republikës së Kosovës, qytet historik dhe simbol i tolerancës jo vetëm që simbolizohet me popullsi e gjuhë të ndryshme, por, normalisht, sikur edhe qytetet e tjera, simbolizohet edhe me varietetet e ndryshme të së njëjtës gjuhë, në këtë rast të shqipes.

Prizreni, që menjëherë pas Luftës së II Botërore ishte qyteti më i madh i Kosovës, në të përdorshin tri gjuhë: shqipja, turqishtja dhe serbishtja. Serbishtja ishte “gjuha e shtetit; e reduktuar për pasojë procesesh intenzive plurilinguizmi, turqishtja përdorej në qytet dhe nga të tjerët, ndërsa shqipja, gjuhë e shtresës së qytetësve që kishte lidhje të pashkëputshme komunikimi me paralagjet dhe fshatrat përreth, pra të gjallës, mbisundueshëm shqipfolëse” (Ismajli, 2005: 17). Në raste të ndryshme të tri gjuhët fliteshin pak a shumë në rrethana plurilinguale. Rrethanat shtetërore shpesh e bënë të domosdoshme njohjen e serbokroatishtes standarde, ndërsa identifikimi emocional, kombëtar dhe zhvillimet e jetës atë të shqipes.

Prizreni është komunë e madhe dhe e rëndësishme nga pikëpamja historike dhe konsiderohet si një nga komunat më shumetnike dhe shumëgjuhëshe. Shqiptarët janë popullata shumicë, por ka edhe një numër të madh pjesëtarësh të komunitetit boshnjak, turk, RAE (romë, ashkalinj, egjiptas), dhe një numër i vogël pjesëtarësh të komunitetit serb, duke e shndërruar atë në një mozaik të vërtetë etnish (<http://prizren360.com/about-prizren/population>), me një shprehje të

diversitetit kulturor, etnik e gjuhësor. Krahas gjuhës shqipe e serbe, në nivel lokal, statusin e gjuhës zyrtare e kanë edhe gjuha turke dhe ajo boshnjake (Rregullore ..., 2008, neni 11), ani pse, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (2007, neni 5, pika 1), „Gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe. Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune (...).” Përcaktime të përafërta kishte edhe kushtetuta e vitit 1974, nga e cila kushtetutë Munishi (2006: 25) sjell një situatë shumëgjuhëshe, por në kuadër të Kosovës: „Në bazë të përcaktimeve në kushtetutën e atëhershme duket qartë se sa i përket statusit të gjuhëve dhe barazisë midis tyre, në KSA të Kosovës kishim një situatë të bilinguizmit institucional, e në disa raste edhe trilinguizmit, kur kërkohet edhe përdorimi i gjuhës turke”. Arsimi në të gjitha nivelet zhvillohet në gjuhën shqipe, boshnjake dhe turke. Komuniteti RAE shkollohet në gjuhën shqipe, por në rrethet familjare ky komunitet shërbehet me të folmen rome. Nuk kemi evidentuar raste që ky komunitet të shkollohet në ndonjë gjuhë tjetër, por kemi hasur raste të përdorimit të gjuhëve të tjera.

Përpos këtyre grupimeve të shqipes përballë gjuhëve ose të folmeve të tjera, në kuadër të shqipes në komunën e Prizrenit, nga vëzhgimi i zonës, kemi evidentuar disa zona e nënzona të të folmeve të shqipes, ku përfshihen të folmet e shqipes të trevave të Opojës, Lumës, Hasit, Vërrinit, Anadrinisë, Podgurit, ndërsa pas vitit 1999 me një numër më të theksuar edhe të folmet e Suharekës, Malishesvës, Rahovecit, Dragashit etj., ndërsa sipas ndarjeve të dialekteve e nëndialekteve Zona e Prizrenit hyn në grupin e nëndialektit të gegërishtes veriore, përkatësisht verilindore (Gjinari – Shkurtaj, 2003: 158). Pra, Prizreni përpos që krijon një mozaik me të folmet e gjuhëve të tjera, ai, krijon një mozaik me varietetet e ndryshme të së njëjtës gjuhë.

Vetë qyteti i Prizrenit është zonë karakteristike me ndërthyerje, gërshetime e ndikime të ndryshme brenda të së njëjtës gjuhë, ku ndërhyjnë varietetet shqipe të zonave të ndryshme të posapërmendura, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, shqipja sfidohet përballë gjuhëve të tjera, si përballë turqishtes dhe varieteteve të ndryshme të të folmeve sllave jugore. Për këtë rast, Prizrenin mund ta ndajmë në disa zona të ndryshme të të

folmeve të shqipes, zona të cilat klasifikohen sipas përshkrimeve demografike etnike, si p.sh.: në lagjen Kurrilla, për shkak të përqëndrimit të popullatës joshqiptare dhe për shkak të rritjes së prestigjit të gjuhës turke me ndikim të faktorëve të jashtëm, lëre që po përhapet dhe po krijohet shprehia e komunikimit përmes turqishtes dhe me një përqindje përmes boshnjakishtes, por edhe komunikimi i shqipes i kalon kriteret gramatikore e fonetiko-fonologjike të shqipes, duke i marrë tiparet shprehëse të turqishtes ose në disa raste të boshnjakishtes, ose duke i plotësuar fjalët e shqipes me ato të turqishtes e boshnjakishtes (*p.sh. Jem kardash po shkon në stanic*). Kjo dukuri është e shprehur tek-tuk nëpër qytet, kryesisht te familjet që dëshirojnë ta mbajnë primatin e qytetasit. Situata qëndron ndryshe në zonat e tjera të qytetit, kjo ngase në disa zona të tjera nuk e kemi faktorin e ndikimit të njërës gjuhë në tjetrën, por në ato zona na paraqiten gërshetime të varieteteve të ndryshme folëse të shqipes, pra kjo varet se nga cila zonë familjet janë shpërngulur në zonë të caktuar të Prizrenit. Në lagjen Bajram Curri kemi popullatë shqipe të ardhur nga zona e Vërrinit, Opojës, Malishevës, Hasit etj., njëjtë edhe në zonën e lagjes Jeta e Re, por këtë përshkrim nuk e kemi në zonën e Tusuzit. Në lagjen e Tusuzit kemi një gjendje në të kundërtën e gjendjes në lagjen Kurrilla. Në këtë lagje shumica e popullatës është e fshatrave shqipfolëse të zonës së Vërrinit, ndërsa kemi edhe popullatën e fshatrave të zonave sllavishtfolëse të Grykës së Lumbardhit, por këtu shumica e këtyre familjeve, nëse gjatë kontaktit paraprakisht nuk i njeh që janë nga zonat minoritare, nuk ke mundësi që t'i dallosh që nuk janë të etnisë shqiptare, pra e folmja e tyre shqipe nuk dallon nga e folmja shqipe e fqinjëve shqipfolës dhe kryesisht të gjithë shkollohen në gjuhën shqipe, për dallim nga lagja Kurrilla ku shumica shkollohen në gjuhën turke. Gjithashtu, në qytet na paraqiten edhe raste të tentimpërdorimit ose etiketimi i folësve të shqipes standarde nga kuadri i mësimdhënësve ose intelektualëve, por ky numër është shumë i ulët, përpos rasteve formale, pra jashtë situatave formale kemi vërejtur që edhe ata ose ato janë folës ose zbatues të varietetit të tij ose të saj lokal, ose familjar. Përdorues të standardit, sipas vëzhgimeve tona, në të shumtën e rasteve na dalin bilingë që shkollohen në gjuhën shqipe, ndërsa në familje janë përdorues të ndonjë dialekti sllav,

rastet konkrete i kemi hasur te nxënës, studentë, mësimdhënës, mjekë etj., të zonave të Mushnikovës, Skorobishtit dhe pjesërisht të Lubizhdës, sesa tek shqipfolësit të përditshëm të cilët si në familje, si në rrugë, si në punë e në miqasi flasin shqip, përkatësisht një varietet të shipes.

Zonat e tjera në rrethin e Prizrenit janë shqipfolëse ose më konkretisht folës të varieteteve të shqipes, përpos zonës së Grykës së Lumbardhit dhe pjesërisht në zonën e Podgurit, të cilët janë folës të sllavishtes, përkatësisht gjuhës boshnjake.

2. Disa dëshmi të evidentuara – rezultatet

Nga vëzhgimi kemi hasur që në të folmet e këtyre zonave theksi kryesisht është paroksiton (parafundor) si: káfe, xháde, penxhére, baklláva, xhenáze, fájde etj. Dukuria e zhvendosjes së theksit për një rrokje prapa janë përfshirë edhe emrat si: Hatíxhe, Hanífe, Ájshe, Xhemíle, Mús, Mustáfa etj.

Gjithashtu, kemi hasur emrat e gjinisë natyrore mashkullore, ndërsa gjinia gramatikore e tyre është femërore, si: Haxhija, Hamdíja, Muslija, Bakija, Bedrija, Ilmija, Alija për Haxhi, Hamdi, Musli, Baki, Bedri, Ilmi, Ali.

Në këto të folme e kemi hasur edhe dukurinë e emërzimit, si: t’kalbtit – pjesa e kalbët e diçkaje; T’nrydhtit – pjesa e ndrydhët e këmbës a e tjetërçkajes; T’prishtit – pjesa e prishur e diçkajes etj.

Numërorin themelor **një** sipas funksionit që kryen e kemi hasur në dy variante, si **ni** dhe **nja**^o: si ni del atëherë kur ai ndodhet para një emri dhe kryen funksionin e numërorit (ma jep ni moll, ni djal i keq e prish ni katund, me Ilmijen veç ni mur na ndan etj.

Një tipar karakteristik folës që i dallon të folmet e Opojës, Zhurit, Vërrinit nga të folmet e tjera të zonës së Prizrenit, është përdorimi i dendur i përemrit pyetës **xhi**, i cili përdoret në funksion të përemrit **çka** – **çfarë** dhe i cili, si i tillë, nuk haset në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, por as në mbarë gegërishten.

Në çdo rast e kemi hasur paskajoren me pjesëzën me+pjesoren: me punue, me dal, me ardh, me luft, duhet me shkue n’Prizeren etj., por edhe

paskajoren e tipit për+me+pjesorja: kur vjen dita për me marr; kan shkue krushqit për me marr etj.

Shprehjen pyetëse e kemi hasur në disa variante: A je tum marr vesh; A je tu kuptu; A po më kupton; A je tu kuptu; A je tu dit, A po dish.

Një vëzhgim të veçantë u kemi bërë ndajfoljeve në zonën e Vërrinit, të cilat i kemi krahasuar me shqipen standarde. Pra, për ndajfoljet e mënyrës në gjuhën standarde, që përputhen me trupin e mbiemrave përgjegjës (i mirë, i keq) dhe emërtojnë cilësinë e veprimit, ose që tregojnë thjesht, si kryhet veprimi i shprehur nga folja, si: *bukur, ëmbël, keq, lehtë, mbarë, mirë, pastër, qetë, shkurt, shtrembër, thjesht, vështirë* (Gramatika 1, 2002: 358 - 366); në të folmen e Vërrinit i kemi hasur në këto trajta: *heshëm, amël, keq, let, marë, mirë, paq, rahat, trup, shtramët, kallajshme, zor*. Pastaj, ndajfoljet ose lokucione ndajfoljore të gjuhës standarde, që e vënë në dukje kohën e pacaktuar në saktësi, si: *dikur, njëherë, një ditë prej ditësh, një herë e një kobë*, në të folmen e Vërrinit i kemi hasur këto trajta: *moti, niherë, ni ditë prej dite, ni herë e ni vakt*. Pastaj, ndajfoljet ose lokucionet ndajfoljore që vunë në dukje kohën e zgjatjes së një veprimi a të një gjendjeje ose dendurinë e tyre, si dhe përforcimin e pësëritjen rregullisht të një veprimi pas një periudhe të caktuar kohe janë: *gatë, gjithmonë, kurdoherë, dendur, ndonjëherë, kobë pas kobe*; në të folmen e Vërrinit i kemi hasur në këto trajta: *gat', përher', deniber', shtypur, dejber', vakt pas vakti*. Dhe, ndajfoljet që tregojnë një veprim të çastit, si: *aty për aty, menjëherë, njëherë e për herë*; në të folmen e Vërrinit i kemi hasur në këto trajta: *qaty për qaty, meniber, niber e përber*.

Në këtë hulumtim i kemi hasur edhe ndajfoljet e vendit. Njëjtë sikur ato të mënyrës edhe këto të vendit i kemi krahasuar ndajfoljet e gjuhës standarde me ato në përdorim në të folmet popullore në Vërrin, si: *afër, lart, pranë, diku, nga, brenda, anëmbanë, nga*; në të folmet e Vërrinit: *ngat, nalt, karshi, dokund, ka, mranda, tehepërte, kab*. Pastaj, kemi hasur edhe ndajfoljet e shkakut të gjuhës standarde, si: *përse, pse* të cilat në të folmen e Vërrinit përdoren me trajtat: *përgji, gj*.

3. Përfundim

Nga shtjellimi i këtij materiali, kemi parë se të folmet e shqipes janë të ndara në dialekte dhe nëndialekte. Disa prej tyre janë studiuar

shterueshëm nga gjuhëtarë, disa sipërfaqësisht. Të folmet dialektore të shqipes janë begatia e shqipes. Për ta dëshmuar këtë begati të shqipes jemi angazhuar që ta vëzhgojmë zonën e Prizrenit me rrethinë. Besoj se kjo pasqyrë e përdorimit të shprehjeve fonetiko-fonologjike, morfologjike, fjalëformuese, sintaksore tregojnë një gjendje të kësaj zone.

Literatura:

1. Gal, S. (1988). *The Political Economy of Code Choice*. In Heller.
2. *Gramatika e gjuhës shqipe (Morfologjia 1)*. (2002). Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
3. Gjinari, J., Shkurtar, Gj. (2003). *Dialektologjia*. Tiranë: ShBLU.
4. Hudson, R. A. (2004). *Sociolinguistics*. Cambridge University Press, 1980, 1996. Përkthimi në shqip: *Sociolinguistika*. Tiranë: Dituria.
<http://prizren360.com/about-prizren/population>
5. Ismajli, R. (2005). *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
6. Ismajli, R. (2012). Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. “*Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*”, ASHAK.
7. *Kushtetuta e Krabinës Socialiste Autonome të Kosovës* (1974). Prishtinë: Rilindja.
8. *Kushtetuta e Republikës së Kosovës* (2008). Prishtinë.
9. Labov, W. (2006). *The Social Stratification of English in New York City*. Cambridge University Press.
10. Munishi, Sh. (2006). *Gjuhë standarde shqipe në Kosovë dhe drejtimit e zhvillimit të saj*. disertacioni i doktoratës (dorëshkrim). Prishtinë.
11. Munishi, Sh. (2009). *Barazja e gjuhëve në Kosovë dhe perspektiva evropiane*. Prishtinë: Kongresin Ndërkombëtar Ballkanik Prishtinë, 11-16 maj 2009.

12. Munishi, Sh (2012). *Probleme të zbatimit të dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë*. AShAK: Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, Prishtinë, ff. 565-580.
13. *Rregullore e përdorimit të gjuhëve në Prizren dhe Rregullore mbi statusin e minoriteteve në Prizren*. Kuvendi Komunal i Prizrenit, Zyra Ligjore.

Shemsi HAZIRI

DALLIMET TERMINOLOGJIKE NË LIGJIN E TRAFIKUT RRUGOR (KOSOVË) DHE NË KODIN RRUGOR (SHQIPËRI)

Abstrakt

Në këtë kumtesë do të përpiqem t'i paraqes dallimet terminologjike në Ligjin e Trafikut Rrugor (Kosovë: 2016) dhe në Kodin Rrugor (Shqipëri: 2015). Këto dallime terminologjike shfaqin një mori ndikimesh nga anglishtja dhe serbokroatishtja në gjuhën shqipe në Kosovë, si dhe nga italishtja dhe anglishtja në Shqipëri, p. sh.: *Ligji për rregullat e trafikut rrugor – Kodi rrugor; patentë shoferi – lejedrejtimi; shenjat e trafikut rrugor – sinjalizimi rrugor; autoudhë – autostradë; shiriti ndarës i rrugës – karrexhata; librezja e qarkullimit – lejeqarkullimi; shofer – drejtues i mjetit, etj.*

Përveç ndikimeve të terminologjisë së gjuhëve të huaja, do të paraqiten edhe mënyrat e fjalëformimit të terminologjisë së trafikut rrugor në gjuhën shqipe, sipas veçorive gramatikore veç e veç. Në përfundim të këtij hulumtimi do të nxirren rezultatet e arritura në fushën e terminologjisë së trafikut rrugor në gjuhën shqipe, si dhe do të jepen rekomandimet e nevojshme për harmonizimin e kësaj fushe specifike të terminologjisë shqipe në të dyja vendet, Kosovë–Shqipëri.

Fjalët kyçe: *terminologjia e trafikut rrugor; dallimet terminologjike; ndikimi i gjuhëve të huaja; harmonizimi i terminologjisë.*

Abstract

This paper is an attempt to present differences in terminology between Law on Traffic (Kosovo: 2016) and Traffic Code (Albania: 2015). These differences in terminology are results of a series of influences of English and Serbo-Croatian in Albanian language in Kosovo as well as Italian and English influence in Albanian language in Albania, as shown in the following examples (*Kosovo – Albania*): *Ligji për rregullat e trafikut rrugor – Kodi rrugor; patentë shoferi – lejedrejtimi; shenjat e trafikut rrugor – sinjalizimi rrugor; antondbë – autostradë; shiriti ndarës i rrugës – karrexhata; librezë e qarkullimit – lejeqarkullimi; shofer – drejtues i mjetit*, etc.

Besides terminological influences by foreign languages, we will also present manners of word-formation of road traffic terminology in Albanian language, based on grammatical specifics for each of them. In conclusion of this paper there will be presented results in regards to the field of terminology used for road traffic in Albanian language and there will be set recommendations for harmonization of specific terminology in this field in both countries, Kosovo and Albania.

Key words: *terminologjia e trafikut rrugor; dallimet terminologjike; ndikimi i gjuhëve të huaja; harmonizimi i terminologjisë.*

1. Hyrje

Terminologjia si një degë e veçantë e leksikologjisë nuk është një fushë e re e studimit, por vetëm në dekadat e fundit është zhvilluar sistematikisht, duke marrë parasysh parimet, bazat dhe metodologjinë e saj studimore. Rëndësia e kësaj fushe të dijes tashmë është njohur edhe në të dyja rrafshet: në atë kombëtar dhe ndërkombëtar. Terminologjia, siç e kuptojmë sot, fillimisht filloi të merrte formë në vitet 1930, ndërsa në vitet e fundit ka lëvizur nga joprofesionalizmi - në një qasje vërtet shkencore (Cabre 1998; Haziri Sh.: 2015; 2018). Sa i përket terminologjisë së trafikut rrugor në gjuhën shqipe, është vënë re se ka mjaft dallime ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Për të vërtetuar këto dallime, janë marrë për studim dhe krahasim dy ligjet e trafikut rrugor në të dyja vendet: Ligji për rregullat e trafikut rrugor (Kosovë) dhe Kodi Rrugor (Shqipëri). Kodi Rrugor (Shqipëri: 2015) përbëhet prej 196 faqeve dhe 235 neneve. Ndërsa Ligji për rregullat e trafikut rrugor (Kosovë: 2016) përbëhet prej 115 faqeve dhe 264 neneve.

Në këto dy dokumente ligjore janë identifikuar disa terma të fushës së trafikut rrugor, të cilët janë përzgjedhur me interes studimor, e më pas janë ndarë sipas rëndësisë së këtij studimi, si në vijim:

- *Terma të trafikut rrugor Shqipëri – Kosovë me sinonimi të plotë;*
- *Termet të cilët janë përfshirë në njërin ligj/ kod, por mungojnë në ligjin/ kodin tjetër;*
- *Mënyra e fjalëformimit të terminologjisë së trafikut rrugor në gjuhën shqipe;*
- *Ndikimi i terminologjisë së trafikut rrugor nga anglishtja dhe serbo-kroatishtja në Kosovë; si dhe*
- *Ndikimi i terminologjisë së trafikut rrugor nga anglishtja dhe italishtja në Shqipëri.*

Për të pasur një pasqyrë më të qartë dhe praktike në këtë hulumtim, për sa i përket dallimeve terminologjike në fushën e trafikut rrugor në gjuhën shqipe, janë bërë përzgjedhjet e termave në forma tabelare.

2. Sfondi teorik

Leksiku i një gjuhe zhvillohet dhe pasurohet pandërprerë. Sipas J. Thomait (2002: 23), “*ka dy lëvizje kryesore në leksikun e gjuhës letrare: a) krijohen a hyjnë fjalë të reja; b) dalin nga përdorimi fjalë të vjetruara. Lëvizja e parë është më e shpejtë, leksiku i gjuhës letrare vjen gjithnjë duke u zgjeruar e duke u pasuruar, krabas zëhvillimit të prodhimit, të shqërisë, të kulturës e të mendimit*”. Me leksik në përgjithësi kuptojmë tërësinë e fjalëve të një gjuhe. Pra, fjala është njësia bazë e leksikut (Memushaj 2002: 141). Leksiku si tërësi ngërthen në vete disa nënndarje brenda tij, si: leksiku i përgjithshëm i një gjuhe, leksiku special ose terminologjik i fushave të caktuara të dijes, ose i lëmenjve të caktuar specialistikë, leksiku pasiv, arkaizmat, leksiku aktiv, leksiku vendës apo autokton, leksiku i huazuar, neologjizmat, polisemia, antonimet, homonimet, sinonimet etj.

Leksiku terminologjik në dekadat e fundit është shumë aktual dhe po ngjall interesime të vazhdueshme të studiuesve të rinj, e që lidhet veçanërisht me lëmenj dhe fusha specifike të dijes, si: leksiku terminologjik i gjuhësisë, leksiku i terminologjisë artistike, leksiku ushtarak, policor, juridik, politik, ekonomik etj. (Coleman: 2000; Halliday: 2007; Haziri Sh.: 2015).

Për krijimin e leksikut terminologjik, merren fjalë të burimit të leksikut të përgjithshëm dhe specializohen në një fushë të caktuar të dijes. Kalimi i fjalës nga fjalori i përgjithshëm në term, quhet terminologjizim (Duro: 1997; 2001).

3. Terma të trafikut rrugor Shqipëri – Kosovë me sinonimi të plotë

Për sa i përket përzgjedhjes së termave me sinonimi të plotë ndërmjet Kodit Rrugor (Shqipëri) dhe Ligjit të Trafikut Rrugor (Kosovë), në vazhdim po paraqesim tabelën 3.1.

KODI RRUGOR	LIGJI PËR RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR
--------------------	--

Policia rrugore	Policia e trafikut
Kantiere rrugore	Vendpunishte në rrugë
Sinjalizimi rrugor	Shenjat e trafikut rrugor
Lëvizjet interurbane	Qarkullimi ndërurban
Sinjale vertikale, horizontale, të ndritshme	Shenja vertikale, horizontale dhe ndriçuese
Mosrespektimi i sinjalizimit rrugor	Mosrespektimi i shenjave të trafikut rrugor
Përmasa gabarite kufitare	Shenjëzimi i gjatësisë së mjetit
Slitat	Sajë me motor (motoski)
Leje drejtimi	Patentë shoferi
Drejtues mjete	Shofer
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	Ministria e Infrastrukturës
Karrexhatë	Shirit ndarës i rrugës

Tabela 3.1: Terma sinonimikë Shqipëri – Kosovë

Pra, siç vërehet në tabelën e mësipërme, sinonimia në terminologjinë e trafikut rrugor Kosovë – Shqipëri është mjaft e pranishme, duke marrë parasysh edhe ndikimet nga italishtja në Shqipëri, si dhe nga serbishtja (apo ish-serbokroatishtja) në Kosovë (Samara: 2008; Proko: 2012; Bajçinca 2016; Blaku 2010). Këto sinonime vijnë në shprehje edhe për shkak të rrethanave historike ndërmjet dy vendeve, kur marrim parasysh ndarjen e padrejtë të territorit të Kosovës nga trojet etnike shqiptare në fillim të shekullit XX nga fuqitë e mëdha të kohës.

4. Terma të cilët janë përfshirë në njërën ligj/kod, por mungojnë në ligjin/kodin tjetër

Për shkak të specifikave të ndryshme të organizimit administrativ dhe shtetëror ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, edhe në Kodin Rrugor (2015) në Shqipëri, si dhe në Ligjin e Trafikut Rrugor (2016) në Kosovë, gjatë procesit studimor të përzgjedhjes së terminologjisë, që nuk është përfshirë në njërin kod/ligj, por që mungon në kodin/ligjin tjetër, konstatohet se raste të tilla janë mjaft evidente. Në vijim po paraqesim tabelën 4.1 me disa terma të përzgjedhur, të cilët pasqyrojnë më hollësisht këtë dukuri:

Tabela 4.1: Terma që janë përfshirë në njërin kod/ligj, por mungojnë në kodin/ligjin tjetër

KODI RRUGOR	LIGJI PËR RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR
	Motokultivator (mjet motorik me dy rrotë për bartje të mallrave me fuqi më të lehta se traktori)
	Motoudhë (rrugë e dedikuar vetëm për automjete)
	Raporti evropian i aksidentit (është i obligueshëm me ligj nga organi kompetent i atij shteti)
Rrathët metalike të rrotave	
Shërbime taksi me mjete transporti që tërhiqen me kafshë	
Ciklomotorë dhe automjete të hershme me interes historik dhe koleksionimi	
Detyrime të koncesionerëve	
Ndërtime, mure dhe vepra mbrojtëse	
Shërbime taksi me autovetura me drejtues mjete	

Qiradhënie mjete me kafshë pa drejtues mjete me të drejtën dhe shitjen e mjeteve	
Të mbjella dhe gardhe	

Shembuj të tillë të terminologjisë së trafikut rrugor, si: *shërbime taksi transporti me kafshë, të mbjella dhe gardhe* (Kodi Rrugor: 2015) dhe *motokultivator, motoudbë, raporti evropian i aksidentit* (Ligji për rregullat e trafikut rrugor: 2016), tregojnë qartë specifika të ndryshme (të dallueshme) të fushëveprimtarisë së dy vendeve në fushën e trafikut (komunikacionit) rrugor, si dhe terminologjisë profesionale në gjuhën shqipe. Dallimet terminologjike të komunikacionit rrugor në relacionin Kosovë – Shqipëri, janë të pranishme për shkak të zhvillimit të ndryshëm historik, ekonomik dhe kulturor në njëqind vjetët e fundit, që nga përcaktimi i kufijve ekzistues të Shqipërisë së sotme më 1913, si dhe shkëputjes së territorit të Kosovës dhe trojeve të tjera etnike shqiptare, duke iu bashkëngjitur shteteve fqinje të Shqipërisë, e deri në ditët e sotme.

5. Mënyra e fjalëformimit të terminologjisë së trafikut rrugor në gjuhën shqipe

Fjalëformimi në gjuhën shqipe realizohet kryesisht nëpërmjet ndajshitesimit, parashtesimit, prapashtesimit, kompozitave, por edhe përmes huazimit të fjalëve të huaja dhe përshtatjes së tyre në gjuhën shqipe përmes mbaresave rasore (Paçarizi: 2015; Memisha: 2011; Memushaj: 2002; Thomai: 2006).

Gjatë përzgjedhjes së termave të trafikut në këto dy dokumente ligjore Kosovë – Shqipëri, kam vërejtur se në përgjithësi fjalëformimi i tyre realizohet nëpërmjet mbaresave shqipe, përgjatë pranimit të termave nga gjuhët e huaja, sidomos nga anglishtja si: *kask-a, helmet-a, patent-ë sboferi, tobograf-i* etj.

Ndërsa, sa i përket mënyrës së fjalëformimit të termave nëpërmjet kompozitave, janë përzgjedhur këta terma, si: *auto-udbë, katër-çikletë, tri-çikletë, moto-kultivator, moto-udbë, gjysmë-rimorkio, leje-drejtimi, ciklo-motorë*, etj.

Mënyra e fjalëformimit të termave të trafikut rrugor përmes parashtesimit është mjaft prodhimtare. Po përmendim fillimisht termin që përdoret në Kosovë, si: *kundër-vajtje* (në Shqipëri – masë administrative apo gjobë); pastaj *nën-kalim, mbi-kalim, tej-kalim, para-kalim, përballë-kalim, anash-kalim* etj.

6. Ndikimi i terminologjisë së trafikut rrugor nga anglishtja dhe serbo-kroatishtja në Kosovë

Ndikimi i serbishtes në terminologjinë e gj. shqipe në Kosovë ka qenë mbizotërues, sidomos nga viti 1970 deri më 1999, për shkak të përkthimeve të drejtpërdrejta të çdo dokumenti të shkruar nga serbokroatishtja në shqipe. Kurse, pas vitit 1999 deri në ditët e sotme, ndikimi më i madh është nga anglishtja si një gjuhë globale. Nuhiu (2013: 123) përmend faktin se në Kosovë pas administrimit ndërkombëtar të pasluftës dhe pranisë së shumë misioneve ndërkombëtare si gjuhë zyrtare – anglishten, kanë marrë hov huazimet e anglicizmave në gjuhën shqipe në mënyrë të pakontrolluar. Këtë fakt e shtjellon edhe Sh. Munishi (2015). Gjatë përzgjedhjes së terminologjisë së trafikut rrugor në Kosovë, që është i ndikuar nga anglishtja, po veçojmë këta terma: si: *trafiku rrugor – traffic; patentë shoferi – driving licence; helmetë – helmet; moped (biçikletë me motor) – moped*, etj.

Sa u përket ndikimeve të serbishtes në gjuhën shqipe janë marrë në veçanti I. Bajçinca (2016), M. Blaku (2010) etj. Sa u përket termave të trafikut rrugor në gjuhën shqipe në Kosovë të ndikuar nga serbishtja, po i veçojmë disa prej tyre: *shenjat e trafikut rrugor – putni saobraćajni znakovi; kundërvajtje – prekršaj; vozitës – vozač; moto-kultivator (mjet motorikë bujqësor) – motokultivator; shiriti (traka) i trafikut – saobraćajna traka* etj.

7. Ndikimi i terminologjisë së trafikut rrugor nga anglishtja dhe italishtja në Shqipëri

Sipas Sh. Munishit, ndikimet e anglishtes vijnë kryesisht nga ngritjet e kapaciteteve nëpërmjet ndihmës së misioneve ndërkombëtare që ka të bëjë me fushën e legjislacionit dhe të integriteteve evropiane. Fillimisht ato ligje përgatiten në gjuhën angleze, e pastaj përkthehen në gjuhën shqipe, me ç'rast përshtaten shumë terme nga gjuha angleze (Munishi, 2015: 49). Sa i përket përzgjedhjes së termave të ndikuar nga anglishtja në Kodin Rrugor (2015) në Shqipëri, po veçojmë disa terma të trafikut rrugor të ndikuar nga anglishtja si: *sinjalizimi rrugor – road signaling; koncesion – concession etj.*

Kurse, sa i përket ndikimit të italishtes në terminologjinë e trafikut rrugor, s'do mend se është i pranishëm edhe në këtë fushë, si edhe në të gjitha fushat e tjera, për shkak të përkthimeve të ligjeve të marra si model nga shteti fqinj perëndimor – Italia. Në rastin konkret në Kodin Rrugor (2015) në Shqipëri, sa u përket termave të trafikut në gjuhën shqipe të ndikuar nga italishtja, po i veçojmë këta terma të huazuar nga italishtja, të përshtatur në shqipe me anë të mbaresave rasore, si: *ciklomotor (motoçikletë) – ciclomotore; karrexhata (shirit/korsi e rrugës) – careggiata etj.*

8. Përfundim

Marrë në përgjithësi, në terminologjinë e trafikut rrugor Kosovë – Shqipëri, duke u fokusuar në dy dokumentet ligjore: Kodi Rrugor (Shqipëri 2015) dhe Ligji i Trafikut Rrugor (Kosovë 2016), konstatohet se ka mjaft dallime terminologjike. Janë identifikuar sinonime të plota, p. sh.: shofer – drejtues mjeti; patentë shoferi – lejedrejtimi; Ministria e Punëve Publike dhe të Transportit – Ministria e Infrastrukturës; Kodi Rrugor – Ligji i Trafikut Rrugor etj. Në disa raste janë identifikuar terma të cilët përdoren në njërin ligj/kod, kurse nuk përdoren fare në ligjin/kodin tjetër, për shkak të specifikave dhe karakteristikave të veçanta të zhvillimit historik të trafikut rrugor Shqipëri – Kosovë, i cili është realizuar qindra vjet ndaras, deri para 20 vjetëve të fundit, kur u çlirua Kosova nga okupatori, si dhe u hap kufiri shqiptaro-shqiptar për t'u intensifikuar qarkullimet rrugore ndërmjet dy vendeve (shteteve).

Në Kosovë, për shkak të rrethanave historike, terminologjia e trafikut rrugor është e ndikuar nga serbo-kroatishtja, për shkak se në kohën e ish-Jugosllavisë janë përkthyer drejtpërdrejt të gjitha aktet ligjore që kanë qenë në fuqi; kurse në 20 vjetët e fundit, terminologjia e trafikut rrugor në gjuhën shqipe është ndikuar ekskluzivisht nga anglishtja (Rugova, B. 2011; 2015). Ndërsa, në Shqipëri, për shkak të fqinjësisë dhe marrëdhënieve historike për një kohë të gjatë me Italinë, terminologjia e trafikut rrugor në gjuhën shqipe është e ndikuar nga italishtja përmes përshtatjes së akteve normative nga ky shtet. Në 20 vjetët e fundit, ka ndikime të përgjithshme nga anglishtja në të gjitha fushat, sepse tanimë ka marrë statusin e një gjuhe dominuese në tërë globin.

Edhe pse dallimet terminologjike të fushës së trafikut rrugor Kosovë – Shqipëri janë mjaft evidente, konstatojmë se çdoherë e më tepër po përafrohemi për sa i përket harmonizimit të terminologjisë, për shkak të marrëveshjeve të rregullta të bashkëpunimit, sidomos ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Policisë së Kosovës, kryesisht në sezonin veror, për të rregulluar qarkullimin rrugor së bashku në territorin shqiptar.

Bibliografia:

1. ASHSH (1989). *Studime për leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III*. Tiranë.
2. ASHSH (2006). *Fjalori i Gjuhës Shqipe*. Tiranë.
3. ASHSH (2005). *Fjalori Sinonimik i Gjuhës Shqipe*. Tiranë.
4. ASHSH (2005). *Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë*. Tiranë.
5. Bajçinca, I. (2016). *Shqipja standarde dhe probleme rreth saj*. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Shoqata e Gjuhës Shqipe e Kosovës. Prishtinë.
6. Bello, V. (2007). *Termet emra – bazë e formimit të terminologjisë së gjuhësisë*. Seminari i GJLKSH-së Prishtinë.
7. Blaku, M. (2010). *Ndikimi i shqipes mbi të folmen serbe të Kosovës*. Instituti Albanologjik. Prishtinë.

8. Cabre, (1998). *Terminology, Theory, methods and applications*. USA.
9. Coleman, J. Cay, Ch. (2000). *Lexicology, Semantics and Lexicography*. USA.
10. Çipuri, H. (2005). *Termet dhe fjalorët terminologjikë ushtarakë në gjuhën shqipe*. Leksikologjia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë. Tiranë.
11. Duro, A. (2001). *Terminologjia si sistem*. Tiranë.
12. Duro, A. (1997). *Terminologjia në ligërimin e specializuar*. Tiranë.
13. Halliday, M.A.K., Colin, Y. (2007). *Lexicology*. London.
14. Haziri, Sh. (2015). *Dallimet terminologjike në Ligjin e Policisë së Kosovës dhe Ligjin e Policisë së Shtetit dhe ca prurje të reja*. “Java e Albanologjisë”. botimi “Albanologji” – Instituti Albanologjik i Prishtinës.
15. Haziri, Sh. (2015). *Sbkëmbimi gjuhësor gjatë bisedave në Qendrat Komunikuese të Policisë së Kosovës* Seminari Ndërkombëtar i Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare. Fakulteti i Filologjisë. Prishtinë.
16. Haziri, Sh. (2018). *Sinonimet në leksikun policor Kosovë-Shqipëri*. Seminari Ndërkombëtar i Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare - 37. Fakulteti i Filologjisë. Prishtinë.
17. Ismajli, R. (2003). *Standarde dhe identitete*. Dukagjini. Pejë.
18. Memisha, V. (2011). *Studime për fjalën shqipe*. QSA – Tiranë.
19. Memushaj, R. (2002). *Hyrje në gjuhësi*. Dituria. Tiranë.
20. Munishi, Sh. (2015). *“Shqipja në epokën e globalizimit”*. ZeroPrint. Prishtinë.
21. Nuhiu, V. (2013). *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*. ASHAK, Prishtinë.
22. Paçarizi, Rr. (2015). *Konversioni në gjuhën shqipe*. Parnas. Prishtinë.
23. Pllana, G. (2018). *Fjalor i termave bazë teknike(mekanike, elektricitet, ndërtim) shqip-gjermanisht gjermanisht-shqip*. Prishtinë.
24. Proko, J. V. (2012). *Leksiku terminologjik i agronomisë në gjuhën shqipe*. QSA. Tiranë.

25. Rugova, B. (2011). *Pozita dhe statusi i shqipes kundruall gjuhëve të tjera të Ballkanit*. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. ASHAK. Prishtinë.
26. Rugova, B., Sejdiu, R. L. (2015). *Hyrje në gramatikën e tekstit në gjuhën shqipe*. Trembelat. Prishtinë.
27. Samara, M. (2008). *Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe*. ASHSH. Tiranë.
28. Thomai, J. (2006). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Shtëpia Botuese e Librit Universitar. Tiranë.

Ligjet:

- Kodi Rrugor (2015), Republika e Shqipërisë
- Ligji për rregullat e trafikut rrugor (2016), Republika e Kosovës

Sheqere TABAKU

**KUNDRINOR I ZHDREJTË ME PARAFJALË APO
RRETHANOR?
TRAJTIMI GJENERATIVIST I TYRE**

Abstrakt

Qëllimi kryesor i këtij punimi është studimi i problemit që haset me kundrinat dhe në veçanti me kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe. Ndaj, në këtë trajtim, do të mundohem të shpjegoj nëse kemi kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë apo rrethanorë. Për ta sqaruar këtë do të marrim në shqyrtim veçanërisht ndërtimet parafjalore që në gramatikën e Akademisë trajtohen si kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë, ndërsa në gramatikën gjenerative, në bazë të teorisë së valencës apo të roleve tematike dhe duke marrë për bazë kokën leksikore e veçoritë gramatikore të saj, nuk dalin më si kundrinorë në asnjë rast, por, siç do të shihet, përshkruajnë rrethanat e kryerjes së një veprimi. Në ndihmë për punimin na vjen dhe dallimi i qartë që ekziston mes dy gjymtyrëve të dyta, rrethanor dhe kundrinor, duke u mbështetur në kriteret, si: kriteri semantik, kriteri i rendit të fjalëve, kriteri i detyrueshmërisë, kriteri i përzgjedhjes nga folja.

Si literaturë bazë do të shërbejnë librat, gramatikë e akademisë I, II dhe gramatikë gjenerative. Në këtë punim pritet të arrihen rezultate nga studimi i kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë në rastet e kufizimit të tij me rrethanorin dhe dalja në përfundimin se kemi një rrethanor dhe jo kundrinor të zhdrejtë me parafjalë. Për realizmin e këtij punimi kam përdorur metodën analizë gjuhësore, metodën përshkruese, krahasuese.

Fjalë kyçe: *Kundrinor i zhdrejtë me parafjalë, rrethanor, kritere, gramatikë gjenerative.*

Abstract

The main purpose of this paperwork is to study the problem that we face the indirect object especially with the indirect object with proposition in Albanian language.

So in this paperwork we will explain if we have an indirect object with preposition or an adverb. To explain this we will study especially propositional formation. Which in academic grammar are used as indirect objects with preposition, and in generative grammar, based in value theory or in thematic role and taking in consideration the peak of vocabulary, it's grammar features are not as an object in any case but as we will see, they describe the circumstances in which an action it's done.

As an aid for this paperwork is the clear division between two second parts., objects and adverbs based on the criterias like: thematic criteria, semantic criteria, word pleace criteria, obligatory criteria and the criteria of verb choice.

As a base literature we will use academic grammar books 1, 2 and generative grammar.

In this paperwork we expt to achieve results from the study of indirect object with preposition in the case of it's limitation with the adverb and cooming into conclusion that we have adverbs not indirect object with preposition. For the realisation of this paperwork I have used the linguistic analytics method, descriptive and comparative.

Keywords: *indirect object, adverbs, criteria, generative grammar.*

Gjuhësia gjenerative është drejtimi mbizotërues në gjuhësinë bashkëkohore. Nëse gjuhësia tradicionale teorinë e gjuhës e ndërton nga faktet, gramatika gjenerative konceptohet si një teori e përgjithshme që synon të shpjegojë faktet gjuhësore me anë të strukturës së frazës, teorinë X-bar. Në thelb të kësaj teorie kategoritë leksikore të gjuhës, emri, folja, parafjala, mbiemri, shërbejnë si koka leksikore që projektojnë sintagma të ndërtuara nga këto koka dhe mund të marrin plotësorë, argumentë të brendshëm, modifikues plotës, të cilët kanë një rol ndihmës, pasi shërbejnë për të treguar veçoritë gramatikore të kokës së sintagmës. Kështu, sintagmë sintaksore quajmë një grupim fjalësh të ndërtuara nga një kategori leksikore, e cila shoqërohet nga specifikues dhe plotësorë që janë gjymtyrë të dyta në varësi të kokës leksikore.

Gjymtyrët e dyta funksionale në trajtimin gjenerativist kanë ndryshuar terminologjinë: kundrinorët (argumente të brendshme, plotësorë), rrethorët (cirkostantë), determinantë (caktuesorë). Gjithashtu, kanë ndryshuar fushën e përdorimit të tyre në raport me foljen: sipas valencës, sipas pozicionit që kanë në fjali në varësi të foljes, sipas konceptit të komplementit mbi çdo objekt sintaksor. Kjo gramatikë ka në qendër foljen dhe valencën e saj dhe i vlerëson sintagmat sipas shkallës së lidhjes së tyre me të, duke i ndarë në argumente dhe cirkostantë.

Valenca është aftësia e foljes për të marrë argument. Termi valencë është huazuar nga fjalori teknik i kimisë, ashtu si formula e llojit H₂O tregon që valenca e atomit të oksigjenit është dyfish në krahasim me atë të hidrogjenit, e kështu për të formuar një molekulë ujë është e domosdoshme prania e dy atomeve hidrogjen dhe një oksigjen, në të njëjtën mënyrë për të formuar një fjali me një folje nevojiten dy grupe emërore, që mund të jenë të domosdoshme (kundrinorë) dhe facultative (rrethorë).

- Po, nga dallojnë argumentet e foljes (kundrinorët) nga rrethorët?

Ndër kriteret për identifikimin e rrethorëve dhe të kundrinorëve janë kryesisht formale dhe sintaksore. Ndër kriteret sintaksore përmendim: 1. kriteri i varësisë 2. kriteri i marrëdhënieve 3. kriteri i pyetjes. Këto zbatohen në shumë gramatika të shqipes, por që nuk janë të

mjaftueshme për të bërë dallimin e rrethanorit nga gjymtyrët e tjera të dyta të fjalisë, pasi rrethanori mund të shprehet nga çdo pjesë ligjrate ku ndër më problematike dalin togjet parafjalore. Në ndërtimet parafjalore të shqipes ka vështirësi në dallimin e rrethanorit nga kundrinori. Përfshirja e të gjithë plotësve që i përgjigjen pyetjes me parafjalë në kategorinë e kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë në gramatikën shqipe është i diskutueshëm, sepse në këtë çështje është marrë si kriter pyetja me parafjalë, duke lënë në hije kriteret e tjera që nuk e mbështesin këtë fakt. Ka mjaft raste që i njëjti përbërës mund t'i përgjigjet njëkohësisht një pyetjeje me parafjalë dhe një pyetjeje pa parafjalë.

P.sh. *Mjeku kaloi pranë krevatit të pacientit. Togu pranë krevatit të pacientit* i përgjigjet pyetjes *ku?* Dhe pyetjes me parafjalë *pranë kujt?*. Kriteri i pyetjes dhe kriteri i pyetjes me parafjalë nuk mund të përdoren si dy kriteret të ndryshme për të dalluar përbërës me funksione të ndryshme sintaksore në fjali.

Pra, nuk mjafton kriteri i pyetjes apo vetëm një kriter për të identifikuar gjymtyrët e dyta, por duhen marrë parasysh një sërë kriteresh morfosintaksore e semantike, por, mbi të gjitha, semantike. A. Kananaj propozon se në vend të kriterit të kategorisë morfologjike, nga e cila varet rrethanori, të merret parasysh funksioni sintaksor i kategorisë nga e cila varet rrethanori. Rrethanori atëherë përkufizohet nga autorja si gjymtyrë e dytë fjalie që varet nga folja. Ndërsa, për të bërë dallimin nga kundrinori me parafjalë, autorja ka përdorur kriteret sintaksore: të domosdoshmërisë, të përzgjedhjes nga folja dhe kriterin semantik.

Në nivel semantik: argumentet tregojnë njësitë e përfshira në mënyrë të drejtëpërdrejtë në procesin e përshkruar nga folja, kurse rrethanorët japin vetëm kontekstin ku zhvillohet një proces i tillë. P.sh. *Ana do të lexojë sintaksën javën që vjen*. Në këtë fjali *Ana* dhe *sintaksën* janë argumente që i merr folja, përkatësisht njëri është kryefjalë, *Ana* dhe *sintaksën* kundrinor i drejtë, kurse *javën që vjen* është rrethanor. Në këtë rast folja është dyvalente, sepse merr dy argumente.

Së dyti, argumentet janë të detyrueshme dhe rrethanorët jo, janë fakultative. *Edrini filloi pushimet javën e kaluar*. *Edrini* dhe *pushimet* janë argumente të foljes *filloi*, javën e kaluar rrethanor. Në qoftë se i heqim

fjalën *pushimet*, kundrinorin, fjalia mbetet jogramatikore *Edrini filloi javën e kaluar*, po çfarë? Ndërsa, po të heqim rrethanorin, ajo do të mbetet gramatikore, *Edrini filloi pushimet*.

Së treti, zgjedhja e argumenteve të foljes është e lidhur ngushtë me vetë foljen, kurse zgjedhja e rrethanorëve mund të qendrojë jashtë saj. Folja kalimtare, *filloi*, kërkon medoemos që subjekti të jetë njeri, sepse vetëm njerëzit bëjnë pushime, kurse zgjedhja e rrethanorëve është më e lehtë, sepse mund të kishim: *Edrini filloi pushimet javën e kaluar/muajin e kaluar/dje/në korrik*.

Së katërti, dallim tjetër ekziston në nivel të rendit të fjalëve në fjali, rendi i argumenteve është i ngulitur, ndërsa i rrethanorëve i lirë. Nëse do të ndryshonim rendin e argumenteve, atëherë do të ndryshonte gjithë kuptimi i fjalisë, ndërsa me rrethanorët nuk ndodh kështu, kuptimi mbetet po i njëjti, p.sh., *javën e kaluar Edrini filloi pushimet*, kjo fjali ka të njëjtin kuptim me fjalinë *Edrini filloi pushimet javën e kaluar*. Në të dyja rastet tregojmë se kur fillon pushimet Goni, pra theksi i frazës bie mbi rrethanën e kohës se kur filloi pushimet. Nëse do të ndryshonim rendin e argumentit do të kishim: *Pushimet filloi Edrini javën e kaluar*, theksi i frazës bie mbi vetë argumentin, kundrinën. Në rastin e parë ne nuk ishim të interesuar të mësonim çfarë do të fillonte Edrini, por kohën kur do të fillonte pushimet.

A kemi kundrinorë me parafjalë apo rrethanorë ?

Libri i Akademisë së Shkencave nuk e merr parasysh aftësinë e foljes për të marrë argumente, duke sjellë kështu ngatërrimin e valencës së foljes. Më poshtë po shqyrtojmë rastet që libri i Akademisë i trajton si kundrinorë me parafjalë.

Kundrina me parafjalën **në**.¹ Kjo kundrinë kur varet nga foljet si: *gdhend, skalit, derdh*, shënon lëndën me të cilën përgatitet objekti i shprehur nga kundrina e drejtë, e cila është e pranishme në këto ndërtime: *që kur ishte i vogël ai gdhendte në dru objekte të ndryshme*. Për ta kuptuar më mirë

¹ Libri Akademisë, fq. 267.

zbatojmë kriteret e mësipërme që bëjnë të mundur dallimin midis rrethanorëve dhe argumentit të foljes ose kundrinës.

Në *dru*, merret si kundrina dhe folja gdhend i bie të jetë një folje trivalente. Le ta provojmë nëse plotësohen kushtet në këtë shembull, thamë që argumentet janë të detyrueshme dhe rrethanorët jo, janë të lirë. *Që kur ishte i vogël ai gdhendte në dru objekte të ndryshme. Që kur ishte i vogël ai gdhendte objekte të ndryshme.* Pra, shihet se në të dyja rastet fjalitë janë gramatikore, edhe nëse hiqet grupi i fjalëve, *në dru*, dhe nuk është i detyrueshëm.

Së dyti, rendi i argumenteve është i ngulitur, edhe nëse ndryshohet rendi i tij, ndryshon domethënia e fjalisë, kurse rendi i rrethanorëve është i lirë dhe nuk ndryshon domethënia e fjalisë. *Që kur ishte i vogël ai gdhendte në dru objekte të ndryshme. Ku? në dru*

Në dru ai gdhendte objekte të ndryshme që kur ishte i vogël. Ku? Në dru. Siç shihet, domethënia e fjalisë nuk ndryshon, çka domethënë që *në dru*, kryen funksionin e rrethanorit të vendit.

Së treti, zgjedhja e argumenteve është e lidhur ngushtë me foljen, ndërsa rrethanori qëndron shumë mirë jashtë foljes. *Që kur ishte i vogël ai gdhendte në dru objekte të ndryshme. Që kur ishte i vogël ai gdhendte në dru/në mermer/në gur objekte të ndryshme.* Të gjitha rastet e trajtuara tregojnë që folja gdhendte është dyvalente dhe jo trevalente si mund ta merrnim në fillim dhe është në rolin e rrethanorit të vendit.² Kundrina me parafjalën **në**, kur varet nga folje si: *ndikoj, sundoj, gjej, sjell, ndihmoj, kopjoj, ndjek, imitoj etj.*, shpreh mjetin veglën e instrumentin, me anë të të cilit realizohet veprimi.

Leksionet u shumëzuan në shaptilograf. Këto detaje të ndërlikuara i prodhojnë nxënësit **në torno**. Nga çdo fshat i Shqipërisë mund të flasësh **në telefon**.

Në fjalinë e parë folja është njëvalente, pasi ka një argument, i cili shprehet me një emër. Libri i Akademisë “*në shaptilograf*”, e merr si kundrinë me parafjalë çka bën që folja të jetë dyvalente që merr dy argumente, por realisht “*në shaptilograf*”, tregon më shumë rrethanën sesa kundrinën. Ndaj folja “*u shumëzuan*” është një valente dhe merr vetëm një

² Sintaksë e gjuhës shqipe, fq. 266.

argument dhe njëkohësisht shoqërohet nga një rrethanor vendi, *në shaptilograf*, që tregon ku u shumëzuan leksionet.

Në fjalinë e dytë folja është dyvalente, sepse merr dy argumente. Ndërsa ***në torno*** është rrethanor vendi, sepse tregon më shumë vendin ku prodhoheshin detajet sesa kundrinën.

Po kështu ndodh dhe për kundrinat me parafjalë në rasën kallëzore. Mund të shprehë mjetin ose veglën me të cilën është kryer veprimi:³

1. *Rapsodi popullor këndoi një këngë me lahutë.*

2. *Rapsodi popullor këndoi një këngë.*

3. *Ne udhëtonim me kalë. 4. Ai shkon në qytet me makinë.*

Në fjalinë e parë folja *këndoi* është dyvalente dhe, duke qenë veprorë, ajo kërkon dy argumente, një të jashtëm në funksion të kryefjalës dhe, duke qenë kalimtare, kërkon një kundrinor të drejtë, argument të brëndshëm, *një këngë*, ndërsa, *me lahutë*, është një element periferik që përshkruan rrethanat e kryerjes së një veprimi specifikisht veglën, instrumentin apo mjetin me të cilin është kryer veprimi. Edhe në fjalinë 3 kemi përshkrimin e rrethanës së një veprimi me mjetin me të cilin është kryer veprimi.

Në fjalinë 4 folja është dyvalente, kryefjala ***Ai*** dhe argumenti i dytë që është pjesë e foljes ***në qytet***, që shpreh vendin për ku synon veprimi dhe SP ***me makinë***, nuk është një plotësor, por njësi fakultative.

Kundrina, kur varet nga një folje që shprehi përlllogaritje e matje, mund të shënojë njësitë e kësaj përlllogaritjeje e matjeje. *Dëborë këtu matet me metra.*

Mund të shprehë objektin që shoqëron sendin e shprehur nga kryefjala: 1. *Tenta shkoi në mal me të vëllanë.* 2. *Gjahtarët janë mësuar me vështirësi.*

Sipas Gramatikës së Akademisë, e bazuar në kriteret logjike, shembujt e mësipërm merren si kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë. Por, sipas teorisë së valences, në shembujt e tillë nuk janë pjesë e brendshme e sintagmës foljore, por janë elemente periferike që shprehin shoqërim, mjet dhe kufizim dhe, si të tilla, përshkruajnë rrethanat e kryerjes së një

³ *Libri Akademisë*, fq. 262.

veprimi. Vetëm në rastet kur një sintagmë foljore, koka e së cilës është një folje kalimtare veprorë pranon një sintagmë emërore SE në funksion të kundrinës së drejtë. Foljet *shkoi, janë mësuar* nuk janë kalimtare, sintagma parafjalore nuk është pjesë e brendshme e tyre, por element fakultativ, mungesa e të cilave nuk prish gramatikalitetin e fjalive gjegjëse.

Në shembullin, *Teuta shkoi në mal me të vëllanë. Teuta shkoi në mal.* Shohim që fjalia është e vetëmjaftueshme semantikisht, nuk cenohet gramatikaliteti i saj. Folja *shkoi* është dyvalente me dy argumente, një i brendshëm dhe një i jashtëm në rolin e kryefjalës, kurse SP *me të vëllanë* është element periferik i fjalisë që shpreh marrëdhënie shoqërimi. Pra, vihet re se nuk kemi një kundrinor të zhdrejtë ashtu siç e cilëson Përnaska dhe Gramatika e Akademisë duke u bazuar në kriterin, që SP kur është frymor të vlerësohet si kundrinor i zhdrejtë me parafjalë. Është koka ajo që përcakton strukturën e sintagmës, është ajo që përcakton numrin e argumenteve që shoqërojnë foljen. Nga ky parim hidhen poshtë kriteret logjike, semantike, të pyetjes për përcaktimin e kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë.

Problematike del dhe ndërtimi parafjalor me parafjalën **nga**, e cila del si rrethanor shkaku dhe si kundrinor i zhdrejtë me parafjalë sipas Përnaskës dhe gramatikës së Akademisë: “kur shprehet me emër në rasën emërore me parafjalën **nga** ka raste takimi me kundrinën e zhdrejtë. Kur emri shpreh frymor ndërtimi funksionon si kundrinë, kur emri nuk shpreh frymor ndërtimi funksionon si rrethanor shkaku.”⁴

1. *Pemët u rrëzuan nga era.* 2. *Pemët u rrëzuan nga ariu.*

R. Përnaska zgjedh kriterin e vepruesit frymor për të dalluar kundrinorët me parafjalë të vepruesit. Duke u bazuar në këtë kriter ai i vë të gjitha ndërtimet parafjalore të veprimit, të shoqërimit, të mjetit apo instrumentit të kundrinori i zhdrejtë me parafjalë. Po kështu dhe gramatika e Akademisë e ruan këtë konceptim. Kësaj i kundërvihet Rami Memushaj, i cili e sheh këtë emërtim të kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë të gabuar, meqenëse, sipas tij, quhet kundrinor i zhdrejtë, komplementi i zhdrejtë mbi të cilin ushtrohet veprimi i foljes, dmth se ka

⁴ Libri i Akademisë. Rrethanori, fq. 275

të bëjë me rolet tematike të pacientit (pësuesi) ose të përfituesit. Autori mendon se sintagmat parafjalore që tregojnë objektin e drejtpërdrejtë janë kundrinorë të drejtë, kurse ato që tregojnë kundrinën në mënyrë të zhdrejtë nga veprimi janë kundrinorë të zhdrejtë. Prandaj, nuk ka arsye që të dy kundrinorët me parafjalë të quhen kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë. Duke u mbështetur në kriterin e valencës së foljes, Memushaj i klasifikon shumicën e kundrinorëve të zhdrejtë me parafjalë në mesin e rrethorëve dhe ndërftu përseri komplementë të tjerë, siç është ai i vepruesit. Sipas tij, shembujt e mësipërm: *pemët u rrëzuan nga era* dhe *pemët u rrëzuan nga ariu* janë plotës veprimi për shkak të ndërtimit pësor. Ndryshimi i strukturës nga aktive në pasive ndryshon pozicionin semantik dhe funksional të përbërësve sintaksorë të fjalisë. Kryefjala del në pozicionin e SP të veprimit dhe është një element fakultativ, kurse kundrinori i drejtë del në pozicionin e kryefjalës, në funksionin semantik të pësuesit.

Era theu pemët.

Pemët u thyen nga era.

Pemët u thyen.

Këto togje parafjalore që shprehin subjektin logjik në ndërtime pësore nuk kryejnë funksionin e kundrinorit në fjali dhe, duke qenë se nuk mund të përfshihen në kategorinë e kryefjalës, mbetet që të përfshihen në kategorinë e rrethororit, zgjedhje e cila mund të mbështetet në faktin që këto ndërtime parafjalore kanë kuptim shkakor, kur nuk shprehin një veprues frymor.

Përfundime

Në këtë punim pasqyrova trajtimin gjenerativist të gjymtyrëve të dyta, të cilat kanë ndryshuar terminologjinë si: kundrinor (argument i brendshëm) rrethoror (cirkostant). Kam sqaruar se nuk mjafton vetëm një kriter si kriteri i pyetjes për të bërë dallimin e qartë që ekziston mes dy gjymtyrëve të dyta rrethoror dhe kundrinor, por, për të qenë më të saktë e të sigurt, jemi mbështetur në kriteret si: kriteri semantik, kriteri i rendit të fjalëve, kriteri i detyrueshmërisë, kriteri i përzgjedhjes nga folja.

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë dallon nga rrethanori që është gjymtyrë plotësuese në fjali. Nëse lidhja midis foljes dhe frazës parafjalore është e kushtëzuar nga për zgjedhja semantike e foljes, atëherë ajo shërben si plotës apo argument, në rast të kundërt shërben si rrethanor.

Më lart sqaruar se ndërtimet parafjalore që në Gramatikën e Akademisë trajtohen si kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë, në gramatikën gjenerative, në bazë të teorisë së valencës apo të roleve tematike dhe, duke marrë për bazë kokën leksikore e veçoritë gramatikore të saj, nuk dalin më si kundrinorë në asnjë rast, por, siç u pa, përshkruajnë rrethanat e kryerjes së një veprimi.

Bibliografia:

1. ASHsh (2002). Gramatika e gjuhës shqipe II, Tiranë.
2. Koleci, Flora dhe Turano, Giuseppina (2011). Hyrje në sintaksën gjenerative, Tiranë, SHB e Librit Universitar.
3. Memushaj, Rami (2008). Gjuhësia gjenerative. Tiranë, SHB e Librit Universitar.
4. Kananaj, Anila (2008). Çështje të rrethanorit në gjuhën shqipe. Studime filologjike, nr 1-2.
5. Kananaj, Anila (2012). Trajtimi i rrethanorit në gramatikat e gjuhës shqipe. S. filologjike, nr 1-2.
6. Përnaska, Remzi (1970). Rreth disa çështjeve të kundrinave në gjuhën shqipe. Tiranë Studime filologjike, nr. 4.

Zana PREKAZI

GJYMTYRËT E VEÇUARA, FJALITË E NDËRMJETME DHE FJALITË E NDËRKALLURA TË SHQIPES – TRI KATEGORI, NJË FUNKSION

Abstrakt

Në këtë punim teorik trajtohen gjymtyrët e veçuara, fjalitë e ndërmjetme dhe fjalitë e ndërkallura të shqipes¹ mbi bazën e pikëpamjeve të gjuhësisë strukturale. Në aspektin sintaksor përshkruhen veçoritë strukturore të ndërtimeve të shtuara, veçanërisht shkëputja e tyre sintaksore nga klauza² kryesore dhe dallimet sintaksore në raport me klauzat e varura. Për të nxjerrë dëshmi e argumente shkencore në favor të qasjes së gjuhësisë strukturale janë analizuar shembuj të vjelë nga Gramatika e Akademisë (2002), si përfaqësuese e gramatikave preskriptiviste të traditës. Pastaj, mbi bazën e analizës cilësore që u bëhet këtyre shembujve, punimi shtron nevojën për rikategorizim të ndërtimeve të shtuara duke vënë në plan të parë strukturën dhe funksionin e jo atë se çfarë shprehin. Një rikategorizim i tillë do ta përfronte analizën gramatikore të shqipes me atë të gjuhëve evropiane.

Fjalët çelës: *ndërtim i shtuar, klauzë e varur, ndajshtrim, shkëputje sintaksore, kuptim, funksion, strukturë*

¹ Në këtë punim për qëllime praktike për këto tri kategori do të përdorim termin gjithëpërfshirës “*ndërtim i shtuar*” (ang. *supplements*), përveç kur na duhet t’i emërtojmë sipas autorëve të caktuar – atëherë emërtimet përkatëse do t’i fusim në thonjëza.

² Në këtë punim do të ndjekim termin “klauzë” sipas Sejdiu-Rugovës (2017) për ta dalluar këtë ndërtim sintaksor nga koncepti tradicional i fjalisë.

Abstract

This theoretical paper discusses supplements in Albanian on the basis of structural linguistic views. Structural features of supplements, in particular their syntactic non-integration from the main clause and the syntactic differences with dependent clauses are described syntactically. In order to draw scientific evidence and arguments in favor of the approach of structural linguistics, examples extracted from Academic Grammar (2002), as a representative of the prescriptive traditional grammars, have been analyzed. Then, on the basis of the qualitative analysis done to these examples, the paper raises the need to re-categorize supplements taking into account first their structure and function and not what they express. Such a re-categorization would approximate the grammatical analysis of Albanian with that of European languages.

Keywords: *supplement, dependent clause, apposition, syntactic non-integration, meaning, function, structure*

1. Hyrje

Studimi i ndërtimeve të shtuara në gjuhësi është ende në një fazë fillestare. Karakteristika themelore që i bën këto ndërtime të dallojnë nga kategoritë e tjera është mosintegrimi i tyre në sintaksën e klauzës kryesore dhe është pikërisht kjo shprehje sintaksore ajo që ua vështirëson studiuesve përcaktimin e tyre në sintaksë. Ato që Huddleston & Pullum (2002) i kategorizojnë si “*Supplements*” në gramatikën e tyre strukturaliste të anglishtes, në sintaksën e gjuhës shqipe (ASHSH, 2002) diskutohen në tre kapituj të veçantë, si: “gjymtyrë të veçuara”, “fjali të ndërmjetme” dhe “fjali të ndërkallura”. Me anë të këtij punimi do të sjellim disa argumente se pse një kategorizim i tillë i trefishtë nuk është i nevojshëm për ndërtime që kryejnë funksionin e nejtë. Për këtë qëllim, mëtohet të diskutohen e shpërfaqen teoria preskriptiviste dhe teoria deskriptiviste, të përfaqësuara nga gramatika që janë referencë e studimit dhe të nxirren dëshmi e argumente shkencore në favor të kategorizimit me bazë strukturale.

2. Përkufizimi dhe kategorizimi

“Gjymtyrët e veçuara”, “fjalitë e ndërmjetme” dhe “fjalitë e ndërkallura” në Gramatikën e Akademisë (2002) ilustrohen përmes shembujve në vijim:

- [1] *Njëri, gazetari më i ri, ishte pothuajse i panjobur për të.*³
[“gjymtyrë e veçuar”]
- [2] *Kishim ndryshuar, ky s’do mend, po gjallëria e viteve të shkollës vlonte gjithnjë në zemrat tona.*⁴
[“fjali e ndërmjetme”]
- [3] *Edhe kur dilte jashtë, - ky ndodhte rrallë, nuk e ndiente veten as në dhe, as në qiell.*⁵
[“fjali e ndërkallur”]

³ Marrë nga Gramatika II: 332.

⁴ Marrë nga Gramatika II: 639.

Shprehja e nënvizuar në [1] ka formën e një sintagme emërore që e kryen funksionin e ndajshimit të veçuar dhe bën pjesë në kategorinë e “gjymtyrëve të veçuara”, ndërsa klauzat e nënvizuara në [2] dhe [3] për nga forma ngjajnë me klauzat kryesore (kanë kryefjalë dhe kallëzues) dhe bëjnë pjesë tek “fjalitë e ndërmjetme”, përkatësisht tek “fjalitë e ndërkalura”. Ndonëse të kategorizuara ndryshe në gjuhën shqipe, këto ndërtime ndajnë karakteristikat e njëjta sintaksore: (a) nuk janë të integruara në strukturën sintaksore të klauzës, (b) veçohen nga klauza përmes intonacionit në të folur apo pikësimit në të shkruar dhe (c) shtohen në fillim, në mes ose në fund të klauzës (Huddleston&Pullum, 2002). Sa i përket pikësimit, këto ndërtime zakonisht ndahen me presje, por në raste të caktuara mund të ndahen edhe me kllapa, viza, pikëpresje apo kombinim të më shumë sesa një shenje të pikësimit, sidomos kur dy e më shumë ndërtime e përmbajnë njëra-tjetrën në fjali.

3. Lidhja e dobët sintaksore

Karakteristika themelore që i dallon ndërtimet e shtuara nga kategoritë e tjera është mosintegrimi i tyre në sintaksën e klauzës kryesore. Në aspektin sintaksor, sintagma emërore e nënvizuar në [1], *gazetari më i ri*, funksionon si ndërtim i shtuar i fjalës që i referohet, pra *njëri*. Ky ndërtim lidhet me shprehjen bartëse semantikisht, por në aspektin sintaksor nuk funksionon si klauzë e varur e saj. Marrë parasysh shkëputjen sintaksore që ka me shprehjen bartëse, Huddleston & Pullum propozojnë që këto ndërtime të paraqiten në diagram si të veçuara nga përbërësit sintaksorë. Figura në vijim paraqet një ilustrim vizual të këtij veçimi:

⁵ Marrë nga Gramatika II: 653.




Figura 1. Paraqitja sintaksore e ndërtimit të shtuar. Shkëputja sintaksore është shënuar me shigjetë të ndërprerë.

Heringa (2011) në parim pajtohet me autorët në fjalë, por e specifikon tutje këtë lidhje të dobët sintaksore duke thënë se shprehja bartëse dhe ndërtimi i shtuar kanë një “strukturë të veçantë sintaksore” që reflektohet edhe në komponentët e tyre semantikë dhe fonologjikë. Sipas tij, kjo lidhje ka natyrë të përfshirjes e jo të dominancës, gjë që e sqaron pavarësinë e ndërtimeve të shtuara në raport me klauzën kryesore.

Ngjashëm, edhe në Gramatikën e Akademisë (2002) vihet në pah lidhja e dobët sintaksore që këto ndërtime kanë me tekstin kur thuhet se “gjymtyrët e veçuara” kanë “një mëvetësi relativisht të madhe”, se “fjalitë e ndërmjetme” përfshihen në fjali a periudhë “pa qenë organikisht [të] lidhur[a] me to” dhe se “fjalitë e ndërkallura” kanë “një lidhje të dobët logjike me përmbajtjen e tekstit”, por dallohen pa nevojë tipa të ndryshme fjalish mbi bazën e asaj se çfarë shprehin ato: ngarkesë më të madhe kuptimore dhe stilistike (“gjymtyrët e veçuara”), kuptime modale e emocionale-ekspresive (“fjalitë e ndërmjetme”), sqarim të kuptimit të fjalisë kryesore (“fjalitë e ndërkallura”), sepse, pavarësisht shkaqeve të veçimit të këtyre fjalive në bazë të kuptimit, nuk vërejmë ndonjë dallim, le të themi, mes klauzave *kejo s’do mend* dhe *kejo ndodhte rrallë* (shih [2] dhe [3] më lart) në aspektin strukturor, në funksionin që e kryejnë apo në vendin që zënë në fjali.

4. Format me të cilat shprehen

Për nga forma ndërtimet e shtuara mund t'u përkasin kategorive të ndryshme gramatikore prej të cilave veçojmë klauzat lidhore, sintagmat emërore (ku bën pjesë edhe ndajshtimi i veçuar), klauzat e pavarura (kryesore), sintagmat mbiemërore, klauzat pa folje, sintagmat parafjalore, sintagmat ndajfoljore, pasthirrmat dhe klauzat që fillojnë me lidhëz. Në gjuhën shqipe sintagmat emërore, sintagmat mbiemërore dhe sintagmat ndajfoljore futen tek “fjalitë e veçuara”, klauzat që fillojnë me lidhëz bashkërenditëse futen tek “fjalitë e ndërkallura” ndërsa klauzat kryesore dhe ato me lidhëza nënrenditëse futen edhe tek “fjalitë e ndërmjetme” edhe tek “të ndërkallurat”, varësisht nga ajo se çfarë shprehin.

Sintagmë emërore:	Njëri, <u>gazetari më i ri</u> , ishte pothuajse i panjohur për të.
Mbiemër:	<u>I dëshpëruar</u> , Dini përplasi shkopin pas raftit.
Ndajfolje:	<u>Çuditërisht</u> , nuk ishte këtu kur ndodhi.
Klauzë lidhore:	Studentët, <u>të cilët e kanë kaluar provimin</u> , mund të hyjnë në klasë.
Klauzë pa folje:	Shokët e mi, <u>shumë prej të cilëve të lodhur</u> , shkuan në festë.
Klauzë kryesore:	Kishim ndryshuar, <u>kjo s'do mend</u> , po gjallëria e viteve të shkollës vlonte gjithnjë në zemrat tona.

5. Ndajshtimi si nënkategori e ndërtimeve të shtuara

Ndërtimi i shtuar që shprehet me sintagmë emërore e që e saktëson kuptimin e shprehjes bartëse, përkatësisht ndajshtimi i veçuar, konsiderohet nënkategori e ndërtimeve të shtuara. Kriteri kryesor që ndajshtimi e përmbush është se mund të qëndrojë në vend të gjithë ndërtimit, ndërsa kjo nuk ndodh me strukturat e tjera. Siç shihet nga shembujt në vijim, nëse ndajshtimin e veçuar e zëvendësojmë me tërë

ndërtimin (shembulli [7]), fjalia ka prapë kuptim, ndërsa kur kemi struktura të tjera, në [8] dhe [9] për shembull, fjalitë janë jogramatike.

[7]

- a. Njëri, gazetari më i ri, ishte pothuajse i panjohur për të.
- b. Gazetari më i ri ishte pothuajse i panjohur për të.

[8]

- a. Kishim ndryshuar, kjo s'do mend, po gjallëria e viteve të shkollës vlonte gjithnjë në zemrat tona.
- b. *Kjo s'do mend po gjallëria e viteve të shkollës vlonte gjithnjë në zemrat tona.

[9]

- a. Edhe kur dilte jashtë, - kjo ndodhte rrallë, nuk e ndiente veten as në dhe, as në qiell.
- b. *Kjo ndodhte rrallë nuk e ndiente veten as në dhe, as në qiell.

6. Ndërtimet e shtuara dhe klauzat e varura

Autorë të ndryshëm, sidomos në disa nga veprat më të hershme të literaturës (Curme, 1947; Acuna-Farina 1996) e shohin ndajshkrimin në marrëdhënie varësie me fjalën së cilës i referohet. Sidoqoftë, problemi kryesor me këtë tezë është se sintaksorisht nuk ka ndonjë kriter që tregon se cili element është kokë e cili është element i varur i saj. Për më tepër, edhe pse ndërtimet e shtuara për nga pesha e kuptimit ngjajnë me klauzat e varura, ato, meqë nuk janë të integruara në sintaksën e fjalisë, nuk mund të shërbejnë si klauzë e varur e ndonjë klauze tjetër. Dy shembujt në vijim e vënë në pah këtë dallim:

[10]

- a. [Studentët që e kanë kaluar provimin] mund të hyjnë në klasë.
- b. Studentët, të cilët e kanë kaluar provimin, mund të hyjnë në klasë.

Në [10a] klauza lidhore shërben për ta përcaktuar tutje fjalën *Studentët*, pra vetëm studentët të cilët e kanë kaluar provimin mund të hyjnë në klasë. Në anën tjetër, në [10b] të gjithë studentët mund të hyjnë në klasë, fakti se e kanë kaluar provimin është vetëm një informatë shtesë, por nuk shërben si përcaktor i fjalës *Studentët*.

Ndërtimi i shtuar e ndërpret klauzën kryesore aty ku klauza e varur nuk mund ta bëjë normalisht:

[11] Motivet që gërshetojnë në temat dhe në subjektet e veprave të tij, janë të shumta, e, do të thoshim, të gjithanshme.

Në shembullin [11] ndërtimi i shtuar hyn në mes të lidhëzës bashkërenditëse dhe elementit të dytë bashkërenditës. Nëse e shndërrojmë ndërtimin e shtuar në pjesë të brendshme të bashkërenditjes, kemi një sintagmë jo gramatikore: **të shumta e do të thoshim të gjithanshme*.

Po ashtu, për dallim nga klauzat e varura, ndërtimet e shtuara mund ta kenë formën e një klauze kryesore me forcë të pavarur ilokucionare:

[12] Atë kohë – a e mban mend? – ishim vetëm 17 vjeç.

Vetëm ndërtimi i shtuar parashtron pyetje, ndërsa kjo pyetje nuk është pjesë e klauzës kryesore e cila është në dëftore. Nga aspekti semantik Potts (2005) i quan këto “shprehje të ngopura” (ang. saturated).

7. Përfundim

Në formë përmbledhjeje të asaj që u trajtua më lart, mund të nxirret si përfundim se nëse nisemi nga koncepti se analiza sintaksore e fjalisë duhet të bëhet duke pasur parasysh në rend të parë strukturën, në rend të dytë funksionin dhe në rend të tretë kuptimin e saj, atëherë ndërtimet e këtyre tri kategorive në fakt e kryejnë të njëjtin funksion – atë të një ndërtimi të shtuar. Ato ndajnë të njëjtat karakteristika sintaksore: (a) nuk janë të integruara në strukturën sintaksore të klauzës, (b) veçohen nga klauza përmes intonacionit në të folur apo pikësimin në të shkruar dhe (c)

shtohen në fillim, në mes, ose në fund të klauzës. Për më tepër, shembujt që i kemi zgjedhur nga Gramatika e Akademisë (2002) (në [2] dhe [3]) për të ilustruar argumentet tona nuk dallojnë as nga forma/struktura me të cilën shprehen, në këtë rast, me formën e një klauze kryesore. (Ndërtimi i nënvizuar nën [1] shprehet me sintagmë, por ky dallim sintagmë-klauzë nuk paraqet bazë që të bëjmë kategorizime të veçanta). Sa i përket kuptimit, mendojmë se nuk duhet të ketë kritere të ndryshme për emërtimin e gjymtyrëve, kur ato përmbushin të njëjtat funksione. Pra, përpjekjet për të gjetur emërtime të reja për çdo kuptim janë të padobishme dhe veçse e ngarkojnë dhe e komplikojnë pa nevojë studimin e sintaksës së gjuhës shqipe.

Referenca:

1. Acuña-Fariña, J.C. (1996). The puzzle of apposition. On so-called appositive structures in English. Santiago de Compostela: Universidade, Servicio de Publicacións e Intercambio Científico.
2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 2: Sintaksa*. Tiranë, AL: Botim i Akademisë së Shkencave.
3. Curme, G.O. (1947). *English Grammar*. New York: Barnes & Noble.
4. Heringa, H. (2011). *Appositional Constructions*. Holandë: LOT
5. Huddleston, R., & Pullum, G. K. (2002). *The Cambridge grammar of the English language*. Cambridge, UK: Cambridge University Press.
6. Potts, C. (2005). *The logic of conventional implicatures*. New York: Oxford University Press.
7. Sejdiu-Rugova, L. (2010). Përcaktorët në gjuhën shqipe – çështje të klasifikimit dhe të përdorimit të tyre. *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë, dhe Kulturën Shqiptare*, 29(1), 135-142. Marrë nga https://drive.google.com/file/d/0B2_VOhY4GgeRSmNxUD_I5YVExdFE/edit?usp=sharing
8. Sejdiu-Rugova, L. (2017). Çështje të sintaksës së shqipes – Koncepte dhe klasifikime. *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën,*

Letërsinë, dhe Kulturën Shqiptare, 36, 5-13. Marrë nga
[https://filologjia.uni-pr.edu/getattachment/Seminari/Seminari-36-\(1\).pdf.aspx](https://filologjia.uni-pr.edu/getattachment/Seminari/Seminari-36-(1).pdf.aspx)

Zeqije XHAFÇE

**LESIKALIZIMI I NGJYRAVE NË GJUHËN
SHQIPE: HUAZIMET DHE SINONIMET**

Abstrakti

Leksikografia e gjuhës së sotme shqipe tregon se gjuha shqipe posedon një leksik të pasur të ngjyrave për shkak të kontakteve gjuhësore me gjuhë të ndryshme gjatë historisë së zhvillimit të saj. Hipoteza e këtij punimi është se faktorët shoqërorë dhe kulturorë ndikojnë në ndryshimin e vokabularit të gjuhës, leksikalizimin e termave dhe, andaj, edhe në përkufizimet e kategorive të ngjyrave.

Analiza e termave të ngjyrave dhe sinonimeve të tyre është bërë në tri nivele: 1. niveli morfologjik, 2. niveli semantik bazuar në leksikografinë e gjuhës shqipe dhe 3. niveli semantik bazuar në përdorimin aktual të termave të ngjyrave. Duke u mbështetur në faktin se struktura konceptuale e sinonimeve mund të ndryshojë, ky punim ka hulumtuar domenin e përdorimit të tyre në krahasim me përkufizimet e tyre të dhëna në fjalorët e gjuhës shqipe. Për të regjistruar gjendjen aktuale të leksikalizimit të ngjyrave, si dhe për të përcaktuar atitudën e folësve ndaj termave të huazuar, kemi bërë një pyetësor me 100 pjesëmarrës, i cili është përbërë nga një paletë të 24 kategorive të ngjyrave. Nga pjesëmarrësit është kërkuar që t'i emërtojnë ngjyrat dhe të japin mendimin e tyre se si mund të emërtohen ndryshe, ose si i emërtojnë të tjerët. Analiza e përdorimit të termave të ngjyrave është realizuar duke u mbështetur në KNGJSH, i cili përmban rreth 20.000.000 përdorime fjalësh.

Fjalët kyçe: *termat themelore të ngjyrave, gjuhë shqipe, leksikalizimi, universalizmi, relativizmi, huazimet, sinonimet*

Abstract

The etymological dictionary of the Albanian language, limited between the X-XII centuries (Orel, 1998) as well as that of Topalli (2017) record more than 20 color terms. Modern Albanian lexicography shows that Albanian language owns a rich lexicon of color terms both because of derivation capacity and language contacts through the history of Albanian language development. Borrowings are considered to be products of the phenomenon of linguistic interference (according to Weinreich's 1963 terminology) with the socio-cultural linguistic basis as one of its foci. The hypothesis of this paper is that the social and cultural factors effect the lexico-semantic changes of a language, the lexicalization methods, hence also the limitation and definition of color categories.

This paper is the result of a exhaustive study which have aimed to determin the basic color terms of contemporary Albanian, give the description of lexicalization forms used in Albanian and discuss the status of Albanian in the context of universalist vs. relativist theory of colors.

The analysis of color terms and their synonyms is done on three levels: 1. morphological level, 2. semantic level based on Albanian lexicography, and 3. semantic level based on actual use of color terms. Drawing on the fact that the conceptual structure of the synonyms may change this paper has explored the domain of thier usage in comparison to their definitions registered in specialized and everyday. To determine the status of color terms as well as to determine the speakrs attitude toward borrowed terms we conducted a survey in which a hundred of speakers took place. The speakers are asked to name 24 color categories, as well as to share their opinion about how they might be named differently, or how others name them. The analysis of color terms usage is based on the NCAL, which summarizes about 20,000,000 tokens.

Key words: *basic color terms, albanian, lexicalisation, universalism, relativism, borrowings, synonyms*

Hyrje

Qëllimi kryesor i këtij punimi është definimi i modeleve të leksikalizimit të ngjyrave në gjuhën shqipe, definimi i modeleve të ndryshme gjatë kategorizimit të spektrimit të ngjyrave, si dhe të definohet se si ndërtohen gjuhësisht domenet e dryshme të ngjyrave. Studimet e deritanishme në këtë fushë kanë qenë të fokusuara në vëzhgimin e dallimeve midis modeleve të leksikalizimit të përdorura për ta shprehur kuptimin. Janë përpjekur që të gjejnë cilat janë dallimet në përdorimin e domeneve në emërtimin e ngjyrave (perime, pemë, minerale etj.). Po ashtu, janë marrë edhe me pyetjet: a luajnë ndonjë rol dallimet kulturore? Cilat janë tipat e tjerë të ndërtimit të fjalëve? Modelet e rregullta të leksikalizimit a mund të definohen si modele për realizimin e kuptimit “N-Like/Sikur-N” në gjuhët Indo Europiane (Rafaelli et al., 2018) ku edhe mendohet se bën pjesë gjuha shqipe.

Gjatë hulumtimit të konceptit të ngjyrës Wierzbicka (2006b; 2007d) shtron hipotezën se ky koncept i referohet një lloj informacioni: informacionit të bazuar në përvojën vizuale. Sipas saj, universalet semantike mund të etablohen vetëm duke e vëzhguar të folmen reale të njeriut në disa gjuhë dhe duke u përpjekur që të identifikohen pikat e përbashkëta të përdorimit gjuhësor. Prandaj, besohet se duke u mbështetur në këtë hipotezë mund të pajtohen dy aspekte fundamentale të gjuhës dhe mendimit, të cilat shpeshherë konsiderohen si të papajtueshme: *relativiteti* dhe *universaliteti*. Konceptet njerëzore universale, të cilat janë të leksikalizuara në të gjitha gjuhët, formojnë një bazë për një numër më të gjerë të konfigurimeve konceptuale, shumica e të cilave janë specifike për gjuhë të caktuar. Për më tepër, ato mundësojnë një parametër të përbashkët për përshkrimin dhe krahasimin e këtyre konfigurimeve nëpër gjuhë dhe kultura të ndryshme. Ai mund të implementohet edhe në semantikën vizuale edhe në domenin konceptual. (Goddard & Wierzbicka, 2014).

Mendimi universalist, i cili ka dhënë kontribut të çmueshëm në hulumtimet e antropologjisë kognitive për teorinë e prototipeve, bazohet në studimin e ngjyrave të Brent Berlin dhe Paul Kay. Në terminologjinë klasike të ngjyrave të quajtur *Basic Color Terms (Termet bazë të ngjyrave)* këta dy studiues morën si bazë pikëpamjen tradicionale, sipas të cilës, gjuhët e

ndryshme mund të gdhenden në spektrumin e ngjyrave në mënyra arbitrare. Rregullsia e parë që kanë vërejtur ka qenë në ato që ata e quanin termat bazike të ngjyrave. Një term i ngjyrës për të qenë bazik : 1. duhet të përbëhet nga vetëm një morfemë, siç është termi ang. *green* për ngjyrën e gjelbër dhe jo nga më shumë morfema, siç është ang. *dark green* (e gjelbra e mbyllur) ose *grass-coloured* (ngjyrë bari). 2. nuk mund të jetë e përfshirë brenda një ngjyre tjetër. Ang. *scarlet* (e kuqe e ndezur), për shembull, është përfshirë brenda ngjyrës ang. *red* (e kuqe). 3. nuk mund të jetë e përkufizuar me numër të vogël të objekteve. Për shembull, termi *blond* në anglisht limitohet vetëm me flokët, druri dhe eventualisht ndonjë objekt tjetër. 4. Duhet të jetë e njohur për të gjithë në përgjithësi, sikur termi ang. *yellow* (e verdhë) në krahasim me termin ang. *saffron* (e verdhë shafrani). (Lakoff, 1987).

Shkurtimisht, qasja e parë mbron se kufijtë e kategorive përcaktohen sipas konventave gjuhësore (Wierbizcka, 2014), ndërsa tjetra mbron se kategoritë e ngjyrave organizohen rreth një fokusi universal (Berlin&Kay, 1969). Mirëpo, kohëve të fundit, kjo temë është aktivizuar prapë dhe janë shfaqur qasjet të cilat i bashkojnë këto dy mendime të kundërta. Në njërën anë, mendohet se kategorizimi i ngjyrave është nën ndikimin e përdorimeve gjuhësore, siç janë shprehjet frazeologjike et. që i nxisin trendet kognitive, faktorët socio-kulturore dhe vlerat e konteksteve të ndryshme. (Bazanella, Ronga 2015), nga ana tjetër, kemi mendimin sipas të cilit ‘Çdo ngjyrë, është ngjyrë fokale deri në një shkallë, formohet duke u mbështetur në parimet e përgjithshme të kategorizimit (Jameson, D’Andrade). Bazanella, në punimin e saj rreth variacioneve dhe invariancive të shfaqjes së ngjyrave, thotë se ‘Thierry dhe të tjerët (2009), kanë provuar se një kategori e ngjyrës e cila ekziston në fjalorin e një personi, ndikon mbi procesin e perceptimit të asaj ngjyre’, dhe jep shembullin e greqishtes bashkëkohore ku spektrumi i ngjyrës së kaltër ndahet në dy kategori, e mbyllur dhe e çelur dhe folësit e greqishtes i identifikojnë dhe ndajnë më shpejt të kaltrën e mbyllur dhe të çelur në krahasim me anglishtfolësit. Po ashtu, përmend Zhou *etj.* (2010) i cili ka thënë se mbi kategoritë leksikore të mësuara të ngjyrave ekziston i njëjti ndikim.’’ (Ronga, Bazanella 2015) Këto eksperimente tregojnë se

kategoritë gjuhësore mund të ndikojnë mbi procesin e perceptimit. Prandaj, perceptimi na ofron një model të komplikuar të ndikimit të ndërsjellë midis kategorive konceptuale dhe gjuhës. Sipas Bazanellës dhe Akmanit (2003), “këto eksperimente e theksojnë dinamikën e tepërt të procesit të kategorizimit të ngjyrave. Kategoritë e ngjyrave mund të shfaqen në një mënyrë shumë fleksibile dhe të shpejtë dhe mund të përshtaten me modelin e karakteristikave kontekstuale”. (Akman, Bazanella, 2003). Sipas universalistëve, ngjyra është një fushë e leksikalizuar në mënyrë universale. Berlin dhe Kay (1969), janë përpjekur që të provojnë se të gjitha gjuhët posedojnë kategori bazike me një numër të kufizuar (2>3>4-5>6-7>11), i cili mund të mbërrijë deri në 11 TTN. Termat themelorë të ngjyrave (TTN), përcaktohen duke u bazuar në kriteret kryesore të lartëshënuara. Përveç kësaj, një karakteristikë tjetër e TTN-së është se huazimet të kohëve të afërta janë cilësuar si të dyshimta. (Berlin ve Kay, 1969:4-7) Për këtë arsye, nuk mund të pranohen si TTN. Shqipja dihet si një gjuhë e cila ka një numër të vogël të fjalëve burimore. Kur shikohet historia e zhvillimit të saj shihet se në çdo fazë të zhvillimit të saj ka huazuar nga gjuhët me të cilët ka pasur kontakte. Kështu që, me një shikim në fjalorët etimologjikë të saj mund të shihet se ndër huazimet nga gjuha latine, romene dhe sllave ekzistojnë edhe termat e ngjyrave. Mirëpo, meqenëse ato nuk mund të marrin pjesë ndër huazimet e reja, i kemi analizuar kushtet e ndodhjes së tyre ndër TTN.

Në Fjalorin etimologjik të V. Orelit, që është i kufizuar me shekujt X-XII, shihet se gjuha shqipe si një gjuhë indoevropiane posedon dy terma të ngjyrave, *bardhë* (*bardhë*>IE bherag) dhe (*i zī*>IE eed) *zëzë* që rrjedhin nga proto-shqipja dhe si të tilla marrin pjesë ndër fjalët e rralla burimore shqipe. Në këtë grup të fjalëve hyn edhe termi *blertë* (*blertë*>IE bhlaros), i cili përdoret për të denotuar ngjyrën e gjelbër (në shqipen bashkëkohore një nga kategoritë e ngjyrës së gjelbër). Ndërsa, sipas Berlin dhe Kay-it, termi i tretë i TTN-së duhet të jetë termi i cili do të denotonte ngjyrën e *kuqe*. Në gjuhën shqipe termi i përdorur për denotimin e ngjyrës së kuqe është një term i huazuar nga romanishtja me prejardhje sanskrite

kuqe (*coccoeus*).¹ “Shqipja, nga latinishtja huazoi termin *verdhë* për të denotuar ngjyrën e verdhë, si dhe termin *gjelbër* për të denotuar ngjyrën e gjelbër.” (Topalli, 2017) Ajo që duhet theksuar këtu është se, këta terma kanë pësuar ndryshime kuptimore gjatë procesit të huazimit. Sepse, sipas kufizimeve të fjalorëve etimologjikë (Orel, 1988 dhe Topalli, 2017) shohim se në fillim termi *verdhë* në gjuhën latine ishte përdorur për të denotuar ngjyrën e gjelbër. Ndërsa, termi *gjelbër* në gjuhën burimore është përdorur për denotimin e ngjyrës së verdhë. Termi *kaltër* është një huazim nga gjuha romane. Ky term, në gjuhën burimore, ishte përdorur për të denotuar ngjyrën e verdhë. “Stabiliteti leksikor, sipas gjuhëtarëve të gjuhësisë historike romane përkufizohet si kohëzgjatja e përjetimit të fjalëve latine në gjuhët romane të depërtuara në mënyrë gojore.” (Dworkin, 2016:9-20). Sipas konstatimeve të Dworkin-it (2016) dhe përdorimit të huazimeve me prejardhje latine në gjuhën shqipe, mund të thuhet se nga aspekti diakronik termat latinë kanë treguar stabilitet të ulët leksikor.

Ndryshimi i kuptimit të këtyre termave mund të ilustruhet në këtë mënyrë:

Lat. Galbinus > Arn. Gjelbër Lat. Viridis > Arn. Verdhë Rom.>Lat. Calthinus > Arn. Kaltër



Thamë se, sipas Berlin & Key, gjuha mund të ketë më së shumti 11 terma bazikë të ngjyrave (me përjashtime të rralla). Kur flasim për gjuhën shqipe nuk mund të themi me saktësi se sa TTN ka, sepse deri më tani nuk është bërë një hulumtim i cili tregon numrin e saktë. Në FEGJSH shihet se shqipja ka regjistruar me dhjetra terma të ngjyrave. Ndër termat e lartpërmendur (*bardhë*, *zezë*, *kuqe*, *verdhë*, *kaltër*, dy terma për ngjyrën e gjelbër, *gjelbër* dhe *blertë*) ekzistojnë edhe disa terma të përdorur për denotimin e kategorive të ngjyrës së *hirtë*: *surmë*, *thjermë*, *murg* dhe *murrinë*.

¹ Rusakov, termin «e kuqe» në punimin «Basic color terms of old Albanian writers» e përshkruan si një TTN (2007).

Kjo e fundit është turqizëm dhe përbëhet nga fjala *mor* me prapashtesën –më për formimin e mbiemrave. Topalli (2017), nga ana tjetër, thotë se ky term është trashëguar nga fondi indoeuropian. (Shih Shtojcën 1) Këtu është me rëndësi të ceket se Orel-i thotë se nuk i ka përfshirë huazimet turke për shkak të limitimit kohor të fjalorit. (Orel, 1998) Megjithatë, në këtë leksikon të kufizuar kemi hasur në një term të ngjyrës me burim turk (*murrme*). Jo shumë më vonë, kur filluan të depërtohen fjalët nga turqishtja, u shfaqën edhe termat e rinj të ngjyrave në leksikonin e gjuhës shqipe: *jeshil, mavi, sari, all, kërmëz, pembe, çivit* dhe *gjyvez* etj. Nga ana tjetër, FGJSSH-ja regjistron një numër të konsiderueshëm të termave të ngjyrave të cilat do të diskutohen këtu. Do të thotë, për të kuptuar mirë rolin e turqizmeve në procesin e emërimit të ngjyrave do të merremi edhe me kategorizimin e ngjyrave në gjuhën shqipe dhe mënyrën se si perceptohen ato në komunitetin shqipfolës, deri ku varet kjo nga prapavija socio-kulturore e këtij komuniteti gjuhësor. Fillimisht, kemi bërë analizën morfologjike të termave të ngjyrave për t'i përcaktuar saktësisht modelet e leksikalizimit, të cilat gjuha shqipe i përdor për t'i emërtuar ngjyrat.

Objekt studimi i këtij hulumtimi është korpusi i emrave të ngjyrave të vjela nga këta fjalorë: Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe (1981, versioni online), Fjalori i Gjuhës Shqipe (2006, version online), Fjalori Etimologjik i Gjuhës Shqipe (1998) dhe Fjalori Etimologjik i Gjuhës Shqipe (2017), Fjalori i Orientalizmave të Gjuhës Shqipe (2005), si dhe nga Korpusi Nacional i Gjuhës Shqipe të publikuar *online*.

Studimi ynë e ka cilësinë e një hulumtimi paraprak të domosdoshëm për studimet kros-linguistike që realizohen në këtë fushë. Qëllimet e këtij hulumtimi janë: definimi i emrave të ngjyrave në kuadër të teorisë universaliste; krahasimi i përkufizimeve të emrave të ngjyrave me përdorimet dhe gjendjen aktuale të tyre në korpusin e teksteve të ndryshme; si dhe përcaktimi i rolit të huazimeve dhe sinonimeve gjatë përshkrimit të konceptit të ngjyrave.

Analiza e termave të ngjyrave dhe sinonimeve të tyre është bërë në tri nivele:

1. niveli morfologjik, për të identifikuar të gjitha llojet e leksikalizimit të ngjyrave në bazë të çkajes do të caktohet numri i saktë i termave bazë të ngjyrave sipas teorisë universaliste,

2. niveli semantik bazuar në leksikografinë e gjuhës shqipe, dhe

3. niveli semantik bazuar në përdorimin aktual të termave të ngjyrave.

Duke u mbështetur në faktin se struktura konceptuale e sinonimeve mund të ndryshojë, ky punim ka hulumtuar domenin e përdorimit të tyre në krahasim me përkufizimet e tyre të dhëna në fjalorët e gjuhës shqipe. Për të regjistruar gjendjen aktuale të leksikalizimit të ngjyrave, si dhe për të përcaktuar atitudën e folësve ndaj termave të huazuar, kemi bërë një pyetësor me 100 pjesëmarrës, i cili është përbërë nga një paletë të 24 kategorive të ngjyrave. Pjesëmarrësit e pyetësorit janë studentët e vitit të parë të Degës së Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, të moshës së përfaqshme (18-19), 76 prej të cilëve janë të gjinisë femërore dhe 18 të gjinisë mashkullore. 6 prej tyre nuk i kanë shënuar të dhënat socio-demografike. Pjesëmarrësit janë banorë të qyteteve të ndryshme të Kosovës, siç janë Prishtinë (22), Prizren (1), Vushtrri (7), Podujevë (13), Ferizaj (2), F.Kosovë (5), Lipjan (4), Kamenicë (1), Rahovec (2), Torun (2), Malishevë (7), Frapojë (1), Mitrovicë (1), Viti (2), Klinë (1), Drenas (3), Pejë (1), Suharekë(1), Shtime (1), Gjilan (1), Obiliq(1), Istog (2), Skenderaj (3) dhe të dy qyteteve të Serbisë dhe Malit të Zi; Preshevë (2) dhe Ulqin (2). Pyetësi është plotësuar në ambientin e fakultetit. Nga pjesëmarrësit është kërkuar që t'i emërtojnë ngjyrat dhe të japin mendimin e tyre se si mund të emërtohen ndryshe, ose si i emërtojnë të tjerët. Përveç kësaj janë bërë intervistat edhe me personat në moshën mesatare lidhur me emërtimin e ngjyrave.

Analiza e përdorimit të termave të ngjyrave është realizuar duke u bazuar në Korpusin Nacional të Gjuhës Shqipe i cili përmban rreth 20.000.000 përdorime fjalësh. Korpusi përbëhet nga tekste të zhanreve dhe regjistrave të ndryshme. Pjesa më e madhe përmban tekste letrare dhe artikuj të gazetave. Po ashtu, janë përfshirë edhe tekstet zyrtare të dokumenteve, shkrimet akademike etj.

Hipoteza e këtij punimi është se faktorët shoqërorë dhe kulturorë ndikojnë në ndryshimin e vokabularit të gjuhës, leksikalizimin e termave dhe, andaj, edhe në përkufizimet e kategorive të ngjyrave.

1. Modelet e leksikalizimit të ngjyrave në gjuhën shqipe:

Ekzistojnë disa fjalëformime sipas të cilave leksikalizohen ngjyrat. Derivacioni dhe konversioni janë ndër metodat më të shpeshta. Disa nga ngjyrat e leksikalizuara me konversion janë: *portokalli* (tur.), *vjollcë*, *jargavan* (tur.), *limon* (tur.), *çivit* (tur.) etj. Përveç konversionit, janë dy terma të leksikalizuar me prapashtesën -ër, e cila përdoret për formimin e mbiemrave: *kaltër* dhe *gjelbër*. Kjo prapashtesë përshkruhet si një prapashtesë e cila nuk është shumë produktive (GA:2002) dhe kjo shihet edhe nga fakti që ka formuar vetëm dy terma të ngjyrave. Të dyjat përdoren për të denotuar kategori të ndryshme në gjuhën dhënëse (latinisht). Prapashtesa e dytë e përdorur në leksikalizimin e ngjyrave është - (ë)m(ë). Edhe kjo prapashtesë është e limituar me disa terma të ngjyrave, duke u fokusuar më shumë tek ngjyra e hirtë: tr. *murrmë* (e hirtë e errët), *surmë* (e hirtë e mbyllur), *thjermë* (e hirtë), *thirmë* (e hirtë). Prapashtesa -t(ë), si ajo e fjalës *bler+të*, ende mbetet shumë produktive në leksikalizimin e ngjyrave dhe jep kuptimin “N-like” (si-N) (p.sh. si bari). Në korpus kemi hasur në këta shembuj: *Portokalltë* [si portokalli (tr.)], *Hirtë* [si hiri], *Kaftë* ose *kafenjtë* [si kafe (tr.)], *Purpurtë* [si heliotropi], *Zeshkët* = si gruri ose si bronzë, *Artë* = si ari, *Argjendtë* = si argjendi, *rrimtë* = Që ka ngjyrë qielli të mbyllur në të hirtë a në të gjelbër; i bruztë. Qiell i rrimtë, *bruztë* = Që është në ngjyrë si të kaltër, në ngjyrë qielli të mbyllur, *qelibartë* [si qelibari (tr.)] = e verdhë në të kuqe, e gjelbër si në të kuqe, *kristaltë* [lisi kristali] = e bardhë si kristali, *akulltë* [si akulli], *trëndafiltë* [si trëndafili] etj. Një model tjetër i leksikalizimit të termave është termi “-emë”, i cili ka kuptimin e përafërt dhe emërton ngjashmërinë me objektet dhe sendet e tjera. Ky term përdoret ekskluzivisht në emërtimin e ngjyrave: *bardhëremë*, *kuqërremë*, *verdhemë* dhe *gjelbëremë*, *kaltëremë*. Nuk është regjistruar me ndonjë turqizëm.

Përbërje apo kompozitë është një metodë tjetër e përdorur për leksikalizimin e ngjyrave. Bazuar në dendësinë e përdorimit në KGJSH mund të konkludojmë se ky tip i leksikalizimit është shumë produktiv,

sepse kemi dy fjalë bazë mbi të cilat ndërtohen fjalë të reja, një prej tyre është turqizmi *bojë* dhe tjetra është fjala *ngjyrë*. Këto dy terma janë regjistruar në FGJSSH dhe kanë intensitet pothuajse të njëjtë të përdorimit: *Ngjyrëçelët, ngjyrëgështenjë, ngjyrëtrëndafil, ngjyrë-argjendi, bojëbizele, bojëqielli, bojëqepe, bojëulliri*. Kombinimi i dy termave të ngjyrës po ashtu janë të shpeshta: *jeshilmolle, bardhëqumështi, blumavi, pusezezë, mavi shege*. Termat “ngjyrë” dhe “bojë”(tur.) përdoren edhe në strukturat e frazave p.sh. *ngjyrë trëndafili, bojë qielli* etj. Këto fraza japin kuptimin e njëjtë si kompozita, por kanë funksione të ndryshme sintaktike brenda fjalisë. Ngjyrat definoohen edhe në mënyra perifrastike. Zakonisht përdoret termi *ngjyrë* në frazat: *ngjyrë e përhimtë në të gjelbër, ngjyrë e kuqe si e zjarrit, ngjyrë e zezë e paqartë* etj. Nuk mund të themi me siguri se ekziston një model i leksikalizimit për hijen dhe dritën, por shihet qartë se termat e ndryshëm dhe përdorimet e ndryshme të gjuhës indikojnë në kategori të ndryshme të spektrumit të ngjyrave. Studimi ynë tregon se në gjuhën shqipe nivelet e ndryshme të hijes dhe dritës shprehen me mbiemrat siç janë *i/e çelur - i/e mbyllur, i/e thellë - i/e dobët, i/e rëndë – i/e lehtë*), me prapashtesën “-emë” dhe lokucionet “*që vjen në të..., ..si e..., në të..., ..ka e...*”, të cilat japin kuptimin e përafërt (p.s.h *gjelbër në të verdhë, gjelbër kab e kaltra*). Shembulli më i mirë për këtë janë përdorimet e këtyre termave si terma teknikë, ku kemi hasur në mbiemrat, siç janë: *e errët, e thellë, e mbyllur, e çelur, e dobët, e fortë, e qeshur, e bukur* etj. Për më tepër, në anketën e realizuar me studentet e Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe kemi hasur në mbiemrat e përdorur si modifikues për të shprehur një nuancë të ngjyrës fokale. P.sh. *e kaltër e gjelbër, all e kuqe*.

2. Sinonimia dhe huazimi: Siç kemi përmendur edhe më parë, shqipja është një gjuhë e cila ka shumë huazime nga gjuhë të ndryshme dhe kjo ka shtuar numrin e sinonimeve të termave të ngjyrave. Përkufizimet e termave të ngjyrave janë hulumtuar duke krahasuar fjalorët etimologjikë dhe bashkëkohorë. Për të parë ndryshimet semantike të fjalëve të huazuara i jemi referuar FEGJSH-së. Përdorimet e termave të ngjyrave janë analizuar në platformën e KGJSSH-së, e cila përmban regjistra të ndryshëm. Gjëja e rëndësishme që duhet theksuar këtu është

se në shekullin 14-të fillon ndikimi intensiv i turqishtes. Procesi i njëjtë i leksikalizimit mund të shihet edhe në grupin e turqizimeve që emërtojnë ngjyra. Edhe pse, të marrë si forma monolekseme ato i janë adaptuar edhe modelit leksikor të gjuhës shqipe me të cilin formohen mbiemrat. P.sh.: *Jeshil* (Tur.) - *i/e jeshiltë* p.sh. *çaji jeshil*, *Sari* (Tur.)-*i/e saritë* p.sh. *shamitë e sarita*, *Mavi* (Tur.) *i/e mavitë* p.sh. *sytë mavi*, *Pembe* (Tur.) *i/e pemtë* p.sh. *fustanipembe*, *All-e* (Tur.) *i/e allit* p.sh. *lulja e allit*.

Për ta ruajtur shkurtësinë e tekstit, këtu do t'i përmendim vetëm huazimet nga gjuha turke, duke ilustruar përdorimin e termit «jeshil». Analiza e terminologjisë së mbetur nuk do të raportohet këtu. Këto huazime ende janë shumë aktive, sipas studimeve të bëra², më shumë në ligjerimin bisedimor. Bazuar në përkufizimet e termave të ngjyrave në fjalorët ato shprehin ngjyrën fokale dhe përdoren si sinonime të ashtuquajtur të termave bazikë të ngjyrave. Mirëpo, analiza e përdorimit të tyre ka treguar edhe rezultate të tjera. Thënë ndryshe, kemi vërejtur që ekziston një tendencë për vendosjen e kuptimeve të ndryshme nën çatinë e një termi të vetëm. Nga vëzhgimet tona kemi parë se situata dhe konteksti mund të ndikojnë në perceptim. Në pyetjen “çfarë dallimi ka midis termit *jeshil* dhe *gjelbër*?” kemi marrë shpjegime të ndryshme. Njerëzit, në hapësirat jo formale (jashtë fakultetit), nuk shohin ndonjë dallim midis këtyre dy termave; i përdorin si sinonime të regjistrave të ndryshme të ligjerimit (high-low speech). Sipas tyre, përzgjedhja e termave bëhet varësisht nga shtresimi social dhe regjioni gjeografik i folësve. Mirëpo, një shitëse në butik përdor termin *jeshil* për të paraqitur një kategori të ndryshme të ngjyrës së *gjelbër*. Po ashtu, një numër i vogël i të anketuarve ka përdorur fjalën *jeshil* për ndonjë nga kategoritë e ngjyrës së *gjelbër*. E njëjta mund të thuhet për termin *e blertë* (e gjelbra e gietheve të njoma), e cila, edhe pse është përdorur për kategorinë fokale të ngjyrës së *gjelbër*, nuk janë të pakta përdorimet për denotimin e një kategorie të veçantë të ngjyrës në fjalë. Në korpusin KNGJSH, po ashtu janë regjistruar përdorimet e huazimeve për denotimin e kategorieve të ndryshme të një ngjyre fokale:

² Reinkowski (2002), Kazazis (1969), Desnitskaya (2006, RP) etj.

(1) ...dhe Migenës i kishin shkrepiturë sytë dhe e **gjelbra** iu kthye në **jeshil** si e një mace të egërsuar. — (KGJSH)

(2) *Armina tregon se ngjyra e saj e preferuar nuk është **blu** por **mavi!** (gazeta)*

(3) *Në çastin kur faqet i bëheshin **alle** të kuqe (Kim Mehmeti, 2002)*

Thënë shkurt, sinonimet mund të përdoren ndryshe varësisht nga faktorët socio-kulturorë dhe gjeografikë dhe nga nivelet e ndryshme të të folurit. Duhet cekur se, në tekstet e medieve të Maqedonisë (999 përdorime) dhe Shqipërisë më shpesh haset në termin *jeshil* sesa në termin *gjelbër*. Prapë, në Kosovë dëgjojmë se si prindërit ankohen për përdorimin e fjalëve të huaja në tekstet shkollore, duke thënë se diçka që dikur ishte *gjelbër* tani mësohet si *jeshil*, ose në vend të termit *kaltër* tani përdoret fjala *blu*. Shkaku i kësaj situatë mund të jetë fakti se disa tekste shkollore shkruhen nga autorë të Shqipërisë dhe jo të Kosovës. Një term i cili është markuar si term i ligjërimit bisedimor (FGJSSH) kalon nga të folurit e ulët në të folurit e lartë. Si rezultat pluraliteti të termave që posedon një folës, patjetër se ndikon në qëllimin e përzgjedhjes gjuhësore të fjalëve dhe gjithmonë do të varet nga praktika e përgjithshme e cila lidhet me kontaktet ndërkulturore.

Fig. 1 Paleta e ngjyrave



Fig. Metodët e leksikalizimit






Fig. 2. Dendësia e përdorimit të termave të ngjyrave të përzgjedhura nga ana e pjesëmarrësve

Përfundimi

Nga analiza diakronike është parë se gjuha shqipe është ndër gjuhët që kanë pasur vetëm dy TTN, *bardhë* dhe *zëzë*, për t'u pasuruar më vonë me huazimet e shumta nga gjuhët latine, romane etj. Jostabiliteti leksikor i huazimeve latine (verdhë, gjelbër, kaltër) ka vazhduar edhe në gjuhën e sotme shqipe dhe kjo mund të vlerësohet si arsye për huazimin e termave të ngjyrave nga gjuha turke. Fakti se ndër TTN-të të gjuhës shqipe bashkëkohore gjenden edhe turqizmat (*jeshil*, *sari*, *mavi*), shkakton më shumë se një term themelor për ngjyrat, prandaj gjuha shqipe mund të futet ndër gjuhët të cilat janë përjashtim nga modeli i kategorizimit të ngjyrave sipas teorisë universaliste. Gjuha shqipe sikurse gjuha indoevropiane i emërton ngjyrat duke u nisur nga emrat e metaleve, si rem, bronz; kafshëve, bimëve, mineraleve etj. Emrat e ngjyrave emërtojnë bimë (p.sh. turqizmi *jeshilës*). Nga modelet e leksikalizimit shohim se gjuha shqipe emërton ngjyra sipas modelit «Sikur-N» (e portokalltë, e bruztë, e

qelibartë etj.). Sipas teorisë së universalisteve, këto ngjyra konsiderohen «termat sekondarë». (Berlin&Kay, 1969)

Në qoftë se huazimet pranohen si TTN, atehërë edhe ky term do të hynte në grupin e ngjyrave të shqipes. Mirëpo, në atë rast në qoftë se huazimi injorohet në fazat e mëvonshme, na paraqiten turqizmat si emërtime të ngjyrave, të cilat i plotësojnë kriteret e universalistave. Fakti se përdorimi i turqizmeve nuk shtrihet njësoj nëpër të folme të ndryshme të shqipes e vështirëson klasifikimin e tyre sipas këtyre kriterëve. Fjalorët (FOGJSH, FEGJSH, FEGJT) ofrojnë të dhëna të ngjashme lidhur me fushat semantike të TTN-ve. Të gjitha fjalët e lartpërmendura demonstrojnë një kategori e cila shfaq një spektrum të gjerë të kuptimeve direkte dhe metaforike. Megjithatë, analiza e korpusit dhe anketa e realizuar na japin rezultate të ndryshme dhe nga kjo mund të konkludojmë se sinonimet mund të përdoren arbitrarisht. Disa prej tyre tregojnë tendenca për shprehjen e niveleve të ndryshme të hijes, dritës dhe intensitetit dhe disa prej tyre përdoren për të emërtuar kategori të ndryshme të ngjyrave. (termi *mavi*, përveç ngjyrës së kaltër, siç është përkufizuar në FGJSH, denoton edhe ngjyrën e purpurtë, termi *blumavi* tregon se kombinimi i dy termave denoton një kategori të veçantë). Gjykuar sipas dendësisë së përdorimit mund të konfirmojmë se përdorimi i turqizmeve është zhvendosur në regjistrin e folur, por e ruan frekuencën stabile të përdorimit. Zhvendosja e fjalës nga regjistri i lartë në regjistrin e ulët shkakton ndryshime semantike dhe fitimin e kuptimeve të reja. Ndryshimet semantike të këtyre fjalëve tregojnë se si ndikohet botëkuptimi i një individi dhe një shoqërie. Prandaj, mendojmë se organizimi i termave të ngjyrave rreth një fokusi universal është i diskutueshëm. Ndryshimet semantike të termave të ngjyrave e shtojnë numrin e kategorive të ngjyrave, që do të thotë se në njëfarë mënyre shtohet edhe numri i ngjyrave fokale. Në këtë kontekst, roli i turqizmeve në gjuhën shqipe fiton një rëndësi të veçantë. Për studime të mëtutjeshme rekomandohet hulumtimi i përhapjes së turqizmeve në lokacione të ndryshme gjeografike të folësve dhe dendësia e përdorimit të tyre në dialektet e shqipes.

Bibliografi:

1. Berlin Brent, Kay Paul. (1969). *Universality and Evolution of Basic Colour Terms*, Berkeley: University of California
2. Desnitskaya, A. V. (2006). “Mbi funksionin stilistik të turqizimave në poezinë shqipe”, *Perla Revistë Shkencore–Kulturore*, Viti XI, Nr. 4 (43), s.126-134
3. Dizdari, Tahir. (2005). *Arnavutça'da şark Kökenli Kelimeler Sözlüğü*, Tirana:AIITC-ISESCO
4. Dworkin, Steven. (2016). «Diachronic overview of color terms in the romance languages: the lexical stability of the latin color vocabulary” s.9-20, Silvestre J.P. ve diğ, *Colour and Colour Naming: Crosslinguistic Approaches*, Centro de Linguistica da Universidade de Lisboa, Universidade de Aveiro in Dicionaristica Portuguesa
5. Goddard Cliff, & Wierzbicka Anna. (2014). *Words and Meanings, Lexical Semantics across Domains, Languages, and Cultures*, Oxford: University Press.
6. Grupi i autorëve. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia*, Vëllimi I, Tiranë
7. Jameson KA, D’Andrade RG. (1997). in *Color Categories in Thought and Language*, eds Hardin CL, Maffi L (Cambridge Univ Press, Cambridge, UK), pp 295–319. ^[1]retrieved in: Kay, 2006
8. Kay Paul, Kempton Willett. (1984). *What is Sapir-Whorf hypothesis?*, American Anthropological Association
9. Kazazis, Kostas. (1969). “The status of turkisms in the present-day balkan languages”, *Continuity and Change, International Balkan Conference*, Ekim, (H. Birnbaum and S. Vryonis (eds.)
10. Kryeziu S, (2014), “Shtrirja e shqipës standarde në Kosovë-Gjakovë” distertacioni i pa botuar i doktoratës, i mbrojtur në Fakultetin e Historisë/Filologjisë në Universitetin e Tiranës në Shqipëri

11. Lakoff, George. (1987). *Women, Fire, and Dangerous Things: What Categories Reveal about the Mind*. Chicago: University of Chicago Press.
12. Orel, Vladimir. (1998). *Albanian etymological dictionary*, BRILLEIDEN • BOSTON • KOLN.
13. Topalli, K., (2017), Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe, QSA Botimet Albanologjike: Tiranë
14. Reinkowski, Maurus. (2002). „Kulturerbe oder Erblast? Zum Status der Turzismen in den Staaten Südosteuropas, insbesondere des Bosnischen“, In: *Mediterranean language review* 14. Wiesbaden: Harrassowitz Verlag
15. Regier vd. (2007). “Color naming reflects optimal partitions of space”, *PNAS*, Vol.104. Nr.4.s.1436-1441
16. Ronga Irene, Bazanella Carla. (2015). “The emergence of color categories: Variance and Invariance”, Arienti, G.; Bara, B.G; Sandini, G. (eds.), Proceedings of the EuroAsianPacific Joint Conference on Cognitive Science, Torino, September 25-27, 2015, s. 222-227
17. Rugova, Bardh & Rugova Lindita. (2016). *Gramatika e tekstit të gjuhës shqipe*, Prishtinë: Trembelat.
18. Weinreich, Uriel. (1953). *Languages in Contact. Findings and Problems*, Paris NewYork: Mouton Publishers.
19. http://web-corpora.net/AlbanianCorpus/search/?interface_language=sq (Qasja e fundit: 15 qërshor 2019)
20. <http://www.albeu.com/kerko.php?fraza=jeshil> (Qasja e fundit: 28 maj 2019)

Shtojcë

Fjalorth i termave të ngjyrave të vjela nga fjalorët dhe të regjistruara në korpusin e studimit

1.	Termet e ngjyrave në gjuhën shqipe	Përkufizimet e vjela nga fjalorët FGJSH (2007), FGJSSH(1981), FETGJSH (2017), AED (1998)
2.	Zi (masc); e zezë (fem)	<p>ZI <i>mb.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSH, 1981)</p> <p>1. Që e ka ngjyrën si ngjyra e qymyrit, e blozës, e seres, e katranit etj.; kund. i bardhë. Ngjyrë (bojë) e zezë. Rroba (këpucë, çorape) të zeza. Shami e zezë. Shirit i zi. Lesh i zi. Pe i zi. Mace e zezë. Dele (dhi) e zezë. I zi si korbi. Katran (korb, sterrë, pisë) i zi shumë i zi. Dërrasa e zezë dërrasë e posaçme e lyer me bojë të zezë, që përdoret në shkollë për të shkruar mbi të me shkumës. Topalli (2017): «që e ka ngjyrën si të qymyrit, të blozës a të serës». Fjalë e mbarë e gjuhës. Topalli regjistron një list të gjatë të fjalëve të formuara si rrjedhoj e kësaj rrënje. Disa prej tyre janë: <i>zijos, sijosh, zimosh, zïmukë, zïjukë, nxij, i përçitur, zeshkë, zeshkëje, zeshkët, zeshkan, ezshkaman, zezukë, zeshkim, zezim, zezak, zezëlinë, darzezë</i> etj.</p>
3.	Bardhë (masc); e bardhë (fem.)	<p>BARDHË <i>f.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSH, 1981)</p> <p>1. Ngjyra e bardhë; bojë e bardhë; kund. e zezë. E bardhë e ndritshme. E bardhë në të verdhë. Lyej me të bardhë. Ndryshon si e bardha nga e zeza</p> <p>BARDHË <i>mb.</i></p> <p>1. Që ka ngjyrën si të borës, të qumështit, të pambukut etj., për shkak se i kthen të gjitha rrezet e dritës; kund. i zi. Ngjyrë (bojë) e bardhë. Letër (mjegull, shkumë) e bardhë. Djathë i bardhë. Re të bardha. Rroba (këpucë) të bardha. Këmishë (bluzë, fustan) e bardhë. Lesh (mëndafsh) i bardhë. Pe i bardhë. Kalë i bardhë. Dele (dhi, pulë) e bardhë. Pëllumb i bardhë. Gëlqere (çimento) e bardhë. Mermer i bardhë. Kripë e bardhë. Sheqer i bardhë. Flamur i bardhë. E bardhë si bora. I bardhë qumësht.</p> <p>2. Që ka ngjyrë të afërt me atë të borës a të qumështit, që ka ngjyrë të hapët; i bardhemë. Lëkurë e bardhë. Duar të bardha. Sy të bardhë. Bukë e bardhë. Verë e bardhë. Dru i bardhë. Tokë e bardhë. Metale të bardha. Qelqurina të bardha. Mjaltë i bardhë. Pluhur i bardhë. Gizë e bardhë. Flokë të bardhë. Rruazat e bardha</p>

		<p>të gjakut. anat. Mëlçia e bardhë. anat. mushkëria. Gurë të bardhë. shah. Zhivë e bardhë. kim.</p> <p>3. Që e ka ngjyrën e lëkurës të çelur (si tipar i një race të njerëzve). Raca e bardhë. Njerëzit e bardhë.</p> <p>4. Që ndrit me një dritë të hapët në ngjyrë të qumështit; i qartë, me dritë. Net të bardha. Mëngjes (agim) i bardhë. Dritë e bardhë. Ndriçim (shkëlqim) i bardhë.</p> <p>5. fig. Që sjell mbarësi e lumturi; që sjell gëzim; fatlum, fatbardhë. Ditë (orë) e bardhë. Vite të bardha. Pleqëri e bardhë. Fat i bardhë. Shtëpi (derë) e bardhë. Ardhtë e bardhë! ur. Qofsh i bardhë! ur.</p> <p>Topalli (2017): Fjalë e trashëguar dhe e mbarë gjuhës. Lidhet me rrënjën indoevropiane *bereg- i bardhë, shkëlqen», ku bëjnë pjesë ind. Vj. Bhráajate- shkëlqen «, av. Brāzati «ndrit», lit. Beršta «zbardhet», got. Baírhts «i çelët, i dnritur» (Meyer) Kjo fjalë poashtu jep një list fjalësh të reja të cilat formohen si rrjedhoj: <i>bardhajakë, bardhan, bardbec, bardhësi, bardhëremë, bardhishë, bardhoç, bardhol, bardhoj, bardhush, bardhëllak, , bardhëlleme, lubardhan, i zbardhëlleme etj.</i></p>
4.	Kuq (masc); e kuqe (fem)	<p>KUQ <i>mb.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSH, 1981)</p> <p>1. Që ka ngjyrën e gjakut, të lulëkuqes etj. Ngjyra e kuqe e kuqja. Flamur i kuq. Ylli i kuq. Bojë e kuqe. Verë e kuqe. Fustan i kuq. Këpucë të kuqe. Çantë e kuqe. Shall i kuq. Fjongo e kuqe. Laps i kuq. Flakë i kuq. I kuq si gjaku.</p> <p>2. Me shumë gjak, që i ka vërshuar gjaku në fytyrë etj. dhe ka marrë ngjyrën e tij, i përskuqur (për fytyrën ose për pjesë të tjera të trupit); i kuqërremë. I kuq në fytyrë. Me duar të kuqe. Me sy të kuq.</p> <p>3. Që ka ngjyrë të afërt a të ngjashme me atë të gjakut; i kuqërremë. Lëkurë e kuqe. Tokë e kuqe. Flokë të kuq. Dyllë i kuq. Tulla të kuqe.</p> <p>Topalli (2017) fjalë e mbarë e gjuhës me burim të diskutueshëm. Mund të jetë trashëguar nga greqishtja «lënd e kuqe», «e kuqe e ndezur» ose mund të jetë huazim prej latinishtës. Cocceus «ngjyrë e kuqe». Kjo fjalë poashtu ka një list rrejedhojash: kuqal, kuqalash, kuqëlare, kuqelim, kuqlesh, kuqëson, skuq, i kuqërremë, i lëkuqtë, i lëkuqshëm, etj.</p>
5.	Gjelibër (masc.); e gjelibër (fem.)	<p>GJELBËR (FGJSH, 2007), (FGJSH, 1981)</p>

		<p>Ngjyra e gjelbër; bojë e gjelbër. E gjelbër e hapët (e mbyllët). Lyej me të gjelbër.</p> <p>GJELBËR <i>mb.</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Që ka ngjyrën e barit të njomë a të gjetheve të bimëve, i blertë. Ngjyrë e gjelbër. Gjethe të gjelbra. Bari i gjelbër. Sallatë e gjelbër. Pëlhurë (basmë) e gjelbër. Dritë e gjelbër. Shenja e gjelbër shenja që tregon se rruga është e lirë për kalim. Bëhet i gjelbër. 2. Që vjen si i kaltër në të verdhë. U bë i gjelbër në fytyrë. 3. Që është i mbuluar me bar të njomë a me gjethe, që ka bimësi të njomë, i blertë. Fushë (lëndinë) e gjelbër. Dru i gjelbër. Rri i gjelbër gjithë vitin nuk i bien gjethet. 4. Që nuk është pjekur ende (për frutat). Mollë të gjelbra. Rrush i gjelbër. <p>Topalli (2017): Fjalë dialektore e toskërishtës që është përgjithësuar në gjuhë. Huazim prej lat. «galbinus» Gegërishtja në vend të saj përdor i <i>blertë</i> (me burim të trashëguar) dhe <i>jeshil</i> nga turqishtja.</p>
6.	Blerhtë	<p>BLERTË <i>mb.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSH, 1981)</p> <p>Që ka ngjyrën e barit dhe të gjetheve të njoma, i gjelbër. Bar i blertë. Gjethe e blertë. Fushë e blertë. Ngjyrë e blertë.</p> <p>* Hardhja e blertë zool. zhapiu.</p> <p>Topalli (2017): <i>mb.</i> «i gjelbër». Fjalë e mbarë e gjuhës, e formuar me prapshtesën –të të mbiemrave nga një rrënjë *bler-, që shfaqet në rrjedhojat e krijuara: <i>bler</i>, <i>bleron</i>, <i>bleris</i>, <i>blerosh</i>, <i>blerishtë</i>, <i>blerueshëm</i> etj.</p>

7.	Jeshiltë	<p>JESHIL <i>mb. bised.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSH, 1981)</p> <p>1. I gjelbër. Ngjyrë jeshile. Sallatë jeshile një lloj lakre që bëhet sallatë. U bë jeshil (në fytyrë) mori në fytyrë një ngjyrë shumë të zbehtë nga frika, nga sëmundja etj.; u mavijos, u ir. Janë ende jeshile (pemët) nuk janë pjekur ende.</p> <p>2. si em. ~E, ~JA f. bised. Ngjyra e gjelbër. Jeshile e hapur (e çelur, e fortë, e thellë, e mbyllur). Veshur në jeshil.</p> <p>3. si em. ~E, ~JA f. ~E, ~ET dhe ~I m. ~E, ~ET. Tërësia e bimëve të gjelbra, e barishteve të njom a etj.; vend me këto bimë a barishte, vend i gjelbëruar. Në jeshile të fshatit. E lëshoi (kalin) në jeshile. Ra në jeshil bagëtia.</p> <p>* Myku jeshil (i gjelbër) bot. shih te MYK, ~U.</p> <p>Bojë bari, blerët, gjelbër, i rimtë, i preshtë (Dizdari, 2005)</p> <p><i>I gjelbër , i blertë.</i> Fjalë e mabrë e shqipës, që konkurron me me <i>i blertë</i></p> <p>Jeshilës “rosak i egër”, jeshilkë “gjelbëroshe”, jeshilon “gjelbëron”, jeshillëk “blerim”, i jeshiltë (Topalli, 2017:673)</p>
	Preshtë	<p>PRESHTË <i>mb.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSH, 1981)</p> <p>Në ngjyrë të preshit, i blertë. Bimë të preshta. Ngjyrë e preshtë.</p> <p>* Kalë të preshtë nuk ka fj. u. një gjë e tillë as që mund të jetë, është diçka e pamundur.</p> <p>i preshtë “i blertë , në ngjyrë të preshit”, preshton “gjelbëron” (Topalli, 2017)</p>
7.	Verdhë (masc); e verdhë (fem)	<p>VERDHË <i>mb.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSH, 1981)</p> <p>1. Që ka ngjyrën e kashtës, të limonit të pjekur, të squfurit a të arit. Ngjyrë (bojë) e verdhë. Pe i verdhë. Shami e verdhë. Fustan i verdhë. Trëndafil i verdhë. Lule të verdha. Qelibar i verdhë. Me flokë të verdhë. Armë të verdha armë të lara me flori.</p> <p>2. Që e ka fytyrën të zbehtë; i zbehtë (për fytyrën ose për pjesë të tjera të trupit të njeriut). I verdhë si ftua (si limon). I verdhë në fytyrë. Dyllë i verdhë shumë i zbehtë.</p> <p>3. bised. Që e ka ngjyrën e lëkurës si të verdhë a të zbehtë të errët (si tipar i jashtëm i një race të njerëzve), mongoloid. Raca e verdhë.</p>
8.	Sari	SARI <i>mb.</i>

		<p>Termi «sari» regjistrohët në FOGJSH si turqizëm. Fjalorët normative dhe FETGJSH (2017) nuk e regjistrojnë. Përdoret në dialektin e gegërishtës. Shpesh mund të dëgjohejt në të folmet e Kosovës dhe të Maqedonisë.</p> <p>1. ë <i>sarita</i>, ngjyrë e verdhë, i verdh në fytyrë, i zbetë 2. bojë sari, e verdhë: flokësari, mollë të sarita, shami të sarita Rrjedhojat e kësaj fjale janë i <i>saritur</i>, <i>saritem</i>, <i>sarillak</i> etj. dhe zakonisht përdoren me kuptimin e zbehjes së fytyrës.</p>
9.	Lulsë	<p>LULSË, mb. «i verdhë»: pej të lules, fytyrë e lules». Fjalë krahinore e geg. Formim i brendshëm prej emrit lule, duke u përgjithësuar ngjyra e verdh e disa luleve, çka e dëshmon mbiemri tjtër e lulme «e verdhë» (triko e lulme «e verdhë»). Rrjedhoja: lulësávem «zverdhem, zbehem» me prapashtesën –av, lulëmin me prapashtesën –im. (Topalli, 2017: 905) Fjalën për herë të parë e regjistroi M. Elezi në Fjalorin e gjuhës shqipe (2006).</p>
10.	Kaltër (masc.); e kaltër (fem.)	<p>KALTËR mb. (FGJSH, 2007), (FGJSH, 1981) 1. Që ka ngjyrën e qiellit të kthjellët, në ngjyrë të qiellit. Qiell (det) i kaltër. Me sy të kaltër. Bëhet i kaltër. 2. si em. ~ËR, ~RA (e) f. Ngjyra e kaltër. E kaltër e mbyllur. Ngjyey me të kaltër. Anon nga e kaltra. * Qymyri i kaltër energjia e valëve të detit, gjatë baticës e zbatícës, që shfrytëzohet për centralet elektrike. Si rrufe (si bubullimë) në qiell të kaltër (të kthjellët) libr. shih te BUBULLIM/Ë, ~A. Myku i kaltër bot. shih te MYK, ~U 1.</p> <p>Kaltër/kaltën: mb. Në ngjyrë të qiellit. Fjalë e mbarë e gjuhës shqipe, e përdorur më shumë në toskërishte, e njohur edhe në gegërishte. Rrjedhoja: kaltërim, kaltërimë, kaltërinë, kaltëror, kaltërosh, kaltërsi, i kaltërremë (i kaltër në të bardh) (Topalli, 2017:699)</p>
11.	Hirtë (masc.); e hirtë (fem.)	<p>HIRTË mb. (FGJSH, 2007), (FGJSH, 1981) Që ka ngjyrën e hirit. Ngjyrë (bojë) e hirtë. Cohë e hirtë. Sy të hirtë. Mjegulla e hirtë. Shelgu i hirtë. bot. Krimbi i hirtë. zool. Miu i hirtë. zool. Topalli nuk e regjistron termin <i>hirtë</i>.</p>

12.	Murrinë	<p>MURRË <i>mb.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSH, 1981)</p> <p>1. Që ka ngjyrë hiri të mbyllur si në të zezë, që vjen si i zi. Këmishë (fanellë, gunë) e murrme. Dhe (gur, shkëmb) i murrinë. Në ngjyrë të murrme. Është (dukjet) si i murrinë.</p> <p>2. Përdoret si pjesë e dytë në emërtimet e pathjeshta për disa kafshë, bimë a lëndë që janë tërësisht a pjesërisht në ngjyrë hiri të mbyllur si në të zezë. Krimbi i murrinë. zool. Miu i murrinë. zool. Ariu i murrinë. zool. Bretkosa e murrme. zool. Algat e murrme. bot. Ndryshku i murr</p> <p>2.më i grurit (i thekrës). bot. Tokat e murrme. Qymyri i murrinë. Giza e murrme.</p> <p>3. I vrenjtur (për qiellin, kohën etj.). Qiell i murrinë.</p> <p>4. edhe fig. Me pak dritë, jo plotësisht i errët. Natë e murrme. Agime të murrme.</p> <p>Murrinë: që ka ngjyrë hiri, në të zezë”.Fjalë e mbarë e gjuhës shqipe e trashëguar nga fondi indoeuropian. Lidhet me rrënjën <i>mer-</i>, <i>mor-</i> “nxij, ngjyrë e errët, njollë”, ku bëjnë pjesë disa fjalë nga greqishtja, rusishtja (mara-fëlliç, njollos), <i>maruška</i> (njollë, shenjë, nishan), çekishtja <i>morous</i> (bagëti me vija ngjyrë hiri), polonishtja <i>morag</i> (me vija të errëta). Nga rrënja e fjalës janë formuar: <i>murro</i>, <i>murrak</i>, <i>murrës</i>, <i>murriçë</i>, <i>murrash</i>, <i>murrëshë</i>, <i>murrëçkë</i>, <i>murriskë</i>, <i>murrel</i>, <i>i murrçimë</i>, <i>murçak</i>, <i>murriq</i>, <i>murroj</i>, <i>i murrëtyer</i>, <i>murrëtij</i>, <i>murrëtoj</i>, <i>i murrëteshëm</i>, <i>murrëtuar</i>, <i>murtis</i>, <i>murrmas</i>, etj... (Topalli, 2017: 1019)</p>
13.	Surme	<p>SURMË <i>mb.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSH, 1981), FETGJSH (2017)</p> <p>Që ka ngjyrë hiri të mbyllët, i murrinë. Trungjet e surmë të shelgjeve.</p> <p>Fjalë e greqishtes, HUazim prej sllavishtes, sur “i murrinë, i përhimë” me prapashtesën –m(ë). Nga rrënja sur janë formuar : i surtë , suran (i hirtë), suroj (ka i murrinë), formime të brendshme me prapashtesa. (Topalli, 2017: 1360)</p>
14.	Thjerme	<p>Fjalorët normative nuk e regjistrojnë. Topalli, i cili jep edhe burimin e Orelit e definon kështu: Thjerme: mb. I hirtë, ngjyrë hiri në të kaltër. Fjalë e gegërishtes, formim i brendshëm me prapashtesën –më nga their, thjerr “bizele”, që ka këtë ngjyrë. Topalli (2017:1517).</p>

15.	Thirrm Thirr	Regjistrohet te Orel (1998). Fjalorët normative dhe FETGJSH nuk e regjistrojnë. Thirr, m. “ <i>blozë</i> ”. Burim diskutueshëm. Mund të jetë i trashëguar nga fondi indoeuropian, duke u lidhur me rrënjën <i>keir-</i> nga <i>kei-</i> “në emërtime ngjyrash”, sidomos për ngjyra të errëta”, ku bënë pjesë irl. Mes cir. Në <i>cir-cub</i> “e zezë qymyr”, duke u nisur nga ngjyra (Orel, 1988). Një burim tjetër mund të jetë folja ther me emrin thërrime, duke u nisur nga përbërja; ose mund të ketë afri me sll. (rus) <i>sera</i> “squfur”, duke u nisur nga djegja e tymi. (Çabej në Topalli, 2017: 1516)
16.	Murg	MURG “që ka ngjyrë të errët, i vrenjtur” (Orel 1988, Topalli, 2017)
17.	Kaftë (masc.); i kaftë (fem.)	KAFENJTË <i>mb.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSSH, 1981) Që ka ngjyrë kafe. Fustan (qilim) i kafenjtë. Toka të kafenjtja. bujq. toka me ngjyrë kafe të errët, të formuara në zonat pyjore me dushk, të pasura me humus dhe shumë pjellore. Topalli (2017) e regjistron si rrjedhoj e fjalës KAFE. Regjistron edhe format “i kaferenjtë, i kaftë e kafetar me burim nga turqishtja. (Topalli, 2017: 688)
18.	Portokalli	PORTOKALLI <i>mb. bised.</i> (FGJSH, 2017), (FGJSSH, 1981) Që e ka ngjyrën si ajo e lëkurës së portokallit të pjekur. Fustan portokalli. E verdh ne4 të kuqe. PORTOKALLTË <i>mb.</i> Që ka ngjyrë të verdhë në të kuqe, që vjen si i verdhë, portokalli. Ngjyrë e portokalltë. Dritë e portokalltë. Perëndim i portokalltë. Topalli (2017) shënon se sipas Meyerit kjo fjalë është huazim nga greqishtja, ndërsa sipas Dizdari fjala bëhet për një turqizëm. Mbiemri i cili e denoton ngjyrën vjen si rrjedhoj e huazimin “portokall” (Topalli, 2017: 1173)
19.	Purpurtë (masc.); e purpurtë (fem.)	PURPURT <i>mb.</i> 1. Që ka ngjyrë të kuqe të ndezur, që është në ngjyrë si të purpurit. Me buzë të purpurta. Re të purpurta. Në ngjyrë të purpurt. 2. Që është bërë prej purpuri. Pelerinë e purpurt.

		Fjala vjen si rrjedhoj e fjalës purpur e cila emërton një lënd të posaçme në ngjyrë të kuqe e ndezur”. Huazim i ri nga latinishtja. (Topalli, 2017: 1201)
20.	Pembe	PEMBE Fjala regjistrohet vetëm në FOGJSH. Dëgjohet shpesh në gjuhën e folur te4 dialektit gegë. Bojë pembe “ngjyrë trëndafil” nga persishtja Penbe= pambuk (Dizdari, 2005)
21.	Rozë	ROZË Termi nuk regjistrohet as në fjalorët normative e as në fjalorët e specializuara. Por haset shpesh në regjistra të shkruara dhe në gjuhëne folur. Është sinonimi i fjalës <i>Pembe</i> dhe <i>pink</i> .
22.	Trëndafil të	TRËNDAFILTË <i>mb.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSSH, 1981) 1. Që ka ngjyrë të çelur ndërmjet së kuqes e së bardhës, në ngjyrë trëndafili; që ka ngjyrë afërsisht të tillë. Lule të trëndafilita. Me faqe të trëndafilita. Me fytyrë të trëndafilitë. Këmishë e trëndafilitë. Agim (mëngjes) i trëndafilitë. Dritë e trëndafilitë. Qiell Sipas Topallit fjala vjen si rrjedhoj e trënjës trëndafil, e cila regjistrohet si huazim nga greqishtja. (Topalli, 2017:1488)
23.	Rimtë	RIMTË <i>mb.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSSH, 1981) 1. Që ka ngjyrë qielli të mbyllur në të hirtë a në të gjelbër; i bruztë. Qiell i rimtë. Mëngjes (muzg) i rimtë. Tym (ajër) i rimtë. Re të rimta. Me sy të rimtë. Bluzë e rimtë. Lule e rimtë. “i kaltër, i bruztë”, , fjale4 e dy dialekteve. Formim i brendshëm prej remtë me prapashtesën –të nga rem “bakër”. Edhe në gjuhë tjera emrat e disa metaleve, si rem, bronz etj. kanë dhën emra ngjyrash (it. Abronzato “i nxirë”). (Topalli, 2017:1251)
24.	Bruz të	BRUZTË <i>mb.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSSH, 1981) 1. Që është në ngjyrë si të kaltër, në ngjyrë qielli të mbyllur. Qiell (det) i bruztë. Fustan i bruztë. Sy të bruztë. Mermer i bruztë. Shkëlqim i bruztë. Topalli e regjistron si rrjedhoj e fjalës “bruz” që e ka kuptimin e gurit të çmueshëm të forte, me ngjyrë qielli në të gjelbër”. Metali

		i bronzit edhe në gjuhë të tjera ka shënuar ngjyra; khs. It. Bronzeo, abbronzato etj. (Topalli, 2017: 255)
25.	Brut	Fjala nuk regjistrohet në FETGJSH, FGJSH, FGJSSH Oreli (1998) e regjistron në këtë mënyrë: brut adj. 'blue, indigo'. From PAIB *hrudja e krasuar me Sllav. *brudi, `ndryshk', *brudts,n7, 'dirty' < IE *bhrou-dh-, cf. *bhrou-t- in Thrac ripoirrog 'barley beer' (OREL Linguistica XXVI 175). 0 DETSCHWEU Thr. Sprachreste 93; cABEJ Etim. II 336 (to barre); TRUBAC'EV ESSJa II 44.
26.	Mavi	MAVI <i>mb. bised.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSSH, 1998) 1. I kaltër, blu e mbyllur. Shirit mavi. Pëlhurë mavi. Iu bë syri (krah, fytyra, plaga) mavi. 2. si em. ~, ~A f. Ngjyra mavi. Mavi e hapur. * Iu bë gjaku mavi u tremb, u frikësua shumë. U bë mavi në fytyrë u nxi nga inati etj. Dizdari (2005): ngjyrë e kaltërt, e rimtë, bojë qielli, bruz, blu ar. Ma'i – ujësore, që i përket ujit Topalli (2017): mb. “i kaltër”, fjalë e mbarë gjuhës, me përdorim të kufizuar në shqipen e sotme. HUazim prej turqishtës. Si rrjedhojë i kemi fjalës: mavis “i bëj mavi”, mavijos, mavush, mavushkë “gjel a pulë me pendë mavi”, mavizë “pjesa e mavijosur rreth syve
27.	Jargavan	JARGAVAN <i>m. bot.</i> (FGJSH, 2007), (FGJSSH, 1981) ngjyra vjollcë e kësaj luleje. Ngjyrë (erë) jargavani. Topalli (2017): Fjalë e mbarë e gjuhës me forma të shumta dialektore: <i>argavan, arkivan, arkavan, jarkivan. Erguvan</i> si huazim prej turqishtës përdoret në Shkodër.
24.	Vjollcë	FGJSH(2007), (FGJSSH, 1981): 1.Ngjyrë vjollce ngjyrë e kaltër si në të kuqe 2.përd. mb. bised. Që ka ngjyrën e lules së kësaj bime. Topalli (2017): “lule me gjethe si zemër”, që çel në pranverë, lat. Viola. Nuk regjistrohet si emër ngjyre.
25.	Gjyvez	Kjo fjalë regjistrohet si turqizëm në FOGJSH (2005) dhe në fjalorin normativ FGJSSH (1981) . FGJSH (2007) nuk e regjistron. NUK e shënon as FETGJSH.

